

KDU 308(05)
94(05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

STUDIME SHOQËRORE

2

2015

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

STUDIME SHOQËRORE

2

2015



PRISHTINË
2015

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

STUDIME SHOQËRORE

2

2015

Këshilli redaktues - Editorial Board

Pajazit Nushi - Kryeredaktor / Editor-in-chief

Edi Shukriu - Sekretar, Secretary

Robert Elsie, Anëtar, Member

Arsim Bajrami, Anëtar, Member

Jusuf Bajraktari, Anëtar, Member

Anton Berishaj, Anëtar, Member

Adresa / Address:

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Redaksia e revistës *Studime Shoqërore*

Rr. Agim Ramadani, p.n.

10 000 Prishtinë

Republika e Kosovës

Tel. + 381 38 249 303

Fax. + 381 38 244 636

E-mail: ashak@ashak.org

Copyright © ASHAK

PËRMBAJTJA

PJESA HYRËSE.....	9
Hivzi ISLAMI, Prishtinë	11
LUGINA E PRESHEVËS: PËRBËRJA ETNIKE DHE EVOLUCIONI I SAJ.....	11
Ibrahim RAMADANI, Prishtinë	35
PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT METROPOLITAN TË QYTETIT TË PRISHTINËS	35
Arsim EJUPI, Prishtinë	45
TRASHËGIMIA KULTURORE NË LUGINËN E PRESHEVËS: GJENDJA DHE PERSPEKTIVA	45
Blerim LATIFI, Prishtinë	67
MBI RRYMAT E ISLAMIT BASHKËKOHOR, KONCEPTIN E LUFTËS SË SHENJTË DHE LEXIMIN E KURANIT	67
Alban BAKIA, Prishtinë	93
IDENTITETI KOMBËTAR DHE MUZETË.....	93
Anton VUKPALAJ, Prishtinë	111
BAJRAKU, INSTITUCION POLITIKO - ADMINISTRATIV OSMAN NË AMBIENTIN E ALPEVE SHQIPTARE.....	111
Zenun HALILI, Prishtinë	133
KUSHTETUTA - GURTHEMEL I DEMOKRACISË AMERIKANE.....	133
Nerxhivane KRASNIQI, Prishtinë	143
HULUMTIMI I PJEKURISË EMOCIONALE TË NXËNËSVE ADOLESHENTË NË SHKOLLËN E MESME TEKNIKE “28 NËNTORI” NË PRISHTINË.....	143
TRYEZA: ARKEOLOGJIA NË TROJET SHQIPTARE: SFIDAT DHE MUNDËSITË	153
Edi SHUKRIU, Prishtinë	155
SFIDAT DHE MUNDËSITË E ARKEOLOGJISË SHQIPTARE.....	155
Exhlale DOBRUNA-SALIHU, Prishtinë	161
QASJE E RE NË ARKEOLOGJINË KOSOVARE DHE GJTHËSHQIPTARE	161
Luan PERZHITA, Tiranë	167
SFIDAT E ARKEOLOGJISË SHQIPTARE NË MIJËVJEÇARIN E RI.....	167

Mixhait POLLOZHANI, Strugë	171
DYERT E MBYLLURA TË ARKEOLOGJISË PËR SHQIPTARËT NË MAQEDONI.....	171
KONFERENCA SHKENCORE: LUFTA E PARË BOTËRORE DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE 1914 – 1918	179
Pajazit NUSHI, Prishtinë	183
GJYKIMET DHE VLERËSIMET E ARGUMENTUARA PËR LUFTËN E PARË BOTËRORE - KOD UNIVERSAL I VEPRIMTARISË SË GJITHMBARSHME TË ASHAK.....	183
Beqir META, Tiranë	189
NDIKIMI I LUFTËS SË I BOTËRORE NË PROCESIN E KONSOLIDIMIT TË KOMBIT SHQIPTAR.....	189
Jusuf BAJRAKTARI, Prishtinë	205
KOSOVA DHE VISET E TJERA SHQIPTARE GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE.....	205
Marenglen VERLI, Tiranë	211
SHQIPËRIA NË OPTIKËN E DIPLOMACISË VJENEZE NË PRAG TË LUFTËS SË PARË BOTËRORE.....	211
Anton PANCHEV, Sofje	223
STATISTIKAT BULLGARE MBI POPULLSINË E KOSOVËS NË LUFTËN E PARË BOTRORE.....	223
Skender ASANI, Shkup	231
VISET LINDORE SHQIPTARE NËN PUSHTIMIN SERB (1912 – 1915).....	231
Fehmi REXHEPI, Prishtinë	243
ZONA OKUPUESE BULLGARE E KOSOVËS GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE.....	243
Frashër DEMAJ, Prishtinë	259
DIPLOMACIA E FUQIVE TË MËDHA GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE.....	259
Isa BICAJ, Prishtinë	271
MALI I ZI DHE SHQIPTARËT GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE.....	271
Islam LAUKA, Tiranë	275
SINDROMI I LUFTËS SË PARË BOTËRORE DHE LUFTA AKTUALE MIDIS RUSISË DHE UKRAINËS.....	275
Ramë MANAJ, Prishtinë	287
LËNDA ARKIVORE PËR LUFTËN E PARË BOTËRORE NË ARKIVIN E KOSOVËS.....	287

Lush Culaj, Prishtinë	291
PROTESTAT E SHQIPTARËVE, DËRGUAR KONFERENCËS SË VERSAJËS.....	291
RECENSIONE	305
Arsim BAJRAMI, <i>Historia e konstitucionalizmit shqiptar,</i> Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2014, f.572.	307
Anton KOLË BERISHAJ, <i>Shoqëria pa shtet - studim</i> <i>socioantropologjik</i>, ASHAK, Prishtinë, 2014, f. 275.	312
Edi SHUKRIU, <i>Hyjnesha Dardane</i>, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2014, f. 190.	317
Hivzi ISLAMI – Arsim EJUPI, <i>Popullsia dhe vendbanimet</i> <i>shqiptare të Luginës së Preshevës - Gjendja dhe rrjedhat</i> <i>bashkëkohore</i>, Botim i ASHAK-ut, Prishtinë, 2015.	319
Ekrem MURTEZAI, <i>Hyrje konceptuale në filozofi</i>, ASHAK, Prishtinë, 2015, f. 390.	323
Pajazit NUSHI, <i>Leksikoni i Psikologjisë në dy vëllime,</i> Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2014, f.1130.	326
FJALIME PËRMORTORE	329
FJALA E HIVZI ISLAMIT PËR AKADEMIK ENGJËLL BERISHËN	331
FJALA E HIVZI ISLAMIT PËR AKADEMIK RUZHDI PLLANËN	332
FJALA E PAJAZIT NUSHIT PËR AKADEMIK BESIM BOKSHIN.....	334
FJALA E ZEQRIRJA BALLATËS PËR AKADEMIK ENGJËLL BERISHËN.....	336
FJALA E FEJZULLAH KRASNIQIT PËR ANËTARIN KORRESPONDENT RUZHDI PLLANA	340
FJALA E LUAN MULLIQIT PËR AKADEMIKUN ENGJËLL BERISHA	343
KRONIKA 2014	345

PJESA HYRËSE

Udhëzime për autorët e punimeve të propozuara për botim

Për botim në revistën *Studime shoqërore* do të merren në konsideratë ndihmesat (trajtesa, studime, artikuj, recensione, etj.) që nuk janë botuar më parë (pos në raste të veçanta) dhe që paraqesin rezultate hulumtimesh origjinale shkencore, profesionale apo të zbatuara nga ana e autorit në fushat e shkencave shoqërore, duke mos prekur të drejtat autoriale të të tjerëve. Për të gjitha punimet e paraqitura për rubrikën Artikuj – studime, Redaksia merr parasysh procedurën e vlerësimit, përkatësisht recensimit. Recensionin mbetet në Redaksi, ndërsa emrat e recensentëve nuk bëhen të njohur për autorin e punimit. Për të tjerat vendos Redaksia. Për origjinalitetin dhe cilësinë e ndihmesave përgjigjen vetë autorët.

Punimi shkencor i paraqitur duhet të përmbajë:

Emrin dhe mbiemrin e autorit, vendin ku jeton e vepron aktualisht dhe titullin e punimit. Pastaj vjen abstrakti me jo më shumë se 200 fjalë dhe në vijim, para punimit, shënohen deri në 10 fjalë çelësa termat kryesorë. Punimi ose trajtesa shkencore mund të shtrihet më së shumti deri në 10 faqe të formatit A4 të radhitura me kompjuter Microsoft Word (210x297 mm), me margjina 20 mm, në fontin Times New Roman 12 pt me radhor normal. Në fund punimi artikulli duhet të ketë një rezymë në rreth 1 faqe. Nëse punimi është në një gjuhë zyrtare të Kosovës, rezymëja duhet të jetë në një prej gjuhëve me qarkullim të gjerë (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) dhe e kundërta. Abstrakti, fjalët a termat çelësa, rezymëja dhe bibliografia duhet të jenë në Times New Roman 10 pt. Literatura e punimit jepet në fund, ndërsa fusnotat në tekstin me të cilin ndërlidhen shënohen në fund të çdo faqeje. Figurat dhe tabelat jepen në tekst. Në literaturë dhe fusnota duhet të shënohen: mbiemri dhe emri i autorit, titulli i punimit të cituar, titulli i publikimit, botuesi, vendi i botimit, viti i botimit, numri i faqes (faqeve). Kur citohet shqip shënohet f. për një f. dhe ff. për më shumë faqe (në gjuhë tjetër: p. apo pp.).

Referimet në fusnotë zakonisht shënohen si vijon:

BUDA, Aleks (2006) “Studime historike”, ASHAK, Prishtinë, ff. 604.
SHULTZ P. Duane (1969) “A history of Modern Psychology”,
Hercourt Brace College Publishers, ff. 511.

Citimi i një punimi në revistë:

ANDREA, Zhaneta (1997) Tuma e Cerujës (Rrethi i Gramshit) - Le
tumulus de Ceruje, ILIRIA 1 - 2, Tiranë, pp. 85 - 93.

Ndihmesa e propozuar duhet të jetë korrektuar gjuhësisht sipas rregullave të drejtshkrimit të shqipes standarde ose të gjuhës në të cilën është shkruar. Redaksisë i dorëzohet versioni elektronik. Autorët që përdorin shenja të veçanta duhet t'i dorëzojnë edhe fontet përkatëse, ashtu si dhe një version në letër apo PDF për identifikim të shenjave të veçanta.

Dorëshkrimet nuk kthehen. Redaksia rezervon të drejtën për të mos dhënë shpjegime në rast se nuk botohet punimi, artikulli, trajtesa apo ndihmesa e paraqitur.

Redaksia

LUGINA E PRESHEVËS: PËRBËRJA ETNIKE DHE EVOLUCIONI I SAJ

KDU 908(=18:497.11)

314(=18:497.11)

Abstrakt

Me pozitën e saj komplekse natyrore-gjeografike dhe komunikuese - strategjike, Lugina e Preshevës, në të gjitha kohët, në kuadër të zhvillimeve të gjera gjeopolitike dhe etnodemografike, ishte dhe mbeti një nyje në vete neuralgjike. Aspiratat e Serbisë, por edhe e të tjerëve për dominim politik, ekonomik dhe gjeostrategjik, nuk pushuan kurrë për këtë territor. Prandaj, në kohë të caktuara bëhej edhe evidentimi i popullatës së Luginës. Format e para të regjistrimit të popullsisë dhe të pasurisë të këtij territori, në kohën turke, ishin sallnamet dhe defterët, që mbaheshin kryesisht për qëllime tatimore.

Sipas statistikave zyrtare të Vilajetit, në fund të viteve të 90-ta të shekullit XIX, Kazaja e Preshevës kishte një popullsi prej rreth 43.000 banorësh, prej të cilëve shumica ishin të krishterë. Vetë qyteti i Preshevës atëherë, vlerësohet t'i kishte rreth 600 shtëpi, me rreth 5.000 banorë, pa u saktësuar përkatësia fetare dhe kombëtare. Ndërkaq, midis dy luftërave botërore, u realizuan dy regjistrime të popullsisë, më 1921 dhe 1931, dhe ndonëse të dhënat u mblodhën vetëm sipas përkatësisë gjuhësore dhe konfesionale, megjithatë lehtë del edhe përkatësia etnike, sepse besimit të krishterë-ortodoks i përkiste vetëm popullsia serbe, ndërsa besimit mysliman, pothuajse vetëm shqiptarët dhe simbolikisht turqit.

Në këtë periudhë ndodhën ndryshime në përbërjen etnike dhe fetare, por gjithnjë në dëm të shqiptarëve dhe myslimanëve, për shkak të shpërnguljes së dhunshme për në Turqi dhe të kolonizimit me popullatë serbe, që nga viti 1912. Në Preshevë, pjesëmarrja e popullsisë myslimane zvogëlohet, nga 89,4% më 1921 në 76,1% më 1931; në Bilaç nga 76,2% në 64,1%; në Bujanoc nga 58,3% në 57,1% dhe në disa vendbanime të tjera rënia shkonte nga 75% në vitin 1921 në 38% në vitin 1931. Ndërkaq, pjesëmarrja e popullsisë ortodokse (serbe) në periudhën brenda viteve 1921-1931 shënon një rritje në shumicën e vendbanimeve të Rrethit të Preshevës: në Preshevë nga 10,6% në 23,7%, pastaj në Bilaç nga 23,8% në 35,8%, në Bujanoc nga 41,7% në 42,7%, në vendbanime të tjera nga 27% në 38%.

Pas Luftës së Dytë Botërore, sipas regjistrimeve zyrtare, numri i popullsisë shqiptare të Luginës së Preshevës, deri në vitin 1991 shënon rritje të vazhdueshme: pjesëmarrja e saj në strukturën etnike rritet nga 44% në vitin 1961 në 79% në vitin 1991. Ndërkaq, sipas regjistrimit zyrtar të vitit 2002 pason një rënie: arsytet janë shpërngulja dhe ndërrimi i konceptcionit (nga "popullsia e përhershme" në "popullsi të pranishme"). Mirëpo, këto vitet e fundit, për shkak të moszhvillimit ekonomik, të paramenduar e të qëllimshëm të regjimit serb dhe presioneve policore-ushtarake të Serbisë, Lugina... intensivisht po boshatiset nga shqiptarët. Shumë vendbanime kanë mbetur pa njerëz, duke u mbyllur edhe shtëpitë dhe rrjedhimisht duke u zvogëluar në mënyrë drastike numri i nxënësve dhe i paraleleve në klasat e ulëta të shkollës fillore, si indikator kryesor i procesit intensiv emigrues dhe i regresit të përgjithshëm

demografik. Nga 136 vendbanime sa ka ky territor, popullata shqiptare shtrihet në 64 sosh, të tipit rural dhe në tri qendra të karakterit urban (Presheva, Bujanoci dhe Medvegja), ndërsa vendbanimet e tjera janë të populluara nga serbët. Shqiptarët me shumicë absolute jetojnë në 41 vendbanime.

Fjalët çelës: Lugina, përbërja etnike, ndryshimi i strukturës etnike, shqiptarët, serbët, përkatësia konfesionale, kolonizimi, shpërngulja intensive, regresi demografik

Historia e Ballkanit, veçanërisht pjesa qendrore e tij ku shtrihet Kosova, Lugina e Preshevës dhe viset e tjera etnike shqiptare, është shumë e ndërlikuar dhe komplekse. Kjo pjesë e Ballkanit, gjatë gjithë historisë, ishte vatër e lëvizjeve, kontakteve dhe konflikteve të popujve dhe kryqëzimit e shtresëzimit të kulturave dhe civilizimeve të ndryshme. Me depërtimin e romakëve, sundimin e gjatë të Bizantit në mesjetë, ardhjen e sllavëve, e më vonë edhe të turqve, në Ballkan u krijuan raporte të reja në strukturën e popullimit dhe ndodhën ndryshime të konsiderueshme në pasqyrën etnike, ku “dendësia etnike në të gjitha trevat e Ballkanit nuk ishte njësoj; në disa pika të tij ishin rrasur shumë popuj, duke u shtruar njëri mbi tjetrin”.¹

Në këto lëvizje dhe shtresëzime më së shumti pësoi etnikumi ilir-shqiptar, i cili dikur, i shtrirë në tërë Siujdhesën Ballkanike, me romanizimin e një pjese të madhe,² do të rrudhet dukshëm në kohën e vonë antike, proces ky që do të vazhdojë edhe në mesjetë, kur do të sllavizohen masa të mëdha shqiptarësh.³ Në truallin gjeoetnik të shqiptarëve u bë edhe prerja e kulturave perëndimore dhe lindore, që la pasoja të shumënduarshme, ndërsa ndarjet e njëpasnjëshme të hapësirës etnike shqiptare, popullit shqiptar i sollën tragjeditë më të mëdha në të gjitha rrafshet, me të cilat edhe sot e gjithë ditën po ballafaqohet.⁴

¹ I. Ajeti, në *Studime*, 2/1995, ASHAK, Prishtinë, 1996, f. 289.

² Z. Mirdita, *Studime dardane*, Rilindja, Prishtinë, 1979, ff. 118-128.

³ Shih më gjerë: A. Handžić, “Nekoliko vijesti o Arbanasima na Kosovu i Metohiji sredinom XV vijeka”, *Simpozium për Skënderbeun*, Prishtinë, 1969, ff. 201-209; H. Hadžibegić, A. Handžić, E. Kovačević, *Oblast Brankovića - opširni katastarski popis iz 1445 godine*, Sarajevo, 1972; S. Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI*, Tiranë, 1984, ff. 1-721; S. Pulaha, “Nahija e Altun-ilisë dhe popullsia e saj në fund të shekullit XV”, *Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave historike*, I-1971, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1972, ff. 193-272; S. Pulaha, “Krahinat verilindore të sanxhakut të Dukagjinit - Hasi dhe popullsia e tyre në gjysmën e shekullit XVI”, *Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave historike*, II-1972, Prishtinë, 1974, ff. 185-336; M. Tërnavë, “Shqiptarët në qytetet e Kosovës në shekullin XV-XVI”, *Studime historike*, 2, Tiranë, 1979, ff. 105-145; M. Tërnavë, *Studime për mesjetën*, Dukagjini, Pejë, 2000, ff. 85-278.

⁴ R. Ismajli, “Shqiptarët dhe Evropa Juglindore”, *Thema*, 11, Prishtinë, 1993, ff. 29-38.

Dimensioni etnik-demografik i Kosovës dhe i trojeve shqiptare në përgjithësi, tashmë një kohë të gjatë është bërë objekt i spekulimeve të historiografisë dhe antropogjeografisë serbe dhe pastaj edhe i qarqeve dhe regjimeve politike serbe dhe serbo-jugosllave. Qarqet shkencore dhe politike serbe, për t'i jetësuar aspiratat shekullore për dominim dhe hegjemoni ndaj Kosovës, përveç me të ashtuquajturën “të drejtë historike” dhe Kosovën si “territor të shpirtit mesjetar serb”, spekulonin pandërprerë edhe me “argumentin demografik”, me qëllim që Kosova të kundrohej si “çështje ekskluzivisht serbe” dhe “ekzistencë e popullit serb”,⁵ ndërsa shqiptarët të privoheshin edhe nga të drejtat e tyre historike, edhe të drejtat e tyre aktuale, jo vetëm për të vendosur vetë për fatin e tyre, por edhe për të jetuar në Kosovë! Sipas tyre, shqiptarët na qenkan këtu “element i huaj”, “i ardhur” këta 2-3 shekujt e fundit, madje edhe pas vitit 1941 si “uzurpatorë” në territorin e “shpirtit mesjetar serb”, etj. Prandaj, të gjitha pushtetet serbo-jugosllave ndërmorën aksione të vazhdueshme për gjymtimin e homogjenitetit etnik të trojeve shqiptare, ndërrimin e përbërjes etnodemografike dhe dobësimin e fuqisë vitale të popullatës shqiptare me masa të ndryshme të presionit e të terrorit.⁶

Pas demonstratave të masive të shqiptarëve, në vitin 1981, për liri dhe barazi në Kosovë, në ish-Jugosllavi zhvillohej një diskurs dhe fushatë e gjerë kundër Kosovës dhe shqiptarëve, në kuadër të të cilave vend të rëndësishëm zinin problemet e tyre demografike, veçanërisht niveli i natalitetit, numri, rritja demografike, shtrirja e gjerë dhe territorialisht kompakte dhe perspektiva e tyre e përgjithshme. Ky diskurs ndaj natalitetit dhe shtimit natyror të shqiptarëve ishte sa neomaltusianist, aq edhe shovinist; ai zhvillohej në mungesë të plotë të gjykimit racional, duke u injoruar ligjësitë objektive të zhvillimit shoqëror dhe qasjet humaniste e shkencore ndaj zhvillimit të popullsisë së një kombi të tërë.⁷ Jo vetëm që me të madhe përdoreheshin termat “eksplozion demografik” dhe “ekspansion demografik” i shqiptarëve të kohës së dominimeve kolonialiste dhe neokolonialiste, por indoktrinimi antinatalitet dhe antishqiptar kishte marrë përmasa të gjera në të gjitha shtresat e shoqërisë serbo-jugosllave, sa që fyhej rëndë femra shqiptare, e cila në çdo forum politik dhe në medime cilësohej si “makinë për

⁵ Shih më gjerë: D. Bogdanović, *Knjiga o Kosovu*, SANU, Beograd, 1986.

⁶ Më gjerë në: H. Islami, *Dimensioni demografik i çështjes së Kosovës*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Prishtinë, 1997, ff. 219-220, 233-234.

⁷ H. Islami, “Demografski problemi Kosova i njihovo tumačenje”, në *Zbornik Kosovo-Srbija-Jugoslavija*, Knjižna zbirka Krt 46, Ljubljana, 1989, ff. 39-66.

prodhimin e fëmijëve”. Në mitingjet populliste-nacionaliste bëhej homogjenizimi dhe mobilizimi etnik i masave serbe dhe shfrytëzohej e tërë energjia e popullit “hyjnor” serb kundër shqiptarëve dhe përgatitjes për konfrontim me të gjithë popujt joserbë.

Në gjithë ish-shtetin, shqiptarofobia mori përmasa shqetësuese dhe shqiptarët nisën të numëroheshin.⁸ Nxirreshin edhe parulla me përmbajtje thjesht raciste e gjenocidale, si p. sh. “Shqiptarët shumohen shumë, por farën e kanë të prishur”, “Shqiptarët duhet dëbuar!”, “Shqiptarët duhet vrarë!” etj. Për këtë qëllim u nxorën vendime e rezoluta partiake e pushtetore, madje edhe ligje me përmbajtje neomaltusianiste dhe raciste dhe pasuan disa valë të kolonizimit të serbëve në Kosovë dhe të ndjekjes së shqiptarëve nga Kosova me masa të presionit politik, ekonomik, psikologjik, policor e ushtarak.⁹ Në të gjitha synimet dhe projektet serbe të gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe gjatë gjithë shekullit XX ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, si pjesë të programit nacional serb, në mposhtjen e faktorit demografik shqiptar dhe në sendërtimin e aspiratave shtetomëdha serbe, pëlleshmëria e femrës shqiptare konsiderohej si një nga pengesat më të mëdha.¹⁰

⁸ Pas akuzave të pandërprera për qëllime manipulative politike se shqiptarët po lindin shumë fëmijë me synim të shqiptarizimit të Kosovës dhe formimit të “Shqipërisë së Madhe”, angazhimi dhe përfundimi zyrtar serb pas gjysmës së viteve të 90-ta nisi të shkojë në një drejtim krejt tjetër: në strukturën etnike të Kosovës nuk dominojnë shqiptarët, por bashkësitë e tjera kombëtare (!), disa prej të cilave as që kanë ekzistuar ndonjëherë. Në përputhje me “standardet evropiane”, shteti serb dhe partitë “opozitare” të saj kishin vendosur t’u ofronin të gjitha të drejtat shqiptarëve, mirëpo kërkonin të respektohej realiteti i ri demografiko-etnik i Kosovës, i cili nuk është më ai që e konfirmonin dhe e vajtonin deri dje.. Prandaj nis fushata fantastike e zvogëlimit të numrit të shqiptarëve dhe e rritjes së numrit të tjerëve, veçanërisht e serbëve, e cila bëhet më transparente në prag dhe gjatë Konferencës së Rambujesë (fillim i vitit 1999) nga ana e përfaqësuesve të Serbisë dhe veçanërisht të kryetarit të atëhershëm të saj M. Millutinoviç, i cili, pa fije turpi, theksonte se në Kosovë shqiptarët nuk janë shumicë, por janë nën 50% e madje nën 40%, duke i abstrahuar vlerësimet e vetë institucioneve përkatëse statistikore të Beogradit se shqiptarët në vitin 1991 në popullsinë e përgjithshme të Kosovës përbënin 82,2% (*Stanovništvo i domaćinstva SR Jugoslavije prema popisu 1991, Stanovništvo 47*, Savezni zavod za statistiku, Centar za demografska istraživanja Instituta društvenih nauka, Beograd, 1995, f. 205).

⁹ Për valët e kolonizimit të Kosovës me serbë me masa të ndryshme të stimulimit e të privilegjeve dhe të shpërnguljes së shqiptarëve me një varg mjetesh presioni e dhune shih më hollësisht: H. Islami, *Dimensioni demografik i çështjes së Kosovës*, ETMMK, Prishtinë, 1997, ff. 177-205.

¹⁰ Çubrilloviç qysh në elaboratin e parë racist e fashisoid kundër shqiptarëve (1937), duke iu referuar qëndrimeve të Cvijiçit, e veçonte këtë komponent të

Edhe Lugina e Preshevës, me pozitën e saj komplekse natyrore-gjeografike dhe komunikuese-strategjike, ishte dhe mbeti një nyje në vete neuralgjike në kuadër të zhvillimeve të gjera gjeopolitike dhe etnodemografike. Interesat e Serbisë dhe të tjerëve nuk pushuan kurrë për hapësirën e Luginës, sikundër as aspiratat për dominim politik, ekonomik dhe gjeostrategjik. Në tendencat për t'u zgjeruar me territore dhe pushtet nga jugu në veri dhe nga perëndimi në lindje dhe e kundërta, në Luginë janë ndeshur perandoritë, të mëdha ose të vogla, njëra pas tjetrës: romake, pastaj bizantine, sllave, osmane, serbo-jugosllave, serbo-komuniste dhe serbo-milloshëviqiane.

Rrethanat e përmendura dhe interesat e të tjerëve bënë që shumë herët Presheva të fitojë karakteristikat dhe funksionet e një qendre urbane në të cilin gravitonin vendbanimet e rajonit. Kështu, nga një defter i shekullit XV (1489) vendbanimi paraqitet si një nga selitë e vilajetit të Preshevës, me emrin Preshova. Sipas historianit S. Rizaj, Presheva “gjatë tërë kohës moderne e mban funksionin e qytezës”.¹¹ Informatat e para për numrin e popullsisë së Preshevës me rrethinë i gjejmë në kohën e Perandorisë Osmane. Në fakt, këto janë format e para të regjistrimit të popullsisë dhe pasurisë në Luginën e Preshevës. Ato janë kryesisht *sallnamet* dhe *defterët*, të cilat pushteti osman i mbante për ta regjistruar popullatën për qëllime tatimore. Në funksion të mbledhjes së taksave, pushteti osman, në shekullin XVI realizoi tri regjistrime për numrin e familjeve (në vitet 1519, 1528 dhe 1570) dhe atë vetëm sipas përkatësisë fetare. Kazaja e Preshevës, sipas statistikave zyrtare të Vilajetit, në vitin 1883, kishte 15.846 banorë, prej të cilëve 8.525 myslimanë dhe 7.321 jomyslimanë,¹² kurse sipas burimeve të njëjta Kazaja e Preshevës në vitin 1896/7 përfshinte 122 fshatra me 6.958 ekonomi familjare dhe 42.248 banorë, prej të tyre 22.224 meshkuj dhe 20.024 femra.¹³ Kjo kaza, sipas vjetarëve të viteve 1896 (1314 hixhri) dhe 1900 (1318 hixhri) “kishte një popullsi

progresit demografik të shqiptarëve. Në këtë elaborat V. Çubrilloviqi theksonte: “Në rastin tonë kemi të bëjmë me një racë të gjallë, të fuqishme dhe të pëlleshme për të cilën i ndjeri Cvijiq ka thënë se është raca më ekspansive në Ballkan” (V. Čubrilović, *I seljavanje Arnauta*, Predavanje održano u Srpskom kulturnom klubu od Dr. Vase Čubrilovića, 7. marta 1937. godine, Vojnoistorijski institut, Arhiv bivše jugoslovenske vojske, Br.2, Fasc. 4, Kutija 69, f. XIX).

¹¹ S. Rizaj, *Kaza Prešova 1896/7 godine. Vranjski Glasnik*, Knjiga br. II, Vranje, 1966.

¹² S. Rizaj, *Struktura stanovništva Kosovskog Vilajeta u drugoj polovini XIX stoljeća*, Vranjski Glasnik, Knjiga br.VIII, Vranje, 1972, f. 107.

¹³ S. Rizaj, *Kaza Prešova 1896/7 godina, Vranjski Glasnik*, Knjiga br. II, Vranje, 1966, f. 440.

të përgjithshme prej 43.436 frymësh, të pandarë në ‘myslimanë’ e ‘të krishterë’.¹⁴ Ndërsa, sipas vjetarit të vitit 1893 (1311 hixhri ose 1309 malije), të ndarë në “myslimanë” dhe “të krishterë”, kazaja e Preshevës “kishte 26.047 ‘të krishterë’ (maqedonas e serbë) dhe 17.389 myslimanë shqiptarë. Sipas këtyre burimeve, popullsia sllave përbënte shumicën, 59,96%, kurse ajo myslimane shqiptare 40,03%. Vetë qyteti i Preshevës me 600 shtëpi, duhet të ketë pasur në mesin e viteve 90 të shek. XIX rreth 5.000 frymë”.¹⁵

1. Pasqyra sipas përkatësisë fetare, gjuhësore dhe etnike midis dy luftërave botërore

Në regjistrimin e parë të vitit 1921, Mbretëria Serbo-Kroate-Sllavene (pas vitit 1929 Jugosllavia) e ka regjistruar popullsinë vetëm sipas përkatësisë gjuhësore dhe fetare, ndërsa përkatësia kombëtare, për shkaqe të politikës unitariste serbomadhe, është injoruar. Mirëpo, me gjithë manipulimet që janë bërë në dëm të shqiptarëve dhe popullsisë joslave, shqiptarët, në bazë të përkatësisë fetare dhe të gjuhës amtare shqipe (arnautski, siç e quanin), dominuan në pasqyrën etnike edhe të Kosovës, edhe të pjesës më të madhe të Luginës.¹⁶ Së pari po i japim të dhënat për popullsinë për rrethin e Preshevës sipas përkatësisë konfesionale, ku shihet se popullsia myslimane dominon në vendbanimet më të mëdha (Presheva, Bujanoci, Bilaçi, Klinoci).

¹⁴ K. Prifti, “Popullsia e Vilajetit të Kosovës në vitet 90 të shek. XIX”, në publikimin *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve*, Shoqata për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga Kosova, Prishtinë, 1992, f. 78.

¹⁵ K. Prifti, *Po aty*, f. 78.

¹⁶ Në vazhdim të manipulimeve me numrin e shqiptarëve, para së gjithash të politizimit të shtimit natyror të shqiptarëve dhe migrimeve të serbëve, gjithnjë në funksion të interesave të politikës së ditës, një demografe serbe nxorri konstatimin “se në vitin 1987 përqindja e popullsisë shqiptare në Kosovë u rrit në rreth 90% të popullsisë së përgjithshme” (D. Avramov, “Opadanje stanovništva: od populacionog fenomena do populacionog problema”, *Stanovništvo*, 3-4/1990 - 1-2/1991, CDI, IDN, Beograd, 1991, f. 240), ndërsa po në këtë shkrim theksonte “se sipas vlerësimeve në vitet e 20-ta të shek. XX popullata shqiptare përbënte rreth 50% të popullsisë së Kosovës” (D. Avramov, *Po aty*, f. 240). Pohimin e fundit e demantojnë vetë rezultatet e regjistrimit zyrtar të vitit 1921, sipas të cilit shqiptarët, sipas gjuhës së tyre amtare, përbënin 65,8% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës (*Prethodni rezultati Popisa stanovništva u Kraljevini Srba, Hrvata i Slovenaca 31. januara 1921*, Državna štamparija, Sarajevo, 1924, f. 3-34; *Stanovništvo i domačinstva SR Jugoslavije prema popisu 1991*, *Stanovništvo 47*, Savezni zavod za statistiku, Centar za demografska istraživanja Instituta društvenih nauka, Beograd, 1995, f. 205).

Tabela 1. Popullsia e Rrethit të Preshevës sipas përkatësisë fetare në vitin 1921¹⁷

Popullsia e pranishme (qytetare dhe ushtarake, e përhershme dhe përkohësisht e pranishme)									
Rrethi i Preshevës									
	Vendbanimi	Totali	%	Myslimanë	%	Ortodoksë	%	Katolikë	%
1	Presheva	5.952	100	5.322	89,4	629	10,67	1	0,02
2	Bujanoci	8.245	100	4.807	58,3	3.438	41,7	-	-
3	(V.) ¹⁸	4.762	100	3.453	72,5	1.309	27,4	-	-
4	Bilaçi	3.473	100	2.464	76,2	826	23,8	1	0,03
5	Zhunica	3.899	100	14	0,36	3.834	99,6	1	0,03
6	Kleniki	3.895	100	8	0,21	3.887	99,7	-	-
7	Klinoci	2.541	100	1.436	-	1.105	43,4	-	-
8	Levosova	1.825	100	-	-	1.825	100	-	-
9	Novosella	2.925	100	-	-	2.925	100	-	-
	Shainca	-	100	-	-	-	-	-	-
	Gjithsej	3.746	100	17.686	46,2	19.788	52,7	-	0,01

Ndër popullatën myslimane ka edhe pak turq të deklaruar që vijnë nga familjet e agallarëve e bejlerëve të mbetur dhe nëpunësve të pushtetit, por pjesa dërmuese e popullsisë myslimane ishin shqiptarë. Megjithatë, qasja metodologjike, kriteri administrativ-politik dhe mospërfshirja, por edhe mosdija për shkak të shkallës shumë të lartë të analfabetizmit, kanë bërë që raporti midis myslimanëve dhe ortodoksëve 17. 686 : 19.788 banorë të mos shprehë pasqyrën reale të strukturës kombëtare të popullsisë në Preshevë me rrethinë. Gjatë regjistrimit të vitit 1921, në kuadër të rregullimit politiko-territorial të Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene, në Rrethin e Preshevës (Preševski srez) nuk përfshiheshin disa fshatra të Karadakut, të cilat në pikëpamje administrative-territoriale ishin të lidhura me rrethin e Gjilanit ose rrethin e Kumanovës.

¹⁷ *Prethodni rezultati Popisa stanovništva u Kraljevini Srba, Hrvata i Slovena 1921 godine*, Državna štamparija, Sarajevo, 1924, f. 102.

¹⁸ Në publikimin statistikor të kohës nën shkronjën “V” nuk dihet se për cilin vendbanim bëhet fjalë. Dihet vetëm shkronja dhe vëllimi numerik, i cili nuk është i vogël.

Tabela 2. Popullsia e Rrethit të Preshevës, sipas gjuhës amtare, në Mbretërinë SKS, në vitin 1921.¹⁹

Rrethi i Preshevës											
Nr.	Vendbanimi	Gjithsej	%	Arnautë	%	Serbë-Kroatë	%	Turq	%	Të tjerë	%
1	Presheva	5.952	100	4.633	77,8	661	11,1	323	5,4	335	5,6
2	Bujanoci	8.245	100	4.033	48,9	3.436	41,8	110	1,3	666	8,1
3	Bilaçi	4.762	100	2.620	55,0	1.298	27,2	343	7,2	501	10,5
4	Zhunica	3.473	100	2.454	70,7	802	23,1	18	0,5	199	5,7
5	Kleniki	3.899	100	-	0	3.883	99,5	-	0	16	0,4
6	Klinoci	3.895	100	-	0	3.887	99,7	-	0	8	0,2
7	Levosova	2.541	100	1.413	55,6	1.102	43,3	6	0,2	20	0,8
8	Novosella	1.825	100	-	0	1.825	100	-	0	-	0
9	Shainca	2.925	100	-	0	2.925	100	-	0	-	0
	Gjithsej	3.746	100	15.153	40,4	19.788	52,9	800	2,1	1.745	4,6

¹⁹ Po aty, f. 102.

Tabela 3. Popullsia e Rrethit të Preshevës për nga përkatësia fetare, në vitin 1931.²⁰

Rrethi i Preshevës											
Nr.	Vendbanim	Gjithsej	%	Myslimanë	%	Ortodoksë	%	Katolikë	%	Të tjerë	%
1	Presheva	7.525	100	5.725	76,1	1.781	23,8	15	0,2	4	0,05
2	Bujanoci	10.462	100	6.081	57,1	4.545	42,7	16	0,15	-	-
3	C ²¹	6.280	100	3.898	62,1	2.381	37,9	1	0,02	-	-
4	Bilaçi	4.789	100	3.068	64,1	1.717	35,9	4	0,08	-	-
5	Zhunica	4.183	100	19	0,45	4.160	99,5	4	0,11	-	-
6	Kleniki	2.281	100	-	-	2.281	100	-	-	-	-
7	Klinoci	3.399	100	1.853	54,5	1.545	45,5	1	0,03	-	-
8	Levosova	1.964	100	-	-	1.964	100	-	-	-	-
9	Novosella	1.510	100	1	0,07	1.508	99,9	1	0,07	-	-
10	Shaince	1.832	100	1	0,05	1.824	99,6	7	0,38	-	-
	Zhbevc	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Gjithsej	44.405	100	20.646	46,5	23.706	53,4	49	0,11	4	0,01

²⁰ *Popis stanovništva u Kraljevini Jugoslavije, Vardarska Banovina, Kumanovski Okrug, Preševski Srez 1931. godine*, Knjiga II, Beograd 1938, f. 104.

²¹ Në publikimin statistikor të kohës, nën shkronjën “C”, nuk dihet se për cilin vendbanim bëhet fjalë. Dihet vetëm shkronja dhe vëllimi numerik, i cili nuk është i vogël.

Midis dy regjistrimeve të popullsisë, 1921-1931, ndodhën ndryshime në strukturën etnike e konfesionale në dëm të shqiptarëve dhe myslimanëve, për shkak të shpërnguljes së shqiptarëve dhe kolonizimit me serbë. Në Preshevë pjesëmarrja e popullsisë myslimane zvogëlohet nga 89,4% në 76,1%; në Bilaç nga 76,2% në 64,1%; në Bujanoc nga 58,3% në 57,1% dhe në një vendbanim tjetër (emri i të cilin nuk figuron në statistikat e regjistrimit) nga 72,5% në vitin 1921 në 37,9% në vitin 1931. Ndërkaq, pjesëmarrja e popullsisë ortodokse (serbe) në periudhën brenda viteve 1921-1931 shënon një rritje në shumicën e vendbanimeve të Rrethit të Preshevës: në Preshevë nga 10,6% në 23,7%, pastaj në Bilaç nga 23,8% në 35,8%, në vendbanimin (emri i të cilit nuk figuron në burimin e cekur) nga 27,5% në 37,9%, në Bujanoc nga 41,7% në 42,7%.

2. Popullsia dhe përbërja e saj etnike në komunën e Medvegjës

Sikurse hapësirat e komunave të Preshevës e Bujanocit, ashtu edhe ajo e Medvegjës përbën një pjesë të pandashme të trungut gjeoetnik shqiptar. Popullsia shqiptare e saj përbënte një masë territorialisht dhe etnikisht kompakte, e cila në periudhat e kaluara ka pasur fatin edhe më tragjik se shqiptarët e Preshevës dhe të Bujanocit. Deri në vitin 1878 kjo popullsi ka jetuar me shumicë në shumë fshatra, jo vetëm të Jabllanicës së Epërme, por edhe në rrethet e Toplicës, Kosanicës, Pusta Rekës, Masuricës, Gërdelicës e Vranjës. Pas vitit 1878, me vendimet e Kongresit të Berlinit, viset e lartpërmendura bëjnë pjesë në kuadër të Mbretërisë Serbe. Nga kjo kohë fillon një periudhë, ndoshta nga më tragjikut për popullsinë shqiptare, e përcjellë me vrasje, masakrime, dhunime, shpërngulje dhe forma të tjera të ngjashme, përmes të cilave është realizuar një spastrim etnik i përmasave të mëdha, nga viset e sipërshënuara. Për dallim prej viseve të tjera, në Jabllanicën e Epërme (Medvegja), për shkak të kontaktit me territoret kompakte shqiptare në Kosovë dhe pozitës së re kufitare me Vilajetin e Kosovës, kushteve natyrore, relievit kodrinor-malor (izolimit), kompaktësisë etnike të fshatrave shqiptare, edhe pse mjaft e cunguar, vazhdon të mbijetojë popullsia shqiptare.

Mbretëria Serbe, me qëllim të ndryshimit të strukturës etnike në territoret, të cilat sapo i kishte futur nën kontrollin e vet, fillon të bëjë kolonizimin me popullsi serbe e malazeze. Kështu, në vitin 1880, ajo nxjerr ligjin për imigrim, i cili sipas përmbajtjes së vet i jepte lehtësime të shumta popullsisë së ardhur.²² Ky ligj parashihte që çdo

²² *Po aty*, f. 86.

familjeje të ardhur t'i dhurohej deri 4 ha tokë të punëshme dhe 2 ari truall për ndërtimin e shtëpisë, ndërsa familjeve më të mëdha të tipit të kooperativave bujqësore (poljoprivredne zadruga) mund t'u jepej edhe nga 2 ha tokë të punëshme për çdo mashkull të familjes me moshë mbi 16 vjet. Në aspektin e marrëdhënieve pronësore-juridike, në dekadën e parë, të ardhurit ishin në pozitën e shfrytëzuesit të tokës, e cila pastaj bëhej pronë e tyre. Këto dhe shumë hollësi të tjera që përmbante në vete ligji, na bënë të përfundojmë se ai ishte një ligj tipik, i cili kishte për qëllim kolonizimin e vendbanimeve të boshatisura nga shqiptarët.

Një nga objektivat e politikës së Mbretërisë Serbe ishte që, në frymën e elaboratit të V. Čubrilloviqit, kolonizimin e këtyre territoreve ta bënte me popullsi malazeze, e cila për shkak të mentalitetit të saj malësor, ishte e vrazhdë dhe e prirë për konflikte.²³ Kështu, me disa marrëveshje ndërmjet saj dhe Mbretërisë malazeze bëhet ardhja e disa mijëra malazezëve të cilët në mënyrë të planifikuar vendosen në zonën kufitare mes Perandorisë Osmane dhe Mbretërisë Serbe. Në fakt qëllimi nuk ishte mbrojtja fizike e Mbretërisë Serbe nga sulmet e mundshme prej territorit të Perandorisë, por ndërprerja e kontinuitetit etnik-demografik, gjuhësor e kulturor të popullsisë shqiptare të rrethit të Jabllanicës me atë të Kosovës, si dhe krijimin e situatës së pasigurt përmes inskenimit të konflikteve ndërmjet popullsisë malazeze dhe shqiptare dhe presioneve e masave të tjera represive për të detyruar edhe atë popullsi të mbetur në Jabllanicën e Epërme (Medvegjë) t'i braktisëë vatrat e veta. Kolonizimi i suksesshëm i malazezëve në komunën e Medvegjës do të shërbejë si një model i mirë për t'u zbatuar më vonë edhe në Kosovë, më konkretisht në Rrafshin e Dukagjinit.

Mungesa e shënimeve për popullsinë e komunës së Medvegjës para vitit 1878 nuk na jep mundësinë për të vlerësuar numrin e popullsisë shqiptare në këtë anë. Por pas këtij viti fillojnë të bëhen disa regjistrime, të cilat edhe pse jo të plota, japin një mundësi për analiza të ndryshme demografike me çka mund të përcillet zhvillimi demografik në këtë komunë. Më poshtë po japim të dhënat e regjistrimit i cili njihej si “regjistrim i njerëzve dhe bagëtisë në

²³ Në të gjitha viset shqiptare ku planifikohej kolonizimi me elementin sllav, në fshatrat ku kishin mbetur ende shqiptarë, “së pari duhet të sillen malazezët – si njerëz zemërakë, agresivë, të pamëshirshëm, të cilët, me eksetet e tyre, do t'i detyrojnë shqiptarët që kanë mbetur të shpërngulen e pastaj të sillen kolonistë edhe nga viset e tjera” (V. Čubrilović, *Po aty*).

territoret e reja të zbuluara në vitin 1878". Ky regjistrim jep të dhënat vetëm për tetë vendbanimet e Jabllanicës së Epërme.²⁴

Tabela 5. Numri i popullsisë shqiptare në disa vendbanime të Rrethit të Jabllanicës, në vitin 1878.²⁵

	Vendbanimi	Numri i shtëpive	Numri i familjeve	Numri i banorëve		
				Meshkuj	Femra	Taksapagues
1	Lebana	27	27	99	84	44
2	Shumana	72	72	265	242	119
3	Shillova	37	37	164	157	60
4	Rujkovci	17	17	56	40	-
5	Tupalla (shqiptare)	20	20	88	86	28
6	Svirçë (shqiptare)	19	19	63	71	26
7	Llasphtica (shqiptare)	5	5	23	10	9
8	Kapiti (shqiptare)	10	10	26	16	11
	Gjithsej	207	207	784	706	297

Prej 8 vendbanimeve të regjistruara, katër prej tyre: Tupalla, Svirca, Llasphtica dhe Kapiti janë me popullsi shqiptare, ku, sipas këtij burimi, në 53 shtëpi kanë jetuar 383 banorë. Duke pasur parasysh që regjistrimi është bërë pas vendosjes së vijës së re kufitare ndërmjet Serbisë dhe Perandorisë Osmane, e cila është përcjellë me një valë të madhe të shpërnguljeve të shqiptarëve në drejtim të Kosovës, pastaj mangësive të vetë regjistrimit, mospërfshirjes së shumë fshatrave me strukturë etnike të përzier ku kanë jetuar edhe shqiptarët, vlerësohet se këto të dhëna as për së afërmi nuk pasqyrojnë realitetin etnik-demografik në Jabllanicën e Epërme (komuna e Medvegjës). Mungesa e të dhënave të mjaftueshme nuk mundëson të analizohen komponentët e ndryshimeve demografike, përveç përbërjes së popullsisë sipas moshës, e cila është në favor të popullsisë mashkullore, ndërsa kanë dominuar familjet e mëdha shumanëtarëshe me nga 9, 10 e më shumë anëtarë. Prej kësaj periudhe e deri në vitin 1910 në Mbretërinë e Serbisë janë realizuar edhe 3 regjistrime të popullsisë dhe shtëpive për vendbanime, si ato të viteve 1893, 1900 dhe 1910. Edhe në këto regjistrime, deklarimi i popullsisë është bërë vetëm sipas përkatësisë gjuhësore dhe fetare, e jo edhe asaj kombëtare.

²⁴ *Po aty*, f. 114.

²⁵ Popis ljudstva i stoke u novooslobođenim krajevima 1878 godine; M. Vasović, Gornja Jablanica-geografska svojstva, Beograd, 1998, f. 115.

Tabela 6. Numri i popullsisë së Medvegjës në periudhën 1890-1910.²⁶

	Vendbanimi	1890			1900			1910		
		M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej
1	Bogunoci	46	47	93	81	81	162	115	111	226
2	Borovci	87	72	159	109	104	213	164	161	325
3	Braina	75	64	139	-	-	-	160	166	326
4	Vrapca	82	51	133	105	83	188	173	158	331
5	Gubavci	29	17	46	-	-	-	69	55	124
6	Gjylekari	84	63	147	146	95	241	168	147	315
7	Kapiti	71	56	127	92	77	169	102	105	207
8	Llapashtica	126	122	248	172	150	322	277	242	519
9	Maroci	76	60	136	71	55	126	169	158	327
10	Maqedonci	98	79	177	153	125	278	215	180	395
11	Medvegja	265	229	494	513	339	852	571	486	1.057
12	Medevci	26	20	46	-	-	-	137	111	248
13	Mërkonji	96	86	182	-	-	-	165	139	304
14	Negosavla	67	48	115	85	83	168	108	90	198
15	Petrila	63	46	109	83	61	144	111	98	209

²⁶ Prethodni rezultati popisa stanovništva u Kraljevini Srbije od 31 decembra 1890. godine, Knjiga I, Beograd 1893; Pregled stanovništva po opštinama i mestima u Kraljevini Srbije po popisu od 31 decembra 1900, Knjiga XXIII, Beograd 1903; Popis stanovništva u Kraljevini Srbije iz 1910; sipas M. Vasović, Gornja Jablanica-geografska svojstva, Beograd, 1998, f.115.

16	Poroshtica	14	11	25	49	39	88	38	41	79
17	Pusta Shillova (Gazdare)	195	180	375	344	327	671	522	450	972
18	Ramabaja	95	70	165	206	188	394	358	321	679
19	Ratkoceri	375	329	705	331	285	616	-	-	-
20	Rujkoci	247	225	472	355	308	663	465	439	904
21	Svirca	204	185	389	290	211	501	359	314	673
22	Sijarina	194	160	354	252	200	452	400	376	776
23	Starabaja	84	59	143	84	70	154	151	130	281
24	Stublla	151	132	283	129	123	252	387	364	751
25	Tullari	88	91	179	156	150	306	279	244	523
26	Tupalla	160	131	292	178	181	359	235	253	488
27	Cërni Vrh	80	71	151	127	117	244	177	156	333
28	Çokotini	71	52	123	84	80	164	147	137	284
29	Buçumeti	377	359	736	508	483	991	733	648	1.381
30	Gërbavci	-	-	-	68	73	141	141	310	320
	Gjithsej	3.626	3.115	6.743	4.771	4.088	8.859	7.096	6.590	13.591

Në vendbanimet kompakte shqiptare gjatë këtyre tri regjistrimeve që u përmendën, në regjistrimin e vitit 1878 është shënuar rritje e vogël të popullsisë. Kështu, për shembull, popullsia e Tupallës është rritur nga 292 banorë, sa ka pasur në vitin 1890, në 359 banorë në vitin 1900 dhe në 488 banorë në vitin 1910; numri i banorëve të Sfirçës është rritur nga 389 banorë në vitin 1890 në 501 banorë në vitin 1900 dhe në 673 banorë në vitin 1910; numri i banorëve të Llapashticës është rritur nga 248 banorë në vitin 1890 në 322 banorë në vitin 1900 dhe në 519 banorë në vitin 1910, ndërsa në Kapit nga 127 banorë në vitin 1890 në 169 banorë në vitin 1900 dhe në 207 banorë në vitin 1910. Duhet theksuar se përveç këtyre vendbanimeve, ku dominon popullsia shqiptare, ka edhe shumë të tjera në të cilat ajo është e pranishme në numër të konsiderueshëm, si Sijarina, Starabaja, Gërbavci, Ramabaja, Banja e Sijarinës etj. Kjo rritje pak e hetueshme e popullsisë në vendbanimet kompakte shqiptare, por edhe në ato të përziera nuk është rezultat i shtimit të ulët natyror të popullsisë, por i shpërnguljes (emigrimit) së popullsisë në drejtim të Kosovës. Kështu edhe gjatë kësaj periudhe, edhe pse në përmasa më të vogla, vazhdon boshatisja e trojeve etnike shqiptare të Jabllanicës.

3. Evolucionit i strukturës etnike të popullsisë, pas Luftës së Dytë Botërore

Nga të dhënat zyrtare të regjistrimeve të popullsisë në Serbi për periudhën 1961-2002 shihet që numri i popullsisë shqiptare në Luginën e Preshevës ka shënuar rritje të vazhdueshme nga 44,3% në vitin 1961, në 78,8% në vitin 1991. Duhet theksuar se përqindja më e vogël e shqiptarëve në raport me serbët në vitin 1961 është rezultat i emigrimit të një numri të konsiderueshëm të popullsisë së kësaj bashkësie etnike për në Turqi dhe mospërfshirjes së një numri të konsiderueshëm të popullsisë së fshatrave kodrinore-malore në regjistrim, ndërsa rënia e pjesëmarrjes së shqiptarëve nga 78,9% sa ishin në vitin 1991, në 72,9% në vitin 2002, është rezultat i aplikimit të konceptionit të “popullsisë së pranishme” në regjistrim, por edhe i shpërnguljes. Sipas të dhënave të komunave, në vitin 2002 nuk janë përfshirë në regjistrim rreth 23.743 banorë ose 20,8% e popullsisë së përgjithshme të Luginës së Preshevës. Në këtë mënyrë regjistrimi i vitit 2002 na jep një pasqyrë jo të drejtë për strukturën etnike të popullsisë.

Duke vështruar evolucionin e pasqyrës etnike sipas komunave, vërehet se popullsia shqiptare dominon në pjesëmarrje shumë të lartë në komunën e Preshevës, ku në vitin 2002 shqiptarët përbënin rreth 94% të popullsisë së gjithmbarshme të komunës, duke e kategorizuar atë si një nga komunat më homogjene sa i përket strukturës kombëtare në territorin etnik shqiptar (Tabela 7), çfarë janë vetëm disa komuna në Kosovë. Në komunën e Bujanocit shqiptarët kanë shënuar një rritje konstante si të numrit absolut, ashtu edhe të atij relativ, ndërsa serbët një rënie që nga viti 1971. Në komunën e Medvegjës, ndërkaq, popullata shqiptare ka pasur një zvogëlim të numrit absolut dhe relativ në vitet 1991 dhe 2002, me tendencë të reduktimit të vëllimit demografik edhe më vonë, deri në prag të shpopullimit, por edhe popullata serbe ka shënuar rënie konstante absolute dhe relative, madje që nga 1971 për shkak të shpërnguljes në drejtim të brendisë së Serbisë.

Përbërja etnike e popullsisë në Luginën e Preshevës është një nga elementet strukturore demografike që tregojnë një shkallë të lartë të homogjenitetit. Ky homogjenitet shprehet përmes dominimit të vazhdueshëm të popullsisë shqiptare në Luginën e Preshevës. Sipas shkallës dhe tipit të homogjenitetit ose heterogjenitetit mund të flitet për përbërjen monolite etnike të një rajoni ose shteti, kur një grup etnik përbën më se 90% të popullsisë totale; me homogjenitet të theksuar etnik, kur grupi etnik përbën 80-89% të popullsisë totale; me homogjenitet të ulët ose heterogjenitet, kur grupi etnik përbën 70-79% të popullsisë totale; heterogjenitetin e lartë kur grupi etnik përbën 60-69% të popullsisë totale dhe heterogjenitetin e theksuar etnik, kur grupi etnik përbën 50-59% të popullsisë totale.²⁷

Përveç përqindjes së grupit më të madh etnik, për përcaktimin e shkallës së homogjenitetit ose heterogjenitetit të popullsisë në një rajon të caktuar përdoret edhe koeficienti i heterogjenitetit etnik. Ky koeficient tregon numrin e pjesëtarëve të të gjithë popujve të tjerë, së bashku në 1000 pjesëtarë të grupit më të madh etnik.²⁸


²⁷ N. Raduški, *Nacionalne manjine u Centralnoj Srbiji, Etničke promene i demografski razvoj*, Centar za demografska istraživanja, Institut društvenih nauka, Beograd, 2007, f. 37.

²⁸ N. Raduški, *Po aty*.


Tabela 7. Struktura etnike e popullsisë, në Luginë dhe në tri komunat e saj, në periudhën 1961-2002.²⁹

	Përkatësia kombëtare	1961		1971		1981		1991		2002	
		Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Presheva	Shqiptarë	18.229	68,1	23.625	78,6	28.961	85,3	34.992	89,8	44.994	93,7
	Serbë	6.741	25,2	5.777	19,2	4.204	12,3	3.206	8,2	2.194	4,57
	Romë	-	-	312	1,0	433	1,2	505	1,3	322	0,67
	Të tjerë	1.768	6,6	343	1,1	350	1,0	240	0,62	498	1,04
Bujanoci	Shqiptarë	16.618	42,54	21.209	48,73	25.848	55,38	29.588	60,09	33.855	63,29
	Serbë	20.033	51,28	18.840	43,29	15.914	34,08	14.660	29,7	14.782	27,64
	Romë	-	-	2.749	6,31	4.130	8,84	4.408	8,86	3.876	7,25
	Të tjerë	2.413	6,18	724	1,67	797	1,7	582	1,35	972	1,82
Medvegja	Shqiptarë	5.037	20,77	5.410	26,01	5.509	31,92	3.832	28,66	3.129	29,19
	Serbë	18.956	78,18	13.002	62,55	9.654	55,94	8.194	61,31	7.158	66,82
	Romë	-	-	52	0,25	83	0,47	119	0,89	108	1,01
	Të tjerë	752	1,05	2.328	11,19	2.011	11,67	1.223	9,14	321	2,98
Lugina	Shqiptarë	39.884	44,31	50.224	53,26	60.318	61,63	68.412	67,38	81.978	72,98
	Serbë	45.229	50,21	37.619	39,86	29.772	30,41	26.060	25,66	24.134	21,38
	Romë	-	-	3.113	3,29	4.646	4,74	5.032	4,95	4.306	3,91
	Të tjerë	4.933	5,48	3.395	3,59	3.158	3,22	2.045	2,1	1.791	1,73


²⁹ Burimi: Popis stanovništva 1961 godine, Vitalna, etnička i migraciona obeležja, Knjiga broj VI, Beograd, 1967; Popis stanovništva 1971 godine, Etnička obeležja stanovništva, rezultati po opštinama, Beograd 1974; Popis stanovništva 1991, Stanovništvo prema nacionalnoj pripadnosti; Popis stanovništva i stanova 2002 godine, Nacionalna ili etnička pripadnost, Knjiga broj I, rezultati po naseljima i opštinama, Beograd, 2003.




Graf. 1. Struktura kombëtare e popullsisë në Luginën e Preshevës në periudhën 1961-2002



Graf. 2. Struktura kombëtare e popullsisë në Komunën e Preshevës në periudhën 1961-2002



Graf. 3. *Struktura kombëtare e popullsisë në Komunën e Bujanocit, në periudhën 1961-2002*



Graf. 4. *Struktura kombëtare e popullsisë në Komunën e Medvegjës, në periudhën 1961-2002*

Tabela 8. Përqindja e grupit më të madh dhe koeficienti i heterogjenitetit etnik, në Luginën e Preshevës.³⁰

	Përqindja e grupit më të madh etnik					Koeficienti i heterogjenitetit etnik				
	1961	1971	1981	1991	2002	1961	1971	1981	1991	2002
Rajoni	50,2	53,3	74,7	85,1	73,1	990	440	350	266	368
Vojvodina	54,9	55,8	54,4	56,8	65,1	822	793	817	762	537
Kosova	67,2	73,7	77,4	81,6	-	489	357	291	226	-
Serbia	74,6	71,2	65,8	65,9	82,8	339	404	449	517	206

³⁰ Burimi: *Popis stanovništva 1961 godine, Vitalna, etnička i migraciona obeležja, Knjiga VI*, Beograd, 1967; *Popis stanovništva 1971 godine, Etnička obeležja stanovništva, rezultati po opštinama*, Beograd, 1974; *Popis stanovništva i stanova 2002 godine, Nacionalna ili etnička pripadnost, Knjiga I*, Beograd, 2003.

Nga të dhënat e mësipërme vërehet se në Luginën e Preshevës, në periudhën kohore 1961-1991, ka pasur trend pozitiv në rritjen e përqindjes së grupit më të madh etnik, që është popullsia shqiptare. Derisa në vitin 1961, në Luginën e Preshevës shqiptarët përbënin 44,3% të popullsisë, në vitin 1991, ky numër dyfishohet dhe arrin në 85,1%. Këto procese etnike-demografike ishin të ngjashme me ato në Kosovë, ku në periudhat e analizuara vazhdimisht vjen deri tek rritja e përqindjes së grupit më të madh etnik (shqiptarëve), nga 67,2% në vitin 1961 në 81,6% në vitin 1991.

Për dallim nga Lugina e Preshevës dhe Kosova, situata etnike-demografike në Vojvodinë dhe Serbi është krejtësisht tjetër, me ndryshime shumë të vogla të përqindjes së grupit më të madh etnik (serbëve). Kështu, në Vojvodinë, kjo përqindje ndryshon në drejtim pozitiv, nga 54,9% në vitin 1961 pjesëmarrja rritet në 65,1% në vitin 2002, kurse në nivel të Serbisë shënohet një trend negativ: nga 74,6% në vitin 1961, në 65,9% në vitin 1991, për të pasuar pastaj rritja në 82,8% në vitin 2002. Rritja e përqindjes së serbëve në Vojvodinë shkon në dëm të popullsisë hungareze, sikurse edhe i vllahëve në Serbi.³¹

Koeficienti i heterogjenitetit etnik në Luginën e Preshevës shënon trend negativ, nga 990 sa ishte në vitin 1961, në 266 në vitin 1991. Në vitin 2002 vjen deri te rritja e këtij koeficienti në 368. Gjithashtu, edhe në Kosovë, në periudhat e analizuara vjen deri te zvogëlimi i këtij koeficienti, nga 489 sa ishte në vitin 1961, në 226 në vitin 1991. Trendi negativ i koeficientit të heterogjenitetit etnik në Luginën e Preshevës tregon se nëpër periudhat e analizuara, vazhdimisht vjen deri te rritja e shkallës së homogjenitetit etnik, me dominim të shqiptarëve.

³¹ P. sh. numri i hungarezëve në ish-Jugosllavi shënonte zvogëlim permanent: 504.369 më 1961, 426.867 më 1981 dhe 378.011 më 1991. Ndërsa, vllahët pothuajse e humbën përkatësinë etnike dhe u shkrinë në serbë. Sipas regjistrimit të vitit 1948 në Serbi u deklaruan 93.440 vllahë ose 2,2% në popullsinë e përgjithshme të Serbisë (në regjistrimin e vitit 1953 me gjuhë amtare vllahë u deklaruan 198.793 veta). Në regjistrimin e vitit 1981 në Serbi rreth 130.000 vetë deklaruan se gjuhë amtare e kanë vllahishten, ndërsa me kombësi vllahë u përcaktuan vetëm rreth 25.000 veta; ndërkaq, sipas regjistrimit të vitit 1991, në Serbi vllahët edhe si grup linguistik u asimiluan: me kombësi u deklaruan 17.642 dhe me gjuhë amtare 16.497 veta! Regjistrimi i vitit 2002 edhe me gjuhë, edhe me kombësi shënoi një “zgjim”: me gjuhë vllahë u deklaruan 54.726 veta, ndërsa me kombësi vllahë 36.742 veta (Burimi: *Regjistrimet zyrtare të popullsisë në Serbi dhe ish-Jugosllavi*, Savezni zavod za statistiku, Republički zavod za statistiku, Beograd).

Kur është fjala për strukturën etnike të një rajoni është me rëndësi të dihet edhe për shtrirjen territoriale të grupeve etnike brenda rajonit. Popullsia shqiptare ka një dominim absolut në pjesën kodrinore-malore të Karadakut në përfundim me një përbërje monolite etnike, si dhe në pjesën fushore të rajonit. Shpatet e Rujanit dhe në përgjithësi pjesa lindore e rajonit dallohet me një heterogjenitet më të theksuar etnik. Shtrirja territoriale e shqiptarëve tregon se hapësira etnike e tyre është në mënyrë funksionale dhe të natyrshme e lidhur në mes veti dhe me trojet etnike shqiptare, me Kosovën dhe hapësirën Kumanovë-Shkup, me të cilat përbën një tërësi të pakëputur.

Struktura e sotme fetare³² reflekton strukturën etnike dhe dallohet për homogjenitet të lartë, me dominimin e besimit mysliman: 73,25% në nivel të Luginës dhe 87,4% në komunën e Preshevës. Besimit të krishterë-ortodoks i takon popullsia serbe, që përbën 21,55% të numrit të popullsisë të Luginës..., dhe 8,69% në komunën e Preshevës. Përqindja e besimeve të tjera është e parëndësishme.³³ Në disa vendbanime të Luginës... ka pasur dhe ende ka dervishë, ndonëse sot në numër shumë të vogël, deri te numri simbolik. Në Preshevë deri në vitin 1912 ka ekzistuar teqeja e vjetër *halveti*, ndërsa në fshatin Nesalcë (komuna e Bujanocit) edhe sot ekziston teqeja e rendit *sadi*, e vjetër rreth 230 vjet, në oborrin e së cilës gjendet edhe tyrbja, ku prehen shehët si themelues të teqesë.³⁴

Summary

Presheva Valley, taking into account its complex natural-geographical and strategic-communication position within broader geopolitical and ethno-demographic developments, was and still it is a neuralgic junction. Serbia's aspirations but also the aspirations of others for political, economical and geostrategic domination in Presheva Valley never stopped. That's why during certain periods was organized the population census in this territory. The first forms of population and housing census in Presheva

³² Në historinë e regjistrimeve të popullsisë së ish-Jugosllavisë dhe Serbisë pas vitit 1945 pyetja mbi përkatësinë fetare është shtruar vetëm tri herë: në vitet 1953, 1991 dhe 2002 si deklaram i lirë i të gjithë personave të moshës madhore. Për fëmijët nën 15 vjet përgjigjen e kanë dhënë prindërit, adoptuesi ose kujdestari (*Stanovništvo i domaćinstva Srbije prema popisu 2002. godine*, Republički zavod za statistiku, CDI, IDN, Društvo demografa Srbije, Beograd, 2006, f. 19).

³³ *Popis stanovništva, domaćinstava i stanova u 2002. Stanovništvo. Verioispovest, maternji jezik i nacionalna ili etnička pripadnost prema starosti i polu, Podaci po opštinama*, RZS, Beograd, maj 2003, f. 15.

³⁴ J. Rexhepagiqi, *Dervishët, rendet dhe teqetë*, Dukagjini, Pejë, 1999, ff. 165, 186-187.

Valley in the time of the Turks were salnames (yearbooks) and defters (registers), organized mainly for taxation purposes.

According to the official Vilayet statistics, the Presheva Kaza (district) had 43.000 inhabitants at the end of 90-ties of the 20th century and most of them were Christians. It is estimated that the city of Presheva itself had, then, about 600 houses, 5.000 inhabitants, but there are no exact data on religious and national belonging. Meanwhile, between the two World Wars were organized two population censuses, in 1921 and 1931, based on conception of “present population” (factual state). Even though the data were collected based, only, on linguistic and religious belonging, it is easy to distinguish the ethnic belonging because only Serbian population belonged to Christian-Orthodox religion, while only Albanians and symbolically Turks belonged to Muslim religion.

During this period, there have been changes in the ethnic and religious composition but always to the detriment of Albanians and Muslims because of forced expulsion towards Turkey and, since 1912, colonization of areas with Serbian population. There has been a decrease in the participation of Muslim population in Presheva from 89,4% in 1921 to 76,1% in 1931, in Bilaç from 76,2% to 64,1%, in Bujanoc from 58,3% to 57,1% while in some other settlements the fall varied from 75% in 1921 to 38% in 1931. Meanwhile, the participation of Orthodox (Serbian) population during the period between 1921-1931 marks an increase in the majority of settlements of Presheva District: in Presheva from 10,6% to 23,7%, then in Bilaç from 23,8% to 35,8%, in Bujanoc from 41,7% to 42,7%, and in other settlements from 27% to 38%.

Following the end of the Second World War and until 1991, according to official statistics, the number of Albanian population in the Presheva Valley has been on increase: its participation in ethnic structure has increased from 44% in 1961 to 79% in 1991. Meanwhile, according to the official census organized in 2002, it has followed a decrease: the reasons are migration and the change of conception (from “permanent population” to “present population”). However, the Presheva Valley is being abandoned, recently, intensively by the Albanians because of the economic stagnation intentionally planned by Serbian regime and because of Serbia’s police-military pressure, resulting in many settlements without people, closed houses and a drastic decrease in the number of pupils and classrooms of primary schools which are the key indicators of an intensive emigration process and general demographic regression. Out of 136 settlements in this territory, the Albanian population is present in 64 settlements, which belong to rural type, and three urban centers (Presheva, Bujanoc and Medvegja), while other settlements are inhabited by Serbs. There are 41 settlements with Albanian absolute majority.

Ibrahim RAMADANI, Prishtinë

PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT METROPOLITAN TË QYTETIT TË PRISHTINËS

KDU 908(496.51-25)

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi konsiston në përkufizimin territorial dhe formulimin e koncepteve zhvillimore të zonës metropolitane të qytetit të Prishtinës. Metodot dhe metodologjia e punës mbështeten në analizën e disa faktorëve relevant gjeohapësinor të territorit në fjalë si: morfologjia e terrenit, shtrirja e vendbanimeve, dendësia e popullsisë, rrjeti i infrastrukturës, ndërsa në bazë të vlerësimit të këtyre indikatorëve të rëndësishëm gjeohapësinor mund të përcaktohen kahet e zhvillimit të ardhshëm të këtij aglomeracioni urban, me tendenca të organizimit metropolitane.

Fjalët çelës: aglomeracion urban, zonë metropolitane, regjion, infrastrukturë, transformim.

Prishtina me rrethinën e saj


Qyteti i Prishtinës, falë pozitës së mirë gjeografike dhe një kompleksi të tërë faktorësh gjeohapësinor,¹ bëhet qendër e rëndësishme, jo vetëm për rrethinën e saj, por edhe për tërë Kosovën e më gjerë. Nëpër territorin e kësaj komune kalojnë rrugë të rëndësishme që nga lashtësia, të cilat çojnë, jo vetëm në brendi të Gadishullit Ilirik, por edhe në Evropën Qendrore dhe më gjerë. Largësia mesatare e qendrave të rëndësishme të regjionit nga qyteti i Prishtinës sillet rreth 300 km, që mund të konsiderohet si një distancë e favorshme. Rëndësia e pozitës gjeografike të qytetit të Prishtinës shpjegohet që nga kohërat e hershme, me lidhjet e mira që kishte me vendet përreth. Në kohën antike nëpër të kalonin dhe kryqëzoheshin rrugët e rëndësishme që lidhnin këto vise me bregdetin e Adriatikut dhe Egjeut në një anë dhe me Evropën Qendrore në anën tjetër.²

¹ B. Maksimović, *Urbanizam - Teorija prostornog planiranja i uređenja naselja*, Beograd, 1986, f. 41-56. Krahaso; D. Tošković, *Metode analize i sinteze u prostornom i urbanistickom planiranju*, IAU, Beograd, 1985, f. 6.

² E. Čerškov, "Oko problema komunikacije i položaja Kosovu u rimskom periodu", *Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, II*, Priština, 1957, f. 54.

Aglomeracioni urban i Prishtinës shtrihet në pjesën verilindore të Kosovës, në zonën e kontaktit të njësive të rëndësishme tektonike dhe morfologjike, të cilat reflektojnë në procese të ndërlikuara shoqërore-ekonomike, por edhe në lidhje komunikative, kulturore dhe politike gjatë gjithë historisë. Rreth 1/3 e territorit të këtij aglomeracioni shtrihet në pjesën qendrore të Rrafshit të Kosovës, ndërsa pjesa lindore, juglindore dhe verilindore e komunës karakterizohet me relief kodrinor dhe malor. Luginat lumore mundësojnë komunikimin ndërmjet pjesëve të ndryshme të komunës dhe më gjerë, si dhe vendosjen e vendbanimeve dhe zhvillimin e aktiviteteve të shumëllojshme njerëzore. Nëpërmjet këtyre luginave lumore, ky aglomeracion urban, lidhet me pjesët tjera të Kosovës dhe më gjerë, por e njëjta vlen edhe për vetë popullsinë e komunës, ngase të gjitha vendbanimet e zonës malore shfrytëzojnë vijat e ndërtuara komunikuese nëpër këto luginat të rëndësishme, për t'u lidhur me qytetin. Këto dispozita territoriale, me disa veçori fiziko-gjeografike lokale, paraqesin bazën natyrore për organizimin dhe zhvillimin e vendbanimeve dhe veprimtarive njerëzore.

Aglomeracioni urban i Prishtinës ka përjetuar ndryshime të rëndësishme fizike dhe sociale, të cilat ndryshime më së shumti janë shprehur në zgjerimin e sipërfaqes urbane me lagje të reja dhe zgjerimin e vendbanimeve përreth qytetit, shpeshherë me ndërtime pa plan në shumë zona të qytetit. Rritja e pakontrolluar e qytetit u shpreh në çrregullimin e bilancit dhe në dezintegrimin e hapësirës urbane, si dhe në përkeqësimin e fizionomisë së qytetit, me tendencë të zhvillimit spontan dhe me degradim të sipërfaqeve të lira. Si problem tjetër, që mund të ceket me rastin e zhvillimit urban të Prishtinës, janë edhe barrierat e zhvillimit të mëtejshëm për shkak të eksploatimit të thëngjillit dhe zhvillimit të energjetikës në pjesën perëndimore që manifestohen me ndotje të konsiderueshme të ambientit, duke përfshirë edhe pjesën më të madhe të qytetit.



Harta 1. Rrjeti i vendbanimeve në zonën e ngushtë metropolitane

Në territorin e zonës së ngushtë gravituese të Prishtinës paraqiten diferenca të mëdha, si në shtrirjen e vendbanimeve, po ashtu edhe në dendësinë e popullsisë. Zona fushore e territorit të komunës së Prishtinës dhe zona përreth qytetit të Prishtinës, sa i përket proceseve shoqërore-ekonomike, është nën ndikimin e zhvillimit intensiv. Kjo zonë karakterizohet me një dendësi të madhe të popullsisë. Sipas burimeve statistikore të vitit 1991, zona fushore e komunës së Prishtinës ka një dendësi prej 2.371 banorë në një km^2 , ndërsa territori i komunës së Prishtinës si tërësi, rreth 500 banorë në km^2 . Prishtina me rrethinë është njëra nga hapësirat me koncentrimin më të madh të popullsisë në Kosovë, ndërsa pjesa kodrinore-malore e saj është përfshirë nga procesi i shpopullimit. Nga gjithsej, rreth 300.000 banorë, sa kishte komuna e Prishtinës në vitin 1991, vetëm në 20% të territorit të saj fushor jetojnë rreth 275.000 banorë, ose 93% e popullsisë së gjithmbarshme të komunës, kurse në zonën kodrinore-malore, me sipërfaqe prej rreth 400 km^2 (80% të territorit) jetojnë rreth 18.517 banorë, që është vetëm 7% e popullsisë së komunës.

Tani, në dekadën e fundit, disa vendbanime të zonës malore gati se janë braktisur tërësisht. Në vendbanimet urbane dhe suburbane të Prishtinës tani jetojnë mbi 90% e popullsisë së gjithmbarshme të komunës, kurse pjesa tjetër e popullsisë jeton në vendbanimet periferike dhe me lidhje më të dobëta komunikative. Me një intensitet të tillë të rritjes së popullsisë (rreth 8.200 banorë në vit), zona aglomerative e Prishtinës, deri në vitin 2020, do t'i ketë rreth 550.000 banorë, me dendësinë e përgjithshme të popullsisë prej 963 banorë në km², kurse në zonën fushore dendësia e popullsisë do të arrijë në rreth 4.500 banorë në km².

Zonimi i territorit në njësi hapësinore, për qëllime të planifikimit të hapësirës, konsiderohet si një nga problemet më të rëndësishme të organizimit shoqëror. Me ndarjen e territorit në njësi më të vogla hapësinore mundësohet detajimi i hapësirës dhe identifikimi i të gjitha ndikimeve dhe ndërveprimeve, të cilat kushtëzojnë zhvillimin e përgjithshëm shoqëror-ekonomik dhe kulturor.³ Karakteristikat natyrore gjeografike, shoqërore-ekonomike dhe funksionale, kanë dëshmuar se në Komunën e Prishtinës dallohen njësi të vogla hapësinore me veçori të ndryshme. Kjo ndarje territoriale, në njësi më të vogla hapësinore, ka një rëndësi të veçantë në procesin e planifikimit me ndikim të konsiderueshëm në organizimin hapësinor dhe në zhvillimin e këtyre njësive territoriale.⁴ Dy tërësitë e mëdha territoriale: zona lindore dhe zona perëndimore, janë të ndara me kufij të theksuar natyrorë, të cilat po ashtu mund të ndahen në nënzona. Kufiri ndërmjet këtyre zonave ndodhet në vijën kontaktuese të pjesës fushore dhe asaj kodrinore-malore, me drejtimin veri-jug. Në disa pjesë kjo vijë depërton përgjatë luginave lumore në lindje, sikurse rasti me luginën e Graçanicës dhe të Prishtinës. Pjesa lindore dhe verilindore e Komunës së Prishtinës është territor kryesisht kodrinor-malor, me sipërfaqe relativisht të madhe. Për shkak të terrenit kodrinor-malor, prej degëve ekonomike, dominojnë blegtoria dhe xehetaria. Rrugët në këtë territor janë relativisht të kalueshme, ndërsa për dallim mund të potencohet rruga në drejtim të Leskocit dhe kohët e fundit rruga e ndërtuar që lidh vendbanimet rurale me Kamenicën. Kushtet natyrore, relativisht të pavoritshme (relievi i përthyer) dhe rrugët e pakalueshme, deri vonë u reflektuan në dendësinë e vogël të

³ K. Mihajlović, *Ciljevi regionalnog razvoja*, Ljubljana, 1968, f. 19.

⁴ D. Princ, *Urbanizam - Urbanističko planiranje*, AFSZ, Zagreb, 2006, f. 9. Krahaso; D. Perišić, *O prostornom planiranju*, IAUS, Beograd, 1985, f. 195, 251.

banimit të kësaj pjese të territorit, si dhe në zvogëlimin e numrit të popullsisë. Në pikëpamje ekonomike dhe sociale, ky territor ngec dukshëm në krahasim me pjesët tjera të Komunës, kështu që me rastin e hartimit të planeve hapësinore duhet të jepet përgjigje për mundësitë e zhvillimit më të shpejtë të kësaj pjese. Fatkeqësisht, në këtë zonë nuk është hapur asnjë repart prodhues me dekada të tëra, ndërsa kjo mungesë e investimeve e dëshmon këtë prapambeturi. Si qendër e rëndësishme lokale e zonës veri-lindore është Keqekolla, e cila integron 10 vendbanime përreth saj. Në këtë rast vlen të theksohet se krahas shtimit relativisht të lartë natyror, numri i banorëve në vitin 1981 (7.200 banorë) mbetet i njëjtë, sikurse dy dekada më parë, ndërsa në dekadën e fundit numri i popullsisë ka tendenca të vazhdueshme të zvogëlimit. Zvogëlimi i numrit të popullsisë në këtë zonë është si pasojë e migrimit të shprehur të popullsisë në drejtim të qytetit të Prishtinës dhe në drejtim të zonave të rrafshëta.

Në pjesën perëndimore dhe jugore, për shkak të pozitës shumë të përshtatshme dhe terrenit të volitshëm, është koncentruar pjesa më e madhe e popullsisë së këtij aglomeracioni, zhvillimi i hovshëm i veprimtarive ekonomike dhe joekonomike, infrastruktura etj. Nga gjithsej 211.156 banorë, sa kishte komuna e Prishtinës në vitin 1981, në zonën urbane të saj jetonin 109.200 banorë, ose mbi gjysma e popullsisë së komunës, ndërsa dy dekada më parë kjo pjesëmarrje ishte vetëm 37%. Kjo hapësirë, në aspektin morfologjik është njëra nga pjesët më të volitshme të zonës metropolitane, por njëkohësisht edhe njëra nga zonat më të volitshme komunikatave, tregtare dhe industriale të Prishtinës. Në këtë zonë kryqëzohen vijat më të rëndësishme komunikatave në drejtim të Shkupit, Gjilanit, Pejës, Prizrenit etj. Kjo zonë karakterizohet edhe me rritje të madhe të numrit të popullsisë, me rreth 2,5 herë për çdo dy dekada, ndërsa si pasojë e kësaj, organizimi hapësinor në një masë të konsiderueshme është i karakterit joracional. Ndërtimet e objekteve jashtë vendbanimeve, në toka bujqësore, përgjatë rrugëve, japin përshtypjen e një zhvillimi të dezintegruar dhe të pavolitshëm, por edhe me pasoja të rënda për zhvillimin e ardhshëm.⁵ Graçanica, si qendër e rëndësishme në jug të qytetit të Prishtinës me zonën e saj integruese, në të ardhmen do të paraqesë pjesën më të rëndësishme të zonës metropolitane të Prishtinës. Terreni i rrafshët dhe pjesërisht i valëzuar ofron kushte shumë të volitshëm për zgjerimin e mëtejshëm të

⁵ M. Kadić, "Društveni uzroci bespravne izgradnje", *Odjek*, Sarajevo, 1972, f. 13.

aglomeracionit urban të Prishtinës. Kjo do të konsiderohet si njëra nga zonat më atraktive dhe më të sigurta të zhvillimit të ardhshëm urban të Prishtinës. Në këtë zonë ndodhet edhe vendbanimi i Hajvalisë, i cili vetëm se është integruar në indin urban të Prishtinës, sikurse shumë vendbanime tjera përreth qytetit.

Duke marrë parasysh proceset integruese territoriale-hapësinore, mund të llogaritet se aglomeracioni urban i Prishtinës (Prishtina, Fushë Kosova, Obiliqi, Graçanica) në vitin 2020 do të ketë mbi gjysmë milioni banorë, me dendësinë e përgjithshme të popullsisë prej 760 banorë në km², ndërsa në zonën fushore me përqendrim të madh të banorëve, të infrastrukturës dhe superstrukturës, dendësia mesatare e popullsisë do të arrijë në rreth 2.400 banorë në km², por me dallime të konsiderueshme ndërmjet zonës urbane të Prishtinës dhe pjesëve tjera të këtij aglomeracioni urban.

Pra, territorin e aglomeracionit urban të Prishtinës (zona e rrafshët) e karakterizon zhvillimi intensiv në të gjitha aspektet, ndërsa pjesa tjetër më e madhe e saj (zona kodrinore-malore) karakterizohet me stagnim të plotë në të gjitha aspektet. Nga të dhënat statistikore mund të shihet se zona malore ka dendësi shumë më të vogël se ajo fushore. Dendësia e popullsisë në zonën fushore është 14 herë më e madhe se në zonën kodrinore-malore, kurse bashkë me qytetin e Prishtinës dendësia e popullsisë është 58 herë më e madhe se në zonën kodrinore-malore.

Dendësia mesatare e vendbanimeve në komunën e Prishtinës është 7 vendbanime në 100 km², por me dallime të mëdha ndërmjet zonave. Dendësia e vendbanimeve në zonën kodrinore-malore është 4,6 vendbanime në 100 km², kurse në zonën fushore janë 17 vendbanime në 100 km². Kjo dëshmon për rolin e faktorëve natyrorë që kanë në shtrirjen e vendbanimeve, popullsisë dhe aktiviteteve njerëzore në hapësirën e caktuar, por edhe në paaftësinë tonë për një zhvillim të harmonizuar dhe të qëndrueshëm.




Figura 1. Organizimi metropolitane i Prishtinës

Në këtë zonë është paraparë edhe me Planin hapësinor të Kosovës “Trekëndëshi i zhvillimit ekonomik të Kosovës” si bosht zhvillimor me interes kombëtar.⁶ Këtë zhvillim strategjik e arsyeton lokacioni i qytetit të Prishtinës si kryeqendër e Kosovës - seli qeveritare e diplomatike, me korridoret kryesore të infrastrukturës

⁶ *Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+*, MMPH, Prishtinë, 2010, f. 137.

rrugore, hekurudhore, ajrore, telekomunikative dhe energjetike, që shtrihen në këtë zonë, si dhe afërsia e kësaj hapësire me korridoret e rëndësishme evropiane.

Funksionalizimi i plotë i këtij sistemi të ndërlikuar urban do të realizohet me rastin e forcimit të sistemit të infrastrukturës rrugore, si element i rëndësishëm i zhvillimit metropolitan,⁷ atëherë kur qyteti i Prishtinës do të lidhet me një linjë tramvaji nga qendra e qytetit deri te stacioni hekurudhor i Fushë Kosovës, ndërsa lidhja e qytetit të Prishtinës me qendrat e tjera (Obiliq, Hajvali dhe Graçanicë), si dhe disa lagje brenda qytetit do të bëhet nëpërmjet rrjetit të trolejbusëve. Vendbanimet, të cilat ndodhen nën ndikimin intensiv të Prishtinës (Lipjani, Drenasi, Podujeva etj.), do të integrohen në zonën metropolitane nëpërmjet komunikacionit të zhvilluar automobilistik dhe hekurudhor.

Përfundim

Në këtë punim janë definuar orientimet zhvillimore strategjike, mundësitë e shfrytëzimit të vlerave natyrore, si dhe zhvillimi dhe rregullimi administrativ i territorit të regjionit të Prishtinës si një kompleks i unifikuar hapësinor e funksional me karakter metropolitan.

Si pasojë e zhvillimeve intensive, nevoja për hartimin e planit regjional të Prishtinës është e domosdoshme, por një projekt i tillë, deri sot, ende mbetet vetëm si ide. Mungesa e një plani regjional të bashkësisë së komunave të Prishtinës ka sjellë grumbullimin e një mori problemesh të mëdha që e keqësojnë edhe fizionominë e vet qytetit të Prishtinës dhe rrethinës së saj, si: ndërtimet pa plan, zhvillimi i pabarabartë ekonomik, dendësia e banimit me dallime të mëdha ndërmjet zonave, koncentrimi i rrjetit të infrastrukturës në një zonë dhe mungesa e saj në zonën tjetër, degradimi dhe humbja e sipërfaqeve bujqësore në mënyrë të pakontrolluar, ndotja e mjedisit etj. Nga e tërë kjo që u tha, mund të konkludohet se qyteti dhe komuna e Prishtinës, me këtë potencial hapësinor dhe me këto vlera natyrore nuk mund të ketë zhvillim të sigurt si njësi e veçantë dhe e dezintegruar nga vendbanimet dhe komunat përreth saj, të cilat në radhë të parë duhet të integrohen në Bashkësinë e Komunave të Prishtinës (Prishtina, Fushë Kosova, Obiliqi, Graçanica). Pra, këto qendra janë të lidhura organikisht ndërmjet veti, ndërsa

⁷ D. Princ, *Urbanizam-Urbanisticko planiranje*, Zagreb, 2006, f. 38.

zhvillimi i ardhshëm metropolitan i Prishtinës nuk mund të paramendohet me këto barriera, që e zbehin qëndrueshmërinë e saj si kryeqendër e Kosovës. Në këtë kompleks të ndërlikuar urban dhe regjional, ndërkohë do të integrohen edhe disa qendra të rëndësishme përreth: Podujeva, Drenasi dhe Lipjani, të cilat krahas modernizimit të infrastrukturës dhe forcimit të lidhjeve komunikuese, do të luajnë rolin e qyteteve satelite, duke formuar kështu zonën metropolitane të Prishtinës.

Summary

Based on the analysis of several key spatial components we have defined strategic development guidelines, the possibilities of utilizing natural assets, as well as the administrative development and regulation of the Prishtina region as a unified spatial and functional complex with a metropolitan character. From everything that was aforesaid, it can be concluded that the city and the municipality of Prishtina with its spatial potential and natural assets cannot have a sustainable development as a separate and disintegrated unit, without the aforementioned settlements and surrounding municipalities, which should be integrated into the Association of Municipalities of Prishtina (Prishtina, Fushë Kosova, Obiliq, Graçanica). These centers are organically related to each other, and future metropolitan development of Prishtina cannot be imagined with these current barriers that weaken its viability as the capital of Kosova. In this agglomeration should be integrated some important centers: Podujeva, Drenas and Lipjan. Contemporary infrastructure and strengthening communication links will transform these centers in satellite towns, thus forming the metropolitan area of Prishtina.

Literatura

- Kadić, M., Društveni uzroci bespravne izgradnje, *Odjek*, Sarajevo, 1972.
- Kubović, B., *Ekonomika regionale*, Rilindja, Prishtinë, 1979.
- Maksimović, B., *Urbanizam -Teorija prostornog planiranja i uredjenja naselja*, Naučna knjiga, Beograd, 1986.
- Mihajlović, K., *Ciljevi regionalnog razvoja*, Ljubljana, 1968.
- Osmani, J., *Vendbanimet e Kosovës I*, Prishtinë, 2003.
- Perišić, D., *O prostornom planiranju*, IAUS, Beograd, 1985.
- Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+*, MMPH, Prishtinë, 2010.
- Princ, D., *Urbanizam - Urbanističko planiranje*, AFSZ, Pëkthim nga gjermanishtja, Zagreb, 2006.
- Šuvar, S., *Između zaseoka do megalopolisa*, IDI, Zagreb, 1973.

TRASHËGIMIA KULTURORE NË LUGINËN E PRESHEVËS: GJENDJA DHE PERSPEKTIVA

KDU 904(497.11)

Abstrakt

Kultura paraqet identitetin shoqëror të popullit dhe shoqërisë së caktuar e cila dëshmon për historinë dhe shkallën e zhvillimit të saj, ndërsa *trashëgimia*¹ kulturore paraqet një tërësi të resurseve kulturore të trashëguar nga e kaluara, të cilën njerëzit e identifikojnë, pa marrë parasysh se a është ajo pronë e tyre apo jo, si shprehje dhe manifestim i vlerave, besimeve, njohurive dhe traditave.

Trashëgimia kulturore e grupit të caktuar kulturor, popullit ose shoqërisë është një nga elementet më të rëndësishme, që dëshmon dhe dokumenton identitetin kulturor, gjuhësor dhe etnik, prandaj si e tillë është objekt i studimit të disiplinave të ndryshme shkencore. Trashëgimia kulturore historike e popullit të caktuar paraqet korpusin e vlerave shpirtërore dhe materiale të krijuara gjatë rrugëtimit historik të tij; pasqyron zhvillimin social, ekonomik, politik, fetar e kulturor të një populli; paraqet përpjekjet e tij shekullore për mbrojtjen dhe konservimin e identitetit të tij etnik, gjuhësor dhe kulturor.

Vendgjetjet arkeologjike, fortifikimet, objektet sakrale si varrezat, xhamitë, e kishat, shtëpitë e vjetra, tradita dhe folklori paraqesin një pasuri të çmueshme, por deri më tash të pahulumtuar e trashëgimisë kulturore të Luginës së Preshevës. Mbrojtja, konservimi dhe propagandimi i vlerave të trashëgimisë kulturore mund t'i shndërrojë ato në një burim të rëndësishëm të përfitimit ekonomik përmes valorizimit turistik.

Fjalët çelës: trashëgimia kulturore, konservimi, propagandimi, kalaja e Preshevës, valorizimi turistik

¹ Trashëgimia (lat. *patrimonium*; frengj. *patrimoine*; ang. *heritage*; trashëgimi nga babai ose paraardhësit; pronë e trashëguar). Në kontekstin historik në të cilin ka lindur, trashëgimia ka nënkuptuar vlerat materiale, respektivisht pronën që i ka takuar individit të caktuar. Domethënia e këtij nocioni në rrjedhat e mëvonshme historike të cilat janë karakterizuar me transformimin e pronës private në atë shoqërore, bëhet edhe më e gjërë dhe më komplekse, duke mos humbur asnjë nga epitetet e mëhershme. Nga kuptimi fillestar, nocioni është zgjeruar, duke emëruar edhe vlerat jomateriale. Me kalimin e kohës, kuptimi i trashëgimisë është shndërruar në diçka që në masë të madhe përcakton dimensionin kulturor dhe tradicional të vlerave materiale dhe jomateriale.

Kuptimet themelore mbi trashëgiminë

Diversiteti i trashëgimisë kulturore në botën në të cilën po jetojmë është burim i pazëvendësueshëm i pasurisë shpirtërore të njerëzimit. Një karakteristikë e veçantë e kësaj trashëgimie bazohet në pasurinë e diversitetit dhe kulturave, të cilat me veçoritë e veta dhe me gërshetimet në mes tyre, i japin asaj një rëndësi të posaçme. Kjo pasuri, e cila përbën bazën materiale dhe shpirtërore të ekzistimit të një populli dhe shoqërie, duhet ruajtur me kujdes. Qëllimi i mbrojtjes është ruajtja e cilësisë dhe vlerave të trashëgimisë kulturore, jetëgjatësia e saj, si dhe mbrojtja e veçorive të ndërtimit të saj. Një nga prioritetet në fushën e mbrojtjes dhe të konservimit të trashëgimisë është edhe harmonizimi i principeve ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ku secili shtet merr mbi vete përgjegjësi për zbatimin e planeve për mbrojtje në kuadër të trashëgimisë së vet kulturore. Duke pasur parasysh rrezikun në rritje, që po i kanoset trashëgimisë kulturore në botë, në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s, në vitin 1972, është nxjerrë *Konventa mbi Mbrojtjen e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore Botërore*. Konventa e vitit 1972 paraqet një nga tri konventat e UNESCO-s, të cilat trajtojnë problemet e trashëgimisë kulturore. Dy të tjerat janë Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, në rastet e konflikteve të armatosura (Konventa e Hagës), e nxjerrë në vitin 1954 dhe Konventa mbi mënyrën e ndalimit dhe moslejimit të importit, eksportit dhe transferit ilegal të trashëgimisë kulturore, të nxjerrë në vitin 1970.

Qëllimi kryesor i Konventës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore është identifikimi i hapësirave që posedojnë trashëgimi natyrore dhe kulturore, të cilat mund të nominohen për listën e trashëgimisë botërore. Që një objekt apo hapësirë e trashëgimisë kulturore të nominohet për listën e trashëgimisë botërore, duhet të posedojë vlerë të rrallë universale, e cila definohet në bazë të kritereve të përcaktuara. Konventa e UNESCO-s e vitit 1972 paraqet një kornizë që mundëson bashkëpunimin ndërkombëtar në sferën e mbrojtjes dhe konservimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në mbarë botën.

Nga UNESCO, si organizatë ombrellë dhe nga Konventa mbi Trashëgiminë, në mesin e shumë organizatave dhe instituteve të themeluara, janë edhe ato që merren me çështjen e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore si IUCN (International Union for

Conservation of Nature) me seli në qytetin Gland të Zvicrës dhe ICOMOS² (International Council on Monuments and Sites) me seli në Paris.

Trashëgimia kulturore

Trashëgimia kulturore është trashëgimi e artefakteve fizike dhe materiale, si dhe attributeve jomateriale të ndonjë grupi të caktuar ose shoqërie që përbëjnë trashëgimi të gjeneratave të kaluara, prandaj si e tillë ruhet me kujdes edhe në ditët e sotme, në mënyrë që t'u lihet si trashëgimi edhe gjeneratave që vijnë pas nesh. Në varësi të proceseve natyrore ose aktivitetit njerëzor, që kanë ndikuar në krijimin e saj, apo edhe shembujt e veprimit të kombinuar të tyre, trashëgimia ndahet në: trashëgimi natyrore, kulturore dhe mikse. Sipas Konventës (neni 1), trashëgimia kulturore është e ndarë në tri kategori.³

Monumentet kulturore (veprat arkitektonike, veprat e skulpturës monumentale dhe pikturës, elementet ose strukturat arkeologjike, mbishkrimet, vendbanimet në shpella dhe kombinimet e më shumë veçorive në to, të cilat posedojnë vlerë universale të rrallë, në aspektin e historisë, artit ose shkencës);

Tërësitë e monumenteve (grupet e ndërtesave të ndara ose të lidhura, të cilat për shkak të arkitekturës, homogjenitetit ose pozitës brenda peizazhit të caktuar posedojnë vlerë universale);

Hapësirat e monumenteve (rezultatet e punës së njeriut dhe punës së kombinuar të njeriut dhe natyrës dhe hapësirat, të cilat përfshijnë lokalitetet arkeologjike, që posedojnë vlerë të rrallë universale nga aspekti historik, estetik, etnologjik ose antropologjik).

² ICOMOS, Këshilli Ndërkombëtar për Monumente dhe Site Kulturore (Frëngjisht: *Conseil international des monuments et des sites*) është një shoqatë profesionale që merret me mbrojtjen dhe konservimin e vendeve dhe objekteve të trashëgimisë kulturore nëpër botë. ICOMOS është themeluar në vitin 1965 në Varshavë, si rezultat i Kartës së Venedikut të vitit 1964, dhe ofron këshilla për UNESCO-n përkitazi me trashëgiminë botërore. ICOMOS aktualisht ka mbi 7,500 anëtarë. Me përjashtime të rralla, çdo anëtar duhet të jetë i kualifikuar në fushën e konservimit, si arkitektët, arkeologët, antropologët, planerët urbanë, inxhinierët, administruesit e trashëgimisë, historianët, historianët e artit, paleontologët apo edhe arkivistët. Selia e këtij institucioni është në Paris.

³ *Convention Concerning Protection of Cultural and Natural Heritage*, UNESCO meeting in Paris, 17-21 November, 1972, article 1.

Nga definimi i kuptimeve themelore për trashëgiminë kuptojmë që për listën e trashëgimisë kulturore botërore është e mundur të nominohet i tërë qyteti, siç është Roma (Itali), ose pjesa e vjetër (historike) e qytetit, çfarë është qyteti i vjetër Torun (Poloni), ose një numër i caktuar i monumenteve të mbrojtura. Sipas të dhënave të World Heritage Committee, e cila ka përpiluar dhe vazhdimisht e përditëson listën e trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore, në vitin 2014, në mesin e 1007 faqeve të internetit të trashëgimisë botërore, 779 ishin të trashëgimisë kulturore, 197 të trashëgimisë natyrore dhe 31 të kombinuara, në 134 shtete në tërë botën.⁴

Në rastin kur një hapësirë të mbrojtur i kanoset rreziku prej natyrës ose njeriut, e njëjta mund të evidentohet në listën e trashëgimisë botërore në rrezik, me qëllim që hapësirës së rrezikuar t'i mundësohet ndihma, në mënyrë që rreziku të tejkalohet. Kur një objekt shënohet në listën e trashëgimisë botërore, pritët që vlerat të cilat kanë rëndësi universale të ruhen. Janë të papranueshme të gjitha ato aktivitete, të cilat e zvogëlojnë autenticitetin dhe vlerën universale. Prandaj, një zonë e mbrojtur mund të largohet nga lista e trashëgimisë botërore në këto raste:

- a) nëse një zonë ballafaqohet me dëmtime, të cilat e kanë shkatërruar vlerën për të cilën ajo është evidentuar në listën e trashëgimisë botërore;
- b) nëse kualiteti i zonës së mbrojtur me rëndësi botërore është rrezikuar nga ana e njeriut, ndërsa masat përmirësuese nuk janë ndërmarrë në kohën e duhur.

Të gjitha zonat nga lista e trashëgimisë botërore janë objekte të shteteve në të cilat ndodhen, por është në interesin e bashkësisë ndërkombëtare që të kujdeset për këto zona për shkak të brezave të ardhshme të njerëzimit.

Ndarja e trashëgimisë kulturore

Trashëgiminë kulturore e përbëjnë trashëgimia kulturore materiale dhe jomateriale, të shoqëruar me trashëgiminë natyrore të mjedisit ku ndodhet ajo. Trashëgimia kulturore materiale dhe jomateriale përfshinë të mira të ndryshme kulturore. Të mirat

⁴ <http://whc.unesco.org/en/committee/>

(objektet) kulturore paraqesin gjësendet dhe krijimtaritë materiale e shpirtërore të cilat janë me interes të përgjithshëm në nivelin lokal, nacional dhe global.

Trashëgimia kulturore materiale nënkupton të mirat kulturore të prekshme të cilat, varësisht nga veçoritë fizike, kulturore, artistike, historike dhe në bazë të mundësisë së prezantimit dhe valorizimit shumëdimensional ekonomik, ndahen në *trashëgimi të luajtshme* dhe *trashëgimi të paluajtshme*.

Në trashëgiminë kulturore e *paluajtshme*, sipas veçorive fizike, artistike, kulturore, historike e shkencore, bëjnë pjesë tërësitë hapësinore kulturore-historike, vendgjetjet arkeologjike, vendet e veçanta etj. Rrethina (mjedisi) ku ndodhet objekti i trashëgimisë kulturore gëzon mbrojtje të njëjtë sikurse objekti i mbrojtur. Ndërsa, në trashëgiminë kulturore të luajtshme, sipas veçorive, fizike, artistike, kulturore, historike e shkencore bëjnë pjesë veprat artistike, materiali arkivor, filmues, librat e vjetra dhe të rralla.

Me “trashëgimi kulturore jomateriale” kuptohen praktikat, paraqitjet, shprehjet, njohuritë dhe dijebërja (*savoir faire*) – si dhe veglat, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore që bashkëshoqërojnë ato – që bashkësitë, grupet dhe, kur është rasti, individët i pranojnë si pjesë përbërëse të trashëgimisë së tyre kulturore. Kjo trashëgimi kulturore jomateriale, përcjellë brez pas brezi, është rikrijuar në vijimësi nga bashkësitë dhe grupet në funksion të mjedisit të tyre, të ndërveprimit të tyre me natyrën dhe të historisë së tyre, dhe u jep atyre një ndjenjë identiteti dhe vazhdimësie, duke ndihmuar kështu për promovimin e respektit për diversitetin kulturor dhe të krijimtarisë njerëzore.⁵ Këto vlera i thekson dhe i mbron UNESCO, që edhe ka dhënë klasifikimin e plotë të trashëgimisë kulturore.

Varësisht nga përmasat e objektit të trashëgimisë kulturore, specifika e ndërtimit, vjetërsia, rariteti apo edhe përmasat e trashëgimisë natyrore kanë edhe rëndësi të ndryshme. Prandaj një objekt i trashëgimisë kulturore qoftë ai një lokalitet arkeologjik, një kishë ose xhami e vjetër, një mbishkrim ose shtëpi brenda territorit të ndonjë komune, ka rëndësi lokale dhe si të tilla duhet të merren nën mbrojtje nga organet komunale. Në rastin kur vlera e caktuar e trashëgimisë kulturore ka përmasa më të mëdha, lashtësi dhe shpërfaqë një periudhë të caktuar historike nëpër të

⁵ *Konventa për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale*, Neni 2, Paris, 17 tetor, 2003, f. 3.

cilën ka kaluar një popull ose etnikum i caktuar, atëherë ajo vlerë ka rëndësi kombëtare dhe merret nën mbrojtje me akte të caktuara ligjore nga organet shtetërore si vlerë (e mirë) me rëndësi kombëtare. Vlerat e trashëgimisë kulturore, të cilat janë të rralla, specifike për nga mënyra e krijimit, datojnë shumë herët dhe dëshmojnë për evoluimin shoqëror dhe historik të njerëzimit, kanë rëndësi universale dhe si të tilla gëzojnë status të veçantë të mbrojtur në nivel botëror.

Trashëgimia kulturore e Luginës së Preshevës: veçoritë, gjendja dhe perspektiva

Pasuria e trashëgimisë së një regjioni, përkatësisht e bashkësisë etnike ose e grupit të caktuar kulturor, që jeton brenda kufijve të tij, është e lidhur ngushtë me zhvillimet historike, sociale, kulturore dhe politike, nëpër të cilat ka rrugëtuar ai grup ose etnikum i caktuar gjatë periudhave të ndryshme historike. Meqenëse Lugina e Preshevës shtrihet në një nga korridoret më të rëndësishme natyrore, i cili shumë herët është shfrytëzuar nga perandori e shtete për të zgjeruar pushtimet e tyre, zhvillimet të cilat i vunë në pah më lartë, kanë qenë shumë të vrullshme, duke u manifestuar edhe me një diversitet të ndikimeve kulturore, që secila nga pak, kanë lënë gjurmë të veta në regjion dhe më gjerë. Mbretëria dardane, pjesë e pandashme e së cilës ka qenë edhe Lugina e Preshevës, ka lënë gjurmë të veta në trashëgiminë kulturore-historike, e cila për shkak të mungesës së hulumtimeve të mirëfillta shkencore, ende ka mbetur e pandriçuar. Në periudhën e sundimit të Perandorisë Romake kemi një lulëzim të regjionit në aspektin e ngritjes dhe zhvillimit të vendbanimeve, tregtisë, bujqësisë dhe zhvillimeve të tjera sociale e politike për të cilat dëshmojnë të dhënat e gjetura arkeologjike, kryesisht në rrafshin aluvial të Moravicës, afër fshatrave Zhunicë, Corroticë dhe Rincë. Sundimi disashekullor i Perandorisë osmane në Luginë dhe më gjerë në Gadishullin Ballkanik, impakti kulturor, social e politik, që ushtron në popullsinë e rajonit përmes konvertimit fetar dhe tendencave për asimilim gjuhësor dhe etnik, arrin të ndryshojnë mjedisin kulturor e social të regjionit. Kjo dëshmohet me një trashëgimi të pasur kulturore-historike, materiale dhe jomateriale.

Vendgjetjet arkeologjike, fortifikimet, objektet sakrale si, varrezat, xhamitë, kishat, shtëpitë e vjetra, tradita dhe folklori paraqesin një pasuri të çmueshme, por deri më tash të pahulumtuar e trashëgimisë kulturore të Luginës së Preshevës.

Rrafshi aluvial i Moravicës, shpatet e Karadikut në perëndim dhe ato të Rujanit në lindje, për shkak të pozitës shumë të volitshme, ishin të banuara shumë herët. Kjo dëshmohet nga vendgjetjet arkeologjike, si në pjesën fushore ashtu edhe në atë kodrinore-malore të Luginës. Kërkimet arkeologjike në mënyrë të organizuar dhe të udhëhequra nga grupe hulumtuese-shkencore, në disa prej lokaliteteve arkeologjike, janë bërë tek në fund të viteve të 60-ta dhe 70-ta të shekullit të kaluar. Bartës i këtyre projekteve hulumtuese-shkencore ka qenë Muzeu Popullor i Vranjës. Niveli i kërkimeve në këto lokalitete është kufizuar vetëm në rekognoscimin (njohjen) e përmasave territoriale të vendgjetjeve arkeologjike, duke përcaktuar edhe periudhat historike të lokaliteteve e rrjedhimisht edhe trashëgimisë arkeologjike.

Ekspeditat hulumtuese, me përjashtime të rralla nuk kanë rezultuar me gjetjen e materialeve arkeologjike të cilat do të mundësonin ndriçimin e shumë aspekteve të zhvillimit historik dhe etno-demografik të regjionit. Ato pak eksponate të gjetura në territoret e Preshevës, Rahovicës, Zhunicës, Corroticës, Bukurocës, Bushtranit, Leranit, Miratocës etj., janë dërguar në Muzeun Popullor të Vranjës. Këto janë kryesisht monedha, gjilpëra, qafore, pitosë dhe mjete të amvisërisë, të cilat datojnë qysh nga periudha dardane, pastaj romake, bizantine. Vendgjetjet arkeologjike në mbarë territorin e Luginës së Preshevës, ku duhet veçuar *Kalanë e Bushtranit*, *Kalanë e Preshevës*, *Kalanë e Kërshevicës*, *Gurin e Shpuar* (Preshevë), *Kacipupin* (Rahovicë), *Bostanishten* (Zhunicë), *Dobrecën* (Bukurocë), *Konopishten* (Corroticë), *Biganocin* (Raincë), përmbajnë në vete një trashëgimi të pasur arkeologjike. Përpos aktiviteteve hulumtuese të bëra nga arkeologët serbë dhe ndonjë të huaji, të gjitha tentimet tjera të bëra më vonë nga njerëz të profesioneve të ndryshme, nuk kanë arritur të ndriçojnë ndonjë problem nga korpusi i veçorive shumë komplekse historike, sociale dhe etnike-demografike të territorit.

Duke qenë të vetëdijshëm mbi pasurinë e trashëgimisë arkeologjike të Luginës dhe rëndësinë që mund të ketë ajo për argumentimin e shumë çështjeve, që kanë të bëjnë me praninë, autoktoninë dhe vazhdimësinë e etnikumit ilir-dardan dhe shqiptar në rajon, mendojmë se kërkimet arkeologjike duhet bërë nga institucionet shkencore dhe akademike të qendrave universitare me pjesëmarrje edhe të arkeologëve të huaj. Të gjitha përpjekjet individuale të njerëzve me përgatitje joadekuate profesionale dhe shkencore, jo vetëm që ngelin në nivelin e vullnetit të mirë, entuziazmit dhe

kërshërisë, por mund të dëmtojnë veçoritë origjinale dhe autenticitetin e artefakteve të gjetura, të cilat assesi nuk do të kontribuonin në ndriçimin e çështjeve shumë të ndjeshme për të cilat u fol më lart. Pa dashje, duhet të konstatojmë se fatin e njëjtë sikurse të trashëgimisë arkeologjike, e kanë pasur edhe shumë vlera të tjera të trashëgimisë kulturore si, shtëpi të vjetra, objekte sakrale, monumente dhe sheshe, të cilat për shkak të neglizhencës së organeve komunale dhe amatorizmit e joprofesionalizmit të të ashtuquajturave shoqata dhe individëve të caktuar, janë shkatërruar dhe rrezikojnë t'i humbin vlerat origjinale e autentike. Proceset historike dhe shoqërore-ekonomike, por edhe ato bashkëkohore si gjithkund në botë, edhe në Luginën e Preshevës e rrezikojnë nga shkatërrimi dhe e devastojnë trashëgiminë kulturore dhe natyrore.

Në Luginë, deri tash, nuk ka pasur një hulumtim serioz mbi objektet e trashëgimisë kulturore, andaj nuk ekziston asnjë elaborat, i cili me argumentim të detajuar dhe shkencor, do të ofronte një pasqyrë të trashëgimisë kulturore dhe kategorizimin e saj, sipas llojit dhe rëndësisë. Hulumtimet e bëra nga shoqata për trashëgimi dhe krijimtari kulturore, edhe pse të udhëhequra nga qasja pozitive, dëshira dhe vullneti i mirë, nuk kanë arritur të përmbushin objektivat mbi identifikimin, evidentimin dhe kategorizimin e drejtë të objekteve të trashëgimisë kulturore në komunat Preshevë e Bujanoc.

Përpos mungesës së njohurive, amatorizmit dhe inferioritetit profesional e shkencor të pjesës dërmuese të njerëzve të kësaj shoqate ndaj problemit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, situata e pavolitshme në sferën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore e natyrore është edhe për shkak të neglizhencës së organeve komunale, si në Preshevë, ashtu edhe në Bujanoc, të cilat për çështjen e identifikimit dhe mbrojtjes së trashëgimisë nuk parashohin asnjëherë, bile as në mënyrë simbolike mbështetje financiare e profesionale, duke mos qenë të gatshëm që së paku të ndajnë një hapësirë modeste brenda shtëpive të kulturës, dedikuar muzeve ku do të ekspozoheshin vlera të caktuara të trashëgimisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme autoktone të Luginës. Shembulli i shkatërrimit të kalldrëmit në Çarshinë e Preshevës, për ta mbuluar atë me asfalt dhe beton, tregon se si qeverisja komunale, me ose pa vetëdije shkatërron vlerat e trashëgimisë kulturore, të cilat në vende dhe rajone të tjera, jo vetëm që mbrohen, por edhe konservohen e restaurohen, duke mundësuar valorizimin turistik dhe në përgjithësi ekonomik të tyre. Prizreni, Gjakova, Novi Pazari, madje edhe Vranja fqinje, i mbrojnë,

konservojnë dhe propagandojnë me krenari këto vlera, duke i shndërruar në pika të rëndësishme turistike brenda hapësirave urbane dhe rrethinës së gjerë ku ndodhen ato. Vlerat e trashëgimisë kulturore të Luginës së Preshevës me veçoritë që kanë, çfarë janë vjetërsia (mosha), rariteti, specifikat e ndërtimit (krijimit), si dhe procesi apo periudha e caktuar historike, të cilën e manifestojnë, mendojnë se kanë vlerë lokale, prandaj si të tilla duhet të merren nën mbrojtje nga organet komunale të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.

Monumentet e trashëgimisë kulturore në Luginën e Preshevës

Kalaja e Preshevës

Banimi i hershëm i territorit të Luginës së Preshevës dëshmohet me praninë e ngrehinave dhe fortifikimeve, të cilat me pozitën e tyre dhe veçoritë e tjera të ndërtimit, kishin funksion strategjik-mbrojtës për popullsinë e regjionit. E tillë është Kalaja e Preshevës, e cila shtrihet rreth 1 kilometër në perëndim të qendrës së qytetit, në anën e majtë të magjistrales Preshevë-Gjilan. Nga kalaja e Preshevës mund të kontrolloheshin të gjitha rrugët, ndërsa deri te ajo mund të shkohej vetëm nga ana perëndimore. Historiografia serbe tenton që ndërtimin e saj t'ia atribuojë sundimtarëve të caktuar serbë, të cilët pas përfundimit të periudhës bizantine, kishin shtrirë pushtimin e vet edhe në këtë pjesë të trungut gjeoetnik shqiptar. Njohja dhe hulumtimi i pozitës, veçorive morfometrike, mënyrës së ndërtimit, gjetjeve arkeologjike brenda territorit të kalasë dhe në rrethinën e afërt siç janë bregu i majtë i lumit të Kurbalisë, Lugu i Brinjës, Përzhari, Valeva etj., dëshmojnë për ekzistimin e kalasë dhe praninë e jetës kulturore brenda dhe në afërsi të saj edhe më herët se periudha romake-bizantine. Meqenëse Lugina e Preshevës gjatë periudhës dardane ishte pjesë përbërëse e saj dhe përbënte kufirin lindor të shtrirjes së grupit kulturor dardan, del që kalaja e Preshevës dhe fortifikimet tjera në regjion, ishin të periudhës dardane. Muret e kalasë të mbetura deri në ditët e sotme janë ngritur më vonë mbi gërmadhat e ngrehinës së vjetër dardane.



Foto 1. Kalaja e Preshevës

Eksponatet e gjetura⁶ gjatë gërmimeve të pakta arkeologjike janë dërguar në qytetin e Vranjës, ndërsa mungesa e masave për restaurimin dhe konservimin e vlerave të kalasë vazhdon t'i degradojë këto vlera dhe rrezikon shkatërrimin total të tyre. Edhe pse shumë afër qytetit, ajo, për shkak të mungesës së rrugës, ka qenë shumë e vështirë për t'u vizituar. Në vitin 2012 është ndërtuar një rrugicë e ngushtë për t'u ngjitur deri te kalaja, por e cila është tërësisht jofunksionale. Mungojnë shenjat që të orientojnë për t'u ngjitur deri te kalaja, ndërsa deri tash, nuk është shtypur asnjë broshurë-prospekt për të propaguar vlerat e kalasë dhe për të stimuluar vizitat e këtij objekti. Përpos vizitave të rralla që bëhen nga nxënësit e shkollave, deri tash, nuk ka asnjë formë të valorizimit turistik të saj.

Kacipupi – Oppidum dardan

Në shpatet jugore të luginës së lumit të Rahovicës, në dalje të saj në fushën e Preshevës ndodhet lokaliteti *Kacipupi*, ku është ngritur një

⁶ Në majen e kodrës ku është kështjella janë gjetur vegla dhe armë prej brince (lloj stralli), kurse në rrëzën juglindore janë gjetur gjilpëra të punuara prej kockave të dërrit të egër. Gjithashtu janë gjetur copa qeramike të vorbave, prodhime të poçarisë etj. Për më tepër shih: J. Murati-Staneci, *Kështjella e Preshevës*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2014, ff. 10-11.

oppidum i cili në bazë të mënyrës dhe teknikave të ndërtimit del të jetë i ngritur në periudhën dardane. Të dhënat nga gjetjet e pakta arkeologjike, sjellin në konkludimin se Kacipupi dhe ngrehinat e ngjashme dardane janë zhvilluar prej shekullit të VII-V p.e.s.⁷ Ngrehinat dardane ndërtoheshin me ledhe prej gurësh të ngjitura me baltë. Pozita e kësaj ngrehine dardane le të kuptohet që kishte funksion mbrojtës për popullsinë dardane, e cila jetonte në zonën kodrinore-malore të Kardakut. Ngjitja deri te Kacipupi është e mundur nga pjesa jugore, ndërsa pjesa veriore dhe lindore janë të pakalueshme për shkak të pjerrtësisë gati vertikale të shpateve. Sipërfaqja e këtij lokaliteti është 120 X 60 m.



Foto 2. Kacipupi – Oppidum dardan

Kalaja e Bushtranit

Kalaja e Bushtranit ndodhet rreth 1 kilometër në juglindje të fshatit Bushtran. Ajo, sikurse ngrehinat e Kacipupit dhe Preshevës, ishte një nga fortifikimet më lindore deri ku shtrihej Mbretëria Dardane. Edhe pse gjatë antikës ishte shumë imponante dhe rreth saj zhvillohej një jetë mjaft e bujshme kulturore, sot, pothuajse nuk ekzistojnë aspak gërmadhat e mureve, të tilla siç i hasim te ngrehinat e ngjashme në Preshevë dhe Rahovicë.

⁷ E. Shukriu, *Dardania paraurbane*, Dukagjini, Pejë, 1995, f. 26.

Tabela 1. *Vendndodhja e monumenteve natyrore dhe kulturore të Luginës së Preshevës*


	LOKALITETI	X ⁸	Y ⁹	Z ¹⁰	KOMUNA KADASTRALE
1	Ujëvara e Bumballës	555807	4689688	506	SHOSHAJË E EPËRME
2	Konopishtë (lok.arkeologjik)	558262	4688651	436	CORROTICË
3	Kalaja e Stanecit	548239	4686686	820	STANEC
4	Vendbanimi i vjetër Vala	550862	4685821	833	BUHIÇ
5	Hardhuci (vorbullë karstike)	545052	4685276	933	SEFER
6	Oda e Can Seferit	554950	4684770	887	SEFER
7	Vorbullë karstike	549240	4688311	796	ILINCË
8	Shpella e Ilincës	549329	4688543	733	ILINCË
9	Kacipupi	553838	4686245	527	RAHOVICË
10	Ilixha	554200	4686092	485	RAHOVICË
11	Gurët e Gatë	555518	4692323	568	RAINCË
12	Kalaja e Bërçecës	552375	4694268	859	RAINCË- BËRÇEC
13	Biganoci	554834	4692057	499	RAINCË
14	Kalaja e Preshevës	551713	4684826	749	PRESHEVË
15	Kisha e Preshevës	552736	4684532	538	PRESHEVË
16	Guri i Shpumë	551544	4683722	637	PRESHEVË
17	Shtëpia e Esat Agës	553341	4684421	519	PRESHEVË
18	Xhamia e Ibrahim Pashës	553338	4684437	517	PRESHEVË
19	Teqeja e vjetër	553338	4684437	519	PRESHEVË
21	Kalaja e Bushtranit	563479	4686494	640	BUSHTRAN
22	Bostanishta (lok. Arkeologjik)	558342	4685867	442	ZHUNICË
23	Dobrecë (lok. Arkeologjik)	557745	4686556	447	BUKUROÇ
24	Shpella e Arushës	550085	4680339	764	TËRRNAVË
25	Guri i Gatë (lok.arkeologjik)	550909	4680720	639	TËRRNAVË

⁸ X – Gjerësia gjeografike sipas projeksionit hartografik UTM (*Universal Transverse Mercator*)

⁹ Y – Gjatësia gjeografike sipas projeksionit hartografik UTM (*Universal Transverse Mercator*)

¹⁰ Z – Lartësia mbidetare

26	Teqe ((Faltore)	558257	4696632	455	NESALCE
27	Urë e Vjetër (Lluçan)	558071	4699839	408	LLUCAN
28	Objekt i lashtë	560768	4702298	423	TËRNOÇ
29	Xhami	560838	4702589	424	TËRNOÇ
30	Kishë	560436	4703064	467	TËRNOÇ
31	Lokalitet i vjetër	560155	4703474	468	TËRNOÇ
33	Xhami	562019	4713589	646	MUHOC
34	Vendbanim antik	555548	4695686	606	VERBAN
35	Xhami	562025	4689528	476	BILAÇ
37	Lokalitet arkeologjik	566892	4698278	441	KËRSHEVICË



Harta 1. Vendndodhja e monumenteve natyrore dhe kulturore të Luginës

Kërsheвица

Kërsheвица ndodhet në shpatet veriperëndimore të Malit të Rujanit, rreth 3 kilometra në juglindje të Bujanocit. Kalaja e Kërshevicës përfshin një plate të zgjatur me shpatet përfaq, prej nga dominon shikimi në drejtim të Moravës Jugore dhe fushës së Bujanocit dhe Vranjës.

Për dallim prej lokaliteteve të tjera arkeologjike, në Kalanë e Kërshevicës, janë bërë hulumtime më të hollësishme, të cilat kanë filluar që nga viti 1966. Qysh në hulumtimet e para është konstatuar se kjo vendgjetje arkeologjike i ka të gjitha elementet e një vendbanimi të fortifikuar – akropolit, së bashku me lagjen jashtë qytetit. Në vitin 2001, në hulumtimet e përbashkëta të bëra nga Instituti Arkeologjik i Beogradit, Muzeu Popullor i Vranjës dhe Fakulteti Filozofik i Universitetit të Beogradit, gjenden të dhëna të vlefshme, të cilat tregojnë së vendbanimi daton nga periudha e bronzit të vonshëm, rreth shekujve 13-14 p.e.s. Kreshta (ngritja) natyrore me një rrafsh të vogël është shfrytëzuar për ndërtimin e fortifikimit me akropol, në të cilën është gjetur një kompleks i madh arkitektonik. Hulumtimet e fundit të bëra në vitin 2008 ndryshojnë disa pikëpamje të mëhershme mbi përmasat e lokalitetit arkeologjik, meqenëse zbulohen gërmadhat e një muri, i cili e rrethonte akropolin dhe lagjen e banuar afër saj në një sipërfaqe prej 5 ha.¹¹



Foto 3. Kalaja e Kërshevicës

¹¹ P. Popović, *Archaeological finds from the vaulted building at Krševica*, *Starinar*, LVIII/2008, f.95.

Materiali i shumtë arkeologjik kryesisht përbëhet nga qeramika luksoze greke e importuar nga punëtoritë e Gadishullit të Atikës ose atyre nga Egjeu Verior. Këto janë pitosë, qeramika e kuzhinës, pastaj janë gjetur edhe stoli, sikurse fibula, unaza, perla të qelqta, gjilpëra, monedha të Filipit II, Aleksandrit të Madh dhe pasuesve të tyre.¹² Të gjitha këto gjetje së bashku, me mënyrën e ndërtimit, dëshmojnë për nivelin e lartë kulturor të popullsisë së këtij vendbanimi.

Mënyra e rregullimit të hapësirës në lokalitetin e Kërshevicës, qeramika e importuar, monedhat dhe gjësendet e tjera, dëshmojnë qartë prezencën greke dhe rëndësinë e këtij vendbanimi. Faktet e lartpërmendura shtrojnë edhe plot dilema përkitazi me emrin dhe funksionin e këtij lokaliteti më verior, me veçori greko-helene dhe na sjellin në lidhje me Damastionin, qytetin xehtar, të cilin e përmend Straboni në librin e tij. Në anën tjetër, edhe pse shumë gjetje arkeologjike kanë karakteristika helene dhe lidhen me territorin trak, ka të tilla, të cilat kanë analogji të madhe me ato të gjetura në Kosovë dhe Maqedoninë Veriore. Këto gjetje janë argument shtesë, që sforcojnë hipotezën se edhe qyteza e Kërshevicës, ka mund të jetë brenda kornizave të shtrirjes së grupit kulturor dardan.¹³ Hulumtimet serioze arkeologjike, të cilat duhet të ndërmerren në këtë lokalitet, mund të vërtetojnë apo t'i hedhin poshtë si të pasakta hipotezat që i zëmë në gojë më lartë.

Guri i Shpumë

Një objekt tjetër i vjetër i trashëgimisë kulturore, i cili tërheq vëmendjen shkencore dhe është mbështetje e mirë për ngritjen e hipotezave mbi të kaluarën, doket dhe ritet fetare të popullsisë në shpatet e Karadakut dhe fushën e Moravicës është “Guri i Shpumë” i cili ndodhet në shpatet veriore të luginës së lumit të Kurbalisë, në jugperëndim të Preshevës. Lokaliteti “Guri i Shpumë”, emri i të cilit rrjedh nga “kisha”, një skulpturë natyrore e pastudiuar, e futur në pjesë shkëmbore, në mesin e të cilit gjendet zgavra, e cila karakterizon këtë gur masiv. Në pamje metafore, kjo vepër krejtësisht natyrore, sikur i ngjanë një observatori natyror enigmatik dhe bënë vendin të

¹² <http://www.narodnimuzej.rs/za-strucnjake/istrazivački-projekti/arheološka-istraživanje/krševica-kale>.

¹³ P. Popović, *Po aty*.

duket mjaft atraktiv”.¹⁴ Ka gojëdhëna se “Guri i Shpumë” të ketë qenë objekt kulti i popullsisë së rrethinës së afërt. Këto pohime kanë njëfarë mbështetje nga analiza e pamjes dhe brendisë së këtij lokaliteti. Në pjesën e sipërme ndodhet një zgavër prej nga njeriu-vizitori mund të lëshohet në hapësirat e brendshme, ndërsa harqet e ashpra nga gurët, si dhe pjesë të murit, që shihen në vend, lënë të kuptohet se këtu kishte një kupolë me dimensione të mëdha, e cila tashmë është mbuluar nga dheu.¹⁵

Hulumtimet arkeologjike në këtë lokalitet dhe në afërsinë e tij, me përfshirjen, jo vetëm të arkeologëve, por edhe të historianëve, antropologëve, arkitektëve e studiuesve të artit, mund të sjellin deri te përcaktimi i periudhës kur është përdorur ky objekt, nevojave për të cilat është ngritur dhe kohëzgjatjes së përdorimit të tij. Deri tash, përveç përcaktimit të pozitës gjeografike dhe dimensioneve, të gjitha konstatimet e tjera janë në nivelin e hipotetik dhe kanë karakter të gojëdhënave, andaj nuk përmbajnë ndonjë të vërtetë shkencore. Megjithatë, pozita, veçoritë morfo-metrike dhe gdhendjet nëpër muret e këtij lokaliteti e bëjnë të rëndësishëm, nga aspekti i hulumtimeve shkencore, të cilat duhet të realizohen nga ekipe të ekspertëve dhe institucione serioze shkencore.

Xhamia e Ibrahim Pashës “Atik Xhamia”

Pas rënies së Luginës së Preshevës nën sundimin e Perandorisë Osmane fillon një etapë e re në zhvillimin kulturor, social dhe etnodemografik të regjionit. Zhvillimet e reja manifestohen me fillimin e procesit të konvertimit fetar, imponimin e shkrim-leximit arab dhe gjuhës osmane në komunikim, promovimit të mënyrave dhe stileve të reja turko-orientale në ndërtimin e objekteve private të ndërtimit, objekteve publike, si xhamive, tyrbeve, hamameve (banjave publike), rrugëve, shesheve urave etj. Dëshmitë e kësaj periudhe disashekullore, sot hasen në objekte dhe forma të ndryshme të trashëgimisë kulturore, materiale dhe jomateriale.

¹⁴ B. Agushi, *Presheva me rrethinë në zhvillimin arkitektonik urbanistik*, Prishtinë, 2009, f. 12.

¹⁵ B. Agushi, *Po aty*, f. 38.



Foto 4. Xhamia e Ibrahim Pashës

Një nga objektet më me vlerë të kësaj trashëgimie në komunën e Preshevës dhe më gjerë është Xhamia e Ibrahim Pashës, siç njihet ndryshe “Atik Xhamia”. Është ndërtuar në vitin 1805 (1220, sipas kalendarit të Hixhrit). Xhaminë e ka ndërtuar Ibrahim Pashë Bushatliu nga Shkodra. Ajo shtrihet në pjesën qendrore të qytetit, skaj çarshisë (sheshit) të qytetit. Në hyrje të xhamisë ndodhet pllaka me mbishkrim në gjuhën turko-osmane, me alfabet arab. Në këtë shkrim thuren elozhe dhe lëvdata për Ibrahim Pashën nga Shkodra, ndërtuesin e kësaj xhamie.

Vjetërsia e xhamisë, stili i veçantë arkitektonik, mbishkrimet në gjuhën turko-osmane, i japin këtij objekti fetar atributet e një monumenti shumë të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore materiale. Në vitin 2013 janë kryer punët në meremetimin dhe gëlqerosjen e objektit, duke konservuar vlerat origjinale dhe autentike. Që nga koha kur është ndërtuar e deri më sot, vazhdon të frekuentohet nga besimtarët myslimanë, jo vetëm të qytetit të Preshevës, por edhe të fshatrave të komunës së Preshevës.

Tyrbja bektashiane

Brenda oborrit të xhamisë së vjetër (Atik Xhamisë) ndodhet edhe Tyrbja bektashiane. Xhamia, tyrbja dhe varrezat e mbishkrimet përbëjnë një kompleks të veçantë të trashëgimisë kulturore të qytetit të Preshevës. Tyrbja është e tipit të mbuluar brenda dhe jashtë saj, ka varreza monumentale të besimtarëve të shquar të këtij sekti. Në formulimin arkitektonik ka të cilësuar mirë harmoninë dimensionale në boshtin horizontal dhe vertikal.¹⁶ Është me bazë katrore dhe me kulm të mbuluar në formë kupole.

Sipas arkitektes me origjinë nga Presheva, Burbuqe Agushi, elementet arkitektonike të këtij objekti vlejné të përsëriten edhe në ndërtimet e reja, me qëllim që të shpërndahen detajet për frymëzim të arkitekturës vendore. Meremetimi dhe konservimi i tyrbes është nevojë imediate, meqenëse ajo është në gjendje shumë të keqe dhe mund të shkatërrohet tërësisht.

Mundësitë e valorizimit turistik të trashëgimisë kulturore në Luginën e Preshevës

Trashëgimia kulturore në kombinim me trashëgiminë natyrore të mjedisit ku ndodhet, mund të shndërrohet në një motiv shumë të rëndësishëm turistik. Ajo mund ta kompletojë ofertën turistike të rajonit, ndërsa në raste të veçanta paraqitet edhe si motivi dhe qëllimi kryesor i udhëtimeve dhe vizitave turistike. Në mesin e shumë formave të udhëtimeve turistike të cilat dallojnë për nga motivet, kohëzgjatja, mosha e njerëzve të përfshirë në to, mënyra e realizimit të tyre etj, kohët e fundit është në rritje e sipër një formë e veçantë e

¹⁶ *Po aty*, f. 137.

turizmit, që udhëhiqet nga motivet kulturore dhe u mundëson turistëve njohjen me vlerat e trashëgimisë kulturore të popujve dhe territoreve të caktuara. Kjo formë e turizmit njihet sot në botë si turizëm kulturor i cili ka të bëjë me produktin turistik të bazuar në trashëgimi dhe kulturë. Turizmi kulturor është secila formë e turizmit që ka për qëllim vizitat turistike të muzeve, shfaqjeve, koncerteve, pastaj formave turistike që lidhen me trashëgiminë materiale ose “të ndërtuar”, duke filluar nga monumentet religjioze e deri te veprat e arkitekturës botërore.¹⁷

Në kontekstin e turizmit kulturor paraqitet një formë specifike e plotësimit të nevojave të turistëve, dhe kjo për faktin se faktori relaksues i konsumimit të shërbimeve turistike, zhvillohet në mjedisin e ri dhe të veçantë kulturor, në dy dimensione kohore. Në fakt, turizmi kulturor krijon iluzionin e dëshiruar të kontaktit me nikoqirin në ambientin autentik. Gjatë këtij kontakti gërshetohen e kaluara me të tashmen. Prandaj, turistët pasurohen me përvojat e reja të përditshmërisë, duke mos u zhytur në të, pastaj njihen me ndodhitë e lashta në po të njëjtin vend etj.¹⁸

Nga definicioni i mësipërm i turizmit kulturor shohim që ai ka motive të shumta, të cilat në përgjithësi identifikohen dhe nxiten nga kultura dhe trashëgimia kulturore e territorit të caktuar. Është vështirë që një territor i caktuar të ofrojë të gjitha këto motive, andaj me përjashtime të rralla, turizmi kulturor është formë komplementare (plotësuese) e udhëttimeve turistike. Kjo vlen edhe për Luginën e Preshevës, në të cilën ekzistojnë disa nga motivet e ofertës turistike kulturore. Lokalitetet arkeologjike, fortifikimet, xhamitë, teqetë, kishat, shtëpitë e vjetra përbëjnë potencialisht një motiv komplementar turistik. Këto vlera të trashëgimisë kulturore plotësohen me vlerat e trashëgimisë natyrore, siç janë Shpella e Ilincës, Shpella e Arushës, burimet termominerale të Bujanocit dhe të Banjkës, peizazhet atraktive të zonës kodrinore-malore të Karadakut dhe Malësisë së Bujanocit etj. Lidhjet e mira komunikuese, ku paraprin Korridorin X dhe rrugët e tjera rajonale, janë një parakusht shumë i volitshëm që mundëson zhvillimin e turizmit transit, me motive kulturore-rekreative.

¹⁷ R. G. Seale, “A Perspective from Canada on Heritage and Tourism”, *Annals of Tourism Research*, Vol 23 (2), 1996, f. 484.

¹⁸ T. Gradiček, “Kulturna baština i gospodarski razvitak Republike Hrvatske”, *Ekonomski Pregled*, 60, (3-4), 2009, f. 200.

Trevat kodrinore-malore të Karadakut dhe Malësisë së Bujanocit me peizazhet e ruajtura natyrore, shtëpitë e vjetra dhe objektet përcjellëse të ekonomive familjare, stanet, doket, traditat e ritet, të cilat në pjesët fushore tanimë janë në zhdukje e sipër, mundësojnë zhvillimin e formave tjera të turizmit, siç janë ekoturizmi dhe etnoturizmi që janë shumë aktuale në qarkullimet e përgjithshme turistike në rajon dhe më gjerë.

Fatkeqësisht duhet të konstatojmë se deri tani nuk është punuar aspak në drejtim të valorizimit turistik të trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Promovimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore, organizimi i festivaleve tradicionale, i ekspozitave, shtypja e prospekteve turistike dhe materialit tjetër propagandues, rritja e vetëdijes së publikut për rëndësinë e tyre, përpilimi i hartave dhe itinerareve turistike dhe vendosja e tyre përgjatë rrugëve kryesore, siç janë Korridori X dhe rrugët tjera rajonale, janë disa nga hapat e nevojshëm me qëllim të promovimit dhe valorizimit konkret turistik të trashëgimisë natyrore e kulturore.

CULTURAL HERITAGE IN PRESHEVA VALLEY: PRESENT SITUATION AND PERSPECTIVE

Summary

The cultural heritage of certain cultural group, people or society is one of the most important element, which proves and argues the cultural identity, language and ethnicity, and as such is study subject for various scientific disciplines.

Historical cultural heritage of the people assigned presents corpus of spiritual and material values created during his historic journey; reflects the social, economic, political, religious and cultural development of peoplea; presents his centuries efforts for the protection and conservation of its ethnic identity , language and culture. Archaeological sites, fortifications, sacral buildings like tombs, mosques, churches, old houses, traditions and folklore present valuable wealth, but so far unexplored cultural heritage Presheva Valley.

Cultural heritage in combination with natural heritage of the environment where it is situated could become a very important tourist motive . It can complete tourist offer of the region, while in certain cases appears as a motive and the main purpose of touristic travels and visits .

Unfortunately, we have to conclude that so far there are no activities at all in terms of tourist valorization of natural and cultural heritage. Promotion of natural and cultural heritage, organization of traditional festivals, exhibitions, printing of touristic prospectuses and other promotional materials, increasing public awareness of their importance, mapping and tourist itineraries and their placement along the main roads, such as Corridor X and other regional roads - are some of the necessary

steps towards promotion of natural and cultural heritage of the region and concrete valorization of it.

Literatura

- B. Agushi, *Presheva me rrethinë në zhvillimin arkitektonik urbanistik*, Prishtinë, 2009.
- Convention Concerning Protection of Cultural and Natural Heritage*, UNESCO meeting in Paris, 17-21 November, 1972.
- Konventa për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale*, Neni 2, Paris, 17 tetor, 2003.
- E. Shukriu, *Dardania paraurbane*, Dukagjini, Pejë, 1995.
- J. Murati-Staneci, *Kështjella e Preshevës*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2014.
- P. Popović, *Archaeological finds from the vaulted building at Krševica*, *Starinar*, LVIII/2008.
- R. G. Seale, "A Perspective from Canada on Heritage and Tourism", *Annals of Tourism Research*, Vol 23 (2), 1996.
- T. Gradiček, "Kulturna baština i gospodarski razvitak Republike Hrvatske", *Ekonomski Pregled*, 60, (3-4), 2009.
- <http://www.narodnimuzej.rs/za-strucnjake/istrazivački-projekti/arheološka-istraživanja/krševica-kale>.
- <http://whc.unesco.org/en/committee/>

MBI RRYMAT E ISLAMIT BASHKËKOHOR, KONCEPTIN E LUFTËS SË SHENJTË DHE LEXIMIN E KURANIT

KDU 28

Abstrakt

Masakrat tronditëse të kryera gjatë luftës civile në Siri dhe Irak, nga grupe të ndryshme, sidomos nga ato të bashkuara nën emblemën e ISIS-it (Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë) kanë bërë që shumë njohës, klerikë dhe teologë islam dhe të tjerë, gjithandej botës, të përfshihen në përpjekjen diskursive për të shkëputur çfarëdolloj lidhjeje në mes teksteve kuranore dhe praktikave luftarake të militantëve të këtij shteti, i vetëshpallur si kalifat i ri. Kjo përpjekje i mëshon idesë se në tekstin kuranor nuk mund të gjenden kurrfarë justifikimesh për krimet e ISSI-it dhe as argumente që mbështesin pretendimin e militantëve të tij se ajo që po bëjnë në Siri dhe Irak nuk është asgjë tjetër përveçse përbushja e një obligimi uranor, që në fenë islame njihet si obligimi i xhihadit - Jihad). Kush ka të drejtë në këtë mes? Që të mund të jepet një përgjigje në këtë pyetje, gjithsesi jopërfundimtare, është e nevojshme që të zberthehen një mori çështjesh. E para, ka të bëjë me kontekstin e rrymave kryesore në islamin bashkëkohor. Kjo do të na bëjë të mundur që të shohim se cili është vendi i grupeve të tilla si ISIS dhe Al Nusra (kjo e dalë si degë e Al Qaida-s) në tipologjinë dhe topologjinë doktrinare islame. E dyta, ka të bëjë me vetë konceptin e xhihadit, dhe në fund është çështja e raportit të vetë tekstit kuranor me luftën, dhunën dhe mënyrat e mundshme të leximit të këtij teksti. Çështjet dy dhe tre na mundësojnë të shohim se deri në çfarë mase janë të bazuara pretendimet e këtyre grupeve, se lëvizjet e tyre përfaqësojnë riaktualizimin e islamit autentik.

Fjalët çelës: Lëvizje radikale religjioze, rrymat kryesore të islamit, lufta e shenjtë, millenarizmi, leximi salafist dhe hegelian i Kuranit, moderniteti.

Masakrat tronditëse të kryera gjatë luftës civile në Siri dhe Irak, nga grupe të ndryshme, sidomos nga ato të bashkuara nën emblemën e ISIS-it (Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë) kanë bërë që shumë njohës, klerikë dhe teologë islamë dhe të tjerë, gjithandej botës, të përfshihen në përpjekjen diskursive për të shkëputur çfarëdolloj lidhjeje në mes teksteve kuranore dhe praktikave luftarake të militantëve të këtij shteti, i vetëshpallur si kalifat i ri. Kjo përpjekje i mëshon idesë se në tekstin kuranor nuk mund të gjenden kurrfarë justifikimesh për krimet e ISSI-it dhe as argumente që mbështesin pretendimin e militantëve të tij se ajo që po bëjnë në Siri dhe Irak nuk është asgjë tjetër përveçse

përmbushja e një obligimi uranor, që në fenë islame njihet si obligimi i xhihadit (jihad).

Kush ka të drejtë në këtë mes? Që të mund të jepet një përgjigje në këtë pyetje, gjithsesi jopërfundimtare, është e nevojshme që të zberthehen një mori çështjesh.

E para, ka të bëjë me kontekstin e rrymave kryesore në islamin bashkëkohor. Kjo do të na bëjë të mundur që të shohim se cili është vendi i grupeve të tilla si ISIS dhe Al Nusra (kjo e dalë si degë e Al Qaida-s) në tipologjinë dhe topologjinë doktrinale islame. E dyta, ka të bëjë me vetë konceptin e xhihadit, dhe në fund është çështja e raportit të vetë tekstit kuranor me luftën, dhunën dhe mënyrat e mundshme të leximit të këtij teksti. Çështjet dy dhe tre na mundësojnë të shohim se deri në çfarë mase janë të bazuara pretendimet e këtyre grupeve, se lëvizjet e tyre përfaqësojnë riaktualizimin e islamit autentik.

Rrymat kryesore në islamin bashkëkohor

Islami, së bashku me Judaizmin dhe Krishterimin, hyn në grupin e të ashtuquajturave “religjione abrahamike”. Këto religjione quhen kështu ngase të trijat kanë të përbashkët rrëfimin mbi profetin Abraham dhe historinë e tij të raporteve me Zotin, histori që shërben si zanafillë e ideve që këto religjione kanë mbi atë që njihet si rendi moral i botës, rojtar i të cilit supozohet se është një Zot i gjithëfuqishëm dhe i gjithëmirisishëm.

Të tria këto religjione, në thelbin e tyre, janë monoteiste, kanë një koncept përgjithësisht të njëjtë për Zotin, por që bien në kundërshtim me njëra tjetrën, në momentin kur u duhet të justifikojnë ekzistencën e njëra tjetrës. Duke qenë se judaizmi është më i vjetri prej tyre, krishterimi dhe islami e arsyetojnë vetveten pikërisht nga ideja se judaizmi është një monoteizëm i deformuar dhe i korruptuar. Në këtë kontekst, në traditën e krishterë besohet se në fillim Krishti erdhi për të rimëkëmbur ligjin, të cilin Zoti përmes Mojsiut ua kishte dhënë hebrenjve dhe për t'i pastruar tempujt nga korrupsioni, degjenerimi dhe mëkati. Në Ungjillin sipas Mateut, Krishti u thotë dishepujve të tij : *“Mos t’ju shkojë ndër mend se erdha për ta shlyer Ligjin ose Profetët! Jo, s’erdha të shlyej, por ta përkryej”*. Më vonë, vetë Islami do të justifikohet ngjashëm. Misioni i Muhamedit nuk është të themelojë një religjion të ri, por të rimëkëmbë monoteizmin

autentik të deformuar nga judaizmi dhe krishterimi. Arsyetimi i vetvetes përmes mohimit të tjetrit, përgjatë historisë, ka shërbyer si burim i përhershëm i konflikteve në mes këtyre religjioneve. Këtyre konflikteve u ka shërbyer shumë, gjithashtu, pretendimi universalist i krishterimit dhe islamit. Se çfarë do të thotë ky pretendim do të shohim në momentin e trajtimit të problemit të xhihadit (luftës së shenjtë).

Në kontekstin bashkëkohor, Islami përbën njërin nga religjionet e mëdha botërore, që me një prezencë të madhe në tre kontinente, ushtron një ndikim të rëndësishëm në jetën e miliona njerëzve, nga Xhakarta në Stamboll. I përhapur në zona të ndryshme gjeografike dhe kulturore, Islami, natyrshëm ka përjetuar modifikime të shumta praktike, si pasojë e proceseve të interaksionit kulturor. Një fakt i tillë ka bërë që sot të mendohet se nuk ka një islam të vetëm, por disa të tillë. Në këtë kontekst, njëri nga studiuesit e njohur të islamit, Jacques Waardenburg konsideron se dallimi fillestar dhe minimal duhet të bëhet në mes islamit oficiel dhe islamit popullor¹. Islami oficiel përfshinë normativat dhe doktrinat, të cilat mendohet se janë të vlefshme për të gjithë myslimanët, e rrjedhimisht edhe kriteret mbi bazën e të cilave përcaktohet identiteti i të qenit mysliman. Artikulimi i këtij islami është produkt i dijetarëve, të cilët posedojnë njohuritë mbi shkrimet e shenjta, traditën dhe ligjin (sheriatin). Kësisoj, islami oficiel në fakt është islami normativ.

Për dallim prej tij, islami popullor përfaqëson një realitet tjetër. Ai përfshinë të gjitha ato mënyra dhe forma të të jetuarit të islamit në kontekste lokale, etnike dhe kulturore. *“Ai është një realitet i gjallë empirik brenda traditës së komuniteteve lokale”*².

Në mes këtyre dy llojeve të islamit, sipas Waardenburgut, shpesh mund të ketë tensione. Kjo sepse, derisa islami oficiel pretendon se normativat e tij kanë validitet universal, islami popullor, nga vetë natyra e tij, përmban elemente, të cilat islami oficiel përpiqet t'i eliminojë. Këto janë elemente të kulturave lokale joislame, që përmes procesit të interaksionit social integrohen në praktikat fetare islame.

Konceptualisht, këto dy lloje të islamit zhvillojnë raporte të ndryshme me tolerancën fetare. Pretendimi për validitet universal e shpie islamin normativ në një qëndrim jotolerant ndaj traditave të tjera

¹ Jacques Waardenburg, *Islam- Historical, Social and Political Perspectives*, Walter de Gruyter-Berlin – New York, 2002, p.13.

² Po aty, p.13.

fetare. Ndërkaq islami popullor, duke bashkëjetuar me këto tradita, natyrshëm zhvillohet në një kulturë të tolerancës fetare. Kjo e shpjegon më së miri edhe traditën e tolerancës fetare në kulturën shqiptare, ku mungesa e konflikteve fetare në mesin e një populli me disa religjione, nuk është pasojë e ndonjë virtyti liberal, por e faktit se shqiptarët, historikisht kanë praktikuar forma popullore të islamit dhe krishterimit, e ku më e njohura është e ashtuquajtura “*praktikë e kripto-krishterimit*”, e cila nënkuptonte një situatë sociale, ku një individ apo grup mbante njëkohësisht disa përkatësi fetare³. Nga perspektiva doktrinare, një praktikë e tillë, përbën herezi të hapur.

Një interpretim interesant për format e ndryshme të islamit e jep filozofi dhe teologu i njohur, Tariq Ramadan. Interpretimi i tij përpiket t’i integrojë format e islamit normativ dhe ato të islamit popullor, brenda konceptit të atij që Ramadan e quan “civilizimi islamik”. Realiteti i këtij civilizimi shprehet në tre nivele. Në nivelin e parë, atë bazik, islami është unik. Kjo në kuptimin se të gjithë myslimanët, qofshin të Lindjes apo Perëndimit, qofshin sunit apo shiit, sufi apo salafi, pajtohen mbi dy burimet fundamentale të islamit – Kuranin dhe traditën orale të profetit Muhamed (suneti). “*Prej këtyre burimeve janë kategorizuar dhe derivuar një numër principesh dhe praktikash, të cilat konstituojnë thelbin e mësimave islame, e mbi të cilat të gjitha traditat dhe shkollat e jurisprudencës pajtohen : gjashtë shtyllat e besimit (arkan al-iman) që konstituojnë besimin (al-aqida) dhe pesë shtyllat e islamit (arkan al-islam) që rregullojnë në detale ritualet (ibadat: adhurimin, ushqimin, etj)*”⁴.

Por, ky konsensus gjithëpërfshirës mbi principet themelore prishet në nivelin e dytë të shprehjes së civilizimit islamik. Në këtë

³ Kjo praktikë u shfaq tek shqiptarët gjatë kohës së konvertimit masiv të tyre nga krishterimi në islamizëm, në periudhën kohore nga shekulli i XVI deri në fund të shekullit XVIII. Domosdoshmëria praktike për të përvetësuar fenë e re dhe vështirësia tradicionale për të braktisur të vjetrën i shtynë shqiptarët që për shumë kohë të mbanin njëkohësisht dy fe, islamin në jetën publike, dhe krishterimin në jetën private e shtëpiake. Me kohë ky fenomen u mësoj atyre një leksion me vlera të paçmueshme, e pikërisht leksionin se mund të besosh Zotin në mënyra të ndryshme, të kesh shumë fe dhe bota, prapëseprapë, të mos përmbysset, e se në fund të fundit është njëjtë si të jesh i krishterë si të jesh mysliman. Ky leksion u shndërrua në kulturën e tolerancës fetare, e cila i ka mbajtur shqiptarët gjithmonë larg prej njërës nga fatkeqësitë më të mëdha, që mund të godasin popujt: luftërat fetare. Për fenomenin e kripto-krishterimit tek shqiptarët shih: Stavro Skendi, *Crypto – Christianity in the Balkan Area under the Ottomans*, botuar në *Slavic Review*, Vol.26, No.2 (Jun, 1967), pp. 227 -246.

⁴ Tariq Ramadan, *Islam and the Arab Awakening*, Oxford University Press, 2012, p.68

nivel zhvillohen një shumësi divergjencash, për shkak të interpretimeve të ndryshme të tekstit kuranor dhe principeve sekondare, që dalin nga principet e para. Këto divergjenca, pastaj marrin, ose formën e dallimeve në mes sunitëve dhe shiitëve, ose formën e dallimeve në mes shkollave të shumta legaliste dhe në këtë mënyrë konstituojnë atë që tanimë e njohim si histori e islamit.

Derisa në nivelin e dytë, brenda civilizimit islamik, kemi diversitetin hermeneutik, në nivelin e tretë të tij, kemi diversitetin e islamit në raport me kultura të tjera, diversitet që përbën thelbin e atij që Waardenburg e quan islam popullor. Ramadan shkruan: “*Myslimanët kanë jetuar në kohë dhe vende të ndryshme dhe janë ballafaquar me kultura të reja. Elemente të shumta të këtyre kulturave janë integruar në referencat islamike, duke u thirrur në rregullin legal, që udhëheq çështjet sociale dhe kulturore: “rregulli primar (në këto fusha) është lejimi”*”⁵. Të gjitha sfidat bashkëkohore të Islamit dalin nga divergjencat e nivelit të dytë, të cilat pastaj implikohen edhe në çështjet e nivelit të tretë. Në këtë kontekst, Tariq Ramadan, duke profilizuar islamin bashkëkohor identifikon gjashtë tendenca apo rryma dominuese brenda tij⁶.

E para prej këtyre rrymave, sipas Ramadan, është *tradicionalizmi skolastik*. Kjo rrymë u referohet shkollave të mëdha të jurisprudencës islame, të zhvilluara gjatë mesjetës, e të cilat bazohen mbi idenë e ndërmjetësimit hermeneutik në mes tekstit kuranor dhe besimtarëve myslimanë. Ramadan konsideron se prej tyre gjashtë janë më të rëndësishmet: *Hanafi, Maliki, Shafi, Hanbali, Zaydi, Jafari*⁷. Duke interpretuar në mënyra të ndryshme metodologjike të drejtën islame, këto shkolla, kanë krijuar kushtet e shfaqjes së një pluralizmi në ushtrimin teknik të praktikave fetare islame brenda komunitetit të besimtarëve, ku secila prej tyre pretendon se ka monopolin mbi ortopraksinë islame (praktikën dhe adhurimin e drejtë) dhe zgjidhjen të problemeve legale. Të fokusuar në këtë dimension, këto shkolla, sipas Ramadan, nuk kanë ndonjë qëndrim të elaboruar dhe as

⁵ Po aty, pp. 68-69.

⁶ Tariq Ramadan, *Western Muslims and the Future of Islam*, Oxford University Press, 2004, pp.24- 30.

⁷ Katër shkolla e para i përkasin islamit suni, ndërsa dy të fundit islamit shiit. Një analizë të thelluar të natyrës së këtyre shkollave e gjejmë në veprat e njërit prej studiuesve më të njohur të jurisprudencës islame, Wael B. Hallaq. Shih : Wael B. Hallaq, *An Introduction to Islamic Law*, Cambridge University Press, 2009, dhe Wael B. Hallaq, *A History of Islamic Legal Theories*, Cambridge University Press, 1997.

prirje për involvim të drejtpërdrejtë politik dhe social në debatet mbi modernitetin.

Rrymë tjetër e rëndësishme në islamin bashkëkohor është *salafizmi literal*. Në arabisht fjala “*salaf*” u referohet paraardhësve, e që në kontekstin islamik, bëhet fjalë për gjeneratat e para të islamit, gjeneratat që e kanë jetuar kohën e Profetit Muhamed. Salafistët bashkëkohorë konsiderojnë se islami autentik, origjinar, mënyra ideale e adhurimit fetar dhe praktikës fetare është pikërisht ajo e këtyre gjeneratave. Të jesh mysliman i vërtetë do të thotë të sillesh dhe besosh sikurse myslimanët e parë (salafët). Në bazë të kësaj, salafistët literalë, sipas Ramadan, hedhin poshtë ndërmjetësimin hermeneutik të shkollave të jurisprudencës si të panevojshëm, herë-herë edhe të dëmshëm. Ata insistojnë mbi akceptimin literal dhe të drejtpërdrejtë të tekstit kuranor dhe traditës së sunetit, dhe bashkë me këtë edhe gjeneralizimin e vlerës së normave, që përmbahen në Kuran dhe sunet. Përmes këtij gjeneralisimi, salafistët literalë, i absolutizojnë këto norma. Ky absolutizim përbën bazën filozofike të intolerancës dhe fanatizmit fetar.

I afërt me këtë rrymë është ajo që Ramadan e quan *salafizmi reformist*, i cili me salafizmin literal ka të përbashkët idealizimin e jetës së myslimanëve të parë (salafëve) dhe leximin e akceptimin e pandërmjetësuar të përmbajtjeve kuranore, por ndahet prej tyre në faktin se afërmon, përkundër imitimit absolut të literalistëve, dimensionin e atij që në teologjinë islame quhet *ijtihad*, e që nënkupton arsyetimin e pavarur dhe përpjekjen kreative gjatë ushtrimit të një praktike fetare, që kryesisht lidhet me zbatimin e së drejtës. *Ijtihad* vjen në shprehje në situatat legale, kur teksti kuranor apo hadithi profetik nuk jep zgjidhje të qartë për një rast të caktuar ligjor. Kjo mungesë kompensohet përmes rezonimit analogjik të legalistëve.⁸

Rryma e katërt e rëndësishme në islamin bashkëkohor, sipas Ramadan, është *salafizmi literal politik*. Kjo rrymë, në thelbin e saj është radikale dhe revolucionare, ngase synimi i saj kryesor është shkatërrimi i rendit politik dhe social modern dhe krijimi i një rendi të ri social, të bazuar në praktikën sociale dhe fetare të myslimanëve të parë të kohës së profetit. Ky rend i ri duhet të jetë rend i kalifatit, ku ligji themelor dhe absolut do të jetë sheriatit, përmes të cilit vendoset

⁸ Wael B. Hallaq, *A History of Islamic Legal Theories*, Cambridge University Press, 1997, p. 23.

mbretëria e Zotit në tokë. Salafizmi literal politik, shpeshherë i njohur edhe si islam politik, në thelbin e tij është anti-modern, ngase procesin e modernitetit e sheh si proces degjenerimi dhe largimi nga idealizmi i jetës së salafëve; është anti-perëndimor, ngase perëndimi shikohet se shkaktari kryesor i këtij degjenerimi; është anti-demokratik, ngase për të sovran është Zoti dhe jo populli; është reaksionar, ngase synon të kthejë historinë e njerëzimit pas, në një moment të largët të rrjedhës kohore të saj; është intolerant, ngase duke insistuar mbi vlefshmërinë absolute të islamit fillestar, të gjitha format tjera të besimit dhe adhurimit i konsideron të gabueshme dhe të palejueshme; gjithashtu është maniheist, në kuptimin se ndan botën në të mirë, në të keq dhe universalist, ngase pretendon se duke poseduar të vërtetën absolute dhe përfundimtare mbi botën dhe jetën njerëzore, janë të obliguar edhe ta përhapin atë në të gjithë njerëzimin, qoftë edhe përmes përdorimit të forcës. Është e qartë se lëvizje të tilla, si ISIS, janë përfaqësuesit më besnik të salafizmit literal politik. Kur bota habitet me gjakftohtësinë e tyre në masakrat që i bëjnë, nuk e ka parasysh faktin se kjo gjakftohtësi është në thelbin e saj - gjakftohtësia e dhunës në botën e vjetër, ku dhuna është praktikë e përditshme dhe normale⁹. T'i pritët koka një njeriu në kohën e Kalifit Omar ka qenë një gjë krejtësisht e rëndomtë. Madje, kjo rëndomësi ekziston deri në ditët e ekzekutimeve publike me prerje koke nga Jakobinët në Francën revolucionare të vitit 1793. Sikurse shkruan Foucault në veprat e tij *“Disiplinë dhe Ndëshkim: Lindja e Burgut”* dhe *“Historia e Seksualitetit - Vullneti për dije”*, humanizimi i ndëshkimit është fenomen i vonë, që zë fill tek në shekullin e XIX, kur pushteti sovran i bazuar mbi të drejtën e sovranit mbi jetën dhe vdekjen, e shtetarëve të tij fillon e humbë terren përballë formave të reja të pushtetit, si pushteti disiplinor dhe biopushteti, të cilët efektivitetin e sundimit nuk e lidhin më me demonstrimin e represionit, por me mbikëqyrjen dhe administrimin e

⁹ Ernest Gellner shkruan se në shoqëritë paramoderne, që në thelbin e tyre janë shoqëri bujqësore, *“janë të dënuara të jetojnë me dhunën”* dhe se *“shpata është më e fuqishme se plugu”* që do të thotë se luftëtarët kanë pushtet të plotë mbi prodhuesit(shih : Ernest Gellner, *Plug, Shpata dhe Libri-Struktura e historisë njerëzore*, Përpjekja, Tiranë,2002, fq.143-144. Ideja e Gellnerit është e ngjashme me teorinë e Herbert Spenser-it, i cili tranzicionin e madh nga bota mesjetare në botën e moderne e interpreton si kalim nga shoqëria militariste, ku dhuna dhe forca janë faktorët determinues të proceseve dhe fenomeneve sociale, në shoqërinë industriale, ku prodhimi paqësor i jetës ekonomike determinon tërësinë e jetës sociale.

(shih: <http://www.bolenderinitiatives.com/sociology/herbert-spencer-1820-1903/herbert-spencer-social-types-militant-and-industrial-societies>).

jetës (“pasurisë biologjike të kombit”). Në kontekstin e biopushtetit “*funksioni më i lartë i pushtetit nuk është të vrasë, por të investojë në jetën*”,¹⁰ prandaj indinjata që sot ngjallin ekzekutimet publike të ISIS-it është në fakt indinjata e ndërjegjes biopolitike të shoqërive moderne. Kalifati i ISIS-it, shkruan Zizek, e hedh poshtë krejtësisht konceptin foucault-ian të biopushtetit¹¹.

Një rrymë tjetër në islamin bashkëkohor, sipas Ramadan, është *reformizmi liberal ose racionalist*. Kjo rrymë insiston në idenë se Islami duhet të adoptojë modelin perëndimor të modernizimit, model i cili i referohet procesit të madh të sekularizimit, përmes të cilit sferat e ndryshme të jetës sociale emancipohen nga kontrolli i autoriteteve fetare. Kjo rrymë aspirojnë që përgjatë botës islame të përhapen idetë dhe vlerat e iluminizmit dhe si shembull i rëndësishëm në këtë kontekst merret modeli kemalist, i aplikuar në Turqinë moderne nën udhëheqjen e Kemal Atatürkut, duke filluar nga vitet njëzet të shekullit të kaluar. Kjo rrymë, inspiruesit kryesorë i ka në botën perëndimore dhe ndikimi i saj duket të jetë ende tepër i dobët në vetë botën arabe. Kemalizmi turk jo që nuk ia ka dalë të përhapet përtej kufijve të Turqisë, por sot duket të jetë i sfiduar brenda vetë saj. Një shembull tjetër është dështimi i të ashtuquajturës “pranverë arabe”, e cila në fillim u inspirua nga modeli perëndimor i revolucioneve demokratike, por më pas degjeneroi në rikthimin e diktaturës ushtarake në Egjipt, si preventivë ndaj krijimit të Egjipti teokratik dhe në luftën civile në Siri, e cila mori përmasat e konfliktit ndërsektar, sipas vijave të vjetra të konfliktit në mes sunitëve dhe shiitëve. Ajo që Slavoj Zizek në vitin 2011 e quante “*mrekullia e Sheshit Tahrir*”¹² përfundoi në tmerrin e masakrave të militantëve salafistë në fushat e Mosulit në verën e vitit 2014.

Tanimë është fakt i njohur se modernizimi në botën arabe ka një emër të keq, për shkak se pas dekolonizimit, modernizimi u bë sinonim me lindjen e një morie shtetesh autoritare, kuazisekulare dhe të korruptuara, të cilat të përkrahura nga Perëndimi, u zunë në konfliktin e madh ideologjik me botën komuniste, e thelluan edhe më tej autoritarizmin e tyre, duke krijuar kështu klimën anti-moderne dhe anti-perëndimore, klimë që më pas u bë toka pjellore për lulëzimin e radikalizmit islamik. Shembulli klasik i kësaj është Revolucion

¹⁰ Michel Foucault, *Historia e Seksualitetit 1- Vullneti për dije*, Dukagjini, Pejë 2008, fq.191.

¹¹ <http://simongros.com/text/articles/slavoj-zizek/isis-is-a-disgrace-to-true-fundamentalism/>

¹² <http://www.theguardian.com/global/2011/feb/10/egypt-miracle-tahrir-square>.

islamik në Iran, në vitin 1979. Reaksioni i ashpër ndaj këtij revolucioni bëri që militantizmit islamik t'i shtohet një dimension i panjohur me herët: xhihadit suicidal¹³.

Rryma e gjashtë në islamin bashkëkohor, të cilën e thekson Ramadan është *sufizmi*, i cili në historinë e islamit ka një traditë shumë të gjatë dhe tejet të pasur në diversitetin e qasjeve. Për dallim nga aktivizimi radikal politik i salafizmit, sufizmi është i përqendruar në ushtrimin e një islami mistik, që do të thotë në vetëpërsosjen individuale morale përmes meditimit dhe kontemplacionit. Për sufistët teksti kuranor nuk është nxitje për veprim politik, për xhihad të shpatës, por nxitje për meditim mistik, meditim i cili përbën rrugën e vetme për të arritur deri tek njohja e hyjnore. Sufizmi është një lloj islami individualist, i cili më shumë aspiro për përsosmërinë morale të individit, se sa atë të kolektivitetit¹⁴.

Koncepti i luftës së shenjtë në traditën abrahamike dhe Jihadi

Nëse sot ka diçka që e bën të frikshëm Islamin në sytë e botës tjetër, padyshim që kjo është ideja e jihad-it. Është pikërisht kjo ide përmes të cilës vetafirmohen sot lëvizjet e ndryshme radikale në botën islame. Pyetja themelore në këtë mes është se sa është ky vetafirmim në përputhje me konceptin e luftës së shenjtë, të cilin e përmbajnë tekstet e shenjta islame?

Ndonëse në shikim të parë duket i qartë, ky koncept, në realitet, është në masë të madhe i komplikuar, mes tjerash edhe për shkak të konotacioneve të tij metafizike. Përfytyrimi i një religjioni të vetëm absolutist dhe universal përbën bazamentin mbi të cilin ndërtohet dhe

¹³ . Studiuesi i njohur francez i Islamit Gilles Kepel, konsideron se xhidadi suicidal (martirizimi) si instrument për luftimin e kundërshtarit ka origjinë shiite dhe zanafilla e tij lidhet me ditët e Revolucionit Islamik në Iran. Të përfshirë në një luftë të pabarabartë me Irakun e mbështetur nga SHBA-ja, me qëllim që të mbrojnë revolucionin e tyre ajatollahët në krye me Khomeinin riaktualizuan mitin e vjetër shiit të martirizimit të imamëve në krye me Imam Hysenin, në vitin 680, për të ruajtur besimin, duke i shtyre të rinjtë iranianë, që të bëjnë të njëjtën gjë për të ruajtur revolucionin islamik, pra, që të martirizohen përmes bombardimit vetëvrasës, në radhët e armikut. Këtë praktikë, më pas e përvetësoi Hezbollahu në Liban dhe prej andej, ajo kaloi tek sunitët. (Shih : Gilles Kepel, *Beyond Terror and Martyrdom – The Future of the Middle East*, The Belknap Press of Harvard University Press, 2008, pp.78-89)

¹⁴ Për të pasur një pasyrë përmbledhëse të sufizmit shih : Eric Geoffroy, *Introduction to Sufism- The Inner Path of Islam*, World Wisdom, 2010.

ideja e luftës së shenjtë. Në këtë kontekst, Bernard Lewis shkruan: *“Ideja se ekziston një e vërtetë unike për të gjithë njerëzimin dhe se detyra e atyre që e zotërojnë është ta transmetojnë atë tek të tjerët, fillon me ardhjen e Krishterimit dhe shfaqet sërish me lindjen e Islamit. Të dy besimet lindën në Lindjen e Mesme dhe grumbulluan një trashëgimi të përbashkët shumë të gjerë, ku përfshihen idetë e hebrenjve mbi monoteizmin, profecinë, zbulesën hyjnore dhe shkrimet e shenjta; filozofia dhe shkenca e Greqisë; e drejta dhe institucionet qeverisëse të romakëve dhe, duke u kthyer akoma më mbrapa në kohë, tradita që mbijetuan nga qytetërime edhe më të lashta të këtij rajoni. Krishterimi dhe Islami kishin të përbashkët një ide të re dhe pothuajse të padëgjuar, se ishin zotëruesit e vetëm të së vërtetës hyjnore në tërësinë e saj”*¹⁵. Monizmi absolut epistemologjik i Krishterimit dhe Islamit rrjedh në mënyrë të drejtpërdrejt nga monoteizmi i tyre. Pra, meqë ekziston një Zot i vetëm, Absolut dhe Përfundimtar, duhet të ekzistojë edhe një e vërtetë e vetme, absolute dhe përfundimtare dhe meqë ky Zot është i gjithëfuqishëm dhe i gjithëpranishëm, atëherë edhe e vërteta e tij duhet të jetë e gjithëfuqishme dhe e kudo e pranishme. Lufta e shenjtë është lufta që ka për qëllim vendosjen me force të kongruencës në mes Pranisë Ontologjike të Zotit dhe Pranisë Epistemologjike të tij në botë.

Studiuesi amerikan, James Turner Johnson, i ka kushtuar një hulumtim të thelluar konceptit të luftës së shenjtë, me fokus krishterimin dhe islammin. Ky hulumtim është përmbledhur në librin e tij *“Ideja e luftës së shenjtë në traditën perëndimore dhe islame”*. Përkundër kompleksitetit me të cilin është e mbështjellë kjo ide, Johnson konsideron se nga analiza që iu bëjmë shembujve historikë në të cilët është operacionalizuar ajo, mund të identifikojmë disa domethënie të cilat asociojnë me thelbin e saj¹⁶. Ai identifikon dhjetë të tilla, por këtu nuk është vendi t’i elaborojmë të gjitha.

Në kuptimin e parë, primordial, lufta e shenjtë nënkupton një luftë që bëhet me urdhrin e Zotit. Shembuj të këtij kuptimi, sipas Johnson, mund t’i gjejmë në traditën e të tri religjioneve abrahamike, që nga rrëfimet biblike të Izraelit të lashtë, ato të xhihadit islamik, që synon nënshkrimin e të gjithë njerëzimit nën komandën e Zotit, e deri

¹⁵ Bernard Lewis, *Islami dhe Perëndimi*, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë, 2005, p.16.

¹⁶ James Turner Johnson, *The holy war idea in western and islamic traditions*, The Pennsylvania State University Press, 1997, pp. 36-38.

tek luftërat fetare të puritanëve anglezë, gjatë kohës së reformacionit fetar evropian.

Ky kuptim, për luftën e shenjtë del nga koncepti i një Zoti që involvohet seriozisht në ngjarjet e historisë dhe do t'u japë kahe atyre, sipas vullnetit të tij. Një koncept i tillë është esencial në traditën e religjioneve abrahamike. Ngjarjet më të rëndësishme sakrale në këtë traditë shprehin një koncept të tillë, që nga eksodi biblik i hebrejve nga Egjipti, përmes Lindjes, Vdekjes dhe Ringjalljes së Krishtit, e deri tek betejat e përgjakshme të Muhamedit, në fushat e Arabisë kundër politeistëve.

Ideja e një Zoti që ndërhyr në kursin e historisë, që dëshiron të diktojë vullnetin e tij në rrjedhën e këtij kursi, ka qenë njëra nga idetë më përcaktuese të mendimit politik e filozofik perëndimor në epokën moderne, e cila sipas interpretimit të Karl Lowith, gjatë procesit të sekularizimit, nuk bëri gjë tjetër veçse domethënien e *Heilsgeschichte* (historia e shenjtë krishtere) e përktheu në gjuhën e *Weltgeschichte* (historia botërore)¹⁷. Shembujt më të shquar të këtij transformimi janë padyshim Hegeli dhe Marksi. Derisa Hegeli, luftëtarët e betejave të “Heilsgeschichte” i shndërroi në “*Agentët e Mendjes Botërore*”¹⁸, Marksi të njëjtit i ktheu në luftëtarët e proletariatit, misioni i të cilëve është vendosja e rendit final moral në botë. Në këtë kontekst, sot e shohin veten edhe xhihadistët islamik, për të cilët Kalifati Universal është ekuivalenti i këtij rendi final. Mbi bazën e kësaj ekuivalence, filozofi gjerman, Peter Sloterdijk, në librin e tij “*Mllëfi dhe Koha*” sheh një analogji të trefishtë në mes komunizmit historik dhe islamit politik¹⁹.

Së pari, njësoj si komunizmi historik dje, islami politik sot manifeston një misionarizëm shumë dinamik dhe inspirues, me pretendime universale, me adresim përtej të gjitha dallimeve njerëzore, i joshë të marginalizuarit, të pavendosurit dhe të zemëruarit, e paraqet veten si avokat spiritual dhe material i të varfërve, duke fituar kështu simpatitë dhe zemrat në një botë pa zemër.

Së dyti, mendon Sloterdijk, joshja e islamit politik nisët nga fakti se ai është në gjendje t'u ofrojë ndjekësve të tij një botëkuptim

¹⁷ Karl Lowith, *Meaning in History*, University of Chicago Press, 1957.

¹⁸ Frazë e Herbert Marcuse e përdorur në veprën e tij “*Mendja dhe Revolucioni*” në pjesën për filozofinë e historisë të Hegelit.

¹⁹ Peter Sloterdijk, *Rage and Time*, Columbia University Press, 2010, pp. 220-221.

teatral grandioz, të qartë dhe agresiv, të bazuar mbi një dallim të qartë në mes miqve dhe armiqve, një mision të pagabueshëm për fitore dhe një vizion final utopik të përsosjes: ringritjen e një emirati global, i cili duhet të shërbejë si bazë për mileniumin islamik (sundimin e përrjetshëm të Islamit mbi tokë). Sipas Sloterdijk, një vizion të tillë millinearist dhe një botëkuptim të tillë teatral dhe agresiv, më herët, vetëm komunizmi ka qenë në gjendje t'ia ofrojë ndjekësve të tij dhe njerëzimit. Por, derisa dobësia e komunizmit dhe shterimi i energjisë së tij doli nga e “*ardhmja utopike që nuk po vinte kurrë*”, tek islami politik, dobësinë kryesore, Sloterdijk, e lidhë me orientimin e tij të shikimit prapa në histori dhe pafuqinë e liderëve të tij për të formuluar një vizion kreativ për të ardhmen. Ëndrra e tyre për të restauruar një perandori të madhe islame neo-mesjetare është përtej të gjitha kushteve reale për të ndodhur²⁰.

Dimensioni i tretë i analogjisë që vëren Sloterdijk në mes komunizmit historik dhe islamit politik është se rritja dramatike e këtij të fundit rezulton nga dinamika demografike në fushën e tij të rekrutimit, fushë që përfshinë vendet me bum demografik të popullsisë, gjë që dikton dominimin e moshave të reja brenda tyre. “*Njësoj si lëvizjet totalitare të shekullit XX, ajo është esencialisht një lëvizje e rinisë, ose më specifikisht, një lëvizje e njerëzve të rinj*”²¹. Këta janë rëndom të rinjtë që, në zona të ndryshme të botës, kanë pësuar forma nga më të ndryshmet të marginalizimit, si pasojë e proceseve dramatike të globalizimit.

Për më tepër, mund të thuhet se analogjia në mes komunizmit historik dhe islamit politik nuk shteron në këto tri elemente, të cilat i analizon Sloterdijk. Sikurse është e njohur, një nga burimet e rëndësishme të bolshevizmit dhe Revolucionit Rus të vitit 1917 është edhe tradita e mendimit politik rus të shekullit të XIX, me rrymat e tij të anarkizmit, populizmit, nihilizmit revolucionar dhe terrorizmit. Leninizmi, në thelbin e tij, është një bashkëdyzim i marksizmit

²⁰ Sloterdijk, po aty, p. 225

²¹ Sloterdijk, po aty, fq.221. Teza e Sloterdijk na përkujton njëri nga analizat më të thella që i janë bërë fashizmit nga njëri prej studiuesve më eminent të tij, George L.Mosse. Mosse në tekste të tij të shumta për fashizmin insiston në idenë se fashizmi ka nisur si një lëvizje e të rinjve, një lëvizje e cila mobilizonte të rinjtë e rebeluar ndaj shoqërisë, prindërve dhe shkollës dhe të cilët të etur për një sens të ri të komunitetit u shtyn drejt aktivizimit militarist dhe idealeve të lidhura me të (shih: George L.Mosse, *Toward a General Theory of Fascism*, botuar në : *Comparative Fascist Studies – new perspectives*, Routledge, London 2010, pp.70-71.

perëndimor, me elemente të këtyre rrymave. Në mesin e figurave që shënjojnë debatet dhe polemikat në mes këtyre rrymave, e gjejmë edhe atë të Sergey Gennadiyevich Nechayev, i cili sot mbahet mend për dy gjëra: për vizionin e tij të komunizmit, të kritikuar nga Marks si vizion i komunizmit të barakave²² dhe për një tekst të shkruar prej tij në formën e zhanrit fetar të katekizmave, e të titulluar “*Katekizmi i revolucionarit*”²³. Në këtë tekst, Nechayev paraqet tiparet dhe parimet, të cilat duhet të udhëheqin mendimin dhe veprimin e një revolucionari. Revolucionari, thotë Nechayev, nuk ka interesa personale, as çështje biznesi, nuk ka as emocione, as pronë e as emër. Tek ai gjithçka është e reduktuar në një mendim dhe pasion të vetëm - revolucionin. Kusht bazik për revolucionarin është që ai të shkëpusë të gjitha lidhjet me rendin ekzistues social dhe me botën e qytetëruar, me ligjet e saj, zakonet, normat morale dhe konventat e pranuar prej saj. Ai duhet të shfaqet si armik i paepur i të gjitha këtyre. Revolucionari e përbuzë moralin e opinionit publik, për të e moralshme është gjithçka që i ndihmon revolucionit dhe e pamoralshme është çdo gjë që e pengon atë. Revolucionari duhet të jetë i pamëshirshëm dhe duhet të mësojë të torturojë. Dhuna për të nuk është pengesë, por përparësi. Duke qenë tiranik ndaj vetvetes, ai duhet të jetë tiranik edhe më të tjerët. Duhet t’i eliminojë të gjitha ndjenjat e dhembshurisë e keqardhjes dhe ditën e natën duhet t’i përkushtohet vetëm shkatërrimit të pamëshirshëm të rendit ekzistues. Ai nuk është revolucionar nëse ka edhe simpatinë më të vogël për këtë rend. Ai njeh vetëm një lloj miqësie dhe vëllazërie: vëllazërinë e shokëve revolucionarë. Ai nuk njeh limite morale në luftën e tij për qëllimin e madh. Për arritjen e tij, të gjitha mjetet dhe rrugët janë të justifikueshme. Etika e tij është ajo që Veber e quan “etika e qëllimeve përfundimtare”. Në këtë pikë, komunizmi real dhe islami politik takohen gjithashtu. Ky i fundit, mendon Sloterdijk, ushqehet pikërisht nga vakumi i lënë pas nga rënia e komunizmit real, e të cilin Sloterdijk e quan “*konstelacioni postkomunist*”²⁴. Islami politik është parazit i këtij konstelacioni²⁴.

Nga e gjithë kjo është e qartë se te Nechayev, figura e revolucionarit dhe ajo e terroristit shkrihen në një dhe psikologjia e revolucionarit të tij është identike me atë të xhihadistëve të sotëm të

²² Marx, Engels, Trotsky, Wright, *Lenin, Marxism versus Anarchism*, Resistance Books, 2001, p. 88.

²³ <http://www.marxists.org/subject/anarchism/nechayev/catechism.htm>.

²⁴ Peter Sloterdijk, *Rage and Time*, Columbia University Press, 2010, p.218.

ISIS-it e Al Qaides²⁵. Në këtë kuptim pamëshira dhe brutaliteti ekstrem që sot ata demonstrojnë në dhunën e tyre nuk e ka origjinën vetëm në pasionin e tyre për t'i imituar salafët e mesjetës së hershme, por edhe në pasionin e revolucionarëve modern, bilanci final i të cilëve arrin në miliona viktima²⁶. Katekizmi i Nechayev-it është edhe katekizëm i ISIS-it.

Tani të kthehemi tek analiza e Johnsonit, e domethënies, të cilat asociojnë me idenë e luftës së shenjtë. Sipas tij, ne mund të flasim për një situatë të luftës së shenjtë kur ajo autorizohet nga një autoritet që ka të drejtën të përfaqësojë Zotin ose të flasë në emër të tij.²⁷ Shembujt klasikë, në këtë rast janë autorizimet papale për kryqëzata gjatë mesjetës, të cilat humbën krejtësisht fuqinë e tyre me fillimet e modernitetit, gjatë procesit të madh të sekularizimit, por shembujt të tillë nuk mungojnë edhe në traditën islame, si në atë shiite edhe në atë sunite. Bile, në Islam, autorizimi për luftën e shenjtë është edhe më i drejtpërdrejtë, marrë parasysh faktin se tradita e themeluar nga Muhamedi nuk bën dallime të qarta dhe nuk vendosë kufij ndarës në mes autoritetit fetar dhe atij politik. Vetë karriera profetike e Muhamedit është shembull në këtë aspekt: ai njëkohësisht ka qenë lider shpirtëror, komandant ushtarak dhe drejtues politik. Një situatë të tillë, Veber e quan cezaro-papizëm, që do të thotë unitet i pushtetit politik dhe atij shpirtëror. Cezaro-papizmi është në thelbin e konceptimit islamik për luftën e shenjtë (Jihad-i). Vetë termi “Jihad”, në përkthim literal, ka domethënien e përpjekjes, orvatjes dhe luftës, domethënie e cila në kontekstin fetar fiton cilësinë e përpjekjes dhe luftës në rrugën e Zotit.

²⁵ Njëri nga njohësit më të mirë të mendimit politik rus Nikolai Berdyaev, në veprën e tij “Ideja Ruse” duke analizuar katekizmin e Nechaev-it gjen aty frymën e fanatizmit dhe terrorizmit. Nechaev, shkruan Berdyaev, është një fanatik dhe zelot (shih: Nikolai Berdyaev, *The Russian Idea*, The Macmillan Company, New York, 1948, p.117). Zelotë janë quajtur pjestarët e një kryengritje hebreje kundër sundimit romak në shekullin e parë të, pak dekada pas vdekjes së Krishtit. Berdyaev e përdor këtë emër për të përcaktuar dimensionin terrorist në tekstin e Nechaev-it ngase zelotët njihen në histori si lëvizja e parë e cila ka përdorur metoda të dhunës që sot i njohim si metoda terroriste, si dhunën ndaj civilëve dhe ekzekutimin brutal të atyre që refuzojnë të përkrahin lëvizjen. (Shih : *The History of Terrorism- From Antiquity to Al Qaida*, Gerard Chaliand and Arnaud Blin (ed), University of California Press, 2007, pp.55-78).

²⁶ shih për këtë : *The Black Book of Communism – Crimes, Terror, Represion*, Harvard University Press, 1999.

²⁷ James Turner Johnson, *The holy war idea in western and islamic traditions*, The Pennsylvania State University Press, 1997, p. 37

Nga studiues të shumtë është bërë përpjekje që koncepti islamik i Jihad-it të kuptohet në një perspektivë më të gjerë se sa kuptimi militarist i tij dhe në këtë drejtim është bërë një klasifikim i Jihad-it në rrugën e Zotit në katër lloje: në Jihad të zemrës (besimit), thelbi i të cilit konsiston në përpjekjen e njeriut për të forcuar besimin e tij, në Jihad të gjuhës (të folurit e drejtë), e i cili nënkupton përpjekjen për vendosjen e dominimit diskursiv brenda vetes dhe rrethit social të fjalës hyjnore, në Jihad të duarve (bërja e veprave të mira), kriter i të cilit është bamirësia sipas urdhëresave hyjnore dhe në Jihad të shpatës (lufta e shenjtë), që nënkupton përdorimin e dhunës në funksion të mbrojtjes apo përhapjes së islamit²⁸.

Sa i përket rëndësisë që kanë këto forma të Jihad-it, shpeshherë, studiuesit thirren në një thënie të profetit Muhamed, cili në një rast ka pohuar dallimin në mes Jihad-it të shpatës si “Jihad i vogël” dhe Jihadit shpirtëror, si “Jihad i madh”²⁹. Ky i fundit, merret në kuptimin e përpjekjes për të pastruar krejtësisht veten që të mund të bëhemi të denjë për mëshirën e Zotit. Kjo përpjekje, brenda kontekstit të religjioneve abrahamike, të cilat bazohen mbi konceptin etik të Zotit, ka kuptimin e vetpërsosjes morale, vet dominimit diskursiv përsosje, e cila brenda islamit më se shumti shprehet në rrymat sufiste.

Të tilla diferencime kanë arritur në konstatimin se termi islamik i Jihad-it më shumë duhet të merret në kuptimin moral-spiritual se sa në atë militarist. Por, Bernard Lew is, njëri nga studiuesit më të mëdhenj të islamit, mbron pikëpamjen e kundërt. Sipas tij, interpretimi moral dhe spiritual i konceptit “Jihad” është zhvilluar kryesisht nga teologët shiitë të epokës klasike dhe pastaj më së shumti nga modernizuesit dhe reformatorët e shekullit XIX e XX, të cilët janë munduar t’i bartin tendencat iluministe brenda botës islame, por shumica dërmuese e teologëve klasikë, juristëve dhe tradicionistëve e marrin konceptin “Jihad” pikërisht në kuptimin militarist të tij.

“Të gjitha koleksionet madhështore të hadith-it përmbajnë një seksion kushtuar Jihad-it, e në të cilin kuptimi militarist dominon. E njejtja gjë është e vërtetë edhe për udhëzuesit e ligjit të sheriatit”.³⁰

Si mund të shpjegohet një gjë e tillë?

²⁸ James Turner Johnson, po aty, p. 62.

²⁹ Johnson, po aty, p. 62

³⁰ Bernard Lewis, *The Political Language of Islam*, The University of Chicago Press, 1988, p.72.

Duket se një arsye e rëndësishme, që ndihmon në këtë drejtim, lidhet me faktin historik se shpallja kuranore, në pjesën dërmuese të saj, ka ndodhur gjatë kohës që Muhamedi dhe mbështetësit e tij, kanë qenë të përfshirë në një konflikt të hapur, të armatosur me kundërshtarët e tyre. Kjo ka ndikuar që lufta të jetë aq shumë e pranishme në suret kuranore dhe përmes emergjencave të saj ditore të ndikojë edhe në semantikën e shumë prej këtyre sureve. Në suren Et Teube, e cila i përket periudhës medinase të profecisë, ekzistojnë dy vargje, 38 e 39, ku shprehen shumë qartë këto emergjenca. Në to thuhet : *O besimtarë! çfarë keni që ngurroni e mbërtheheni fort për toke kur ju thuhet: “Dilni në luftë në rrugën e Allahut?! A jeni të kënaqur me jetën e kësaj bote, në vend të së amshueshmes?! Kënaqësia e kësaj bote, në krahasim me atë të botës tjetër, është shumë e vogël. Nëse nuk shkoni në luftë, Ai do t’ju ndëshkojë me dënim të dhimbshëm dhe do t’ju zëvendësojë me një popull tjetër”*. Këtu nuk ka dilemë dhe zgjedhje në mes luftës dhe jetës, por dilemë dhe zgjedhje në mes shkuarjes në luftë dhe vdekjes si ndëshkim nga ikja prej saj. Ikja prej luftës shkakton zemërimin e papërmbytur të Zotit. Këto vargje nuk janë të vetmet. Kurani është i mbushur me vargje të ngjashme. Duket se mbi bazën e kësaj, Maks Veber, arrin në përfundimin se islami është më shumë religjion i luftëtarëve se sa grupeve të tjera sociale. Etosi i tij është etosi i luftëtarëve. Veber shkruan se në Islam *“tipi i personalitetit ideal nuk është intelektual, por luftëtar”*³¹. Shehidi (luftëtar i vrarë në rrugën e Allahut) vlerësohet në shumë vargje kuranore si njeriu më i dashur i Zotit dhe ky lloj militarizmi ka influencuar edhe përfytyrimin e islamit për botën tjetër. *“Në Islam bota tjetër është paraqitur si paraajsë shqisore e luftëtarëve”*.³² Kjo pikëpamje e Veberit na mundëson të kuptojmë në masë të madhe entuziazmin e sotëm të militantëve të lëvizjeve islamike, si ISIS apo Al Nusra dhe pretendimet e tyre serioze se islami i tyre është forma më autentike dhe origjinare e islamit. Në njëfarë kuptimi, analiza veberiane duket se u jep të drejtë atyre.

Ky dimension militarist i Islamit fillestar të cilin e evidenton Veberi, si dhe qëndrimi agresiv i tekstit kuranor ndaj formave të tjera të adhurimit fetar, shpesh hidhen poshtë, duke u thirrur në referenca të tjera, që gjenden brenda vetë këtij teksti, të cilat duket se na flasin për një islam kryesisht paqësor. Njëra prej tyre është Sureja El-Kafirun,

³¹Maks Weber, *Economy and Society – An Outline of Interpretive Sociology, Volume I*, University of California Press, 1978, p. 626.

³²Weber, po aty, p. 625.

një sure e shkurtër ku e gjejmë atë që mund të quhet “vargu i tolerancës fetare”. Vargu thotë: “*Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time*”. Konteksti i këtij vargu flet për qëndrimin që Muhamedi duhet të mbajë ndaj besimtarëve dhe ky qëndrim është tejet tolerant. Atij i kërkohet që të mbajë fenë e vet dhe të mos merret me jobesimtarët, që kanë fenë e tyre. Një qëndrim ky i denjë për t’u përfshirë në traktatet themelore liberale për tolerancën fetare. Por, liberalizmi i kësaj sureje duket qartë se bie në kontradiktë të hapur me suret e tjera, ku urdhërohet persekutimi i jobesimtarëve.

Si mund të shpjegohet kjo kontradiktë brenda Kuranit? Një pikënisje e mirë në këtë drejtim është tek Veberi, i cili kur flet për Islamin e hershëm konsideron se karakteri i islamit ndryshon edhe gjatë vetë kohës profetike të tij. Kjo do të thotë se tjetër karakter ka islami i shpallur në periudhën e parë mekase dhe tjetër islami i shpallur në periudhën medinase. Islami i Mekës, sipas Veberit, ka kryesisht karakter eskatologjik; natyra e tij dominohet nga një prirje për tërheqje nga kjo botë, ndërsa me largimin e Muhamedit në Medinë ai shndërrohet në një religjion luftarak, me karakter të qartë arabik.³³ Kjo mund të ketë ndikuar që suret e Mekës të jenë më tolerante dhe të fokusohen më shumë në çështjet e botës tjetër, ndërsa persekutimi i jobesimtarëve është punë që i mbetet Zotit. Shpjegimit mund t’i shtohet edhe leximi situacional politik: në Mekë, Muhamedi është praktikisht i pafuqishëm që t’u kundërvihet me forcë politeistëve, të cilët realisht e kanë nën kontroll. E vetmja mënyrë e mbijetesës së religjionit të sapothemeluar është përmes gjuhës së koekzistencës me besimet tjera. Ndërkaq, me të shkuar në Medinë gjendja ndryshon. Këtu Muhamedi themelon bashkësinë e parë të myslimanëve, e armatosë mirë atë dhe e nisë në luftë me politeistët. Gjendja e luftës kërkon qëndrime të tjera: nuk ka më vend për tolerancë; kundërshtarët duhen shkatërruar; toleranca e tyre është vetëshkatërrues. Në këtë kontekst, e drejta e persekutimit të jobesimtarëve duplikohet: persekutimit hyjnor të botës tjetër i shtohet edhe persekutimi njerëzor në këtë botë, ndërsa vetë Muhamedi, sipas shprehjes së Veberit, përjeton ndryshimin nga një udhëheqës pietist në qytetin e Mekës në sundimtarin politiko-ushtarak të Medines, të tipit *podesta*.³⁴

Një domethënie tjetër, që asocion me konceptin e luftës së shenjtë, sipas Johnson, i referohet gjendjes në të cilën lufta e shenjtë

³³ Weber, po aty, fpp. 623-624.

³⁴ Maks Weber, *Economy and Society – An Outline of Interpretive Sociology*, Volume I, University of California Press, 1978, p.573.

nënkupton një luftë, e cila ka për qëllim afirmimin e religjionit të drejtë ose vendosjen e një rendi social mbi bazën e një autoriteti hyjnor.³⁵ Në të tri religjionet abrahamike, kjo domethënie e luftës së shenjtë, manifestohet gjerësisht. Mojsiu ngjitet në mal për të marrë dekalogun hyjnor, i cili do të shërbejë si themel i bashkësisë së re të hebrenjve pas daljes nga rendi social e politik i Egjiptit faraonik. Krishti vjen për të themeluar mbretërinë e Zotit në tokë dhe Perandori Konstandin³⁶ e Papa Urbani II,³⁷ marrin përsipër ta realizojnë këtë përmes shtatës, ndërsa në Kuran, myslimanëve u thuhet se duhet të luftojnë deri në ditën që e gjithë faja e tokës të jetë nën pushtetin e fjalës së Zotit. Nuk do të ketë paqe në botë derisa kjo të mos përmbushet. Këtu e ka origjinën koncepti islamik i ndarjes bipolare të botës, në Dar al-Islam (shtëpia e Islamit) dhe në Dar al-Harb (shtëpia e luftës). Aty ku për sa kohë nuk sundon islami gjendja është ajo e luftës. Këtë koncept sot e gjejmë në themelet ideologjike të lëvizjeve radikale xhihadiste, si ISIS dhe Al Nusra.

Kjo domethënie e luftës së shenjtë është e lidhur me atë që u tha më sipër, mbi absolutizmin epistemologjik dhe moral të religjioneve abrahamike, sidomos krishterimit dhe islamit. Përmes këtij absolutizmi, luftërat e shenjta bëhen pjesë e lëvizjeve të mëdha millineariste, objektivi final i të cilave është zgjidhja përfundimtare e problemeve politike dhe morale të rendit njerëzor. Moderniteti iluminist edhe pse e çliron shoqërinë nga pushteti i autoriteteve fetare, nuk ia del të çlirohet edhe nga pasioni millenarist i zgjidhjeve përfundimtare, dhe nga kjo marrin jetë disa nga ideologjitë e mëdha të modernitetit, si komunizmi e fashizmi, por edhe filozofi të tjera sekulare që besojnë se tanimë është gjetur rruga e shkurtër për të arritur deri tek e vërteta finale mbi gjithçka.

³⁵ James Turner Johnson, vep e cit, p.38.

³⁶ Perandori Konstandin në histori njihet si perandori i parë romak, që me Ediktin e Milanos të vitit 313, i dha fund persekutimit të krishterëve, duke lejuar praktikimin e lirë të krishterimit dhe më pas, duke nisur procesin e shndërrimit të tij fillimisht në religjionin kryesor të botës romake, e me perandorin Teodos, edhe në religjionin zyrtar të perandorisë (Edikti i Selanikut 380).

³⁷ Papa Urbani II është papa i parë që në vitin 1095 autorizoi kryqëzatën e parë perëndimore kundër sundimit mysliman në lindjen e mesme. Në dekadat në vazhdim, papët e Romës, autorizuan një sërë kryqëzatesh të tjera, të cilat të gjitha përkufizoheshin përmes idesë për çlirimin e varrit të shenjtë të krishtit në Jerusalem. Papët kishin të drejtën të thirrnin kryqëzatë edhe brenda vetë krishterimit, kur ishte në pyetje ndonjë lëvizje fetare, që binte në kundërshtim me doktrinën zyrtare të Kishës Katolike. E tillë ishte kryeqëzata kundër vëllazërisë fetare të katarëve në shekullin XIII.

Për nga vetë natyra e tyre, lëvizjet millenariste, kërkojnë bindje e besim absolut, dhe për të arritur këtë nuk mjafton vetëm argumenti racional, por duhet gatishmëri, që të përdoret edhe dhuna ndaj atyre që dalin si pengesë në marshimin e madh millenarist. Pikërisht me këtë aspekt lidhet një domethënie tjetër, të cilën e gjejmë në konceptin e luftës së shenjtë, në të cilën kjo luftë shfaqet si luftë për të fuqizuar konformitetin e religjionit dhe dënuar deviacionin.³⁸ Në librin e *Levitikut* (Testamenti i Vjetër) ne hasim skena ku Moisiu me bekimin e Perëndisë urdhëron mbytjen me gurë të devijuesve nga parimet e vendosura në Malin Sinaj. Në anën tjetër historia e krishterimit që nga polemikat e Shën Augustinit me donatistët e deri tek shkishërimi i Luterit nga Papati është e mbushur me akte dhune kundër atyre që janë konsideruar devijues, jobesimtarë apo idhujtarë. Në këtë rrafsh dimensionin më i errët është padyshim inkuzicioni kishtar kundër heretikëve gjatë mesjetës.

Ndërkaq, edhe brenda Islamit, mllef i kundër këtyre kategorive është po aq radikal dhe teksti kuranor është tejet eksplicit në këtë drejtim. Ai u kërkon myslimanëve që t'i luftojnë idhujtarët dhe mosbesimtarët deri në momentin kur ata të mposhten dhe besimi në Allahun të vendosë sundimin e tij.³⁹ Idhujtaria brenda islamit është e lidhur me një koncept të rëndësishëm të kohës së fillimeve të tij, me konceptin e *jahiliyya-s*. Ky koncept i referohet injorancës politeiste të

³⁸ James Turner Johnson, vep e cit, p. 38

³⁹ Në suren El-Bekare, surja më e gjatë kuranore, e shpallur në Medinë, kemi një varg ku mosbesimi, në stilin e lashtë, kriminalizohet, madje deri në atë shkallë sa kriminaliteti i tij konsiderohet edhe më i rëndë se ai i vrasjes. Vargu thotë: “Mosbesimi është më i rëndë se vrasja”. Ai është i përfshirë brenda tërësisë së vargjeve, 190-191, të Sures El-Bekare, ku myslimanëve u kërkohet t'i ndjekin dhe vrasin të gjithë ata që i kundërvihen rrugës së Allahut. Kriminalizimi i mosbesimit nuk është një specifikë që e gjejmë vetëm në Kuran apo edhe në tekstet tjera biblike. Edhe në librin e Platonit “*Ligjet*”, i shkruar gati njëmijë vjet para Kuranit, gjejmë pak a shumë të njëjtën gjë, dënimin me vdekje të ateistëve, ngase ateizmi është për Platonin një sëmundje e shpirtit. Ata që e kritikojnë Platonin për karakterin totalitar të mendimit të tij filozofik, në mesin e të cilëve më i njohuri është, Karl Popper, mes tjerash u referohen paragrafeve 908 dhe 909 të dialogut “*Ligjet*”, ku Platoni përshkruan mënyrën e dënimit të jobesimtarëve dhe ku ateizmi cilësohet si sëmundje e mendjes. Po në këtë paragraf, Platoni flet për një si burg të përbashkët (*common jail*) që asocion me kampin e përqëndrimit dhe për këshillin e natës (*nocturnal council*), që drejton “shtëpinë e korrektimit”, e cila në njëfarë mënyre asocion me inkuzicionin kishtar (Plato, *Laws*, botuar në: *The Collected Dialogues of Plato – Including The Letters*, Princeton University Press, 1989, pp. 1463-1464.).

Arabisë paraislamike, e cila është ekuivalencë e mosnjohjes së Zotit. Duke qenë njëkohësisht koncept gnoseologjik dhe moral, *Jahiliyya* ka në njëfarë kuptimi edhe konotacione të brendshme sokratike, ngase ajo implikon idenë se injoranca (mosnjohja e Zotit të vërtetë) shpie në veprime të këqija e të mbrapshta (adhurimi i perëndive të rrejshme). Sokrati thoshte, pak a shumë, të njëjtën gjë, se injoranca është burim i të keqes dhe më vonë Platoni në alegorinë e tij të shpellës, jetën në injorancë e përshkruante si një jetë të mjerë skllevërisht. “Pafajësia” e këtij koncepti të vjetër të islamit në kohën tonë është prishur nga ideologët e rrymave të radikalizmit islamik, të cilët e nxjerrin atë nga konteksti i ngushtë historik dhe i japin validitet universal në kushtet e shoqërisë bashkëkohore. Njëri prej tyre është ideologu i “Vëllazërisë Myslimane” Sayyid Qutb, i cili konceptin e *jahiliyya-s* e bën koncept qendror në veprat e tij.⁴⁰ Për Qutb, ekuivalenti bashkëkohor i *jahiliyya-s* paraislamike është moderniteti perëndimor, me të gjitha dimensionet e tij, sekularizmin, demokracinë, materializmin, sensualizmin, pragmatizmin, ateizmin e lejuar etj. Të gjitha këto, janë trajta të idhujtarisë dhe puna e parë e xihadit është shkatërrimi i tyre. Qutb shkon edhe më tutje, duke përfshirë brenda botës së *jahiliyya-s* bashkëkohore edhe të krishterët dhe hebrenjtë, ngase sipas tij, ata e meritojnë një gjë të tillë me vetë faktin se kanë pranuar kushtet dhe parimet jofetare të modernitetit, diçka që nuk parashihej në *jahiliyya-n* klasike, ku të krishterët dhe hebrenjtë dalloheshin nga idhujtarët politeistë.⁴¹ Në këtë mënyrë, Qutb dhe pasuesit e tij, zhvillojnë teoritë e mospajtit në mes modernitetit dhe islamit dhe në të njëjtin drejtim shkon edhe rryma tjetër radikale, vahabizmi, i cili nga doktrina e tij e monoteizmit absolut⁴² derivon qëndrimin nihilist ndaj vlerave materialiste të modernitetit. Këtë qëndrim sot e gjejmë në zemër të pasionit militant të lëvizjeve të tilla, si ISIS dhe Al Qaida.

Kurani në mes interpretimit salafist dhe interpretimit hegelian

Kurani, parimisht, mund të interpretohet në dy mënyra: salafiste dhe hegeliane. Interpretimi salafist e sheh Kuranin si tekst hyjnor,

⁴⁰ Sayed Khatib, *The Political Thought of Sayyid Qutb*, Routledge, London and New York, 2006, fq.10-43

⁴¹ Ian Buruma dhe Avishai Margalit, *Oksidentalizmi- Perëndimi dhe armiqtë e tij*, Botimet IDK, Tiranë, 2013, fq. 107.

⁴² Jacques Waardenburg, *Islam- Historical, Social and Political Perspectives*, Walter de Gruyter-Berlin – New York, 2002, pp.232-233.

brenda të cilit gjithçka është e përkryer dhe si e tillë ka vlerë absolute dhe universale. Kjo do të thotë se ajo çka thuhet aty është dhe duhet të jetë valide për të gjitha kohërat, kontekstet dhe situatat. Nëse thuhet se idhujtarët duhen vrarë, atëherë kjo duhet të vlejë njëjtë si në vitin 632, edhe në vitin 2014. Në leximin salafist nuk është konteksti që i jep kuptim tekstit kuranor, por e kundërta konteksti duhet të formësohet në tërësi, sipas këtij teksti. Logjika e këtij qëndrimi është e thjeshtë: Zoti absolut nuk mund të hartojë tjetër veçse një tekst që ka vlerë absolute në të gjitha situatat dhe rrethanat, në kohë dhe hapësirë. Kur një logjikë të tillë e lëmë në rrafshin e spekulimit metafizik, e rreziku limitohet vetëm prodhimin e atyre, Kanti i quante “*iluzione transcendentale të mendjes së pastër*”, e më vonë filozofia analitike i identifikonte si “*iluzione të prodhuara nga keqpërdorimi i gjuhës*”, por kur vendosim që këtë lloj absolutizmi ta shndërrojmë në program politik dhe recetë sociale për mënyrën e organizimit të shoqërisë, atëherë dogmatizmi metafizik merr formën e fanatizmit fetar e politik. Kjo shpjegohet me faktin se fanatizmi bazohet mbi vetëbesimin e krijuar nga një grup se ai ka përjetuar revelacionin (zbulesën) e absolute. Ky vetëbesim e shpie grupin drejt vizionit manihesit për botën, në vizionin për ndarjen globale në mes të mirës dhe të keqes, e cila pastaj kërkon detyrimisht një luftë të shenjtë kundër anës së keqe. E tërë kjo qëndron në thelbin e lëvizjeve radikale, si ISIS e Al Nusra. Justifikimi i dhunës së tyre, përmes sureve uranore, është i mundur vetëm nëse këtyre sureve u bëjmë lexim salafist.

Alternativa e tij është leximi hegelian, parimi metodologjik i të cilit thotë se çdo tekst nuk është tjetër përveçse shprehje e frymës së kohës së tij. Kjo do të thotë se çdo tekst flet dhe shpreh problemet e kohës në të cilën është shkruar dhe është marrëzi të mendohet se ai mund të transcendojë (kapërcejë) kohën e tij.⁴³ Çdo individ, shkruan Hegeli, në secilin rast është fëmijë i kohës së tij dhe nuk mund të kapërcejë përtej limiteve të saj. Një gjë e tillë vlen edhe për profetin Muhamed dhe përvojën e tij fetare, të kodifikuar në tekstin e Kuranit.

⁴³ Ky parim mund të nxirret nga teksti i parathënies, që Hegeli ka shkruar për veprën e tij “*Elementet e filozofisë të së drejtës*”. Në këtë parathënie Hegeli paraqet pikëpamjen e tij mbi natyrën e refleksionit filozofik, i cili për Hegelin, në thelbin e tij është vetëm një refleksion retrospektiv. Parimi mund të nxirret edhe nga koncepti për historinë e filozofisë, e të cilin Hegeli e zhvillon në veprën e tij “*Leksione mbi Historinë e Filozofisë*”. Në këtë vepër Hegeli kritikon pretendimet e filozofive të ndryshme për të dhënë të vërtetën e plotë mbi realitetin dhe insiston në idenë se vlera e vërtetë e çdo filozofie qëndron në të qenit e saj një moment (pjesë) i shpalosjes të së vërtetës.

Shqetësimet e tij janë në fakt shqetësimet shpirtërore e politike, që dominojnë Lindjen e Mesme në fillimet e botës mesjetare dhe sukseset e tij lidhen me faktin se ai veprimi në përputhje me atë që e kërkonin tendencat kryesore të kohës së tij, në mesin e të cilave kryesorja ishte ekspansioni i formës monoteiste të besimit fetar⁴⁴.

Për dallim nga leximi salafist, leximi hegelian tekstin ia nënshtron kontekstit dhe kjo ka për pasojë mohimin e pretendimeve të tekstit për absolutizëm epistemologjik (Kurani si e vërtetë e plotë dhe përfundimtare), universalizëm moral (Sheriati si kod universal moral) dhe imperializëm politik (kalifati islamik, si rendi final politik i botës). Në botën perëndimore ky nënshtrim i tekstit ndaj kontekstit ka prodhuar kritikën historiciste-iluministe të shkrimeve të shenjta biblike⁴⁵, kritikë e cila sëbashku me dimensionet tjera të iluminizmit, pas një procesi të gjatë historik, ia dolën që krishterimin agresiv të mesjetës ta shndërrojnë në krishterimin tolerant të kohës moderne. Në këtë kuptim mund të thuhet se Friedrich Meinecke ka të drejtë kur e quan historicizmin si “njërin nga revolucionet më të mëdha intelektuale që ka përjetuar mendimi perëndimor”.⁴⁶ Kuptimi i termit “historicizëm”, te Meinecke, dallon nga kuptimi që i jep atij Karl Popper, si një ekuivalent modern i metafizikës fataliste. Te Meinecke, historicizmi kuptohet si metodë apo pikëpamje, sipas të cilës të gjitha vlerat, idetë dhe praktikat njerëzore, janë produkte të konteksteve të caktuara historike dhe mund të kuptohen e valorizohen vetëm përmes dhe brenda tyre. Në këtë kuptim, historicizmi është anti-absolutist dhe anti-esencialist.

Duke u kthyer të bota arabe mund të thuhet se kjo botë, me gjasë do ta ketë vështirë të gjejë qetësi pa e përjetuar këtë revolucion intelektual në arealin e saj kulturor. Ky përjetim, në radhë të parë, nënkupton kontekstualizimin e Kuranit në histori, prej nga mund të derivohet vlera e tij e vërtetë si një dokument i rëndësishëm i civilizimit njerëzor, por jo edhe si alfa dhe omega e këtij civilizimi. Kontekstualizimi nuk nënkupton reduktimin e Kuranit vetëm në një vlerë muzeale, por hapjen e mundësive

⁴⁴ Studimet më serioze historiografike flasin se tendenca drejt monoteizmit dhe procesi i rënies së politeizmit ishin shfaqur tek fiset arabe disa dekada para lëvizjes fetare të Muhamedit. Shih : Jacques Waardenburg, *Islam- Historical, Social and Political Perspectives*, Walter de Gruyter-Berlin – New York, 2002, pp. 24-44.

⁴⁵ Kjo traditë fillon me shkrimet e Spinozës dhe merr një zhvillim të hovshëm në iluminizmin francez dhe filozofinë humaniste të hegelianëve të majtë si Strauss, Bauer, Feuerbach.

⁴⁶ Frederick C.Beiser, *The German Historicist Tradition*, The Oxford University Press, 2011, p.1.

për lexim selektiv të tij, në funksion të koekzistencës ndërmjet kulturave në botën tonë, që tanimë i ka marrë të gjitha tiparet e atij, që McLuhan e quante “fshati global”.⁴⁷ Zhveshja e Kuranit nga absolutizmi epistemologjik, moral dhe politik, i cili i vendosë arabët myslimanë në kulminacionin më të lartë të historisë botërore, përbën një kusht mental, që bota arabe të çlirohet nga “kultura e poshtërimit”,⁴⁸ e cila sipas Dominique Moisi, e ka mbërthyer këtë botë dhe për pasojë është krijuar brenda saj psikologjia masive e hakmarrjes, e cila pastaj është mishëruar në lëvizje dhe grupe të tilla, si Al Qaida dhe ISIS. Çlirimi nga kultura e poshtërimit është njëkohësisht edhe çlirim nga interpretimi komplotist i historisë,⁴⁹ i cili njësoj si Diga e Mosulit, që i jep energji elektrike Luginës së Mesopotamisë, u jep energji pasioneve militante të këtyre lëvizjeve.

⁴⁷ Këtu vlen të theksohet se kultura teologjike islame nuk është krejtësisht e shkëputur nga tendencat e brendshme reformatore. Në kuadrin e shkollave të jurisprudencës islame është shkolla hanefite, e cila në thelbin e saj përmban parimin se ligji islame duhet t’u përshtate rrethanave të reja; ai duhet të ecë krahas ndryshimeve kohore ngase fenomenet dhe faktet e reja kërkojnë vendime dhe zgjidhje të reja. Shih : C.G. Weeramantry, *Islamic Jurisprudence- An International Perspective*, MACMILLAN PRESS, 1988, p. 50.

⁴⁸ Në esenë e tij mbi “gjeopolitikën e emocioneve” politologu francez Dominique Moisi, shkruan se ndjenja e poshtërimit dominon atëherë kur kontrasti në mes të kaluarës suaj të idealizuar e të lavdishme dhe të sotmes tuaj zhgënjyese bëhet tepër i madh. Kjo ndjenjë, në botën arabe, është shndërruar në kulturë të poshtërimit, e cila ushqehet nga kontrasti në mes përfytyrimit për të kaluarën e lavdishme (nga triumfi i Muhamedit, deri tek rënia e Kalifatit islamik në shekullin XIII) dhe gjendjes së mëvonshme të botës arabe, e cila përfshin një mori nënshtrimesh të njëpasnjëshme, si nënshtrimi osman, nënshtrimi nga fuqitë imperialiste perëndimore, humbja poshtëruese në konfliktin me Izraelin, nënshtrimi nga regjime të korruptuara autoritariste. Shih: Dominique Moisi, *Gjeopolitika e Emocioneve*, AIIS, Tiranë 2010, pp. 25 dhe 94-139.

⁴⁹ Teoricienti politik i Shkollës së Frankfurtit, Franz Neumann, konsideron se intepretimi komplotist i historisë shfaqet në situata të krizave të mëdha sociale, kur grupet që humbin pushtetin apo pësojnë rënie, duke mos qenë në gjendje të kuptojnë racionalisht procesin historik që ka shkaktuar rënien e tyre priren drejt teorive të komplotit, ku faktorët shkaksorë impersonalë të rënies zëvendësohen me fajtorë të personifikuar, që besohet se kanë planifikuar dhe organizuar rënien e tyre. Këto teori të komplotit instrumentalizohen nga demagogët, të cilët përmes prodhimit të frikës masive, arrijnë të mobilizojnë masat dhe kështu krijojnë terrenin për shfaqjen e lëvizjeve totalitare. Në këtë kontekst, si shembuj klasikë, Neumann i konsideron nacional-socializmin gjerman dhe fashizmin Italian. Shih: Franz Neumann, *Frika dhe Politika*, botuar në *Thema* (Revistë e Shoqatës së Filozofëve dhe Sociologëve të Kosovës), nr.10, 1988, fq. 125-155). Priirja për akceptimin e teorive të komplotit, sot është dominuese në background-in ideologjik të lëvizjeve radikale në botën islame, me çka determinohet edhe karakteri totalitar i tyre.

ON CONTEMPORARY STREAMS OF ISLAM, THE CONCEPT OF HOLY WAR AND READING OF QURAN

Summary

The horrifying massacres committed during the civil in Syria and Iraq from different groups, particularly those under the emblem of the ISIS (Islamic State of Iraq and Syria) got many scholars, clerics, Islamic theologians and others throughout the world involved in trying to extract any kind of discursive connection between the Quran and military practices of the militants of this state, proclaimed as the new caliphate. This attempt afflicts the idea that either justifications or arguments can be found in the Quran for the ISIS crimes, which is proclaimed by its militants that their deeds in Syria and Iraq are nothing more but a fulfillment of the Quran obligation that in Islam is known as the Jihad.

Who is right in this instance? In order to be able to reply to this question, however inconclusive, it is necessary to dismantle a range of issues. The first has to do with the context of the main streams in contemporary Islam, in order to know the terrain of such groups, such as ISIS and Al Nusrat (that emerged as a branch of Al Qaeda) in typology and topology Islamic doctrine; the second has to do with the concept of Jihad, and ultimately the issue of the Quran text itself, including the war and violence and possible means of interpreting this text.

Bibliografia

- Jacques Waardenburg, *Islam- Historical, Social and Political Perspectives*, Walter de Gruyter-Berlin – New York, 2002
- Tariq Ramadan, *Islam and the Arab Awakening*, Oxford University Press, 2012.
- Tariq Ramadan, *Western Muslims and the Future of Islam*, Oxford University Press, 2004
- Kurani i Madhërishëm*, botoi “Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam”, Tiranë 2006.
- Ernest Gellner, *Plugu, Shpata dhe Libri-Struktura e historisë njerëzore*, Përpjekja, Tiranë, 2002.
- Michel Foucault, *Historia e Seksualitetit I- Vullneti për dije*, Dukagjini, Pejë 2008.
- Gilles Kepel, *Beyond Terror and Martyrdom – The Future of the Middle East*, The Belknap Press of Harvard University Press, 2008.
- Eric Geoffroy, *Introduction to Sufism- The Inner Path of Islam*, World Wisdom, 2010.
- Wael B. Hallaq, *A History of Islamic Legal Theories*, Cambridge University Press, 1997.
- Bernard Lewis, *Islami dhe Perëndimi*, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë, 2005.
- Bernard Lewis, *The Political Language of Islam*, The University of Chicago Press, 1988

-
- Peter Sloterdijk, *Rage and Time*, Columbia University Press , 2010.
- Karl Lowith, *Meaning in History*, University of Chicago Press, 1957.
- Marx, Engels, Trotsky, Wright, *Lenin, Marxism versus Anarchism*, Resistance Books, 2001.
- Nikolai Berdyaev, *The Russian Idea*, The Macmillan Company, New York, 1948.
- The History of Terrorism- From Antiquity to Al Qaida*, Gerard Chaliand and Arnaud Blin (ed), University of California Press, 2007.
- James Turner Johnson, *The holy war idea in western and islamic traditions*, The Pennsylvania State University Press, 1997.
- Maks Weber, *Economy and Society – An Outline of Interpretive Sociology, Volume I*, University of California Press, 1978.
- Plato, *Laws*, botuar në : *The Collected Dialogues of Plato – Including The Letters*, Princeton University Press, 1989.
- Sayed Khatab, *The Political Thought of Sayyid Qutb*, Routledge, London and New York, 2006
- C.G. Weeramantry, *Islamic Jurisprudence- An International Perspective*, MACMILLAN PRESS, 1988
- Frederick C.Beiser, *The German Historicist Tradition*, The Oxford University Press, 2011.
- Dominique Moisi, *Gjeopolitika e Emocioneve*, AIIS, Tiranë 2010.

Alban BAKIA, Prishtinë

IDENTITETI KOMBËTAR DHE MUZETË

KDU 069.5(496.51)(091)

Çështja se kush e ka pushtetin ndaj kontrollit të identitetit, është temë sfide e debatit.

Clavir (2002) xx

Abstrakt

Ky artikull, përmes analizës kritike të sfondit historik të zhvillimit të konceptit dhe rolit të muzeut kombëtar në Evropë, paraqet një kornizë diskurseve, në të cilën mund të bazohet projekti i zhvillimit të muzeut kombëtar të Republikës së Kosovës. Artikulli argumenton që, me gjithë rëndësinë që të kuptohet se si kanë lindur dhe janë zhvilluar muzetë publikë, qëndrimet ndaj të kaluarës që kanë ndihmuar në krijimin e tyre, nuk do të duhej të diktojnë apo kufizojnë të ardhmen e mundësive të muzeve publikë. Në artikull elaborohen dy raste studimore të ngjarjeve të veçanta të historisë, për të cilat ka reagime diverse kulturore, Skënderbeu me shqiponjën dykrenare dhe Beteja e Kosovës (1389). Përmes këtyre rasteve paraqitet dhe modeli se si Muzeu Kombëtar i Kosovës mund të reflektojë për një natyrë të hapur të të menduarit historik, kritik dhe vetëkritik, të bazuar në nocionin e shkencës dhe progresit shoqëror, ku krahas paraqitjes së artefakteve të rëndësishme historike, mundësohet gjithashtu hapësira për krijimin e një sensi të historisë së përbashkët midis vetë individëve.

Fjalët çelës: Muzeu Kombëtar, identiteti, të menduarit historik kritik, Beteja e Kosovës, Skënderbeu

Historiku i shkurtër i identitetit kombëtar dhe i Muzeut Kombëtar

Ideja e kombit në përgjithësi dhe e identitetit kombëtar më saktësisht është relativisht e re në aspektin historik. Të dyja konceptet janë produkt i kohës moderne, të cilat mund të thuhet se janë pjekur në formën si i njohim ato sot, në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë,¹ bashkë me 'kulturën', siç e njohim ne sot. Një kriter me rëndësi për të pasur identitet legjitim kombëtar gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë ishte prania e një historie të përbashkët kombëtare. Kjo do të thotë se

¹ Hobsbaun (1990) 40-41.

definimi dhe prezantimi i të kaluarës kishte (dhe akoma ka) kulturalisht funksion kompleks dhe me rëndësi në jetën personale dhe publike. Prandaj, institucionet që ruajnë dhe prezantojnë të kaluarën dhe identitetin kombëtar në emër të popullit apo kombit, sikurse muzetë, janë thellësisht politike. Historitë kombëtare, prandaj, janë të konstruktura, shpesh me qëllim specifik galvanizimin e identitetit kombëtar dhe prandaj e arsyetojnë rendin aktual social dhe politik. Në shekullin e nëntëmbëdhjetë, ato kanë tentuar që *zanafillat autentike* të popullit t'i gjurmojnë nga e kaluara e largët, prandaj shpesh i janë referuar ndonjë ngjarjeje, në të cilën për herë të parë është manifestuar identiteti kombëtar, zakonisht ndonjë kohe të lavdisë së shquar.² Megjithatë, në kohët moderne ekziston një pyetje e hapur rreth kuptimit të identitetit kombëtar dhe asaj se kush e kontrollon atë dhe, çka është më me rëndësi, duke iu ngritur një çështje kombeve të para moderne, që nisën projektin e definimit të identitetit të vet kombëtar, respektivisht, zhvillimit të muzeve. Kjo ese do të fokusohet në rastin e Republikës së re të Kosovës.

Në të kaluarën, nevoja për të zhvilluar histori kombëtare, posaçërisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë, ishte në përgjithësi pasojë e rrëmujave enorme ekonomike, sociale dhe politike, të cilat kanë karakterizuar fillimin e periudhës moderne në Evropë. Veçanërisht, kjo u pa në Britani, ku hapi shumë i shpejtë i ndryshimit të shoqërisë, peizazhit natyror dhe mjedisit gjatë shekujve të tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë çoi në një ndjenjë nevojë për të ruajtur të kaluarën, gjë e cila po anashkalohej nga zhvillimet e reja.³ Duke prezantuar të kaluarën e përbashkët kombëtare, grupe sociale, që ishin shumë të ndryshme apo që kishin madje interesa të kundërta ekonomike e politike, mund të kishin identitetin kombëtar të përbashkët. Në këtë kuptim, gjersa shija kulturore e individit është gjithnjë personale, kultura në vete paraqet kontingjent edhe politik edhe historik. Ajo dallon tek shoqëritë e ndryshme, në kohë të ndryshme dhe në vende të ndryshme.

Sot, ne mund të vendosim që ndryshe të veprojmë sa i përket projektit të zhvillimit të identiteteve kombëtare dhe historive të përbashkëta. Së pari, muzetë kombëtarë mund të kërkojnë të shkojnë përtej, thjesht, legjitimitetit të rendit aktual shoqëror dhe politik; së dyti, ne mund të jemi më të vetëdijshëm sa i përket aspekteve pozitive

² Hobsbaun (1990) 41.

³ Louenthal – Biney (1981) 165.

të dallimeve kulturore mes grupeve të ndryshme sociale. Në Kosovë, për shembull, projekti i zhvillimit të një identiteti të përbashkët kombëtar do të mund të konsiderohej i rëndësishëm nga pikëpamja e konsolidimit të një ndjenje të përbashkët mes grupeve paraprakisht kontradiktore kulturore dhe fetare, ndonëse ka ndjeshmëri të madhe sa i përket çështjeve të pronësisë kulturore dhe rrënjëve historike, që janë shprehur në mënyrë të dhunshme në të kaluarën, gjë që e bën këtë çështje të vështirë për politikëbërësit, që përpiqen të ndërmjetësojnë me artistët e artefaktet dhe me shoqërinë e gjerë. Me agimin e një identiteti kombëtar në Britani, për shembull, idetë e kombit u barazuan me ato të progresit, historisë dhe shtetit, dhe u konsoliduan përmes kulturës që po zhvillohej. Nuk duhet të vijë si befasi, prandaj, që muzeu publik kombëtar, siç e njohim ne sot, ka lindur në Britaninë e shekullit të tetëmbëdhjetë, dhe lulëzoi në të nëntëmbëdhjetin.

Në shekullin e tetëmbëdhjetë, në Mbretërinë e Bashkuar, muzetë e para publike qeveriseshin nga një bord anëtarësh të besuar, i cili kishte në mandat ruajtjen e koleksioneve të vëna nën besimin e tyre.⁴ U zhvilluan koleksione të rëndësishme publike artefaktesh, të cilat u vunë për shikim publik. Shkenca pati rol kyç në këtë proces. Muzetë katalogonin gjetjet dhe zhvillonin shumë koleksione të historisë natyrore, që në anën tjetër mund të përdroreshin nga shkencëtarët për hetime shkencore. Shpesh mbledheshin skelete njerëzore, me qëllim të kryerjes së studimit mbi “racat”, të cilat shprehimisht dalloheshin nga artefaktet e popujve evropianë. Prandaj, identiteti kombëtar, është jo gjithmonë i paracaktuar, por edhe i krijuar aktivisht, apo i *zbuluar* si proces. Në shekullin e njëzetë, ideja e ruajtjes së artefakteve në muze, akoma konsiderohej *përpykje e denjë* në peshën e vet, edhe nëse ishte larg vendit të tyre të origjinës.⁵ Rastësisht, kjo ka çuar në debate të ashpra rreth pronësisë kulturore dhe riatdhesimit të objekteve historike bashkë me nevojën, veçanërisht në Britani, për rivlerësim të politikës kulturore dhe rolit të muzeve kombëtare.

Megjithatë, në fund të shekullit tetëmbëdhjetë dhe fillimit të atij të nëntëmbëdhjetë, shoqëritë perëndimore, në përgjithësi ishin optimiste rreth potencialit të shkencës, si thelbësor për progresin njerëzor dhe të kuptuarit më mirë të universit (Clavir, 2002: 12). Ata që besonin në këtë, përgjithësisht e konsideronin veten të zinin *bazë të lartë morali*, prandaj progresi njerëzor identifikohet shpesh me

⁴ Clavir (2002)13.

⁵ Clavir (2002) 31.

përparimin e kombit. Kështu mund të shohim se një pikëpamje e veçantë ndaj botës, në fillim mbështetej në muzeun kombëtar, dhe arsyetonte rolin e tij në ruajtjen e të kaluarës, bashkë me vendimet e bëra për atë se cilat objekte ishin të denja për t'u përfshirë dhe pse?

“Në shumë histori muzesh, ruajtja e artefakteve historike mbështeste, meta-narrativet e nacionalizmit evropian, arritjeve sipërore, superioritetit kinse evropian ndaj kulturave tjera, dhe rrënjëve evropiane në botën Klasike. Koleksionet indigjene sintetizoheshin brenda kësaj perspektive.”⁶

Mund të shohim rëndësinë e gjurmimit të identitetit evropian nga bota klasike dhe të bërjes së koleksioneve indigjene, si dytësore në këtë proces. Koleksione të tilla ishin më shumë njëlloj xhingle, apo shtese ndaj artefakteve kryesore, që strehoheshin dhe paraqiteshin në muze, që së paku konsideroheshin të denja për përfshirje në bazë të meritave të tyre shkencore, por që më shpesh shërbenin si krahasim për të ilustruar me shembuj cilësinë superiore të artefakteve evropiane. Megjithatë, të gjitha objektet që ruheshin në muze, me këtë pikëpamje, kuptoheshin si momente *statike* të historisë së një kulture, gjë e cila reflekton pikëpamjen se muzetë promovojnë përfaqësime statike dhe se janë edhe vetë statike.⁷ Duhet të theksohet, gjithashtu, se këto muze të para publike, në fillim ishin të hapura vetëm për anëtarë të caktuar të shoqërisë, që ishin për afërsisht të barabartë me klasat e larta dhe ato të mesme, që ishin në zhvillim e sipër - njerëzve të paarsimuar dhe atyre më pak të respektueshëm nuk u lejohej hyrja, duke kundërshtuar rëndësinë si në rrafshin lokal, ashtu edhe në atë kombëtar.

Sot, një ide e rëndësishme për muzeun bashkëkohor është akoma ideja e unikatësisë së objektit individual, ose pazëvendësueshmërisë. Artefaktet duhet të konsiderohen si diçka e veçantë, në mënyrë që të konsiderohet artikull legjitim për t'u përfshirë. Një 'mandat tjetër fundamental' është ai i arsimimit.⁸ Mund të shohim se Muzeu i Historisë Natyrore në Londër, për shembull, gjithashtu, fillimisht përdorej edhe për të edukuar klasat e larta dhe të mesme, por edhe për të vendosur koleksione që ishin njësoj interesante për dijetarët. Kjo është larg idesë së arsimimit që ne ua ngarkojmë muzeve sot. Megjithatë, në aspekt të të qenit informativ për

⁶ Clavir (2002) 31 – 2.

⁷ Clavir (2002) 32.

⁸ Clavir (2002) 32.

fëmijët dhe i kuptueshëm për grupe të ndryshme sociale dhe kulturore, Clavir vë në dukje se muzetë e 'Kombeve të Para' (popullatat indogjene) mund të vendosnin të kufizojnë qasjen në koleksionet e caktuara, mbi bazë gjinie apo kriteresh të tjera, të cilat nuk do të konsiderohen demokratike në vendet, si për shembull në SHBA.⁹ Kjo ngre pyetjen se për *kë* janë muzetë në kohën bashkëkohore, dhe çfarë do të thotë të jenë demokratike, nëse të tilla duhet të jenë. Në të vërtetë, të parat, siç edhe pamë, muzetë e para në Britani nuk ishin demokratike, ashtu siç mund të mendojmë. Muzetë e 'Kombeve të Para' duhet të ofrojnë përgjigje në pyetje të thella dhe të vërteta rreth asaj se si t'i konstitujnë vetë të kaluarat e tyre dhe ndjenjën e identitetit kombëtar, gjë e cila mund të hedhë dritë mbi çështje të përgjithshme të rolit të muzeut sot.

Rrjedhimisht, sot pranohet se muzeu nuk është hapësirë 'neutrale'.¹⁰ Kjo do të thotë se nuk mund të jemi të pafajshëm rreth rolit dhe qëllimit të muzeut kombëtar, apo në fakt, rreth vetë konceptit të identitetit kombëtar. Nga kjo pikëpamje, politika kulturore që dikton rolin e muzeve mund të kuptohet si kontratë e përkohshme mes grupeve të ndryshme shoqërore. Për shembull, postmodernizmi ka tendencë që të luftojë për përfaqësimin e perspektivave të shumëfishta, dhe të sfidojë autoritetin e perspektivave tradicionale perëndimore, siç përshkruhet më lart. Ky është sfondi historik dhe me korniza kritike-diskursive, me të cilat do të bazohet projekti i zhvillimit të një muzeu kombëtar për Republikën e Kosovës.

Kosova: lindja e shtetit më të ri në botë dhe problemi i kulturës së përbashkët

Republika e Kosovës, shteti më i ri në botë, shpalli pavarësinë në shkurt të vitit 2008. U raportua se politika premtoi demokraci që respekton të drejtat e të gjitha komuniteteve etnike. Mund të shihet gjithashtu se shteti i ri zgjodhi që të përfaqësojë pavarësinë e saj me një vepër arti publik në formë monumeti, NEWBORN (BBC, 2008). Kjo pasqyron atë se nocioni i pavarësisë konsiderohet vlerë e rëndësishme e përbashkët kulturore për Republikën e re. Megjithatë, u raportua se dallimet etnike, fetare dhe kulturore, që në të kaluarën kanë formësuar zonën, shpesh me dhunë, ende ishin të pranishme

⁹ Clavir (2002) 192.

¹⁰ Clavir (2002) 202.

(BBC, 2008). Kjo e komplikon çështjen se si të pasqyrohet identiteti kombëtar i shtetit, i cili duket se nuk ka asnjë të përbashkët kulturore mes grupeve të ndryshme, e shoqëruar me histori të rënda përplasjesh kulturore dhe pretendimesh të kontestuar historike të trashëgimisë, prejardhjes, vlerave, kombëtarisë dhe shtetësisë. Megjithatë, e kanë të përbashkët të kaluarën historike, ku kanë jetuar në të njëjtin areal, por gjithmonë me dallime kulturore e gjuhësore, historike e sociale, religjioze e politike.

Historia e terrenit, që përafërsisht sot përbën Republikën e Kosovës dhe popujt e tij të ndryshëm, është kontestuar ashpër, dhe akoma në një farë mase kontestohet nga grupe të ndryshme sociale. Kjo do të thotë se muzeu i ri publik duhet të veprojë me kujdes, ngase ende ka shumë çështje për të zgjidhur. Megjithatë, mund të thuhet se pas vitit 1918, në Jugosllavi ka pasur qëndrime të ndryshme sa i përket krijimit të një kulture të përbashkët, gjë e cila me pak fjalë mund të përmblihet se ka evokuar, qoftë bashkim, bashkëpunim apo tolerancë.¹¹ Kjo gjë është shumë ndryshe nga krijimi i qëndrimeve ndaj të kaluarës dhe ruajtjes që përshkruhet nga burimet dhe autorët, që eksploronin rolin e muzeut publik në Evropën Perëndimore dhe në veçanti në Angli.¹² Megjithatë, kjo sugjeron që ideja e kulturës së përbashkët është me rëndësi për ata që identifikohen me grupe të ndryshme kulturore. Më tej, Kostovicova pohon se ndarja /segregacioni i zbatuar në arsim mes serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë, në fillim të viteve të 90-ta të shekullit XX, thelloi hendekun ndarës të koncepteve të ndryshme të kombit dhe atdheut.¹³ Kjo sjell në pah natyrën kontingjente të politikës kulturore dhe nxjerr në pah rolin e atyre, që këso politikash, zhvillojnë si ndërmjetësues. Kjo, gjithashtu tregon vështirësinë e reflektimit të nocionit paksa më tradicional të kombit si atdhe në muze kombëtar.

Prandaj, kjo ese, do të marrë si raste studimore për dy ngjarje të veçanta të historisë, që për serbët dhe shqiptarët janë përkatësisht të rëndësishme, për sa i përket projektimit të një muzeu kombëtar. Shqiptarët dhe serbët e Kosovës janë dy grupet dominuese kulturore dhe fetare në Republikën e Kosovës. Prandaj, historia dhe identiteti i të dyjave mund të reflektohet dhe të hulumtohet në mënyrë kritike. Roli i politikës kulturore në këtë rast, është që të ndërmjetësojë në mes të dy grupeve, por gjithashtu, që të synojë të shqyrtojë dhe të shprehë

¹¹ Uatchel (1998) 228.

¹² Clavir (2002)26,129; Louenthal – Binney (1981) 48, 68,1 29.

¹³ Kostovicova 92005) 72-3 , 85-7, 104-11.

vlerën e përbashkët kulturore të pavarësisë dhe rëndësinë e kulturës së përbashkët, të shprehur nga shqiptarët edhe nga serbët në Kosovë. Dy ngjarjet janë: Beteja e Kosovës në vitin 1389 si rast studimi për krijimin e identitetit të kosovarëve serbë dhe Skënderbeut si figurë kombëtare shqiptare në shekullin e pesëmbëdhjetë, për krijimin e identitetin të kosovarëve shqiptarë.

Në përputhje me hulumtimet e kohëve të fundit, muzeu kombëtar për Republikën e Kosovës do të synojë të përqendrohet jo vetëm në legjitimimin e rendit aktual politik apo instalimin e ndjenjave të patriotizmit *per se*, që historikisht e kanë pas për qëllim shpeshherë muzetë, por diçka që është edhe më shumë në përputhje me teorinë, që qëndron prapa idesë së republikës dhe hulumtimit të fundit – të zgjedhin, të shqyrtojnë nocionet e qytetarisë e të kulturës së përbashkët, në mënyrë më kritike dhe vetëkritike e reflektuese. Në vend se të merret modeli i shekullit të nëntëmbëdhjetë evropian si emërues, ai do të synojë të bazohet në nocionet e rëndësisë së shkencës dhe përparimit shoqëror, por të jetë i kujdesshëm dhe të mos i identifikojë ato me 'kombin', dhe në vend të kësaj të bëjë me shenjë kah një ide më universale e zhvillimit të përgjithshëm të njerëzimit, gjatë gjithë historisë. Kjo logjikë, për shembull, do të prezantonte personalitetin e Nënës Terezë, jo vetëm nga diskursi i identifikimit me kombësinë e saj, por do të ishte e paraqitur në raport me përdorimin, ku Kosova padyshim zë vendin e parë në botë për hapësira publike, të emërtuara në kujtim të saj. Pra, do të duhej të synojë më tej të kuptojë artefaktet e paraqitura, si pjesë e një procesi të vazhdueshëm të të kuptuarit dhe të të bërit të historisë në vend, si momente statike të një të kaluarë historike tashmë 'të vdekur'. Muzeu i propozuar për Kosovën nuk mendon të heqë dorë nga përgjegjësia për paraqitjen objektive të historisë, për më tepër, ai tenton të reflektojë, me të vërtetë, një natyrë të hapur të të menduarit historik brenda Republikës së Kosovës, në kohën e tashme. Tekefundit, është obligim i qytetërimit bashkëkohor që vlerat kulturore të paraqitën e të prezantohen ashtu si janë e të mos politizohen, duke e pasuruar koloritin e mozaikut kulturor kosovar.

Rasti i studimit 1: Beteja e Kosovës (1389) dhe reagimet - përshtypjet diverse kulturore

Beteja e Kosovës ka ndodhur në qershor të vitit 1389. Luftimi është bërë në Fushën e Kosovës, apo 'Fushën e Mëllenjave', mes

Aleancës së Ballkanit dhe ushtrive turke të Perandorisë Osmane, nën sulltan Muratin I. Beteja përfundoi me fitore të turqve ndaj Aleancës Ballkanike. Në vitin 1989, kur Millosheviqi shkoi në Gazimestan dhe nga aty rifilloi mitin e Kosovës dhe shpalli ‘luftë të mundshme’, para një milion serbësh, burra e gra, lufta iu prezantua popullit në Serbi si opsioni i vetëm. Kjo nënkupton se edhe prezantimi i kësaj ngjarjeje historike, edhe ruajtja e artefakteve lidhur me të, janë të rëndësishë së madhe, por edhe të larmishme kulturore dhe politike. Për shembull, shkrimtari shqiptar, Ismail Kadare, i cili para pak kohësh fitoi çmimin ndërkombëtar “International Man Booker Prize” për romanin *Kronikë në Gur*, shquhet për aftësinë e tij të komentimit mbi krijimin e miteve dhe identiteteve kombëtare nga perspektiva bashkëkohore, nëpërmjet nocioneve të ironisë dhe ndërlojës postmoderniste të perspektivave të ndryshme. Në *Dosja H*, Kadare rrëfen se si Beteja e Kosovës ishte bërë mit nacionalist, baladë në dy gjuhë, e cila bëri heroin epik të njërit komb, armik të kombit tjetër.¹⁴

Së fundi, mund të thuhet se ruajtja e artefakteve që përfaqësojnë të kaluarën e Betejës së Kosovës është shumë me rëndësi, meqë mund të thuhet se kjo ngjarje është në përgjithësi me rëndësi, sa i përket kujtesës së disa prej ngjarjeve kryesore, që kanë formësuar këtë rajon më gjerësisht.

Për këtë arsye, një ekspozitë do të dedikohet për të paraqitur historinë e Betejës së Kosovës. Ekspozita do të shpjegohet në gjuhën shqipe dhe serbe, me disa përkthime anglisht. Koncepti kryesor, prapa kësaj ekspozite, do të jetë gjetja e ngjarjeve të përgjithshme, që çuan deri te Beteja, dhe eksplorimi i asaj se çfarë ndodh nga një shumëllojshmëri perspektivash të ndryshme, që ndërkohë synojnë të paraqesin edhe reagimet e ndryshme bashkëkohore ndaj kësaj ngjarjeje.

Së pari, cikli i këngëve kreshnike si dhe i baladave heroike të Kosovës, do të përfshihet në hapësirën e ekspozitës, që është e rezervuar për reagimet komentimet letrare rreth Betejës, nga perspektiva të ndryshme kulturore. Pas Betejës, e cila kishte zgjatur një ditë, serbët dhe shqiptarët, të mundur, zhvilluan këngët e veta epike për humbjen.¹⁵

¹⁴ White (2004) 25.

¹⁵ Di Lellio (2009) 39.



Miniaturë ruse e Betejës së Kosovës, autori i panjohur, shekulli i gjashtëmbëdhjetë.¹⁶



Manastiri i Graçanicës¹⁷

¹⁶http://upload.wikimedia.org/wikipedia/commons/7/71/Battle_of_Kosovo_1389.

¹⁷https://commons.wikimedia.org/wiki/Wiki_Loves_Monuments_2014_winners#media/viewer/File:Manastir_Gracanica.

Cikli i baladave është i rëndësishëm për serbët dhe mendohet të jetë vepra e parë e poezisë popullore serbe. Megjithatë, është gjithashtu e vërtetë, se janë gjetur këngë, që kanë regjistruar këtë betejë edhe në kulturën shqiptare.¹⁸ Edhe këto do të jenë në dispozicion për t'u lexuar përmes qëndrimit në hapësirën e ekspozitës. Do të ishte e mundshme, që gjithashtu, të vihen në dispozicion regjistrimet e disa prej këtyre këngëve dhe të mund të dëgjohen me kufje nga të pranishmit, me nga një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes, të secilës pjesë. Prezantimi i përfaqësimeve të ndryshme kulturore të Betejës së Kosovës do të ishte ndihmesë drejt reflektimit mbi vlerën e përbashkët kulturore të tolerancës dhe të të qenit të hapur ndaj interpretimeve të ndryshme të së njëjtës ngjarje, dhe synimeve për të çuar përpara vlerënjohtjen e trashëgimisë së përbashkët kulturore.

Së dyti, në hapësirën e ekspozitës, do të jetë një numër pikturash të ngjarjes. Gjithsesi, këto do të jenë piktura nga burime të ndryshme pas Betejës. Për shembull, në ekspozitë do të përfaqësoheshin edhe fotografi të zmadhuara, apo edhe imazhe digjitale të pikturave të rëndësishme të betejës së Kosovës nga këndvështrimi turk. Për shembull, mund të shohim se një pikturë e rëndësishme e Muratit I, nga shekulli i gjashtëmbëdhjetë ruhet në një muze në Turqi.¹⁹ Përfshirja e një pikturë të tillë është me rëndësi, pasi që ajo tregon se ekspozita nuk është duke u përdorur për qëllime të pagdhendura propagandistike, por për të shqyrtuar në mënyrë kritike perspektivat e ndryshme kulturore, që bartin në vete ngjarjet e 1389-s, të cilat kanë jehonë dhe rëndësi edhe jashtë territorit të Kosovës, me vijat e saja aktuale. Murati është figurë e rëndësishme, meqë turqit thonë se ai u vra nga kalorësi Milesh Kopili apo i njohur tek serbët si Millosh Obiliq. Regjistra më të hershëm të kësaj ngjarjeje ka në formë të një letre, të dërguar nga Fiorentina Mbretit të atëhershëm të Bosnjës. Ky tekst do të vihet në dispozicion afër pikturës së Sulltanit, bashkë me regjistrat e ndryshëm të vdekjes së tij nga burime të ndryshme kulturore si dhe tablo të tjera. Gjithashtu, mund të shohim një përfaqësim rus të Betejës, në një miniaturë nga shekulli i gjashtëmbëdhjetë.²⁰ Sërish, kjo tregon se Beteja e Kosovës është e rëndësishme, jo vetëm për serbët e Kosovës në aspektin e të qenit pikë ankorimi për konceptet e identitetit kombëtar, por se ka pasur ndikim

¹⁸ Di Lellio (2009) 4.

¹⁹ http://upload.wikimedia.org/wikipedia/commons/7/75/Murad_I.jpg

²⁰ http://upload.wikimedia.org/wikipedia/commons/7/71/Battle_of_Kosovo_1389.PNG

në të gjithë rajonin. Më tej, ne mund të shqyrtojmë në mënyrë kritike edhe rëndësinë e nocioneve të pavarësisë – diçka që ka rëndësi për Republikën e Kosovës, por që shkon përtej të qenit vetëm në drejtim të shqiptarëve dhe serbëve.

Së treti, mund të shohim gjithashtu rëndësinë e fesë për popullatën e Kosovës, dhe mënyrën në të cilën manastiret historikisht u bënë qendra arti dhe të mësimi. Ideja e përgjithshme do të ishte të kontekstualizohet Beteja e Kosovës përmes tregimit të efekteve të saj në jetën e përditshme. Manastiri i përdorur do të ishte Manastiri i Graçanicës, që është në pikë me gjurmë romake të shekullit 6 pas Krishtit. Vetë ky manastir ka histori interesante, pasi që është ndërtuar dhe rindërtuar në pika të ndryshme gjatë historisë së gjatë, dhe mund të shërbejë si shembull interesant i natyrës së historisë së rajonit, me kundërshtimet e saj dhe luftërat e ndryshme e me rindërtimet (shpeshherë materialet e kohës romake janë përdorur për rindërtime të mëvonshme, edhe në periudhën mesjetare edhe në atë osmane). Ai, më vonë u bë një nga shtëpitë e para të shtypit serb. Ka shumë kartolina të manastirit nga shekulli i kaluar, bashkë me ditarë të shkruar dhe regjistra të atyre që kanë jetuar atje, apo e kanë vizituar. Përfshirja e disa prej këtyre dokumenteve do të ishte me rëndësi nga pikëpamja e eksplorimit të përvojave dhe reagimeve e komenteve të njerëzve të zakonshëm lidhur me një objekt, që ka u mbijetuar sfidave të kohës dhe që ka vazhduar tutje, duke marrë pjesë në zhvillimin e historisë së zonës.

Në përfundim, ngjarjet e Betejës së Kosovës, veçanërisht detajet e tyre, nuk janë gjithnjë të qarta në aspekt historik. Mund të shohim se Beteja ka efekte jashtë rajonit të Kosovës dhe ka efekte edhe në grupe kulturore të tjera, për të cilët beteja u bë rrënja e identitetit të tyre kombëtar. Në frymën e eksplorimit kritik dhe të tolerancës mes grupeve, ekspozita do të shqyrtojë reagimet e ndryshme kulturore dhe kritike ndaj Betejës. Ajo do të përbëhet kryesisht nga burime dytësore (për fat të keq ekzistojnë pak burime parësore të kohës, prandaj mund të konsiderohet mitike), bashkë me disa informacione të drejtpërdrejta faktike për vetë ngjarjet – datat, pajtimet mbi numrin e përfaqësuar, koha, e kështu me radhë. Ajo, gjithashtu do të eksplorojë ndikimin e Betejës së Kosovës në kulturën serbe, veçanërisht në aspekt të ciklit të këngëve epike, por edhe do të synojë të tregojë se janë bërë interpretime të tjera kulturore, dhe se ato janë të rëndësishme për grupet e tjera kulturore. Së fundi, ekspozita do të synojë të zgjatojë reflektimin mbi mënyrën se si Beteja e Kosovës dhe artefaktet nga kjo

periudhë, konsiderohen historikisht të rëndësishme për komunitetin ndërkombëtar, veçanërisht në aspekt të ndërtesave historike dhe veprave të ndryshme të artit.

Rasti i studimit 2: Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, hero i shqiptar (1405-1468) dhe shqiptarja dykrerëshe

Rasti i dytë i studimit eksploron heroin kombëtar shqiptar të shekullit të pesëmbëdhjetë Gjergj Kastriotin - Skënderbeun. Skënderbeu ishte një prijës shqiptar dhe figurë ushtarake që mbrojti nga pushtimi Otoman jo vetëm shqiptarët, por mbarë qytetërimin evropian. Ai është hero qendror në kulturën shqiptare. Madje, thuhet se ka qenë frymëzim me ndikim të madh në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, në vitin 1912.

Pas betejës së Kosovës në vitin 1389, otomanët bënë përpjekje për të kufizuar krijimin e një identiteti të veçantë shqiptar në rajon, posaçërisht duke penguar zhvillimin e traditës së shkruar.²¹ Kjo është një prej arsyeve kryesore të zhvillimit të traditës së fortë orale²² dhe ndërtimit të heronjve të përbashkët, që i ka dhënë shqiptarëve ndjenjë të identitetit, shpresës dhe forcës. Më tej, Bajroni dhe Kockel, (2006:93) pretendojnë se intelektualët shqiptarë tentojnë të mitizojnë figurën e Skënderbeut, për të lidhur Shqipërinë me traditë Perëndimore, folklorin humanist në kundërshtim me të krishterët ortodoksë dhe pranisë myslimane në vend, që prej shekullit të pesëmbëdhjetë. Megjithatë, është po ashtu me rëndësi që të jemi të vetëdijshëm se Skënderbeu, si figurë kulturore, nuk mund të paraqitet në dritë 'neutrale' në hapësirën e muzeut. Ai është shumë i rëndësishëm për një numër të madh të popullsisë, si personalitet historik dhe si hero kombëtar. Prandaj, preferohet qasje kritike, duke u bazuar veçanërisht në burime më bashkëkohore. Për shembull, shkrimtari shqiptar, Ismail Kadare, që njihet për aftësinë e tij të komentimit mbi krijimin e miteve kombëtare dhe të identiteteve nga këndvështrime bashkëkohore, prek mbi nocionet e ironisë dhe bashkëveprimit postmodernist, nga perspektiva të ndryshme. Ekspozita do të synojë të përfshijë disa prej reagimeve, komenteve bashkëkohore të Kadaresë ndaj të kaluarës dhe miteve shqiptare të identitetit kombëtar, në formë të ekstrakteve nga vepra e tij, me qëllim

²¹ Bajron – Kockel (2006) 62.

²² Bajron dhe Kockel (2006) 62-3.

ndërmjetësimit të veprës së një autori të gjallë me popullatën e gjerë të Republikës së Kosovës, siç e kemi përmendur në rastin e parë të studimit.

Skënderbeu është thënë se ka bartur shqiponjën e zezë me dy koka, në vulën dhe flamurin e tij. Ky simbol ka rëndësi historike dhe përdoret aktualisht në flamurin e Republikës së Shqipërisë, me sfond të kuq.²³ Thuhet se buron nga Perandoria Bizantine dhe më vonë është përdorur nga shtete të tjera, veçanërisht Austro-Hungaria.²⁴ Po i njëjti flamur valohej, jozyrtarisht, nga shqiptarët në Kosovë në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. Është përdorur si flamuri i Republikës së Kosovës, të shpallur në vitet e 1990-ta. Shqiptarët mund të arrestoheshin dikur për valim të flamurit shqiptar, për shembull në Maqedoni.²⁵ Republika e Kosovës ka shmangur këtë simbol në flamurin e saj, mbase për të shmangur ndjenjat nacionaliste. Flamuri i tanishëm është blu dhe ka pamjen e territorit të Kosovës, me gjashtë yje, që përfaqësojnë gjashtë grupet etnike e Kosovës .

Pra, mund të shohim se i njëjti flamur është përdorur në mënyra të ndryshme në kohë të ndryshme, me kuptimet, dikur të rezistencës shqiptare ndaj Perandorisë Osmane, dikur të unitetit dhe pavarësisë kombëtare, e deri tek botëkuptime të ndryshme. Ai reflekton përvoja të ndryshme sociale dhe nocione të jetës kombëtare dhe kulturës publike.

Flamujt, në përgjithësi kanë luajtur rol të rëndësishëm në historinë e rajonit, si fontanë pretendimesh, mospajtimi e rezistence. Mund të shohim, po ashtu, se një mënyrë për të bërë gjestin publik të të qenit të hapur dhe tolerant, është krijimi i një flamur të ri për një Kosovë të re. Prandaj, kjo ekspozitë do të bazohet në përdorimet e ndryshme të simbolit të shqiponjës dykrenore, që nga shekulli i pesëmbëdhjetë, duke u përqendruar kryesisht në jetën e Skënderbeut, nocionin e rezistencës dhe të asaj se si është e përfaqësuar kjo nëpër kohërat e ndryshme.

Prandaj, një pjesë e kësaj ekspozite do të jetë zonë interaktive, ku anëtarët e publikut, nga të gjitha grupet kulturore, fetare dhe etnike, në njërën anë do të mund të reflektojnë mbi përvojat e tyre të veçanta dhe përdorimet e flamurit shqiptar, dhe në anën tjetër, mbi reagimet e tyre personale ndaj Skënderbeut. Anëtarët e publikut do të ftohen për

²³ Elsie (2001) 10.

²⁴ Elsie (2001) 140.

²⁵ Clark (2002) 22.

të dhënë reagime përshtypje të shkurtër në kartolinë dhe atë ta vendosin në një tabelë publike. Më tej, muzeu do të bëjë përpjekje aktive për të mbledhur dokumente të ndryshme, si fotografi, shënime ditari e të dhëna anekdotike, me qëllim të eksplorimit të përvojave të njerëzve të zakonshëm nga dora e parë dhe reagimet, përshtypjet rreth përdorimeve të ndryshme të flamurit dhe të vetë simbolit të shqiponjës dykrerëshe. Kjo zonë interaktive arsyetohet me atë se synon të eksplorojë mënyrën se si politika kulturore gjithmonë është e kushtëzuar, është një lloj kontakti i përkohshëm mes grupeve kulturore. Më tej, siç vë në dukje Clavir, “muzetë e kombeve të para kanë mundësi që, në njërin anë, edhe të bëjnë ruajtjen tradicionale, dhe të tentojnë të sigurojnë një të ardhme produktive, përmes “zgjerimit të marrëdhënieve bashkëpunuese, duke nderuar njerëzit dhe diversitetin e tyre”.²⁶

Pjesa e dytë kryesore e ekspozitës do të eksplorojë Skënderbeun ashtu siç është paraqitur ai, që nga shekulli i pesëmbëdhjetë dhe do të synojë prezervimin e kësaj. Çka është me rëndësi, kjo përfshinë piktura dhe përshkrime, si dhe tregime nga tradita shqiptare. Më tutje, mund të shohim se Skënderbeu ishte frymëzimi për një operë të kompozitorit Italian, Vivaldi, rreth vitit 1718. Një incizim i kësaj vepre do të ishte në dispozicion për t’u dëgjuar në ekspozitë, me qëllim që të tregojë mënyrat e ndryshme të reagimeve ndaj të kaluarës së përbashkët. Ekspozita, gjithashtu, do të eksplorojë Skënderbeun si hero të krishterimit. Për shembull, Skënderbeu është admiruar edhe nga të krishterët e shekullit pesëmbëdhjetë për rezistencë ndaj turqve. Atij i ishte dhënë titulli “Atlet i Krishtit” nga Papë Kaliksti III.²⁷ Kjo e bën atë simbol edhe më universal të rezistencës ndaj pushtimit të huaj, se që mund të kuptohet nga vështrimi i tij si, vetëm hero kombëtar shqiptar.

Siç është thënë, situata në Republikën e Kosovës është akoma në njëfarë mase delikate dhe assesi nuk është e qartë se çka nënkuptohet me nocionin kulturë e përbashkët kombëtare, apo me nocionet tradicionale të ruajtjes, në aspekt të së kaluarës së përbashkët. Prandaj, janë zgjedhur dy raste studimi për t’i ilustruar edhe vështirësitë, edhe mundësitë e prezantimit të së kaluarës, në shërbim të reflektimit mbi identitetin kombëtar në Republikën e Kosovës.

²⁶ Clavir (2002) 249.

²⁷ Elsie (2001) 122.

Mosha tepër e re e muzeve publikë në Republikën e Kosovës dhe nevoja për të qenë kritikë ndaj çdolloj burimi historik

Për dallim prej rastit të përshkruar dhe të paraqitur nga Louenthal dhe Binney e të tjerë në Britani,²⁸ në kohët e shkurtimeve të mëdha të shpenzimit publik dhe zhvendosjes së përgjithshme drejt marketizimit, veçanërisht në aspekt të ruajtjes kombëtare dhe muzeve publikë, mund të themi se e kaluara, me të vërtetë, është bërë me rëndësi politike të shtuar dhe të thellë në Republikën e Kosovës. Këtu, e kaluara është ende objekt kontesti i thellë, i cili zhvendos rolin e muzeut publik dhe të vetë politikës kulturore. Louenthal dhe Binney et.al. (1981:120) ishin pjesë e diçkaje që mund të tematizohet si 'lëvizje prezervacioniste' në Britani, dhe ata ishin të preokupuar gjerësisht me atë se rritja dhe zhvillimi i shpejtë i bërë nga Qeveria Konservatore e atëhershme po shkatërronte artefakte dhe zona të rëndësishme historike të vendit. Qeveria shfaqte qëndrim jorespektues ndaj aspekteve të caktuara të prezervimit. Prandaj, autorët i hynë njëlloj projekti, të themi, 'ruajtjes' së të kaluarës.

Roli i të kaluarës, posaçërisht në Kosovë, nuk ka se si të jetë më i ndryshëm. Këtu, e kaluara nuk është si një shtet që duhet të shpëtohet apo hulumtohet, por më shumë si një vend që duhet të krijohet. Me të vërtetë, mjediset e jetuara, artefaktet lokale dhe objektet në territorin e Kosovës kanë mbijetuar shekuj luftërash, ndryshime udhëheqësish politike, fesë, domethëniesh ndryshuese kulturore, asociimesh personale dhe nocionesh të identiteteve kombëtare. Prandaj, roli i muzeve publikë në këtë rast nuk është i njëjti si me atë të Britanisë së shekullit të nëntëmbëdhjetë apo të Britanisë në vitet 1980. Kjo do të thotë se është me rëndësi të kuptohet ajo se si kanë lindur dhe janë zhvilluar muzeu publik dhe qëndrimet ndaj të kaluarës, që kanë ndihmuar këtë krijim, por se ato assesi nuk diktojnë apo kufizojnë të ardhmen e mundësive të muzeve publikë, si jashtë Britanisë, ashtu edhe, mbase brenda saj. Prandaj, muzetë publikë në Republikën e Kosovës nuk mund të reflektojnë status quo-në ashtu-kështu të pranishme, meqë nuk ka fare të tillë – apo nuk ka sens të qartë të identitetit të përbashkët kombëtar, brenda Republikës. Në vend të kësaj, duhet të përpiqet që në njërin anë të ruhen artefaktet e rëndësishme, historike në përgjithësi, ndërsa në anën tjetër, të

²⁸ Louenthal - Binney et.al. (1981) 60.

krijohet hapësira për krijimin e një sensi të ri të identitetit të përbashkët dhe historisë së përbashkët mes vetë individëve.

Summary

National Identity and Museums

The need to develop national histories specifically during the nineteenth century was a general consequence of the huge economic, social and political upheavals that characterized the beginning of the modern period in Europe. Through presenting a shared national past, social groups with significantly different or even opposing economic and political interests could share a common national identity. In this sense, whilst individual cultural taste is always personal, culture itself is both political and historically contingent. It differs in different societies at different times and in different places.

Nevertheless, defining and presenting the past has culturally been complex and very important function in both personal and public life. Institutions that preserve and present the past and national identity on the part of the people or nation – such as museums – are thus profoundly political. The function of national museums has been to display national histories which often have been constructed with the specific purpose of galvanizing national identity and thus justifying the current social and political order (Miller Lane, 2000). In contemporary times, however, there is an open question about the meaning of national identity and who controls it; more importantly, a genuine issue arises for first nations embarking on a project of defining their own national identity and developing national museums accordingly.

Nowadays, the project of developing national identities and shared histories could be drafted differently. For one, national museums might seek to go beyond simply legitimizing the current social and political order; for two, we might be more aware of the positive aspects of cultural differences between different social groups. In line with recent research, the national museum proposed for the Republic of Kosova could aim to focus not on simply legitimizing the current political order or instilling feelings of patriotism *per se* as often aimed for by museums historically. But – and more in line with the theory underlining the idea of a republic and recent research – choose to explore notions of citizenship and shared culture and history in a more critical and self-reflective manner. Rather than taking the traditional models of the European historic museums, it shall aim to draw on notions of the importance of science and social progress, but be careful not to identify these with ‘the nation’ and rather point to a more universal idea of the general development of humanity throughout history. It will further seek to understand the artifacts presented as part of an ongoing process of understanding and making history, rather than as static moments in an already ‘dead’ historical past. The Museum of Kosova should not seek to abdicate responsibility for presenting history as objective; rather, it should strive on the one hand to preserve important historical artifacts in general; but on the other, to create a space for the creation of a new sense of common identity and shared history amongst individuals themselves.

Bibliografia

- Ante, A. (2010). Shtetndërtimi dhe Zhvillimi: Dy anë të të njëjtës monedhë? Shtjellim i rastit të Kosovës. Disserta Verlag.
- Anscombe, Frederick F. (2006). Perandoria Otomane në politikat e fundit ndërkombëtare - II: the case of Kosovo. *Rishikim i Historisë Ndërkombëtare* 28 (4) 758-793
- Clavir, M. (2002). Ruajtja e Asaj që Vlerësohet: Muzeu, Konservatori dhe Kombet e Para. Vankuver, Toronto: UBC Press
- Clark, H. (2002). Kosova, në punim e sipër: përmbyllja e ciklit të dhunës. Angli: Coventry
- Di Lellio, A. (2009). Beteja e Kosovës, 1389, Ep Shqiptar. Londër: I.B. Tauris.
- Elsie, R. (2010). Fjalor Historik i Shqipërisë. Uegen, Tirana 2011 .
- Hariman, R. Lucaites, J.L. (2007). S'ka nevojë për mbishkrim: fotografitë ikonike, kultura publike, dhe demokracia liberale. Chicago: University of Chicago Press.
- Kohl, P.L. dhe Fawcett, C.P. (1995). Nacionalizmi, politikat dhe praktika e arkeologjisë. Kembrixh: Cambridge University Press.
- Kostovicova, D. (2005). Kosova: politikat e identitetit dhe hapësirës. Londër: Routledge.
- Lowenthal dhe Binney, M. (eds.). (1981). E kaluara jonë para nesh: Pse e ruajmë atë? Londër: Maurice Temple Smith Limited.
- Macloed, S. dhe Watson, S.E.R. (2007). Revolucione muzesh: si ndryshohen muzetë dhe ndryshimet. Londër: Taylor dhe Francis.
- Reginald Byron, R. dhe Kockel, U. (2006). Negociimi i kulturës: zhvendosja, përzierja dhe kujtesa në Europën bashkëkohore. LIT Verlag Münster.
- White, Anne (2004) 'Kosova, identiteti etnik dhe "kalimet kufitare" në Dosjen H dhe novela tjera të Ismail Kadaresë,' tek Peter Wagstaff (ed.), *Kalimet Kufitare: Hartimi i Identiteve në Europën Moderne* (Bern: Peter Lang, 2004), f. 23-54.
- Wachtel, A. (1998). Të bësh shtet, të thyesh shtet: letërsia dhe politika kulturore në Jugosllavi. Stanford: Stanford University Press.
- Warrender, G. and Knaus, V. (2008). Brandt Travel Guides: Kosovo.

Burimet në internet

- Historia e Muzeut Britanik. Gjetet në:
http://www.britishmuseum.org/the_museum/history_and_the_building/general_history.aspx [Marrë më: 10 dhjetor 2010].
- Encyclopedia Britannica në internet, Gjetet në:
<http://www.britannica.com/EBchecked/topic/322736/Battle-of-Kosovo> [Marrë më 12 dhjetor 2010].
- Histori e shkurtër e Kosovës. Gjetet në:
<http://lamar.colostate.edu/~grjan/kosovohistory.html> [Marrë më 12 dhjetor 2002].
- Serbët shënojnë përvjetorin e Betejës së Kosovës të vitit 1389, Radio Europa e Lirë. Gjetet në:
<http://www.rferl.org/content/article/1077370.html> [Marrë më 12 dhjetor 2002].
- Deputetët e Kosovës shpallin pavarësinë, BBC Online, 17 shkurt 2008. Gjetet në:

<http://news.bbc.co.uk/1/hi/7249034.stm> [Marrë më 11 dhjetor 2002].

Kosova shpall pavarësinë nga Serbia, nga Dan Bilefsky, Neë York Times, 18 shkurt 2008. Gjendet në:

<http://www.nytimes.com/2008/02/18/world/europe/18kosovo.html?pagewanted=print> [Marrë më 11 dhjetor 2002].

Fantazmat e Kosovës, nga Beth Kampschor, Archeology.org, korrik/gusht 2007.

Gjendet në: <http://www.archaeology.org/0707/etc/kosovo.html> [Marrë më 12 dhjetor 2002].

Beteja e Kosovës, këngë epike serbe. Gjendet në:

http://www.kosovo.net/history/battle_of_kosovo.html. [Marrë më 12 dhjetor 2002].

Anton VUKPALAJ, Prishtinë

BAJRAKU, INSTITUCION POLITIKO - ADMINISTRATIV OSMAN NË AMBIENTIN E ALPEVE SHQIPTARE

KDU 94(496.).071

Abstrakt

Ky artikull ka të bëjë me administrimin osman të fiseve malësore të Shqipërisë së Veriut përmes institucionit të bajrakut. Bajraku simbolizon institucionin e parë politiko-administrativ osman në këto treva dhe si i tillë ka luajtur rol kyç në organizimin politik dhe administrative të fiseve malësore. Ai do të sjellë ndryshime, sa i përket organizimit politik dhe raportit të popullsisë malësore me shtetin, por edhe sa i përket organizimit administrativ, sepse ai bën një ndarje të re territoriale, e cila nuk përputhet me ndarjet tradicionale fisnore. Bajraku do të udhëhiqet nga një bajraktar (flamurtar), detyra e të cilit do të jetë të organizojë furnizimin e ushtrisë osmane me ushtarë në kohë lufte. Në këmbim, bajraktari do të gëzojë disa privilegje dhe do të performojë shpesh edhe punë administrative. Në këtë artikull është studiuar bajraku në kuadrin politiko-administrativ osman dhe janë trajtuar disa nga karakteristikat kryesore të këtij institucioni, si dhe disa aspekte të evolucionit të tij gjatë shekujve.

Fjalët çelës: *bajraku, Alpet shqiptare, institucion, bajraktar, administratë, osman, timar*

Bajraku institucion politiko-administrativ osman në ambientin e Alpeve shqiptare

Ndarja e Malësisë së Mbishkodrës në bajraçe, shënon një formë të veçantë të qeverisjes së këtij territori malor të organizuar në fise.¹ Disa autorë e kanë konsideruar këtë organizim si një konfederatë të lirë fisesh.² Edhe pse nuk dihet me saktësi se kur është vendosur sistemi i bajraçeve në Malësi, shkrimet e para, të cilat i përmendin bajraçet, datojnë nga fundi i shekullit XVII, pas luftës së gjatë

¹ ZICKEL, Raymond E. , IWASKIW, Walter R., (1994), *Albania: A Country Study*. Front Cover. Federal Research Division, Library of Congress, faqe 263.

² SCHON, Robert & GALATY, Michael L. (2006), "Diachronic Frontiers: Landscape. Archaeology in Highland Albania", *Journal of world-systems research*, XII, 2, 231-262, faqe 231. <http://www.jwsr.org/wp-content/uploads/2013/03/jwsr-v12n2-sandg.pdf>

osmane-perëndimore, 1683-1699.³ Disa burime të tjera e vendosin atë edhe më herët⁴. Kjo periudhë historike e vendosjes së bajraqeve përputhet edhe me dështimin e ekspeditave osmane, për të shtrirë sistemin e timareve, që shekuj me radhë ka shërbyer si sistem i shkrires së shoqërive të organizuara në fise. Nga shekujt XV-XVII, timari ishte institucion dominues në qeverisjen e territoreve ballkanike.⁵ Në fund të shekullit XVII, osmanët i shndërrojnë timaret në çifligje. Çifligu do të jetë institucion feudal i bazuar mbi një kontratë, ku subjekteve të çifligjeve u jepet një pjesë e prodhimit të tyre.⁶

Në momentin e vendosjes së bajrakut si institucion, ambienti alpin shqiptar, i kishte të gjitha karakteristikat e një shoqërie mesjetare. Ajo ka qenë e organizuar në segmente, ku ka dominuar organizimi fisnor dhe trashëgimia mbi bazën e Kanunit. Në pamundësi për ta nënshtruar, Perandoria osmane e mbante atë nën kontroll përmes sulmeve ushtarake, të cilat, edhe pse nuk kanë arritur kurrë ta nënshtrorin, kanë pasur për efekt që ta pengojnë organizimin e saj. Si pasojë, këto sulme kishin si qëllim varfërimin ekonomik dhe zvogëlimin e numrit të meshkujve, të dëmtuar në luftëra. Qëllimi ishte që të pengohet organizimi në njësi me të larta.⁷ Për këtë arsye, institucioni i bajrakut duhet të konsiderohet, para së gjithash, si një aftësi e fiseve malësore, që të negociojnë një nënshtrim politik të limituar.⁸

Lashtësia e imponimit të bajrakut si institucion dhe vendosja e tij me trashëgimi ka bërë që ky institucion të krijojë identitet dhe premisa, të cilat e bëjnë të konsiderohet si autokton, duke e harruar

³ ULQINI, Kahreman (2002), *Bajraku në organizimin e vjetër shoqëror*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 20.

⁴ HASLUCK, Margaret (1954), *The Unwritten Law in Albania*. Cambridge: Cambridge University Press.

⁵ Vështirësinë e vendosjes së sistemit të timareve në sanxhaqet shqiptare e tregon fakti se në vitin 1533, nga 2000 timare që ekzistonin në Sanxhaqet e Vlorës, Ohrit, Elbasanit, Prizrenit, Vushtrrisë dhe Shkodrës, 683 nga ata (34%) i takonin Sanxhakut të Vlorës kurse ai Shkodrës numëronte vetëm 188 timare (9%). Shih: *Historia e popullit shqiptar* (2002), I, Tiranë, f. 657-668.

⁶ Atyre u jepet gjysma e prodhimit kur furnizojnë vetë mjetet e punës dhe kafshët të cilat nevojiten për të punuar tokën. Kur ata sigurojnë vetëm forcën punëtore, marrin vetëm një të tretën e prodhimit. Shih: BACKER, Berit (2003), *Behind Stone Walls*, Dukagjini Balkan Books, f. 62.

⁷ BOEHM, Christopher (1984), *Blood Revenge, The enactment management of conflict in Montenegro and Other Tribal Societies*, University Press of Kansas, f. 10.

⁸ Ibid.

originën e tij të vërtetë. Për këtë arsye, para se të analizojmë bajrakun nga brenda dhe ndryshimet, të cilat ai i ka sjellë, duhet ta vendosim atë në kornizat politiko-institucionale osmane dhe të shpjegojmë se cilat janë specifikat e këtij institucioni, në raport me institucionet tjera osmane. Qëllimi është të kuptojmë se pse osmanët krijojnë një institucion të tillë dhe sa ai përputhet me logjikën politike dhe administrative osmane? Kjo duhet bërë edhe për shkak se bajraku është institucion i cili, si i tillë, nuk ka ekzistuar në vende të tjera, nën kontrollin osman. Një analizë e shkurtër e organizimit administrativ osman do të na ndihmojë që ta kuptojmë pozitën e këtij institucioni në këtë kontekst organizativ. Në një fazë tjetër, do ta analizojmë bajrakun si institucion politik lokal dhe do të tentojmë të shpjegojmë se cili ka qenë raporti i bajraktarit me bajrakun e tij dhe, cilat kanë qenë ndryshimet, të cilat ai i ka sjellë.

Pra, disa parametra duhet të merren parasysh në analizën dhe studimin e institucionit të bajrakut. Në rënd të parë, reformat politike dhe administrative të Perandorisë Osmane. Në veçanti, duhet të përmendim reformën e Tanzimatit, të adoptuar në pjesën e dytë të shekullit XIX, e cila bën një riorganizim territorial. Vilajetet shqiptare të cilat krijohen me këtë reformë kishin për qëllim të bëjnë përzierjen e shqiptarëve me popujt e tjerë, dhe të kundërshtojnë organizimin në baza kombëtare i cili në atë kohë ishte në një fazë embrioni. Te fiset e organizuara në bajraçe, kjo kohë shënon fillimin e shumëfishimit të bajraqeve, si mënyrë për të krijuar konflikte brenda kësaj shoqërie dhe për ta shkriur atë në administratë të zakonshme. Për këtë arsye, një ndër vështirësitë kryesore për të kuptuar këtë institucion është, që fillimisht duhet ta kuptojmë diakroninë e tij dhe ndryshimet, të cilat i ka pësuar brenda dhe jashtë.⁹

Në këtë kontekst evolutiv, bajraku duhet të analizohet nga aspekti i konvertimit të popullsisë në islam. Progresivisht, ky konvertim do të modifikojë natyrën e këtij institucioni te ato bajraçe, të cilat konvertohen. Për tre shekuj të ekzistencës së tij, bajraku është transformuar nga një institucion ushtarak, në një institucion politiko-administrativ, para se të shkrihet në administratën osmane. Në disa regjione, ai do të vazhdojë të luajë rol simbolik gjatë pas tërheqjes osmane.

⁹ STAVRIANOS, L. S.(1958), *The Balkans since 1453*. Holt, Rinehart dhe Winston, New York, faqe 101.

Institucioni i bajrakut në sistemin politiko-administrativ osman

Literatura e fokusuar në organizimin politiko-administrativ osman i klasifikon institucionet politike dhe administrative osmane të ndara në “institucione qeverisëse” dhe “institucione myslimane”.¹⁰ Institucionet qeverisëse janë përbërë nga Sulltani dhe të afërmit e tij, administrata civile dhe ushtria, kurse institucionet myslimane, nga administrata fetare.¹¹ Mirëpo, për një kohë të gjatë, funksionet “ekzekutive” dhe “administrative” janë kryer nga administratat civile dhe ajo fetare së bashku. Vendosija e institucioneve politike dhe administrative në territoret e dominuara me shekuj është bërë nga të dy këto administrata. Historiani, Kemal Karpas, bën një diferencë ndërmjet “njerëzve të shpatës”,¹² që kanë qenë ushtarët dhe “njerëzve të shkrimit”,¹³ të cilët kanë qenë klerikët fetarë dhe administrata fetare. Madje, pjesëmarrja e klerikëve në vendosjen e administratës hershme osmane, është bërë përmes dervishëve, pak a shumë heterodoks, të cilët shoqëronin progresionin politik osman në Evropë. Bektashianët kanë qenë avangarda e shtrirjes osmane në Evropë.¹⁴

Një ndër studiuesit më të njohur bashkëkohor të perandorive, Michael W. Doyle, në librin e tij *Perandoritë*, e klasifikon Perandorinë osmane në grupin e “perandorive tribale” (fisnore). Doyle thotë se ajo është krijuar nga grupe tribale turkomane (Selxhuk, Osmanli etj.) në shekullin XI, të cilat kanë filluar ta sulmojnë Bizantin që në atë kohë ishte para shkatërrimit.¹⁵ Ai pohon se kjo karakteristikë “tribale” e kësaj perandorie do të manifestohet për një kohë të gjatë edhe në vetë organizimin politik dhe administrativ të Perandorisë Osmane.¹⁶ Përkundër perandorive tjera, kjo perandori nuk ka filluar me një metropol të centralizuar të fuqishme, e cila ia impononte forcën e vet periferisë. Kjo perandori nuk ka pasur asnjë model ekonomik uniform, të shtrirë mbi gjithë periferinë e vet. Për këtë arsye, territoret periferike të subordinuara të pushtetit qendror, nuk i

¹⁰ LYBYER, Albert Howe (1913), *The government of the Ottoman empire in the time of Suleiman the Magnificent*, Harvard, Harvard University Press.

¹¹ Ibid.

¹² KARPAS, Kemal (1968), *Political and Social Thought in the Contemporary Middle East*, London, f. 72.

¹³ Ibid.

¹⁴ BALIVET, Michel (1992), Aux origines de l'islamisation des Balkans ottomans. In: *Revue du monde musulman et de la Méditerranée*, N°66, f. 14.

¹⁵ BOYLE, Michael W (1986), *Empires*, Cornell University Press, f. 105.

¹⁶ Ibid.

kanë pasur të njëjta të drejta dhe të njëjtat obligime.¹⁷ Kjo është manifestuar me një nivel të ulët të politikave të homogjenizuese të komuniteteve nën dominimin e saj. Historiani, Robert Mantran, e konsideron këtë « më shumë si një burim politik sesa si një dobësi ».¹⁸ As pushteti periferik nuk ka qenë gjithmonë osman. Vizirët, si përfaqësues të lartë të portës, p.sh., nuk kanë qenë të gjithë me origjinë turke.¹⁹ I vetmi nivel politik-administrativ, i cili ka qenë osman është niveli i pushtetit qendror, ku sulltanët kanë praktikuar një politikë sistematike të burokratëve dirigjues, me sekuestrime nga grupet minoritare dhe me përdorimin e sklllevëve në aparatet administrativ dhe ushtarak. Ata kanë pasur një politikë të pushtetit të bazuar mbi afërsinë e shërbëtorëve të Portës me Sulltanin. Përfaqësuesit e Sulltanit zgjidhnin disa mijëra të rinj të krishterë, çdo 3-7 vjet, të cilët i sillnin në Stamboll dhe i konvertonin në myslimanë. Atyre, që dalloheshin për nga kapacitetet e tyre intelektuale dhe fizike, u ofrohej një edukatë, e cila i bënte shërbyes të kompletuar të shtetit. Madje, disa nga ata dërgoheshin në një shkollë brenda Pallatit mbretëror. Ashtu, sikur shumica e perandorive ushtarake, Perandoria Osmane ka praktikuar sistemin e formimit të fisnikëve të shtetit me një politikë poshtë-lart (*bottom-up*). Një numër i personave të sekuestruar (skllav), emërtoheshin funksionarë të aparatit shtetëror dhe nuk mund të shiteshin më si skllavë. Ky sistem i mundësonte Sulltanit që të jetë i rrethuar me persona të cilët ishin borxhli total të tij. Si pasojë e këtij sistemi, Sulltani kishte të drejtë absolute mbi jetën dhe vdekjen e tyre dhe, në rast se ata e kundërshtonin, kishte mundësi t'u merrte atyre çdo garanci juridike.

Këtë sistem të formimit të burokratëve shtetëror e analizon edhe Makiaveli, i cili thotë se “e gjithë monarkia e turkut është e qeverisur nga një shef, të tjerët janë shërbëtorët e tij dhe, duke e ndarë mbretërinë e tij në Sanxhaqe, dërgon administratorë të ndryshëm të cilët i emëron dhe i zëvendëson sipas dëshirës së tij”.²⁰ Makiaveli insiston në faktin se, në raport me Sulltanin, shefat osmanë janë të gjithë “edhe skllav, edhe të obliguar”, mirëpo, populli nuk ka besnikëri ndaj tyre. Në nivelin lokal, nuk është me rëndësi që

¹⁷ COLAS, Dominique (1994), *Sociologie Politique*, Presse Universitaire de France, Paris, f. 516.

¹⁸ MANTRAN, Robert (1989), dir. *Histoire de l'Empire ottoman*, Paris, Fayard, ff. 227-264.

¹⁹ Berit Backer numeron 11 vizir të mëdhenj Shqiptarë, shih: BACKER, Berit, op. cit. f. 65.

²⁰ COLAS, Dominique, *Sociologie Politique*, op.cit., f. 517.

funksionarët e Sulltanit të përfitojnë nga një ndjenjë besnikërie nga të administruarit e tyre: ajo që është me rëndësi është besnikëria e tyre ndaj sulltanit dhe që ata të arrijnë të bashkojnë sa më shumë haraç, qoftë edhe nëpërmjet vetorganizimit të komuniteteve, për të cilat janë përgjegjës. Kjo do të ketë pasoja edhe sa i përket organizimit politik dhe administrativ të Perandorisë, sepse, për një kohë të gjatë, vetëm provincat qendrore do të kenë organizim shtetëror dhe vetëm ato do të jenë të nënshtruara pushtetit qendror. Provincat periferike do të konservojnë strukturat e tyre parashtetërore dhe autonominë e tyre. Kjo situatë rezulton nga faktorë të shumtë, prej të cilëve duhen përmendur: mungesa e teknikave të menaxhimit të hapësirave, heterogjeniteti etnik dhe kulturor, i cili nuk mund dominohej etj.

Këtë mungesë të organizimit të shtetit në provinca periferike, osmanët e kompensojnë me vendosjen e sistemit të timarit. Timaret vendosen në vende të ulëta. Për më shumë se tre shekuj, timari ka qenë një prej shtyllave të administrimit të Perandorisë Osmane. Në momentin e shpërbërjes së këtij institucioni, sanxhaqet shqiptare kanë numëruar më shumë se 2000 timare. Timari ka qenë një lloj koncesioni territorial që i jepej një kalorësi, i cili duhej të luftonte dhe të furnizonte një kontingjent luftëtarësh.²¹ Në raport me pushtetin qendror dhe institucionet tjera, timari ka pak autonomi. Timariotët, të cilët ndryshe quheshin Spahi, kanë pasur për detyrë të administrojnë një territor të caktuar dhe të bashkojnë tatimet. Mirëpo, kjo e drejtë mund t'u merrej atyre. Timari si koncesion ka qenë personal dhe, pas vdekjes së përfituesit, ai nuk u jepej në trashëgimi fëmijëve të tij.²² Madje, gjatë karrierës së tij, një përfitues mund t'i jepeshin timare me vlera të ndryshme, varësisht nga avancimi i tij. Kjo ndodh për arsye se pasuria ose pozita sociale nuk trashëgoheshin, dhe ato mund të arriheshin vetëm me mirënjohje dhe merita. Evolucionin në pozita sociale shënohej me shpërndarje të titujve *vizir* ose *agë*. Shërbimi ushtarak ka qenë element kyç për të avancuar në hierarki.

Ky sistem i mundësonte Portës mirëmbajtjen e kalorësve lehtë të organizuar në baza provinciale. Shkaku pse timari ka pasur një rol të rëndësishëm për Portën është se, për një kohë të gjatë, timariotët kanë formuar shumicën e ushtrisë osmane. Ushtria si institucion qendror i shtetit osman, nuk ka mundur të organizohej mbi baza tribale, ashtu

²¹ BALDICEANU, Nicolae (1980), "Le timar dans l'Etat ottoman (debut XIV-debut XVI siecle)", Wiesbaden, O. Harrassovitz, f. 747.

²² HADZIBEGIC, Hamid, HANDZIC, Adem, KOVACEVIC, Esref (1972), *Oblast Brankovica: Opsirni katastarski popis is 1455 godine*, Sarajevë.

siç kanë qenë bajraquet. Organizimi ushtarak mund të jetë funksional vetëm nëse organizohet në bazë të hierarkisë. Për këtë arsye, shumica e timariotëve kanë qenë oficerë të Portës ose funksionar. Në disa raste, timari i është dhënë edhe ndonjë kleriku, por asnjëherë kryetarëve të fiseve. Kjo është edhe arsyeja pse timari konsiderohet si institucion, i cili ka pasur për qëllim thyerjen e sistemit të fiseve, si e vetmja mënyrë për të siguruar nënshtrimin ndaj hierarkisë. Sistemi i timareve trashëgon tek bajraku raportin që e ka pasur timarioti me Portën. Si person i dalluar, timarioti shtynte rajën, pjesën e popullsisë, e cila i paguante taksa shtetit turk, por nuk merrte pjesë në qeverisje që të punonte tokën dhe që të jetë pjesë e ushtrisë osmane në kohë lufte.

Mirëpo, në zonat malore të Shqipërisë së sotme (në Alpet e Mbishkodrës), osmanët kurrë nuk e arrijnë këtë thyerje të homogjenitetit fisnor. Kjo është edhe arsyeja pse bajraku imponohet pas dështimit të vendosjes së timarit. Bajraquet nuk mund të shndërrohen në koncesione sepse bajraktari, në krahasim me timariotin, nuk ka kurrfarë të drejte detyruese ndaj pronarëve të tokave mbi territorin, të cilin ai e udhëheq.²³ Pastaj, vendosja e bajrakut me njohje të drejtës së trashëgimisë, e bën të pamundur për bajraktarin që të lëvizë nga një bajrak në tjetrin. Familjet e bajraktarëve akumulojnë dhe trashëgojnë pushtet të vazhdueshëm. Njëkohësisht, trashëgimia e bën të pamundur ngritjen e bajraktarit në hierarki të Perandorisë ose të evoluojë në grada tjera. Mirëpo, si shpërblim, vendosja me trashëgimi e bën të pamundur shkarkimin e bajraktarit. Siç e pamë, timarioti mund të shkarkohej në çdo kohë nga administrata qendrore, ose t'i jepej atij një koncesion tjetër. Pamundësia e shkarkimit të bajraktarëve do të bëjë që, prej momentit që sistemi i bajraqeve bëhet pengesë për të reformuar administratën (fundit i shekullit 19), osmanët fillojnë të shumëfishojnë numrin e bajraktarëve, me qëllim që të krijojnë konfuzion dhe përçarje.

Bajraku si niveli më i ulët administrativ

Në fund të shekullit 17 dhe në fillim të shekullit 18, osmanët bëjnë reformat e para për të përmirësuar sistemin administrativ, shërbimin ushtarak, reformën e gjykatave dhe dhënien e një statusi politik, subjekteve të krishtera dhe atyre hebre. Kjo politikë e hapjes

²³ BOJANIC, Dusanka (1973), *Fragmenti zbirnog popisa Vidinskog sandaka iz 1466 godine*, in Mesovita Grada Beograd, f. 5.

ndaj komuniteteve jomyslimane duhej të figuronte edhe në vetë strukturat administrative. Një pjesë e këtyre institucioneve, të cilat gjendeshin nën nivelin e sanxhaqeve, do të bëhen me “këshille”. Këta “këshilla”, do të jenë të përbërë nga zyrtarë të emëruar, liderë fetarë lokalë myslimanë dhe jomyslimanë dhe anëtarë të tjerë të zgjedhur nga një sistem indirekt për të përfaqësuar popullatën lokale. Këshillat kanë qenë risi dhe në kuptim të dhënies popullatës jomyslimane, kishin rol më të madh në qeverisje, edhe pse në përgjithësi, ato çështje do të vazhdojnë të dominohen, pak a shumë, nga ata që kanë dominuar deri atëherë. Gradualisht, duke akumuluar një numër të madh të kompetencave, si në sistem administrativ ashtu edhe atë juridik, këshillat do të bëhen ndër kontrolluesit më të mëdhenj të pushtetit të përgjithshëm të shefave të njësive administrative. Ato mund të konsiderohen si një hap i rëndësishëm drejt integritit të popullsisë lokale në vendimmarrje.

Në strukturën organizative osmane, njësia më e lartë administrative ka qenë vilajeti (turq. *Elayet*). Vilajetet - lloje regjionesh të sotme moderne, kanë qenë të qeverisura nga një guvernator (*Vali*). Nën nivelin e vilajetit ka qenë sanxhaku (turq. *liva*) i cili ka pasur madhësinë e një province.²⁴ Në fazën e fundit të Perandorisë Osmane, vilajeti i Shkodrës përbëhej nga dy sanxhaqe: ai i Shkodrës dhe i Durrësit. Për një kohë të gjatë, sanxhaqet kanë qenë të udhëhequr nga një sanxhakbeg, i cili kishte një autonomi të caktuar. Me reformën e Tanzimatit, në pjesën e dytë të shekullit 19, ata u zëvendësuan me një lloj prefekti të quajtur *mutesarif*, i krijuar sipas modelit francez të administratës, i cili përcaktohej nga burokracia shtetërore qendrore.²⁵ Sanxhaku është një ndër institucionet më të vjetra osmane, që është krijuar në shekullin 14. Sanxhaqet nuk kanë pasur status të njëjtë në të gjitha vendet e Perandorisë. Në disa sanxhaqe, shefat e tyre kanë pasur në dispozicion një forcë ushtarake e

²⁴ Sanxhaku nuk ka qenë gjithkund i organizuar njësoj. Disa sanxhaqe kanë qenë relativisht të pavarura dhe nuk kanë qenë të varura nga vilajetet, por drejtpërdrejt nga qeveria osmane qendrore. Shkaqet kanë mund të jenë të ndryshëm. Afërsia me Stambollin ose rëndësia e regjionit në pyetje. Ka pasur edhe “sanxhaqe të privileguara” ose “provinca autonome” (turq. *eyalat-i mumtaze* ose *muhtare*) – siç ka qenë ai i Egjiptit ose i Rumelisë së Lindjes, të cilat kanë qenë vetëm nominalisht nën kontrollin e Perandorisë. Shih : JELAVICH, Barbara (1983), *History of the Balkans: Eighteenth and Nineteenth Centuries*, Cambridge, Cambridge University Press, f. 57.

²⁵ Mbi ndarjen e Gadishullit ballkanik, si njësi e vetme administrative shih: JELAVITCH, Barbara, *History of the Balkans...*, op. cit.

cila, së bashku me një grup burokratësh, kanë bashkuar tatimet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në sanxhaqet e tjera, autoritetet osmane kanë bashkuar tatimet, duke u bazuar mbi një numër ndërmjetësuesish. Përveç kësaj, çdo sanxhak ka pasur sistemin e vet ligjor, të bazuar mbi respektin e traditave lokale. Traditat respektoheshin deri në atë masë, sa që e lejonte nënshtrimi ndaj Perandorisë dhe Islamit.

Varësisht nga koha dhe nga reformat administrative, nën nivelin e Sanxhakut, ka pasur edhe dy nivele të tjera administrative: Kazatë (turq. *Kazas*)²⁶, lloj bashkish të udhëhequra nga një Kajmekam (turq. *ka imakan*) dhe Nahijet (turq. *Nahiyes*)²⁷, lloj nën-distriktesh, në krye të të cilëve gjendej një shef i quajtur Muhtar (turq. *Mudir*). Kazatë, si njësi administrative në nivelin e sanxhaqeve, kanë qenë sinonim me qytetet e sotme. Kazaja ka qenë nivel administrativ osman, i udhëhequr nga një zyrtar i përcaktuar nga administrata osmane dhe ku nuk ka pasur pjesëmarrës jomyslimanë. Vetëm këshilli i kazave ka pasur një ose dy përfaqësues jomyslimanë.²⁸ Sanxhaku i Shkodrës, në fazën e fundit të Perandorisë, përfshinte kazatë e Shkodrës, Ulqinit, Tivarit, Podgoricës, Lezhës, Krujës, Pukës dhe Mirditës²⁹. Nahijet kanë qenë niveli më i ulët administrativ osman dhe janë të ngjashme, sa i përket madhësisë së territorit dhe organizimit politik, me bajraqet.

Për dallim nga bajraqet, nahijet janë njësi administrative, të cilat janë pjesë e hierarkisë administrative osmane. Mirëpo, edhe nahija, dhe bajraku, i japin llogari kazasë. Si nivele më të ulëta administrative, nahijet dhe bajraqet përputhen me komunat e sotme, edhe pse kanë qenë njësi më të vogla se komunat. Nahija ka qenë institucion i hapur, edhe për jomyslimanët, të cilët kanë ndikuar përmes këshillave të pleqve, të cilët kanë marrë pjesë në zgjedhjen e shefit të nahijes. Një ilustrim i mirë i asaj, se cilat kanë qenë kompetencat e nahijeve e gjejmë te propozimi që e bën Konferenca e Ambasadorëve, në vitin 1913, një vit pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Ajo i bën propozimet e veta duke u bazuar në sistemin

²⁶ Për më shumë mbi kazanë shih. DIZDARI, Tahir (2005), *Fjalor i Orientalizmave në Gjuhën Shqipe*, f. 527.

²⁷ BARDHI, Ali (2008), Organet e administratës publike lokale në kazanë e Tuzit në fund të periudhës së shtetit osman, shih:
<http://orientalizmi.wordpress.com/2012/08/06/organet-e-administratës-publike-lokale-në-kazanë-komunën-e-tuzit-në-fund-të-periudhës-së-shtetit-osman/>

²⁸ Ibid.

²⁹ Ibid.

administrativ osman, i cili ka qenë në funksion për një kohë të gjatë në vilajetet shqiptare. Në këtë propozim thuhet:

Nahija përbëhet nga një grup fshatrash, të cilët janë të lidhura gjeografikisht dhe ekonomikisht dhe ku popullsia e përgjithshme e tyre është nga 4.000 deri në 7.000 frymë (neni 132). Çdo nahije administrohet nga një Mudir, i cili ndihmohet nga Këshilli Komunal (neni 133). Këshilli Komunal përbëhet nga sekretari i Nahijes dhe nga 4 anëtarë të zgjedhur. Zgjedhjet bëhen mbi bazën e shumicës së zërave të fituara nga kryepleqtë e fshatrave përbërëse, të mbledhura në kryeqendrën e Nahijes dhe nën drejtimin e kryeplakut të kryeqendrës (neni 134). Mudiri ka për detyrë: publikimin dhe zbatimin e ligjeve, dekretëve, rregulloreve dhe urdhëresave të qeverisë. Regjistrimin e popullsisë, kontrollin e perceptimit të taksave dhe tatimeve (neni 135). Këshilli Komunal vendos për çështjet e mëposhtme: çështjet e higjienës publike; rrugët e komunikacionit ndërmjet fshatrave; mirëmbajtjen e çezmave, puseve, cisternave dhe akuariumeve; përmirësime në rrjedhjen e ujërave; ujitjen e tokave bujqësore, kanalizimet dhe digat; përmirësime të bujqësisë dhe të kafshëve shtëpiake.³⁰

Këto kompetenca janë zakonisht ato që u jepen komunave të sotme, edhe pse komuna moderne ka më shumë pushtet. Mirëpo, ngjashmëria me bajrakun është e madhe. Territorialisht, edhe Bajraku ka qenë i përbërë nga një grumbull fshatrash (jo gjithmonë), edhe pse numri i banorëve ka qenë zakonisht më i vogël se ai i nahijeve. Edhe Bajraku ka pas kuvendin e vet, ashtu sikur nahijet. Ky kuvend i Bajrakut ka qenë i përbërë nga kryepleqtë e fshatrave përbërës. Sipas të gjitha gjasave, Nahijet u paraprijnë bajraqeve, sepse, si institucione të krijuara në shekullin XVI, ka shumë mundësi që ato, pas kundërshtimeve të popullsisë lokale, të shndërrohen në Bajraqe. Madje, disa autorë flasin për një ndarje të Malësisë në nahije. Kështu, sipas G. Gawryç, në gusht të vitit 1911, pas kryengritjes malësore kundër osmanëve, Malësorët, nën presionin e Malit të Zi, negociojnë një marrëveshje me osmanët. Në këtë memorandum turko-malësor figuron se Turqia jep dëmshpërblim për dëmet e shkaktuara nga ekspeditat turke kundër Malësisë dhe se, ajo merr obligim që të

³⁰ HOTI, Genc K., Komentet mbi një dokument dypërmasor ("Organizimi i Shqipërisë sipas vendimit të Konferencës së ambasadorëve në Londër më 29 korrik 1913" dhe "Statuti i Shqipërisë i përpunuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit".) http://www.albanovaonline.info/index2.php?option=com_content&do_pdf=1&id=809

ndërtojë rrugët si dhe dy shkolla në Malësi. Në këtë marrëveshje figuron gjithashtu se Turqia merr obligim “që të emërojë në krye të nahijeve të Shalës, Shoshit, Shkreelit, Grudës, Kastratit, Hotit dhe Kelmendit, njerëz të afërt të familjeve të bajraktarëve”.³¹ Autori nuk tregon me saktësi se a ka pas një ndarje të vërtetë të Malësisë në nahije, ose se kjo ndarje ka qenë vetëm formale?

Mirëpo, ajo që mund të nxirret nga një krahasim i nahijeve me bajraquet është se shumica e kompetencave, të cilat u takojnë nahijeve, i gjejmë edhe te bajraku, përveç atyre regaliane, të cilat, tek nahijet, si nivel administrativ shtetëror, ndryshojnë në raport me bajrakun, i cili nuk është pjesë e hierarkisë shtetërore. Përveç kësaj, sa u përket kompetencave të këshillave të nahijeve dhe të bajraqeve, gjejmë shumë ngjashmëri. Bajraktari ka pasur për obligim kryesor të furnizojë Portën me ushtarë. Si pjesë e kontratës me osmanët, në kohë lufte, është dashur të ftojë nga një luftëtar nga çdo shtëpi.³² Ky obligim nuk figuron tek nahija, si nivel administrativ shtetëror. Te nahija, furnizimi me ushtarë ka qenë kompetencë e Sanxhakut. Tjetër ndryshim ndërmjet këtyre dy njësive administrative ka qenë sistemi i drejtësisë. Ashtu sikur e pamë më lart, i pari i nahijes kishte për detyrë edhe “publikimin dhe zbatimin e ligjeve, dekretëve, rregulloreve dhe urdhëresave të qeverisë”. Sistemi ligjor i bajrakut nuk hyn në kuadër të sistemit ligjor të perandorisë, sepse bajraku i nënshtrohej rregullave të Kanunit. Edhe vetë bajraktari i nënshtrohet Kanunit. Edhe pse, limitet territoriale të bajraqeve i përcaktojnë osmanët, brenda tyre dominonte ligji kanunor. Tutje, kjo manifestohet si mungesë e pushtetit detyrues, që e karakterizon bajrakun në raport me nahijen, e cila i zbaton ligjet përmes pushtetit detyrues të shtetit. Tek bajraku, është Kuvendi i Bajrakut i cili bën interpretimin e normave kanunore dhe përcakton sanksionimin eventual të atyre të cilët nuk i respektojnë ato. Pastaj, vendimet të cilat merren, zbatohen nga vetë komuniteti. Nuk ka pushtet detyrues të specializuar, ashtu siç ekzistonte te shteti. Kuvendet e nahijeve nuk kanë kompetenca të tilla dhe ato funksionojnë më shume si këshilla.

Sidoqoftë, vendosja e bajraqeve në nivelin më të ulët administrativ shtetëror tregon shumë mbi politikën osmane ndaj popullsisë së alpeve shqiptare. Kjo situatë është edhe më domethënëse, kur e dimë se elita burokratike osmane, ka qenë e

³¹ GAWRYCH, George (2006), *The Crescent and the Eagle: Ottoman Rule, Islam and the Albanians, 1874-1913*, I.B. Tauris, Londër, f. 187.

³² BACKER, Berit (2003), *Behind Stone Walls*, op. cit. f. 62.

angazhuar në politikë shumë më shumë sesa në administratë. Burokracia e lartë osmane ka pas një status shumë superior në raport me administratën e mesme ose të ulët. Kjo ndodh edhe për shkak të edukatës që ata kanë marrë. Personat në pozita të larta, madje e kanë marrë emrin Pashë.³³ Ashtu, siç u tha më lart, bajraktari nuk ka qenë pjesë e hierarkisë osmane dhe i ka raportuar administratës së ulët osmane. Këto njësi të reja territoriale janë të rrethuara me territore të tjera, të cilat qeverisen nga administrata shtetërore. Bajraktari do të reduktohet në një lloj gjysmë perfekti, i cili nuk ka në dispozicion të vet një aparat detyrues shtetëror.

Bajraku si institucion politik

Ndryshimet, të cilat i sjell bajraku si institucion politik dhe administrativ, do të ketë pasoja në organizimin e shoqërisë malësore. Megjithatë, me konvertimin progresiv të popullsisë së këtyre zonave në islam, ky institucion, do të humbasë në peshë. Te vendasit e krishterë, bajraku do të vazhdojë të luajë një rol strukturues, edhe pas tërheqjes së osmanëve. Kjo mund të shpjegohet me nevojën e ruajtjes së homogjenitetit, përballë presionit që ushtrohet nga jashtë mbi këto fise. Edhe pse, në fazat e para të vendosjes së këtij institucioni, mungojnë të dhëna mbi peshën e tij, bajraku do të mbahet mend si institucion, i cili solli një ndarje të re territoriale, që nuk përputhej me ndarjet fisnore tradicionale.³⁴ Kjo tregon se qëllimi i osmanëve ka qenë rishpërndarja e pushtetit politik tradicional dhe mjet për të penguar krijimin e një instance politike ose administrative më të lartë, e cila do të përfshinte të gjitha fiset e Malësisë së Mbishkodrës. Kështu e shpjegon Anton Kolë Berishaj këtë:

Me copëtimin e fiseve synohet thyerja e forcës homogjenizuese dhe struktura organizative e tyre, krijimi i distancave farefisnore, dobësimi i ndjenjës së origjinës së përbashkët dhe lidhjes së gjakut etj. Këtë e bën administrata turke për interesa të gjetjes së mekanizmave të ndikimit, përmes instalimit të institucionit të bajrakut dhe injektimit të “virusit” politik, ligjeve të portës dhe mënjanimin e rolit kanunor të kryefisnorit³⁵.

³³ HERPER, Metin dhe BERKAM, Umit (2009), *Bureaucracy in the Ottoman–Turkish Polity* in Farazmand Ali, *Bureaucracy and administration*, CRC Press, London, f. 65

³⁴ BACKER, Berit, *Behind Stone Walls*, op.cit., f. 59.

³⁵ BERISHAJ, Anton K (2014), *Shoqëria pa shtet, studim socioantropologjik*, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë, f. 141.

Si shoqëri e izoluar dhe homogjene në aspektin etnik dhe kulturor, ky ambient nuk ka pasur një qeveri qendrore me autoritet të centralizuar. Ajo ka pasur vetëm segmente të shoqërisë (fiset) të (vetë) organizuara. Bajraku si institucion i krijuar dhe i legjitimuar nga osmanët, simbolizon pushtetin politik të specializuar që është pushteti shtetëror. Mirëpo, bajraktari nuk ka legjitimitet të plotë shtetëror për shkak se është i vendosur me trashëgimi. Natyra trashëguese e këtij institucioni e bën të pamundur shkarkimin ose revokimit e bajraktarit, gjë që e bën të pamundur për shtetin të ndryshojë përfaqësuesit e vet. Mirëpo, këtë mundësi nuk e ka as shoqëria fisnore e atij ambienti, sepse as ajo nuk ka mundësi ta ndryshojë atë.³⁶

Pushteti i limituar i bajraktarit del në sipërfaqe nëse i marrim parasysh kërkesat e bëra ndaj bajraktarit, që në mënyrë të vazhdueshme të sigurojë legjitimitet dhe përkrahje për veprimet e tij nga komuniteti i gjerë.³⁷

Po ashtu, duhet përmendur edhe mjedisin malor dhe vështirësitë e krijimit të qendrave të dendura të vendbanimit, të cilat e stimulojnë nevojën e krijimit të udhëheqësve dhe organizimit më të lartë politik. Migrimet e vazhdueshme, qofshin stinore apo të përhershme, po ashtu, janë faktorë që shkojnë në favor të konstatimit të parë. Të gjitha këto elemente kanë bërë që të mos krijohet një pushtet detyrues, në krye të njësisë fisnore. Ky pushtet detyrues i ka munguar edhe bajraktarit i cili nuk arrit të krijojë pushtet shumë të diferencuar. Ky pushtet i limituar është edhe arsyeja se pse ky institucion ndryshon nga institucionet e qeverisjes indirekte (indirect rule) ashtu siç e definojnë disa autorë.³⁸ Ky sistem i qeverisjes indirekte është vendosur nga shumë shtete evropiane imperialiste në kolonitë e tyre. Perandoria Britanike për shembull, ka përdorur këtë lloj institucioni në një shkallë të gjerë, në Afrikë dhe në Indi. Ky lloj sundimi indirekt është vendosur zakonisht në vende ku ka pasur vështirësi, për të vendosur një administratë koloniale në gjendje të qeverisë. Sundimi indirekt në këtë situatë ka nënkuptuar menaxhimin e popujve dhe territoreve, përmes kryetareve të fiseve tradicionale, të cilat kanë shërbyer për

³⁶ Edhe pse Margaret Hasluck thotë se kur një person konsiderohet i paaftë për të ushtruar detyrën e bajraktarit, ai është zavëndësuar nga një person tjetër nga familja ose vëllezërit e tij.

³⁷ PULA, Besnik, *State, Law, and Revolution: Agrarian Power and the national State in Albania, 1850-1945*, faqe 160,

<http://deepblue.lib.umich.edu/bitstream/handle/2027.42/84596/bpul?sequence=1>

³⁸ Ibid.

interesat e kolonizuesit. Këta kryefisnorë tradicionalë u kanë garantuar britanikëve përfitime komerciale, koncesione dhe tatime. Në këmbim, britaniket u kanë garantuar atyre mbështetje ushtarake. Kjo u bën të mundur këtyre kryefisnorëve lokalë në këtë sistem, që të tregohen lojalë ndaj hierarkisë britanike, sepse, ajo u siguron atyre pozitën, të cilat shefat e tjerë nuk mund t'ua kontestojnë, përderisa ata ishin të përkrahur nga britaniket. Edhe pse, sistemi i bajraqeve garanton një lloj qeverisjeje indirekte, bajraktari nuk ka siguri nga osmanët, në rast se kontestohet nga popullsia lokale. Bajraktari nuk ka pasur në dispozicion të tij një forcë detyruese e cila do të kishte bërë atë një lloj prefekti osman. Pushtetin e tij, bajraktari e ushtron si lider karizmatik i një shoqërie brenda të cilës, të gjithë anëtarët, duke përfshirë këtu edhe vetë prijësit, u nënshtrohen rregullave të përbashkëta. Problemi i dominimit rregullohet përmes balancimit të pushtetit, një solucion politik praktik i cili nuk është i bazuar mbi konsensusin moral të grupit.³⁹ Fisi nuk ka pasur mundësi ta luajë rolin e këtij institucioni detyrues, sepse nuk ka qenë institucion i organizuar në mënyrë permanente dhe ka qenë pak i centralizuar. Madje, edhe kodi i nderit për femra dhe për meshkuj, mbahej pjesërisht nëpërmjet rrjeteve intensive të thashethemeve, të cilat funksiononin në mungesë të pushtetit detyrues brenda fisit.⁴⁰

Një shoqëri e organizuar mbi baza fisnore, është madje më pak e varur nga të tjerët dhe ka më pak prirje që t'i nënshtrohet autoritetit. Kuvendi i fiseve, si instanca më e lartë e pushtetit tradicional, nuk ka vepruar në mënyrë permanente, por vetëm në raste të veçanta, kur fiset janë rrezikuar nga jashtë ose kur ka pasur konflikte ndërmjet tyre. Po ashtu, edhe pse secili fis ka pasur një prijës (kryefisnorin), ky nuk ka pasur pushtet të centralizuar. Kryefisnori e ka ushtruar autoritetin e tij nëpërmjet respektit që ka gëzuar brenda komunitetit e jo nëpërmjet fuqisë, për t'ua imponuar të tjerëve vullnetin e tij, në mënyrë arbitrare. Kryefisnori është dashur të tregojë shumë i durueshëm dhe të shmangte çdo formë të detyrimit, me qëllim që të evitohet përçarjen e grupit që mund të rezultonte me shpërbërjen e fisit. Shoqëritë fisnore si ato të Malësisë kanë qenë shoqëri, ku diferencimi shoqëror ka qenë i kufizuar. Udhëheqja dhe diferencimi i kufizuar politik zakonisht

³⁹ BOEM, Christopher (1984), *Blood Revenge, The enactment management of conflict in Montenegro and Other Tribal Societies*, University Press of Kansas, f. 236

⁴⁰ STEWART, Pamela, STRATHERN, Andrew (2002), *Violence: Theory and ethnography*, Continuum, London, f.116.

prodhojnë pushtet të kufizuar politik. Për këtë arsye, pushteti i kryefisnorit buron nga poshtë, e jo nga lart.

Bajraktari sjell risi sa i përket legjitimitetit, sepse ai i kombinoi të dyja. Zgjedhja e tij nga lart (osmanët) i jepnin legjitimitet shtetëror, por për të ushtruar pushtetin atij, i duhej që ta vendoste atë në nivel lokal dhe të krijonte identitet brenda bajrakut. Një tjetër element që e limitonte pushtetin e bajraktarit lidhet me faktin se ky titull nuk jepej sipas parimit gjerontokratik, parim ky që bazohet mbi respektimin e parimit të ushtrimit të pushtetit nga më të vjetrit dhe i cili e karakterizon sistemin fisnor të alpeve shqiptare. Përkundër disa shpjegimeve, sipas të cilave titulli i bajraktarit jepej në baze të trimërisë së dëshmuar në luftë.⁴¹ ka shumë më shumë gjasa që ai u jepej familjeve më të fuqishme brenda fisit. Kjo mund të shpjegohet edhe me fuqinë që është nevojitur për të imponuar këtë institucion në nivel lokal.⁴²

Bajraku nuk i eliminon institucionet e tjera tradicionale, siç janë kuvendet e fiseve dhe strukturat e tjera ekzistuese. Sidoqoftë, bajraktari, gati gjithkund, në fillim ka luajtur rolin e ndërmjetësuesit, i cili nuk e vë në pyetje ekzistencën e Kanunit dhe të strukturave të tjera të organizimit dhe udhëheqjes. Normat kanunore do të vazhdojnë të luajnë rolin e mbajtjes së rregullit dhe të furnizojnë një kuadër juridik dhe deontologjik, për zgjidhjen e konflikteve. Bajraku fillimisht do të jetë institucion, i cili vetëm i mundëson administratës turke, që të mbajë kontaktin me popullatën. Disa autorë e konsiderojnë si një “modus vivendi” ndërmjet osmanëve dhe popullsisë lokale.⁴³ Madje, Margareth Hasluck, thotë se për një kohë të gjatë, bajraktari do të luajë vetëm rolin e një diplomati ose të prijësi të luftës, pa pushtet të vërtetë politik.⁴⁴ Bajraktari arrin të imponohet nëpërmjet shërbimeve që ai ofron. Në një situatë të varfërisë ekstreme, të shkaktuar nga izolimi i këtyre zonave malore, popullsia fillon të ketë përfitime të ndryshme, të cilat progresivisht e bëjnë bajraktarin të pranueshëm për popullsinë lokale. Përndryshe, për pushtetin osman, do të kishte qenë e pamundur që të bazohen mbi një personalitet tjetër që i çon në hije strukturat tradicionale, nga të cilat ai duhej të merrte legjitimitetin. Kjo i mundëson bajrakut që progresivisht t'i japë fund “anarkisë së

⁴¹ HASLUCK, Margaret, *The Unwritten Law in Albania...* op. cit.

⁴² Berishaj Anton K., *Shoqëria pa shtet...*, op. cit. F. 102.

⁴³ BECHERELLI, Andrea, CARTENY, Andrea (2013), *L'Albania indipendente e le relazioni italo-albanesi (1912-2012)*, Sapienza, Romë, f. 14.

⁴⁴ HASLUCK, Margaret (1954), *The Unwritten Law in Albania*, op. cit..

organizuar⁴⁵ dhe të bëjë lidhjen ndërmjet pushtetit qendror dhe komuniteteve lokale të pavarura.⁴⁶ Disa autorë potencojnë se një ndër shkaqet të cilat i mundësojnë bajrakut të pranohet nga popullsia lokale është lirimi i pagimit të taksave nga popullsia lokale. Madje, Berit Backer, thotë se osmanët edhe i paguajnë malësorët, të cilët shkojnë në luftë.⁴⁷ Kjo na mundëson t'i kuptojmë kushtet historike të krijuara nga një izolim shekullor i kësaj zone, izolim ky, që i obligon ata të mbijetojnë në një ambient te mbyllur.

Bajraku dhe konvertimi në islam

Vendosja e bajrakut në një regjion malor, i cili në shekullin 17 kishte një popullsi me shumicë absolute katolike e shtron domosdoshmërisht pyetjen se, cili është dimension i fetar i këtij institucioni. Kjo ndodh për arsye se autonomia, si karakteristikë e bajrakut, ka kuptim vetëm në raport me specifikën fetare të Veriut shqiptar. Edhe pse është vështirë të bëhet ndarja ndërmjet fetares dhe fisnores të fiset e kësaj zone, kjo ndarje duhet të kuptohet edhe në aspektin e trajtimit të ndryshëm, që ishte i rezervuar për jomyslimanët brenda Perandorisë Osmane. Një studim i antropologut amerikan, Carlton Coon, i bërë në vitin 1929-1930 tregon se, nga 250 000 “gegët tribal”, siç i quan ai, 160.000 ishin myslimanë, kurse 90.000 ishin të krishterë⁴⁸. Ai madje paraqet një kartë gjeografike përmes së cilës tregon se bajraqet me popullsi katolike gjenden në zonat malore më të izoluara të Veriut të Shqipërisë.⁴⁹ Kjo do të thotë se për 3 shekuj, tri të katërtat e këtyre fiseve konvertohen në islam. Konvertimi në islam në Ballkan fillon shumë para vendosjes së bajraqeve. Dëshmi të konvertimeve kemi nga shekulli 14-15, që, autorë të ndryshëm tregojnë për ato. Një ndër ato është ajo e Bajazit Pashës, Vizirit të Madh të Mehmet Pashës së parë, i cili shkruan se mobiliteti social është bërë i mundur duke iu falënderuar konvertimit në islam. Për atë, ashtu si edhe për fëmijët e tjerë të katundareve të varfër ballkanik, të

⁴⁵ EVANS-PRICHARD, Edward E (1940), *The Nuer: A Description of the Modes of Livelihood and Political Institutions of a Nilotic People*, Oxford, Clarendon Press.

⁴⁶ BACKER, Berit, *Behind Stone Walls...*, op.cit.

⁴⁷ Ibid.

⁴⁸ CARLTON, Coon (1950), *The Mountain of Giants*, A Racial and Cultural Study Of the North Albanian Mountain Ghegs, Cambridge, Massachusetts, f. 35.

⁴⁹ Ibid.

bëhesh mysliman do të thotë të këmbesh “kondicionin e vet modest për një fat të madh”.⁵⁰ Osmanët, thotë Bajezid Pasha, “kanë zgjedhur me urtësi katundarët më të defavorizuar, të cilët nuk besojnë në zot dhe kanë bërë nga ata besimtarë të vërtetë, oficerë përfitues dhe guvernatorë të dalluar, dhe unë jam njëri nga ata”.⁵¹

Megjithatë, ky proces i konvertimit do të zgjasë disa shekuj, dhe sipas disa autorëve, “islamizimi do të jetë më i ngadalshëm në Shqipëri, por do të vazhdojë rregullisht në shekullin 16, 17, 18.”⁵² Është pikërisht kjo koha kur vendosen bajraquet, si rezultat i kundërshtimit të dominimit osman. Konvertimi do të vazhdojë edhe brenda shoqërive të organizuara në bajraqe. Bajraku nuk do të mund të luajë rolin e ‘mileteve’, institucione të cila u kanë mundësuar shumë popujve të Ballkanit të organizohen në baza fetare. Edhe në këtë aspekt, politikat e Perandorisë Osmane ndaj popujve jomyslimanë ndryshojnë, duke filluar nga toleranca më e madhe dhe integrimi, siç ka qenë rasti i shumë aristokratëve bizantinë dhe atyre të Konstantinopojës, të cilat kanë ushtruar pozita ministrash, shefish të Flotës osmane, vojvodësh të principatave vasale etj., deri te masakrat me të mëdha, siç ka qenë ajo kundër armenëve, masakër kjo e cila ka marrë përmasa të gjenocidit. Megjithatë, si çdo sundues, edhe osmanët kanë pasur për qëllim të eksploatojnë ekonomikisht popujt e dominuar, pa pasur nevojë t’i eksterminojnë ata. Konvertimet e dhunshme kanë qenë të rralla, edhe pse, ashtu siç ka ndodhur në Malësi, popujt e revoltuar janë izoluar dhe shumica janë konvertuar progresivisht. Ngushtimi i hapësirës, i shkaktuar nga izolimi, do të fuqizohet edhe me politikat e taksimit. Konvertimi është edhe sinonim i lirimit nga larja e haraçit (tatim i dyfishtë për jomyslimanët) dhe me lirimin nga marrja e fëmijëve (Jeniçerët-Yeni-ceri). Fëmija nuk u merrej të pasurve, sepse ata kanë pasur mundësi të paguanin haraçin.

Në shekullin 18, pushteti osman vendosi të ndryshojë politikat e veta ndaj popujve jomyslimanë, duke krijuar institucionin e Miletit (nga arabishtja *milla*-religjion). Mileti do të jetë institucionalizim i statusit të komuniteteve të krishtera, të cilat kanë ekzistuar në territore, nën kontrollin osman.⁵³ Pushteti osman u mundësoi popujve

⁵⁰ BALIVET, Michel (1992), *Aux origines de l'islamisation des Balkans ottomans*. In: *Revue du monde musulman et de la Méditerranée*, N°66, ff. 11-20.

⁵¹ Ibid.

⁵² Ibid. f. 13.

⁵³ STEFANOV, S (1997), “Millet System in the Ottoman Empire-Examples for oppression or for Tolerance?” *Bulgarian Historica Review* (2, 138-142) f. 139

jomyslimanë të organizohen në milete, duke u dhënë kishave të tyre një rol social dhe kulturor esencial.⁵⁴ Perandoria emëron prijësit fetarë të mileteve. të quajtur Miletbash. Autonominë e tyre, këto grupe fetare, e paguajnë me kontributin, të cilin Miletbashi e bashkon për Sulltanin. Edhe pse shumë autorë e konsiderojnë krijimin e sistemit të mileteve si rezultat i “sklerozës” së Perandorisë Osmane, e cila do të manifestohet me një lloj rigidifikimi të kufijve komunitarë, ky institucion i ka mundësuar asaj të zgjidhë konfliktet dhe të amortizojë kundërshtimet, të cilat buronin nga komunitetet e krishtera, brenda territorit të vet.⁵⁵

Edhe Bajraku do të luajë deri në njëfarë mase rolin e amortizuesit të kundërshtimeve të fiseve malësore ndaj perandorisë, mirëpo, për dallim nga Mileti, ky institucion nuk ka qenë institucion i dhënë në baza fetare. Përkundrazi, aty ku Miletbashi përfaqësonte të gjithë miletin e vet, duke luajtur kështu rolin e një institucioni të centralizuar dhe hierarkik, bajraku simbolizonte shkapërderdhjen e fiseve malësore dhe tentimin për të ndryshuar edhe ato struktura fisnore të strukturuar. Miletbashi përfaqësonte të gjithë komunitetin e vet (fetar), kurse bajraktari përfaqësonte bajrakun e tij, që ishte vetëm njëri nga shumë bajraqe të ngjashme. Këto dy institucione ndryshojnë edhe për nga vetë natyra e tyre organizative. Bajraku krijohet fillimisht si institucion ushtarak, karakteristikë kjo e cila do ta përcjellë gjatë atë, kurse te mileti dominon religjioni si element themelues. Këto institucione ndryshojnë edhe në ngjashmëritë e tyre sepse edhe pse te dyja duhet të deklarohen besnik të Perandorisë, bajraktari i raporton kazasë, si nivel më i ulët administrativ, kurse Miletbashi i raporton qeverisë qendrore. Shkaku që osmanët nuk bazohen tek klerikët katolikë për të vendosur pushtetin e tyre, tregon se qëllimi i tyre nuk ka qenë që të krijojnë një entitet politikoterritorial, i cili de facto ekzistonte në aspekt fetar, por që të pengojnë krijimin e tij. Madje, në Malësi, as kisha katolike nuk e kishte fuqinë, të cilën e kanë pasur kishat ortodokse brenda Perandorisë. Deri vonë, kushtet e vështira të jetesës e kishin bërë të vështirë vendosjen e famullive mbi gjithë territorin e Malësisë. Popujt ortodoksë të

⁵⁴ BOUGAREL, Xavier (1994), “Etat e communautarisme en Bosnie-Herzegovine”, *Culture e conflits num.* 15-16,, f.16.

⁵⁵ LEMBRUCH, Gerhard (1974), “A Non-competitive Pattern of Conflict Management in Liberal Democracies: The Case of Switzerland, Austria and Lebanon”, in: McRae, Kenneth (ed.), *Consociational Democracy: Political Accommodation in Segmented Societies*, McLlelland and Stewart, Ottawa, faqe 96.

Ballkanit kanë pasur rrënjë më të thella për faktin se Perandoria Osmane është vendosur mbi territorin e Bizantit dhe kjo e shpjegon se pse autoriteti i klerikëve ortodoksë, ka qenë më i fuqishëm. Kjo ia ka mundësuar Kishës ortodokse të ushtrojë autoritet më të madh.

Bajraçet, të cilat konvertohen në islam, do të shndërrohen progresivisht në institucione shtetërore të tipit feudal, të ngjashme me institucionet e tjera osmane. Kjo e shpjegon pse në disa zona, bajraktarët do të akumulojnë pushtet që, Margareth Haslluck, e quan pushtet despotik.⁵⁶ Ajo thotë se në disa zona të Dukagjinit, bajraktarët janë shumë të fuqishëm dhe akumulojnë pasuri, prestigj dhe kanë një raport kuazifeudal me Bajrakun e tyre. Ky status sundues nuk mund të shpjegohet jashtë përkrahjes së fuqishme, të cilën këta persona e merrnin nga osmanet. Në zonat e krishtera, Carlton Coon, thotë se të pakta janë vendet ku ky institucion ka peshë të madhe, madje ai thotë se shumë shpesh, ai gjendet nën dominimin e kryetarit të fisit. Rezultat i konvertimit të njëpasnjëshëm të bajraçeve në islam, do të rezultojë me izolim gjithnjë më të madh të bajraçeve, të cilat nuk konvertohen. Kjo do të rezultojë me mundësi gjithnjë e më të vogla të qarkullimit të bajraçeve të krishtera, të cilat do të izoloohen gjithnjë e më shumë.⁵⁷ Noel Malcolm, madje thotë se ky izolim do të ketë një çmim të lartë edhe brenda bajraçeve. Ai jep një shifër, sipas së cilës, në fund të periudhës osmane, 1/5 (19%) e meshkujve të këtyre bajraçeve vdesin si pasojë e konflikteve të brendshme dhe hakmarrjes.⁵⁸

Carlton Coon, jep dy argumente që e shpjegojnë konvertimin masiv të bajraçeve të Veriut shqiptar. Së pari, ai thotë se katolicizmi si religjion kishte dështuar në ndryshimin e traditave fisnore të malësoreve, të cilat rezultonin me një numër shumë të madh të ndalesave. Ndër ato, ai i numëron pasojat që rridhnin nga martesat endogame (cross-cousin marriage), të cilat e bënin të pamundur martesën brenda grupit, divorcin, leviratin (martesën me gruan e vëllait në rast të vdekjes së tij), vëllamërinë artificiale, që i bënte të pamundura martesat ndërmjet familjeve të betuara, betimin e virgjëreshave etj. Shumica e këtyre ndalesave ishin, sipas tij, të lejuara në islam, gjë që i jepte legjitimitet te kjo popullatë.⁵⁹

Së dyti, sipas tij, shumë nga persona të konvertuar shihnin se ka

⁵⁶ HASLUCK, Margaret, *The Unwritten Law in Albania...* op. cit.

⁵⁷ COON, Carlton, *The Mountain of Giants...*, op. cit., f. 36.

⁵⁸ New York Times, 9 gusht 1998, <http://www.nytimes.com/books/first/m/malcolm-kosovo.html>

⁵⁹ Ibid.

përfitime solide nga kjo lëvizje. Një mysliman mund të mbante armën gjithandej në publik dhe mund të vriste të krishterë, sipas vullnetit të tij, sepse ata ishin banditë (outlaws). Ai mund të udhëtonte në territorin turk, pa u brengosur se mund të kapej, si dhe mund të përfitonte edhe shumë favore ekonomike në raport me kushërinjtë e tij të krishterë (...) ai mund t'i bashkëngjitej ushtrisë turke, dhe mund të ngjitej lartë në grada; shumë gjeneralë të ushtrisë turke kanë qenë shqiptarë dhe kanë pasur pozita të larta shtetërore, një nga ata ka themeluar shtëpinë mbretërore të sotme të Egjiptit.⁶⁰

Ai thotë se edhe Islami, në atë kohë, dukej si më në trend edhe për faktin së njerëzit e pasur jetonin në qytete, oficerët e ushtrisë dhe elitat e tjera ishin myslimane. Shumica e qyteteve flisnin turqisht me preferencë. Malësorët e krishterë ishin të varfër. Coon i analizon bajraçet pikërisht në këtë aspekt diakronik dhe thotë, për shembull, se disa bajraçe të cilat ishin në procesin e konvertimit ose ishin konvertuar vonë, përdornin emra myslimanë kur shkonin jashtë për të evituar problemet.

Summary

Created at the end of the 17th century by the Ottomans, the institution of bajrak is considered as the first political and administrative institution in the mountainous region of today's northern Albania. As a territorial unit, the bajrak consisted of a group of villages and was led by a bajraktar ("standard bearer") whose duty was to organize military recruitment in time of war. The Ottomans entrusted the bajraktar with providing soldiers from his bajrak, in exchange for certain privileges and sometimes he performed important administrative and political duties. The bajraktar was a hereditary position via paternal ancestry appointed by the Ottoman government. The heredity created a special relationship of the bajraktar with the state administration since, once he was appointed, he could never be dismissed. This made it necessary for him to be recognized and respected by his fellow citizens in order to play his role.

In this article, we started by studying some of the most significant characteristics of this institution. We compared it with the other ottoman institutions in the Balkans. As the lowest administrative level, the bajrak could not contribute to higher political and administrative organizations. The bajrak was rather an obstacle for higher political organizations and contributed to the isolation of mountainous tribes of northern Albania. In some regions where the population converted to Islam, this institution was transformed in a feudal like institution whereas in the regions with catholic majorities, it could hardly differentiate from the other traditional institutions. Through the study of the institution of Bajrak, the aim was to give an

⁶⁰ Ibid. f. 43-44.

overall explanation of the ottoman administration in northern Albania since very few studies in the past have highlighted the place of this institution in the general ottoman administration.

Bibliografia

- Backer Berit, 2003, *Behind stone and Wallschanging Household Organisation Among The Albanians of Kosova*, Dukagjini Balkan Books, Pejë.
- Balivet Michel. Aux origines de l'islamisation des Balkans ottomans. In: *Revue du monde musulman et de la Méditerranée*, N°66, 1992.
- Baldiceanu Nicoara, 1980, "Le timar dans l'Etat ottoman (XIVe-XVe siècles), Structures féodales et féodalisme dans l'Occident méditerranéen (Xe-XIIIe siècles). *Actes du colloque de Rome*.
- Blanc A. "Recherches sur les communautés patriarales et les structures agraires en Albanie du Nord". In: *Bulletin de l'Association de géographes français*, N°292-293, Maj-qershor, 1960. faqe 117- 128.
- Boehm Christopher, *Blood Revenge, The enactment management of conflict in Montenegro and Other Tribal Societies*, University Press of Kansas, 1984, faqe, 10
- Bougarel Xavier, Etat et communautarisme en Bosnie-Herzegovine, *Cultures & Conflicts* 15-16 (1994)
- Berishaj Anton K. *Shoqëria pa shtet, studim socio-antropologjik*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK), 2014.
- Berishaj Anton K. *Shndërrimi i etnisë*, Dukagjini, 1998.
- Bojanic Dusanka, 1973, *Faksimili fragmenti zbirnog popisa Vidinskog sangaka iz 1466 godine*, t. II, Beograd.
- Becherelli Andrea, Carteny Andrea, *L'Albania indipendente e le relazioni italo-albanesi (1912-2012): Atti del Convegno in occasione del centenario dell'indipendenza albanese* (Sapienza, 22 nëntor 2012), ed. Nuova Cultura, 2013
- Colas Dominique, 1994, *Sociologie Politique*, Paris, Presse Universitaire de France.
- Carlton Coon, *The Mountain of Giants, A Racial and Cultural Study Of the North Albanian Mountain Ghegs*, Cambridge, Massachusetts, 1950.
- Doyle Michael W. , *Empires*, Cornell University Press 1986.
- Evans-Prichard Edward E., *The Nuer: A Description of the Modes of Livelihood and Political Institutions of a Nilotic People*, Oxford, Clarendon Press, 1940.
- Gawrych George, *The Crescent and the Eagle: Ottoman Rule, Islam and the Albanians, 1874-1913*, I.B. Tauris, Londër 2006, faqe 187.
- Jelavich Barbara, 1983, *History of the Balkans*, Cambridge, Cambridge University Press.
- Hadzibegic H, Handzic A, Kovacevic E, 1972, *Oblast Brankovica opsirni katastarski popis iz 1455 godine*, Sarajevë, volumi 2.
- Hasluck Margaret, 1954, *The Unwritten Law in Albania*, Cambridge, Cambridge University Press.
- Herper Metin dhe Berkam Umit, *Bureaucracy in the Ottoman-Turkish Polity in Farazmand Ali, Bureucracy and administration* (2009), CRC Press, London
- Karpat Kemal, *Political and Social Thought in the Contemporary Middle East*, London, 1968

- Lewis Bernard, 1963, *Istanbul and the Civilization of the Ottoman Empire*, Norman, University of Oklahoma Press.
- Lehmbruch, Gerhard, 1974: "A Non-competitive Pattern of Conflict Management in Liberal Democracies: The Case of Switzerland, Austria and Lebanon", in: McRae, Kenneth (ed.), *Consociational Democracy: Political Accomodation in Segmented Societies*, McLleland and Steward, Ottawa: 90-97.
- Lybyer Albert Howe, *The government of the Ottoman empire in the time of Suleiman the Magnificent*, Harward, Harvard University Press 1913.
- M.O.H. Ursinus, 1993, « Millet », in *The encyclopedia of Islam : New Edition*, ed. C.E. Bosworth, faqe 61-67, Leiden, Brill.
- Makiaveli Nikolo, 1977 (perkthimi shqip), *Sundimtari*, kapitulli IV.
- Malcolm Noel, *Kosovo: A Short History*, Macmillan, London, 1998.
- Oktay Cemil, 1999 « De la Taxis et de l'Oikonomia. Au cercle de justice : de l'idéologie politique byzantine a l'idéologie politique ottomane », *Revue Méditerranées*, numer 20.
- Mantran Robert, 1989, *Histoire de l'Empire ottoman*, Paris, Fayard.
- Pulaha Selami, 1974, *Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, volumi 2, Tirane.
- Schon Robert & Galaty Michael L., "Diachronic Frontiers: Landscape. Archaeology in Highland Albania", *Journal of world-systems research*, XII, 2, dhjetor 2006, 231-262.
- Roux Jean-Paul, *Histoire des Turcs*, Paris, Fayard. 1984
- Stefanov Svetoslav, "Millet System in the Ottoman Empire-Example fot oppression or for Tolerance?", *Bulgarian Historical Review* (1997, 2-3), 138-142.
- Skendi Stavro, 1967, *The Albanian National Awakening, 1878-1912* (Princeton, NJ, Princeton University Press.
- Stewart Pamela, Strathern Andrew, *Violence: Theory and ethnography*, Continuum, London, 2002
- STEGMAN, Andre, *Pouvoir et institutions en Europe au XVIeme siecle*, Librairie Philosophique J. Vrin, 1987
- Stavrianos L. S. *The Balkans since 1453*. Holt, Rinehart dhe Winston, New York 1958, faqe 101.
- Ulqini Kahreman, 1991, *Bajraku në organizimin e vjetër shoqëror*, ed. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë
- Zickel E. Raymond, Iwaskiw R.Walter, 1994, *Albania: a country study*, ed. Headquarters Dept.

Zenun HALILI, Prishtinë

KUSHTETUTA - GURTHEMEL I DEMOKRACISË AMERIKANE

KDU 342.4(73)(091)

Abstrakt

Gjatë shekullit të shtatëmbëdhjetë dhe viteve të para të shekullit të tetëmbëdhjetë, mijëra emigrantë nga Evropa, kryesisht nga Britania e Madhe, emigruan për në Amerikë. Emigrantët e parë që kaluan Atlantikun për në “ tokën e premtuar”, që sot njihet me emrin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, fillimisht e projektuan një marrëveshje, e cila i bashkonte si komb. Marrëveshja, që u quajt “Nenet e Konfederatës dhe Bashkimit të Përrjetshëm”, e cila u miratua nga një kongres shtetesh, u bë detyruese në vitin 1781. Por, dështimi i Neneve të Konfederatës (1781-87) për të krijuar një qeverisje të qëndrueshme të kolonive amerikane, i çoi delegatët në Kuvendin Kushtetues të vitit 1787, për t’i dhënë një pushtet më të gjerë qeverisë qendrore.

Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara e vitit 1787, paraqet ligjin themelor të shtetit. Ajo vendos formën e qeverisë kombëtare dhe përcakton të drejtat dhe liritë e popullit amerikan. Në të renditen, gjithashtu, qëllimet e qeverisë dhe metodat e realizimit të tyre. Kushtetuta përbëhet nga preambula, shtatë nene dhe 27 amendamente. Ajo ka krijuar një sistem federal të qeverisjes, duke i ndarë kompetencat qeverisëse midis qeverisë kombëtare dhe qeverive shtetërore. Ajo, gjithashtu, ka krijuar një qeverisje kombëtare të balancuar, duke e ndarë pushtetin ndërmjet tri degëve të qeverisjes. Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara, e cila është kushtetuta më e vjetër në fuqi e botës, është amendamentuar kohë pas kohe, por parimet e saj themelore ende janë në fuqi.

Fjalët çelës: Kushtetuta, federalizmi, ndarja e pushteteve, demokracia, amendamentet kushtetuese, qeverisja demokratike, kontrolli juridik, legjislativi, ekzekutivi, gjyqësori.

Hyrje

Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, tani është e vjetër dyqind e njëzetetë vjet. Ajo ishte një dokument i shquar, kur u hartua në vitin 1787, dhe deri me tani ka funksionuar shumë mire. Me disa ndryshime, ajo ka vazhduar të sigurojë një kornizë shembullore për qeverisjen përfaqësuese dhe për mbrojtjen e të drejtave themelore. Pothuajse të gjithë popujt që jetojnë në SHBA e admirojnë Kushtetutën, por vetëm disa prej tyre e kuptojnë atë.

Dokumenti, si i tillë, mund të lexohet në pak minuta, dhe çdo qytetarë duhet që ta lexojë atë. Por, për ta lexuar kushtetutën nuk do të thotë se duhet kuptuar çdo gjë që është shkruar brenda saj, sepse disa prej dispozitave kryesore të saj janë mjaft të përgjithësuara dhe të paspecifikuara mirë. Shumica e qytetarëve në Shtetet e Bashkuara mund të kenë dëgjuar nga burime të ndryshme se Kushtetuta ka diçka për të thënë për aktet afirmative, abortin, dhe lutjet e shkollave, por ata nuk mund të gjejnë asnjërin nga këto fjalë në Kushtetutë.

Por, ajo që mund të gjendet aty, janë dispozitat që ndalojnë qeveritë shtetërore apo federale për të “mohuar mbrojtjen e barabartë para ligjit”, për të privuar të drejtën e njerëzve për jetë, liri, ose pasuri pa një “proces të rregullt ligjor”, ose për të hartuar ligje që respektojnë “ngritjen e fesë.” Hartuesit e Kushtetutës kanë qenë të vetëdijshëm se për t’i qëndruar kohës, ajo duhet të shkruhej me një gjuhë të përgjithësuar, duke lënë që detajet të specifikoheshin me tutje nëpërmjet interpretimeve si “koncepte të mëdha” të Kushtetutës të cilat mund të aplikohen për zgjidhjen e një numri të problemeve të paparashikuara.¹

Kështu, Kushtetuta mund të kuptohet vetëm duke ekzaminuar se si ajo është interpretuar dhe aplikuar në vitet, që nga adaptimi i saj. Çdo zyrtar qeveritar nga legjislativi, ekzekutivi, apo gjyqësori, duhet interpretuar Kushtetutën për të përcaktuar kufijtë e autoritetit të tij, ose të saj. Gjyqtarët e kanë ndërtuar Kushtetutën për ‘tu dhënë atyre fuqinë, për të përcaktuar kushtetutshmërinë e akteve legjislative dhe ekzekutive në rrjedhën e vendosjes së padive, dhe rrjedhimisht, vendimet e tyre kanë marrë një rëndësi të veçantë për të përcaktuar atë që thotë Kushtetuta.

Historia kushtetuese e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Gjatë shekullit të shtatëmbëdhjetë dhe viteve të para të shekullit të tetëmbëdhjetë, mijëra emigrantë nga Evropa, kryesisht nga Britania e Madhe, emigruan në Amerikë. Arsyet e shpërnguljes së tyre ishin të ndryshme, por më së shpeshti ato ishin të lidhura me keqtrajtimet politike dhe religjioze, si dhe dëshirën e emigrantëve për një jetë më të mirë. Emigrantët e parë britanikë që kaluan Atlantikun për në “tokën e premtuar”, që sot njihet me emrin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, u

¹ Shih McCulloch v. Maryland, 17 U.S. 316 (1819)

vendosën atje dhe themeluan trembëdhjetë kolonitë e para,² të cilat ende ishin nën juridiksionin e pushtetit britanik.

Të pakënaqur me sundimin britanik, në vitin 1776, trembëdhjetë kolonitë amerikane i dërguan delegatët e tyre në Kongresin Kontinental në Filadelfia. Atje, ata adaptuan Deklaratën e Pavarësisë, e cila është konfirmuar pas Luftës Revolucionare me Traktatin e Parisit, të vitit 1783. Pasi u bënë shtete të pavarura, kolonitë e themeluan një konfederatë. Menjëherë pas kësaj, Kongresi Kontinental propozoi Nenet e Konfederatës,³ të cilat u ratifikuan nga dymbëdhjetë shtete. Por, nenet u bënë detyruese kur u ratifikuan nga shteti i trembëdhjetë, Merilendi, në mars të vitit 1781.⁴

Nenet e Konfederatës e ndërtuan një qeverisje qendrore të dobët e me kompetenca të kufizuara. Asaj i mungonte autoriteti për të vjelë taksë dhe për t'i rregulluar marrëdhëniet tregtare. Në organin ligjvënës të konfederatës, i cili ishte njëdhomësh, shtetet përfaqësoheshin me dy deri në shtatë përfaqësues, por çdo shtet kishte një votë. Konfederatës i mungonte dega ekzekutive dhe një sistem i gjykatave kombëtare.⁵ Meqenëse qeverisë kombëtare i mungonte edhe autoriteti për rregullimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, disa shtete filluan t'i ndërtojnë vetë marrëdhëniet e jashtme me shtetet e huaja. Disa prej shteteve formuan ushtritë dhe filluan t'i nxirrnin valutat e tyre. Duke i parë këto dhe dobësi tjera, u shtrua nevoja për ndryshimin e Neneve të Konfederatës.

Dështimi i Neneve të Konfederatës (1781-87) për të krijuar një qeverisje të qëndrueshme të kolonive amerikane, i çoi delegatët në Kuvendin Kushtetues të vitit 1787, në Filadelfia, për t'i dhënë një pushtet më të madh qeverisë qendrore.⁶ Qëllimi kryesor i Kushtetutës ishte krijimi i një pushteti të fuqishëm të qeverisjes me anë të zgjedhjeve, i përgjegjshëm drejtpërdrejt ndaj vullnetit të popullit. Puna për të hartuar në dokument, që do t'i kënaqte të gjithë, nuk ishte e

² Bardes, Shelley, Shmidt: American Government and Politics Today, 2004-2005 Edition. Published by, Thompson Learning, Inc.f.34.

³ Nenet e Konfederatës, ishin Kushtetuta e parë e SHBA-ve.

⁴ Vështrim mbi sistemin amerikan të qeverisjes: Botuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, f.7.

⁵ Robert Devenport: American History, 2003 Edition, published by Alpha –A Pearson Education Company.f.73.

⁶ Greg Rusell: Kushtetutësia në Amerikë dhe përtej saj, në Kumtesat mbi Demokracinë. Nr. 2.f.3.

lehtë. Disa prej delegatëve sollën me vete planet, që ata dëshironin t'i shtronin për diskutim para Kuvendit Kushtetues.

Një ndër ta ishte edhe delegati Xhejms Medisoni nga shteti i Virxhinisë, plani i të cilit propozonte formimin e një qeverie të fortë kombëtare dhe formimin e një sistemi federal të qeverisjes me ndarje të kompetencave, ndërmjet qeverisë kombëtare dhe qeverive shtetërore. Me këtë plan propozohej edhe formimi i një legjislature dydhomëshe, që do të përbëhej prej Dhomës Përfaqësuese dhe prej Senatit, dhe formimi i degës gjyqësore. Një tjetër plan që u paraqit në punimet e Kuvendit Kushtetues ishte edhe plani i delegatëve nga shteti Nju Xhersi, i cili propozonte që të behkëshin disa ndryshime, por që Nenet e Konfederatës, mos të zëvendësoheshin me një dokument tjetër.

Mospajtimet më të theksuara ndërmjet këtyre dy planeve dolën rreth përfaqësimit dhe dallimeve në mes shteteve të Veriut dhe shteteve të Jugut, për çështjen e skllavërisë. Delegatët e shtetit Kenetikë e bënë një propozim që e zgjodhi problemin. Plani i tyre parashikonte që numri përfaqësuesve në Senat të ishte i barabartë nga dy për çdo shtet, ndërsa në Dhomën Përfaqësuese ky numër të përcaktohej në raport me numrin e popullsisë.⁷

Krijimi i një presidence të fuqishme të njësuar u bë shkak që në Kuvendin Kushtetues të kishte edhe përplasje mendimesh. Mospajtimet më të mëdha dolën rreth mënyrës së zgjedhjes dhe mandatit të presidentit.⁸ Në fund komisioni, i ngritur me anëtarë nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse nxori kompromisin, sipas të cilit zgjedhja e presidentit do të bëhej me anë të Kolegjumit elektoral. Përfundimisht, delegatët u pajtuan që mandati i presidentit të jetë katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat të ri. Hartuesit e kushtetutës formuan edhe Gjykatën Supreme dhe autorizuan Kongresin për formimin e gjykatave federale të ciklit të ulët.

Më 17 shtator të vitit 1787, pasi u nënshkrua nga shumica e delegatëve pjesëmarrës, Kongresi i Dytë Kontinental e dërgoi kushtetutën te shtetet për ratifikim. Lypsej vota e nëntë shteteve para se dokumenti të hynte në fuqi. Nju – Hëmpsheri ishte shteti i nëntë që bëri që kushtetuta të hynte në fuqi më 21 qershor të vitit 1788.⁹ Në

⁷ Zenun Halili, Politika dhe Qeverisja e SHBA-ve, botoi Adea, Prishtinë (2006) f.30

⁸ Ibid, f.31.

⁹ Shih Kushtetuta e SHBA-ve, me shënime sqaruese, botuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, f.7.

disa shtete federalistët mund të mos kishin arritur kurrë ratifikimin e kushtetutës, po mos të kishin premtuar amendamentet.

Kushtetuta e SHBA-së e vitit 1787

Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila përbëhet nga shtatë nene dhe 27 amendamente, është kushtetuta e parë në botë e shkruar thellësisht me karakter juridik. Për nga gjatësia, kjo kushtetutë, bënë pjesë në llojin e kushtetutave me procedurë shumë të ngurtë ndryshimi. Gjatë hartimit të kushtetutës, Etërit Themelues, u mbështeten në katër parime kryesore, me të cilat ata e ndërtuan sistemin e ri politik të Shteteve të Bashkuara. Këto parime ishin: republikanizmi, federalizmi, ndarja e pushteteve dhe sistemi i kontroleve dhe balancimeve të pushtetit.¹⁰

Duke iu frikuar tiranisë, hartuesit e Kushtetutës bënë ndarjen e kompetencave qeverisëse në mes të Qeverisë Kombëtare dhe qeverive shtetërore. Qëllimi ishte që të formohej sistemi i parë federal në botë, në të cilin 13 shtetet e atëhershme të pavarura do të bashkoheshin së bashku nën ombrellën e një qeverie të përbashkët kombëtare. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Qeveria Kombëtare, që e ka selinë në Uashington, D.C., zbatohen për çdo individ që jeton brenda kufijve kombëtarë, kurse ligjet, në secilin nga pesëdhjetë shtetet, zbatohen vetëm për banorët e atyre shteteve.¹¹

Në bazë të federalizmit amerikan, Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara është burim i autoritetit si për Qeverinë Kombëtare, ashtu edhe për ato të shteteve. Ky dokument, nga ana e tij, reflekton vullnetin e popullit amerikan që është pushteti suprem në një demokraci.¹² Me një fjalë, sistemi amerikan i ligjvënies mbështetet në një themel, ku autoriteti është i ndërthurur. Shtetet dhe kushtetutat e shteteve ekzistojnë brenda një sistemi federal, të qeverisur nga Kongresi, nga presidenti dhe nga një sistem federal gjykatash, në kuadrin e Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kongresi: Neni I i Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara i jep të gjitha kompetencat ligjvënëse të Qeverisë Kombëtare Kongresit, të

¹⁰ Janda, Berry, Goldman: The Challenge of Democracy. Government in America. Third Edition, published by Houghton Mifflin Company, 1992.f.82.

¹¹ Daniel J.Elazar:Exploring Federalism; University of Alabama Press, 1991 , f.34.

¹² David J.Bodenhamer:"Federalizmi dhe Demokracia", kumtesa nr.4, e botuar në përmbledhjen "Kumtesat mbi Demokracinë", f.1.

ndarë në dy dhoma: Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve.¹³ Kongresi, i përbërë nga dy dhoma, ishte ndër kompromiset më të rëndësishme që u arritën në Kuvendin Kushtetues. Shtetet e mëdha e përkrahnin Planin e Virxhinisë, sipas të cilit çdo shtet do të përfaqësohej në bazë të numrit të popullsisë. Ndërsa shtetet e vogla ishin për Planin e Nju-Xhersit, sipas të cilit të gjitha shtetet do të kishin përfaqësim të njëjtë. Me kompromisin e arritur u vendos që të gjitha shtetet të kenë përfaqësim të njëjtë në Senat, kurse Dhoma e Përfaqësuesve të zgjidhet sipas numrit të popullsisë. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës të gjitha shtetet, përpos Nebraskës, kanë legjislatura dydhomëshe.

Presidenca: Neni II i Kushtetutës sanksionon se pushteti ekzekutiv ushtrohet nga presidenti i Shteteve të Bashkuara, i cili, së bashku me zv.presidentin, gjedhet me anë të Kolegjiutit Elektoral për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat tjetër. Presidenca e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është themeluar më shumë se 200 vjet më parë, si një institucion i vogël dhe jo aq i fuqishëm. Sot Dega Ekzekutive është shumë më e madhe, më e fuqishme, por edhe e kontrolluar.¹⁴ Hartuesit e Kushtetutës e krijuan Presidencën e SHBA-së pa pasur ku të bazoheshin për një sistem të tillë, sepse deri atëherë asnjë shtet i botës nuk e kishte zgjedhur ekzekutivin e vet në mënyrë demokratike.

Gjykatat: Neni III i Kushtetutës sanksionon se “ i tërë pushteti gjyqësor i Shteteve të Bashkuara do t’i vishet një gjykatë supreme, si dhe gjykatave të tjera më të ulëta, që mund t’i themelojë Kongresi kohë pas kohe.”¹⁵ Kongresi e ruan edhe sot të drejtën për të krijuar e suprimuar gjykata federale, si dhe për të përcaktuar numrin e gjykatësve federalë, por ai nuk mund të suprimojë Gjykatën Supreme. Gjykata supreme-është gjykata më e lartë e Shteteve të Bashkuara dhe e vetmja e krijuar nga Kushtetuta. Vendimi i Gjykatës Supreme nuk mund të apelohej në ndonjë gjykatë tjetër. Duke e shfrytëzuar **doktrinën e kontrollit gjyqësorë**, si dhe autoritetin e madh që ka gëzuar, kjo gjykatë i ka dhënë vetës të drejtë të lëshohet edhe në vlerësimin e përshtatshmërisë së amendamenteve, përkatësisht ndryshimeve dhe plotësimeve të Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara

¹³ Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara, Neni I, Paragrafi 1.

¹⁴ Michael A.Genovese The Power of the American Presidency 1789-2000. Published in 2001, by Oxford University Press, f.1.

¹⁵ Donald L.Carper, Norbert J..Mietus, Bill W.West: Understanding the Law.Third Edition.Published in 2000, by Thomson Learning,f.53.

të Amerikës.¹⁶ Kjo kompetencë e mbikëqyrjes gjyqësore nuk sanksionohet me Kushtetutë, por ajo përbën një doktrinë, të cilën Gjykata Supreme e ka adaptuar në rastin Marberi kundër Medisonit të vitit 1803.

Karta e të Drejtave

Duke qenë se në vitin 1787, shumica e kushtetutave shtetërore kishin pasur edhe nga një deklaratë të qartë për të drejtat e njeriut, shumica e amerikanëve mendonin se Kushtetuta e re nuk mund të quhej e plotë pa një deklaratë të tillë. Zgjerimi i kompetencave të Qeverisë Kombëtare dhe frika se një qeveri e tillë do të mund t'i shkelte të drejtat dhe liritë civile, çuan në kërkesat e antifederalistëve për përfshirjen e një karte për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Amerikë. Në anën tjetër, federalistët argumentonin se nuk kishte arsye për shqetësime të tilla, ngase të drejtat që me Kushtetutën e propozuar i delegohen Qeverisë Kombëtare, janë të pakta dhe të kufizuara, kurse ato që duhet t'u mbeten shteteve të veçanta, janë të shumta dhe të pakufizuara.¹⁷ Në fund, federalistët u pajtuan për një kartë të tillë me 10 amendamente kushtetuese.

Amendamenti 1 - ia ndalon Kongresit nxjerrjen e ligjeve për vendosjen e një feje, apo për ndalimin e ushtrimit të lirë të saj, për kufizimin e lirisë së fjalës dhe shtypit, apo të të drejtës për t'u grumbulluar në mënyrë paqësore dhe për t'i parashtruar qeverisë plotësimin e kërkesave nëpërmjet peticionit.

Amendamenti 2 - është mjaftë i diskutueshëm, e ndalon Qeverinë Kombëtare të kufizojë të drejtën për të mbajtur armë. Amendamenti u aprovua me qëllim që Kongresi të mos mund të çarmatoste Forcat Mbrojtëse Territoriale të një shteti të veçantë, por në disa shtete individët mendojnë se ky amendament ua lejon të drejtën për armëmbajtje.

Amendamenti 3 - i mbron qytetarët nga strehimi i ushtarëve në kohë paqesje në çfarëdo shtëpie pa pëlqimin e pronarit të saj, as edhe në kohë lufte, në qoftë se një gjë e tillë nuk është e caktuar me ligj. Ky

¹⁶ Kurtesh Salii: "E Drejta Kushtetuese I", ribotuar nga Universiteti i Prishtinës, në vitin 2001, f.111.

¹⁷ Letra e Federalistit, nr. 45, të cilën e ka shkruar Xhejms Medisoni më 26 Janar 1788.

amendament doli nga një ankesë e vjetër kundër anglezëve, të cilët i kishin detyruar qytetarët të strehonin ushtarët në shtëpitë e tyre.

Amendamenti 4 - thotë se të drejtat e qytetarëve për të gëzuar sigurinë e personit dhe të banesës, të dokumenteve dhe të pasurisë së tundshme kundër kontrollit dhe konfiskimit të padrejtë nuk mund të shkelen. Sipas këtij amendamenti, urdhri i kontrollit dhe i arrestimit mund të lëshohet vetëm kur është i arsyetuar mirë dhe i shoqëruar me deklaratën e betimit ose premtimit solemn, si dhe ku duhet të jetë përcaktuar me hollësi vendi në të cilin do të kryhet kontrolli, bashkë me emrat e personave që do të arrestohen apo të sendeve që do të konfiskohen.¹⁸

Amendamentet 5, 6 dhe 8 - merren kryesisht me të drejtat e personave të akuzuar për shkeljen e Ligjit Federal. Nëpërmes Amendamentit të 5-të sigurohet se askush nuk mund të dal në gjyq për një krim federativ pa qenë akuzuar nga një juri e lartë. Po ashtu, sipas këtij amendamenti, askush nuk mund të gjykohet dy herë për të njëjtën shkelje të ligjit, as nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes në një çështje penale, as të privohet nga jeta, nga liria dhe nga pasuria, pa u zhvilluar një proces i rregullt gjyqësor.

Amendamenti i 6-të kërkon që ndaj personave të akuzuar të zhvillohet një proces gjyqësor i shpejtë dhe i hapur nga një juri pa paragjykime. Në amendamentin e 7-të bëhet fjalë për gjykimet në çështjet e rëndomta, ku shuma e kontestuar i kalon 20 dollarë.

Amendamenti 9 - garanton se mos renditja e disa të drejtave të tjera në Kartën e të Drejtave nuk bëhet për të mohuar apo për të nënvleftësuar të drejtat e tjera që i ruan populli.

Sipas amendamentit 10, të drejtat të cilat Kushtetuta Kombëtare nuk ua njeh, ose që nuk ua ndalon shteteve të veçanta, i përkasin shteteve dhe popullit.

Disa Amendamente të tjera

Kongresi e ndaloi importimin e sklleverve në vitin 1808, pas periudhës njëzetvjeçare, që e përcaktonte Kushtetuta, por shtetet jugore, të cilat merreshin me veprimtari bujqësore, nuk e përkrahën një vendim të tillë, i cili do të ndikonte në zhvillimin e tyre ekonomik. Në bazë të traditës, femrat trajtoheshin si qytetarë të rendit të dytë.

¹⁸ Versioni shqip i Kushtetutës së SHBA-ve, me shënime sqaruese, shpërndarë nga Shërbimi Informativ i Shteteve të Bashkuara .f. 44.

Amendamenti 13 - i dha fund skllavërisë në Shtetet e Bashkuara, por padrejtësitë ndaj zezakëve vazhduan edhe më tej. Më 13 qershor 1866 Kongresi propozoi

Amendamenti 14 - të gjithë personave të lindur në Amerikë dhe të gjithë atyre që janë bërë shtetas sipas ligjeve, u njihej shtetësia dhe u garantohej mbrojtja e barabartë me ligjet e vendit.

Amendamenti 15 - u zgjerua e drejta e votimit në Amerikë, ratifikuar më 3 shkurt të vitit 1870. Në vitin 1920, koalicioni, i përbërë nga femrat e grupeve të ndryshme sociale dhe shoqërore, arriti të sigurojë ratifikimin e Amendamentit të 19-të dhe futjen e tij në Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara.

Amendamenti 19 - garantonte të drejtën e femrave për të votuar, kurse Amendamenti i 26-të u njuh të drejtën e votës shtetasve në moshën 18 vjeç e sipër.¹⁹

Përfundim

Adaptimi i Kushtetutës amerikane ishte një arritje e habitshme. Duke krijuar degët e ndara legjislative dhe ekzekutive dhe duke fuqizuar gjyqtarët e pavarur, për të zbatuar një katalog të të drejtave themelore, Etërit Themelues të Shteteve të Bashkuara, ndërtuan një strukturë shembullore për qeverisje nga populli për popullin. Kushtetuta në Shtetet e Bashkuara paraqet aktin më të lartë juridik dhe që nga miratimi, formalisht ka mbetur e pandryshuar. Si e tillë, ajo konsiderohet si kushtetuta e parë moderne e shkruar në botë, kushtetuta e parë federative, dhe kushtetuta më e shkurtër në botë. Dy qëllimet kryesore të Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara ishin, si të thuash, një kontratë shoqërore e një filozofie demokratike, që përfshinte “ themelimin e një bashkimi më të përsosur” të Shteteve të Bashkuara të Amerikës si dhe “ bekimin e lirisë “ për çdo individ, jo vetëm për brezin e atëhershëm, por për të gjithë brezat që vijnë më vonë. Miratimi i Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara ishte një moment me rendësi historike, jo vetëm për Amerikën, por edhe për të gjithë botën. Ajo ishte një kushtetutë që për herë të parë në histori u shkrua nga “populli për popullin “.

¹⁹ David P. Currie The Constitution of the United States. (2000) University of Chicago Press, f. 70.

Summary

The U.S. Constitution established America's national government and fundamental laws, and guaranteed certain basic rights for its citizens. It was signed on September 17, 1787, by delegates to the Constitutional Convention in Philadelphia, presided over by George Washington. Under America's first governing document, the Articles of Confederation, the national government was weak and states operated like independent countries. At the 1787 convention, delegates devised a plan for a stronger federal government with three branches—executive, legislative and judicial—along with a system of checks and balances to ensure no single branch would have too much power.

The Bill of Rights –10 amendments guaranteeing basic individual protections such as freedom of speech and religion –became part of the Constitution in 1791. To date, there have been a total of 27 constitutional amendments. The U.S. Constitution compared with others in the states and in the world, is relatively short. Because amending it is difficult. Due to this fact it has remained largely intact for over two hundred years. In large parts, this is because the principles set forth in the Constitution are sufficiently broad that they can be adapted to meet the needs of a changing society. The Constitution did not result just from creative thinking. Many of its provisions were grounded in contemporary political philosophy. The delegates to the Constitutional Convention in 1787 brought with them to important sets of influence: their political culture and their political experience. In the years between the first settlements in the New World and the writing of the Constitution, Americans had developed a political philosophy about how people should be governed and had tried numerous forms of government. These experiences gave the founders the tools with which they constructed the Constitution.

Literatura

- Bardes, Shelley, Shmidt: American Government and Politics Today, 2004-2005 Edition. Published by, Thompson Learning, Inc.
- Robert Devenport: American History, (2003), Alpha –A Pearson Education Company.
- Janda, Berry, Goldman: The Challenge of Democracy. Government in America. Third Edition, published by Houghton Mifflin Company, 1992
- Lambro Filo: “ Historia e sistemeve të qeverisjes”, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2000.
- Daniel J. Elazar: Exploring Federalism; University of Alabama Press, 1991
- Luan Omari: “Sistemi Parlamentar”, botimi i tretë, Shtëpia Botuese “Elena Gjika”, Tiranë, 2004.
- Arsim Bajrami: “Parlamentarizmi” (Aspekte krahasuese) Prishtinë, 2010.
- Aurela Anastasi: “Historia e institucioneve”, Librit Universitar, Tiranë, 2002.
- Michael A. Genovese The Power of the American Presidency 1789-2000. Published in 2001, by Oxford University Press.
- Irving Stevens: Constitutional and Administrative Law. (1996), Pitman Publishing.

HULUMTIMI I PJEKURISË EMOCIONALE TË NXËNËSVE ADOLESHENTË NË SHKOLLËN E MESME TEKNIKE “28 NËNTORI” NË PRISHTINË

KDU 159.9

173.5

Abstrakt

Në këtë punim është hulumtuar në mënyrë empirike pjekuria emocionale e nxënësve adoleshentë në Shkollën e Mesme Teknike “28 Nëntori” në Prishtinë . Analiza përfshin 100 nxënës të vitit të parë (klasat e X-ta) dhe 100 nxënës të vitit të katërt (klasat e XIII –ta) të kësaj shkolle. Zgjedhja e tillë e mostrës ka për qëllim të vë në pah pjekurinë emocionale në varësi të moshë së nxënësve adoleshentë.

Për hulumtim është përdorur testi standard për njohurinë e pjekurisë emocionale. Nxënësit, fillimisht janë njoftuar deri në detaje lidhur me temën e hulumtimit dhe sidomos me faktin se ky hulumtim është anonim dhe se rezultatet e tij do të përdoren vetëm për qëllime hulumtuese. Kështu, në pyetësin për njohjen e pjekurisë emocionale nuk ka figuruar emri dhe mbiemri i nxënësve, por vetëm gjinia. Nga rezultatet e këtij hulumtimi ka dalë pjekuria emocionale, në varësi të moshës dhe gjinisë së nxënësve adoleshentë.

Fjalë çelës: *Pjekuria emocionale, nxënësit adoleshentë*

Hyrje

Termi emocion e ka prejardhjen nga fjala latine emovare, “lëviz”¹. Emocioni është gjendje psikologjike e ndërlikuar, që shpreh gjendje shpirtërore të trazuar të individit, e cila e shtyn atë për të reaguar apo për të kryer veprime e sjellje të caktuara. Si të tilla, ato janë pjesë e pandarë dhe e domosdoshme për funksionimin e botës shpirtërore të individit.

Emocioni si përgjigje, apo si reagim ndaj një stimuli apo ngacmuesi të caktuar, tek individit shkakton: eksitim fiziologjik, ndjenjë subjektive, interpretim konjitiv, sjellja e dukshme etj.

Emocioni u jep përparësi njërit apo më tepër drejtimeve të aktivitetit për të cilat krijon ndjenjën e urgjencës, ashtu që ajo mund të ndalet ose të garojë me procese alternative shpirtërore, ose me aktivitet.

¹ Nushi,P.(2014)'' Leksikon i psikologjisë, Vëllimi I'', ASHAK, f.191

Paraqitja e emocioneve është gjithmonë e shoqëruar me disa ndryshime fiziologjike në organizëm. P.sh. me rastin e frikës dhe zemërimit, është konstatuar rritja e adrenalinës në gjak. Si rezultat kemi zbrërthimin e shpejtë të glikogjenit në sheqer ushqyes, që ka për pasojë rritjen e vrullshme të sheqerit në gjak. Si ndryshim tjetër fiziologjik me rastin e emocioneve është ndryshimi i përmasave të enëve të gjakut në lëkurë dhe ndryshimet në punën e gjëndrave të djersitjes.

DEFINIMI I PJEKURISË EMOCIONALE DHE ANALIZA E SAJ

Pjekuria ndjenjore, përkatësisht pjekuria emocionale e njeriut, nënkupton kontrollin e përjetimeve dhe të reagimeve ndjenjore të njeriut si dhe përpjekjet e vetëdijshme për zhdukjen e përjetimeve dhe të reagimeve të atilla emocionale, të cilat njeriu i konsideron të padëshirueshme për të.

Lëvizjet e trupit dhe toni i zërit janë më zbuluese të emocioneve të fshehura sesa fytyra.²

Kështu, mund të konstatohet se: zhdukja e përjetimeve dhe e reagimeve ndjenjore, të padëshirueshme për njeriun, e paraqet një rëndësi të pjekurisë ndjenjore të njeriut. Zhvillimi i përjetimeve dhe i reagimeve të njeriut, me ndjenja të dëshirueshme dhe të kontrolluara, paraqet një komponentë tjetër të pjekurisë emocionale. Pjekuria emocionale e ka edhe komponentën e përjetimit dhe të reagimit emocional të njeriut, sipas përcaktimeve dhe zakoneve të qëndrueshme sociale.

Personat me pjekuri emocionale, rrallëherë ankohen për vendimet e tyre, ata nuk eksitohen lehtë dhe mjaft mirë ia dalin që të kontrollohen edhe në kushtet e situatave stresuese.

Një nga metodat për matjen e pjekurisë emocionale është e bazuar në punimet e Salovey dhe Mayer (1990). Kështu, një mënyrë për matjen e pjekurisë emocionale tek individit, është nëpërmjet të testeve për aftësi specifike të njerëzve. Këto teste kanë shumë rëndësi, sidomos për punën e përditshme që zhvillohet në ambientet shkollore. Njohja e komponentit emotiv, zhvillimi dhe edukimi i saj në vazhdimësi, e bënë të mundur që shkallë-shkallë të mësohen nxënësit se si t'i drejtojnë në mënyrë inteligjente emocionet e veta, në mënyrë që ato t'i shërbejnë si mbështetje për çdo sjellje të individit.

² Pango, Y. (2005) "Psikologji sociale", BU, ILAR, Tiranë, 2005. f. 99.

Në përgjithësi, pjekuria emocionale e përfshin aftësinë e vetëmenaxhimit dhe aftësinë e individit për t'u lidhur me të tjerët.

Në grupin e aftësisë për vetëmenaxhim bëjnë pjesë: **Njohja e vetes** (individët, të cilët e njohin veten, ata në një shkallë të madhe i dinë dobësitë e tyre dhe për ato dobësi flasin para të tjerëve hapur; **Vetregullimi** (aftësi e individit për t'i drejtuar impulset dhe ndjenjat shqetësuese në rrafshin e qëllimeve të mira për veten dhe **Motivacioni** (aftësia e individit për ta drejtuar drejt veten për të arritur rezultate sa më të mira dhe për t'i gëzuar ato).

Në grupin e aftësive për t'u lidhur me njerëzit e tjerët bëjnë pjesë: **Empatia** (aftësia e individit për t'i kuptuar emocionet e të tjerëve dhe për t'i trajtuar ata në varësi të reagimeve të tyre emocionale); **Aftësitë sociale** (aftësia e individit për të gjetur pika të përbashkëta dhe për të ndërtuar raporte të mira njerëzore me persona të tjerë).^{3 4}

Jack Majer dhe Peter Salovey, në vitin 1990, e kanë përkufizuar pjekurinë emocionale si pjekuri sociale, e cila i përfshin aftësinë për t'i monitoruar ndjenjat dhe emocionet e vetes dhe të të tjerëve, si aftësi për t'i dalluar emocionet e caktuara dhe për t'i përdorur ato në drejtimin e duhur.

Në vitin 2005, S.Hein, ka dhënë një përkufizim për pjekurinë emocionale:

“Pjekuria emocionale është fuqia e lindur për të ndier, për të përdorur, për të kombinuar, për t'i kuptuar, mësuar dhe menaxhuar emocionet”. Kështu, pra, sipas Hein-it, pjekuria emocionale është fuqi e lindur, e cila varet nga aftësia e individit për t'i ndier emocionet dhe përfshin në vetvete aftësinë për të kuptuar ndjenjat.

Sipas Hein-it, inteligjenca e lindur mund të zhvillohet ose edhe të shkatërrohet nga përvojat jetësore dhe kjo ndodh, sidomos nga mësuesit, prindërit dhe nga të afërmit e tjerë gjatë fëmijërisë dhe të periudhës së adoleshencës. Kështu, është e mundur që një person të ketë një inteligjencë emocionale të lartë dhe e njëjta inteligjencë emocionale gjatë fëmijërisë të shkatërrohet emocionalisht, duke e arritur kështu një koeficient emocional të ulët. Përveç kësaj, mund të ndodhë edhe e kundërta.

³ Orhani, Z. (2011)'' Psikologji e emocioneve'' , Shtëpia botuese ''Vllamasi'', Tiranë, ff.158-165.

⁴ Golman,D. (1995)''Intelegjenca emocionale,pjesa e parë,Bantam Books, ff. 142-147

Rëndësia e pjekurisë emocionale

Studiuesit e ndryshëm të lëmit të pjekurisë emocionale kanë arritur edhe në përfundimet si në vijim:

- *Pjekuria emocionale* - është faktor i rëndësishëm për cilësinë e jetës së individit dhe për arritjen e suksesit të tij në punë. Pra, personat të cilët dinë t'i drejtojnë dhe t'i menaxhojnë mirë emocionet e tyre dhe kuptohen me të tjerët, kanë më shumë gjasa për të bërë një jetë të kënaqshme dhe efektive.
- *Shëndeti emocional* është faktor kryesor për të mësuarit efektiv. Për të pasur sukses në mësim, nxënësi apo studenti, është e nevojshme kuptueshmëria e mënyrës se si mësojmë dhe lidhur me këtë është qenësore të kemi një zgjim të interesit për dije, aftësi për komunikim, aftësi për kooperim etj. Të gjitha këto tipare janë aspekte të pjekurisë emocionale. Kështu, mund të konstatohet se pjekuria emocionale ka dhënë prova më të mira në raport me analizat, të cilat bëhen me metodat tradicionale, siç është koeficienti i inteligjencës, apo testet e standardizuara lidhur me këtë koeficient.

Në këtë kuadër pjekurinë emocionale e formësojnë faktorët, si në vijim:

Njohja e vetes dhe e emocioneve tek të tjerët

Njohja e vetes është njëra nga komponentët kryesor të pjekurisë emocionale. Disa persona janë të vetëdijshëm për emocionet e tyre dhe për to kanë krijuar edhe mendime personale lidhur me ndjesitë që i përjetojnë dhe për të njëjtat emocione, ata, kanë krijuar edhe reflekse të caktuara, edhe reagime përkatëse.

Në përgjithësi, njerëzit të cilët nuk janë të vetëdijshëm për ndjenjat e tyre dhe nuk janë në gjendje t'i kontrollojnë ndjenjat e tyre, ata në përgjithësi, në moment të caktuara, nuk janë në gjendje që të bëjnë zgjidhje të mençura për probleme të caktuara jetësore. E tërë kjo është konstatuar se mund të ketë edhe efekte të caktuara edhe në marrëdhëniet ndërpersonale.

Në rastet e shumta, nga miqtë dhe bashkëpunëtorët tonë, mund t'i kuptojmë më mirë disa nga sjelljet tona personale. Për këtë arsye, ndaj këshillave, të cilat na japin të tjerët (miqtë dhe dashamirët) duhet të jemi plotësisht të hapur.

Kontrollimi dhe menaxhimi i emocioneve

Në përgjithësi, jemi kryesisht ne, ata që kemi mundësi për t'i kontrolluar emocionet e caktuara, si për nga intensiteti, ashtu edhe për nga kohëzgjatja e tyre. Për këtë arsye, ne duhet të mësohemi për t'i kontrolluar emocionet tona, përkatësisht komponentët, që lidhen me eksperiencën tonë, lidhur me emocionet për të mënjeluar kështu zemërimin momental dhe për të vendosur kontrollin e caktuar mbi reagimet tona afektive dhe për t'i larguar në kohën e duhur pasojat e këtyre afekteve momentale në sjelljen tonë.

Veprimet e individit për ta modifikuar situatën, e cila shkakton emocion quhet KOPING. Në kushtet kur situatë e caktuar edhe pas aplikimit të koping-ut nuk merr drejtimin e duhur, atëherë duhet bërë modifikime përkatëse në sjellje. Nëse situata konkrete është modifikuar, deri në atë masë, sa më nuk pritet ndonjë shpërthim i ndonjë emocioni të ri, themi se emocioni i pritur e ka mbaruar aktivitetin e tij dhe se i njëjti është shuar.

Në situatë komplekse, shqisat tona grumbullojnë shumë informacione, nga të cilat vetëm një pjesë e vogël nga ato përpunohet me vetëdije. Kështu, edhe reagimet tona emocionale veprojnë sipas disa informacioneve, të cilave në një moment të caktuar, ne iu kemi dhënë rëndësi më të madhe në krahasim me disa informacione të tjera, të cilat në atë moment i kemi lënë pas dore. Pranimi i sa më shumë informacioneve lidhur me një problematikë, e cila në një moment është element potencial për të krijuar emocione, si dhe analiza dhe përpunimi i atyre informacioneve lidhur me atë problematikë të caktuar është një hap i rëndësishëm i rritjes së pjekurisë emocionale.

Në mjaft situata, ne mund ta kuptojmë se një emocion i caktuar po na paralizon, duke penguar pjesëmarrjen për vendime të proceseve të larta mendore. Në shkollë, emocioni i fuqishëm mund të lindë, qoftë edhe nga një qortim i thjeshtë nga ana e mësimitdhënësit. Nëse ky proces përsëritet me kohë, mund të rezultojë edhe me keqësim të raporteve mësimitdhënës - nxënës. Në këto kushte, kur ne e identifikojmë emocionin, nivelet e aktivitetit cerebral janë të ulëta dhe

është shumë lehtë të vendoset kontrolli i emocioneve . Nëse ne presim që shkalla e aktivizimit cerebral të ngrihet, atëherë aftësitë për vetëkontroll të emocioneve të caktuara zvogëlohen. Kështu, nxënësit duhet të njoftohen me shenjat fiziologjike të emocioneve karakteristike, të cilat e paralajmërojnë një emocion negativ. Nëse p.sh. ndodh rrahje e shpejtë e zemrës, djersitje e duarve dhe djersitje e ballit, janë shenja të ankthit. Një emocion i tillë mund të shmanget me një ndërhyrje taktike të mësuesit, nëpërmjet të ushtrimeve argëtuese me nxënësit.

Komponentë tjetër e pjekurisë emocionale është aftësia e individit për ta motivuar veten, për të arritur qëllimet e veta madhore përkatësisht aftësia e tij për ta privuar veten nga kënaqësitë e momentit, me qëllim të arritjes së qëllimeve më të rëndësishme më vonë.

Qëllimi i hulumtimit dhe kërkimit

Nga problemi i hulumtimit dalin qëllimet e hulumtimit. Qëllimi kryesor i hulumtimit është që të bëjmë një studim lidhur me pjekurinë emocionale dhe lidhshmërinë e saj me moshën dhe gjininë e adoleshentëve.

Mund të theksoj se arsyeja kryesore që më ka shtyrë ta bëj këtë hulumtim empirik është njohja e pjekurisë emocionale të nxënësve, të cilët si fëmijë e kanë përjetuar luftën në Kosovë dhe shumë vështirësi të tjera në kohën e fillimit të ndërtimit të vendit. Përveç kësaj, kam dashur ta njoh dhe hulumtoj pjekurinë emocionale, në varësi të moshës dhe të gjinisë të këtyre nxënësve.

ORGANIZIMI DHE PËRPUNIMI I REZULTATEVE TË HULUMTIT

Hulumtimi i pjekurisë emocionale të nxënësve adoleshentë është kryer në muajin prill të vitit 2011, në Shkollën e Mesme Teknike''28 Nëntori'', fillimisht me 100 nxënës të vitit të katërt (klasat e trembëdhjeta) dhe me 100 nxënës të vitit të parë (klasat e dhjeta) të po kësaj shkolle. Nga ky numër i nxënësve të testuar janë përzgjedhur 100 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 100 nxënës të gjinisë femërore. Nxënësit, fillimisht janë njoftuar deri në detaje lidhur me temën e

hulumtimit dhe sidomos, me shumë kujdes, atyre u është sqaruar se ky hulumtim është anonim dhe se rezultatet e tij do të përdoren vetëm për qëllime hulumtuese. Të udhëhequr nga ky parim, në pyetësor nuk ka figuruar emri dhe mbiemri i nxënësit, por vetëm gjinia. Në këtë mënyrë, nxënësve u është dorëzuar udhëzimi për mbushjen e pyetësorit (**testi standard i njohurisë emocionale**) i cili përmban 25 pyetje, ndërsa përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të tij, nxënësve u është sqaruar deri në detaje. Bazuar në rezultatet e testit, përcaktohet pjekuria emocionale për një nxënës sipas barazimit:

$$P_{e,1} = \frac{Sh_{pik}}{NR_{pyt}} = \frac{Sh_{pik}}{25}$$

Ku janë:

Sh_{pik} - Shuma e pikëve të mbledhura sipas testit të njohurisë emocionale;

NR_{pyt} - Numri i tërësishëm i pyetjeve të testit për njohjen e pjekurisë emocionale

Në mënyrë të ngjashme e përcaktojmë pjekurinë emocionale për secilin nxënës dhe e gjejmë mesataren aritmetike. Nëse kjo mesatare del në diapazonet: 21 deri 24 pikë, vlerësohet gjendje emocionale shumë e mirë; me 17 deri 20 pikë, vlerësohet gjendje e kënaqshme emocionale; me 13 deri 16 pikë - gjendje rinore emocionale; me 10 deri 12 pikë – gjendje fëmijërore emocionale dhe më pak se 10 pikë vlerësohet gjendje infantile, ose pjekuria emocionale e paarrirë.

Sipas barazimit të cekur, i llogarisim vlerat e pjekurisë emocionale për të gjitha mostrat e pranuar për shqyrtimin e 100 nxënësve të klasave të trembëdhjeta (nga ky numër është marrë mostra e 50 meshkujve dhe 50 femrave) dhe për të gjitha mostrat e pranuar për shqyrtim për 100 nxënës të klasave të dhjeta (nga ky numër janë vlerësuar 50 meshkuj dhe 50 femra). Pas kësaj llogaritjeje, është përcaktuar mesatarja aritmetike e pjekurisë emocionale për 50 meshkuj dhe për 50 femra dhe pjekuria mesatare për të gjithë nxënësit. Rezultatet e shqyrtimit janë paraqitur në tabelën vijuese.

Pjekuria mesatare emocionale e 100 (50 femra dhe 50 meshkuj) nxënësve adoleshentë të klasave të dhjeta të 100 (50 femra dhe 50 meshkuj) nxënësve të klasave të tetë të Shkollës së Mesme Teknike ‘‘28 Nëntori’’ në Prishtinë

	Pjekuria mesatare emocionale, klasa X	Pjekuria mesatare emocionale, klasa XIII
50 Femra (F)	17.83	18.1
50 Meshkuj (M)	17.6	17.9
100 (F+M)	17.75	18.0

ANALIZA E REZULTATEVE TË PËRFITUARA

Nga rezultatet e përpunuara të pasqyruar në tabelë shihet se pjekuria mesatare aritmetike për 50 nxënës femra ka dalë **17.83**, e cila i përket diapazonit të gjendjes emocionale të kënaqshme (17 deri 20) pikë. Edhe pjekuria mesatare aritmetike për 50 nxënës meshkuj, ka dalë **17.6**, e cila gjithashtu i përket diapazonit të gjendjes emocionale të kënaqshme. Për pasojë, edhe për tërë mostrën e hulumtimit prej 100 nxënësve, pjekuria emocionale është gjithashtu e kënaqshme.

Nga analiza e mostrës, prej 50 femrash dhe 50 meshkujsh, nxënës të klasës së dhjetë, del se femrat janë për 1.31 % më të pjekura emocionalisht se sa meshkujt, nxënës të klasës së njëjtë.

Nga kjo analizë del se femrat, nxënës të klasës së tetë janë për 1.12 % më të pjekura emocionalisht se sa djemtë, nxënës të klasës së njëjtë.

Për të dy grupmoshat e mostrës së shqyrtuar, ka rezultuar se femrat janë emocionalisht më të pjekura se meshkujt. Kjo diferencë e pjekurisë emocionale është më e madhe për grupmosha më të reja, dhe e njëjta zvogëlohet me rritjen e moshës.

Nga analiza del se pjekuria emocionale është rritur me rritjen e moshës së nxënësve adoleshentë. Kështu, nxënësit e klasave të trembëdhjeta kanë rezultuar me pjekuri emocionale për 1.4% më të lartë se sa nxënësit e klasave të dhjeta. Kjo rritje e pjekurisë emocionale me rritjen e moshës te meshkujt, ka dalë se është për 0.1 % më e lartë se sa te femrat.

PËRMBLEDHJA

Ne këtë hulumtim është treguar një analizë e detajuar e pjekurisë emocionale të nxënësve adoleshentë, sipas moshave dhe gjinive në një shkollë të mesme të Republikës së Kosovës. Nga analiza empirike e pjekurisë emocionale ka rezultuar se nxënësit adoleshentë në këtë shkollë janë në gjendje të kënaqshme të pjekurisë emocionale. Pjekuria emocionale ka shënuar rritje me rritjen e moshës. Kjo rritje e pjekurisë emocionale ka rezultuar më e theksuar te meshkujt.

Për të dy grupmoshat e analizuara me nxënësit e klasës së dhjetë dhe të klasës së trembëdhjetë, ka rezultuar se femrat e të njëjtës moshë janë pak më të pjekura se meshkujt. Kjo diferencë e pjekurisë emocionale ka shënuar një rënie me rritjen e moshës.

Kjo analizë do të pasqyrojë pjekurinë emocionale të nxënësve adoleshentë, dhe i njëjti mund të shfrytëzohet si material ndihmës i rëndësishëm për punë më të kualifikuar të mësimdhënësve me nxënësit e tyre, duke e pasur në konsideratë edhe komponentën e pjekurisë emocionale të tyre.

Summary

In this investigation is shown a detailed analyse of the teenagers(pupils) emotional maturity according to ages and genders in one secondary school of Kosovos Republic. From the empiric emotional maturity analys there is a result that teenages pupils in this school have a delightful situation of emotional maturity. The emotional maturity has shown increase due to the aging. This emotional maturity increase has resulted more emphasized in men.

For two analysed age groups of pupils of X class and XIII class has resulted that females of the same age are little more matured than men. This difference of emotional maturity has shown a fall due to aging.

This analysis will reflect the emotional maturity of teenagers and the same one can be used like a helpful and important material for more qualified work of teachers with their pupils, having in consideration their emotional maturity component.

Keywords: *emotional maturity, teenagers pupils*

Literatura

- Anderson M.(1992) ‘Intelligence and development, a cognitive theory’, Oxford: Blackwell.
 Averill, J.R.(2000) “Intelligence, emotion and creativity”, San Francisco.

- Boyle, G. J., Stankov, L. M ,Cattell,R.B. (1995) ‘‘Mesaurment and statistical models in the study of personalit and intelligence’’,New York.
- Browne-Miller,A.(1995)’‘Intelligence policy’’, New York.
- Caroll,J.B.(1982)’‘The measurment of intelligence’’, New York.
- Daniel Golman(1995)’‘Emotional intelligence’’,1995.
- Daniel Goleman(1997)’‘Emocionalne intelegencije’’, përkthim nga anglishtja, Zagreb, 1997.
- Dragoti, E.(2004)’‘ Psikologjia sociale’’, Tiranë.
- Dragoti, E.(2005)’‘ Adoleshenti’’, Albdesign’’, Tiranë.
- Goleman ,D.(1997),, Emocional intelligence in context,emocional development and emocional intelligence’’, basic boks, New York.
- Goleman ,D.(1998)’‘Working with emocional intelligence’’,New York.
- Krasniqi, N.(2011)’‘ Ndikimi i pjekurisë emocionale në suksesin e nxënësve adoleshentë’’, Punim magjistrature, Tetovë.
- Nushi, P.(2002)’‘Psikologji e përgjithshme I’’, Libri shkollor, Prishtinë.
- Nushi, P.(2004)’‘Inteligjenca dhe masa e zhvillimit të saj ndër shqiptaret e moshës madhore’’, ASHAK, Prishtinë.
- Nushi, P.(2010)’‘Fjalor shpjegues i psikoanalizës’’, ASHAK, Prishtinë.
- Nushi,P.(2014)’‘ Leksikon i psikologjisë’’, Vëllimi I, ASHAK.
- Nushi,P.(2014)’‘ Leksikon i psikologjisë, Vëllimi II’’, ASHAK.
- Orhani, Z.(2011)’‘ Psikologji e emocioneve’’, Shtëpia botuese ‘‘Vllamasi’’, Tiranë.
- Pango,Y.’‘(2005) Psikologji sociale’’.ILAR, Tiranë.
- Prelvukaj,M. Berisha, N.(2006)’‘ Shkolla e mesme teknike 28 Nëntori’’,monografi, Prishtinë.

**TRYEZA:
ARKEOLOGJIA NË TROJET
SHQIPTARE: SFIDAT DHE MUNDËSITË**

SFIDAT DHE MUNDËSITË E ARKEOLOGJISË SHQIPTARE

KDU 902(=18)

Më lejoni që në fillim të them se trashëgimia arkeologjike është vlerë e përbashkët dhe se, si e tillë, është një kubik i mozaikut kulturor kombëtar, rajonal, evropian dhe botëror. Është kjo arsye pse këtë tryezë e shoh si mundësi që të diskutojmë rreth gjendjes në fushën e arkeologjisë dhe të perspektivës së saj.

Këtë tryezë e shoh edhe si mundësi që të shkëmbehen njohuritë shkencore dhe profesionale, në tumirë të mbrojtjes së integruar të trashëgimisë kulturore, nga nivelet qendrore deri tek qytetari dhe anasjelltas. Këtu zë vend dhe prezantimi dhe shfrytëzimi ekonomik i trashëgimisë së pasur dhe të llojllojshme arkeologjike, si pjesë integrale e ardhmërisë së arkeologjisë së trojeve shqiptare, të rajonit dhe më gjerë.

Kur kihen parasysh mundësitë e shumta të arkeologjisë në trojet shqiptare, shtrohet pyetja e domosdoshme: A bëmë sa kemi mundur deri më sot, apo ende dominojnë retorika e zbrazët, paragjykimet, lufta për pushtet, pseudo-profesionalizmi dhe pasioni amator? Mendoj se është e nevojshme që të reflektojmë në këtë pyetje, gjithnjë duke pasur parasysh edhe rrjedhat, që nuk janë varur gjithmonë vetëm nga ne.

E kaluara e trojeve shqiptare është e stërngarkuar me shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore për nevoja politike, veçanërisht për krijimin e të drejtës false historike të serbëve mbi Kosovën. Në kuadër të kësaj, politikat serbe kanë krijuar dhe ushqyer ndarjen e trashëgimisë në baza religjioze dhe Kosova ende ballafaqohet me përdorimin e trashëgimisë kulturore, si mjet i presionit politik, ndërsa ndarja e saj në baza etnike edhe me ‘pëlqimin’ ndërkombëtarë krijoi një absurditet *sui generis*, në kundërshtim me të gjitha konventat ndërkombëtare për trashëgiminë kulturore.

Më duket e nevojshme të ritheksohet se shkalla e studimit dhe e kujdesit ndaj trashëgimisë arkeologjike është shprehje e dy elementeve kyçe të nivelit kulturor, të një hapësire apo të një populli: 1. të nivelit kulturor në të kaluarën dhe 2. të nivelit kulturor në të sotmen. Përderisa e kaluara nuk mund të ndryshohet bashkë me nivelin kulturor të saj, me

kujdesin tonë ndaj trashëgimisë arkeologjike, ne e mbrojmë këtë dhe, njëkohësisht, dëshmojmë nivelin e sotëm tonë kulturor.

Arkeologjia dhe trashëgimia e saj janë vlera të veçanta dhe kjo nënkupton njohjen e shtresimeve kulturore në kohë dhe në hapësirë, përmes shfrytëzimit të dimensioneve të shumta që i ofron, ato shkencore dhe profesionale. Ky shfrytëzim varet nga mënyra se si i qasemi arkeologjisë dhe qasja e vetme e duhur është menaxhimi i drejt dhe mbështetja në shkencë dhe përvojat profesionale. Është kjo dhe arsye pse mendoj se, pikësëpari dhe me shumë seriozitet, duhet të parashtrihen sfidat e deritashme. Parashtrimin e sfidave duhet parë si ndihmesë për t'i evituar sa më shpejt lëshimet e derisotme dhe kurrsesi si mohim i të arriturave. Numri i këtyre sfidave nuk është edhe aq i vogël dhe këto shtohen më tej nëse nuk ndërmerren hapat e duhur sa më shpejt. Me këtë rast, do të përqendrohem në dy çështje parësore, siç janë: 1. Politikat nacionale dhe 2. Bashkëpunimi.

1. Politikat nacionale

Kur kihet parasysh se trashëgimia kulturore, e cila përfshin dhe arkeologjinë, është një ndër shtyllat kryesore të një shteti dhe të identitetit të tij, si sfida kryesore janë politikat nacionale. Me këtë nënkuptohet përpilimi i gjithmbarshëm i politikave, me prioritete shkencore dhe profesionale dhe zbatimi i tyre.

Është e natyrshme të supozohet se politikat nacionale të trashëgimisë kulturore janë përpiluar nga dy shtetet ekzistuese: Kosova dhe Shqipëria. Nëse në Kosovë janë hartuar politikat nacionale, shtrohet pyetja se cilat janë këto dhe sa zbatohen. Mbase, lidhur me këto, duhet trajtuar edhe koordinimi me politikat kulturore të shteteve ku jetojnë shqiptarët, aq më tepër që kultura dardane është në territorin e sotëm, të zhvilluar në të kaluarën edhe në territorin e sotëm të Maqedonisë dhe të Serbisë.

Përkundër proklamimit se në Kosovë ka politika nacionale në fushën e arkeologjisë, është vështirë të kuptohet se cila është ajo, nëse lihen anash politikat e rinovimit të kishave ortodokse dhe Ulpiana antike, që duhet të jenë vetëm një segment i zbatimit të këtyre politikave dhe jo çështje kyçe.

Politikat nacionale për fushën e arkeologjisë, është dashur të dalin si prioritet dhe si propozim i Institutit Arkeologjik të Kosovës dhe ky të jetë pjesë e diskutimit publik. Ky institut është dashur ta bëjë

fillimisht analizën e gjendjes së arkeologjisë, t'i përcaktojë prioritetet shkencore dhe profesionale dhe t'i evidentojë lokalitetet arkeologjike të Kosovës.

Si pasojë e veprimeve, jo të duhura dhe të veprimeve *ad hoc*:

- **Republika e Kosovës nuk e ka ende Listën e Përhershme të Monumenteve Kulturore në Mbrojtje.** Kjo listë përbën njëri nga shtyllat e shtetit dhe për përpilim e tij ka pasur financime dhe nga Britania e Madhe e të tjerë. Natyrisht, mungesa e saj lejon edhe manipulimet nga Serbia. Lista e përkohshme nuk mjafton, listë kjo që çuditërisht u nënshkrua në vitin 2014, për të dytën herë.
- **Nuk është bërë përnjohja e plotë arkeologjike e gjithë territorit të Kosovës.** Përnjohja arkeologjike është dashur t'i evidentojë të gjitha lokalitetet ekzistuese të Kosovës, duke shfrytëzuar të gjitha burimet e shkruara, duke u konsultuar me ekspertët e fushës dhe duke njohur terrenin cep më cep.
- **Në Kosovën e pasluftës kishte financime për hulumtime arkeologjike, por menaxhimi ishte i dobët dhe jo aq transparent.** Në këtë drejtim ka pasur mbështetje të Qeverisë së Kosovës, në dekadën e fundit dhe donacione të jashtme.
- **Në Kosovën e pasluftës janë bërë shumë gjurmime arkeologjike, por këto jogjithherë janë mbështetur në prioritete shkencore.**

2. Bashkëpunimi

Bashkëpunimi në fushën e arkeologjisë është një parakusht, pa të cilin nuk mund të ketë rezultate të pritura. Andaj, si sfidë e veçantë, shtrohet çështja e bashkëpunimit, përkatësisht e mbrojtjes së integruar të trashëgimisë kulturore, që nënkupton koordinimin dhe interaksionin midis niveleve të ndryshme. Në këtë drejtim, mbrojtja nënkupton bashkëveprimin e koordinuar midis ministrive të veçanta, të institucioneve, të shkencëtarëve dhe profesionistëve të fushës, të OJQ-ve e deri tek qytetari.

Mbrojtja e vërtetë e trashëgimisë nënkupton dhe bashkëpunimin me organet e sigurisë të një shteti. Mungesa e këtij bashkëpunimi, si dhe vetëdija jo e duhur për vlerat e çmuara, bënë që arkeologjia në

trojet shqiptare të ballafaqohet edhe me vjedhjen dhe tregtimin me trashëgiminë e luajtshme arkeologjike.

Në fushën e arkeologjisë janë konstatuar sfida të shumta sa i përket çështjes së bashkëpunimit, duke u nisur nga interferimet politike e deri tek anashkalimi i institucioneve dhe i individëve. Vartësia e udhëheqësve të institucioneve nga nivelet politike ishte sfidë me shumë pasoja, ndërsa bashkëpunimi midis institucioneve në Kosovë, duke u nisur nga ministritë, nuk ishte për t'u lakmuar. Anashkalimi i vazhdueshëm i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, si Agjenci e pavarur për trashëgimi kulturore e Republikës së Kosovës, është një kaptinë më vete dhe paraqet shkelje të normave juridike.

Në Kosovë ka ngjarë që Universiteti i Prishtinës të pengohet që të zhvillojë gërmime, gjë që tingëllon si absurditet më vete. Me këtë rast duhet të përkujtoj se marrëveshja e nënshkruar nga UP dhe institucionet e trashëgimisë kulturore në Kosovë, në vitin 2006, për hulumtime në Ulpianën antike ngeli vetëm në letër. Kjo nuk u realizua për shkak të mosgatishmërisë për bashkëpunim të institucioneve të trashëgimisë kulturore.

Kur kihet parasysh se universiteti krijon kuadro të reja, është e panatyrshme që e drejta për hulumtime arkeologjike t'i takojë vetëm Institutit Arkeologjik, si rezulton nga një vendim i kohëve të fundit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Natyrisht, krijimi i kuadrove të mirëfillta arkeologjike është domosdo e kohës, andaj dhe nisma e punës së Degës së Antropologjisë – Drejtimi Arkeologji pranë Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës është për t'u përshëndetur. Të mësuarit e ABC-së së arkeologjisë, si dhe në fushat e tjera, është një domosdo dhe mënyrë që të evitohen gabimet e 'ekspertëve' që në botimet e tyre e shohin shtresën e periudhës së hekurit mbi atë të periudhës romake, gjë që nuk ndodh kurrë.

Bashkëpunimi me Shqipërinë ka nisur që nga viti 2000, por duhet thënë se ky është zhvilluar në mënyrë mjaft selektive dhe me paragjykime ndaj arkeologjisë së Kosovës. Botimet *Harta Arkeologjike e Kosovës I dhe II* janë botime me vlerë, por do të ishin më të plota sikur të kishte pasur bashkëpunim të nevojshëm.

Në periudhën e kaluar ka pasur edhe mungesë të etikës profesionale arkeologjike, andaj dhe janë shfaqur përvetësimet e lokaliteteve dhe të rezultateve. Me këtë rast nuk dua të ndalem në

mundësitë që i ka ofruar ndërtimi i infrastrukturës rrugore gjithandej Kosovës, të cilës është dashur t'i paraprijë përnjohja këmbë e të gjitha traseve, si dhe prezenca e arkeologëve gjatë mihjeve në trasetë e planifikuara. Ky veprim është zhvilluar, p.sh. në Slloveni dhe në trasenë jo aq të gjatë, janë zbuluar me dhjetëra lokalitete arkeologjike.

Duke i lënë anash dhe shumë shembuj të tjerë, mund të them se në nivelin e sotëm, përkundër disa përparimeve, arkeologjia ende shihet si atraksion dhe si rrugë përfitimi individual apo grupor dhe jo si një fushë që kërkon angazhim shumë më serioz.

Perspektiva

Duke pasur parasysh se arkeologjia mbështetet në shkencë dhe se për zhvillimin e saj duhet pasur vizion, mendoj se sa më shpejt duhen ndërmarrë veprimet vijuese:

- Analiza e gjendjes në fushën e arkeologjisë.
- Përpilimi dhe zbatimi i politikave të arkeologjisë në nivel shtetëror.
- Menaxhimi i drejt i trashëgimisë arkeologjike, pa interferime politike.
- Bashkëpunimi shkencor dhe profesional në fushën e arkeologjisë dhe të shkencave që përkojnë me të.
- Krijimi i kuadrove të reja arkeologjike dhe të atyre që ndërlidhen me arkeologjinë (konservatorë, vizatues etj.)
- Standardizimi i terminologjisë arkeologjike në gjuhën shqipe.
- Përpilimi i strategjisë për parandalimin e trafikimit me objekte arkeologjike.
- Promovimi i vlerave të arkeologjisë, deri tek nivelet më të larta të vendimmarrjes shtetërore, duke e mënjanuar mundësinë që arkeologjia të shihet vetëm si atraksion.
- Promovimi i pasurisë arkeologjike dhe të arriturave në nivel ndërkombëtar.

Janë edhe një varg çështjesh të nevojshme për diskutim dhe gjetjen e mënyrave për zgjidhjen e tyre. Me këtë rast e ndjej të nevojshme të përkujtoj se është obligim ndërkombëtar që Serbia ta

kthejë thesarin arkeologjik të Kosovës, të huazuar gjatë kohës së luftës për ekspozitën politike të hapur në Beograd, në vitin 1998.

Për fund, dua të ritheksoj se mbrojtja adekuate e trashëgimisë arkeologjike ofron mundësi të shumta, përfshirë dhe zhvillimin e ekonomisë turistike, bashkëpunimin rajonal dhe më gjerë dhe, njëkohësisht, mund të shërbejë për ngritjen e respektit të ndërsjellë midis popujve dhe për ndërtimin e paqes së nevojshme.

QASJE E RE NË ARKEOLOGJINË KOSOVARE DHE GJTHËSHQIPTARE

KDU 902(=18)
061.23(496.51)

Në këtë tryezë të parë arkeologjike do t'i shtroj gjërat prioritare, të cilat që sa kohë më preokupojnë dhe vetëm pjesërisht kam pasur rastin t'i paraqes në dy artikuj të shkurtër¹, por që, në një takim si ky, të cilin as në kuadër të arkeologëve kosovarë, deri tash nuk e kemi pasur, besoj se do të jenë me interes.

Prezantimin tim, i cili ka të bëjë me dy çështje të mëdha kyçe: ecuritë e tanishme dhe mundësitë e qasjes së re arkeologjike, e kam shtruar përmes shtatë pikave kryesore të lidhura shumë ngushtë njëra me tjetrën.

1. Themelimi i shoqatës së arkeologëve të Kosovës dhe kooperimi i saj me trojet e tjera shqiptare.
2. Ngritja e kuadrove të arkeologëve.
3. Gërmimet arkeologjike.
4. Përgatitja e lokaliteteve arkeologjike për prezantim.
5. Publikimet.
6. Studimi i materialit të veçantë.
7. Projektet.

1. Themelimi i Shoqatës së Arkeologëve të Kosovës dhe kooperimi i saj me trojet e tjera shqiptare

Këtë pikë e kam vënë në rend të parë, meqë edhe pse në kushtet e tanishme, përkatësisht pas luftës, në Kosovë u krijuan mundësitë për themelimin e kësaj shoqate, ne nuk e realizuam një gjë të tillë. Mendoj se themelimi i saj është prioritar. E them këtë, duke u nisur nga fakti se ajo është një praktikë e çfarëdo disipline. Në rastin tonë, meqë nuk e mbaj në mend, kur jemi takuar ndonjëherë, është më se e nevojshme, për shumë arsye. Së pari, për afrim e bashkëpunim më intensiv në mes arkeologëve e institucioneve përkatëse dhe, sidomos, për t'i shtruar

¹ “Arkeologjia e Kosovës në rrethana të reja”, Simpozium shkencor i mbajtur më 18-19 dhjetor 2003, *50 vjet studime Albanologjike*, Prishtinë 2004, 553-556; e njëjta, “Kosovska arheologjia danas” *Obavijesti*, HAD, Zagreb 2007, 176-170.

sfidat dhe mundësitë për një mbarëvajtje sa më të suksesshme të arkeologjisë, duke e përpiluar edhe një plan strategjik.² Njëkohësisht do të ishte më i lehtë edhe bashkëpunimi me arkeologët e trojeve të tjera shqiptare. Nga ky aspekt, sidomos është i mirëseardhur themelimi i Shoqatës së arkeologëve të mbarë trojeve shqiptare, e cila, hiç dobitë tjera, do të na mundësoj këso lloj takimesh.

2. Kuadrot e arkeologëve

Si pikë e dytë, po ashtu shumë e rëndësishme, është çështja e kuadrove të mirëfillta arkeologjike. Duke e vlerësuar mundin e secilit, ne nuk kemi nevojë për përshkrime arkeologjike, por për studim dhe publikim të materialit arkeologjik, të zbuluar qoftë me gërmime arkeologjike, qoftë me gjetje rasti nga arkeologët që e kryejnë arkeologjinë në departamentin e arkeologjisë, me të gjitha lëndët përkatëse dhe gjuhët klasike. Për këtë mendoj se do të na ndihmonte hapja e Departamentit të Arkeologjisë – qoftë edhe mikse, me një disiplinë të përafërt – për të cilin edhe kemi një personel të shkolluar mirë në departamentet arkeologjike të qendrave të njohura universitare, e cila, fatbardhësisht, u arrit këtë vit si drejtim i Arkeologjisë në kuadër të Departamentit të Antropologjisë. Kjo veçanërisht do të jetë në dobi të rajonit shqiptar në Maqedoni, Luginë të Preshevës dhe në Mal të Zi, ku i kemi të njohura sfidat e përgatitjes së këtyre kuadrove dhe të vetë punës arkeologjike. Ndërkaq, nga profilet arkeologjike në Kosovë, do të veçoja mungesën e kuadrove të reja të epigrafisë greke dhe latine, ku te ne veçanërisht, kjo e dyta është prioritare. E, mbi të gjitha, mungesën e kuadrove të periudhës mesjetare, duke filluar nga shekulli VII. Prandaj, do të ishte mirë që aftësimi i kuadrove të reja të realizohet përmes një plani të përmbushjes së zbrazëtirave të këtyre fushave arkeologjike.

3. Gërmimet arkeologjike

Të gjithë e dimë se gërmimet përbëjnë pjesën e pandashme dhe mjaft të rëndësishme të arkeologjisë, të cilat tani, në rrethana të reja,

² Për këtë mbase do të na shërbente si model një plan i mirë i Republikës së Kroacisë: *Strateški plan Hrvatskog arheološkog društva* (2013-2015), Zagreb, listopad 2012.

janë duke u ndërmarrë për çdo vjet, por gjithnjë në mungesë të atyre mesjetare. Ato së pari filluan të realizohen me ekipe të përbashkëta nga Shqipëria, ku i një rëndësie të veçantë është gjurmimi i kalave dhe objekteve të antikitetit të vonë dhe krishterimit të hershëm, të cilave, më herët nuk u është dhënë aq rëndësi. Tani janë duke vazhduar me ekipe të huaja perëndimore, me mjete dhe metoda moderne të gjetjes më të shpejtë të materialit. Mirëpo, duhet gjithsesi ta them një realitet tjetër të pranishëm në Kosovë, lidhur me këto gjurmime. Ne arkeologët e Kosovës, që në fillim (vitet e shtatëdhjeta), edhe pse ishim pak, u punësua aty ku patëm mundësi, e jo aty ku kishte nevojë. Prandaj, sot jemi të shpërndarë në disa institucione nën dy ministri: të Kulturës dhe të Shkencës. Kështu, bartëse të këtyre gjurmimeve janë institucionet nën Ministrinë e Kulturës dhe, fatkeqësisht, jashtë pjesëmarrjes në gjurmime mbesin ata arkeologë të mirëfilltë nën Ministrinë e Shkencës, ku herë pas herë financohen vetëm hulumtimet e materialit arkeologjik 10-ditor në terren, që realizohet vetëm me gjetjen dhe matjen e fotografimin e tyre, por gjithnjë duke pasuar studimi i tij. Prandaj, është e udhës dhe e duhur, që këta arkeologë të ftohen për bashkëngjitje në këto gjurmime, mbase gjithsesi, qoftë edhe si këshilltarë, të cilët përvojën e tyre në njohjen e materialit të fushës përkatëse e kanë dëshmuar me publikimet studimore të tyre në vend dhe jashtë. Këtu do të theksoja se ndihma nga këta specialistë gjithnjë kërkohet në mënyrë individuale për identifikim të materialit nga arkeologët gjatë gjurmimeve, por ka raste kur kjo shfrytëzohet padrejtësisht.³ Ndërkaq, sa i takon gjurmimeve të përbashkëta të trojeve shqiptare, ato duhet të jenë edhe më intensive, por gjithnjë me reciprocitet në mes Shqipërisë dhe Kosovës, ndërsa sa i takon trevave të tjera (Maqedoni, Luginë e Preshevës dhe Mal i Zi) duhet të fillohet me ftesa për gjurmime dhe vizitave tona të lokaliteteve dhe objekteve arkeologjike të këtyre trevave. Para pak kohësh, autorja e këtyre rreshtave, iu ka përgjigjur pozitivisht ftesës nga Maqedonia (Shkupi) në këtë cilësi.

Njëkohësisht, do të theksoja se, si pjesë përbërëse e çdo gjurmimi, duhet të jetë pasqyra e shkruar arkeologjike e gjurmimit, e cila është praktikë kudo dhe që ka qenë edhe më herët, e me të cilën

³ Këtu do të cekja rastin e objektit të parë të zbuluar në Dërsnik, të cilin, autorja e këtij prezantimi, me kërkesë të bartësit të gjurmimeve, arkeologut M. Valla nga Instituti Arkeologjik, për ndihmë të definimit të tij, e identifikoi si vilë urbane, por që kjo u përvetësua nga ai si zgjidhje e tij duke e prezantuar në mediat e shkruara dhe elektronike, pa u përmendur fare me një falënderim emri i saj.

njoftohen studiuesit e tjerë me rezultatin e gërmimeve të kryera. Do të shtoja se, po ashtu, në prezantimin e rezultateve të gërmimeve në takimin e fundvitit, do të duhej të ftohen të gjithë arkeologët pavarësisht pjesëmarrës në këto gërmime. Kjo do të ishte mirë që të bëhet një praktikë e zakonshme, si në Kosovë, e cila nuk është realizuar kurrë, ashtu edhe në Shqipëri.

4. Përgatitja e lokaliteteve arkeologjike për prezantim

Duhet të mendohet për mundësitë e nismës së përgatitjes së ndonjërës nga lokalitetet dhe objektet arkeologjike për prezantim. Kjo është edhe një nismë e mirë, sidomos nga aspekti i turizmit kulturor, ku lokalitetet arkeologjike, një pjesë e të cilave me rëndësinë e tyre gjithsesi e meritojnë të shndërrohen edhe në parqe arkeologjike, do të bëheshin destinacionet kryesore të këtij turizmi.

5. Publikimet

Te publikimet, së pari fjalën e kam te revista shkencore-profesionale arkeologjike – Periodika, e cila, pos një numri të dalë nga Instituti Arkeologjik, për fat të keq me censurë të punimeve, me gjithë këto gërmime e gjetje rasti, nuk e kemi më. Kështu, punimet tona janë të shpërndara në revistat e institucioneve të ndryshme: Institutin Albanologjik dhe atë të Historisë, Fakultetin Filozofik dhe në Akademi. Prandaj, revistën vjetore të punimeve arkeologjike (studime, materiale etj.) ta marrim si të domosdoshme dhe që më realizimin e saj askush të mos na pengojë, meqë institucionet e tjera i nxjerrin rregullisht. Në këtë revistë e cila duhet të jetë e spektrit të gjerë, si shkencor në fushë të arkeologjisë, ashtu dhe rajonal me punime arkeologjike nga të gjitha trojet shqiptare, mjaft e rëndësishme është redaksia, gjithsesi me një ose dy anëtarë të jashtëm, para së gjithash nga rajoni shqiptar. Të njëjtat rregulla duhet të vlejnjë edhe për qendrat e trojeve të tjera shqiptare, ku në fakt, kjo periodikë, sot për sot, realizohet vetëm në Shqipëri. Për një bashkëpunim sa më të madh do të ishte mirë që në intervale të caktuara kohore, sipas mundësive, ta publikonim një revistë të përbashkët. Njëherësh, mendoj se është me rëndësi të ceket se, duhet filluar me punime të shkruara në anglisht, që tashmë është bërë rregull në qendrat e tjera, apo me rezyme sa më të

gjatë, për të pasur një komunikim sa më të gjerë botëror në fushë të arkeologjisë.

Përkitazi me Hartën Arkeologjike të Kosovës, nga e cila kanë dalë dy vëllime, gjithsesi duhet që, në publikimin e vëllimeve të radhës, të citohen të gjithë autorët, të cilët i kanë botuar më herët eksponatet e inkuadruara në to – të neglizhuar deri tash,⁴ ashtu siç edhe veprohet,⁵ meqenëse ky është rregull.

Pos botimeve të veçanta autoriale, duhet stimuluar edhe daljen e një fjalori terminologjik të arkeologjisë së përbashkët: Kosovë e Shqipëri, ku do të realizohej standardizimi i kësaj terminologjie, e në kuadër të tij dhe transkriptimi i drejtë i termave latine (në kontekst të mënyrës klasike, apo tradicionale).

Për realizimin e kësaj veprimtarie botuese, shumë e rëndësishme është përkrahja e të dy Akademive të Shkencave dhe Arteve.

6. Studimi i eksponateve të veçanta

Kjo pikë ka të bëjë me ndonjë zbulim artefakti, monumenti, objekti e kështu me radhë, ku në qendrën dhe trevën e zbulimit nuk ka ekspert për studimin e mirëfilltë të tij, atëherë eksperti për këtë më parë të kërkohet në trevën tjetër brenda trojeve shqiptare dhe në rastin pozitiv t'i besohet studimi atij. Kjo do të jetë një shenjë e vlerësimit shkencor dhe e respektit të ndërsjellë mes arkeologëve dhe institucioneve arkeologjike të këtij rajoni, duke kontribuar në një bashkëpunim më të ngushtë. Prandaj, shkëmbimi i ekspertëve të fushave të caktuara arkeologjike, duhet të jetë sa më i pranishëm brenda trojeve shqiptare.

7. Projektet

Tek projektet, së pari kam menduar në projekte të përbashkëta, si të arkeologëve në Kosovë, ashtu edhe të atyre në të gjitha trojet

⁴ Grup autorësh, *Harta Arkeologjike e Kosovës I*, Prishtinë 2006, f. 161, figs. 6.22, 6.23, f. 162, fig. 6.25, f. 170, fig. 6.39, f. 173, fig. 6.44, f. 174, fig. 6.45 a-b, f. 180, fig. 6.57, f. 185, fig. 6.63, f. 186, fig. 6.66; *Harta Arkeologjike e Kosovës II*, 2012, f. 47, figs. 1.21, 1.22, f. 68, fig. 1.52, f. 71, fig. 1.55, f. 155, fig. 4.9 a-b, f. 160, fig. 4.15, f. 241, fig. 7.16.

⁵ Khr. *Arheološka karta na Republika Makedonija 2*, Skopje 1966.

shqiptare. Ato do të realizoheshin në kuadër të periudhave të caktuara (parahistori, antikitet apo mesjetë) sipas kësaj ecurie: 1. nga disa aspekte të periudhës së caktuar kohore dhe 2. të një çështjeje të caktuar gjatë periudhave të ndryshme kohore (p.sh. religjioni, artefaktet etj.), qoftë të një treve të caktuar (p.sh. Dardani, që do të përfshinte Kosovën, Maqedoninë veriperëndimore dhe Serbinë juglindore), ose, aq më mirë, të popullatës gjithëpërfshirëse të trojeve shqiptare (p.sh. Ilirët e Jugut, duke përfshirë Shqipërinë, Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë Perëndimore). Them se për këto projekte duhet menduar, meqë me një angazhim serioz do të arrijmë sukses.

Nga ky aspekt i rëndësishëm është edhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Mënyra më e përshtatshme për kyçje në projekte të këtij karakteri, ku prioritare kishin me qenë ato të rajonit, që kanë të bëjnë me trevat ilire, mendoj se është inkuadrimi në shoqatat arkeologjike të karakterit evropian dhe botëror,⁶ që arrihet përmes pjesëmarrjes në tubime arkeologjike të profilit të ngushtë dhe publikimit të punimeve në revistat përkatëse. Prandaj, është koha që të fillojmë t'u qasemi edhe këtyre projekteve.

Do të shtoja se për mbarëvajtje sa më të suksesshme të arkeologjisë në tërësi, gjithsesi duhet një qasje e re edhe nga ana e të dy ministrive: Kulturës dhe Shkencës.

Në fund shfrytëzoj rastin për të dhënë një propozim për kthimin e artefakteve nga Serbia, të marra në vitin 1999. Personeli arsimor-shkencor dhe kulturor i trojeve shqiptare, do të ishte mirë ta nisë aksionin që t'ia bëjë një lutje Google-s që në vend të logos ta vendosë thirrjen për ndihmë të kthimit të mbi 1247 eksponateve arkeologjike dhe etnografike të Kosovës, të marra nga Serbia, pak kohë para bombardimeve të NATO-s. Mendoj se kjo do ta sensibilizonte opinionin botëror dhe do të ndihmonte sadopak në kthimin e këtyre artefakteve në shtëpi.

⁶ Këtu do t'i cekim disa: “Shoqata e arkeologëve të Kroacisë”, “Shoqata e arkeologëve të Evropës”, “Shoqata e studiuesve të artit provincial romak”, Shoqata e studiuesve të sarkofagëve antikë”, anëtarë të së cilave është ndonjëri nga ne .

Luan PERZHITA, Tiranë

SFIDAT E ARKEOLOGJISË SHQIPTARE NË MIJËVJEÇARIN E RI

KDU 902(091)

Të nderuar kolegë,

Më lejoni që të falënderoj nga ana ime prof. Edi Shukriun për këtë nismë fisnike që ka ndërmarrë për të tërhequr vëmendjen mbi sfidat që po kalon arkeologjia shqiptare në këtë periudhë.

Po ashtu, më lejoni të falënderoj drejtuesit e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, veçanërisht kryetarin prof. Hivzi Islamin, për mbështetjen sistematike që i ka dhënë botimeve shkencore në fushën e arkeologjisë.

Në pamundësi për të qenë pjesë e këtij forumi, të nderuar, më lejoni që të shpreh shkurtimisht disa mendime rreth temës “*Arkeologjia në trojet shqiptare: Sfidat dhe mundësitë*”.

Siç e dini, Instituti i Arkeologjisë, sapo festoi 65-vjetorin e krijimit të tij. Parë në retrospektivë, arkeologjia shqiptare, e ka zanafillën e saj në aspektin institucional, në vjeshtën e vitit 1948, kur krijohet Grupi arkeologjik në përbërje të Institutit të Shkencave në Tiranë, duke kaluar gradualisht në vitin 1964 në Sektorin e Arkeologjisë, në vitin 1976 si Qendra e Kërkimeve Arkeologjike e Akademisë së Shkencave, e cila u shndërrua në vitin 1991 në Institutin e Arkeologjisë dhe nga viti 2008 Instituti i Arkeologjisë bëhet pjesë e Qendrës së Studimeve Albanologjike. Grupi arkeologjik, i krijuar në vitin 1948, shënoi fillimin e themeleve të asaj që njihet si “shkolla arkeologjike shqiptare”, e cila nuk kishte ekzistuar më parë, ku kanë vënë nga një gur me peshë breza arkeologësh, siç i quan prof. Kristo Frashëri, “*arkeologë mësues dhe arkeologë nxënës, nxënës të djeshëm që janë bërë mësues të sotëm, po aq të denjë sa mësuesit e tyre*”.

Gjatë kësaj periudhe, arkeologjia shqiptare realizoi, jo vetëm zbulime të mëdha të kulturës materiale e shpirtërore të qytetërimeve të shkuara (vendbanime, qytete, monumente e objekte) nëpërmjet qindra ekspeditave kërkimore në terren, por forcoi edhe fizionominë e saj si shkencë. Këto arritje janë pasqyruar gjithashtu në qindra artikuj studimor, të botuar brenda e jashtë vendit, në revistën periodike “Iliria”, “Candavia” si dhe në shumë botime monografike.

Revista “ILIRIA” e cila nuk ka pasur ndërprerje në publikimin e saj as në vitet e vështira 90-të, mirëfilli shkencore ka të publikuara deri më sot 45 volume me mbi 15.000 faqe me gjuhë shqip dhe përmbledhje në gjuhë të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht dhe gjermanisht) dhe qasje në nivelin më të mirë ndërkombëtar. Ka një sasi tjetër të madhe botimesh monografike dhe artikuj shkencorë të botuar si brenda dhe jashtë vendit në revista të njohura shkencore me faktor impakti, nga Franca, Italia, Gjermania, Austria, Anglia, Kroacia etj.

Ndryshimet e mëdha demokratike dhe përpjekjet e Shqipërisë për t’u afruar e integruar me vendet e tjera evropiane, në fillim të viteve 90, krijuan kushte të reja për zhvillimin e kërkimit shkencor, sipas modeleve perëndimore, duke dalë kështu nga mbyllja e gjatë prej rreth pesë dekadash. Kërkimi i deriatëhershëm i mbështetur vetëm në burimet e mjetet e brendshme, duke mos shfrytëzuar sa e si duhet përparimet e shkencës dhe teknikës evropiane e botërore, po bëhej gjithnjë e më frenues për zhvillimin e arkeologjisë shqiptare.

Organizimi i projekteve të para të bashkëpunimit, si formë më rezultative për kërkimet arkeologjike me arkeologë nga Franca, Britania e Madhe etj., pas viteve 90' dhe eksperiencia e fituar nga këto bashkëpunime, treguan, jo vetëm mundësitë e reja për kërkime në të gjitha fushat me mjete e metoda bashkëkohore, por edhe për kualifikimin e specialistëve të rinj të arkeologjisë. Këto zhvillime ndodhën në periudhën kur Shqipëria kalonte vështirësi të mëdha, në kushtet e transformimit politik, ekonomik dhe shoqëror.

Projektet shumëvjeçare të gërmimeve bashkuan përvojat e arkeologëve shqiptarë me ato të arkeologëve dhe specialistëve nga vende, si Franca, Italia, Britania e Madhe, Gjermania, SHBA, Austria, Zvicra, Izraeli, Polonia e Greqia, në kërkimet për të gjitha fushat e arkeologjisë, si për prehistorinë, antikitetin dhe mesjetën. Bashkëpunimet me të huajt kanë sjellë dobi në vazhdimin e punës kërkimore arkeologjike, por duhet thënë se e kanë cenuar disi përzgjedhjen e tematikave të trajtuara.

Legjislacioni në fushën e kërkimit shkencor

Proceset e zhvillimeve reformuese të sotme kanë nxjerrë problem të reja në lidhje me mbarëvajtjen e kërkimit shkencor arkeologjik. Instituti i Arkeologjisë gjatë kësaj periudhe, e cila njihet me emrin “transicion”, pothuajse është transformuar totalisht gjatë 20

vjetëve të fundit. Me një potencial prej 122 punonjësish në vitet 1992, ky institucion, në vitin 2008 është rrudhur në 22 punonjës shkencorë, gjë që krijon vështirësi në sistemin e kërkimit shkencor të arkeologjisë. Vështirësitë financiare të viteve të fundit kanë bërë që të mos merret parasysh specifika e këtij instituti, që vepron në terren me kosto më të shtrenjtë financiare se institutet e tjera të Albanologjisë. Nuk mund të punohet normalisht pa plotësuar nevojat e domosdoshme për mjete pune, fuqi punëtore, studentë, teknologji bashkëkohore, akomodim të ekipeve që veprojnë në terren etj.

Ky transformim u shoqërua edhe nga ndryshimet në legjisllacionin shqiptar për trashëgiminë kulturore. Ndonëse aktualisht, ky institut i nënshtrohet sot dy ligjeve bazë, të cilat vetë janë në proces zhvillimi: *Ligji për Trashëgiminë Kulturore* dhe *Ligji për Arsimin e Lartë*. Përfaqësimi i këtij instituti në organet ligjberëse është zvogëluar në minimum, ose mungon fare.

Për vetë specifikën e punës kërkimore në terren dhe studimore në zyrë, këto dy ligje, nuk arrijnë të mbulojnë ashtu siç duhet problematikat, që dalin për kërkimin shkencor arkeologjik. Ndaj, ka lindur mendimi për formulimin e një ligji adekuat për kërkimin shkencor.

Po e diskutoj këtë problem të legjisllacionit, pasi mendoj se është një dukuri që ruan një rol parësor për zhvillimin e shkencës së arkeologjisë. Në njohurinë time në Kosovë, gjërimet arkeologjike më së shumti bëhen kryesisht nga Muzeu i Kosovës dhe Instituti i Arkeologjisë, dy institucione këto në vartësi të Ministrisë së Kulturës që në strukturën e tyre nuk kanë për detyrë kërkimin shkencor. Ndodh që këto hulumtime të sistemohen në depot arkeologjike dhe të mos shohin kurrë dritën e botimeve në revistat shkencore. Një pjesë e tyre janë publikuar falë dëshirës individuale të kolegëve por, jo se është një detyrë institucionale. Ndryshe ndodh me gjërimet arkeologjike të Universitetit të Prishtinës, apo të Institutit Albanologjik, të cilët në fokusin e tyre kanë botimin shkencor të gjurmimeve arkeologjike.

Mendoj që kërkimi shkencor në fushën e arkeologjisë nga ana legjisllative duhet të njësohet. Është koha që arkeologjia shqiptare të funksionojë e unifikuar në fushën legjisllative të kërkimit shkencor.

A duhet të kemi një strategji në fushën e arkeologjisë?

Mendoj se jemi në periudhën e një panorame te re, që është krijuar aktualisht si rezultat i ndryshimeve të hartës politike të shteteve

në Ballkan. Arkeologët, ndonëse të shpërndarë në shtete të ndryshme, si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, tashmë kanë mundësinë e një bashkëpunimi ndërmjet tyre, ku mund të diskutojnë çështje me rëndësi, mbi historinë e formimit të ilirëve, apo të shqiptarëve të hershëm.

Natyrisht kjo kërkon angazhim dhe mirëkuptim të të gjithëve, ku platforma të jetë uniteti dhe diversiteti i mendimit shkencor në kërkimet arkeologjike gjithëshqiptare.

Për këtë do të mendoja se do të ishte me të vërtetë me vlerë krijimi i një Unioni Arkeologjik Shqiptar, një forum ndërinstytucional kërkimor-shkencor, i cili mund të drejtohej nga një bord me përfshirjen e personaliteteve të fushës nga institucionet.

Natyrisht, Unioni Arkeologjik Shqiptar, kërkon një mbështetje financiare nga institucionet përbërëse, me qëllim për zbatimin e një strategjie të kërkimit shkencor mbarëshqiptar në mijëvjeçarin e ri.

Organizimi në çdo fund viti, i një takimi shkencor të Unionit në kryeqendrat e shteteve shqiptare, në formën e një kolegjiumi, ku të pasqyrohen rezultatet e arritura nga gërmimet e vitit, apo diskutime që sjellin risi në kërkimin shkencor, do të rrisin ndjeshëm shkallën e njohjes së rezultateve arkeologjike, por dhe debatin shkencor.

Njëkohësisht do të propozoja krijimin e një organi botues të unionit, ku do të gjejnë vend studimet dhe kërkimet shkencore arkeologjike të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi.

DYERT E MBYLLURA TË ARKEOLOGJISË PËR SHQIPTARËT NË MAQEDONI

KDU 902(497.7)

Paranteza. Arkeologjia ka luajtur dhe vazhdon të luajë rol të madh në zhvillimin e shoqërisë moderne, sidomos ndikimi i saj është shumë domethënës në formimin e shteteve nacionale. Por, me paraqitjen e arkeologjisë së procesit (arkeologjisë së veprimit) gjatë viteve 60–ta të shekullit XX, kjo lëmi shkencore nxori në pah neutralitetin dhe objektivitetin në përdorimin e njohurive të saj shkencore.

Ndërkohë, në raport me publikun, arkeologjia bazohet në nevojat e shoqërisë bashkëkohore, por duke e refuzuar diskursin autoritar të saj shkencor. Në përputhje me botëkuptimet e këtilla është zhvilluar dhe avancuar metodologjia dhe terminologjia e fuqishme arkeologjike, e cila ka shkaktuar largimin e pashmangshëm të pjesës laike të publikut nga debati mbi çështjet e ndjeshme arkeologjike. Ndonëse e përjashton diletantizmin, nuk do të thotë se nuk e përfill rolin aktiv të publikut gjatë marrjes së vendimeve, në të mirë të politikave dhe parimit të hulumtimit dhe prezantimit objektiv të trashëgimisë arkeologjike. Pra, me fjalë të tjera, kjo do të thotë se arkeologjia bazohet në parimin interpretues dhe dialogun me publikun vendor. Këtu po e merr domethënien e duhur edhe nevoja për “kulturën arkeologjike”, e cila në fakt duhet t’i kundërvihet abuzimit me “shkollat nacionale” arkeologjike, të cilave jo rrallëherë u vishen epitete nga ma të ndryshmet.

Meqenëse thuhet se nuk ekziston në kuptimin e plotë përgjigje absolute mbi atë “nëse ekziston kulturë arkeologjike”, atëherë vështirë se mund të ketë një përgjigje adekuate për atë, nëse ne shqiptarët kemi “arkeologji nacionale”. Themi kështu, ngase kjo është çështje e ndërjegjes dhe përgjegjshmërisë së një individi, komuniteti apo shoqërie. Paralelja e tërhequr midis këtyre dy binomeve, në shikim të parë duket pak sa e palogjikshme, por po të thellohesh diç më tepër në zbërthimin e tyre, me siguri që bëhet më i kuptueshëm realiteti i arkeologjive të ndara mbi baza etnike dhe nacionale. Më probleme të kësaj natyre sigurisht që sot përballën edhe popujt më të fuqishëm të planetit, dhe të mos flasim për popujt e vegjël, (ku bëjmë pjesë edhe

ne shqiptarët), që inferioritetin e tyre në segmentet të ndryshme mundohen ta kompensojnë me anë të imponimit të nacionales, të përdorur si epitete me vend e pa vend.

Gjendja: Por, sidoqoftë, për t'i qëndruar besnik temës bosht të kësaj tryeze, unë megjithatë do të nënvizoja faktin se sado romantike duket, këndshëm tingëllon kur e dëgjon binomin “**arkeologjia shqiptare**”. Aq më tepër kur dihet se shqiptarët jetojnë në gjashtë shtete. Atëherë, vetvetiu imponohen pyetjet: vallë a vlen ky formulim për gjitha trojet shqiptare një lloj? Si dhe, sa ne shqiptarët bëjmë për ta jetësuar këtë moto në praktikë?

Mbase, nuk do ta kisha parashtruar në kumtesën time këtë dilemë, po të mos më kishte nxitur shembulli që ka të bëjë me hartimin e programit mësimor të një lënde universitare, ku bëhej fjalë për **lëmin e historisë, ‘Civilizimi (qytetërimi) evropian’**. Lëndën në fjalë e ligjëron një profesor i njohur shqiptar në disa universitete tona, i cili edhe pse gojën e ka plot trashëgimi dhe kulturë kombëtare, ndërkohë që, në përmbajtjen e librit të tij, ai i kishte përfshirë të gjitha kulturat botërore, duke filluar që nga parahistoria dhe deri tek kultura islame, por vetëm **qytetërimi dhe kultura ilire** nuk figuronin aty. Pse? Kjo mbase është pyetja e cila kërkon përgjigje! Ndonëse kjo çështje nuk është temë e kësaj tryeze, por ama kjo flet mjaft për gjendjen e arkeologjisë në trojet shqiptare. Dhe, përderisa ne kërkojmë që të tjerët të na e respektojnë pasurinë tonë arkeologjike, kurse vetë sillemi me mospërfillje ndaj saj. Aq më shumë, po ta kemi parasysh edhe faktin që trojet shqiptare, të cilat shtrihen në gjashtë shtete, ato edhe administrohen në bazë të legjislacionit tyre, atëherë duhet kërkuar alternativa të tjera në trajtimin e këtij problemi.

Meqenëse këtu po flasim për ardhmërinë e arkeologjisë shqiptare, siç e paralajmëron edhe vetë motoja e tryezës shkencore: “**Arkeologjia në trojet shqiptare: sfidat dhe mundësitë**”, me keqardhje duhet konstatuar se nuk mund të flitet dot për arkeologji shqiptare në Maqedoni. Them kështu, sepse për këtë kontribuojnë sa të tjerët, po aq edhe ne!

Cilët janë të tjerët? Ata janë institucionet shtetërore, që janë të huaja për ne shqiptarët në Maqedoni, të cilat skajshmërisht janë uzurpuar dhe kontrollohen nga maqedonasit. Ndërkaq, ne (shqiptarët) jemi ata të cilët nuk sakrifikojmë pothuajse asgjë nga rahatia jonë kolektive dhe as ajo individuale për t'i dalë në ndihmë trashëgimisë arkeologjike. Edhe nëse ndodhë kjo gjë ndonjëherë, (e cila më shumë është deklarative sesa konkrete), ajo bëhet për qëllime të përfitimeve

politike, ose po, sa për të pozuar para medimeve dhe për asgjë më tepër. Dhe për fat të keq, kështu kjo gjendje po vazhdon dekada me radhë, duke u lënë në masë të madhe pasuria arkeologjike në trojet shqiptare në Maqedoni në (pa)mëshirë...!

Duhet përkujtuar se gjatë dhjetë viteve të fundit, Maqedonia është ndër shtetet, jo vetëm të rajonit, por edhe me gjerë, që më së shumti ka dhënë para për arkeologjinë. Sipas një përlllogaritje të lirë, mendohet se për hulumtime dhe konservim dhe restaurim, kjo shumë arrin dhe në qindra milionë euro. Prandaj, edhe krahas shfrytëzimit të arkeologjisë për qëllime politike, ku ka edhe keqinterpretim dhe keqpërdorim të saj, si dhe moszbatim të metodologjisë së mirëfilltë gjatë gërmimit dhe konservim - restaurimit, duhet pranuar se, në Maqedoni është bërë mjaft për pasurinë arkeologjike. Dhe sidoqoftë, për disa gjera të mira, ajo duhet të shërbejë edhe si shembull për Shqipërinë dhe Kosovën, sidomos kur bëhet fjalë për përkrahjen financiare të projekteve arkeologjike dhe sidomos ndjekjen ligjore të thesar-kërkuesve klandestine dhe tregtimit me artefakte arkeologjike.

Por, për fat të keq, në tërë këtë ndërmarrje arkeologjike, është përjashtuar ai që mund të quhet hise dhe interes shqiptar. Kjo do të thotë se, **Ministria e Kulturës bashkë me Drejtorinë për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore**, zbatojnë politika të dyfishta, ku e drejta ekskluzive u përket vetëm maqedonasve, kurse shqiptarët marrin aq sa duan maqedonasit. Kjo vërehet, si në përfshirjen e kuadrove shqiptarë nëpër institucionet që merren me trashëgiminë arkeologjike ashtu edhe në përkrahjen financiare të projekteve që kanë të bëjnë me zonat arkeologjike dhe institucionet që administrohen nga shqiptarët.

Pra, dyert e arkeologjisë vazhdojnë të mbeten akoma të mbyllura për shqiptarët në Maqedoni. Duke iu referuar një shënimi të fillimit të viteve 90-ta të shekullit të kaluar, që strukturën institucionale dhe të kuadrit, gjendja faktike nëpër institucionet e trashëgimisë kulturore, ishte me sa vijon: nga 20 institucione ekzistuese në Maqedoni dhe me mbi 70 kuadro, kryesisht arkeologë dhe historianë të artit, nuk kishte të punësuar asnjë kuadro shqiptar¹. Edhe pse kishte arkeolog të diplomuar, të cilët pritnin vite me radhë, por kush nuk e çante kokën për ta. Kjo do të thotë se atyre nuk ua bënte fare për trashëgiminë arkeologjike.

¹ Mixhait Pollozhani, *Trashëgimia kulturore ti përkas edhe trashëgimtarit*, Mozaik Arkeologjik, 238-244, Shkup, 2001

Kjo gjendje e cila mbretëronte që nga periudha e komunizmit, fatkeqësisht, aspak më e mirë nuk është edhe sot e kësaj dite. Sepse, po qe se thirremi në numra, ndonëse në përgjithësi është shtuar numri i institucioneve në vend, del se momentalisht kemi të punësuar vetëm një arkeolog, një historian të artit, tre ose katër konservues, si dhe ndonjë kuadër tjetër shqiptarë të kësaj fushe, që unë mund të mos kem informacion. Përballë qindrave kuadrove maqedonas të punësuar, nga gjashtë a shtatë arkeologë të rinj shqiptarë, nëse nuk janë edhe më shumë, asnjëri nga ata nuk është punësuar në institucionet përkatëse.

As krijimi i institucioneve shqiptare, ide kjo që gjatë më shumë se dy dekada po promovohet nga partitë politike shqiptare, nuk ka dhënë ndonjë rezultat të madh. Gjatë kësaj periudhe janë themeluar vetëm dy prej tyre, të cilat llogariten si institucione shqiptare, dhe ato janë: **Instituti për Trashëgiminë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup**, dhe **Qendra për Konservim**, e themeluar vite më parë në **Gostivar**. Edhe pas kaq vitesh, këto institucione, jo vetëm që po përballen me probleme të skajshme burokratike, si dhe me mungesë të kuadrit të duhur, ato njëherësh kanë edhe kufizime ligjore veprime të kuptueshme në të drejtën për hulumtime arkeologjike.²

Sfidat: Ky ishte aspekti institucional me mangësitë e shumta formale - juridike dhe me shumë mungesa të infrastrukturës teknike dhe të metat tjera të mbrojtjes dhe përkujdesjes së trashëgimisë. Ndërkaq, një problem, gjithashtu shqetësues dhe akoma më shumë se kaq, është edhe aspekti përmbajtjesor dhe cilësor i përkujdesjes ndaj trashëgimisë. Çka dua të them me këtë? Fjala është, pra, për atë se si i qasemi ne shqiptarët në Maqedoni sot pasurisë arkeologjike, qoftë si vetëdije dhe ndërgjegje qytetare, por, për më shumë, sidomos edhe si kompetencë shkencore dhe përgjegjësi profesionale. Kur flitet për politikën e arkeologjisë në Maqedoni, ku padyshim që rolin dominues, siç u tha më lartë, e kanë maqedonasit, edhe për aq pak sa pyetën për çështjet të arkeologjisë, fjalën kryesore ndër shqiptarët e kanë diletantët! Elementet e këtillë vazhdimisht janë prezentë nëpër komisione ministrish, dhe sidomos nëpër medime, të cilët me heshtjen e tyre nëpër institucione dhe me fjalorin e tyre nacional romantik bosh krijojnë mendim të rrejshëm dhe ndikim të gabuar për ardhmërinë e pasurisë arkeologjike te popullata shqiptare.

² Të përkujtojmë se në këto institucione mungojnë arkeologët, historianët e artit, por edhe kuadro tjera deficitare të cilët do të kontribuonin në lëmin e trashëgimisë kulturore.

Ndaj, si rrjedhojë, edhe shtrohet pyetja, se si do ta detektojmë, hulumtojmë dhe interpretojmë pasurinë arkeologjike në trojet shqiptare, në këtë drejtim, edhe kulturën ilire-shqiptare në Maqedoni. Është fakt i pamohueshëm se edhe trojet shqiptare në Maqedoni kanë një pasuri arkeologjike shumë të begatshme, e cila në mënyrë intensive shtresohet që nga periudha paleolitit dhe vazhdon të jetë e pranishme deri në epokat e mëvonshme. Sipas të dhënave të publikuara nga institucionet gjegjëse të trashëgimisë së vendit, në territorin e Maqedonisë aktualisht janë evidentuar më shumë se **4700** lokalitete arkeologjike.³ Dihet që vetëm një numër i vogël nga këto është hulumtuar plotësisht, kurse, nëpër shumë lokalitete vazhdojnë hulumtimet. Por, shumë pak kemi hulumtime të lokaliteteve që janë regjistruar nëpër viset perëndimore të Maqedonisë. Qasja e seleksionuar dhe përjashtuese ndaj lokaliteteve arkeologjike ka ndikuar që shumë nga ato rrezikojnë të shkatërrohen. Për këtë, më së miri flasin vendgjetje të ndryshme arkeologjike, sidomos për t'u veçuar është gjendja e bazilikës **Shën Erazmo** në fshatin Podmol të Ohrit, e cila pasi është gërmuar, që atëherë pothuajse është lënë pa kujdes fare. Shpjegimi i vetëm për këtë ka të bëjë me faktin se në këtë lokalitet janë gjetur stoli dhe materiale të tjera të arkeologjike të kulturës së hershme mesjetare shqiptare. Pastaj, shkatërrimi nga thesarkërkuesit klandestinë i shumë lokalitete me vlerë të madhe arkeologjike, nga të cilat do të veçonim: **Gradecin** në Gostivar, **Kalaja e Hisarit** në Shipkovicë dhe **Kalanë e Orashes** në rrethinën e Tetovës etj., janë dëshmi të gjalla të politikeve diskriminuese ndaj trashëgimisë arkeologjike në vend. Ndërkohë, një rrëfim në vete mbeten interpretimi joobjektiv dhe prezantimi tendencioz i rezultateve të hulumtimeve arkeologjike nga ana e një numri të arkeologëve maqedonas.

Të përkujtojmë se ashtu si tërë trojet shqiptare, edhe territoret e banuara nga shqiptarët në Maqedoni, fshehin shumë të panjohura arkeologjike, me zbulimin e të cilave mbase do të zgjidheshin shumë enigma të lashtësisë së saj. Me ndërmarrjen e ekspeditave eventuale arkeologjike do të mund të zbulohen disa nga qytetet e antikitetit për të cilët deri më tani mësojmë vetëm prej burimeve të ndryshme të shkruara antike,⁴ për emra qytetesh të pazbuluara akoma,⁵ siç janë:

³ Паско Кузман, *Археолошки локалитети*, Македонско културно наследство, Скопје, 2008, 11

⁴ Grup autorësh. *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*, Prishtinë, 1979, 123, 124

Engelana (në pellgun e Liqenit të Ohrit), **Uskana** (Kërçova) dhe të 11 qytetet tjera të Penestisë (sipas Tit Livit), **Draudakumi** (Gostivari), **Oeneumi** (Tetova), **Damastioni**⁶ (Brazda - Shkupi!?), **Deborus** (Dibra), **Lamud(ava)** (Llopatë – Kumanovë) etj. Një nga preokupimet e ardhshme të arkeologjisë duhet të përqendrohet edhe në plotësimin e hartës arkeologjike të Maqedonisë, pasi që harta ekzistuese është shumë e vobektë dhe me shumë pasaktësi. Edhe një projekt i tillë mund të realizohet si formë e bashkëpunimit ndëruniversitar, apo edhe të institucioneve të tjera të trashëgimisë

Mundësitë: Edhe pse zhvillimet bashkëkohore kanë hapur mundësi për bashkëpunim të qëndrueshëm në fushën e arkeologjisë midis shkencëtarëve dhe profesionistëve që veprojnë në trojet shqiptare, kjo përparësi nuk shfrytëzohet aq sa duhet. Sepse, me përjashtim të Shqipërisë dhe Kosovës, ky bashkëpunim me trojet tjera nuk mund të thuhet se ekziston. Prandaj, është më se e domosdoshme nevoja për shkëmbimin e përvojave dhe thellimin e njohurive shkencore në plan mbarëkombëtar dhe ndërkombëtar. Për hulumtimin dhe mbrojtjen e integruar, prezantimin e mirëfilltë dhe shfrytëzimin e kulturor dhe ekonomik të trashëgimisë arkeologjike, në të mirë të sotmes dhe të nesërme, duhet mbështetur sidomos në projektet të përbashkëta. Për këtë duhet krijuar fonde të nevojshme financiare nga ana qeverive të shteteve përkatëse. Por, gjithashtu, duhet shfrytëzuar edhe mundësitë që i ofron bashkëpunimi ndërkufitar, sidomos Maqedoni – Shqipëri, Maqedoni – Kosovë, siç është përkrahja financiare e parashikuar në komponentin e dytë të **IPA – Fondeve**. Këto projekte mund të realizohen me anë të bashkëpunimit në partneritet ndërmjet institucioneve shtetërore dhe shoqatave jofitim-prurëse nga dy anët.

Meqenëse edhe qëllimi parësor i tryezës është që të konstatohet gjendja reale e hulumtimeve dhe perspektivave në fushën e arkeologjisë në trojet shqiptare, unë mendoj se pikërisht legjislacionin dhe zbatimin e tij duhet shikuar si faktorin kryesor në hapjen e mundësive të zhvillimit dhe funksionimit, si një tërësi të arkeologjisë në të gjitha territoret shqiptare. Vetëm me liberalizmit dhe harmonizimin e legjislacionit mund të stimulohen dhe avancohen format dhe mënyrat e bashkëpunimit në fushën e arkeologjisë, gjë që

⁵ Mixhait Pollozhani, *Qytetet e humbura ilire!*, Sjenja, viti IV, nr. 40, shator, Shkup

⁶ Mixhait Pollozhani, *Damastioni (pse jo) në Shkup*, Shenja, viti III, nr. 28, gusht, Shkup, 2013

do të hapnin edhe mundësi të reja për veprime më të suksesshme në të ardhmen në këtë drejtim.

Pasi që, zonat arkeologjike me të cilat disponon hapësira perëndimore e Maqedonisë përbëjnë pjesë të pandara të tërësisë së njëjtë etnike dhe kulturore, atëherë është nevojë imediate e arkeologjisë shqiptare (sidomos Republika e Shqipërisë) që të bëjë përpjekje më këmbëngulëse për të qenë më e pranishme në projektet hulumtuese në këtë vend. Këtë e mundëson Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë.⁷ Vetëm do të nënvizoja mundësitë që aktualisht i ofron Ligji për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Republikën e Maqedonisë, i cili në Nenin 56 alineja 1, thotë: “*...Me përjashtime bartës i lejes për hulumtime arkeologjike mund të jetë edhe person juridik i huaj*”. Ndërsa në nenin 57, alineja 1 thotë: “*Organizata ndërkombëtare nga fusha e mbrëmjes, institucione të huaja shkencore dhe punonjës të huaj nga fusha e arkeologjisë mund të marrin pjesë në hulumtimet arkeologjike, vetëm nëse punimet i ekzekutojnë (realizojnë) në bashkëpunim me persona juridikë nga neni 56, alineja 2, pika 1 dhe 2, dhe sipas kushteve të parapara në kontratën e lidhur midis tyre*”. Gjithashtu, në nenin 57, alineja 5, thuhet: “*Arkeologët e huaj dhe punonjës shkencor dhe specialistë nga fusha e mbrojtës mund të marrin pjesë në hulumtimet arkeologjike që i realizojnë persona juridik dhe fizik të vendit, me pajtim të drejtuesit profesional*”.

Por, për të qenë ky bashkëpunim më kuptimplotë, atëherë duhet shikuar mundësinë e angazhimit të arkeologëve shqiptarë nga Maqedonia, nëpër ekspeditat dhe ekipet hulumtuese, të Shqipërisë dhe të Kosovës. Sidomos, këtu kam parasysh angazhimin e arkeologëve të rinj dhe studentëve, për t'i ndihmuar ata në aftësimin e tyre të mëtutjeshëm profesional, sidomos me procesin e hulumtimit dhe gërmimit në terren.

Përfundimi: Si përfundim do të shtoja edhe atë se nuk mjafton vetëm ta përmendësh gojarisht epitelin “arkeologji shqiptare”, por atë duhet praktikuar realisht, duke i hequr të gjitha paragjykimet, qofshin ato përballë vetes, apo edhe kundrejt të tjerëve. Është koha e fundit për të filluar me shfrytëzimin e mundësive për bashkëpunim të qëndrueshëm midis shkencëtarëve dhe profesionistëve që veprojnë në trojet shqiptare në fushën e arkeologjisë, që ofrojnë zhvillimet bashkëkohore. Kështu do të mund thelloheshin njohuritë shkencore,

⁷ http://www.kultura.gov.mk/documents/Zakon_za_zastita_na_kulturnoto_nasledstvo.pdf

mbrojta e integruar, prezantimi i denjë dhe shfrytëzimi i trashëgimisë arkeologjike, për të mirën e të sotmes dhe të ardhmes sonë kulturore dhe ekonomike. Dhe, vetëm kështu do të përsoseshin format dhe do të rritej niveli i deritanishëm i bashkëpunimit, si dhe do të shtoheshin mundësitë për bashkëveprime më të suksesshme në fushën e arkeologjisë.

**KONFERENCA SHKENCORE:
LUFTA E PARË BOTËRORE DHE
ÇËSHTJA SHQIPTARE
1914 – 1918**



19 shtator 2014
Amfiteatri i Akademisë

Me rastin e shënimit të 100-vjetorit të Luftës së Parë Botërore, Seksioni i Shkencave Shoqërore i ASHAK-ut organizoi Konferencën shkencore kushtuar kësaj ngjarjes historike. Në Konferencë u prezantuan 12 kumtesa.

PROGRAMI

Sesioni I (ora 10:00)

Kryesia e punës: Pajazit Nushi, Beqir Meta, Jusuf Bajraktari

Fjala e hapjes

Akademik Pajazit Nushi, nënkryetar i ASHAK,
GJYKIMET DHE VLERËSIMET E ARGUMENTUARA PËR
LUFTËN E PARË BOTËRORE - KOD UNIVERSAL I
VEPRIMTARISË SË GJITHMBARSHME TË ASHAK

1. Beqir META, Ndikimi i Luftës së Parë Botërore në procesin e konsolidimit të kombit shqiptar.
2. Jusuf BAJRAKTARI, Kosova dhe viset tjera shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore.
3. Marenglen VERLI, Shqipëria në optikën e diplomacisë vjeneze në prag të Luftës së Parë Botërore.
4. Anton PANÇEV, Statistikat bullgare mbi popullsinë e Kosovës në Luftën e Parë Botërore.

Sesioni II (ora 11:30)

Kryesia e punës: Mark Krasniqi, Marenglen Verli, Frashër Demaj

5. Skender ASANI, Viset lindore shqiptare nën okupimin serb 1912-1915.
6. Fehmi REXHEPI, Zona okupuese bullgare gjatë Luftës së Parë Botërore në Kosovë.
7. Frashër DEMAJ, Diplomacia e Fuqive të Mëdha gjatë Luftës së Parë Botërore.
8. Isa BICAJ, Mali i Zi dhe shqiptarët gjatë Luftës së Parë Botërore.
9. Islam LAUKA, Lufta e Parë Botërore dhe konflikti aktual Rusi-Ukrainë.
10. Ramë MANAJ, Lënda arkivore për Luftën e Parë Botërore në Arkivin e Kosovës.
11. Lush CULAJ, Protestat e shqiptarëve dërguar Konferencës së Versajës. Fjalën përmbyllëse e mbajti anëtari korrespondent Jusuf Bajraktari.



Kryesia e punës: Pajazit Nushi, Beqir Meta, Jusuf Bajraktari

Pajazit NUSHI, Prishtinë

**GJYKIMET DHE VLERËSIMET E
ARGUMENTUARA PËR LUFTËN E PARË
BOTËRORE - KOD UNIVERSAL I VEPRIMTARISË
SË GJITHMBARSHME TË ASHAK**

KDU 94(4/9)“1914”
341.6

*Fjala e hapjes së konferencës shkencore “Lufta e Parë Botërore dhe
Çështja Shqiptare 1914 - 1918”*

I nderuari Kryetar i AKSHAK-ut, kolegë, miq dhe shokë,

Hapi punimet e Konferencës “Lufta e Parë Botërore dhe Çështja Shqiptare”, që mbahet me rastin e 100-vjetorit të fillimit të kësaj lufte. Në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, si edhe përgjithësisht në institucionet shkencore vjetorin e njëqind të kësaj lufte, si edhe të ngjarjeve historike të rëndësishme, e shënojmë me studime e trajtesa, përmbajtja e të cilave ka të bëjë në rend të parë me gjykime vlerash shkencore të karakterit historik; për këtë konferencë do të thosha se gjykimet historike të përmbajtjeve të këtyre punimeve do të jenë të liruara, pak a shumë, nga gjykimet vlerësuese të tjera, sidomos nga gjykimet vlerësuese politike dhe juridike, sado që këto të fundit janë të lidhura ngushtë me gjykimet vlerësuese historike për këtë luftë. Punimet mbi bazën e gjykimeve të argumentuara shkencërisht kushtuar përvjetorit të njëqind të Luftës Parë Botërore janë kod universal i veprimtarisë së gjithmbarshme të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, si edhe i të gjitha institucioneve shkencore. Nga ky kod, jemi nisur edhe ne, kur qysh në qershorin e vitit të kaluar, të vitit 2013, kemi programuar organizimin e kësaj konference. Mbi themelet e qasjes së këtillë, kësaj ngjarjeje me rëndësi të përgjithshme për vendet pjesëmarrëse në këtë luftë, si edhe për të gjitha vendet e tjera, kemi konstatuar shumësinë e motiveve që na kanë shtyrë të angazhohemi drejtpërdrejtë në mbajtjen e kësaj konference. Para së gjithash, duhet thënë se për Luftën e Parë Botërore ekziston literaturë e gjerë, ku mbisundojnë qasjet politike, ushtarake, diplomatike, juridike etj., që institucionet dhe studiues disiplinash të ndryshme i kanë historizuar në kuptimin e përcaktimit të shkaqeve dhe të pasojave të kësaj lufte për kohën kur u zhvilluan operacionet ushtarake, duke përfshirë edhe pasojat e tyre. Por, do të thosha se ka

më pak studime nga aspekti i ndikimit të pasojave të Luftës Parë Botërore në zhvillimet e tashme politike, ekonomike, diplomatike, sociale etj. Kjo vlen posaçërisht për popujt e Evropës Juglindore, sidomos për shqiptarët. Edhe pas njëqind vjetësh argumentet për pasojat e kësaj lufte për shqiptarët nuk janë shterur, kurse qasja studimore për këtë luftë në relacion me të sotmen e shqiptarëve përgjithësisht, posaçërisht në relacion me Kosovën e sotme, kërkon angazhime më të gjëra dhe më të thella.

Duke u nisur nga mendimi përgjithësues e filozofik i Benedito Kroçes, sipas të cilit “çdo histori e njëmendtë është histori bashkëkohore”, jam i mendimit se edhe sot relacionet e zhvillimeve bashkëkohore me të kaluarën e largët njëshekullore paraqesin një fushë hulumtuese me interes të veçantë. Lidhur me këtë, sot më shumë se dje, gjendemi në pozicione hulumtuese më të përshtatshme, si në pikëpamje të metodave dhe procedurave hulumtuese, ashtu edhe në pikëpamje shumë më të gjerë të lëndës arkivore. Derisa më herët gjykimet vlerësuese kanë pasur mbështetje më tepër në perceptimin e veprimeve dhe të aksioneve ushtarake, si edhe në supozimet për aspiratat dhe synimet e anëtarëve të fuqive aleate dhe kundërshtarë të asaj kohe, sot gjykimet e mirëfillta historike për këtë luftë kërkojnë shfrytëzim racional të dokumentacionit burimor dhe komentim të saktë për fuqitë ndërluftuese ushtarake: britanike, franceze, ruse, japoneze, serbe etj., që luftonin kundër fuqive qendrore, përkatësisht kundër fuqive ushtarake të Gjermanisë, Perandorisë Austro – Hungareze, Turqisë Osmane dhe të Bullgarisë. Në këtë luftë asnjansia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve përgjithësisht për përleshjet e këtyre fuqive nuk mjaftoi për mosdëmtimin e tokave shqiptare dhe të popullsisë së tyre, sepse fuqitë ndërluftuese i shndërruan tokat tona në arenë lufte, duke rrezikuar në këtë mënyrë ekzistencën e shqiptarëve përgjithësisht, sidomos atë të shtetit të cunuar dhe të posaformuar të Shqipërisë. Ndërkaq, për shqiptarët dhe vendet e tyre të ngelura jashtë shtetit të Shqipërisë edhe gjatë viteve 1914 – 1918 të kësaj lufte vazhdoi “shpata e zjarri”, sipas modelit të përshkruar nga knjazi Millan Obrenoviqi më 1877, “i cili lëvdohej që Sanxhakun e Nishit deri dje shqiptare, sot kemi arritur ta bëjmë krejtësisht trevë serbe”.¹ Këtë e argumenton vendosja e pushtetit ushtarak serb në Kosovë gjatë viteve 1912 – 1915 dhe dhuna e hapur e këtij pushteti mbi popullsinë shqiptare. Pavarësisht nga kjo situatë, me vendimet e

¹ Prof. Dr. Xheladin Shala “Copëtimi i Shqipërisë”, Albanica, nr.85, Prishtinë 2008, fq. 87.

Konferencës së Paqes në Paris, pas përfundimit të Luftës Parë Botërore, siç është tashmë e njohur, Kosova dhe trevat e tjera të shqiptarëve, të ndara qysh më 1913 në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, këtë ndarje e njohën dhe mbi këtë bazë, këto treva ngelën në kuadrin e Serbisë, Malit të Zi dhe të Greqisë. Rinjohja e ndarjes së këtillë, e vitit 1918, që ishte vendim i padrejtë me rrënjë historike të mëhershme, u lidh me zhvillimet më të reja politike për shqiptarët dhe Kosovën. Disa zhvillime historike nga dekada e parë e shekullit njëzet dhe vendimet për to, u shndërruan në argumente juridike për posedimin e Kosovës nga ana e Serbisë. Mjafton këtu të përmendim disa nga më të rejtat, që lidhen me këtë kohë dhe me vendimet e përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Kështu, më 1 dhjetor 2009 në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, pala serbe, e cila përfaqësohej nga historiani Dushan Bataković, ambasador i Serbisë në Francën e atëhershme, paraqiti disa “argumente” nga vitet e hershme të qindvjetëshit njëzet, si edhe nga ato të përfundimit të Luftës Parë Botërore dhe të vendimeve të vitit 1918, kundër shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Duke iu referuar këtyre “argumenteve historike” ai para trupit të lartë të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ka përmendur edhe këtë pohim “Kosova ka qenë djepi historik i Serbisë dhe përbën një nga shtyllat kryesore të identitetit të saj.”²

Të nderuar të pranishëm,

I ndjeri Gazmend Zajmi, pas botimit të veprës historiografike “Srbija 1878, Dokumenti” – “Serbia 1878, Dokumente, Beograd 1978) ka lënë trashëgimi të rëndësishme për çështjet historike dhe determinantet sociologjike, etnike – territoriale dhe demografike për shqiptarët, sidomos për shqiptarët e Kosovës, përballë “argumenteve historike” të mendimtarëve serbë. Për temën bosht të kësaj konference ka rëndësi të posaçme e terë kjo trashëgimi, nga e cila do të ndaja punimin e tij “Rrjedhat e konfliktësisë shqiptaro - serbe në rrafshin kushtetues të ish-Federatës Multinacionale të Jugosllave”. Në këtë punim, lidhur me Luftën e Parë Botërore, përveç të tjerash, ka shkruar: “Në saje të rezultateve të luftërave ballkanike (1912 – 1913) përkatësisht të pushtimit serb të Kosovës me popullsi numerikisht

² Prof. Dr. Arsim Bajrami, “Argumentimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Pavarësinë e Kosovës”, nga ligjëratat inauguruese e Arsim Bajramit, mbajtur në ASHAK, në marsin e vitit 2014.

dominante shqiptare, Kosova si trashëgimi territoriale e shtetit serb, u përfshi në kuadër të shtetit serbo – kroat – slloven (Jugosllavisë), të krijuar pas Luftës së Parë Botërore.”³ Në mbështetje të analizës së thuktë të konfliktësisë shqiptaro – serbe dhe mbi themelin e argumenteve historike, i ndjeri Gazmend ka përfunduar: “Solucioni i Kosovës së pavarur (. . .), nuk është kurrfarë solucioni ekstrem, por është solucion i drejtpeshuar i kohës, me interes të thellë kombëtar, jo vetëm për kombin shqiptar, por edhe për kombin serb në Ballkan”. I përmenda këto qëndrime lidhur me çështjen që është objekt studimor i kësaj konference, sepse edhe sot, mendimi historik serb i referohet gjykimeve për pasojat e Luftës së Parë Botërore, duke e vlerësuar Kosovën territor të së ashtuquajturës “Serbi e Vjetër” duke mos lënë anash të ashtuquajturin rolin e ushtrisë serbe në “çlirimin e Kosovës nga pushtuesit”. Së këndejmi, pasoi trajtimi i Kosovës në Kushtetutën e Serbisë së sotme, si pjesë të Serbisë. Lidhur me këtë, ju kujtoj fjalët e Kryepeshkopit të Kishës Ortodokse Serbe, të thëna lirisht në mes Tiranës, jo më shumë se para disa muajsh, ose botimin etno – historik të Beogradit “Otmica Kosova” – “Gllabërimi i Kosovës” botuar para katër vjetësh, botimin e Enciklopedisë së Jugosllavisë, të Enciklopedisë të Maqedonisë të tërhequr nga shitja, pasojat e rënda të Memorandumit të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve, që tashmë janë bërë më se evidente, madje të dëmshme edhe për popullin serb, kurse mendimi akademik serb dhe qëndrimet e tashme ndaj këtij memorandumi nuk dëgjohen, pavarësisht se “babai” i këtij dokumenti, tashmë i ndjeri Dobrica Qosiq, para vdekjes ka deklaruar “Kosova për Serbinë është e humbur njëherë e përgjithmonë”. Ndërkaq, Kushtetuta e Serbisë, Kosovën e konsideron si pjesë të Serbisë, madje me rëndësi historike për qenien e saj etj. Por, edhe disa shkrime historiografike të shqiptarëve, kanë nevojë të rishikohen. Kështu, p. sh., në tekstin e zërit “Lufta e Parë Botërore 1914 - 1918” të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar bëhet fjalë për pushtimin e Shkodrës, të Skraparit, të Vlorës, etj., por Kosova nuk përmendet, pa marrë parasysh se përmendet Shqipëria e Veriut, por këtu bëhet fjalë për veriun e shtetit të Shqipërisë. Në tekstet e mëvonshme, siç është përmbajtja e zërit “Kosova” është theksuar politika e dhunës së hapur mbi popullatën shqiptare të Kosovës etj. I përmenda vetëm ca raste, duke theksuar tekstet e fjalorëve dhe të enciklopedive, sepse tekstet e fjalorëve dhe të

³ Rrjedhat e konfliktësisë Shqiptaro – Serbe në rrafshin kushtetues të ish Federatës Multinacionale të Jugosllavisë” ASHAK, Botime të veçanta, Seksioni i Shkencave Shoqërore, Libri 9, Prishtinë, 1997, fq. 108.

enciklopedive, siç është e njohur, konceptohen dhe shkruhen në mbështetje të teksteve burimore historike, juridike, politikologjike etj. nga përmbajtje e të cilëve konceptohen përmbajtjet e ngjeshura me informacione të zërave të fjalorëve dhe të atyre enciklopedikë.

Në konceptin aktual “ballafaqimi me të kaluarën”, që ka përmasa të theksuara shkencore e jo politike, gjykimet vlerësuese të paargumentuara për Luftën e Parë Botërore, për pasojat e saj për shqiptarët përgjithësisht, dhe historizmi i tyre sidomos për Kosovën, duhet të zëvendësohen me argumente të pathyeshme të dokumentacionit burimor. Ne e ndiejmë nevojën për një ballafaqim të këtillë, sepse konsiderojmë se dialogët shkencorë i kontribuojnë objektivizmit të raporteve shqiptaro – serbe dhe historisë së tyre. Rezultatet e kësaj konference mund të shfrytëzohen edhe për organizim të bisedave, për ballafaqim me të kaluarën. Le të shpresojmë!

Ju faleminderit.



Pamje nga Konferenca

NDIKIMI I LUFTËS SË I BOTËRORE NË PROCESIN E KONSOLIDIMIT TË KOMBIT SHQIPTAR

KDU 94(=18)“1914”

Lufta e Parë Botërore ndërpreu në mënyrë dramatike procesin e sapofilluar të sendërtimit të shtetit kombëtar, i cili do të ishte parakushti themelor dhe shtylla kryesore për ndërtimin e institucioneve kombëtare të të gjitha llojeve, si bazat themelore të konsolidimit dhe progresit të kombit shqiptar. Tashmë, Aleatët shkuan dhe më tej në braktisjen e shqiptarëve, veçanërisht po të mbahen parasysh garancitë që ata u kishin dhënë kombeve të vogla evropiane.

Mund të dallojmë tri faza, në të cilat kaloi kombi shqiptar:

1. Ethet e pragluftës, të cilat bënë që shqiptarët, jo vetëm të lireshin në fatin e tyre, por edhe të destabilizoheshin, duke bërë që të mbisundonin forcat antikombëtare.
2. Në fazën e dytë pas pushtimit, ku secila prej fuqive do të ushtronte ndikime të ndryshme mbi shqiptarët, mbi çështjen e pavarësisë, madje do të përpiqeshin që të kontrollonin edhe Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.
3. Në periudhën e tretë, kur shqiptarët u zhgënjyen nga shpresat për mbështetjen e shteteve të huaja dhe vendosën t'i realizonin aspiratat e tyre vetë.

Periudha e pragluftës rezultoi me efekte shkatërrimtare për shtetin e ri shqiptar. Në qendër të kësaj shpërbërje kishte dy faktorë kryesorë që favorizonin dukshëm njëri-tjetrin, sigurisht për të zezën e shtetit dhe kombit shqiptar.

Së pari, ishte largimi i Fuqive të Mëdha nga politika e tyre, e pranimit të shtetit shqiptar dhe nga vendimet e Konferencës së Londrës të vitit 1913. Tashmë nevoja imediate e suksesit në luftë do të dominonte dhe shkelte rëndë parimin e kombësive. Lidhur me këtë E. Grey deklaronte: “Në luftë patjetër do të ketë marrëveshje të fshehta. Në të, shumë gjëra që shihen si kriminale, janë të pashmangshme.”¹ Të gjitha Fuqitë e Mëdha, ndoshta vetëm me përjashtimin e Austrisë,

¹ David Lloyd George, *Memories of the Peace Conference*, 2 vëll. (New Haven, 1939), II, f. 502.

kishin vendosur që e ardhmja e shtetit të pavarur e shëndetlig shqiptar duhej rishikuar dhe garancitë të cilat i kishin formuluar kolektivisht në Londër, më 1913, nuk ishin më të vlefshme e të qëndrueshme. Ky ishte rreziku më i madh i jashtëm, që vinte në dilemë, jo më konsolidimin, por mbijetesën e kombit shqiptar.

Së dyti, ishte gjendja e kombit shqiptar, dobësitë dhe kundërshtitë e brendshme të tij, dhe mbi të gjitha copëzimi fetar e krahinor, i cili nxitej nga faktorët e fuqishëm nga jashtë. Ndonëse pikëpamja e Hastings se Islami ka një karakter konservator dhe është i paaftë për t'u bërë forcë lëvizëse në favor të idesë kombëtare, është tërësisht e gabuar.² E vërteta është se nacionalizmi shqiptar, para dhe gjatë luftës, manifestonte dobësi të theksuara. Ideja kombëtare dhe vizioni për një komb të bashkuar me institucione gjithëpërfshirëse dhe të respektueshme nga të gjithë ishte ende larg të qenët dominuese. Por, me gjithë dobësitë dhe krizën momentale që po kalonte, nacionalizmi shqiptar nuk ishte i kufizuar vetëm diku në një cep të Shqipërisë, siç ka theksuar Nicola Guy, e cila thotë se gjatë kësaj periudhe nacionalizmi u rishfaq kryesisht në jugun ortodoks dhe në diasporën e tij më të kultivuar.³ Në fakt fanatizmi fetar i të gjitha llojeve, si mysliman ashtu dhe ortodoks, ishte pengesë serioze, e cila në prag të luftës, e ushqyer nga propagandat e huaja, u shndërrua në një bombë shpërthyesë për shtetin dhe unitetin e kombit shqiptar, duke errësuar perspektivën e tij. Përprjekja e viteve 1913-1914, ishte jetëshkurtër për shkak të luftës dhe dështoi për një varg arsyesh, duke hedhur dyshime mbi idealizmin kombëtar. Grupe dhe individë të ndryshëm, që i ishin kundërvënë ose nuk e kishin mbështetur pavarësinë, u rrekën të shfrytëzonin situatën e krijuar nga lufta, për të çuar më tej interesat e tyre të ngushta lokale ose individuale. Kjo u zhvillua dhe u nxit edhe nga fuqitë e huaja, të cilat përpiqeshin të siguronin klientë pa para për realizimin e ambicieve të tyre në Shqipëri. Pa stabilitet dhe siguri, problemet që duheshin zgjidhur për farkëtimin e një kombi shqiptar pas largimit të pushtuesve, do të rezultonin kësisoj të vështira për elitën e vogël nacionaliste.

² A. Hastings, *The Construction of Nationhood: Ethnicity, Religion and Nationalism*, Cambridge, 1997, f. 200-202.

³ Nicola Guy, *Lindja e Shqipërisë - Nacionalizmi etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe lindja e Pavarësisë shqiptare*, "Pegi", 2010, f. 153.

Etapa e dytë rigjallërimi kombëtar shqiptar, 1916-1918

Qysh nga janari i vitit 1916, luftimet midis Fuqive të Mëdha do të zhvilloheshin edhe në territorin shqiptar. Secila prej ushtrive të tyre përdori propagandën dhe nxitjet e ndryshme për të bërë për vete nacionalistët dhe jo nacionalistët shqiptarë në zonat që kontrollonin dhe për të penguar rivalët e vet në zonat e tyre. Nacionalizmi shqiptar, për arsye të fraksioneve brenda tij, por edhe të rrethanave, ndërhyrjeve të huaja dhe konjunkturave të kohës, nuk mundi të përpunonte një politikë unike, të përcaktuar qartë dhe konsekuente gjatë Luftës së Parë Botërore. Ndryshimet ndodhnin jo vetëm midis fraksioneve të ndryshme, por qëllonte shpesh që, edhe i njëjti grup apo individ i rëndësishëm, të ndryshonte besnikërinë e tij. Kjo dobësoi pozicionin e shqiptarëve përkundrejt kundërshtarëve të tyre, pasi ata shiheshin si njerëz pa taban, tek të cilët nuk mund të mbështeteshe.

Gjatë luftës, në vend mbizotëronin interesat lokale dhe krahinore. Kjo situatë bëri që të shumë të huaj, por jo vetëm tek ata, të mbizotëronte mendimi për një organizim kantonal të kombit shqiptar, në të ardhmen. Këto identitete lokale dominuese, në fakt e mjegullonin perspektivën kombëtare, por nuk ishin domosdoshmërisht të papajtueshme me identitetin kombëtar. Vetëm se ata, duke qenë shumë të theksuara, e dëmtonin seriozisht perspektivën e unifikimit kombëtar dhe favorizonin tendencat shpërbërëse. Ndarja e Shqipërisë në njësi gjithnjë e më të vogla, me lidhje të pakta midis zonave të ndryshme, ishte një hap prapa nga Lëvizja e mëparshme Kombëtare. Alternativat e autonomisë vendore mundën të lulëzonin për shkak se diferencat dhe rivalitetet midis grupimeve të ndryshme shqiptare ishin rishfaqur dhe kishin prishur këtë koalicion, edhe kështu të dobët. Pushtimi i huaj e përforcoi dukshëm këtë tendencë.

E marrë në tërësi, Lufta e Parë Botërore dëmtoi seriozisht procesin e ndërtimit të shtetit kombëtar dhe konsolidimin dhe progresin e komb-formimit në Shqipëri. Por, brenda kësaj fatkeqësie të përgjithshme, ka edhe disa zhvillime specifike, të cilat ndikuan në drejtime të ndryshme në avancimin e pjekurisë kombëtare. Duhet theksuar qysh në fillim se, përmes fatkeqësive të luftës, nacionalistët shqiptarë do të fitonin një përvojë të re politike dhe një shkallë më të lartë të ndërgjegjes kombëtare.

Zhvillimi kombëtar nën pushtimin austro-hungarez

Por, nga ana tjetër, në atmosferën e mugëtirë që kalonte kombi shqiptar gjatë Luftës së Parë Botërore, mund të shquhen edhe disa njolla të ndriçuara, ku dritëhijet kryqëzohen. Risitë, disi pozitive që shprehnin afirmimin, organizimin dhe përpjekjet e kombit shqiptar për liri ishin më evidente në zonën e pushtimit austro-hungarez. Në këtë zonë, dhe pikërisht në Shkodër, në pranverë të vitit 1915, u formua organizata “Komiteti i Fshehtë” i Kosovës me kryetar Hoxhë Kadriun⁴, e cila ishte organizata më e fuqishme nacionaliste, që ishte krijuar deri në këtë kohë dhe që në vitet në vijim do të luante një rol të madh me përpjekjet për çlirimin e Kosovës nga zgjedha serbe, për bashkimin e saj me shtetin shqiptar si dhe në procesin e riformimit të shtetit shqiptar pas Luftës.

Në këtë periudhë vërehet fuqizimi i një organizate tjetër atdhetare në diasporë, Federatës Panshqiptare “Vatra”, e themeluar në prill të vitit 1912. Kjo organizatë u bë boshti kryesor i nacionalizmit shqiptar në diasporë dhe apogjeun e forcës, organizimit dhe kontributit politik të saj për çështjen shqiptare e arriti në vitet e fundit të Luftës së Parë Botërore. Kjo ishte organizata më e fuqishme atdhetare që kishte vepruar ndonjëherë në diasporë. Me shtypin dhe memorandumet, e aktet e tjera politike të saj, ajo shënonte një hap përpara në kultivimin e politikës mbarëkombëtare dhe ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Gjithashtu, me shtypin, aktivitetin diplomatik, lidhjet dhe asociacionet që krijoi, ajo avancoi ndjeshëm propagandimin e të drejtave të popullit shqiptar në SHBA dhe Evropë. Me të drejtë, F. Konica ka theksuar se “Vatra” veprroi “si guvernë shqiptare” duke zëvendësuar shtetin e vdekur shqiptar”.

Pavarësisht se në nivelet e ndryshme të institucioneve të Perandorisë Austro-Hungareze kishte projekte e paragjykime të ndryshme për ringritjen e shtetit shqiptar,⁵ duhet theksuar se

⁴ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 882, Viti (më tej: V.) 1915, dosja (më tej: D.) 9, fl. 707-708, “Komiteti i Fshehtë”.

⁵ *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSt.A.P.A.A.*) në *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 27-5-513, Raport i konsullit austro-hungarez, Kviatkovski në Samsun të Turqisë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ), Samsun, 24 maj 1917; *po aty*, Vj. 26-8-372, Shkresë tepër konfidenciale e MPJ drejtuar konsullit të Përgjithshëm, Kral, në Shkodër, Vjenë, 8 maj 1926. Në këto dy dokumente dhe në të tjera rezulton se kishte divergjenca midis drejtuesve të ushtrisë që ishin kundër ringritjes së një shteti shqiptar pas Luftës, dhe MPJ që mendonte se duhej bërë e kundërta.

autoritetet austro-hungareze relativisht mbajtën një qëndrim pozitiv ndaj vijueshmërisë së procesit të afirmimit dhe konsolidimit të kombit shqiptar. Ky qëndrim dallonte cilësisht nga qëndrimi i shteteve të tjera pushtuese, duke qenë më pozitiv ndërmjet tyre.

Qeveria austro-hungareze, më në fund, vendosi që në viset shqiptare të pushtuara të krijoheshin administratë civile, e cila sipas fjalëve të gjeneral-majorit austro-hungarez, V. Bobeçiç, do të kujdeseshin që populli shqiptar “të edukoheshin për autonominë, hap pas hapi, nga administrata ushtarake dhe më vonë, sapo të ishin krijuar premiset, do të ndërtohej shteti i pavarur shqiptar nën protektoratin efektiv të Austro-Hungarisë”.⁶

Në fillim të vitit 1916, në zonën e Matit, që ishte nën sundimin austro-hungarez, u forcua një qendër e vjetër e nacionalizmit shqiptar. A. Zogu u shfaq si një figurë udhëheqëse kombëtare me një peshë të konsiderueshme dhe aktive në skenën politike shqiptare.⁷ Bashkëpunimi i tij me Aqif Pashë Elbasanin krijoi me të vërtetë një zonë tjetër të gjerë, ku nacionalizmi shqiptar ishte i fuqishëm. Kjo zonë, që shtrihej midis Matit e Shkumbinit, tentoi të shndërrohej në një bastion për ringritjen e shtetit shqiptar dhe të fuqizimit të lëvizjes kombëtare. Madje, me përpjekjet e tij për thirrjen e një kuvendi kombëtar, A. Zogu dhe Aqif Pashë Elbasani, synonin të sendërtonin institucionin themelor kombëtar, i cili do të shërbente për ringritjen e institucioneve kombëtare qysh gjatë Luftës, të cilat më tej do të shërbenin si një bazë apo piemont për zgjerimin e tyre në zonat e tjera të pushtimit, sapo këto të liroheshin nga ushtritë pushtuese. Ky projekt ishte një hap madhor, që do të tentonte kapërcimin e fragmentarizmit të Lëvizjes Kombëtare, një defekt historik i saj, qysh prej Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kombi shqiptar do të provonte kështu, se ishte i pjekur dhe se kishte tashmë aftësi shtet-formuese.⁸ Programi kryesor i Kongresit kombëtar ishte rikthimi i Princ Vidit – një politikë që e përkrahnin shumica e nacionalistëve shqiptarë. A. Zogu u kërkoi autoriteteve austro-hungareze që Austria të garantonte “shtrirjen e

⁶ *Po aty*, Vj. 26-12-1220, Relacion i gjeneral-majorit V. Bobeçiç mbi pozitën e ardhshme të Shqipërisë, Shkodër, 28 dhjetor 1916.

⁷ *Po aty*, Vj. 26-18-1850, Aneks për raportin nga Shkodra, nr. 16/pol. i Stacion komandës austro-hungareze në Elbasan, Shkodër, 23 mars 1916; Lef Nosi, *Dokumente historike 1912-1918*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 2007, f. 246.

⁸ Lef Nosi, *Dokumente historike...* “Programa e Kongresit”, f. 251; *Shqipëria më 1937 – Veprimi shtetnor gjatë njëzet e pesë vjetëve të parë të vetqeverimit*, vëll. I, Shtypshkronja “Kristo Luarasi”, Tiranë: 1937, f. 12.

vijës kufitare në përputhje me parimin e nacionalitetit”,⁹ çka do të thoshte, ribashkim i Kosovës e Çamërisë. Por nisma e marrë nga nationalistët shqiptarë u pengua me forcë nga autoritetet austro-hungareze.¹⁰

Megjithëkëtë, nationalistët shqiptarë u përpoqën të përfitonin sa të mundnin nga hapësira që krijohej në zonën austro-hungareze. Kështu, ata arritën që të krijonin një administratë të përbërë nga shqiptarë, por nën kontrollin austro-hungarez, që shtrihej nga Malësia e Mbishkodrës e deri në lumin Vjosë. Austriakët u lejuan shqiptarëve të gjitha të drejtat e tyre kulturore, duke mbështetur e ngarkuar me detyra të rëndësishme nacionalistë të shquar. Administrata shqiptare veprroi në tre drejtime kryesore: financa, arsimi dhe drejtësia. Një pjesë e nacionalistëve të larguar nga terrori serbo-malazez u rikthye duke kontribuar fuqimisht në aktivitetet kombëtare.

Politika austro-hungareze ndihmoi për të dobësuar më tej barrierat kulturore midis shqiptarëve, dhe si e tillë do të kishte pasoja pozitive gjatë e pas Luftës. Administrata shqiptare e krijuar ishte e rregullt, efikase dhe e mbështetur në modelin evropian perëndimor.¹¹ Kështu u hodhën hapat e parë edhe për formimin e nëpunësve shqiptarë me profil kombëtar e perëndimor. Në administratën e re u përfshinë edhe shqiptarë të krahinave shqiptare të aneksuara nga Serbia e Mali i Zi me vendimet e Konferencës së Londrës së vitit 1913. Pra, ishte një hap tjetër drejt një administrate gjithëkombëtare e jo gjysmëkombëtare. Autoritetet austro-hungareze lejuan përdorimin e flamurit kombëtar, nxitën shtypin shqiptar,¹² korrespondenca zyrtare përveç gjuhës gjermane u realizua edhe në gjuhën shqipe, duke e ngritur më lart standardizimin dhe nivelin e formulimit të saj. U bë një hap tjetër serioz për shkëputjen nga gjuha turke në dokumentacionin e administratës fiskale. Konsulli i Përgjithshëm, Kral, kërkonte me këmbëngulje “shqiptarizimin absolut të shërbimit të administratës në Shqipëri”¹³.

⁹ *British National Archives, London*, Public Record Office; Foreign Office (më tej: FO) 371/3155/49228, Spiers për Ministrinë e Luftës, 13 mars 1918; FO 371/3155/49231, Spiers për Ministrinë e Luftës, 14 mars 1918.

¹⁰ *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 26-6-631, Telegram shifër i kontit Turn drejtuar MPJ, 17 mars 1916.

¹¹ Franz Steiner, *Numërimi i parë i popullsisë në Shqipëri*, Shtypshkronja Franciskane, 1922, f. 4.

¹² *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 26-30-2031, Shkresë e MPJ drejtuar A. Rappaport, Vjenë, 19 janar 1916.

¹³ *Po aty*, Vj. 27-5-552, Raport i Kral për MPJ, Shkodër, 30 shtator 1917.

Një hap i madh përpara ishte formimi i “Komisia Letrare”, e cila do të ndihmonte në përmirësimin e drejtshkrimit të gjuhës zyrtare shqipe, të hidhte themelet e një gjuhe të përbashkët letrare dhe në pasurimin e saj dhe të drejtonte punën për botimin e librave e teksteve shkollore në gjuhën shqipe. Veprimtaria që zhvilloi “Komisia Letrare” ishte një kontribut me rëndësi për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe unifikimin e dy dialekteve të kësaj gjuhe, duke shkuar drejt krijimit të një standardi të përbashkët të gjuhës shqipe. Në vitet 1916-1917 në zonën austro-hungareze u shtuan shkollat shqipe dhe, mbi të gjitha, u ngrit cilësia e mësimdhënies, pajisjeve dhe u rrit frekuentimi i tyre. Këto shkolla u shndërruan në vatra të rritjes së ndërgjegjes dhe formimit të inteligjencies së re kombëtare. Kësaj arritjeje i duhet shtuar edhe ngritja e shumë shkollave fillore shqiptare në viset shqiptare në Kosovë e në Malin e Zi. Tekstet shkollore u përmirësuan ndjeshëm dhe u mbështetën në dialektin e Elbasanit, që ishte një dialekt qendror dhe unifikues. Autoritetet austro-hungareze mbështetën kultivimin e një nacionalizmi përbashkues dhe unifikues, që evokonte origjinën e vjetër të popullit shqiptar, që siç shkruante Gjergj Fishta “të ngjallnin shpirtin e Skënderbegut ndër zemra t’gjith shqyptarvet”¹⁴. Madje filloi edhe një proces desllavizimi në viset shqiptare, që kishin qenë të aneksuara nga Serbia e Mali i Zi. Përveç të tjerave, ky proces u shfaq edhe në fillimin e masave për heqjen e prapashtesës “viq” nga mbiemrat e familjeve shqiptare, duke i kthyer ato në formën e mëparshme origjinale.¹⁵

Austriakët hodhën hapat e para edhe drejt kultivimit të harmonisë dhe kombëtarizimit të institucioneve fetare. Pasi hodhi poshtë një propozim të autoriteteve ushtarake austro-hungareze për Lidhjen dhe përfshirjen e Kryemyftinisë së Shqipërisë në kuadër të “Reis ul Ulemasë” së Sarajevës, si dhe thirrjes së hoxhallarëve boshnjakë në Shqipëri, kryekonsulli Kral dhe Ministria e Jashtme mbështetën vendosjen e një kryemyftiu vendas në drejtim të Komunitetit Mysliman Shqiptar. Në maj të vitit 1918 të gjitha proceset gjyqësore të Sheriatit filluan të kryheshin në gjuhën shqipe.¹⁶

¹⁴ “Mas 450 vjetsh”, *Posta e Shqipërisë*, nr. 12, Shkodër, 17 janar 1917, f. 1.

¹⁵ *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 27-4-467, Relacion i Feldmarshall-Leitnant Veber, drejtues i Guvernës së Përgjithshme të Ushtrisë austro-hungareze në Malin e Zi, drejtuar Kryekomandës së Ushtrisë, Cetinë, 15 korrik 1917.

¹⁶ *Po aty*, Vj. 28-68, Raport i Kral për MPJ, Shkodër, 14 qershor 1918.

Ndërtimi i rrugëve të transportit për nevojat ushtarake nga austro-hungarezët¹⁷ ishte një zhvillim i rëndësishëm strategjik, që krijonte kushtet bazike për bashkimin kombëtar, duke ndihmuar në zbutjen e njërës prej barrierave më të mëdha të këtij bashkimi dhe unifikimi. Në këtë drejtim ndihmoi edhe fuqizimi i rrjetit postar.

Pas publikimit të Traktatit të Fshehtë të Londrës nga qeveria sovjetike, më 23 nëntor 1917, austriakët e përkthyen atë në shqip dhe e shpërndanë në të gjithë vendin. Kjo ushtroi një ndikim të madh tek nacionalizmi shqiptar, i cili e shtoi bindjen se nuk mund të vijonin të vareshin nga Fuqitë e Mëdha, dhe se tani ai duhej të riorganizohej e reformohej për të qenë i gatshëm në fundin e luftës. Ky ishte një ndikim tjetër i cili do t'u çelte sytë shqiptarëve por dhe do të ngrinte ndjeshëm ndërgjegjen dhe profilin politik të kombit shqiptar dhe të pararojës së tij më të emancipuar nacionalistëve. Kështu, në mënyrë paradoksale, Shqipëria e mjerë po rritej nga vuajtjet dhe dhimbjet e forta të saj.

Gjithsesi, duhet shënuar se pati edhe kufizime të rëndësishme. Kështu, autoritetet austriake nuk e pranuan propozimin e nacionalistëve shqiptarë me në krye H. Prishtinën për bashkimin e Pejës, Gjakovës, Gucisë, Mitrovicës, Vuçiternës me Shqipërinë, me qëllim që të bëheshin pjesë e shtetit të ardhshëm shqiptar. Mesa duket Vjena nuk dëshoi që të ngutej në këtë drejtim, pasi mund të armiqësonte më tej irredentizmin serb dhe malazez. Nga ana tjetër, duhet theksuar se trupat austriake i trajtuan mikpritësit e tyre shqiptarë mjaft keq. Ata mobilizuan popullsinë në punë të detyrueshme, sekuestruan me forcë të gjitha llojet e mallrave dhe dhanë çmime të ulëta ose me kredi për ato që blinin.

Zona franceze e pushtimit - një vatër tjetër e mbijetesës dhe ringjalljes së nacionalizmit shqiptar

Shpallja e Republikës së Korçës ishte tregues për rilindjen e nacionalizmit shqiptar në një prej zonave ku ai kishte qenë i fuqishëm edhe para luftës, por njëkohësisht ku ai ishte sfiduar fuqishëm dhe kishte zhvilluar një betejë e ashpër me nacionalizmin grek. Mbi të gjitha, ky ishte një eksperiment i suksesshëm, ku myslimanët dhe

¹⁷ Sipas dokumenteve austro-hungareze rezulton se u ndërtuan ose përmirësuan 739 km rrugë automobilistike (*po aty*, Vj. 27-7-772, Raport i Kral për MPJ, Shkodër, 7 janar 1917).

ortodoksët punuan bashkërisht nën të njëjtën administratë, pa ndërlikimet e krijuara prej rivaliteteve dhe intrigave të Fuqive të Mëdha, që e kishin dëmtuar rëndë shtet-formimin gjatë regjimit të Vidit. Prej këtij, dashamirësit e Shqipërisë dhe optimistët e huaj, apo vendas panë një eksperiment të suksesshëm të ndërtimit të një shteti dhe kombi modern shqiptar, i bazuar në bashkëveprimin kombëtar të elementëve të ndryshëm fetar. Funksionimi normal dhe i suksesshëm i krahinës autonome apo siç është quajtur republikës së Korçës ishte jo vetëm një model, por edhe një shpresë e madhe për ringritjen e kombit shqiptar dhe aftësinë e tij për vetëqeverim e progres, pas ngjarjeve dramatike të viteve 1914-1915, që e kishin tronditur dhe mjegulluar këtë besim.

Zona italiane dhe zhvillimi i stresuar i nacionalizmit shqiptar

Politika italiane e Traktatit të Fshehtë të Londrës (1915) ndryshoi duke filluar nga viti 1917, pikërisht se tani filloi të dukej rënia e Perandorisë Austro-Hungareze, rivalit të saj kryesor në Shqipëri. Në vitin 1919, me daljen në skenë të Jugosllavisë, që do të zëvendësonte Austro-Hungarinë, si rival i Italisë, politika italiane do të kërkonte vetëm zotërimin e Vlorës dhe më tej u orientua në mbështetjen e nacionalizmit shqiptar. Krijimi i një Shqipërie të Madhe paraqiste avantazhe për politikën italiane, sepse do të shërbente si kundërpeshë ndaj Jugosllavisë në krahun lindor të Adriatikut. Por, nga ana tjetër, qeveria italiane ishte më e interesuar për përfitimet spektakulare gjatë, se sa për përfitimet më pak interesante në Shqipëri.

Mbështetja italiane për nacionalizmin shqiptar, jo vetëm që ishte e kufizuar dhe e kushtëzuar, por veçanërisht ajo deformonte karakterin dhe dëmtonte imazhin e tij të pastër dhe parimor kombëtar. Kështu, ajo u krijoi nacionalistëve dhe perspektivës së kombit shqiptar mjaft kundërshti të rrezikshme ndërkombëtare. Diplomati britanik i angazhuar me çështjen shqiptare, Harold Nicolson, shkruante në ditarin e tij: “Ishte një fat tmerrësisht i keq për Shqipërinë që po i imponojnë Italinë si fuqi mandatare, e më pas do t’i cungohen kufijtë, thjesht dhe vetëm se asnjë prej nesh nuk i beson Italisë në Ballkan”¹⁸.

¹⁸ H. Nicolson, *Peacemaking 1919*, London, 1933, f. 276.

Në zonën e pushtimit italian, ndonëse shqiptarët gëzonin relativisht pak autonomi, italianët siç shkruan Swire, morën rolin e një rojtari dashamirës, disi autokratik. U ndërtuan 200 milje rrugë të mira dhe 50 milje hekurudhë, u hapën spitale dhe shkolla, gazetaret kombëtare nisën të qarkullonin. Gjendja ekonomike e popullsisë u përmirësua ndjeshëm. Proklamata e gjeneralit Ferrero për autonominë e gjithë Shqipërisë nën protektoratin italian binte ndesh me Traktatin e Fshehtë të vitit 1915. Sonnino, për shumë konsiderata, që nuk është vendi t'i përmendim këtu, në këtë kohë anoi nga rikrijimi i shtetit shqiptar. Të gjitha këto do të ndikonin pozitivisht për riafirmimin e vitalizmin e kombit shqiptar, ndonëse edhe rreziqet që vinin prej objektivave të politikës italiane për ekzistencën e tij ishin të mëdha.

Por, këto kundërshti të rrezikshme, do të rezultonin fatlume në një drejtim tjetër. Më në fund, kontradiktat e ashpërsuara italo-amerikane, të cilat kulmuan me thirrjen e drejtpërdrejtë që Wilsoni i drejtoi popullit italian për të pranuar të 14 pikat e tij, e shtuan kundërshtimin e tij që Italisë t'i jepej mandati mbi Shqipërinë. Gjatë një takimi me Clemanceau-n dhe Lloyd George, më 6 maj 1919, Wilsoni nguli këmbë që shqiptarëve t'u jepej pavarësia, duke kundërshtuar Lloyd George-n, i cili shprehte dyshime përkundrejt bashkimit të tyre.¹⁹ Kështu, nga një kundërshtim ndaj italianëve, të cilët e kishin shfaqur hapur imperializmin e tyre, Wilsoni u kthye kundër politikave britanike dhe franceze, të cilët e kishin më të maskuar atë. Por, pjesa tjetër e delegacionit amerikan, si p.sh. Day House, Johson, ishin më pak të bindur për pavarësinë shqiptare dhe ishin të prirë për të luajtur lojën e shkëmbimeve, tipar karakteristik i diplomacisë së vjetër. Wilsoni mbeti i bindur se Shqipëria nuk duhej përdorur si peng dhe se qysh në këtë fazë duhej zbatuar parimi i vetëvendosjes.

Në rrethanat e krijuara në fund të Luftës së Parë Botërore, kur Italia kontrollonte shumicën dërrmuese të territorit shqiptar, një nga segmentet kryesore të nacionalizmit shqiptar, duke parë pozitën e dëshpëruar të çështjes shqiptare konstatoi se rruga e vetme praktike ishte arritja e një kompromisi me Italianë. Por, pajtimi i interesave shqiptare me objektivat që kishte përcaktuar Roma, ishte diçka e vështirë, pasi diferencat ishin të mëdha. Për këtë arsye, kompromisi do të ishte shumë i dhimbshëm për shqiptarët. Qysh pas Deklaratës

¹⁹ Petsalis N. Diomidis, *Greece at the Paris Peace Conference*, Thessaloniki, 1978, f. 150.

italiane në Gjirokastrë, Mehmet Konica, i cili ishte kryedelegati i “Vatrës” në Evropë, e siguroi Sonnino se në qoftë se qeveria italiane do të bënte një deklaratë formale në mbështetje të një shteti të pavarur shqiptar, që të përfshinte brenda kufijve të tij të gjitha territoret me popullsi mbizotëruese shqipfolëse, atëherë Italia do të kishte mbështetjen e plotë të “Vatrës” për vendosjen e protektoratit. Në funksion të kësaj, në fillim të dhjetorit 1918, Sonnino ftoi në Romë nacionalistët kryesorë shqiptarë në mërgim. Ai ishte i interesuar të fitonte mbështetjen e tyre, por nuk ishte aq i gatshëm që të bënte një deklaratë zyrtare nga frika e reagimeve që kjo mund të shkaktonte tek Aleatët. Kundërshtitë e Aleatëve ishin evidente. Qysh në mesin e tetorit 1918, qeveria franceze kishte paralajmëruar Konsultën të ndalonte nxitjen e nacionalizmit shqiptar në zonat e pushtimit italian, pasi Traktati i Fshehtë i Londrës ia rezervonte jugun e Shqipërisë, Greqisë. Në fillim të nëntorit 1918, Foreign Office dhe Departamenti Amerikan i Shtetit, pasi ishin informuar se italianët po përgatiteshin të formonin një qeveri kukull në Shqipëri, për t’i paravendosur Aleatët para një fakti të kryer, paralajmëruan Romën se do të kundërshtonin çdo veprim të njëanshëm në Shqipëri.²⁰ Sonnino nuk mund të dilte hapur kundër partnerëve të tij. Ai u premtoi nacionalistëve shqiptarë se do t’i ndihmonte në organizimin e një shteti modern dhe do t’i ndihmonte ata në rimarrjen e territoreve shqiptare, duke premtuar se do të bllokonte kërkesat greke dhe sllave atje. Fillimisht italianët iu përveshën punës që të nxisnin nacionalistët shqiptar të kërkonin publikisht përmes peticioneve të ndryshme krijimin e një Shqipërie nën protektoratin italian. Njëkohësisht, ata punuan fort në prapaskenë për të penguar formimin e një qeverie qendrore shqiptare. Përkohësisht, ata ia arritën këtij qëllimi, kur në Lezhë u mblodhën rreth 100 krerë shqiptarë, më 9 dhjetor 1918, dhe Ettore Lodi arriti ta kanalizonte takimin larg idesë së krijimit të një qeverie të përkohshme shqiptare.²¹

Por, nacionalistët shqiptarë nuk do të ndaleshin këtu. Mehmet Konica, që ishte shndërruar në këto momente në figurë qendrore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, ndërmoi udhëtime në Shqipëri për të

²⁰ DDI, Seria 6, I, nr. 694; Department of State (ed) Papers Relating to the Foreign Relations of the United States of America 1919; The Peace Conference, 13 vols (Washington, D.C., 1942-1947); FRUS, FFG, II, f. 374-5.

²¹ O. Pearson, *Albania in the Twentieth Century: A history*, 3 vols. , I, p. (London, 2003) esp. Voll. *Albania and King Zog: Independence Republic and Monarchy 1908-1939*.

organizuar një takim të dytë të udhëheqësve shqiptarë, i cili u organizua në Durrës, në dhjetor 1918 (Kongresi i Durrësit). Këtu Lodi nuk ishte më në gjendje të kontrollonte takimin, sikundër kishte bërë në Lezhë. Pavarësisht kundërshtimeve të tij, shqiptarët e shpallën këtë Kuvend Kombëtar dhe vijuan me krijimin e një qeverie të përkohshme, me në krye Turhan Pashën. Kuvendi kërkoi rivendosjen e shtetit të pavarur shqiptar dhe artikuloi pretendimet për bashkimin e territoreve shqiptare, të aneksuara nga serbët e grekët më 1913.

Shqiptarët po vepronin kështu, edhe një herë në mënyrë të pavarur, duke sfiduar Fuqitë e Mëdha, interesat e të cilave nuk pajtoheshin me ato të tyre. Por, nga ana tjetër, përkrahja e të mëdhenjve ishte kusht i rëndësishëm për të fituar. Konica shkoi në Romë për të shpjeguar se përse ishte formuar qeveria në kundërshtim me vendimet e italianëve. Ai ishte krejtësisht i vetëdijshëm se kjo lëvizje i kishte kapur italianët në befasi dhe kishte shkuar shumë më larg se sa kishin parashikuar ata, ndaj, ai ishte i shqetësuar se mos humbiste mbështetjen italiane. Ai kishte organizuar emërimin e Turhan Pashës si kryeministër, si një përpjekje për të zbutur kundërshtitë italiane²². Me gjithë sfidën që i ishte bërë, edhe Sonnino nuk donte konflikt me nacionalistët shqiptarë, sepse nuk donte ta humbiste mbështetjen e tyre. Duke vlerësuar se tani ishte tepër vonë që kjo lëvizje të zhbëhej, ai vendosi që aktet e Kuvendit Shqiptar të zbeheshin në praktikë dhe qeveria e Durrësit të asfiksohej pak nga pak, deri atje ku e kërkonin interesat italiane. Qeveritë franceze, britanike e amerikane, gjithashtu, refuzuan ta njihnin atë. Italianët u përpoqën të luanin një lojë të dyfishtë, duke e paraqitur kundërshtimin si të imponuar nga Fuqitë e tjera, dhe, nga ana tjetër, të ruanin ndikimin mbi nacionalistët shqiptarë.

Ndikimi i politikës amerikane në ringritjen e nacionalizmit shqiptar

Hyrja e SHBA-së në luftë më 7 dhjetor 1917 i shtoi një element të rëndësishëm mbijetesës së kombit shqiptar, pasi SHBA-të, ndonëse nuk kishin asnjë politikë shqiptare, nuk ishin palë nënshkruese e Traktatit të Fshehtë dhe hynë në luftë mbi bazën e të drejtave të vetëvendosjes kombëtare. Këto parime nacionaliste liberale të reja do të ndikonin disi edhe në politikën evropiane. Por, çështja shqiptare u pa shumë ndryshe nga çështjet e tjera kombëtare. Roger MacGinty ka

²² N. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, f. 181.

nënvizuar se hyrja e SHBA-së në luftë dhe veprimet e bolshevikëve kanë pasur një ndikim të rëndësishëm për nacionalizmat ballkanike. Kjo vlente edhe për nacionalizmin shqiptar, duke aktivizuar në maksimum organizatën e tij më moderne, të fuqishme dhe të organizuar mirë, Federatën “Vatra”. Fillimisht “Vatra” kishte mbështetur Austro-Hungarinë, por hyrja e SHBA-së në luftë, bëri që ajo të ndryshonte drejtim. Ajo mbështeti SHBA-në, duke përqaftuar njëkohësisht si vlerë idealet dhe institucionet politike liberale amerikane, me besim se parimet e Wilson-it për vetëvendosjen e kombeve të vegjël do të zbatoheshin edhe për Shqipërinë dhe do t’i shërbenin objektivave të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Parimet wilsoniane ngërthenin dy elementë përbërës kryesorë: të drejtën për autonomi për grupet kombëtare dhe procesin demokratik brenda shteteve. 14 pikat përfshinin mjaft parime që mund të konsiderohen si të kundërta me të drejtën për vetëvendosje dhe mundësonin edhe të tjera përparësi për përcaktimin e kufijve, përfshi këtu stabilitetin ndërkombëtar, zhvillimin historik, kufijtë ekonomikë, mundësitë për mbrojtjen e kufijve, çështjen e sigurisë dhe komunikacionin.²³ Mbi të gjitha, në çështjen shqiptare, pika 11 e Wilsonit parashikonte daljen e Serbisë në det, pavarësinë e saj ekonomike dhe rikthimin e kufijve serbë, malazezë e rumunë. Si rezultat, zgjidhja e çështjes shqiptare do të ishte një kombinim midis vetëvendosjes kombëtare bazuar tek gjuha, interesave të Fuqive të Mëdha dhe të vogla, dhe marrëveshjeve të mëparshme midis fuqive të ndryshme. Ky ishte një kombinacion tepër i komplikuar dhe do të kalonte përmes krizash të rënda të kombit shqiptar, duke e çuar atë sa pranë greminës së shpërbërjes, aq edhe pranë një shpëtimi fatlum dhe më të qëndrueshëm, se ai i vitit 1913.

Në raportin përfundimtar të Komisionit Hetimor të SHBA-së për përfundimin e Paqes më 21 janar 1919, një Shqipëri e pavarur, konsiderohej si e përealizueshme, si pasojë e dobësisë së ndjenjës kombëtare të këtij populli, institucioneve të prapambetura, vështirësive në komunikacion dhe ndërhyrjeve nga ana e shteteve fqinje, bazuar kjo në gërshetimin e faktorëve etnikë, ekonomikë e strategjikë. Në një raport të këtij Komisioni, thuhej se “përpjekja për të krijuar një shtet shqiptar më 1912-1914, ka dështuar aq shumë, sa që na duket e pasaktë që Shqipërinë ta klasifikojmë në listën e shteteve të

²³ A. Sharp, “*Britain and the minorities at the Paris Peace Conference*”, në A.C.Hepburn (ed), *Minorities in History* (London 1978), pp.177-178.

reja të mundshme”. Si rrjedhim u propozua copëtimi dhe një shtet i vogël mysliman në Shqipërinë e Mesme në protektoratin e një Fuqie të paimterësuar, pasi shqiptarët konsideroheshin të paafte për vetëqeverisje.

Por, në fillim të Konferencës së Paqes, pozicioni amerikan kishte lëvizur drejt një simpatie kundrejt nacionalizmit shqiptar. I vetmi hezitim që mbetej ishte mendimi se shqiptarët ishin të papërgatitur për pavarësinë e plotë të atij lloji, që ishte shpallur më 1912. Si rezultat, kundër dëshirës së tyre, udhëheqësit amerikanë erdhën në pozicionin e përkrahjes së një mandati italian me natyrë tepër të kufizuar. Arsyet e këtij ndryshimi mendoj se kanë lidhje me aktivitetet e “Vatrës” dhe të rigjallërimit të nacionalizmit modern shqiptar në ShBA.

Qëndrimi i Wilsonit pati implikime të thella: 1. Në vonimin e marrjes së një vendimi rreth pavarësisë së Shqipërisë dhe kufijve të saj. Wilsoni, pa dashje, bëri të mundur që në Shqipëri të krijohesh një qeveri kombëtare, pak a shumë e qëndrueshme, e organizuar dhe antiitaliane (e dalë nga Kongresi i Lushnjës) të kishte ende një entitet shqiptar të mundshëm për t’u ruajtur. Ndërkohë, gjatë marsit 1920, Wilsoni arriti të hiqte problemin shqiptar nga çështja e Adriatikut, duke e kthyer atë në një problem thjesht shqiptar.

Politika britanike ndërtohej mbi dy parime: 1. Mbështetja e nacionalizmave klienteliste e të dobishme për të, si p.sh. grekët. 2. Nisur nga konsideratat e luftës, qeveria britanike e konsideronte çështjen shqiptare të ndryshme prej çështjeve kombëtare të shteteve të tjera të vogla. Shqiptarët gjatë pjesës më të madhe të luftës ishin të përçarë, e për pasojë të dobët në raport me rivalët e tyre. Shqiptarët kështu nuk konsideroheshin të dobishëm dhe shtoheshin hezitimet për mbështetjen e parimit të vetëvendosjes për ta. FO mendonte se shtetet që do të ngriheshin mbi vetëdijen e një kombësie të përbashkët, duhej të ishin të qëndrueshme pasi kështu mund të jepnin një ndihmë më të vendosur kundër agresionit se sa forma e vjetër e shtetit. Në rastin e Evropës Juglindore, FO, vlerësonte se vetëvendosja ofronte perspektivën më të mirë për një paqe të përhershme, ndaj ajo ishte e dëshirueshme dhe plot avantazhe për interesat britanike. Por në rastin e Shqipërisë, këto parime të formuluar nga Departamenti i Zbulimit Politik të FO,²⁴ nuk patën shumë ndikim, kryesisht për shkak të ndërvarësisë që çështja shqiptare kishte me ambicet italiane. Politika

²⁴ FO 371/4353, Memo on Europe, PID, paper, f. 23.

britanike ndaj Shqipërisë do të kishte shumë dilema dhe do të ndikoheshin nga shumë motive, që do të gërshetoheshin midis tyre, duke e shndërruar çështjen shqiptare në një plaçkë tregu.

Në fund të luftës, nacionalistët shqiptarë projektuan të rreshtoheshin përkrah Antantës, në këmbim të rinjohjes së pavarësisë së saj. Në qershor 1918, Mehmet Konica propozoi krijimin e një detashmenti shqiptar nën udhëheqjen e Aubrey Herbert, përkundrejt rinjohjes së pavarësisë pas luftës. Foreign Office e hodhi poshtë këtë ofertë. Sikundër shkruante në atë kohë, Harold Nicolson, atëherë një zyrtar i ri në MPJ, “vështirë se do të ishte e ndershme për ne që t’i nxisnim shqiptarët të luftonin për një vend të coptuar.”²⁵ Pra, oferta shqiptare ishte shumë pak e vlefshme për britanikët, të cilët në çështjen shqiptare udhëhiqeshin nga parime të tjera shumë më të rëndësishme për ta.

Nacionalizmi shqiptar në fundin e luftës - progres i papërfunduar

Ndonëse në vitin 1919 rivalët e shqiptarëve kishin një argument më të fuqishëm, të bazuar mbi provat rreth mënyrës se si u shemb regjimi i Vidit, si dhe mbi ndasitë shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore dhe Konferencës së Paqes së Parisit, nacionalizmi shqiptar po bënte hapa para. Në mënyrë kuptimplote, Lëvizja Kombëtare e Shqiptarëve në fund të luftës ishte karakterizuar kryesisht nga zbehja e dallimeve fetare, ndryshe nga momentet e fillimit të luftës, kur përçarja fetare ishte demonstruar dukshëm. Përparimi i nacionalizmit shqiptar në muajt e fundit të luftës dhe pas saj, do të ecte me shpejtësi. Kjo ngjasonte me përvojën e kombësive të tjera të vogla evropiane-lindore, por njëherazi ndryshonte prej tyre, për shkak të mungesës së mbështetjes së Fuqive të Mëdha për veprimet e shqiptarëve.

Por, në ringritjen e kombit shqiptar, përveç rrethanës negative që lidhej me mungesën e një aleati të madh, kishte një rrethanë pozitive. Mehdi Frashëri, me të drejtë shkruante në atë kohë se “situata e re e të tri shteteve – Ruisë, Austrisë dhe Turqisë – do të sjellë një ndryshim të shëndetshëm në Shqipëri, si për moralin e shqiptarëve, ashtu dhe për politikën e Fuqive të Mëdha dhe shteteve të vogla ndaj nesh. Të tria Fuqitë e lartpërmendura, nuk do të ishin një faktor politik gjatë Konferencës së Paqes. Për rrjedhojë, çështja shqiptare do të zgjidhej

²⁵ FO 371/3157/127525, Shënime të H. Nicolson.

nga “Fuqi pa interes dhe miqësore” duke bërë të mundur zbatimin e parimeve willsoniane. Pavarësisht se koha do të provonte se rreziket do të ishin shumë më të mëdha se sa mendonte ai dhe se altruizmi i Fuqive ishte thjesht një iluzion i tij, pavarësisht peripecive, parashikimi i Mehdiut do të rezultonte gjenial.

Gjithsesi, duhet nënvizuar se nacionalizmi shqiptar nuk e kapërceu fazën e përçarjes organizative dhe fragmentarizmin. Në të vërtetë u krijua një përfaqësim qendror, por ky ishte i dobët, pa autoritetin e duhur dhe nën kontrollin dhe presionin e huaj që e diskreditonte dhe asfiksonte autoritetin dhe prestigjin e tij, si një organizëm qendror drejtues mbarëkombëtar. Delegacioni kryesor që ishte ai i qeverisë së Durrësit, gjithashtu nuk i kishte përpunuar mënyrat e duhura për mbrojtjen e çështjes shqiptare. Në shumë drejtime, politikat dhe veprimet e tij ishin naive dhe pa nivelin që kërkonte diplomacia e rafinuar e kohës. Ky defekt ishte produkt i krizës së gjatë, që po kalonte çështja shqiptare dhe i mungesës së përvojës diplomatike shtetërore. Delegacioni i Durrësit me të drejtë u paraqit në Konferencë si një përfaqësi e pastër e krejt popullit shqiptar. Por, ky deklaram u prit armiqësisht nga përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha në sallë, pasi ai ndryshonte mjaft nga perceptimet e tyre.²⁶ Nga ana tjetër, ekzistenca e shumë delegacioneve në Konferencën e Parisit ishte në vetvete problematike dhe do të rezultonte e dëmshme për çështjen kombëtare shqiptare, pasi mosmarrëveshjet e tyre mund të shfrytëzoheshin nga rivalët e Shqipërisë, si provë për pretendimin se shqiptarët nuk ishin të gatshëm për vetëqeverisje. Kjo ishte ana negative, por kjo shumicë delegacionesh kishte edhe një anë disi pozitive në situatën e atëhershme. Ata ushtruan një farë presioni dhe ndikimi që Fuqitë (si p.sh. Italia) të mos arrinin të merrnin nën kontroll për interesat e tyre të ngushta përfaqësimin e shqiptarëve.

Në lëmshin e këtyre kundërshtive, në të cilat eci kombi shqiptar, do të triumfonte e drejta e tij dhe shansi pothuajse final historik i mbijetesës dhe i konsolidimit, i cili në dekadat që do të pasonin do të kishte herë lëkundje të vogla dhe herë të mëdha, por asnjëherë nuk do të vihej në pikëpyetje aq seriozisht sa u vu gjatë Luftës së Parë Botërore.

²⁶ FO 371/3593/27947, Komisioni grek, shënimet, 26 shkurt 1919.

Jusuf BAJRAKTARI, Prishtinë

KOSOVA DHE VISET E TJERA SHQIPTARE GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

KDU 94(496.51)“1914”
94(=18)“1914”

Lufta e Parë Botërore mori shkas nga vrasja e princit trashëgimtar të Austro-Hungarisë, Franz Ferdinandi, më 28 qershor 1914, në atentatin e Sarajevës nga Gravrillo Principi, anëtar i organizatës terroriste serbe “Bosna e Re”. Në fakt, lufta që filloi me sulmin e Austro-Hungarisë ndaj Serbisë, më 28 korrik 1914, është pasojë e kundërthënieve dhe armiqësive të thella ndërmjet shteteve evropiane në garën e tyre politike e ushtarake për koloni dhe sfera interesi mbi zona të ndjeshme, siç janë Ballkani e vende të tjera. Lufta e Parë Botërore përkon edhe me kohën e ndërtimit të Shqipërisë së pavarur, e cila kishte vetëm një vit e gjysmë jetë, të mbushur me plot lufta e peripeti. Mbi gjysma e trojeve shqiptare, si Kosova, Çamëria, Maqedonia Perëndimore, Ulqini, Tivari, Plava, Gucia vuanin nën sundimin e shteteve ballkanike, Serbisë, Mali të Zi dhe Greqisë.

Periodha, 1913-1914, nuk qe e mjaftueshme për konsolidimin e shtetit dhe aq më pak të çështjes shqiptare. Populli shqiptar, pas shpalljes së pavarësisë, kaloi nëpër sfida të shumta që iu imponuan nga rrethanat e kohës. Këto rrjedha u ashpërsuan me fillimin e luftës, e cila do të ketë pasoja shumë të rënda për qenien kombëtare dhe për shtetin e pavarur shqiptar të pakonsoliduar ende politikisht. Fuqitë e Mëdha, që kishin vënë Shqipërinë nën garancinë e kontrollit të tyre, tani kishin hyrë në luftë me njëra tjetrën, të rreshtuara në bllokun e Boshtit Trepalësh (Gjermania, Italia (deri në prill 1915-s) dhe Austro-Hungaria) dhe atë të Antantës (Anglia, Rusia dhe Franca). Të dy grupet ndërluftuese shpejtuan ta përdornin Shqipërinë si objekt të planeve të tyre luftarake e politike.

Edhe pse në bazë të Konferencës së Londrës ishte i garantuar neutraliteti i Shqipërisë, megjithatë, në rrethanat e shpërthimit të luftës, Fuqitë e Mëdha nuk iu përmbajtën këtij parimi. Sikur palët ndërluftuese do t’u përmbaheshin vendimeve të 1913-s ngjarjet në Shqipëri do të zhvilloheshin ndryshe. Mund të pritej që Shqipëria të lihej e qetë, pa u ngatërruar me blloqet ndërluftuese. Por, fatkeqësisht, situata u përkeqësua në mënyrë dramatike në dëm të shqiptarëve, duke u rrezikuar seriozisht, jo vetëm ekzistenca e një shteti të ri, por edhe qenia e një populli të tërë.

Përkundër shpalljes së neutralitetit që në fillim të luftës nga Qeveria e Princ Vidit, zhvillimet e mëpastajshme patën pasoja shumë të rënda politike, ekonomike dhe shoqërore për vendin. Territorët shqiptarë u pushtuan nga ushtritë e shteteve ndërluftuese, duke i shndërruar ato në arenë lufte. Në tetor të vitit 1914, Greqia pushtoi Shqipërinë e Jugut; po në këtë muaj Italia pushtoi ishullin e Sazanit, ndërsa në tetor 1914 Vlorën. Në qershor të vitit 1915 Serbia pushtoi Shqipërinë e Mesme, ndërsa Mali i Zi, Shqipërinë Veriore.

Traktati i Fshehtë i Londrës i nënshkruar në prill të vitit 1915 midis Italisë e Fuqive të Antantës shënon aktin e shëmtuar, sipas së cilit jo vetëm që likuidohej pavarësia e Shqipërisë, por bëhej copëtimi i plotë i tokave shqiptare midis katër vendeve fqinje (Italisë, Greqisë, Serbisë dhe Malit të Zi).

Në kuadër të rrethanave të krijuara u manifestuan shqetësime të reja për patriotët dhe liderët e grupimeve politike si brenda ashtu edhe jashtë atdheut. Zëdhënës i qarqeve patriotike shqiptare edhe me këtë rast u bë “Federata” e shqiptarëve të SHBA-së e cila doli me platformën politike “kundër protektoratit italian mbi Shqipërinë dhe për pavarësinë dhe sovranitetin e saj të plotë.”¹ Sipas marrëveshjes ushtarake të 6 shtatorit 1915 midis Bullgarisë, Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë parashihej zgjerimi bullgar përtej vijave të parapara me Paqen e Madhe të Shën Stefanit të vitit 1878.² Mbi këtë marrëveshje Bullgaria, pas Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë, më 10-11, 1915 sulmoi Serbinë në tri drejtime.³ Më 14 tetor, forcat bullgare depërtuan në Sektorin e Maqedonisë, në mënyrë që t’u pritej rruga forcave serbe dhe për të penguar tërheqjen në drejtim të Greqisë dhe bashkimit me forcat aleate. Ky veprim strategjik rriti prestigjin e Boshtit Trepalësh në krahasim me Antantën. Prandaj, komanda serbe dha urdhër që forcat e tyre të tërhiqen nëpër Kosovë dhe Shqipëri për të dalë në Adriatik. Ishte e qartë që Serbia po pësonte në të gjitha vijat e frontit, që nga Beogradi që ishte në duart e austro-gjermanëve, nga Kumanova e Shkupi që më 21 e 22, tetor 1915 ranë në duar të bullgarëve dhe në këtë mënyrë u bllokua rruga për Selanik.

Më 19-21 nëntor në rajonin e Leposaviqit u bënë përlëshjet e para në territorin e Kosovës midis forcave serbe e atyre Austro-Hungareze, të cilat zunë rob rreth 2000 ushtarë serbë me pajisje

¹ *Arben Puto, Historia Diplomatike e ceshtjes shqiptare, ASHSH, Tirane, 2003, f.259.*

² *Limon Rushiti, Rrethanat politike-shoqërore në Kosovë 1912-1918, Prishtinë, 1986, f.173.*

³ *Po aty.*

ushtarake. Shpartallimi i ushtrisë serbe bëhej me të madhe jo vetëm në fushëbeteja, por edhe për shkak të sëmundjeve, kushteve të këqija atmosferike në kohë dimri si dhe dezertimit në masë të ushtarëve të demoralizuar e të rraskapitur. Në këto rrethana, Komanda Supreme Serbe, merr vendim që tërheqja të bëhet nga Prishtina e Mitrovica nëpër Pejë, Gjakovë, Prizren, Shqipëri Veriore në drejtim të bregdetit shqiptar, për t'i shpëtuar asgjësimit të plotë.⁴ Për politikën e fqinjëve ndaj Shqipërisë në këtë kohë dhe pasojat e saj, Kosta Novaković, shkruan: “Nga Lindja dhe nga Jugu, Serbia dhe Greqia bëjnë presion ...dhe e çojnë kufirin e tyre gjithnjë më thellë në Shqipëri ...përkundër të gjitha presioneve, të gjitha pjesët e Shqipërisë po tregojnë gatishmërinë e tyre për rezistencë”.⁵

Më tutje, Novaković vazhdon se e vetmja pasojë pozitive e hyrjes së ushtrisë serbe në Shqipëri për popullin shqiptar është rezistenca unanime dhe armiqësia e tij kundër Serbisë... Kjo është për të ardhur keq, por shqiptarët nuk janë fajtorë për këtë. Frika nga humbja e pavarësisë është faktor i rëndësishëm dhe ai së shpejti do të sjellë edhe deri tek e vetmja mënyrë e drejtë e mbrojtjes nga armiqët e jashtëm, deri të një bashkësi më e fuqishme dhe një formë e organizimit shtetëror.⁶

Pas shpartallimit të forcave serbe malazeze, forcat ushtarake austro-hungareze dhe ato bullgare u futën në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare. Ato sipas marrëveshjes u ndanë në zona të veçanta ushtarake. Zona austro-hungareze përfshin: Mitrovicën, Vushtrinë, Drenicën e Poshtme, Istogun, Pejë, Gjakovën, Plavën, Gucinë, Pazarin e Ri, Ulqinin dhe Tivarin. Në zonën bullgare hyjnë Podujeva, Prishtina, Drenica e Epërme, Prizreni, Ferizaj, Gjilani, Kaçaniku, Presheva, Kumanova, Shkup, Tetova, Gostivari, Dibra, Kërçova, Struga, Ohri dhe Prespa. Pozita e shqiptarëve në zonën austro-hungareze ishte shumë më e favorshme se sa në periudhën 1912-1915 nën sundimin serb. Pushteti austro-hungarez e njohu të drejtën e shqiptarëve për vetadministrim lokal, për zhvillimin e kulturës dhe arsimit në gjuhën amtare, u lejua përdorimi i lirë i flamurit shqiptar dhe afirmimi e rritja e vetëdijes kombëtare.

Pozita e shqiptarëve në zonën bullgare ishte më e rëndë sesa në atë austro-hungareze. Bullgarët nuk u njohën atyre të drejtat kombëtare e njerëzore, bënë mobilizimin dhe rekrutimin e detyrueshëm të

⁴ *Po aty, f.174-175.*

⁵ *Serbia e Shqiptarët, Libri I, Instituti i Historisë Prishtinë, Prishtinë 2011, f.250.*

⁶ *Po aty, f.251.*

meshkujve për luftë si dhe në aksione e punë të detyrueshme në ndërtimin e rrugëve dhe objekteve të infrastrukturës ushtarake.⁷

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Çamëria dhe viset tjera shqiptare vuanin si mos më keq nga ekspeditat e ushtrisë e bandave keqbërëse greke, të cilat grabitën, vranë, përdhunuan e dogjën fshatra të tëra. Mijëra banorë shqiptarë u larguan nga vatrat e tyre nën trysinë e terrorit e gjenocidit për në Shqipëri dhe Turqi, në kërkim të shpëtimit për jetë.⁸

Megjithëse Shqipëria dhe populli shqiptar përgjithësisht nuk ishin pjesëmarrës aktiv në Luftën e Parë Botërore, atyre iu imponua statusi i një plaçke tregu sipas interesave të fuqive pjesëmarrëse në luftë. Mikesha e dëshmuar e popullit shqiptar dhe e të drejtës universale njerëzore, Edith Durham, lidhur me këtë kontekst kohor ka shkruar se “Shqipëria u hodh përpara ujqërve për të shpëtuar shtetet më të vjetra”. Përkundër therorive dhe sakrificave të shumta, shqiptarët mbijetuan flakën shkatërruese të Luftës së Parë Botërore duke rikrijuar pavarësinë e Shqipërisë dhe konsolidimin e identitetit kombëtar.

Lufta e Parë Botërore ishte luftë me përmasa të mëdha shkatërrimtare midis Paktit Trepalësh në njërin anë dhe Aleancës së Antantës nga ana tjetër. Në luftë, përkrah Fuqive të Antantës u rreshtuan edhe Italia (1915); Japonia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Më vonë, këtij blloku iu bashkuan edhe monarkitë ballkanike (Serbia, Mali i Zi dhe Greqia). Ndërsa në anën e Paktit Trepalësh u radhitën Perandoria Osmane dhe Bullgaria. Kjo luftë përfundoi me fitoren e Fuqive të Antantës, në nëntor të vitit 1918.

Gjatë Luftës së Parë Botërore u përfshinë afër 40 shtete dhe u mobilizuan rreth 74 milionë ushtarë. Ajo pati për pasojë shkatërrime dhe dëme kolosale ekonomike e mbi të gjitha humbjen e 17 milionë njerëzve dhe plagosjen e rreth 20 milionë të tjerëve.⁹ Përfundimi i kësaj lufte solli edhe fundin e katër Perandorive: Rusisë Cariste (1917); Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë (1918) si dhe të Perandorisë Osmane (1922), të cilat u pasuan me krijimin e disa shteteve të reja dhe me rendin e ri ndërkombëtar.

⁷ Hysni Myzyri, *Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve*, Prizren, 2001, f.190-191.

⁸ *Po aty*.

⁹ Enver Robelli, *Lufta dhe Letra dashurie*, Koha Ditore, 26.7.2014, f.18-19; Faruk Ajeti, *Sikur mos të ndodhte atentati ndaj Franz Ferdinandit*, Koha Ditore, 28.6.2014, f.23.



SHQIPËRIA NË OPTIKËN E DIPLOMACISË VJENEZE NË PRAG TË LUFTËS SË PARË BOTËRORE*

KDU 94(496.5)“1914”
327(4/9)(486.5)“1914”

Është e njohur historia 6-mujore e qeverisjes së Shqipërisë nga princi gjerman, Vilhelm Vid, në periudhën 7 mars - 3 shtator 1914. Me konsensusin e Fuqive të Mëdha, edhe për shtetin më të ri të Ballkanit - Shqipërinë, u caktua një monark i huaj, ashtu sikurse më parë ishte vepruar me Greqinë, Rumaninë dhe Bullgarinë. Por, në rastin e fundit eksperimenti dështoi. Sot e kësaj dite jepen argumente për faktorët e brendshëm e të jashtëm që e penguan gjermanin pedant e korrekt të konsolidonte Shqipërinë dhe pushtetin e tij, duke krijuar një dinasti të qëndrueshme. Padyshim, të gjithë studiuesit dhe analistët konvergjojnë në një pikë: shpërthimi i Luftës së Parë Botërore, hodhi në erë konsensusin e të mëdhenjve, status-kuonë në rajon e më gjerë dhe, natyrisht, nuk i la më asnjë pikëmbështetje edhe pushtetit të Vidit¹. Por, ky fisnik gjerman që e kanë kritikuar për mosnjohje të realitetit shqiptar, për inteligjencë mesatare, për mungesë vendosmërie, për paaftësi për të zgjidhur “nyjën gordiane” me veprime energjike, për krijimin e një monarkie operetë etj., por që më e drejtë do të kishte qenë të fajësohej vetëm se nuk mundi të bënte mrekulli (siç është shprehur Edit Durham)², u largua dinjitoz. Ai shpenzoi për Shqipërinë e nuk fitoi materialisht nga Shqipëria, sakrifikoi moralisht dhe e la asnjënjë Shqipërinë ndaj konfliktit botëror, sikurse ishte vendosur në Konferencën e Londrës³, kur

* Kumesë e mbajtur në Konferencën Shkencore të organizuar në Prishtinë, më 19 shtator 2014, nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.3, Tiranë: Toena, 2007, f.75; Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, Tiranë: Toena, 2013, f. 246; Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar, 1912-2005*, Tiranë: 55, 2006, f. 59; D.Heaton Armstrong, *Shqipëri 1914, Gjashtë muaj Mbretëri*, Tiranë: ISHSAN, 2001, f. 34.

² Albert Mousset, *Shqipëria përballë Europës*, Tiranë: Dituria, 2004, f. 17; Edit Durham, *20 vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë, 1989, f. 48. “Mundet që Vidi të kritikohet për mungesë kompetence, shkruan Durham, por duhet të dimë se vetëm një njeri me një force të pazakontë karakteri dhe me një njohje shumë të thellë të zakoneve të vendit mund të çante ndaj forcave që ishin bashkuar kundër tij”.

³ *Historia e Popullit Shqiptar...*, f. 25; P.Milo, *Politika e jashtme...*, f. 242; K.Dervishi, *Historia e shtetit...*, f. 58-59; Vilhelm, princi i Shqipërisë, princi i

shumëkush do t'i servilohej përkrahësit më të fuqishëm (në rastin konkret Austro-Hungarisë) dhe do të rriskonte të pozicionohej për të fituar kapital politik për të ardhmen, duke e ngarkuar Shqipërinë me "kredi të dyshimta" në mos "kredi të këqija".

Një vështrim i vëmendshëm i dokumentacionit të kohës, madje edhe i dokumentacionit të vetëm ndonjëres nga Fuqitë e Mëdha, me interesa të veçanta në rajon, i konfirmon vlerësimet e mësipërme. Në këtë kumtesë hulumtimi ka pasur për objekt përgjithësisht dokumentacionin austro-hungarez, më i ploti në ato vite, krahas atij të Italisë. Diplomata të kualifikuar e të shumtë austro-hungarezë, të vendosur gjithandej në viset shqiptare, përkatësisht në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK) (Kral), në konsullatat e Durrësit (Lovental), Vlorës (Majerhausen), Shkodrës (Halla), Shkupit (Jeličko), Prizrenit (Lejhanec), dhe Mitrovicës (Umlauf), në korespondencën e tyre me përfaqësuesit e tjerë të Austro-Hungarisë në rajon, përkatësisht në ambasadat në Romë (Meray) e Stamboll (Mittag) dhe në legatat në Athinë (Shilasi), Cetinë (Otto), Beograd (Gisell), e Bukuresht (Ottokar Çernin), apo me eprorët në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, posaçërisht me kontin Berchtold etj., na kanë dhënë një informacion tepër të çmuar për periudhën disa mujore në Shqipëri para shpërthimit të Luftës së Parë Botërore. Në këtë kuadër gjendet informacion i bollshëm edhe për fillimet e rebelimeve në Shqipërinë e Jugut dhe të Mesme, që tronditën shtetin e ri shqiptar në prag të Luftës së Madhe⁴. Por informacioni ndriçon shumë më gjerë se thjesht fillimin e kryengritjeve, apo motivet dhe nxitësit e tyre, më gjerë se zhvillimet e luftimeve, më gjerë se situata sociale, fetare, etnike etj., në Shqipërinë e Jugut dhe të Mesme. Ai na jep informacion interesant për situatën në Shqipëri dhe në rajon, për përpjekjet e shtetit shqiptar për t'u rimëkëmbur e organizuar, për përpjekjet e Vedit për të qeverisur. Edhe vetëm dokumentacioni i muajit maj dhe i dhjetëditëshit të parë të qershorit 1914, që kemi konsultuar për tematikën e kumtesës, ofron mjaft të dhëna për punën e bërë nga institucionet e vendit për kompletimin dhe zbatimin e legjislacionit, që do të plotësonte Statutin Organik të Shqipërisë,⁵

Vidit, *Promemorie mbi Shqipërinë*, Skënderbegs Boks, Tiranë, 2010; etj.

⁴ *Arkivi i Institutit të Historisë*, Fondi i Vjenës, Dosjet mars-shtator, 1914.

⁵ *Historia e Popullit Shqiptar...*, f. 59. Statuti u miratua në Vlorë më 10 prill nga KNK, përgatitur sipas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër të 29 korrikut 1913. Sipas këtij statuti Shqipëria shpallej principatë kushtetuese sovraane dhe e trashëgueshme nën garancinë e Fuqive të Mëdha, të cilat garantonin edhe tërësinë e tokave të shtetit shqiptar dhe asnjë-nësinë e tij.

përprjekjet për vënien nën kontroll të gjithë krahinave të vendit, për vendosjen e rendit në ato krahina ku shtrinte autoritetin qeveria për hapjen e përfaqësive diplomatike në shtetet që kishin njohur Shqipërinë, (përkatësisht me Fuqitë e Mëdha Austro-Hungarinë, Italinë, Britaninë, Gjermaninë, Rusinë, Francën, Japoninë dhe me vendet e rajonit, Rumaninë, Serbinë, Greqinë), mandej për mbajtjen e qetësisë në kufijtë e përcaktuar me fqinjët veriorë, për përprjekje për të ingranuar parinë e Jugut dhe bajraktarët e Veriut në të mirë të stabilizimit të shtetit (Eqerem Libohova, Azis Vrioni, Bektash Cakrani, Hysni Toska, Preng Bib Doda, Isa Boletini, Bajram Curri etj.)⁶ etj. Në këtë kuadër nuk munguan përprjekjet për largimin e trupave greke nga Shqipëria e Jugut, përprjekjet për qetësimin e “vorio-epirotëve” përmes negociatave lidhur me kërkesat e tyre “autonomiste”, përprjekjet për përballimin e propagandës osmaniste e turkomane (Esat Toptani, Arif Hiqmeti etj.), përprjekjet për përballimin e shqetësimeve nga situata në kufi e përtej kufijve (veprime të bandave serbe në Kosovë, goditje të malësorëve mbi forcat malazeze në Has, afrim trupash serbe pranë kufijve etj.)⁷.

Interes të veçantë për kompletimin e tablosë së kohës japin të dhënat rreth përprjekjeve për të filluar veprime të natyrës ekonomike, rreth angazhimit për të përfituar nga këshilltarët, organizatorët dhe specialistët e huaj, madje jo vetëm për organizimin e xhandarmërisë (ishin dërguar për këtë oficerë holandezë), por edhe për stërvitjen e forcave të tjera të armatosura me perspektivë krijimin e një ushtrie shqiptare (kishin treguar gatishmëri austro-hungarezët dhe rumunët) dhe, së fundi, edhe për të vënë në efikasitet ekonominë⁸.

Është në interes të shënohet që, me gjithë se shumë probleme ishin grumbulluar, se situata nuk ishte e favorshme për zgjidhjen e tyre, qeveria e Vidit e formatuar më 17 mars, nën kryesinë e Turhan Pashë Përmetit⁹, nuk la pas dore edhe problemin e arsimit. Të dhëna të dt. 18

⁶ *AIH*, Fondi i Vjenës, dosjet maj-qershor 1912. Raporte të diplomatëve austro-hungarezë në Romë, Shkodër, Durrës.

⁷ *Po aty*, Vj. 24-I-186, Vjenë 6 maj 1914 dhe Vj.24-14-1429, Njoftime të Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

⁸ *Po aty*, Vj. 24-I-186, Vjenë, 6 maj 1914 dhe Vj.24-14-1429, Njoftime të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Vjenë. Më 16 maj Nagi e A.Baldaci ishin të parët, përkatësisht nga A-H dhe Italia në sektorët e punëve botore, që do të ushtronin funksionet e tyre në Shqipëri. Një këshilltar belg planifikohej të vinte për financat etj.

⁹ *Po aty*, Fondi i Vjenës, dosje të marsit 1914; Shih edhe *Historia e Popullit Shqiptar...*, f. 59, si edhe *Fjalorin Enciklopedik Shqiptar*, vëll. 3, Tiranë:

maj saktësojnë se, pas hapjes së disa shkollave në rajonin e Durrësit dhe Tiranës, u hapën shkolla shqipe edhe në Shkodër e Lezhë¹⁰.

Por a kishte Vidi kompetenca të tilla që çdo sukses apo dështim i kësaj kohe t'i vishet atij? Natyrisht që jo. Me Statutin Organik të Shqipërisë të hartuar nga ndërkombëtarët, përcaktohej se Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, sikurse ishte vendosur në Londër, do të vijonte të kryente për 10 vjet mbikëqyrjen e shtetit të ri. Madje KNK nuk do të ishte një organ thjesht kontrolli, por sipas Statutit do të ishte bartësi kryesor i pushtetit në Shqipëri, organi më i lartë që do të ndërhynte në gjithë organizimin e shtetit dhe do të vendoste për gjithë çështjet administrative financiare etj.¹¹ Mungesa e unitetit në KNK e bënte edhe më të vështirë pozicionin e princit.

Megjithatë, në shtetin e ri, princ Vidi dhe një pjesë e strukturave të administratës së tij, iu vunë punës. Dhe, nëse nuk kishin qasje në bisedimet për t'i dhënë fund lëvizjes “vorio-epirote”, që kish shpërthyer jo rastësisht pak ditë para se Vidi të vinte këmbën në Shqipëri¹², përmes forcave të xhandarmërisë dhe të vullnetarëve proqeveritarë, ushtruan presionin e tyre që J.Zografosi dhe qarqet qeveritare të Athinës, që qëndronin pas tij, të mos ishin aq të qetë në negociatat e filluara më 10 mars në Korfuz me të dërguarin e Princ Vedit, kolonelin holandez Tomson, të emëruar si “komisar i jashtëzakonshëm”.

Ndërkohë, më 26 mars, kishte shpërthyer një kryengritje antiserbe në Kosovë¹³. Si reaktion zinxhir Athina dhe Beogradi reaguan duke ndërmarrë veprime në Shqipëri. Shkatërrimi i saj garantonte politikën e tyre aneksioniste në viset shqiptare të aneksuara dhe më tej të pretenduara. Dokumentacioni austriak i kohës përmend lëvizje të shumta trupash serbe gjatë gjithë prillit dhe majit dhe

Kristalina-KH, 2009, f. 2156. Qeveria e 17 marsit kishte këtë përbërje: Turhan Pashë Përmeti, kryeministër dhe ministër i Punëve të jashtme, Esat Pashë Toptani, ministër i Luftës dhe i Punëve të brendshme, Myfit Bej Libohova, ministër i Drejtësisë, Azis Vrioni, ministër i Bujqësisë, dr. Gaço Adhamidhi, Ministër i Financave, Preng Bib Doda, ministër i Punëve Botore (nuk e ushtroi detyrën), Mihal Turtulli, ministër i Arsimit, Hasan Prishtina, ministër i Postë-Telegrafeve.

¹⁰ *AIH*, Vj. 24-25-2571, Raport i datës 18 maj 1914.

¹¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, f. 59.

¹² *Po aty*, f. 61. Më 2 mars 1914, 5 ditë para mbërritjes së Vedit në Durrës, i ashtuquajtur “kongres epirot” shpalli “autonominë e Vorio-Epirit” dhe formoi “qeverinë e përkohëshme” të J.Zografosit.

¹³ Liman Rushiti, *Rrethanat politico-shoqërore në Kosovë 1912-1918*, Prishtinë, 1986, f. 85.

dislokim të tyre pranë kufirit të shtetit shqiptar, kurse në prefekturat jugore të Korçës dhe Gjirokastrës veprime të hapura e të kamufluara të forcave greke¹⁴. Raportet e konsullit të Durrësit, Lovental, sinjalizojnë për një situatë të acaruar në gjysmën e parë të majit edhe në Shqipërinë e Mesme, por ato bëhen të detajuara e konkrete që nga 17 maji i 1914-s, kur ndodhi përplasja e parë te Ura e Limuthit pranë kodrave të Rrashbullit midis rebelëve dhe batalionit të tiranasve (800 vetë) të komanduar nga Abdi Bej Toptani, që udhëtonte drejt Durrësit për t'u dërguar në Jug të vendit kundër rebelëve “vorio-epirotë”¹⁵. (Fillimi i rebelimit më 17 maj korrespondon me nënshkrimin po atë ditë në Korfuz të protokollit midis Zografos dhe KNK). Gjithçka është shënuar kronologjikisht për zhvillimin e luftimeve dhe për përhapjen e rebelimit në Shqipërinë e Mesme në botimet e derisotme monografike, përfshi dhe Historinë e Popullit Shqiptar, të botuar në disa edicione me disa vëllime, figuron në ato dhjetëra telegrame, informacione e raporte që i shkonin Vjenës nga konsujt e saj në Durrës, Shkodër, Vlorë etj., dhe nga ambasadori i saj në Romë, Merey. Më duket me interes të ndalem në opinionet dhe analizat që diplomatët austro-hungarezë ofrojnë për fillimet e rebelimit në fjalë.

Nga ambasadori austro-hungarez në Romë, Merey, që në fillim të majit, sinjalizohet se shtypi britanik (“Tajmsi”) përgojon aftësinë e Vidit për të qeverisur¹⁶. Në kujtimet e Syrja Vlorës thuhet se në fund të gushtit koloneli Filips, komandant i garnizonit ndërkombëtar në Shkodër, e kish kompromentuar veten duke bashkëpunuar me rebelët kundër princit¹⁷. Rasti i parë tregon për mungesën e simpatisë në Londër kundër një princi që konsiderohej njeri i Austro-Hungarisë, kurse rasti i dytë, në prag të Luftës së parë Botërore (pas vrasjes së Franc Ferdinandit, më 28 qershor, pas shpalljes së luftës nga Austro-Hungaria ndaj Serbisë më 8 korrik dhe pas fillimit të Luftës së Parë Botërore, më 4 gusht), provon se Britania e Madhe, e pozicionuar në luftë kundër Austro-Hungarisë, ngutej për të rrëzuar influencën e kësaj të fundit në Shqipëri.

Njoftime të tjera ndriçojnë qëndrimin e Stambollit për ngjarjet në Shqipëri. Ambasadori i Austro-Hungarisë në qendrën e Perandorisë Osmane njoftonte në fillim të majit se aktiviteti i Arif Hiqmetit në

¹⁴ *Po aty*, Fondi i Vjenës, dosje të mars-prillit, 1912.

¹⁵ *Po aty*, Vj. 24-30-3078, Raport i dt. 18 maj 1914 i Loventalit për Berchtoldin.

¹⁶ *AIH*, Vj. 24-19-1929. Raport i Merey-t, dt. 4 maj 1914.

¹⁷ Syrja Vlorë, *Kujtime. Nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës*, Iceberg, Tiranë 2013, f. 118.

Shqipëri për të propaganduar kundër Vidit dhe në favor të vendosjes së një princi turk në fronin e shtetit të ri, po bëhej haptazi dhe intensivisht¹⁸. Më 14 maj edhe konsulli në Durrës, Lovental telegrafonte se kishte informata se Arif Hiqmeti vepronte “bashkërisht”, apo nën një mbulesë, me Esat Toptanin dhe se Syrja Vlora (caktuar si ministër i akredituar në Vjenë) i kish thënë atij se besonte në një grusht shteti të afërt¹⁹.

Njoftim me interes është edhe ai për udhëtimin 15 ditor të kryeministrit, Turhan Pashës, në kryeqytetet e Fuqive të Mëdha (12 maj - 25 maj) duke filluar nga Roma, për të kërkuar kredinë e premtuar prej 75 milion fr. ari, mandej për ngritjen e statusit të principatës në nivel mbretërie, dhe për të paraqitur kërkesa të tjera në drejtim të përkrahjes për Shqipërinë dhe të marrjes së garancive për mbrojtje ndaj politikës destruktive të fqinjëve. Në këtë kuadër ai i kish kërkuar San Xhulianos demarshe të përbashkëta me Austro-Hungarinë, për problemin e Epirit dhe një ndihmë urgjente ekonomike, që do të shërbente edhe për të shmangur një katastrofë humanitare, e cila kërcënonte rreth 100 mijë banorë të viseve shqiptare të jugut të larguar nga vatrat e tyre për shkak të terrorit grek dhe të dyndur në territoret e kontrolluara nga qeveria²⁰.

Vjena, ndërkohë ishte e informuar intensivisht nga përfaqësuesit e vet diplomatikë, qoftë për veprimet e Greqisë në Shqipërinë e Jugut, qoftë për politikën e dhunës së Serbisë, që nxiste shpërngulje masive të shqiptarëve nga Kosova dhe sjelljen aty të kolonëve sllavë. Në një njoftim të konsullit në Mitrovicë, Umlanf, të 12 majit, raportohej për procedura të shpejtuara në nxitjen e shpërnguljeve. Sipas konsullit në fjalë në mars-prill 1914, vetëm nga rrethi i Mitrovicës ishin larguar 1200 familje shqiptare dhe ishin sjellë 80 familje malazeze dhe 10 familje serbe të ardhura nga SHBA²¹.

Njoftimet nga konsujt në Durrës (Lovental) dhe Shkodër (Halla), të dt. 18-28 maj 1914, bëjnë fjalë jo vetëm për veprimet e kryengritësve, por edhe për një kombinim të veprimtarisë shtetërore të italianëve, serbëve e grekëve, në dëm të princ Vidit dhe në favor të kryengritësve të Shqipërisë së Mesme. Në mesin e këtij kombinacioni qëndrojnë dhe dy degëzime në vend, të kundërvënies ndaj Vidit,

¹⁸ *AIH*, Vj. 24-29-2952, Telegram i ambasadorit dt. 2 maj 1914.

¹⁹ *Po aty*, Vj.24-30-3031. Telegram i Loventalit, dt. 14 maj 1914.

²⁰ *AIH*, Vj. 24.30.3034, Tel. i Min. P. të Jashtme, Vjenë, 15 maj 1914 për Loventalin në Durrës.

²¹ *Po aty*, Vj. 24.38.3888, Tel. i konsullit, dt. 12 maj 1914,

përkatësisht nga pasuesit e xhonturqve dhe të Esat Toptanit. Nuk mungojnë të dhënat dhe për veprime të Ismail Qemalit, nxitjen prej tij të të birit, Qazimit që të vihet në krye të trupave vullnetare të Vlorës, kundër “vorio-epirotëve”²² etj.

Të dhëna të herëpashershme japin informacion edhe lidhur me kërkesat që paraqesin kryengritësit²³, për praninë gjithnjë më të madhe në Durrës, pas 19 majit (data e arrestimit të Esat Pashës), të anijeve italiane e austro-hungareze të luftës etj.²⁴

Të dhëna interesante në dokumentacionin diplomatik austro-hungarez, janë gjithashtu ato që, krahas qëndrimit ndaj kryengritësve të Shqipërisë së Mesme dhe Esat Pashës, pasqyrojnë qëndrimet e kancelarive të Fuqive të Mëdha dhe personaliteteve të ndryshëm përfaqësues të tyre, ndaj princ Vidit dhe dy qeverive të tij (pas kthimit nga Evropa më 25 maj 1914, Turhan Pasha u caktua të rikrijojë kabinetin, i cili vijoi nga 28 maj deri më 3 shtator.²⁵

Diplomatët italianë (deri në nivelin e San Xhulianos) dhe ata rumunë duket se e mbrojnë Esat Toptanin, por ndërsa italianët e denigrojnë Vidin, rumunët nuk e bëjnë këtë²⁶. (Vidi ishte nipi i Mbretëreshës Elisabeta të Rumanisë). Esati duket se ka mbështetje edhe në Beograd, Cetinë dhe Athinë. Sipas ambasadorit Merei (Romë), po të realizohej nga Esati një grusht shteti, Serbia, Mali i Zi dhe Greqia, kundrejt ndihmës për të, do të kishin koncesione territoriale²⁷. Dokumentacioni të le të kuptosh se edhe Vjena gradualisht po akumulonte pakënaqësi ndaj Vidit²⁸. Së fundi edhe

²² *Po aty*, Tel. i Ismail Qemalit, dt. 19.5.1914 dërguar nga Nica, (Francë) të birit.

²³ *Po aty*, Vj. 24.30.3082, Informacion i Merey-t, nga Roma, dt. 19.5.1914.

²⁴ *Po aty*, Vj. 19.V.1914, Vj. 24.3.321. Raporte të Loventalit për eprorët.

²⁵ *Shqipëria më 1937*. Veprimi shtetnor gjatë 25 viteve të parë të vetqeverimit I, Tiranë, 1937, f. 114-115; Shih edhe *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, vëll.3, Tiranë: Kristalina KH, 2009, f. 2156. Kabineti i ri rezultoi me këtë përbërje: Turhan Pasha kryeministër, Preng Bibë Doda, ministër i Punëve të Jashtme, Aqif Pashë Elbasani, ministër i Brendshëm dhe zëvendësisht i Luftës, (ministër i Luftës në gusht u caktua Kara Seit Pasha), Mihal Turtulli, ministër i Arsimit, Mithat Frashëri, ministër i Punëve Botore dhe i Postë-Telegrafave, Abdi Toptani, ministër i Bujqësisë, Myfit Libohova i Drejtësisë, Filip Noga i Financave.

²⁶ *AIH*, Vj. 21.V.1914, Vj. 24.31.3115.

²⁷ *Po aty*, Vj. 24-23-2306. Njoftim i Merey-t, dt. 22.5.1914 për Vjenën.

²⁸ *Po aty*, Vj. 24-22-2226, Reagim i Shefit të Shtabit të Ushtrisë së Austro-Hungarisë, Conrad, dt. 4 prill 1914; po aty, Vj. 24-28-2858, Raport i Merey-t, dt. 4 qershor 1914 për Berchtoldin.

midis figurave të shquara të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare vihet re e njëjta gjë. Midis të pakënaqurve figuron edhe Ismail Qemali²⁹.

Në gjithë këto qëndrime nuk ka asgjë paradoksale, por pasqyrim të pastër interesash. Nëse për qëndrimin e lexueshëm lehtësisht kundër Vidit në qarqet drejtuese të Stambollit, Beogradit, Cetinës dhe Athinës, apo për qëndrime më të mbuluara të Londrës dhe Romës, argument është mospërputhja e interesave të tyre politike me konsolidimin dhe forcimin e shtetit shqiptar (Turqia, Serbia, Greqia, Mali i Zi), ose me konsolidimin e pushtetit të gjermanit Vid në krye të këtij shteti (Britania e Madhe, Italia), për Austro-Hungarinë arsyeja është tjetër. Përprerja e Vidit për të respektuar vendimet e Konferencës së Londrës (vendimet e 29 korrikut 1913) dhe Statutin Organik të Shqipërisë (të 10 prillit 1914), si edhe për të ekuilibruar interesat e Vjenës me ato të Romës në Shqipëri, sfidonte pretendimet e Vjenës për supremaci të padiskutueshme. Kurse në vlerësimin jopozitiv të I.Qemalit për Vidin ndikonin motive personale dhe vlerësime të ndryshme në përzgjedhjen rishtas të aleatit të madh midis faktorit ndërkombëtar.

Duke materializuar politikën dhe synimet e tyre në Shqipëri, shtetet e sipërpërmendur ndërmoren hapa konkretë. Sipas dokumentacionit austro-hungarez, qeveria serbe kish futur në veprim agjunkturën e saj në radhët e parisë në Kosovë. Ajo financonte me 10.000-20.000 napolona ar Aqif Hiqmetin e dërguar nga xhonturqit në Dibër për propagandë dhe për krijim grupesh të armatosura³⁰. Gjithashtu autoritetet serbe nxisnin midis myslimanëve shqiptarë kundërshtimin e Vidit dhe, madje, në viset e Remjes, Ohrit dhe Prespës, i rekrutonin ata si xhandarë dhe, që nga Dibra, i kalonin në Shqipëri³¹. Atasheu ushtarak i Austro-Hungarisë në Beograd, majori Galinek, njoftonte shefin e Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë në Vjenë (Conrad) më 29.V.1914, se qëndrimi i Serbisë qysh kur u krijua Shqipëria konsistonte në shtimin e vështirësive për konsolidimin e saj, në dërgimin e armëve dhe municioneve në Shqipëri dhe në veprime që synonin shkatërrimin e shtetit shqiptar.³²

²⁹ *Po aty*, Vj. 24-29-2960, Tel. i Merey-t, dt. 4 qershor 1914, për kontin Berchtold.

³⁰ *AIH*, Vj. 24-40-4077, Lejhanec nga Prizreni, dt. 1 qershor 1914.

³¹ *Po aty*, Vj.24-23-2315, Vj.24-23-2313, Tel. i konsujve në Shkup dhe Selanik, dt. 22 maj 1914.

³² *Po aty*, Vj. 24-28-2861, Informacion i Galinekut, dt. 29.V.1914; Vj.24-40-4075, Konsulli në Prizren Lejhanec, më 29 maj relatonte për propagandë serbe, antivindiste, në Mirditë.

Në të njëjtën kohë me veprimet e serbëve, xhonturqit organizonin në Stamboll e Selanik oficerë me origjinë shqiptare (janë identifikuar disa me origjinë nga trevat shqiptare nën sundimin serb, si Mehmet Arifi nga Tetova, Sait Rifati nga Struga etj.) dhe i dërgonin në Shqipëri³³. Prania e agjitorëve të tyre në zonën e kryengritjes konfirmohet edhe nga përfaqësuesi i Austro-Hungarisë në KNK (Kral), i cili i kish konstatuar ata gjatë takimit që përfaqësuesit e KNK kishin pasur më 27 maj me kryengritësit.³⁴

Më të pakta ishin informacionet për veprimtarinë e Greqisë, preokupim kryesor i së cilës mbetej zotërimi i situatës dhe qëndrimi antividist në Shqipërinë e Jugut. Pasi u sigurua nënshkrimi i Protokollit të Korfuzit, përmbajtja e të cilit është e njohur, Athina ruhej për të mos u kompromentuar në treva të tjera shqiptare. Gjithsesi ngjarjet në Shqipërinë e Mesme për situatën e rëndë në Durrës, sikurse raportonte konsulli i Austro-Hungarisë në Korfuz, “u pritën këtu me një gëzim djallëzor”³⁵.

Veprimet e italianëve janë më të njohurat. Fakte të shumta jepen në dokumentacionin austriak për qëndrimin e diplomatëve dhe ushtarakëve italianë në përkrashjen të Esat Pashës, në komunikimin e tyre të vazhdueshëm me rebelët, në nxitjen e fshehtë të myslimanëve kundër të tjerëve, meqenëse katolikët konsideroheshin përkrashës të A-H etj.³⁶

Në linjën e politikës italiane duket se është pozicionuar për momentin edhe I.Qemali, për të cilin Syrja Vlora i telegrafon nga Roma konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në MPJ në Vjenë, duke e njoftuar për disa intervista të tij dhe duke rekomanduar që t’i krijohen vështirësi sepse “ai është në opozitë me qeverinë e Shqipërisë”³⁷.

Dokumentacioni austro-hungarez jep informacion edhe për programin e rebelëve, të shpallur më 3 qershor 1914 në Shijak, në një lloj kongresi, apo mbledhje të përgjithshme. Kjo mbledhje, që zgjodhi kryetar të Qendrës së Përgjithshme të rebelimit esatistin Mustafa Ndroqi, nënkryetar majorin Xhenabi Adili, myftiun e Tiranës Musa Qazimin, Arif Hikmetin dhe Haxhi Adilin dhe komandant të ushtrisë Qamil Haxhi Fezën, të gjithë të konfirmuar si proturq e proesatistë, në

³³ Po aty, Vj. 24-23-2321, Tel. i MPJ, dt. 23.5.1914 për përfaqësitë diplomatike në Romë, Athinë, Durrës, Vlorë.

³⁴ Po aty, Vj.24-26-2674, Tel i Kralit nga Vlora, dt. 28 maj 1914.

³⁵ Po aty, Vj. 24-23-2360, Raport konsullor, dt. 27 maj 1914.

³⁶ Po aty, Vj.24-28-2803, Tel. nga Lovental, dt. 1 qershor 1914.

³⁷ Po aty, Vj. 24-44-4195, Tel. i S.Vlorës nga Roma, dt. 4 qershor 1914.

programin e miratuar kërkoi: përmbysjen e princ Vidit dhe qeverisë së tij, bashkimin e Shqipërisë me Perandorinë Osmane, vendosjen e një princi turk në Shqipëri, përdorimin e flamurit osman në vend të atij shqiptar, përdorimin e gjuhës turke etj.³⁸

Në këtë mënyrë Vjena tani kishte të pasqyruara kërkesat e kryengritësve, të unifikuara, të cilat deri atëherë i ishin relatuar të pjesshme dhe të ndryshme nga deklarues të ndryshëm. Raporti i 4 qershorit 1914, që ambasadori austro-hungarez në Romë, Merey, i dërgonte qendrës, ishte një analizë e plotë e situatës në Shqipëri, krijuar nga rebelimi në Shqipërinë e Mesme, por, gjithashtu, edhe pasqyrë e qëndrimit që diplomacia e Vjenës po adaptonte ndaj Vidit dhe regjimit të tij.³⁹

Merey, me anën e këtij raporti, i bënte të ditur Bertholdit se nuk kishte dyshim për origjinën e rebelimit. Sipas tij, në prapaskenë në radhë të parë qëndronin “*intrigat turke*”. Për diplomatin me përvojë, ky qëndrim lidhej jo me ndonjë dëshirë për ta rifituar Shqipërinë, por me synimin që, përmes një regjimi mysliman në Shqipëri, të kërcënohej Greqia, me të cilën Perandoria Osmane kishte kontradikta për çështjen e ishujve të Egjeut.

Për sa i përket Serbisë, analizonte Merey, ajo synonte krijimin e një situatë katastrofë në Shqipëri, për të ndërmarë ndonjë aksion në një kohë të afërt. Më tej ai vërente se rebelimi mund të posedonte edhe një karakter autonom dhe të paraqitej si një manifestim tradicional i anarkisë, protestës kundër taksave, kundër shërbimit ushtarak, për mbrojtjen e islamizmit nga kultura evropiane etj. Si faktor që nxiti shpërthimin e kryengritjes, Merey përmend edhe pavendosmërinë e Vidit për të vepruar në disa momente decizive. Sipas ambasadorit, qëndrimi i tij ndaj Esatit dhe rebelëve, “ndoshta e groposi krejt pozitën e tij në Shqipëri dhe në botën e jashtme”.

Kurse qeverinë Merey e konsideronte pothuaj inaktive. Sipas tij, “punët e saj të vetme ishin dorëheqjet, rishpërndarja e portofolave dhe rimarrja e funksioneve. Në opinionin e ambasadorit, Myfit Libohova, vlerësohet i korruptuar, Preng Bib Doda, ministër vetëm në letër, anëtarët e tjerë të kabinetit zero, kurse kryeministri Turhan Pasha, i pazoti dhe pa energji. Përsa i përket Esat Pashës, Merey e cilëson konspirator dhe bashkëpunëtor, në mos të blerë, nga turqit, serbët dhe

³⁸ *Po aty*, Vj. 24-25-2563, Raport dt. 4 qershor 1914, togerit Zaver për MP të Luftës dhe MP të Jashtme në Vjenë; Shih edhe *Historia e Popullit Shqiptar...*, f. 65; etj.

³⁹ *AIH*, Vj. 24-28-2858, Raport i Merey-t, dt. 4 qershor 1914, për Berchtoldin.

grekët, flirtues me italianët dhe nxitës të rebelimit, që në të ardhmen me rrëzimin e princit të zinte vetë kryen e vendit.

Në raportin e 4 qershorit ambasadori Merey analizon edhe politikën italiane. Sipas tij Italia kërkonte të mbështetej mbi elementin mysliman në Shqipëri, meqenëse Austro-Hungaria konsiderohej e lidhur me katolikët. Në këtë linjë ai shihnte edhe motivin e afrimit të Italisë me Esat Pashën.

Për të kapërcyer krizën në Shqipëri diplomati i njohur rekomandonte një ndërhyrje kolektive, përkatësisht miratimin nga të gjithë Fuqitë e Mëdha të një pranie të plotë të forcave ushtarake ndërkombëtare në Durrës, si edhe zgjerimin e kompetencave të KNK.

Shpërthimi i një anarkie të plotë në Shqipëri nuk mund të përballohet vetëm nga princi dhe qeveria e tij, nënvizonte ai, sepse u mungojnë mjetet për të zotëruar me forcë situatën. Mbetet pra të shpresohet te “operativiteti i prestigjit evropian” për një ndërhyrje kolektive jo në stil të gjerë. Sidoqoftë “e ardhmja e Shqipërisë..., mua më duket shumë e errët”, përfundonte me nota pesimiste Merey analizën e tij, duke shtuar se ngjarjet e ndodhura së fundi në Shqipëri kanë hedhur mjaft hije në relacionet e Vjenës me Romën.

Opinionet e ambasadorit Merey pasqyrojnë një vijë të qëndrimeve të Vjenës për çështjen shqiptare, për situatën rajonale, për Vidin dhe faktorin shqiptar etj., të cilët nuk i kishin nën kontroll sikurse pretendonin. Gjithsesi, dokumentacioni austro-hungarez i kohës hedh dritë mbi situatën e vështirë që kalonte Shqipëria në hapat e para të jetës si shtet i pavarur, që përkuan me pragun e Luftës së Parë Botërore. Gjashtë muajt e qeverisjes së Vidit mbetet të trajtohen me shumë kujdes dhe protagonistët të marrin vlerësimin realist të merituar. Një gjë është e padiskutueshme. Shpërthimi i kësaj lufte i dha fund konsensusit të Fuqive të Mëdha për çështjen shqiptare të vendosur në Konferencën e Ambasadorëve, ndali përpjekjet për stabilitetin e shtetit të ri shqiptar dhe madje projektoi, deri me traktate me vlera juridike, si Marrëveshja e Fshehtë e Londrës (1915) midis Antantës dhe Italinë, asgjësimin e tij.

Anton PANCHEV, Sofje

STATISTIKAT BULLGARE MBI POPULLSINË E KOSOVËS NË LUFTËN E PARË BOTRORE

KDU 312.7(496.51)“1914

Në nëntor të vitit 1915, pas shpartallimit të ushtrisë serbe nga forcat e Aleancës Qendrore (Gjermania, Austro-Hungaria dhe Bullgaria) dhe pas pushtimit të të gjitha territoreve të Serbisë, pjesa më e madhe e Kosovës u okupua nga bullgarët. Për qeverisjen e këtyre viseve, administrata bullgare kishte nevojë nga të dhëna të sakta mbi popullsinë vendase dhe mbi përbërjen e saj etnike. Organet e administratës kanë mbledhur të dhëna të tilla, por statistikat më të sakta kanë qenë të përpunuara nga disa studiues bullgarë, të cilët kanë zhvilluar ekspedita shkencore për hulumtimin e gjithanshëm të këtyre trojeve shqiptare. Këto dokumente paraqitin një burim të çmueshëm për popullsinë e Kosovës në këtë periudhë, sepse kanë qenë të plota dhe të paanshme dhe të përgatitura për mbretin Ferdinand dhe për institucionet bullgare. Shkencëtarë si, Vasil Kënçov, Nedjalko Kulushev (N. Marenin), Vasil Zlatarski, Stefan Dimitrov, Anastas Ishirkov, Ljubomir Miletiç, Jordan Ivanov, Stefan Mladenov, Dimitër Gadzhanov e disa të tjerë, kanë qenë, jo vetëm midis profesorëve më të famshëm bullgarë, të cilët kanë lënë gjurma të shumta në fusha të ndryshme si: historia, gjeografia, arkeologjia, ekonomia, etnografia, gjuhësia etj, por kanë shkruar edhe disa libra dhe shumë artikuj shkencorë, në të cilët kanë përshkruar dhe kanë paraqitur hulumtimet e tyre për viset lindore shqiptare. Ata kanë udhëtuar në Maqedoni dhe në Kosovë dhe përshtypjet e tyre bashkë me një analizë të shkëlqyer ka sjell rezultate të larta shkencore. Nga punimet e tyre mund të marrim të dhëna dhe fakte të hollësishme për gjendjen në viset lindore shqiptare, për disa dekada me radhë. Hulumtimet e këtyre profesorëve janë burim i çmueshëm për numrin e popullsisë shqiptare në Maqedoni, por edhe në Kosovë, në fillim të shekullit XX, për gjendjen sociale, për ekonominë, tregtinë, gjuhën, situatën fetare, etnografinë, arkitekturën, kolonizimin serb pas Luftërave ballkanike, për arsimin dhe organizimin shoqëror, për kishat dhe xhamitë e për shumë aspekte të tjera nga jeta e shqiptarëve.

Ky tekst është vetëm një vështrim i shkurtër, i cili do të përqendrohet mbi analizën e këtyre statistikave bullgare, mbi lëvizjet e popullatës dhe mbi humbjet e mëdha njerëzore, të cilat i kanë pësuar shqiptarët e Kosovës.

Ndarja administrative

Pushteti i ri bullgar ka krijuar sistemin administrativ mbi bazën e vjetër, me pak ndryshime. Në territoret e Kosovës, në zonën bullgare, janë formuar dy qarqe:

1. Qarku i Prishtinës me pesë rrethina: Rrethina e Podujevës, Rrethina e Gjilanit, Rrethina e Ferizajt, Rrethina e Prishtinës – qytet, Rrethina e Prishtinës – fshatra.
2. Qarku i Prizrenit nën administrimin bullgar ka pasur kufijtë e tillë. Rrethina e Rahovecit me 16 komuna dhe 109 vendbanime, Rrethina fshatare e Prizrenit me 14 komuna dhe 49 vendbanime, Rrethina e Prizrenit, Rrethina e Suharekës me 10 komuna dhe 40 vendbanime¹.
3. Rrethina e Kaçanikut ka qenë në Qarkun e Shkupit, por për qëllimet e këtij teksti, popullsia e saj do të përfshihet në statistikat për popullsinë e Kosovës.

Statistikat e popullsisë dhe humbjet e saj

Ngjarjet tragjike në periudhën 1912 – 1915 kanë pasur një ndikim të madh mbi numrin e popullsisë dhe relativisht mbi përbërjen etnike në Kosovë. Shkencëtari bullgar, Stefan Dimitrov, në vitin 1916 ka arritur deri përfundimin se në Kosovë “në tri vitet e fundit për shkak të ngjarjeve të ndodhura në lidhje me luftën, në numrin dhe në përbërjen etnike të popullsisë janë bërë ndryshime të mëdha”².

Qarku i Prishtinës

Shumë humbje ka pësuar popullata e Qarkut të Prishtinës. Bashkë me shtimin natyral të popullsisë, ka pasur edhe një lëvizje të madhe shpërngulëse nga dhe në qarkun e Prishtinës. Si rezultat nga kjo lëvizje, kah mesi i këtij viti (1916), popullsia, në tërë Qarkun e Prishtinës, ka dalë sipas llogarive të përafërta të organeve administrative bullgare, deri 206 000 banorë. Prej tyre $\frac{3}{4}$ kanë qenë shqiptarë, rreth 50 000 serbë dhe të tjerët 6-7000 katolikë, romë, hebre, vllleh etj. Shumë shqiptarë janë shpërngulur gjatë luftërave ballkanike dhe në vendin e tyre kanë ardhur serbë nga Serbia³. Sipas

¹ Димитров, Стефан. Северозападна Македонија. Софија, 1916, ф. 95.

² По ату, ф. 89.

³ По ату, ф. 89.

Mladenovit, në Qarkun e Prishtinës ka pasur 128 164 shqiptarë dhe 40 871 serbë, d.m.th.më shumë se 75% shqiptarë, më pak se 22% serbë dhe 3% komunitete të tjera. Të gjitha mizoritë e pushtetarëve serbë kanë qenë pa rezultat të rëndësishëm dhe nuk kanë ndryshuar situatën etnike⁴.

Rrethina e Gjilanit

Gjilani ka pasur 7500 - 8000 banorë në vitin 1916, derisa pas Luftës Ballkanike 5 - 6% nga shqiptarët janë shpërngulur për në Turqi. Në vendin e tyre, qeveria serbe ka vendosur përafërsisht kaq serbë nga rajoni i Pirotit, Vranjës etj. Më shumë shpërngulje të shqiptarëve ka pasur nga katundet e Gjilanit drejt Turqisë – mbi 300 shtëpi.

Rrethina e Ferizajt

Nga Ferizaj kanë ikur në Turqi mbi 200 shtëpi dhe kanë ardhur 50-60 familje serbe nga Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja. Në vitin 1916 Ferizaj ka pasur diku 3000 banorë – mbi 1000 shqiptarë, 900 serbë (shumica prej tyre kanë ardhur pas pushtimit serb), 600 romë, 140 vllleh dhe pak hebrenj.

Rrethina e Podujevës

Të gjithat 8 komuna të Rrethinës së Podujevës kanë qenë të banuara vetëm me shqiptarë. Në Podujevë dhe në 55 katundet e saj ka pasur 17 615 shqiptarë dhe 180 serbë.⁵

Rrethina e Prishtinës

Para Luftës Ballkanike Prishtina dhe fshatrat e saj kanë pasur diku 80 000 banorë. Pas pushtimit serb, rrethina e Prishtinës ka humbur 15 000 banorë. Nga qyteti i Prishtinës kanë ikur 2000 veta, vetëm nga muhaxhirët, të cilët kanë ardhur në vitin 1877.⁶

Vetëm në dimrin dhe pranverën e vitit 1913, nga Qarku i Prishtinës u shpërngulën 10 000 banorë drejt Turqisë. Kolonizimi serb ka qenë shumë aktiv në Qarkun e Prishtinës. Qeveria serbe i ka shtyrë serbët nga Leskoci, Prokuplja dhe nga vendbanime të tjera. Ata merrnin pronat e shqiptarëve. Në rrethinën e Podujevës janë vendosur diku 200 familje serbe dhe shqiptarët janë detyruar t'i "shitnin" tokat e tyre për çmime shumë të lira⁷.

⁴ Младенов, Стефан. Пътешествие из Македония и Поморавието. София, 1916, f. 179.

⁵ Младенов, vepr. e përm., f. 179.

⁶ Dimitrov, vepr. e përm., f. 90.

⁷ По аты, f. 91.

Megjithatë, masave të rrepta nga ana e pushtetarëve serbë për shfarosjen e shqiptarëve dhe zëvendësimin e tyre me serbë nga Serbia dhe Mali i Zi, dominimi i popullatës shqiptare në Qarkun e Prishtinës ka mbetur i dukshëm.

Popullsia e qytetit të Prishtinës ka qenë 15 960 njerëz, derisa prej tyre 11 486 shqiptarë, 4164 serbë dhe 328 hebre.⁸ Në Rrethinën e Ferizajt ka pasur rreth 70 % shqiptarë, 26% serbë dhe 4% të tjerë. Në Rrethinën e Podujevës shqiptarët kanë qenë 99 %, në Rrethinën e Prishtinës ka pasur 68.5% shqiptarë, 26% serbë dhe 5.5% të tjerë. Në Rrethinën e Gjilanit ka pasur 54 570 shqiptarë myslimanë, 1820 shqiptarë katolikë, 28 881 serbë, 268 romë ose 63.5% shqiptarë, 33.5% serbë dhe 3% të tjerë⁹.

Edhe sipas **Dimitër Gaxhanovit**, Rrethina e Podujevës ka pasur 24 973 shqiptarë myslimanë dhe 362 serbë. Rrethina e Gjilanit – 40 518 shqiptarë myslimanë, 1760 shqiptarë katolikë, 29 447 serbë. Rrethina e Prishtinës ka pasur 40 646 shqiptarë myslimanë¹⁰, 2420 shqiptarë katolikë, 12 993 serbë dhe 328 hebre. Rrethina e Ferizajt ka pasur 22 545 shqiptarë myslimanë, 144 shqiptarë katolikë, 8148 serbë, 2081 romë. Sipas Gaxhanovit, në Qarkun e Prishtinës ka pasur 128 682 shqiptarë myslimanë, 4324 shqiptarë katolikë, 50 951 serbë, 2081 romë dhe 328 hebre¹¹.

Qarku i Prizrenit

Në mesin e vitit 1916, sipas llogarive të organeve administrative bullgare, popullsia e qarkut të Prizrenit ka qenë 87 656 banorë – 16 576 serbë dhe 64 911 myslimanë, kryesisht shqiptarë. Zvogëlimi i numrit të banorëve në qarkun e Prizrenit ka qenë rezultat të arsyeve të njëjta si në rajonet e tjera të Kosovës. Shqiptarët kanë vuajtur shumë nga regjimi serb dhe shumë prej tyre janë vrarë nga serbët.¹²

Sipas **Dimitrovit** qyteti i Prizrenit ka pasur diku 20 000 banorë, Rrethina fshatare e Prizrenit – 19 000 banorë, Rrethina e Suharekës – 14 000 banorë dhe Rrethina e Rahovecit – 35 000 banorë. Katundet e qarkut kanë qenë pothuajse plotësisht shqiptare. Në tërë qarkun shqiptarët në vitin 1916 kanë qenë $\frac{3}{4}$ nga popullsia e përgjithshme – diku 65 000 veta dhe midis tyre 1600 katolikë. Serbët kanë qenë

⁸ Иширков, Анастас. Пътуване в Македония и Поморавия, София, 1916, f. 108.

⁹ Mladenov, vepr. e përm., f. 179.

¹⁰ Гаджанов, Димитър. Мюсюлманското население в новоосвободените земи, Софиа, 1916, f. 254.

¹¹ По ату, f. 255.

¹² Dimitrov, vepr. e përm., f. 96.

16 000 dhe kanë jetuar kryesisht në Prizren dhe në disa fshatra rreth qytetit. Shumica prej serbëve në rrethinën e Rahovecit kanë ardhur nga Serbia pas Luftës Ballkanike.¹³ Në Qarkun e Prizrenit ka pasur edhe 3300 turq, pothuajse të gjithë në Prizren¹⁴.

Sipas **Ishirkovit** Prizreni ka pasur 19 586 banorë. Shqiptarë 3257, turq 9422, serbë 5452, romë 1119, vllëh 329. Shumica e turqve kanë qenë shqiptarë të turqizuar.¹⁵ Në disa troje kanë shënuar procesin e turqizimit të disave prej shqiptarëve. Vasil Kënçov, ka shkruar në fund të shekullit të XIX-të se popullsia e Shkupit përbëhej kryesisht nga shqiptarë të turqizuar dhe kanë qenë pothuajse gjysma e popullatës¹⁶. Edhe një citat: “Nuk mund të bëhej dallim i qartë mes shqiptarëve myslimanë dhe turqve, sepse shumica prej turqve në Prizren kanë qenë shqiptarë të turqizuar”¹⁷.

Sipas **Mladenovit**, përbërja etnike e popullsisë, ka qenë: në Rrethinën e Rahovecit – 30 502 shqiptarë, 3556 serbë. Në Rrethinën e Suharekës – 12 963 shqiptarë dhe 1227 serbë. Në qytetin e Prizrenit dhe në fshatrat përreth tij – 65% shqiptarë dhe 35% serbë.¹⁸ Sipas **Gaxhanovit**, në Qarkun e Prizrenit ka pasur rreth 65 000 shqiptarë myslimanë, rreth 5300 shqiptarë katolikë, 28 466 serbë, 12 000 bullgarë myslimanë (goranë), 2000 turq dhe rreth 300 vllëh¹⁹.

Rrethina e Kaçanikut

Viset e Kaçanikut edhe para një shekulli kanë qenë 100 % me popullsi shqiptare. Sipas informatave të Mladenovit, Rrethina e Kaçanikut ka pasur 29 vendbanime me 6000 banorë, të gjithë shqiptarë.²⁰ Gaxhanov ka dhënë të dhëna pak të ndryshme dhe ka shtuar numrin e shqiptarëve deri 8294 veta.²¹ Edhe sipas tij, rajoni i Kaçanikut ka qenë krejt shqiptar.

¹³ По аты, f. 97.

¹⁴ По аты, f. 98.

¹⁵ Ishirkov, vepr. e përm., f. 109.

¹⁶ Кънчов, Васил. (Избрани произведения, т. II, Издателство Наука и изкуство, София 1970). Град Скопие. Бележки за неговото настояще и минало, f. 30.

¹⁷ Ishirkov, vepr. e përm., f. 108.

¹⁸ Mladenov, vepr. e përm., f. 181.

¹⁹ Gaxhanov, vepr. e përm., f. 255.

²⁰ Mladenov, vepr. e përm., f. 178.

²¹ Gaxhanov, vepr. e përm., f. 251.

Përfundim

Sipas Ishirkovit, popullsia e përgjithshme në zonën bullgare ka qenë diku 300 000 banorë. Prej tyre, 220 000 kanë qenë shqiptarë dhe 60 000 serbë.²² Të gjithë shkencëtarë bullgarë, në periudhën e Luftës së Parë Botërore, me një zë kanë shënuar karakterin etnik shqiptarë të Kosovës.

Në bazë të hulumtimit të disave prej dokumenteve dhe studimeve bullgare, ka mundësi të bëhen disa përfundime të rëndësishme për situatën demografike në trevat lindore shqiptare, para dhe pas luftërave:

1. Në fillim të shekullit XX, shqiptarët kanë dominuar plotësisht në viset në zonën bullgare të Kosovës së sotme;
2. Luftërat, kryengritjet, reprezaljet, shpërnguljet në periudhën 1912 – 1915 kanë shkaktuar humbje të mëdha njerëzore në viset shqiptare, për të cilin fakt dëshmojnë edhe qindra dokumente dhe hulumtime bullgare;
3. Me gjithë humbjet e mëdha, statistikave bullgare nga Lufta e parë botërore, konfirmojnë ruajtjen e dominimit shqiptar në të gjitha pjesët e Kosovës, por konstatojnë edhe faktin se popullata shqiptare në Kosovë ka zvogëluar shumë numrin e saj.
4. Kolonizimi serbë u dështua në përpjekjet e tij për ndryshimin thelbësor të karakterit etnik të Kosovës.

Bibliografi

- Димитров, Стефан. Северозападна Македонија. Софија, 1916.
- Гаджанов, Димитър. Мюсюлманското население в новоосвободените земи, Софија, 1916.
- Иширков, Анастас. Пътуване в Македонија и Поморавија, Софија, 1916.
- Кънчов, Васил. (Избрани произведения, т. II, Издателство Наука и изкуство, Софија 1970). Град Скопие. Бележки за неговото настояще и минало.
- Младенов, Стефан. Пътешествие из Македонија и Поморавието. Софија, 1916

²² Ishirkov, vepr. e përm., f. 110.



Kryesia e punës: Mark Krasniqi, Marenglen Verli, Frashër Demaj

VISET LINDORE SHQIPTARE NËN PUSHTIMIN SERB (1912 – 1915)

KDU 94(=18)“1912/1915”

Në fillim të decenies së dytë të shekullit XX, me fillimin e luftërave ballkanike, shtetet përreth tokave të banuara me shqiptarë, të cilat ishin pjesë përbërëse të Perandorisë Osmane, kishin për synim që sapo të shkatërrohet kjo perandori, tokat shqiptare t'i fusin në përbërjen e shteteve të tyre etnike. Lufta italo-osmane dhe Kryengritja e përgjithshme shqiptare e vitit 1912, e cila kishte kulmuar më 12 gusht të vitit 1912, me hyrjen e mijëra kryengritësve shqiptarë në kryeqendrën e vilajetit të Kosovës në Shkup, i dha goditje të reja Perandorisë Osmane. Shqiptarët e krahinës së Shkupit, kishin mungesë armatimi dhe një ushtri të pakonsoliduar. Kryengritësit shqiptarë pas arritjes së marrëveshjes politike shqiptaro-osmane të 18 gushtit 1912, ishin demobilizuar dhe shpërndarë nëpër krahinat e tyre. Në këto rrethana të disfavourshme, kryengritësve shqiptarë iu desh të ballafaqohen me Aleancën Ballkanike.

Në Luftën e Parë dhe të Dytë Ballkanike, Serbia kishte arritur të jetësojë projektin famëkeq të Ilija Garashaninit, i quajtur “Serbia e Madhe”. Në favor të këtij projekti shkonin edhe konstelacionet e Fuqive të Mëdha, që dëshironin t'i shmangeshin një lufte gjithëpërfshirëse në Evropë. Në këtë drejtim ata pranuan “status-quo”-në në terren, që korrespondonte me dhunë, masakra dhe shpërngulje të popullatës shqiptare nga trevat e tyre etnike. Këtu qëndrojnë shkaqet se pse në trevat lindore shqiptare shpërtheu Kryengritja antiserbe e Shtatorit të vitit 1913, e cila mori përmasa të mëdha, që kishte shqetësuar autoritetet serbe, për shkak se ata dëshironin të mbajnë ato që kishte arritur në teren, dhe përkrahjen që kishte nga Rusia në sjelljen e vendimeve që konfirmonin pushtimin e trevave shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër.¹

¹ Глигор Тодоровски, *Српски извори за историјата на Македонскиот народ 1912 – 1914*, Скопје, 1979, 4 – 5; В.П.Потемкин, *Историја дипломатије-Дипломатија новог века (1872 – 1919)*, Свеска друга, Београд, 1949.; Hysni Myzyri, *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, Prizren, 2001; Muhamed Shatri, *Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër 1912 – 1913*, Tiranë, 2012; Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë*

Në të njëjtën kohë shtetet ballkanike (Serbia, Greqia, Bullgaria dhe Mali i Zi), shpejtuan ta vënë në lëvizje Aleancën politike dhe ushtarake, me qëllim që problemet e Ballkanit t'i zgjidhnin në përpunje me interesat e tyre dhe në dëm të popujve që nuk ishin pjesë e kësaj Aleance ballkanike. Me fillimin e Luftës së Parë Ballkanike, për popujt që nuk ishin pjesë e Aleancës ballkanike, u krijua një gjendje e re politike tepër e rëndë dhe e rrezikshme.² Në vitin 1913 me zhvillimet e luftërave ballkanike, jeta e shqiptarëve në trevat lindore përkeqësohej në mënyrë alarmante. Populli shqiptar në këto treva nuk kishte kush ta mbronte në raportet ndërkombëtare. Kanalet për kontaktet ndërkombëtare në rrafshin diplomatik, duke shfrytëzuar edhe marrëdhëniet, njohjet private, ishin, gati më të mirat, ato të Kishës katolike, sidomos të imzot Mjedës dhe priftërinjve të asaj kohe që kishin studiuar nëpër vende të ndryshme të Evropës, përfshirë këtu edhe dom Zef Ramaj.³ Në këto rrethana përpara prijësve të popullit shqiptar dilnin dy probleme të ngutshme: qëndrimi që duhej mbajtur ndaj konfliktit ballkanik dhe ç'duhej bërë për të shpëtuar trojet e banuara me shqiptarë nga rreziqet që u kanoseshin.

Pas Betejës së Kumanovës dhe pushtimit të qytetit më 26 tetor 1913, Ushtria serbe e pushtoi pa luftë Shkupin. Gjatë rrugëtimit të saj për në Shkup, ajo vrau e masakroi pa mëshirë disa mijëra shqiptarë të pafajshëm. Atë ditë pas rënies së Shkupit, Ushtria serbe i kapi të gjallë 13 krerë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Komanda supreme serbe në një njoftim të saj theksoi se në afërsi të Shkupit ishin zënë robër prijësit shqiptarë dhe ishin deportuar në drejtim të Beogradit: Hasan Bej Prishtina dhe Said efendi Hoxha nga Shkupi. Që të dy, sipas këtij raporti, ishin deputetë të Parlamentit të Stambollit dhe nacionalistë të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Në këtë raport, Hasan Prishtina vlerësohej si intelektual dhe fanatik i madh i çështjes shqiptare. Ai së bashku me Ismail Qemalin kanë luajtur rol si përfaqësues kryesor të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare para përfaqësuesve ndërkombëtarë dhe kanë mirëmbajtur lidhjet me ambasadat e interesuara në Stamboll si edhe

I, Tiranë, 2013; Skender Asani, *Kryengritja e përgjithshme shqiptare e vitit 1912, sipas burimeve bullgare*; Врење у Албанији, “Политика”, бр.3466, дт.06.09.1913, Београд, 1913, 1.

² Петар Стојанов, *Македонија во политиката на големите сили во времето на балканските војни 1912 – 1913*, Скопје, 1979, 113; Драги Ѓорѓиев, *Британските конзули во Македонија 1797 – 1915* (Документи), Скопје, 2002, 417.

³³ Albert Ramaj, *Dëshmitar kohe - Dom Zef Ramaj (1882 – 1914), famullitar dhe mësues në Shkup*, St.Gallen, 2014, 167.

jashtë Perandorisë Osmane⁴, ndërsa në Austri dhe Itali në veçanti. Hasan Prishtina është gjithashtu i njohur edhe si person i cili lidhur me çështjen shqiptare mbështetej shumë tek Austria, ku ai ka edhe shumë lidhje të rëndësishme. Pasi, sipas njohurive që kemi, të dy janë pjesë e përbashkët me udhëheqësit e tjerë shqiptarë në Beograd, është me interes që ata të ndahen. Është shumë vështirë që të mendohet se ata ndonjëherë mundën të heqin dorë nga lufta për nacionalizmin shqiptar dhe autonominë e Shqipërisë dhe mu për këtë arsye Hasan Prishtina është shumë i rrezikshëm për shkak të lidhjeve që i ka jashtë Perandorisë Osmane.⁵

Zhvillimi i shpejtë i Luftës së Parë Ballkanike dhe fitoret e saj në fushëbeteja, mundësuan që Aleanca ballkanike ta realizojë qëllimin e kamotshëm për të realizuar projektet e tyre kundrejt territoreve shqiptare. Më e theksuara ishte Beteja e Kumanovës, ku ushtria osmane kapitulloi përballë ushtrisë serbe dhe i mundësoi asaj që të depërtojë në brendi të territoreve të banuara me shqiptarë. Ushtria e aleatëve ballkanikë, gjatë okupimit të territoreve të banuara me shqiptarë, duke përdorur propagandën se “po ndjek armikun”, vuri në jetë planin për spastrimin etnik të këtyre territoreve. Marshimi i ushtrisë serbe dhe i çetave çetnike gjatë operacioneve luftarake, në Luftën e Parë Ballkanike, edhe në viset lindore të banuara me shqiptarë, përcillej me represion, çarmatosje të shqiptarëve dhe armatosje të serbëve dhe të krishterëve sllavo-ortodoksë, me shfarosje fizike, dhunime, djegie të shtëpive dhe të katundeve shqiptare në trevat e Velesit, Kumanovës, Shkupit, Tetovës, Gostivarit, Kërçovës, Strugës, Ohrit, etj.

Me vendosjen e Komandës së III-të serbe me seli në Shkup, do të fillonin vrasjet, dhunimet, torturimet dhe djegiet e fshatrave dhe lagjeve shqiptare të Shkupit dhe rrethinës. Të gjitha këto veprime të ushtrisë serbe, do t'i përshkruante deri edhe në hollësi gazetari Leon Trocki, i cili flet për veprime devijuese të shteteve ballkanike ndaj popullatës së pafajshme shqiptare gjatë viteve 1912-1913, sepse shteti dhe qeveria djathtiste e Dumës Ruse, atëbotë i heshte këto krime të kryera nga aleatët e saj sllavistë në Gadishullin ballkanik, ndaj trevave shqiptare. Shënimet e L. Trockit dhe të L. Frojndliht për Ballkanin Jugor, janë për më tepër edhe tema tabu, për atë tragjedi dhe golgotë shqiptare që ishte shkaktuar.⁶

⁴ Perandorisë Osmane

⁵ Архив на Институтот за Национална Историја – Скопје, Микрофилм – 46, Фонд. Арнаути 1912 – 1913.

⁶ Leon Trocki, *Prapa perdes së luftërave ballkanike*, “Studime albanologjike”, nr.7, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, Shkup, 2013.

Gazetari austriak Leo Frojdlih, autor i librit “Golgotha Shqiptare”,⁷ i përshkruante masakrat e serbëve në vjeshtën e vitit 1912, deri në pranverën e 1913-s, në trojet shqiptare, Kosovë, Maqedoni me këtë gjuhë: “Me qindra e mijëra kufoma të masakruara notonin në rrjedhat e lumenjve. Kishte raste që ata gjatë therjes mblidhnin gjakun në kupa dhe e hapnin gostinë me të”.⁸

Në ditët e fundit të muajit mars të vitit 1913, në gazetën gjermanofone “Allgemeiner Tiroler Anzeiger” dhe “Reispost” me titull “Die serbische Unmenschlichkeit in Albanien”, Dom Zef Ramaj nga Shkupi do të deklaronte se: **“Për momentin nuk kam mundësi që t’ju dërgoj një raport të detajuar. Ju duhet të keni parasysh se gjendemi në gjendje luftime... Nuk mund të paramendoni atë se çka është mëkatuar ndaj bashkatdhetarëve tanë në këtë luftë... Zemra ime është përplot, për atë se çfarë mundë t’ju shkruaj më tutje. Më mirë do të vdisja se Shqipërinë ta shihja në këtë gjendje, në të cilën gjendet”**.⁹

Çetat kryengritëse si kundërpërgjigje ndaj terrorit serb kundrejt shqiptarëve, që në pjesën e parë të vitit 1913 ndërmerrnin aksione diversante e luftarake ndaj ushtrisë, çetave paramilitare serbe, policisë dhe administratës serbe në krahinën e Shkupit. Sipas shefit të policisë lokale të Çairit dhe Butelit, në pjesën e dytë të muajit janar 1913, në këto lokacione ishte vërejtur një veprim i një çete të shqiptarëve mirë të armatosur prej 40 kryengritësve, të cilët kryenin aksionet në këtë krahinë, të cilat veprime u intensifikuan gjatë prillit dhe majit të vitit 1913.¹⁰

⁷ Viti 1913 ishte viti i “Golgotës shqiptare” siç e quan edhe Leo Freundlich në librin “Albaniens Golgotha”. Ky libër, i botuar në Vjenë, jep shumë informacione për opinionin e gjerë, i cili do njihet me gjendjen e rëndë të shqiptarëve. Autori kishte mbledhur material të botuara në gazetën ditore të asaj kohe, që për autor kishin Lazër Mjedën, famullitarin e atëhershëm të Shkupit, Dom Zef Ramajn, Dom Pashk Krasniqin, Dom Nikolla Glasnovicin, etj. Në letërën e 24 janarit dërguar Vatikanit thuhej se Dom Zef Ramaj e dom Pashk Krasniqit raportonin sidomos për ato vende që ishin afër famullisë së tyre. Dom Zefi, raportonte për gjendjen në rajonin e Shkupit Kumanovës, Kisela Vodës, Tetovës e Gostivarit, kurse Dom Pashkë Krasniqi raportonte për Prizrenin, Pejën e vende të tjera përreth: Albert Ramaj, *Dëshmitar kohe - Dom Zef Ramaj (1882 – 1914) famullitar dhe mësues në Shkup*, St.Gallen, 2014, 167 – 168.

⁸ Leon Trocki, *Prapa perdes së luftërave ballkanike*, “Studime albanologjike”, nr.7, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, Shkup, 2013, 115 – 118.

⁹ Albert Ramaj, *Dëshmitar kohe - Dom Zef Ramaj (1882 – 1914) famullitar dhe mësues në Shkup*, St.Gallen, 2014, 168.

¹⁰ Архив на Институтот за Национална Историја – Скопје, фонд.Врховна команда – Полициско оделение 1913 год., Начелство Округа Скопшјанског,

Sipas të dhënave që dispononte Brigada e VI serbe, thuhej se kah fundi i muajit janar 1913, në fshatrat Nigishtan, Kuçevishtë dhe Graçan ishin vërejtur veprime të çetave të armatosura shqiptare, me ç'rast më 27.01.1913 në fshatin Graçan ishin dërguar forca të mëdha serbe, ku ishte zhvilluar një përlëshje e armatosur me çetat shqiptare. Paraprakisht e gjithë popullata shqiptare e kishte lëshuar fshatin dhe ishin vendosur në qytetin e Shkupit.¹¹

Ndërsa, në pjesën e dytë të vitit 1913, për shkak të rrethanave shumë të rënda, u shtua dukshëm edhe veprimtaria e çetave kryengritëse në territoret të banuara me shqiptarë. Komanda e III-të serbe me seli në Shkup, gjatë periudhës së dytë të vitit 1913 në raportet e përditshme njoftonte se në fshatrat e Velesit dhe Karadakut të Shkupit ishin vërejtur lëvizje të shpeshta të çetave të armatosura shqiptare dhe se një sasi e madhe e armatimit bartej për në Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Strugë, Ohër dhe Dibër. Më tej në raport thuhej se ushtria serbe duhet të reagonte me tërë ashpërsinë e saj për të eliminuar furnizimin me armatim dhe për të asgjësuar lëvizjet e grupeve të armatosura shqiptare. Veprimi i grupeve të armatosura shqiptare në krahinën e Shkupit kishte shqetësuar autoritetet serbe. Ata frikoheshin nga një kryengritje e përgjithshme e shqiptarëve, si reflektim i dhunës së ushtruar ndaj popullatës së pambrojtur shqiptare që nga pjesa e dytë e tetorit të vitit 1912 deri në shtator të vitit 1913.¹²

Lufta diplomatike e shteteve evropiane për përcaktimin e kufijve ballkanikë ishte e ashpër, meqë gërshetoheshin interesat e ndryshme të këtyre shteteve varësisht sipas ndikimit të tyre në Ballkan. Italia ishte e interesuar që Serbisë t'i pamundësojë dalje në brigjet e Adriatikut. Me këtë qëndrim të Italisë solidarizohej edhe Gjermania. Diplomacia gjermane ia kishte bërë të ditur Serbisë, se qeveria e Gjermanisë është e detyruar të mbështesë aleatin e saj - Italinë. Më tej në telegram thuhej se Gjermania mundë të bëjë lëshim: “Jo port serb në Adriatik, por komunikim me anë të hekurudhës me këtë det, nëpër një tokë të

бр.907, 27.01.1913; Halim Purellku, *Kryengritja e shtatorit e vitit 1913*, “Jehona”, Shkup, 1993, 45.

¹¹ Архив на Институтот за Национална Историја – Скопје, фонд.Врховна команда – Полициско оделение 1913 год., Начелство Округа Скопљанског, бр.1251, 27.01.1913; бр.717, 30.01.1913.

¹² Архив на Институтот за Национална Историја – Скопје, фонд.Врховна команда – Полициско оделение 1913 год., бр.1463, 03.05.1913; бр.поверливо.16.09.1913; Богумил Храбак, *Цемијет организација муслимана Македоније, Косова, Метохије и Санџака 1919 – 1928*, Београд, 2003, 61.

huaj, dhe korridori Beograd - Nish - Kumanovë - Shkup - Selanik për të dal në detin Egje nëpër luginën e Vardarit”.¹³

Në këtë kohë diplomacia serbe vlerësonte se prej fillimit të krizës ballkanike, Austro-Hungaria, frikësohej që kjo të mos merrte komplikime evropiane, sepse më së shumti do të dëmtohej vetë ajo. Po ashtu konstatonte se Austro-Hungaria në këtë periudhë i shfrytëzonte vendimet Fuqive të Mëdha për qëllime të veta dhe angazhohej që të përçajë Aleancën Ballkanike, duke kërkuar pavarësinë e Shqipërisë. Austro-Hungarisë i shkonte për shtati mobilizimi i shqiptarëve në kufij, që asaj t’i shërbejë si alibi për t’i anuluar vendimet e mëhershme të ambasadorëve në Konferencën e Londrës. Gazeta Politika (“Политика”) e Beogradit, i interpretonte shkrimet gazetave franceze, të cilat raportonin nga Vlora dhe argumentonin angazhimin e Austro - Hungarisë dhe Italisë, të cilat angazhoheshin që të lëvizin kufijtë e Shqipërisë në brendi të territorit të Serbisë dhe Malit të Zi.¹⁴ Ndaj krizës ballkanike, Fuqitë e Mëdha kishin kujdes që ajo mos të merrte përmasa evropiane, për shkak se nuk ishin të gatshëm për një luftë gjithëpërfshirëse dhe ishin të gatshme të pranonin situatat e krijuara në Ballkan.

Në ditët e para të shtatorit gazeta “Politika” informonte se në kufirin shqiptaro - serb, tek fiset e mëdha shqiptare, ndjehej një mobilizim. Në këtë drejtim, nga raportet e përditshme që siguronte kjo gazetë nga komanda supreme ushtarake, thuhej se agjentët austriak dhe italian për një kohë të shkurtër kanë arritur të armatosin shumë fise shqiptare. Siç njoftonte gazeta “Politika”, prijësi i njohur popullor Isa Boletini, po organizonte shqiptarët për të sulmuar territorin e Serbisë, me synim marrjen e Gjakovës dhe Prizrenit. Në këtë organizim të shqiptarëve, sipas kësaj gazete, kishte edhe oficerë të lartë të ish-Perandorisë Osmane, por edhe oficerë austriakë. Ndaj kësaj lëvizjeje të shqiptarëve, komanda ndërkuftare serbe kërkonte përforcime, e cila dërgohej pandërprere nga komanda supreme serbe.¹⁵

Kryengritja shqiptare ishte drejtuar kundër Serbisë dhe Malit të Zi, të cilat me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, aneksoheshin territore të banuara shqiptare. Kryengritësit shqiptar ishin mirë të armatosur me mauzerë, mitraloz dhe topa të kalibrit të

¹³ Raymond Poincare, *Lufta e parë dhe e dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës (1912 – 1913)*, Logos-A, Shkup, 2005, 303.

¹⁴ Вести из Албаније, “*Политика*”, бр.3465, 05.09.1913, Београд, 1913, 3.

¹⁵ Врење у Албанији, “*Политика*”, бр.3464, 04.09.1913, Београд, 1913, 1.

madh. Sipas autoriteteve ushtarake serbe kjo ishte dëshmi se Austria dhe Italia po i armatoste shqiptarët.¹⁶

Sipas informacioneve që dispononte gazeta “Politika” (Политика), në Durrës po qëndronte një oficer i lartë i Ushtrisë bullgare, z.Markov, i cili kishte ardhur si përfaqësues i Qeverisë bullgare, me qëllim që të hyjë në bisedime me prijësit e kryengritjes. Ai shqiptarëve u kishte premtuar përkrahjen e Mbretërisë së Bullgarisë, nëse ngrihen kundër Serbisë, Greqisë dhe Malit të Zi. Oficeri kishte premtuar se shtetit shqiptar nga ana e Bullgarisë do t’i dërgohet një kontingjent i madh me armatim. Do të dërgoheshin artileri e rëndë dhe do të dërgohen instruktorë për të trajnuar Armatën shqiptare, se si duhet përdorur topat dhe mitralozat. Markov ishte takuar me shumë prijës të kryengritësve shqiptarë dhe kishte tentuar që të përvetësonte Esad Pashën.¹⁷ Sipas informacioneve të gazetës, nga Vlora ishte nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet VMRO – së dhe Isa Boletinit e Bajram Currit. Më tej thuhej se Jane Sandanski kishte arritur t’i bëjë për vete këta dy prijës shqiptar, në luftë kundër Serbisë dhe Malit të Zi.¹⁸

Gazeta “Politika” interpreton shtypin austriak lidhur me arsyet e ngritjes së revoltës së armatosur të shqiptarëve në vijën kufitare, i cili shtyp, e akuzonte Serbinë se kishte mbyllur tregun në Gjakovë dhe Prizren, me çka i kishte varfëruar skajshmërisht popullatën shqiptare dhe i kishte detyruar të vdesin për bukë. Nëse shqiptarët ia mësynin këtyre tregjeve, ata vriteshin rrugës nga ushtria serbe.¹⁹ Sipas raportit nga Dibra thuhej se më 9 shtator, çetat kryengritëse kishin sulmuar Armatën serbe, kishin detyruar atë të tërhiqet dhe kryengritësit shqiptarë kishin arritur, që ta shtinë në dorë Peshkopinë e Brodin e Vogël dhe i ishin afuar qytetit të Dibrës. Sipas kësaj gazete, në radhët e kryengritësve kishte afro 20 mijë shqiptarë nën armë, kundrejt një numri shumë më të vogël të ushtrisë serbe.²⁰ Kryengritësit shqiptarë të udhëhequr nga Elez Isufi kishin marrë Zhirovnicën dhe ishin drejtuar drejt Dibrës, në të cilin hynë pa problem.²¹ Çlirimi i tre qyteteve, kishte jehuar fuqishëm në territoret tjera të banuara me shqiptarë dhe kishte rritë shpresën për të reviduar vendimet e Konferencës së

¹⁶ Врење у Албанији, “*Политика*“, бр.3466, 06.09.1913, Београд, 1913, 1.

¹⁷ Врење у Албанији, “*Политика*“, бр.3466, 06.09.1913, Београд, 1913, 1

¹⁸ Извештај Политици, “*Политика*“, бр.3466, 06.09.1913, Београд, 1913, 1

¹⁹ Борбе с Арнаутима, “*Политика*“, бр.3469, 09.09.1913, Београд, 1913, 3.

²⁰ Арнаути пред Дебра, “*Политика*“, бр.3470, 10.09.1913, Београд, 1913, 3.

²¹ Како су напали, “*Политика*“, бр.3477, 17.09.1913, Београд, 1913, 3.

Ambasadorëve në Londër dhe në mobilizimin e masave të gjëra në luftë kundër Serbisë dhe Malit të Zi. Sipas informacioneve që dispononte gazeta, kryengritësit ishin drejtuar në tre drejtime: një pjesë e kryengritësve u nis nga Elbasani në drejtim të Strugës e Ohrit, pjesa tjetër prej Lumës në drejtim të Tetovës dhe pjesa e tretë prej Dibrës në drejtim të Kërçovës dhe Gostivarit. Pjesa e kryengritësve që ishte nisur në drejtim të Gostivarit ishte ndeshur në Galiçnik me Ushtrinë serbe, të cilën e morën, duke i shkaktuar humbje të mëdha kësaj ushtrie.²² Pastaj kryengritësit ishin drejtuar kah Mavrova, ku do të zhvillohet një luftë e ashpër me forcat ushtarake serbe. Kryengritësit shqiptarë kishin shti nën kontroll Nikofirovën dhe Leunovën dhe ishin afruar në afërsi të Gostivarit. Luftë e ashpër ishte zhvilluar në Vrutok dhe Reçan dhe në paralagjet e Gostivarit.²³

Gazeta posedonte informacione se me 14 shtator kryengritësit shqiptar kishin arritur 15 kilometra afër qytetit të Kërçovës dhe bënë presion që të futen në qytet.²⁴ Ndërsa, kryengritësit që ishin nis nga Elbasani në drejtim të Strugës, pa vështirësi të mëdha më 15 shtator hynë në këtë qytet. Ndërsa, vojvoda Çaulev kishte hyrë po të njëjtën ditë me 300 kryengritës në qytetin e Ohrit. Sipas informacioneve të gazetës thuhej se Petar Çaulev, së shpejti qytetin e Ohrit do t'ua dorëzonte shqiptarëve dhe ky qytet do të hynte nën juridiksionin e qeverisë së Vlorës.²⁵ Sipas informatave që dispononte gazeta më 16 shtator 1913, ishte zhvilluar një luftë e ashpër në Zajaz të Kërçovës ndërmjet forcave të kryengritësve shqiptarë dhe Ushtrisë serbe.²⁶

Sipas informacioneve që dispononte gazeta, nga armata supreme vihej në dukje se ushtria serbe po i rikthente pozicionet e dikurshme. Kjo gazetë informon se nga 17 shtatori ushtria serbe ripushtonte qytetet si rrethin e Kërçovës, qytetin e Dibrës, Peshkopinë, Strugën dhe Ohrin.²⁷ Beteja më e ashpër u zhvillua në Petrinjë, e cila sipas të dhënave nga komanda supreme vlerësohej si kyçe për të ripushtuar Ohrin dhe Strugën.²⁸

Në një shkresë të 29 shtatorit 1913, kryetari i Komunës së Qukësit, i drejtohet prefektit të Elbasanit, me anën e së cilës e njofton

²² Пад Галичника, " *Политика* ", бр.3471, 11.09.1913, Београд, 1913, 2.

²³ Борба још траје, " *Политика* ", бр.3474, 14.09.1913, Београд, 1913, 1.

²⁴ Пред Кичевом, " *Политика* ", бр.3475, 15.09.1913, Београд, 1913, 2.

²⁵ Бугари у Охриду, " *Политика* ", бр.3476, 16.09.1913, Београд, 1913, 1.

²⁶ Иза Кичева, " *Политика* ", бр.3477, 17.09.1913, Београд, 1913, 2.

²⁷ Борбе са Арнаутима, " *Политика* ", бр.3479, 18.09.1913, Београд, 1913,

²⁸ Код Охрида, " *Политика* ", бр.3477, 17.09.1913, Београд, 1913,

për veprimet e kryengritësve dibranë kundër pushtuesve serbë. Në bazë të kërkesës që u bë nga ana e Qeverisë së Dibrës, fuqia e rëndësishme e dibranëve që ndodhej në Ohër dhe Strugë, u tërhoq një ditë më parë për në Dibër. Që nga mali Petrinja deri në një vend afër Resnjës luftoi burrisht ajo fuqi e pakët që mbeti aty së bashku me një fuqi të përbërë prej 100 vetëve të komanduar nga Petrushit (Petar Çaulev, S.A).²⁹

Ndërsa, gazeta “Përlindja e Shqipërisë” e datës 25 shtator të vitit 1913, boton një artikull me titull “Lufta në Bukovë”, ku përshkruhej shumë qartë rrjedha e luftimeve: *“Luftë e rrept dhe e përgjakëshme u ba në Petrin, në atë mal ngjat Resnjës, në Zavu dhe në Bukovë. Trimëniën që dëftuen kryengritësit, me gjithë pakicën e tynë, ashtë lart çdo lavdie. Së vrarët t’armikut janë aqë shumë sa kapërxejnë nga të 500 a 600 shpirtë. Prapë s’na rrihet pa përmendun emënin e Petrushit, i cili tregoi kuximin e tij të zakonshëm sa u habitën gjindja e atjeshme”*.³⁰

Një nga mekanizmat për kolonizimin e territoreve që dikur ishin në përbërje të Perandorisë Osmane, e që pas Luftës së Parë dhe të Dytë Ballkanike hynë në kuadër të Serbisë, ishte reforma agrare, përmes së cilës u realizuan aspiratat ekspansioniste të borgjezisë serbe. Kjo politikë ishte zbatuar në viset lindore shqiptare. Qëllimi kryesor i çdo reforme agrare, para së gjithash ishte zhvillimi ekonomik, por këtu u ndërthurën edhe interesa të tjera sociale dhe nacionale, siç ishin ato në vendet e lartpërmendura, ku u ndeshën këto tri koncepte.

Për zbatimin e kolonizimit të viseve lindore shqiptare, më 20 shkurt 1914, u soll “Dekreti për popullim”. Që nga koha e sjelljes së këtij dekreti, e deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore, kishte vetëm aq mundësi sa të bëhen përgatitjet e para për popullimin në trevat lindore shqiptare. Me fillimin e Luftës së Parë Botërore u ndërpreu edhe përgatitjet për kolonizimin e pjesëve të banuara me shqiptarë nën okupimin serb, ndërsa kolonizimi do të zbatohet pas Luftës së Parë Botërore.³¹

²⁹ *Qeveria e Përkohëshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, nëndor 1912 – janar 1914*, nr.286, 29.09.1913, Tiranë, 1963,207, 341

³⁰ Lufta në Bukovë, “*Përlindja e Shqipëniës* “ (*Organ për me mbrojtur të drejtat kombëtare*), 25. Vjesht’ e I.1913, faq’ e 5.

³¹ Në Nenin 1 të Rregullores për vendosje parashihej edhe autokolonizimi, nëpërmjet blerjes së lirë të tokës. Në Nenin 2 parashihej cilat toka vijnë parasysh për kolonizim dhe mbahej llogari që të mos jenë pronë private, por të jenë

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, vazhdoi procesi i kolonizimit në trevat e banuara me shqiptarë. Për atë qëllim, Qeveria e Mbretërisë SKS, më 25 shkurt 1919 e pranoi draftin e reformës agrare dhe e publikoi më 27 shkurt të atij viti me titull: “*Dispozitat paraprake për përgatitjen e reformës agrare*”. Këto dispozita paraqitnin bazë ligjore për zbatimin e reformës agrare në Mbretërinë SKS, si dhe për kolonizimin e trevave etnike shqiptare.³² Ndërsa, në një dokument zyrtar të lëshuar nga qarku i Shkupit, thuhej se kanë filluar të marrin raporte, se myslimanët (shqiptarët, S.A) që gjatë vitit 1912 – 13 i lëshuan këto territore dhe janë shpërngulur në vendet tjera, kanë filluar të kthehen e t’i kërkojnë pronat e tyre. Të shqetësuar nga kjo dukuri e kthimit, qarqet shtetërore urdhërojnë Ministrinë e Punëve të Brendshme që t’u refuzojë leje-qëndrimin në Mbretërinë SKS dhe t’ua refuzojë kërkesat për rikthimin e pronës, me arsyetim se ato toka janë në shërbim të reformës agrare dhe kolonizimit.³³

Në anën tjetër, edhe pasi Bullgaria pësoi humbje në Luftën e Dytë Ballkanike, ajo nuk u tërhoq nga synimet e saja për të jetësuar vendimet e Shën Stefanit. Përkundrazi, formimi i qeverisë së kryesuar nga V.Radosllavov më 4 korrik 1913, synonte krijimin e lidhjeve më të përafërta me Austro-Hungarinë, me çka filloi pa rezervë ta orientojë politikën bullgare në ujërat e Forcave Trepalëshe. Kjo ishte shenjë se politika bullgare nuk do të mbetet jashtë ngjarjeve të mëdha të vitit 1914, dhe me ndihmën e Austro-Hungarisë e Gjermanisë do ta arrijë atë që nuk mundi ta arrinte gjatë luftërave ballkanike, pra që të

shtetërore dhe të “shkreta”. Sipas Nenit 8 të Rregullores, si subjekte të kolonizimit parashihen “vendasit nga hapësirat e porsaçliruara, pastaj qytetarët e kufijve të vjetër të Mbretërisë së Serbisë dhe më pas popullsia serbe dhe sllave nga jashtë vendit”. Në Nenin 11 përcaktohej minimumi prej 5 hektarëve tokë për një amvisëri, dhe nga 2 hektarë për çdo mashkull, anëtarë të familjes, nëse ka mbi 16 vjet, pastaj edhe 3 hektarë për amvisëri që ka vegla dhe bagëti për përrunim të tokës; Александар Апостолов, *Колонизација на Македонија во стара Југославија*, Скопје, 1966, 37 – 39.

³² Në “Normat Paraprake”, menjëherë në Nenin 1 parashihej pezullimi i raporteve të çifçinjve, ndërsa ndalohej vendosja e raporteve të reja. Çifçinjët shpallëshin si pronarë të lirë të tokës së çifçinjve. Domethënë, sipas Rregullores nga vitit 1914, kolonizimi i paraprante reformës agrare. Praktikisht, kolonizimi filloi të zbatohet menjëherë që nga viti 1919, ndërsa çështja e çifçinjve, për arsye të ndryshme përfundimisht do të zgjidhet me Ligin e viteve 1931-33; Александар Апостолов, *Колонизација на Македонија во стара Југославија*, Скопје, 1966, 62 – 63.

³³ Државен Архив на Република Македонија – Архив на Град Скопје, фонд.Градско поглаварство, кутиа.167, Краљство Срба Хрвата и Словенаца Начелство округа скопског, 26.01.1920 године.Скопље.

qeverisë me këtë pjesë të Ballkanit, ku parashihte të okuponte territoret e Shqipërisë lindore.³⁴

Pasi u shpartalluan forcat serbe nga ana e ushtrisë austro-hungareze dhe bullgare, ato u futën në viset shqiptare që më parë ishin nën okupimin serb. Trevat lindore shqiptare (Kumanova, Shkupi, Tetova, Gostivari, Dibra, Kërçova, Manastiri, Struga, Ohri dhe Prespa), hynë në zonën bullgare të pushtimit, ku pozita e tyre ishte më e rëndë në krahasim me atë të zonës austro-hungareze. Pushtuesi bullgar sillej brutalisht me shqiptarët. Ai nuk u njohu atyre të drejtat kombëtare e njerëzore.³⁵ Me pushtimin e këtyre viseve, Bullgaria jetësoi aspiratat e saja të parapara me projektin e Shën Stefanit.

³⁴ В. Радославов, *България и световната криза*, София, 1923, 130.

³⁵ В. Радославов, *България и световната криза*, София, 1923, 117, 119, 130; Hysni Myzyri, *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, Prizren, 2001, 190 – 191.

ZONA OKUPESE BULLGARE E KOSOVËS GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

KDU 94(=18)“1914”

Situata në Kosovë dhe fillimi i Luftës së Parë Botërore

Pas mbarimit të luftërave ballkanike brenda një kohe të shkurtër filloi lufta imperialiste botërore. Shkas për fillimin e Luftës së Parë Botërore ishte Atentati i Sarajevës, të cilin e kreu Gavrillo Principi mbi Franc Ferdinandin dhe bashkëshorten e tij, më 28 qershor të vitit 1914, në Sarajevë. Qeveria e Vjenës e akuzoi Serbinë duke i dërguar ultimatum dhe duke e fajësuar si organizatore të atentatit. Qeveria serbe për t’iu shmangur konfliktit i pranoi të gjitha kërkesat që ia parashtrori qeveria e Vjenës, me përjashtim të asaj që të lejojë që policia e Austro-Hungarisë t’i kërkonte fajtorët e atentatit në territorin e Serbisë, një gjë të tillë Serbia si shtet i pavarur nuk mund ta pranonte.¹

Lufta e Parë Botërore ishte një ndër ngjarjet më të rëndësishme të shekullit të kaluar. Ajo pati dhe ushtroi ndikimin e vet të fuqishëm edhe në jetën ekonomike, shoqërore dhe politike të shqiptarëve në tërësi dhe të Kosovës në veçanti. Pasojat e kësaj lufte botërore për shqiptarët dhe Kosovën ishin tepër të mëdha dhe me rrjedhoja negative që u shprehën gjatë gjithë shekullit të kaluar.

Fillimi i Luftës së Parë Botërore Kosovën dhe shqiptarët jo vetëm që i gjeti të ndarë, të coptuar e të sunduar në pjesën më të madhe nga shteti i Serbisë por njëherazi edhe të rrezikuar e të sulmuar edhe nga fqinjët tjerë të cilët kishin apetite pushtuese për trojet e banuara me shqiptarë.

Vetëm një muaj pas atentatit të Sarajevës, më 28 korrik të vitit 1914. Austro – Hungaria i shpalli luftë Serbisë. Sapo shpërtheu lufta, si tërë rajoni ashtu edhe tërë Kosova u përfshinë në erërat e luftës. Këto erëra të luftës në Kosovë u manifestuan përmes mobilizimit të njerëzve, kafshëve bartëse dhe tërheqëse, përmes dhënies së rekuizimit për nevojat e ushtrisë etj.²

¹ Istorija Jugoslavije, Beograd 1953, f. 375.

² Milovan Sekulic, Kosova od 1912-1918, (dorëshkrim, tezë doktorate e mbrojtur në Fakultetin Filozofik të Prishtinës me 1978), f. 77.

Mobilizimi i njerëzve dhe i kafshëve në ushtrinë serbe ndikoi negativisht në jetën e popullsisë dhe të ekonomisë së Kosovës, sidomos të shqiptarëve. Me rekrutimin e një numri mjaft të madh njerëzish, dobësohej krahu i punës në familjet shqiptare, prandaj dobësohej edhe fuqia ekonomike e shqiptarëve.

Pas disfatës së ushtrisë serbe dhe pas tërheqjes së saj në drejtim të jugut, gjegjësisht në drejtim të Kosovës, popullsia dhe ekonomia e Kosovës pësoi edhe më shumë. Përveç që merrej ushqimi për nevojat ushtarake, bëhej edhe rekuizimi për nevojat e mëtejshme si i ushqimit, i drithit, i kafshëve dhe i ushqimit të kafshëve, si dhe rekuizimi i kafshëve tërheqëse për nevojat ushtarake.³

Serbia, duke u gjendur para rrezikut, para tetorit të vitit 1915 kishte filluar mobilizimin i cili përfshinte edhe shqiptarët. Mobilizimi i popullsisë shqiptare në radhët e ushtrisë serbe nuk përkonte me marrëveshjen mes Turqisë dhe Serbisë me të cilën ishte paraparë që deri më 1915, të gjithë ata që i takonin konfesionit myslimanë të mos i nënshtroheshin obligimeve ushtarake.⁴

Shqiptarët e mobilizuar, dërgoheshin në front, në fillim kundër Austro-Hungarisë dhe Gjermanisë, e pas hyrjes së Bullgarisë në luftë edhe në frontin kundër Bullgarisë. Nuk kemi të dhëna të sigurta se sa shqiptarë të Kosovës u dërguan në këto dy fronte. Nga një raport i komandës së trupave ushtarake serbe mësojmë se nga Maqedonia dhe nga Kosova ishin rekrutuar 53.088 njerëz.⁵ Ndërkaq, disa të dhëna të tjera dëshmojnë se në frontin luftarak me Austro-Hungarinë janë dërguar 8.481 shqiptarë dhe turq.⁶

Mobilizimin e shqiptarëve në ushtrinë serbe shtypi borgjez serb mundahej ta paraqiste si vullnetar; se shqiptarët kinse vullnetarisht paraqiteshin të shkonin në frontin e luftës. Mirëpo, në bazë të të dhënave arkivale dhe të atyre të mbledhura nga terreni, vijmë deri te e vërteta se popullsia shqiptare bënte rezistencë në forma dhe në mënyra të ndryshme ndaj mobilizimit. Pothuajse asnjë shqiptar nuk iu përgjigj mobilizimit me dëshirë. Ai bëhej me dhunë, prandaj, dezertimi ishte bërë dukuri e përditshme e shqiptarëve nga radhët e ushtrisë serbe.

³ Dr.Limon Rushiti, Rrethanat politiko – shoqërore në Kosovë 1912 – 1918, Prishtinë 1986. f.170.

⁴ Gazeta “Politike” Beograd 9.XII.1914, Myslimani i gradanska obaveza.

⁵ Si shënimi 3. f.169.

⁶ Muhamed Tërnav, Kaçaniku me rrethinë deri në Luftën e Dytë Botërore, Prishtinë 1995, f.79.

Shqiptarët dezertonin për shumë arsye. Por, në radhë të parë, ngase organet ushtarake serbe i dërgonin në fronte të papërgatitur për luftë, ngase nuk donin të shkonin në luftë për mbrojtjen e tokave dhe të interesave të Serbisë, ndaj së cilës kishin qëndrim armiqësor, ngase nuk dëshironin të ushqeheshin nga i njëjti kazan me ushtarët serbë, për shkak të religjionit (mishit të derrit) e të tjera arsye.⁷

Bullgaria i shpall luftë Serbisë

Pas mbarimit të luftës së Dytë Ballkanike, (1913), e cila siç dihet përfundoi me disfatën e Bullgarisë, borgjezia bullgare ishte e pakënaqur me mbetjen e Maqedonisë nën sundimin e Serbisë. Politika e saj tani ishte orientuar dhe mbështetej ngushtë me atë të Austro-Hungarisë dhe të Gjermanisë, të cilat e joshnin për t'iu bashkuar fuqive qendrore, në mënyrë që ato t'i realizonin planet e tyre ekspansioniste në Ballkan dhe më gjerë.

Qeveria bullgare, gjatë luftërave ballkanike, nuk mundi t'i realizonte planet për aneksimin e territorit në drejtim të Vardarit dhe Moravës, për shkak se Serbia e theu marrëveshjen serbo-bullgare, të nënshkruar më 13 mars 1912 rreth ndarjes së territorit të Maqedonisë. Ajo edhe më tutje nuk hiqte dorë nga politika ekspansioniste, që mbështetej në strategjinë bullgaromadhe. E revoltuar nga ky rast, ajo vetëm priste momentin e volitshëm për t'iu hakmarrë Serbisë.⁸ Ky moment erdhi në fillimin e Luftës së Parë Botërore, që për borgjezinë bullgare ishte mjaft i volitshëm.

Qysh në fillim të luftës, shtetet e Antantës (Anglia, Franca dhe Rusia) duke parë qëllimet e shteteve centraliste (Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë), për t'i realizuar planet e veta, filluan negociatat me Bullgarinë, duke i premtuar asaj pjesën juglindore të Serbisë, një pjesë të Kosovës dhe të Maqedonisë. Me këto premtime, shtetet e Antantës, u përpoqën ta tërhiqnin Bullgarinë në anën e tyre. Megjithatë, qeveria bullgare, në shtator të vitit 1915, ia kthen përgjigjen se nuk pranoi të kalonte në anën e shteteve të Antantës.⁹

Më 3 shtator 1915, qeveria bullgare, pas bisedimeve me qeverinë turke, e shpejtoi procesin e nënshkrimit të marrëveshjes për

⁷ Gazeta "Srpske novine", Beograd 15.03.1915,

⁸ Krste Bitovski, Poloznata vo Vardarska Makedonija za vreme na bugarskata okupacija 1915-1918, Glasnik, 1-2, Skopje, 1960, f.470.

⁹ Po aty.

neutralitet, e cila parashihte që t'ia merrte Turqisë një pjesë të Trakisë, deri në rrjedhën e lumit Marica. Në këtë mënyrë, qeveria turke i bëri lëshime Bullgarisë, vetëm për të kaluar në anën e shteteve të bllokut centralist. Qeveria serbe nuk donte të dinte për neutralitetin dhe qëllimet bullgare ndaj territoreve, deri në lumin Moravë dhe Vardar. Mirëpo, në këtë rast shtetet centraliste (Gjermania dhe Austro-Hungaria i dhanë përkrahje të fuqishme Bullgarisë, duke ia plotësuar kërkesat hegjemoniste borgjezisë bullgare.¹⁰

Më 6 shtator të vitit 1915, ndërmjet Bullgarisë, Gjermanisë dhe Austro - Hungarisë, u nënshkrua një marrëveshje sekrete miqësore, e cila kishte për qëllim të përgatitë një aksion dhe të sulmojë Serbinë. Me këtë konventë ushtarake, Gjermania dhe Austro - Hungaria ia pranuan të gjitha kërkesat territoriale, që i paraqiti për zgjerim në territorin e Serbisë, Maqedonisë dhe Kosovës. Kështu Bullgaria zgjerohej edhe më tepër seç parashihte Paqja e Shën Stefanit e vitit 1878. Për këto premtime të aleatëve të luftës, Bullgaria u obligua që të bënte mobilizimin e përgjithshëm për luftë kundër Serbisë, në afat prej 15 ditësh, pas nënshkrimit të konventës, që ta sulmonte 5 ditë pasi këtë ta bënte Austro - Hungaria. Gjithashtu, Bullgaria u obligua ta sulmonte Serbinë me 4 divizione dhe me 3 brigada. Kështu, pas sulmit të Gjermanisë dhe të Austro - Hungarisë në fillim të tetorit 1915, Bullgaria e bëri këtë me 10-11 tetor 1915, me sulm të përnjëhershëm në tërë kufirin me Serbinë. Më 14 tetor, forcat ushtarake bullgare depërtuan në tërë kufirin me Serbinë.¹¹ Në Maqedoni kishin për detyrë të depërtonin sa ma thellë, për t'ua prerë rrugën forcave ushtarake serbe, që të mos mund të tërhiqeshin në jug, në drejtim të Greqisë, nga e cila anë Serbia priste ndihmën e premtuar të aleatëve, të cilën në të vërtetë edhe e kishin plotësuar, sepse në Selanik, qysh më 5 tetor 1915, forcat Anglo-Franceze kishin formuar njësitë luftarake të ashtuquajtura Ushtria e Lindjes, nën komandën e gjeneralit francez, Saraj.¹²

Për shkak të obligimeve që kishte marrë para aleatëve, ushtria bullgare ishte e orientuar që ta pengonte me çdo kusht depërtimin e ushtrisë serbe në jug. Ajo po të lejonte ushtrinë serbe të bashkohej me ushtritë aleate, sillej në pyetje sukcesi i boshtit trepalësh. Prandaj

¹⁰ Po aty. f.471; Lazim Berisha, Pushteti bullgar gjatë Luftës së parë Botërore në Kosovë, Jehona nr.6, Shkup 1972, f.100.

¹¹ Milan Zelenika, Rat Srbije i Crne Gore 1915, Beograd 1954, f.143-148.

¹² Mihajlo Vojvodiq - Dragutin Zhivojinoviq, Velika Srbije 1914 - 1918. Beograd 1970, f.166.

përpiqej që, ushtrinë serbe ta detyrojë të tërhiqet në drejtim të Kosovës, duke llogaritur që popullsia e Kosovës, jo vetëm që nuk do t'i dalë në ndihmë, por edhe do ta sulmojë me anën e çetave kryengritëse çlirimtare, të cilat në realitet vazhdonin të luftonin kundër ushtrisë dhe organeve të tjera të pushtetit serb, që nga Lufta e Parë Ballkanike.¹³

Ushtria serbe e sulmuar nga veriu prej ushtrisë gjermane dhe austro-hungareze, nga jugu prej ushtrisë bullgare e prej çetave çlirimtare shqiptare u gjend në pozitë të rëndë dhe nuk ishte në gjendje të përballonte sulmet nga të gjitha drejtimet, prandaj u detyrua të ndërrojë drejtimin dhe të tërhiqet në drejtim të Shqipërisë.

Trupat bullgare pasi depërtuan thellë në territorin e Maqedonisë, më 22 tetor 1915, pushtuan Shkupin, pasi një ditë më parë pushtuan Kumanovën dhe kaluan në Kosovë, në rrethin e Gjilanit.¹⁴ Me pushtimin e Shkupit dhe të Kumanovës, ushtria serbe iu prenë të gjitha vijat e komunikacionit si dhe shpresa e tërheqjes në jug, për t'u bashkuar me trupat aleate në Greqi.

Tani ishte qartë se ushtria serbe kishte vetëm një drejtim për tërheqje. Trupat austro-gjermane kishin pushtuar Beogradin dhe me shpejtësi të madhe depërtonin kah jugu. Drejtimi i vetëm për tërheqjen e ushtrisë serbe ishte territor i Kosovës për të kaluar në Shqipëri, gjegjësisht në Durrës, ku Esat Pashë Toptani garantonte sigurinë e ushtrisë serbe.

Nga presioni i madh, nga njëra anë, e forcave austro-gjermane dhe në anën tjetër të atyre bullgare, më 21.XI.1915. Komanda Supreme e ushtrisë serbe merr vendim për tërheqje nëpër Kosovë; Pejë-Gjakovë-Prizren, në drejtim të Shqipërisë.¹⁵ Tërheqja u bë nëpër terren të papërshtatshëm dhe në kohë dimri, në drejtim të bregdetit shqiptar. Qëllimi ishte të shpëtohet çka mund të shpëtohet, pasi rrugëdalje tjetër nuk kishte.

Zona okupuese bullgare dhe rregullimi administrativ

Pushtuesit bullgarë dhe austro-hungarezë, që në Kosovë zëvendësuan pushtuesit serbë e malazezë, ranë në ujdi për ndarjen e zonave të interesit dhe për caktimin e vijës së demarkacionit.

¹³ Limon Rushiti, Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918, Rilindja, Prishtinë, 1986, f.173-174.

¹⁴ Prvi svetski rat, Srbija i Crne Gora u Prvom Svetskom ratu 1914-1918, Beograd 1975, f.200.

¹⁵ Milan Zelenika, Rat Srbije i Crne Gore 1915, Beograd, 1954, f.385.

Zona e pushtimit austro-hungarez përfshinte: Mitrovicën, Vushtrrinë, Drenicën e Poshtme, Pejën, Istogun, Gjakovën, Plavën, Gucinë, Tivarin dhe Ulqinin. Kurse zona e pushtimit bullgar përfshinte: Podujevën, Prishtinën, Drenicën e Epërme, Ferizajn, Gjilanin, Prizrenin, Preshevën, Kumanovën Shkupin, Tetovën, Gostivarin, Dibrën, Kërçovën, Strugën, Ohrin dhe Prespën.¹⁶

Pjesa e Kosovës nën okupimin bullgar bënte pjesë në të ashtuquajturën: “Krahina e inspektoratit ushtarak të Maqedonisë, e cila përfshinte 7 qarqe në Maqedoni, kurse në Kosovë atë të Prishtinës dhe të Prizrenit, që përputhej me ndarjen ushtarake administrative, të cilën e pati bërë Serbia pas luftërave ballkanike.”¹⁷ Sipas kësaj ndarjeje, territorin e Kosovës që mbeti nën okupimin bullgar deri më 29 shtator 1918, e përbënin: Podujeva, Prishtina, Novobërda, Gjilani, Kamenica, Vitia, Ferizaj, Lipjani, Drenasi, Theranda, Rahoveci, Prizreni dhe Kaçaniku.

Me traktatin e nënshkruar më 1 prill të vitit 1916, në mes të Austro-Hungarisë dhe Bullgarisë, pos të tjerash, ishte paraparë që Austro-Hungaria të shfrytëzonte disa vija të komunikacionit. Pos të tjerash, ajo siguroi hekurudhën Kaçanik - Ferizaj - Fushë Kosovë - Mitrovicë, që kishte rëndësi strategjike dhe ekonomike.¹⁸

Procesi i ndarjes së territoreve në mes aleatëve nuk u krye pa probleme. Midis aleatëve pati mjaft konteste, sidomos në tre muajt e parë të vitit 1916, më shumë rreth caktimit të vijës së demarkacionit në disa territore me rëndësi gjeostrategjike.

Territori i Kosovës, që mbeti nën sundimin bullgar, administrativisht u nda në 8 rrethe, 116 komuna, në të cilat bënë pjesë 832 fshatra. Ndërsa, numri i popullsisë në këtë territor ishte 317.438 banorë.¹⁹

Në secilën qendër të qarkut, por edhe në çdo rreth, pushtuesit bullgarë ngritën edhe organet ushtarake si qendër të divizioneve apo të brigadave ushtarake, e posaçërisht në territorin e Kosovës, ku vendosi forca të zgjedhura ushtarake, ngase Kosova konsiderohej vend i rëndësishëm strategjik.

¹⁶ Historia e Popullit Shqiptar për shkollat e mesme, Prishtinë, 1998, f.233.

¹⁷ Ruzica Guzina, Opstina u Srbija 1839-1918, Beograd 1976, f.466.

¹⁸ Dr. Zivko Avramovski, Konflikti austrohungarezo-bullgar rreth Kosovës dhe synimet e Bullgarisë për të dalë në Detin Adriatik përmes Shqipërisë (1915-1918), Gjurmime Albanologjike, nr.III. 1973, Prishtinë 1975.

¹⁹ Krsto Bitovski. Glas stradanja atpor stavovnika Kosova i Metohije za vreme bugarske okupacije, “Istorijski Glasnik” nr.4. Beograd, 1963. f.83.

Bullgaria, siç u tha më lart, në territoret e okupuara, përveç organeve ushtarake, i zgjodhi edhe organet e pushtetit civil dhe bënte me dije se këto territore do t'i aneksonte. Në këto territore sundonte 'naçallniku' i cili kishte pushtet të pakufishëm, qendra administrative e të cilit ishte në Shkup. Ai sundonte përmes organeve ushtarake – policore dhe atyre të pushtetit civil, të qarqeve, rretheve, komunave dhe fshatrave. Përveç organeve të përmendura u formua edhe një lloj i komiteteve, në krye me kryetarin e komitetit në qarqe, rrethe dhe komuna. Përveç prefektit ekzistonin edhe komisione shumanëtarëshe, me tre anëtarë, në krye të të cilëve gjendej kryetari.²⁰ Në krye të tyre ishte i koncentruar i tërë pushteti civil.

Në të gjitha rrethet, pos organeve civile pushtuesi bullgar vendosi edhe organet ushtarake. Organet ushtarake ushtronin pushtetin e vet të pakufishëm. Ato dhe organet politike ishin mbi organet e pushteti civil, të cilat u shërbenin vetëm për çështje administrative.²¹

Për shkak të problemeve të shumta, ndarja administrative e instaluar në Kosovë qëndroi deri më 6 qershor të vitit 1918, kur pushteti bullgar nuk ishte më në gjendje ta mbante nën kontroll popullsinë për shkak të qëndresës së fortë të armatosur, nëpërmjet lëvizjes çlirimtare. Në rrethana të reja kryhet riorganizimi i forcave ushtarake në Kosovë, e cila nga kjo kohë ndahet në dy rajone të "Brigadave okupuese" e këto ndaheshin në "pollkovne okupacione reone" – në koloni okupuese ushtarake. Qarku i Prishtinës përbënte rajonin e parë të kolonisë okupuese të rajonit të Brigadës së Parë Okupuese, pa rrethin e Ferizajt, kurse qarku i Prizrenit, bashkë me rrethinën e Ferizajt dhe Kaçanikut e përbënte rajonin e katërt të kolonisë okupuese të rajonit të Dytë të Brigadës Okupuese. Këto, pastaj ndaheshin në njësi më të vogla okupuese, ku bënin pjesë rrethet. Kjo ndarje ngeli deri në fund të shtatorit të vitit 1918.²²

Rrethanat ekonomike dhe politike nën sundimin bullgar

Rrethanat shoqërore – politike dhe ekonomike nën sundimin bullgar gjatë Luftës së Parë Botërore ishin tejet të rënduara. Pozita e

²⁰ Dr. Rudica Guzina. Opstine u Srbiji 1839-1918. Beograd. 1976. f.466.

²¹ Dr. Bogomil Hrabak, Dr. Dragoslav Janković, Srbija 1918, Beograd, 1968, f.102-103.

²² Kërsto Bitovski, Glad stradanja i otpor stanovništva Kosova i Metohije za vreme Bugarske okupacije Istorijski Glasnik 4, Beograd, 1963, f.90-91.

shqiptarëve në zonën e pushtimit bullgar ishte shumë më e rëndë në krahasim me zonën austro-hungareze. Ndërkaq, pozita e minoritetit sllav ishte pakrahasimisht më e mire. Pushtuesi bullgar sillej brutalisht me shqiptarët. Ai nuk u njohu atyre kurrfarë të drejte kombëtare e njerëzore. Që në fillim u arrestuan shumë patriotë në mesin e të cilëve edhe Hasan Prishtina. Përveç vrasjeve, rekrutimit, rekrutimit të punës së detyrueshme, pushteti bullgar shtypte pamëshirshëm çdo përpjekje për qëndresë të popullsisë shqiptare.

Situata politike dhe ekonomike nën sundimin bullgar karakterizohej me uri, vuajtje e persekutime të popullsisë, sidomos të asaj shqiptare. Ushtria bullgare, posa hyri në territoret shqiptare, si detyrë kryesore i shtroi vetes të furnizohet me ushqim, duke rekuizuar drithin dhe të mirat e tjera materiale. Në fillim pushtuesit bullgarë që të mund të tubonin drithërat dhe të lidhnin popullsinë e qyteteve me organet e pushtetit ofruan çmime mjaftë të larta për një kilogram drithë. Drithi u mblodh në depot ushtarake bullgare dhe austro-hungareze. Në këtë mënyrë u krijua kriza artificial e bukës, kështu që në mesin e popullsisë së varfër u shfaq uria. Kriza goditi edhe fshatarët e viseve kodrinore – malore.

Që në muajt e parë të vitit 1916, uria si dukuri paraqitet pothuajse në tërë territoret e pushtuara nga bullgarët. Ajo ishte mjaft e theksuar në rrethin e Ferizajt, sidomos në komunën e Shtërpçës ku “më tepër se gjysma e popullsisë, mbi 2.000 vetë, qe një muaj e gjysmë ushqehen me kunguj, posaçërisht familjet e të mobilizuarve.”²³ Edhe gjatë vitit 1917, gjendja ishte shumë e rëndë në këtë regjion. Në një letër të ‘naçallnikut’ të rrethit të Ferizajt të datës 17.VI.1917, në fshatrat e komunës së Shtërpçës, por edhe në fshatrat e tjera të këtij rrethi, vetëm më 13 dhe 14 qershor, nga uria kishin vdekur 4 vetë të moshës 5-50 vjeç. U tërhiqej vërejtja organeve të rrethit se, po që se nuk ndërmarrin masa për ndihmë, më shumë se gjysma e popullsisë do të vdesë nga uria. Në të njëjtën letër njoftohej se popullsia, në mungesë të drithit ther bagëtinë, për t’i shpëtuar vdekjes, mirëpo duke ngrënë vetëm mish sëmureshin.²⁴

E njëjtë ishte gjendja edhe në rrethet tjera, sidomos në atë të Prishtinës. Në vitin 1916 vetëm në Prishtinë organet e pushtetit i regjistruan ma se 2000 vetë të cilët nuk kishin me çka të blejnë bukë

²³ Kerste Bitovski, p.c. f.84.

²⁴ Po aty. f.84; Limon Rushiti, Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918 Rilindja, Prishtinë, 1986, f.180-181.

për vete dhe për familjet e tyre. Organet komunale të Prishtinës, në dimrin e vitit 1917 konstatonin se “Varfëria ka arritur kufirin më të lartë”.²⁵

Mungesa dhe vuajtjet për ushqim ishte prezent edhe në fshatrat, toka e të cilëve ishte e pjellorisë së lartë, ngase drithi konfiskohej nga organet e pushtetit bullgar. Në shtimin e varfërisë, përveç rekuizimit, ndikonin edhe faktorët e tjerë, si mobilizimi, internimi dhe puna e dhunshme, jo vetëm në infrastrukturën lokale, por edhe në atë qendrore, sikurse ishte hekurudha me binarë të ngushtë në Kërçovë, Gostivar dhe Veles - Prilep.

Rekuizimi dhe puna e dhunshme - forma të veçanta të shfrytëzimit ekonomik

Shfrytëzimi ekonomik i popullsisë, nga ana e pushtuesve bullgarë, kryhej përmes formave dhe mënyrave të shumta. Pa dyshim, një ndër format më të rënda të shfrytëzimit ekonomik, ishte rekuizimi i ushqimit dhe i të mirave të tjera material, i cili zgjati gjatë tërë kohës së pushtimit.

Për realizimin e rekuizimit, pushteti nxori edhe akte dhe vendime ligjore e nënligjore, me anën e të cilave muntohej t’i jepte legjitimitet plaçkitjes së popullsisë.

Kështu, pushteti bullgar, përmes Inspektoratit Ushtarak Krahinor të Maqedonisë, me Urdhëresën nr.62 të datës 31 korrik 1916, që i dedikohej mbledhjes së tepricave nga bujqësia, në bazë të së cilës pronari i tokës ishte i obliguar të japë:

1. Nga toka të cilën nuk e punonte pronari, por punohej përgjysmë;
 - a. Pjesën e dhjetë të prodhimit, ai që e punonte tokën,
 - b. Pjesën e dhjetë, pronari i tokës, d.m.th. nga e njëjta tokë dhe
 - c. Gjithë prodhimin, nëse pronari i tokës, nuk jetonte në zonën okupuese të Inspektoratit Ushtarak të Maqedonisë, pa marrë parasysh se a ka familje apo jo.
2. Të dhjetën e prodhimit nga toka, nëse e punon vetë pronari.
3. Të gjitha prodhimet nga toka, pronari i së cilës nuk e ka pranuar apo nuk paraqitet.²⁶

²⁵ Po aty.

Për të ushqyer dhe mbajtur ushtrinë, pushtuesit bullgarë, përveç tokave bujqësore, rekuizonin edhe prodhimet blegtorale dhe kafshët. Ata merrnin pjesë të bagëtisë nga fshatarët dhe i përdornin për mish, kurse kafshët pëlleja, në pranverë i tubonin në të ashtuquajturat “manrra” dhe i mbanin deri në vjeshtë. Këto lloj fermash, u formuan pranë çdo njësie ushtarake dhe shfrytëzonin qumështin e leshin, kurse fshatarëve i mbetej vetëm të ushqenin bagëtinë gjatë dimrit. Gjatë verës, fëmijët e pronarëve të bagëtive, me vedra në dorë, u afroreshin “manrrave” bullgare, që ushtarët t’u japin nga pak hurrë të djathit nga qumështi i deleve të tyre.²⁷ Bullgarët, para se të tubonin bagëtinë në pranverë, i merrnin qengjat, edhat dhe viçat në emër të rekuizimit – tepricës, e vende-vende, disa i paguanin me çmime minimale dhe kështu siguronin mishin për nevojat ushtarake.

Përpos artikujve ushqimorë, e kafshëve, masa e rekuizimit përfshinte edhe: leshin e deleve, kashtën, sanën (barin), lëkurën e kafshëve, bakrin, thasët, drutë, fasulen, pataten, dardhat e thata, kumbullat, mollët etj. Lista e këtyre mallrave që rekuizoheshin gjenden të shënuara edhe në urdhëresat e kryetarit të komisionit për rekuizimin në rrethin e Prishtinës, Vllahovit.²⁸

Rekuizimi ishte aq gjithëpërfshirës, sa që bëhej edhe për mallin, që ishte i destinuar për treg. Kjo zbatohet sidomos prej vitit 1917, kur edhe qëndresa e popullit mori hov, pothuajse në të gjitha viset e okupuara nga Bullgaria. Si masë sigurie organet bullgare kufizuan lëvizjen e qytetarëve dhe largimin e tyre nga fshati. Duhej marrë leje edhe për të shkuar në mal për dru, për çka duhej paguar 0,50 leva për një ditë. Nëse fshatari dëshironte të çojë në treg diçka për të shitur, ishte i obliguar që në leje të shënojë, jo vetëm artikujt, por edhe sasinë. Nëse fshatari në leje shënonte se do t’i çonte në treg 30 ve, e kishte më tepër, atëherë rojet të cilat u vendosen në çdo rrugë para hyrjes në qytet, ia konfiskonin, sepse konsiderohej si kontrabandë. Kjo vlente për të gjithë artikujt, prandaj për këtë shkak, tregtia në këtë periudhë pothuajse ishte e vdekur. E njëjta gjë vlente edhe për zejtarinë.²⁹

Përveç rekuizimit, ndikim shumë të madh në varfërinë e popullsisë, patën edhe masat e tjera detyruese si: kulluku – puna e

²⁶ Krste Bitovski, p.c. f.87, cituar sipas Limon Rushitit, Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918, Rilindja, Prishtinë, 1986, f.182.

²⁷ Janiçije Popoviq, Kosovo u ropstvu pod bugarima 1915-1918, Leskovac, 1921, f.87-88.

²⁸ Kerste Bitovski, p.c. f.88.

²⁹ Janiçije Popoviq, Kosovo u ropstvu pod bugarima 1915-1918, Leskovac, 1921, f.85.

dhunshme e meshkujve bashkë me qerret dhe bagëtinë tërheqëse, por edhe internimi në kampet e punës të Bullgarisë.

Objektet më të mëdha që u ndërtuan me anën e kullukut, padyshim ishin hekurudhat me binarë të ngushtë, Gostivar-Kërçovë dhe Veles-Prilep, ku një numër i madh i punëtorëve, për shkak të kushteve të rënda të punës vdiqën. Në ndërtimin e këtyre hekurudhave, që nga viti 1916, ishte angazhuar popullsia e Kosovës me qe e me bagëti tërheqëse. Gjithashtu, popullsia e Kosovës dhe më gjerë, ishte përfshirë në punë të detyrueshme edhe në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve për nevojat e ushtrisë bullgare.

Në hekurudhat e lartpërmendura punohej nga dy muaj, në kushte shumë të vështira. Kushtet tejet të vështira, mundimi dhe puna e rendë, bënë që shumë njerëz në këto vendpunime të mbesin përgjithmonë. Punëtorët, që punonin në mirëmbajtjen e rrugëve sipas urdhëresave të Inspektoratit Ushtarak të Krahinës së Maqedonisë duhej të ishin 25 km. larg vendbanimit të përhershëm. Në këtë mënyrë, evitohej mundësia që punëtorët të shkojnë në shtëpi çdo natë, kurse kushtet e punës ditore ishin diell me diell, nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të ushtarëve bullgarë, të cilët sa herë që donin, edhe i rrihnin me dru.

Rezistenca kundër pushtuesit bullgar

Gjendja e vështirë ekonomiko – shoqërore e popullsisë në zonën okupuese bullgare, solli si rrjedhojë qëndresën e pandërprerë kundër pushtuesve bullgarë.

Kjo qëndresë, edhe pse spontane e nuk kishte një qendër të udhëheqjes, u zgjerua dhe u masivizua, sidomos nga dhjetori i vitit 1916, kur filluan të vepronin çetat kryengritëse, që luftonin me armë kundër ushtrisë e xhandarmërisë bullgare. Këto çeta gëzonin përkrahjen e tërë popullsisë së Kosovës.³⁰

Rezistenca kundër pushtimit bullgar ishte shumëformëshe dhe gjithëpërfshirëse. Format më të shpeshta ishin: mospërgjigja për rekrutim dhe mobilizim në radhët e ushtrisë bullgare, moskryerja e obligimeve që i caktonte pushtuesi, ikja nga vendpunimet, shkatërrimi i mjeteve të punës dhe i objekteve të ndryshme, që u shërbenin

³⁰ Dr. Fehmi Rexhepi, Gjilani me rrethinë gjatë Luftës së Dytë Botërore 1941-1945. Prishtinë, 1998, f.36.

organeve ushtarake dhe atyre të pushtetit civil, propagandimi kundër pushtuesit bullgar etj .

Megjithatë, forma më e avancuar e qëndresës dhe më e fuqishme ishte kundërvënia e armatosur përmes lëvizjes çlirimtare – lëvizjes kaçake si dhe bashkëpunimi me kryengritësit serbë, sidomos në vitin 1917, në Toplicë.

Që në pranverë të vitit 1916, çetat çlirimtare – kryengritëse, në zonën okupuese bullgar, e vepronin pothuajse në të gjithë territorin. Çeta më e shquar në këtë kohë, padyshim ishte çeta e Iljaz Reçakut me shokë si: Jetish Behluli, Rexhë Bardhi dhe të tjerë pjesëtarë të lëvizjes kaçake, qysh prej kryengritjeve shqiptare të viteve 1910-1912.³¹

Për nivelin e organizimit të rezistencës, e cila ishte mjaft e fuqishme dëshmojnë edhe dokumentet e shumta të organeve ushtarake bullgare, që ndërmerrnin masa represive për shuarjen e saj.

Kështu, pos të tjerash, Komandanti i kolonës së tretë të këmbëorisë, Petrov, më 25 dhjetor 1916, lajmëronte Inspektoratin Ushtarak të Krahinës së Maqedonisë në Shkup: “Me keqardhje të madhe ju lajmëroj se në disa vendbanime të rrethit të Gjilanit dhe të Kaçanikut janë paraqitur të arratisur, të cilët në çeta të organizuara kanë vrarë ushtarët bullgarë”. Inspektorati Ushtarak nga Shkupi, në përgjigje, urdhëron që t’i përcillet urdhër popullsisë së rretheve të përmendura që deri më 29 janar 1917, t’i dorëzojë të gjitha armët, kurse pas afatit të përmendur, nëse ndokujt i gjendet arma, ai do të trajtohet si kryengritës, do të pushkatohet, shtëpia do t’i digjet, kurse e gjithë pasuria do t’i konfiskohet. Gjithashtu, ftoheshin të gjithë kaçakët që të dorëzoheshin deri në datën e caktuar. Nëse në ndonjë fshat do të bëhej ndonjë vrasje e njerëzve ose e ushtarëve bullgarë, popullsia e atij fshati, sipas urdhëresës detyrohej të paguante 1000 - 5000 leva.³²

Se urdhëresat e tilla nuk dhanë rezultate, kuptohet edhe nga një dokument ushtarak ku pos tjerash thuhej: “Me gjithë vërejtjet e shumta dhe masat e marra shumë të rrepta, po vazhdon prishja e rendit dhe e qetësisë. Në rrethet e Prishtinës, Rahovecit, Prizrenit, Podujevës dhe Gjilanit, prapë gjenden dezertorë nga armata dhe nga fshatrat, të cilët vrasin ushtarët.” Prapë ftohet popullsia e rretheve të përmendura që t’i dorëzojnë armët deri më 20 nëntor 1917. Prej kësaj kohe gjoba

³¹ Limon Rushiti, v.c. f. 194-195.

³² A. M. Shkup, Fondi, Makedonska vojna inspekcijaska oblast, DN. 12-17, 25, 12.1916. cituar sipas Limon Rushitit, v.c. f.195.

për vrasjen e zyrtarit apo të ushtarit bullgar shtohet nga 5.000 – 25.000 levë.³³

Përkundër kërcënimeve dhe shtimit të represionit, vrasjeve dhe djegies së shumë fshatrave, pushtuesit bullgarë nuk mundën ta ndalin qëndresën e popullsisë shqiptare të Kosovës, për as një çast. Duke mos pasur mundësi ta shuajnë rezistencën e shqiptarëve, pushtuesi bullgar, me anë të organeve ushtarake, shkuan aq larg sa që nëpër fshatra vendosën roje të armatosura – për të penguar njerëzit e panjohur dhe kaçakët që të hynin në fshat, të përcjellin si dhe të përgjojnë lëvizjet dhe bisedat e njerëzve. Ata, gjithashtu, organizuan një lloj policie të armatosur nëpër fshatra me njerëz të besueshëm që kishin për detyrë për të mbajtur rendin dhe qetësinë dhe t'i luftojnë të arratisurit nga pushteti.

Të gjitha këto masa represive patën vetëm efekt të kundërt, ngase populli, edhe më tepër mllfesej, e me këtë edhe rezistenca shtohej. Kjo vërtetohet edhe nga raportet ushtarake, ku pos të tjerash thuhej se “në malet e Kosovës për çdo ditë shtohen çetat e vogla kaçake, të cilat sulmonin organet e pushtetit dhe njësitet e vogla ushtarake e policore, në çdo vend dhe në çdo kohë”.³⁴

Lëvizja kaçake bashkëpunonte edhe me rajonet fqinje, sidomos me kryengritësit e Jabllanicës. Me 3 janar 1917, komandanti i Aradhës së Jabllanicës së Epërme, Milinko Vllahoviç, zhvilloi bisedime me shqiptarët për luftë kundër armikut të përbashkët. Bisedimet u përsëritën edhe në fillim të shkurtit me delegatët e ardhur nga Prishtina. Njeri prej tyre ishte, Bajram Govori, me të cilin komandanti serb kishte shkuar edhe në Prishtinë.³⁵

Kur u mor vendimi për kryengritjen e Toplicës, më 8-9 shkurt 1917, në fshatin Obiliq të Pusta Rekës, në mesin e 13 prijësve zgjidhet edhe Ramadan Neziri, ish-rreshter i xhandarmërisë bullgare në Prishtinë. Ai u zgjodh adjutant i komandantit të Aradhës Komite të Jabllanicës, dhe komandant i rojës së Kwartit.³⁶

Çetat kryengritëse shqiptare, të formuara anekënd Kosovës, vepronin dhe kryenin aksione të armatosura pandërprerë, duke i

³³ Po aty, f.196.

³⁴ Krste Bitovski, Glad stradanja i otpor stanovnistva Kosova i Metohije za vreme Bugarske okupacije, Istorijski Glasnik nr.4, Beograd, 1963. F. 90 – 92.

³⁵ Më gjerësisht shiqo: Dr. Milivoje Peroviç, Toplicki ustanak, Beograd, 1959, fq.103-109.

³⁶ Po aty, f.112-113.

shkaktuar armikut dëme shumë të mëdha dhe duke mos e lënë për asnjë çast të qetë.

Në kuadër të bashkëpunimit, në mes të kryengritësve shqiptarë dhe serbë, edhe më 20 shkurt 1917, në Kurshumli u zhvilluan bisedime në mes të kryengritësve serbë dhe shqiptarë. Në këto bisedime, kryengritësit shqiptarë ishin pajtuar që kryengritësit serbë të merrnin Nishin, kurse shqiptarët u zotuan se do ta çlirojnë Prishtinën, Mitrovicën dhe Pejën. Luftimet e përgjakshme të çetave shqiptare kundër ushtrisë bullgare, më 7 mars 1917, u dëgjuan edhe në Kurshumli.³⁷

Rezistenca e armatosur e shqiptarëve, në zonën okupuese bullgare, nuk pushoi as pas shtatorit të vitit 1918, kur kapitulloi ushtria bullgare, e në vend të saj, në fund të shtatorit dhe në fillim të tetorit të vitit 1918, depërtoi ushtria franceze e pas saj edhe ajo serbe, e cila vendosi pushtetin okupes duke, riokupuar kështu edhe një here Kosovën.

³⁷ Po aty, shtojca fq.342.



Luftëtarë shqiptarë

DIPLOMACIA E FUQIVE TË MËDHA GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

KDU 327(4/9)“1914”

Grupit të shteteve dhe krijimit të subjekteve që përbënin “Fuqitë e Mëdha” i kanë paraprirë një varg i ngjarjeve, akteve, vendimeve, luftërave, gjeopolitikave e gjeostrategjike, duke filluar që nga Kongresi i Vjenës (18 shtator 1814 - 9 qershor 1815),¹ Kongresi i Ahenit (1818), Konferenca e Parisit (1856)², Bashkimi i Gjermanisë (1871), Bashkimi i Italisë (1861), Marrëveshja e Raihshtadit (1876), Kriza Lindore (1875), Lufta ruso-osmane (1877-1878), Traktati i Shën Stefanit (3 mars 1878), Kongresi i Berlinit (13 qershor 1878), marrëveshjet biletarele që i kanë parapri formimit të Paktit Trepalësh dhe Paktit të Antantës, Luftërat Ballkanike (1912-13), Konferenca e Ambasadorëve në Londër (1912-1913) për të ardhur deri te akti i fillimit të Luftës së Parë Botërore³.

Termi “ fuqi e madhe “ ishte përdorur së pari për të përfaqësuar fuqitë më të rëndësishme në Evropë, pas rënies së Perandorisë së Napoleon Bonapartës. Shtetet më të konsoliduara - “Fuqitë e Mëdha” të kësaj periudhe si: Perandoria Austriake, Franca, Prusia, Rusia dhe Britania e Madhe, përbënin “Koncertin e Evropës. “⁴ Pra, secili prej tyre, në mënyrën e vet, tregonte fuqinë e bazuar politike e diplomatike përballë të tjerëve. Nga ana tjetër, këto shtete, shquheshin edhe si potenciale të rëndësishme dhe dominuese edhe në aspektin ekonomik e ushtarak, jo vetëm në Evropën kontinentale, por edhe në koloni.

Konferenca e Ambasadorëve në Londër paralajmëroi një etapë të re në marrëdhëniet ndërkombëtare në historinë e Ballkanit⁵. Përderisa në Londër po merreshin vendime politike, ngjarjet në rajonin e Ballkanit, po merrnin forma e dimensione të ndryshme, duke dalë jashtë kontrollit.

¹ Paul W. Shroeder, “Did the Vjena settlement rest on a balance of power”, botuar në *American Historical Review*, 1992, f. 683-706.

² “*Paris Treaty of 1856*”, *The New Encyclopedia Britanica*, volume 9, London 2007, f. 153-154.

³ Me gjerësisht shih: *Norman Rich, Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1814-1914*, Tiranë 2006.

⁴ Henry Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë 1999, f. 88.

⁵ Lisen Bashkurti, *Shqiptarët në rrjedhat e diplomacisë*, Tiranë, 2003, f. 133.

Dekada e parë dhe e dytë e shekullit XX, në Evropë, u karakterizua me rivalitet politik, diplomatik e ushtarak. Diplomacia ndërkombëtare, sidomos ajo e shteteve që përbënin grupin e fuqive të mëdha ishte shumë aktive në mbajtjen e ekuilibrit të forcave. Fuqitë e Mëdha u fokusuan në ngjarjet dhe lëvizjet politike në Evropë dhe në koloni. Edhe zhvillimet në Ballkan përbënin një interesim të jashtëzakonshëm në politikën e diplomacinë ndërkombëtare. Me kalimin e kohës, shtetet e Evropës e kthyen ekuilibrin e forcës në një garë armatimesh, pa kuptuar se teknologjia moderne dhe mobilizimi i përgjithshëm e kishin bërë luftën e përgjithshme si rrezikun më të madh për sigurinë e tyre dhe për qytetërimin evropian në tërësi.⁶

Vend të veçantë në diplomacinë e 6 fuqive të mëdha zinte edhe shturja e perandorive, posaçërisht asaj osmane⁷. Shkatërrimi i kësaj të fundit do të ishte me shumë të panjohura, do të ngrehte shumë çështje të pazgjidhura, do të shtonte shpresat e popujve të robëruar dhe do të nxiste edhe më shumë pretendimet për ndarjen e "trashëgimisë osmane" në mes shteteve ballkanike,⁸ të cilat kishin hartuar strategji prej kohësh. Në këto procese, secili nga shtetet e fuqishme, bënte përpjekje të pareshtura, në kërkim të aleancave në mes vete dhe rreshtimin e aleatëve të vegjël mbas politikës së tyre. Si rezultat i angazhimeve diplomatike, u krijuan edhe blloqet politiko-ushtarake të cilat patën rolin kryesor gjatë gjithë periudhës së Luftës së Parë Botërore. Këtyre aleancave i kanë paraprirë një varg marrëveshesh bilaterale të shteteve evropiane, shumë vite para fillimit të Luftës së Parë Botërore. Disa nga këto marrëveshje, që mund të konsiderohen se i kanë paraprirë aleancave të mëdha, janë marrëveshja e shkurtit të vitit 1887 midis Austro-Hungarisë dhe Italisë, ku u nënshkrua një traktat bashkëpunimi për çështje me interes të përbashkët. Kjo marrëveshje, u ripërtëri në dhjetor të vitit 1900, ku subjekt trajtimi u bë edhe Shqipëria. Roma dhe Vjena ranë dakord me formulën "noli me tangere" (mos më prek).⁹ Pra, sipas kësaj marrëveshjeje, Italia dhe Austro-Hungaria zotoheshin që nuk do ta pushtonin Shqipërinë dhe nuk do të cenonin interesat e njëra-tjetrës.

⁶ Henry Kissinger, vep e cit. f. 169.

⁷ Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Republikës Kosovë më tej ASHARK, Marrëveshja e paqës e lidhur me 14 janar në mes të Perandorisë Osmane dhe Mbretërisë së Serbisë, Fondi: Dokumente serbe për Luftën e Parë Botërore, dokumenti nr.4.

⁸ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tirane 2009, f. 21.

⁹ Po aty.

Edhe Gjermania dhe Austro-Hungaria, në vitin 1879, nënshkruan marrëveshjen politike e ushtarake. Kësaj marrëveshjeje, më 1882, iu bashkua edhe Italia, që ishte në armiqësi me Francën për shkak të pushtimit të Tunizisë, duke krijuar kështu Aleancën Trepalëshe, e cila më vonë doli të jetë njëra nga dy paktet më të fuqishme politiko-ushtarake në Luftën e Parë Botërore, 1914-1918.

Në anën tjetër, Franca dhe Rusia, duke e ndier rrezikun nga një bllok i fuqishëm politik e ushtarak gjermano-austriak, u afruan në mes veti dhe në vitin 1892 krijuan aleancën ushtarake franko - ruse.

Edhe Britania e Madhe, që kishte bërë pushtime të mëdha koloniale, ndiqte politikë të matur dhe ishte e interesuar të ruante ekuilibrin e forcave në Evropë. Por, zhvillimi ekonomik, fuqizimi ushtarak gjerman dhe aspiratat pushtuese koloniale, e shtyn Londrën të afrohej me Francën e Rusinë si rivale të gjermanëve. Me 1904, Franca e Britania u morën vesh dhe nënshkruan marrëveshjen ushtarako-politike. Pas kësaj marrëveshjeje, më 1907, ndërmjet Francës, Rusisë dhe Britanisë, u formua aleanca e njohur me emrin Antanta. Kështu, në Evropë u formuan dy blloqe politike e ushtarake, synim i të cilave ishte rindarja e botës, përkatësisht ruajtja e kolonive.

Pas formimit të blloqeve ushtarake, pati kriza që acaruan marrëdhëniet ndërmjet blloqeve dhe u bënë rrezik permanent për shpërthimin e konflikteve me karakter ndërkombëtar. Ndër krizat më të njohura ishin: lufta japoneze-ruse, kriza marokene, kriza e aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe luftërat pushtuese të shteteve ballkanike kundër Perandorisë Osmane. Pra, dy aleancat ndodheshin përballë njëra tjetrës, të ndara nga një hendek mosbesimi, tensionimi e rivaliteti të skajshëm, i cili shpërtheu më 28 qershor 1914 me atentatin ndaj trashëgimitarit të fronit austro-hungarez, për t'u shndërruar pas një muaji në shkas për fillimin e Luftës së Parë Botërore.

Shkuarja e Franc Ferdinandit në Sarajevë nxiti qarqet nacionaliste serbe, ku ishte krijuar një frymë armiqësore ndaj Austro-Hungarisë, meqë serbët në njëërën anë i frikoheshin pushtimit nga Austro-Hungaria dhe nga ana tjetër pretendonin të vënin dorë mbi ato territore në Bosnjë dhe në vise të tjera. Prandaj, me kalimin e kohës gjithnjë e më shumë acaroheshin situata dhe tendoseshin marrëdhëniet austro-serbe. Serbët, për të qenë sa më të gatshëm për situata sfiduese, thuhet se në kuadër të armatës serbe kishin formuar një organizatë të fshehtë, e njohur si "Crna Ruka" (Dora e Zezë). Udhëheqësi i kësaj organizate ishte caktuar majori serb, Dragutin Dimitrijeviq, i cili

njëkohësisht ishte edhe shëf i Kundërzbulimit në Ushtrinë e Serbisë.¹⁰ ‘Crna Ruka’ kishte ngarkuar Gavrillo Principin për të kryer aktin e atentatit ndaj Franc Ferdinandit. Sipas organeve austriake të kundërzbulimit, “Atentati i Sarajevës” ishte i organizuar nga institucionet shtetërore të Serbisë, të mbështetura nga diplomacia ruse. Në atentat ishin përfshirë edhe një numër i konsiderueshëm i nacionalistëve serbë, në mesin e tyre edhe Nedeljko Çabrinoviq, Trifko Grabez, Vasa Çubriloviq¹¹, Cetres Popoviq dhe një boshnjak i quajtur, Mehmed Basiç etj.¹²

Më 28 qershor, përderisa Franc Ferdinand po parakalonte nëpër Sarajevë, atentatorët ishin vënë në veprim përmes Nedeljko Çabrinoviq, i cili kishte hedhur një bombë në drejtim të trashëgimtarit austro-hungarez. Meqë në përpjekjen me bombë nuk ishte arritur qëllimi, nga ana tjetër, Gavrilo Principi, kishte nxjerrë revolen dhe e kishte plagosur për vdekje princin, Franc Ferdinand dhe princeshën Sofia. Pas hetimit të ngjarjes, organet e hetuesisë austro-hungareze kishin konstatuar lidhjen e drejtpërdrejtë të aktit terrorist dhe atentatorëve me organizatën “Narodna Odbrana”, pjesëtar i së cilës kishte qenë Gavrilo Principi.¹³

Serbia sa për sy e faqe kishte reaguar, duke “dënuar” aktin e vrasjes me qëllim që të hiqte dilemat e shfaqura për implikimin e drejtpërdrejtë të qeverisë serbe në atentat. Sidoqoftë, akti terrorist i vrasjes së Franc Ferdinandit e vuri forcërisht në lëvizje diplomacinë e Fuqive të Mëdha dhe qëndrimet pro et kontra kësaj ngjarjeje tragjike dhe me pasoja të rënda e të shumanshme. Rusia përkrahte dhe solidarizohej me Serbinë në këto “momente të vështira”, kur edhe vetë Beogradi po shfaqte “keqardhje” për rastin. Ky ishte një taktizim i sinkronizuar nga diplomacia ruse dhe ajo serbe me pretendim për t’u shfajësuar dhe për të mos adresuar përgjegjësinë tek qeveria e Beogradit. Për çudi, edhe Franca doli hapur në përkrahje të Qeverisë serbe, duke i rekomanduar Beogradit që gjërat t’i trajtonte me kujdes dhe gjakftohtësi maksimale. Përkrahja e Francës dhe e Rusisë ndaj Serbisë nxiti reagime të ashpra të Vjenës, e cila atentatin e Sarajevës e

¹⁰ Eqrem Zenelaj, *Historia e Diplomacisë*, Prishtinë 2013, f. 302.

¹¹ Vasiliqe “Vasa” Çubriloviq (14 janar 1897-11 qershor 1990) ishte një politikan dhe studiues serb. Në vitin 1914, ai ishte student në Sarajevë, i rekrutuar për të ndihmuar në vrasjen e Archduke Franz Ferdinand të Austrisë. Ai vdiq në moshën 93. Gjatë gjithë jetës u shqua si nacionalist dhe antishqiptar i përbetuar.

¹² Eqrem Zenelaj, vep e cit. f. 304.

¹³ Po aty f. 305.

cilësonte si vepër të pastër kriminale të Serbisë të mbështetur pa rezervë nga qeveria ruse.¹⁴

Në këto rrethana, Austria duhej “të mbronte nderin dhe krenarinë shtetërore” të një monarkie me traditë, por Franc Jozefi I,¹⁵ kishte shfaqur dilema për sulmin eventual, që mund t’i bënte Serbisë, si kundërpërgjigje ndaj vrasjes së trashëgimtarit të fronit. Çdo veprim i ngutshëm, i pamatur dhe pa u konsultuar me Gjermaninë, si aleate e natyrshme, mund të sillte pasoja të paparashikueshme, jo vetëm për monarkinë dualiste, por edhe për gjithë “Koncertin Evropian” dhe më gjerë. Përveç të tjerash, hezitimi i perandorit vinte për dy arsye kryesore:

E para, Austria ende nuk e kishte marrë pëlqimin dhe përkrahjen e kryeministrit Tisza të Hungarisë, e cila kishte pjesën e saj në Mbretërinë dualiste dhe e dyta, druhej nga ndonjë bashkim forcash pansllaviste, reagim të Bllokut të Antantës dhe për këtë arsye duhej të siguronte përkrahjen e plotë ushtarake të aleatëve, posaçërisht të Gjermanisë dhe personalisht të Perandorit Vilhelmi II.¹⁶ Në këtë situatë, Rusia si njëra nga fuqitë e Antantës kishte koncentruar forca të mëdha në rajon duke iu afruar Gjermanisë. Gjermanët i kërkuan Ruisë që me urgjencë të largonte trupat e saj nga kufiri me Gjermaninë dhe kërkuan edhe nga Franca të qëndronte neutrale në një përplasje të mundshme gjermano-ruse. Mirëpo, Franca, të cilës iu bashkua edhe Britania e Madhe, u afruan edhe më shumë me Rusinë për shkak të rrezikut që ndjenin nga bashkimi i forcave gjermane në një front të përbashkët. Diplomacia britanike ishte e shqetësuar, jo vetëm për Evropën Kontinentale dhe zonat e interesit në rajone të

¹⁴ Henry Kissinger, vep e cit. 170.

¹⁵ Franz Joseph I ose Francis Joseph I (gjermanisht : Franz Joseph I. , rumun : Francisc Iosif (pa numër përdorur) , hungarez : I. Ferenc József , serbisht : Фрања Јосиф (pa numër përdorur) , slloven: Franc Jožef I. , çek : František Josef I. Sllovakisht : František Jozef I. , kroate : Franjo Josip I. , italian : Francesco Giuseppe (Cecco Beppe) I. , boshnjak : Franjo Josip I. , 18 gusht 1830 - 21 nëntor 1916) ishte perandori i Austrisë dhe Austro-Hungarisë, nga 1848 deri në vdekjen e tij në vitin 1916.

¹⁶ Wilhelm II ose William II (gjermanisht: Friedrich Wilhelm Viktor Albrecht von Preußen ; Frederick William Victor Albert i Prusisë , 27 janar 1859 - 4 qershor 1941) ishte perandori i fundit gjerman (Kaiser) dhe Mbret i Prusisë. Qëndroi në pushtet nga 15 qershor 1888 deri më 9 nëntor 1918. Ai ishte nipi i madh i mbretëreshës Viktoria të Britanisë së Madhe.

ndryshme të saj, por druante edhe për Mesdheun dhe kolonitë nëpër kontinente jashtë Evropës.¹⁷

Në rrethanat e fillimit dhe zhvillimit të aksioneve luftarake në Luftën e Parë Botërore ishte shumë aktive edhe diplomacia e fshehtë, përmes së cilës shtetet mundoheshin të gjenin veten në anën e të fortëve, që mund të ishin fitues të luftës, që po merrte përmasa botërore. Kështu nisen edhe rreshtimet e shteteve të vogla në krah të Fuqive të Mëdha. Në anën e Aleancës Trepalëshe, pos Gjermanisë, Austro-Hungarisë dhe Turqisë, nga viti 1915 hyri edhe Bullgaria. Diplomacia italiane, e cila prej kohësh kishte treguar shenja të afrimit me Gjermaninë dhe Austrinë, u tregua shumë e vëmendshme, duke mos hyrë në luftë, por duke shpallur asnjësinë për të fituar kohë dhe për t'u parashtruar kushte të dy blloqeve, para se të bashkohej me njërin ose tjetrin pakt politik-ushtarak.

Pra, duke ndjekur interesat e tyre që kishin kosto të lartë, shtetet evropiane e kthyen ekuilibrin e forcës në një garë armatimesh, pa e kuptuar se teknologjia moderne dhe mobilizimi i përgjithshëm do të ishte fatal për shtetet veç e veç dhe për qytetërimin evropian në përgjithësi.

Pasi që Austria i shpalli luftë Serbisë, vazhdoi më tej zgjerimi i zonës së krizës. Me 5 gusht, Vjena i shpalli luftë edhe Rusisë. Në të njëjtën kohë, edhe Gjermania i shpalli luftë Rusisë më 1 gusht, dhe dy ditë më vonë nisi luftën edhe me Francën, për të vazhduar pastaj me 4 gusht me opsionin e luftës edhe me Britaninë e Madhe. Vazhdimësia e këtyre akteve tregoi paaftësinë dhe mungesën e gatishmërisë së diplomacisë së fuqive të mëdha, për t'i zgjidhur çështjet e hapura me metoda diplomatike. Meqë gjatë muajit gusht 1914 shpallja luftë u bë modë, Japonia, më 23 gusht hyri në luftë kundër Gjermanisë.¹⁸ Përderisa aleatët gjermanë e austriakë hynë në luftë të drejtpërdrejtë, Italia ende po bënte sehir, duke qenë shumë aktive në diplomaci, jo për të ndikuar në ndërprerjen e luftës, por duke analizuar ofertat diplomatike për të qenë e bindur për pozicionin që do të mbante në këtë përplasje ndërkombëtare.

Kështu, nga viti 1915, u intensifikuan veprimet e diplomacisë së fshehtë. Si rezultat i këtyre veprimeve u nënshkrua edhe Traktati i

¹⁷ Më gjerësisht për qëndrimin e Britanisë së Madhe ndaj çështjeve me interes të përgjithshëm shih: Valentina Duka, *Dokumente Britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët*, vëllimi I dhe II, Tiranë 2012.

¹⁸ *Fjalori Enciklopedik*, Tirane 2002, f. 430.

Fshehtë i Londrës dhe nënshkrimi i marrëveshjes në mes të Fuqive të Antantës dhe Italisë. Në nënshkrimin e këtij traktati morën pjesë Rusia, Franca, Britania e Madhe dhe Italia,¹⁹ apo më saktësisht diplomatët burrështetas të vendeve përkatëse: Benkendorf²⁰, Cambon²¹, Sir Eduard Grey²² dhe Imperiali²³.

Sipas paktit, Italia duhej të hiqte dorë nga Aleanca Trepalëshe dhe të bashkohet me Paktin e Antantës. Italia gjithashtu duhej t'i shpallte luftë Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë brenda një muaji. Duke qenë të bindur në fitoren kundër Gjermanisë dhe aleatëve të saj, Pakti i Antantës, i kishte premtuar Italisë përfitime të rëndësishme territoriale. Pra, Italia do të merrte Trentinon, Rijekën, Dalmacinë Veriore, duke përfshirë Zarën, Shibenikun dhe shumicën e ishujve dalmat, Portin e Vlorës në Shqipëri. Italia do të vendoste protektorat mbi Shqipërinë, duke rezervuar të drejtën për të përfaqësuar shtetin e Shqipërisë në marrëdhëniet e saj bilaterale dhe multilaterale ndërkombëtare.

Italisë, gjithashtu, i njiheshin pjesë të rëndësishme të kolonive gjermane në Azi dhe Afrikë. Kurse, në rast të ndarjes së Perandorisë Osmane, Italia do të merrte një pjesë të rëndësishme nga rajoni i Mesdheut.²⁴

Madje, përveç Italisë e cila u josh për t'u bërë pjesë e Antantës, nga këto marrëveshje përfitonin edhe shtete të vogla aleate, të cilat

¹⁹ Baker, Ray Stannard. *Woodrow Wilson and World Settlement, Volume I* Doubleday, Page, and Company, 1923, f. 52–55.

²⁰ Count Alexander Konstantinovich Benckendorff (1 gusht 1849-11 January 1917) ishte një diplomat rus, i cili ka shërbyer si ambasador në Danimarkë dhe në Bitaninë e Madhe.

²¹ Pierre Paul Cambon (20 janar 1843 në Paris - 29 maj 1924 në Paris) ishte një diplomat francez dhe vëllai i ambasadorit francez në SHBA Jules Cambon.

²² Edward Grey, (25 prill 1862-7 shtator 1933), i njohur më mirë si Sir Edward Grey, ishte një burrë shteti Liberal britanik. Ai shërbeu si Sekretar të Jashtëm 1905-1916. Më të filluar Lufta e Parë Botërore ai kishte deklaruar “Llambat po na fiken në të gjithë Evropën Ne nuk do të kemi jetë ti shohim përsëri të jenë nderur.” Ai ishte ambasador në Shtetet e Bashkuara në mes 1919 dhe 1920 dhe kreu i Partisë Liberale në Dhomën e Lordëve në mes 1923 dhe 1924.

²³ Marquis Guglielmo Imperiali (19 gusht 1858 - 20 janar 1944) ishte një nëpunës i mbretit italian dhe diplomat. Një liberal i lidhur me politiken majtë. Ishte një pasardhës i familjes konservatore Imperiali. Pozita e tij më e rëndësishme ishte si ambasador italian në Londër gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918)

²⁴ Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë, më tej AIHP, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 302, dok. IV, Nr. 403.

nuk kishin qenë prezentë me rastin e nënshkrimit të Traktatit të Fshehtë të Londrës. Kështu, Mbretëria e Serbisë, pavarësisht se nuk ishte e pranishme as nënshkruese, përfitonte territore të rëndësishme si: bregdetin Dalmat, në mes të Kërkës dhe Stonit, duke përfshirë gadishullin Pljesacit, portin e Splitit, dhe ishullin Braç.

Mbretëria e Malit të Zi, gjithashtu, zgjerohej në një pjesë të bregdetit Dalmat, midis Budvës Stonit, duke përfshirë Raguzën (Dubrovnikun) dhe Bokën e Kotorrit. Kjo shtrirje do të vazhdonte deri në kufirin, në jug me portin shqiptar të Shëngjinit.

Pjesë e rëndësishme e marrëveshjes ishin edhe Bosnja dhe Hercegovina, Sremi, Baçka, Sllavonia etj. Disa zona të rëndësishme të territoreve të Shqipërisë do të ndaheshin gjithashtu në mes të Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë.

Diplomacia italiane këmbënguli që çështja e bregdetit të Adriatikut midis Zarës dhe Istrës të zgjidhet pas luftës, gjë për të cilën u pajtuan edhe aleatët.

Traktatin e Fshehtë të Londrës e dekonspiroi, duke e bërë publik partia bolshevike ruse, e udhëhequr nga Vladimir Iliq Lenini²⁵. E ashtuquajtura “Qeveria Revolucionare në Rusi”, më 28 nëntor 1917 e botoi traktatin në revistën “Pravda”²⁶. E gjithë kjo u bë me qëllim të komprometimit të qeverive të shteteve kapitaliste dhe me idenë që shteti komunist është mundësia e vetme dhe më e përkryer e avancimit dhe të arriturave të një shoqërie pa klasa, me të drejta të barabarta.

Kështu, më 25 maj të vitit 1915²⁷, Italia i shpalli luftë Austro-Hungarisë dhe një vit më vonë edhe Gjermanisë. Në këto rrethana të luftës, i vetmi ishte presidenti amerikan, Wudrou Wilson,²⁸ i cili promovonte “një shërbim të mirë ndërmjetësimi” për evitimin e luftës.

²⁵ Vladimir Iliq Uljanov - Lenini (10 prill 1870 Simbiski - 21 janar 1924 Gorki, Moskë) ishte një revolucionar rus, politikan komunist, pjesëmarrës dhe lider në Revolucionin e Tetorit, udhëheqësi i parë i Republikës Sovjetike Socialiste Ruse dhe që nga viti 1922 lideri i parë i Bashkimit Sovjetik.

²⁶Eqrem Zenelaj, vep. e cit. f. 311.

²⁷Po aty

²⁸Thomas Woodrow Wilson (1856-1924) president i 28-të i SHBA , shërbeu në zyrë 1913-1921 dhe e drejtoi Amerikën gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918) . Ishte avokat i paepur për demokracinë dhe paqen në botë. Wilson është renditur shpesh nga historianët si një nga presidentët më të mëdhenj të kombit amerikan. Wilson ishte doktor i shkencave profesor në kolegji. Kishte kryer edhe detyrën e presidentit të Princeton University dhe guvernator Demokrat i New Jersey-it, para se të fitonte Shtëpinë e Bardhë, më 1912.

Por, thirrja e tij nuk gjeti përgjigje pozitive, meqë perandori gjerman e kishte refuzuar nismën e presidentit Wilson, për të ndërmjetësuar paqen. SHBA-të, në krye me presidentin Wilson mbajtën pozicion neutral me idenë se militarizimi i mëtutjeshëm i Evropës do të sillte pasoja për vetë evropianët. Ai intensifikoi komunikimin edhe me sekretarin e jashtëm, Grey, të cilin e shihte si partner në realizimin e projektit të tij për paqen. Afrimi i diplomacisë amerikane dhe asaj britanike si dhe refuzimi i diplomacisë gjermane ndaj ofertës amerikane për paqen, ndikoi që diplomacia e Washingtonit të afrohej gjithnjë e më shumë me Paktin e Antantës.

Presidenti Wilson u kishte dërguar edhe një notë paqeje fuqive ndërluftuese, më 21 dhjetor 1916. Kësaj note të Wilsonit, forcat aleate iu përgjigjën më 12 janar 1917.

Ndërkohë, të njëjtin vit (1917), Kaizeri Vilhelmi II,²⁹ duke u ndier i rrezikuar intensifikoi edhe më shumë luftën, duke përdorur në masë edhe luftën me nëndetëse. Ky realitet i cenoi në masë të konsiderueshme interesat politike, ekonomike e strategjike amerikane në Evropën kontinentale dhe në koloni. Në shkurt të vitit 1917, përderisa komanda gjermane urdhëroi rifillimin e luftës me nëndetëse kundër Britanisë, në të njëjtën kohë, bllokoi çdo qarkullim mallrash ndërmjet Anglisë dhe SHBA-së. Kjo u bë shkak i hyrjes së SHBA-së në luftë. Forcat gjermano-austriake shpejtuan në përgatitjen dhe ndërmarrjen e masave për fitore në perëndim, para zbarkimit të forcave amerikane në Evropë. Megjithatë, synimet e forcave të Boshtit për fitore në Perëndim nuk u realizuan. Forcat anglo-franceze edhe më tej mbrojtën vijat luftarake dhe nuk lejuan depërtimin e ushtrive të boshtit. Hyrja e SHBA-së në luftë, e ndryshoi rrënjësisht zhvillimin e ngjarjeve. Nga kjo kohë roli dhe ndikimi i Evropës në zhvillimin e ngjarjeve do të zvogëlohet. SHBA, si fuqi ekonomike e ushtarake, do të luajë rolin vendimtar në zhvillimet e ngjarjeve të mëvonshme, jo vetëm në Evropë, por edhe në pjesët e tjera të botës.

Në harmoni me veprimet në terren dhe kontributin e dhënë në ndihmë forcave aleate, diplomacia amerikane, më saktësisht presidenti Wilson kishte përgatitur një program, i cili u njoh si 14 pikat e

²⁹Wilhelm II ose William II (gjermanisht: Friedrich Wilhelm Viktor Albrecht von Preußen ; Frederick William Victor Albert i Prusisë , 27 janar 1859 - 4 qershor 1941) ishte perandori i fundit gjerman (Kaiser) dhe Mbret i Prusisë. Qëndroi në pushtet, nga 15 qershori 1888 deri më 9 nëntor 1918. Ai ishte nipi i madh i mbretëreshës Viktoria, të Britanisë së Madhe.

programit të Wilsonit. Në këto 14 pika përfshiheshin çështje të ndjeshme dhe shumë të rëndësishme ndërkombëtare, të cilat mund të krijonin kushte për një paqe të qëndrueshme në botë.

1. Bërja publike e marrëveshjeve ndërkombëtare të paqes, si dhe evitimi i traktateve të fshehta midis shteteve.
2. Lundrim i lirë, i pacenuar dhe i pakufizuar në ujërat ndërkombëtare.
3. Tejkalimi i kufizimeve ekonomike dhe vënia e kushteve të barabarta tregtare për të gjitha kombet e botës, heqja e të gjitha barrierave.
4. Kufizimi i armatimit për të gjitha shtetet, si kusht i domosdoshëm për vënien e paqes.
5. Kompensimi i dëmeve dhe vënia e baraspeshës, sa u takon kolonive.
6. Rregullimi i territorit me marrëveshje të veçanta dhe përfshirja e kufijve të Ruisë në këto marrëveshje.
7. Te respektohet dhe të mos vihet në dyshim sovraniteti i Belgjikës.
8. I tërë territori i Francës të rregullohet dhe t'i kthehen territoret e okupuara.
9. Caktimi i kufijve të Italisë, bazuar në shtrirjen e popullsisë italiane.
10. T'u njihet e drejta, të jenë të përfaqësuar në Lidhjen e Kombeve, popujve të Austro-Hungarisë.
11. Rumania, Serbia dhe Mali i Zi të rregullohen, të krijohet paqe e qëndrueshme në Ballkan dhe t'i mundësohet Serbisë një qasje e lirë në det.
12. Pjesët e territorit të Perandorisë Osmane të formojnë një shtet të pavarur të Turqisë, lundrimi në Dardanele të jetë i lirë për të gjitha kombet. Kombeve që ishin nën këtë Perandori t'u mundësohet zhvillim autonom.
13. Të themelohet shteti i pavarur polak në territorin e vet kompakt. Pavarësia politike dhe ekonomike t'i sigurohet me konventa ndërkombëtare.
14. Të formohet një Lidhje e Kombeve si garantë e paqes së qëndrueshme dhe t'u garantohet e drejta, si kombeve të mëdha ashtu edhe kombeve të vogla njësoj.

Gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918) u shkatërruan katër perandori: Gjermania, Perandoria Osmane, Perandoria Ruse dhe

Perandoria Austro-Hungareze. Në territoret e këtyre perandorive të shkatërruara, u krijuan shtete të reja, si: Mbretëria Serbe – Kroato - Sllovene, Polonia, Çekosllovakia, Austria, Hungaria, Lituania, Letonia, Estonia dhe Finlanda.

Lufta e Parë Botërore zgjati më se katër vjet dhe përfundoi me fitoren e Antantës. Në të morën pjesë 65 milionë njerëz, 8,5 milionë janë vrarë e 20 milionë janë plagosur. Prej tyre, 3,5 milion mbetën të paaftë për punë. Lufta i solli njerëzimit fatkeqësi të shumta: sëmundje, mjerim, rrënime të tmerrshme dhe dëme materiale tepër të mëdha. Shuma e përgjithshme e shpenzimeve të parapara të shteteve ndërluftuese i tejkaloi 1000 miliardë dollarë. Vetëm shpenzimet ushtarake u bënë 350 miliardë dollarë.

Lufta e Parë Botërore pati karakter pushtues. Fuqitë qendrore, Gjermania dhe Austro-Hungaria bënë luftë për ndarjen e botës, për koloni, për tregje, për baza të lëndëve të para, për vendosjen e sundimit të tyre mbi shtetet e tjera, kurse fuqitë e Antantës dëshironin së pari t'i ruajnë kolonitë dhe primatin e tyre e pastaj të zënë koloni të reja dhe të forcojnë dominimin e tyre në botë. Pas përfundimit të luftës përplasja e serishme e diplomacisë së Fuqive të Mëdha do të ndodhë në konferencën e Paqes në Paris, ku natyrisht dominuan interesat diplomatike të shteteve, që dolën fitimtare nga Lufta e Parë Botërore.

MALI I ZI DHE SHQIPTARËT GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

KDU 94(=18:497.16)“1914”

Vrasja e princit trashëgimtar të fronit të Austro-Hungarisë, Franc Ferdinandit, më 29 qershor 1914, në Sarajevë, u bë shkas për fillimin e Luftës së Parë Botërore.¹ Kërkesa e Austro-Hungarisë, që funksionarët e qeverisë së saj të merrnin pjesë në hetimet dhe gjykimin e bashkëpunëtorëve të kryerjes së atentatit, nuk u pranua nga qeveria serbe. Në këto rrethana, autoritetet austriake të përkrahura nga Gjermania i shpallën luftë Serbisë. Anëtarët e Bllokut të Antantës, Anglia, Franca dhe Rusia i shpallën luftë Austro-Hungarisë, kurse Gjermania, që ishte aleate e kësaj të fundit, shteteve të Antantës.² Kështu, Mbretëria Malaziasë, që ishte aleat tradicional i Serbisë i shpalli luftë Austro-Hungarisë dhe sulmoi pozicionet e saj ushtarake në kufi me Bosnjën.³

Monarkitë ballkanike, Serbia dhe Mali i Zi, kishin dalë të rraskapitura nga luftërat ballkanike dhe si rrjedhojë ishin të papërgatitura për të përballuar një luftë të re me një fuqi të madhe ushtarake e ekonomike siç ishte Austro-Hungaria. Pengesë serioze e realizimit të synimeve të planeve të Fuqive të Mëdha dhe atyre ballkanike ishte bërë edhe Shqipëria. Në këtë vend janë përplasur interesat e dy blloqeve ushtarake: Antantës dhe Fuqive Qendrore. Kjo bëhej, sidomos për shkak se bregdeti shqiptar kishte rëndësi strategjike për forcat ndërluftuese.⁴

Fillimi i Luftës së Parë Botërore krijoi një gjendje mjaft të pafavorshme për Shqipërinë. Ajo e gjeti shtetin shqiptar të paformuar politikisht, kurse Fuqitë e Mëdha që e kishin Shqipërinë nën garancinë dhe kontrollin e tyre, hynë në luftë mes vete.⁵ Kështu, pas fillimit të luftës çështja shqiptare u përfshi në planet ushtarako-strategjike të Fuqive të Mëdha ndërluftuese, veçanërisht të Austro-Hungarisë e Italisë dhe të monarkive fqinje, të Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë.

¹ Xhon Roberts, *Evropa 1880-1945*, Beograd, 2002, f.305.

² *Istoriya Jugoslavia*, Beograd, 1972, f.159

³ Po aty.

⁴ Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugoslavia 1918-1927*, Tiranë, 1992, f.19.

⁵ *Historia e Popullit Shqiptar*, Prishtinë, 1969, f.389.

Në anën tjetër, në territoret e pushtuara gjatë luftërave ballkanike (Kosovë, Maqedoni Perëndimore, Plavë, Guci e Tuz) Serbia dhe Mali i Zi kishin vendosur një regjim ushtarako-policor dhe ushtronin masa të egra shtypëse, kolonizuese e sllavizuese ndaj popullsisë shqiptare.⁶ Dhuna dhe politika shfarosëse e organeve shtetërore malazeze kishte marrë përmasa aq të mëdha, saqë edhe individit të pushtetit të atëhershëm malazez filluan të bënin ankesa në Cetinjë. Madje, vetë sekretari i brigadierit famëkeq, Veshoviq, i shkruante Cetinjës se masat e rrepta të tij ndaj popullatës shqiptare mund të shpënë në një shpërthim e revolte të përmasave të mëdha tek popullsia shqiptare.⁷

Lufta midis Antantës dhe Bllokut Qendror rezultoi me një përpjekje të madhe në tërheqjen e Italisë në anën e secilit prej blloqeve. Romës iu ofruan shumë lëshime në Ballkan e në Shqipëri, nga të dyja palët, por më të gjera e më të favorshme ishin ato të fuqive të Antantës. Në marrëveshjen e fshehtë të Londrës, që u nënshkrua me 26 prill 1915, Fuqitë e Antantës, i dhanë Italisë pjesë të Shqipërisë dhe të bregdetit dalmatin.⁸

Mbretëria Malaziase, pas fillimit të luftës, kishte bërë ankesa tek Fuqitë e Antantës se gjendja në Shqipërinë Veriore ishte e rëndë dhe se fshehurazi po vepronin aktivisht agjentët e Austro-Hungarisë. Në fakt Austro-Hungaria, pas fillimit të luftës ka bërë përpjekje që për interesat e veta t'i nxiste shqiptarët për t'u futur në luftë kundër Serbisë dhe Malit të Zi. Në veçanti, Austro-Hungaria ka bërë përpjekje t'i përvetësojë krerët e Lëvizjes Kombëtare, Hasan Prishtinën e Bajram Currin, që ishin shumë të pakënaqur me mbetjen e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare jashtë kufirit të Shqipërisë.⁹

Si rrjedhojë, në zonat kufitare midis Shqipërisë e Malit të Zi, në muajt tetor-nëntor dhe dhjetor të vitit 1914 pati veprime të armatosura. Këto veprime ishin më tepër spontane e të pa organizuara nga ndonjë qendër.¹⁰

Fushata malazeze u bë edhe më e zëshme pas nënshkrimit të Traktatit të Londrës. Sa ishte e shqetësuar qeveria malazeze nga veprimtaria e krerëve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në Shkodër, tregon qartë një telegram nga Peja nga Hajdukoviç, ku thuhet "Esadistët dhe Vidistët, pas shumë kundërthëniesh janë pajtuar mes

⁶ Po aty fq. 26.

⁷ ArkiviShtetëror i Cetinjes (mëtuje ASHC), Fondi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosja 135, Nr. i dok 5070.

⁸ Paskal Milo, vep. e cit.. fq. 36.

⁹ Paskal Milo, vep. e cit.. fq. 36.

¹⁰ Operacije Crnogorske Vojske u prvom Svetskom Ratu, Beograd, 1954, fq. 231.

vete. Pas pajtimit, Bajram Curri ka udhëtuar për në Shkodër për t'i pajtuar gjaqet dhe për të organizuar furnizimin e popullsisë me armë. Qëllimi i tij i fundit është që t'i bashkojë shqiptarët dhe t'i hedhë në luftë kundër nesh. Bashkë me Bajram Currin janë edhe Hasan Prishtina, Isa Boletini, Hysni Curri dhe Hafiz Gruda.”¹¹

Pas nënshkrimit të marrëveshjes së fshehtë të Londrës, qeveria malazise priste momentin e përshtatshëm për realizimin e synimeve të veta, për pushtimin e Shkodrës. Gjendjen kaotike ndërkombëtare dhe ballkanike, veçanërisht e shfrytëzoi Monarkia Malazise, dhe me 14 qershor të vitit 1915 ushtria malazeze pushtoi Shkodrën. Madje, në krye të ushtrisë malazeze ishte kryeministri i atëhershëm malazez, Janko Vukotić,, ndërsa operacionet luftarake i udhëhiqte brigadieri famëkeq, Radomir Veshović.¹² Vlen të ceket veprimtaria antikombëtare në vazhdimësi e Esat Pashë Toptanit, i cili në shenjë simbolike, në qendër të qytetit të Shkodrës, i dorëzoi çelësin e qytetit, gjeneralit famëkeq, Veshović. Fuqitë e Antantës nuk e pranuan këtë akt të qeverisë malazise, duke e kundërshtuar dhe duke cekur se futja e ushtrisë malazeze në Shkodër, në këto rrethana, ishte e panevojshme.

Mbretëria Malazise, futjen e ushtrisë së saj në Shkodër, para Fuqive të Antantës e justifikoi, gjoja se forcat kufitare të saj në vazhdimësi po sulmohen nga banda shqiptare, në veçanti, pengesë serioze e këtyre sulmeve janë bërë në anijet tregtare, që lundronin nga Liqeni i Shkodrës përmes Lumit Buna, në Adriatik.

Sipas gazetës malazeze “Glas Crnogorca”, që ishte zëdhënëse e shtetit malazez, hyrja e ushtrisë malazeze në Shkodër është pritur përzemërsisht nga popullsia e qytetit. Në një telegram, sipas kësaj gazete, të dërguar nga Prenk Bib Doda, lartmadhërisë mbretit Nikolla thuhej se ardhja e ushtrisë suaj në Shkodër, ishte jo vetëm e nevojshme, por edhe e domosdoshme, sepse kjo ushtri ka vënë rregull e qetësi në këtë qytet, që deri atëherë ishte në gjendje kaotike. Për rregullin dhe disiplinën, që ka vënë ushtria juaj në këtë qytet, duhej ndjerë kënaqësi, jo vetëm popullsia shkodrane, por edhe ju lartmadhëri dhe mbar bota.¹³

Por, në të njëjtin numër të kësaj gazete botohet përgjigja e mbretit Nikolla, dërguar Prenk Bib Dodës, duke falënderuar këtë të fundit për besnikëri, që shprehte ai ndaj tij.¹⁴

¹¹ Gazeta “Glas Crnogorca” nr.30, 17.06.1915

¹² Gazeta “Glas Crnogorca” nr. 30, 17. 06. 1915.

¹³ Gazeta “Glas Crnogorca” nr. 31. 20. 06. 1915.

¹⁴ Po aty.

Po ashtu, sipas shtypit malazez, edhe pjesa tjetër e parisë myslimane të Shkodrës, i kishte dërguar telegram falënderimi mbretit Nikolla për vendosjen e rendit dhe qetësisë në këtë qytet. Të gjitha këto shkrime të gazetës malazeze, gjoja se popullata e Shkodrës dhe paria e saj pushtimin e këtij qytetit e ka pritur me përzemërsi, është krejtësisht e pabazë. Një raport nga komanda e ushtrisë malazeze dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, veç të tjerash, thuhej: *“Propaganda e agjentëve të huaj, veçanërisht të atyre austriakë dhe turq është shumë e madhe. Këto dy shtete, sipas kësaj gazete, po shpërdornin të holla të paria e fiseve të Krasniqes, Shalës, Shoshit e Nikajt. Madje, si rrjedhojë e veprimtarisë së këtyre agjentëve, shqiptarët kanë filluar të grupohen dhe herë pas herë po sulmojnë forcat tona, të vendosura në pjesë veriore të Shqipërisë dhe në Shkodër. Numri i këtyre forcave është rreth 3000 veta dhe janë të armatosur mirë. Në këto rrethana, ne kemi qenë të detyruar të ndërmarim veprime ushtarake dhe t’i asgjësojmë këto banda. Luftimet kanë zgjatur 5 ditë dhe ne kemi arritur t’i thyejmë ato forca dhe t’i zëmë të gjallë rreth 46 agjentë, tek të cilët janë gjetur edhe shkresa, të cilat dëshmojnë për veprimtarinë e tyre agjenturore nga ana e Austrisë kundër shtetit tonë. Këta persona janë dërguar në burgun e Podgoricës. Më tej, thuhej se nga pala jonë (ushtrisë malazeze) janë vrarë 9 veta, janë plagosur 34, kurse 2 janë zhdukur, ndërsa për palën shqiptare nuk kemi informata. Po ashtu, thuhet se pas thyerjes së forcave shqiptare, janë marrë mbi 9 mijë pushkë, disa bomba dhe 1 mitraloz i prodhimit gjerman.”*¹⁵

Është interesant të ceket së në këtë informacion ka kontradikta. Në qoftë së numri i kryengritësve ka qenë 3000, atëherë si është e mundur që nga këta kryengritës të merren 9 mijë pushkë, që do të thotë se çdo luftëtarë ka pasur në dispozicion nga 3 pushkë. E vërteta qëndron në faktin se armët e marra nuk janë vetëm nga kryengritësit por nga tërë popullata shqiptare, e cila gjatë çarmatimit u terrorizua si më herët nga organet e shtetit malazez.

Mbretëria Malazeze i njihte mirë veprimet e lëvizjes kombëtare, që ishin bërë pengesë e realizimeve të synimeve të saj pushtuese, prandaj gjatë periudhës së pushtimit malazeze të Shkodrës, nga qershori i vitit 1915 deri në janar 1916 vrau Dedë Gjon Lulin, Mehmet Shpendin, Mustafa Qullin dhe Bajo Topullin. Ndërsa, në ditën e pushtimit të Podgoricës nga Austro-Hungaria vrau edhe Isa Boletinin me bijtë dhe nipat e vet. Ishte ky një veprim makabër i shtetit malazez ndaj këtyre veprimtarëve kombëtarë dhe si synim ishte që popullin shqiptar, qoftë të Kosovë apo të Shqipërisë t’i lë pa udhëheqës.

¹⁵ “Glas Crnogorca” nr. 32. 1915.

SINDROMI I LUFTËS SË PARË BOTËRORE DHE LUFTA AKTUALE MIDIS RUSISË DHE UKRAINËS

KDU 94(470)“1914”

94(477)“1914”

Aneksimi i Krimesë nga Rusia, në mars të këtij viti dhe mbështetja prej saj e forcave separatiste ukrainase në Donjeck dhe Llugansk, bëri që shumë historianë, analistë, studiues e politologë të përsërisin pyetjen e shtruar para gjashtë vjetësh, kur në gusht 2008, Rusia ndërhyri ushtarakisht në Gjeorgji, duke shkëputur prej saj dy krahina, Abhazinë dhe Osetinë e Jugut, të njohura ndërkombëtarisht edhe nga vetë Rusia, si pjesë e territorit gjeorgjian. Pyetja e atëhershme ishte kjo: Kush e ka radhën pas Gjeorgjisë? Përgjigja e një pjese të mirë të ekspertizës politike e shkencore të asaj kohe, fatkeqësisht, rezultoi të jetë e saktë - radhën do ta kishte Ukraina.

E njëjta pyetje shtrohet edhe sot: Kush e ka radhën pas Ukrainës? Shtetet baltike, Lituani, Letoni, Estoni? Aq më tepër që këto dy të fundit kanë komunitete të rëndësishme rusësh etnikë e rusishtfolës. Apo Moldavia, shteti i brishtë, ku si pasojë e ndërhyrjes së Armatës së 14 ruse, në fillim të viteve `90, sot e kësaj dite, ekziston konflikti “i ngrirë” i Transdnistrisë, krahinës që këtë vit i kërkoi zyrtarisht Moskës përfshirjen në Federatën Ruse? Sipas analistit Pavel Sheremet, Putin do të përpiqet të dalë në Moldavi dhe krahinën e saj, Transdnistria, për t’u ndërfutur në trupin e Evropës Qendrore dhe Lindore, duke e futur në rreth Ukrainën dhe duke e vënë plotësisht nën kontroll Detin e Zi.¹ Të gjitha shtetet e lartpërmendura kanë qenë pjesë e BS, deri në shpërbërjen e tij, në vitin 1991.

Të tjerë analistë e studiues shkojnë edhe më tej, duke mos përjashtuar nga lista e zezë e Putinit as Poloninë, dikur pjesë e Perandorisë Ruse.

Pyetje të tilla janë shprehje e shqetësimit të thellë të botës akademike, shkencore e politike që shkaktoi aneksimi i Krimesë, akt i cili përbën “rastin e parë të pushtimit territorial në Evropë, që nga koha e Luftës së Dytë Botërore.”² Ky shqetësim ka të bëjë edhe me nëpërkëmbjen e hapur të së drejtës ndërkombëtare nga Moska, si dhe natyrën, historikisht, ekspansioniste të Rusesë, që, për hir të interesave të saj si fuqi e madhe, nuk është ndalur dhe nuk ndalet as para aventurave ushtarake të tipit të Gjeorgjisë 2008 dhe Ukrainës 2014.

Meqenëse lufta Rusi – Ukrainë përkoi me shënimin e 100-vjetorit të Luftës së Parë Botërore, shumë studiues kërkuan dhe gjetën paralele domethënëse midis tyre, pavarësisht se i ndan një shekull i tërë. Sipas Bashkëdrejtorit të Institutit të Analizës së Sigurisë Globale në Uashington, Gal Llaft “kuptimi i llogarive strategjike”³ që bënte Rusia në prag të Luftës së Parë Botërore na ndihmon të deshifrojmë kodin e sjelljes së sotme të Moskës në Ukrainë.

Në Manifestin e Carit, Nikollaj II, të datës 20 korrik 1914, thuhet: “Duke ndjekur amanetin e vet historik, Rusia një dhe e pandarë me popujt sllavë në besim dhe gjak, kurrë nuk ka qenë indiferente ndaj fatit të tyre. Këto ditë, kur Austro-Hungaria i paraqiti Serbisë kërkesa krejtësisht të papranueshme për një shtet, në mënyrë unike dhe me një forcë të veçantë, shpërthyen ndjenjat vëllazërore të popullit rus ndaj sllavëve...”⁴

Po të merret i shkëputur ky fragment, mund të biesh lehtë pre e stereotipit, sipas të cilit, Rusia u përfshi në Luftën e Parë Botërore, jo për shkak të interesave të veta perandorake, të cilat ajo i perceptonte si jetike, por për hir të aleates së saj ballkanike, Serbisë.⁵ Kjo tezë, natyrisht, mbështetësit e saj kryesorë i ka të përqendruar në Moskë dhe në Beograd, por nuk mungojnë as në Perëndim.⁶ Midis tyre është edhe ish-Sekretari Amerikan i Shtetit, Henri Kisingeri, i cili, duke iu referuar lidhjeve ruse-serbe dhe mbrojtjes së Serbisë nga Rusia, arrin në përfundimin se “Kombet e Evropës i lejuan vetes të bëheshin pengje të klientëve të tyre kokëkrisur ballkanikë, në vend që t’i frenonin ata”.⁷ Për hir të së vërtetës, duhet thënë se në librin e tij “Diplomacia”, Kisingeri, si një nga përfaqësuesit më të shquar të shkollës realiste, sjell fakte dhe argumente që rrëzojnë tezën, sipas së cilës, fuqitë e mëdha të asaj kohe, përfshirë Rusinë, u tërhoqën në konflikt nga klientela ballkanike, në kundërshtim me vullnetin e tyre.⁸ Faktet dëshmojnë se Rusia hyri në Luftën e Parë Botërore për interesat dhe egon e saj, si fuqi e madhe. Janë të njohura rivalitetet historike të Ruisë me fuqitë e tjera evropiane për ndikim në Ballkan, në Evropën Lindore, në Azinë Qendrore etj. Por, në prag të Luftës së Parë Botërore, si kërcënim kryesor, Perandoria Ruse e shihte Gjermaninë. Kjo situatë është fiksuar në një informacion sekret të Shtabit të Përgjithshëm të Flotës Detare të Ruisë, drejtuar Carit, Nikollaj II, në fillim të vitit 1914: “Pesëmbëdhjetë vitet e fundit, Gjermania është përpjekur me të gjitha forcat për ta nënshtruar Rusinë ekonomikisht dhe për ta dobësuar atë politikisht dhe ushtarakisht... Por, rilindja e Ruisë, tashmë, ka filluar dhe po përparon me shpejtësi. Për pasojë, në

Gjermani po shfaqet frika, lidhur me shtrirjen e mëtejshme të ndikimit të saj, prandaj gjermanët po nxitojnë të marrin masa”.⁹ Është koha kur Berlini kishte shpallur synimin për ndërtimin e një hekurudhe që do ta lidhte me Bagdatin, nëpërmjet Stambollit. Pikërisht në këtë periudhë, nisnin e forcohen marrëdhëniet midis Gjermanisë dhe Perandorisë Osmane, sidomos në fushën ushtarake. Një mision ushtarak gjerman u vendos në Stamboll për të drejtuar stërvitjen dhe modernizimin e ushtrisë turke, në mënyrë të veçantë, Korpusin e saj të Parë, që kishte për detyrë mbrojtjen e kryeqytetit dhe të Ngushticave. Perandori gjerman, Vilhelmi II, shprehu besimin se flamujt e vendit të tij “së shpejti do të valëviten mbi fortifikimet e Bosforit”.¹⁰ Në takimin që Nikollaj II pati me ambasadorin britanik në Shën Peterburg, deklaroi se në një situatë të tillë, Rusia do ta kundërshtonte me të gjitha forcat Gjermaninë “edhe sikur lufta të ishte e vetmja alternativë”.¹¹ Kjo luftë, sipas shefit të administratës ushtarake të Rusisë, Nikollaj Obrushev, “do të ishte e përgjithshme, jo e lokalizuar”.¹²

Kërcënimin tjetër ndaj interesave të saj, Perandoria Ruse e shihte tek Austro-Hungaria. Vjena konsiderohej nga Shën Petërburgu si një ndër rivalët e tij më të egër në Ballkan. Në qendër të politikës ballkanike ruse, për rreth tre shekuj me radhë, ka qenë frenimi i ekspansionit austriak në drejtim të Ballkanit, duke përdorur të gjithë instrumentet që kishte në dispozicion, ushtrinë, diplomacinë, shpesh edhe popullsitë ortodokse të këtij rajoni, duke i manipuluar dhe shfrytëzuar ato në funksion të interesave të veta, për ta mbajtur Austro-Hungarinë sa më larg Ballkanit. Në këtë kontekst, duke filluar që nga Lidhja e Prizrenit, por edhe para saj, Rusia nuk ka lënë gurë pa lëvizur për copëtimin e trojeve shqiptare dhe pengimin me çdo mjet të përpjekjeve për formimin e shtetit të pavarur shqiptar, i cili shihej prej saj si një projekt, kryesisht austro – hungarez. Të tre projektet¹³ e hartuar nga Shën Petërburgu, në prag të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, e gjymtonin atë territorialisht, deri në kufijtë e një prefekture, midis Matit dhe Elbasanit, ndërkohë që një gjymtim akoma më i rëndë i bëhej përmbajtjes së tij: sipas projekteve ruse, ai do të quhej “shteti mysliman shqiptar”.

Rusia ishte ndër fuqitë e para, krahas Britanisë së Madhe, Francës dhe Italisë që, në fillim të Luftës së Parë Botërore, në vend që të mbronin pavarësinë e Shqipërisë si garantuese e saj, në bazë të vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, i shkeli ato me të dyja këmbët, duke iu rikthyer, edhe një herë tjetër, tezës së vet të vjetër për copëtimin e trojeve shqiptare. Në një takim me

ambasadorin e Francës, Moris Paleologu¹⁴, Cari, Nikollaj II¹⁵, i paraqiti atij pikëpamjen ruse, lidhur me Shqipërinë londineze, edhe ashtu të cunguar. Sipas tij, Serbia duhet të marrë pjesën veriore të Shqipërisë, Greqia, atë jugore, ndërsa Vlora duhej t'i kalonte Italisë.¹⁶

Politikën e mbajtjes larg të Austro-Hungarisë në Ballkan, Rusia e ka ndjekur edhe lidhur me Serbinë. Sipas llogarive të Shën Peterburgut, me pushtimin e Serbisë, Vjena nuk do të ndalej vetëm me kontrollin e Adriatikut, por mund të dilte në Egje, duke pretenduar edhe ajo kontrollin e Ngushticave. Rusia mund të pajtohej me gjithçka, por kurrsesi me marrjen nën kontroll të Ngushticave nga një fuqi e madhe si Gjermania, apo aleatja e saj, Austro-Hungaria. Kjo do të thoshte asfiksi ekonomike për perandorinë cariste, pasi nëpërmjet Dardaneleve dhe Bosforit kryhej pjesa më e madhe e eksport-importit rus. Në të njëjtën kohë, do të shkaktonte asfiksi ushtarako-strategjike, sepse nëpërmjet tyre kalonin anijet luftarake ruse për mbrojtjen e interesave të saj si fuqi e madhe në Mesdhe dhe po nëpërmjet Ngushticave futeshin anijet luftarake të kundërshtarëve të saj, gjë që Rusia e kishte provuar, duke e pësuar keqas, në Luftën e Krimesë, gjatë viteve 1854-1856.

Një interes tjetër që e çoi Rusinë drejt përfshirjes në Luftën e Parë ishte ai i përmirësimit të imazhit. Pas poshtërimit nga Japonia, më 1905 dhe nga Berlina e Vjena, më 1908, duke e detyruar që të pranojë aneksimin austro-hungarez të Bosnjës, pa marrë asgjë në shkëmbim, Rusia dëshironte që, nëpërmjet fitores që ajo shpresonte ta arrinte në Luftën Botërore, të rivendoste autoritetin dhe prestigjin e saj si fuqi e madhe e klasit të parë.

Këto ishin interesat themelore që e shtynë Peterburgun drejt Luftës së Parë Botërore dhe jo sllavofilia apo serbofilia ruse, që propagandohet nga historiografia ruse dhe një pjesë e historiografisë serbe.

Në manifestin e lartpërmendur të Carit, Nikollaj II, nuk flitet hapur për këto interesa, sepse ai ishte një dokument moralizues e propagandistik, që kishte për qëllim mobilizimin e perandorisë në emër, gjoja, të solidaritetit me vëllezërit serbë të një feje e të një gjaku. Megjithatë, edhe në këtë dokument ka një fjali kyçe që shpreh thelbin e interesave ruse në Luftën e Parë Botërore, që, siç e formulon Cari, është “mbrojtja e pozitës së Ruisë si fuqi e madhe”.¹⁷ Këtij qëllimi i janë nënshtruar “serbofilia” dhe “solidariteti sllav” apo pretendimet e Peterburgut për, gjoja, mbrojtjen e paqes e të rendit ndërkombëtar.

Deshifrimi i kodit të sjelljes së sotme të Ruisë putiniste, nisur nga “kuptimi i llogarive të saj strategjike”, në vitin 1914, do të thotë që këtë sjellje ta shohim të kushtëzuar nga interesat e saj aktuale si fuqi e madhe, ashtu siç i percepton ajo.

Sot, pas 100 vjetësh, sipas Moskës, pozitat e Ruisë përsëri janë të kërcënuara.¹⁸ Nëse atëherë problem themelor ishin Ngushticat dhe frika e kontrollit të tyre nga Gjermania apo Austro-Hungaria, këtë radhë, Presidentin Putin e ka kapur ankthi se mos, pas orientimit propeëndimor të Ukrainës, Krimea kthehet nga një bazë e fuqishme ushtarake ruse, në bazë ushtarake amerikane ose të NATO-s, duke e kthyer Detin e Zi në një det të rrezikshëm, armiqësor për Rusinë. Qëllimi i aneksimit të Krimesë, duket se ishte parandalimi i një zhvillimi të tillë, që, në gjykimin e Moskës, cenonte interesat e saj jetike në fushën e sigurisë. Por, duke fituar Krimenë, Rusia humbi Ukrainën.

Me humbjen e saj, si republika më e madhe dhe më e pasur, pas Ruisë, në ish-Bashkimin Sovjetik, merr fund edhe ëndrra e Putinit për Bashkimin Euraziatik, si një pol i veçantë fuqie, në botën shumëpolëshe. Ndërhyrja në Ukrainën juglindore dhe mbështetja e forcave separatiste në Donjeck dhe Llugansk, duket se ka si qëllim që, në pamundësi të kthimit të Ukrainës në sferën e saj të ndikimit, ta destabilizojë atë dhe të mos i japë asnjë mundësi që të integrohet në strukturat e BE dhe NATO-s. Pengesë kryesore për realizimin e ambicieve si fuqi e madhe, Rusia e konsideron SHBA-në, NATO-n dhe BE-në.

Duke vazhduar me deshifrimin e kodit të sjelljes së sotme të Ruisë, mund të pohohet se, ashtu si me 1914, edhe me 2014, përmirësimi i imazhit, rikthimi i vendit në hierarkinë e lartë të fuqive botërore, ishte një tjetër interes që e shtyu Kremlinin drejt goditjes së Ukrainës dhe aneksimit të Krimesë. Mesazhi që ai dëshiron t'i japë Perëndimit, nëpërmjet ndërhyrjes në Ukrainë, është ky: Nëse nuk doni të dëgjoni zërin dhe mendimin tonë, nëse nuk doni të respektoni interesat tona, ne do t'ju detyrojmë ta bëni këtë. Në logjikën e Putinit, tani Rusia është bërë aq e fortë, sa t'i lërë pas fyerjet dhe poshtërimet që, sipas tij, Perëndimi ia ka bërë Ruisë, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe shpërbërjes së BS.

Ashtu si 100 vjet më parë, edhe në vitin 2014, Rusia nuk kursehet në përdorimin e demagogjisë. Për shkak të ndërhyrjes me forca ushtarake kundër një vendi tjetër sllav, siç është Ukraina, Moska nuk mund të flasë më në emër të “solidaritetit sllav”, si në rastin e

Serbisë, por ka shpikur “mbrojtjen” e të drejtave të rusëve etnikë dhe të popullsisë ruseshtfolëse”¹⁹, duke i dhënë vetes të drejtën e ndërhyrjes, jo vetëm në Ukrainë, por në gjithë hapësirën ish-sovjetike, kudo ku jetojnë pjesëtarë të së ashtuquajturës “botë ruse” dhe sa herë që ajo vetë e gjykon se të drejtat e tyre po “shkelen”. Natyrisht, nuk janë të drejtat e ruseshtfolësve ato që e shqetësojnë Moskën, por interesat shtetërore të saj, si fuqi e madhe.

Përtej Ruisë, në plan më të gjerë global, një tjetër ekspert amerikan, Ambasadori Charles Freeman, gjen “ngjashmëri shqetësuese” midis sfidave të një shekulli më parë dhe atyre të sotme. Ai thekson se edhe në prag të Luftës së Parë Botërore procesi i globalizimit po zhvillohej me shpejtësi, ekuilibri i forcave po ndryshonte, fryma nacionaliste po përhapej, tensioni shoqëror-ekonomik po rritej, ndërkohë që teknologjitë ushtarake po përsoseshin,²⁰ duke paralajmëruar ndryshimin e karakterit të veprimeve luftarake.

Sot, këto dukuri po shfaqen në progresion gjeometrik. Gazeta “Die Welt” konstaton “ngjashmëri të dukshme strukturore”²¹ midis sistemit të sotëm ndërkombëtar dhe atij që ekzistonte në prag të Luftës së Parë Botërore. Këtu, në radhë të parë, ajo ka parasysh lëvizjet tektonike në shpërndarjen e fuqisë dhe shfaqjen e lojtarëve të rinj që aspirojnë të sfidojnë rregullat e vendosura pas Luftës së Ftohtë, midis të cilëve, ndër më aktivët dhe më agresivët, paraqitet Rusia.

Pas zhvillimeve dramatike në Ukrainë, janë bërë gjithnjë e më të shumtë zërat për fillimin e një “luftë të ftohtë” të re, midis Lindjes dhe Perëndimit. Sipas politologëve rusë, Fjodor Llukjanov dhe Sergej Karaganov, “lufta e ftohtë”, as që është ndërprerë ndonjëherë, sepse, sipas tyre, edhe pas viteve `90- të të shekullit të kaluar, Perëndimi vazhdoi politikën e frenimit, të marginalizimit dhe poshtërimit të Ruisë.²² Profesori i Universitetit të Nju Jorkut, Stiven Kohen, jo vetëm që e pranon se situata e tanishme në marrëdhëniet ndërkombëtare i ka të gjitha shenjat e “luftës së ftohtë”, por e krahason atë me momentet më të mprehta të ballafaqimit midis Perëndimit dhe Lindjes, duke u shprehur se kriza aktuale është me e rrezikshme se ajo e Karaibeve në vitin 1962.²³ Nuk janë të paktë zërat, sipas të cilëve, po shfaqen fantazmat e luftës së tretë Botërore²⁴, e cila, sipas tyre, nuk mund të jetë tjetër veç luftë bërthamore. Profesori i Universitetit Kolumbia, Robert Levgold, paralajmëron se acarimi i krizës së sigurisë në qendër të Evropës mund të kthejë rrezikun e kësaj lufte.²⁵ Aq më tepër që Vladimir Putini, më se një herë, gjatë këtij viti,

i është referuar arsenalit bërthamor rus dhe nevojës së modernizimit të tij. Në doktrinën ushtarake dhe atë të sigurisë të Federatës Ruse, që në vitin 1993 është hequr dorë nga parimi “i mospërdorimit i pari të armës bërthamore”. Para pak kohësh, ishte pikërisht Moska ajo që kërcënoi se vetëm Rusia është në gjendje që ta shndërrojë SHBA-në në pluhur radioaktiv.²⁶ Se çfarë do të thotë luftë bërthamore, këtë e ka paralajmëruar me kohë, Albert Ajnshtajni: pas luftës së tretë, e katërta do të zhvillohet me gurë dhe me shkopinj.²⁷ Nisur nga arsenalet e fuqishme bërthamore që zotërojnë SHBA dhe Rusia, armagedoni eventual atomik, me shumë gjasë, do t'i jepte fund jetës në planetin tonë.

Sa janë reale gjasat për luftë botërore, në mënyrë të veçantë, për një ballafaqim bërthamor midis Ruisë dhe SHBA-së? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, duhet nisur nga rrethanat aktuale, si dhe nga raporti i forcave midis aktorëve kryesorë të skenës politike ndërkombëtare. Precedentët historikë janë të pamjaftueshëm për të arritur në përfundime të argumentuara shkencërisht. Analogjitë me të shkuarën mund të ofrojnë pjesë të së vërtetës, por asnjë prej tyre nuk pasqyron dot situatën e tanishme, sidomos sa u përket prognozave katastrofike.²⁸ Duke pranuar që situata e sotme ndërkombëtare ka “ngjashmëri të dukshme strukturore” me atë në prag të Luftës së Parë Botërore, duhet vënë në dukje se ato janë larg së qeni identike. Mark Tuen ka shkruar se historia rimon²⁹, duke kuptuar me këtë që ajo nuk përsëritet, as nuk mund të përsëritet pikë për pikë.

Dallimi themelor është se me 1914, përballë njëri-tjetrit ishin dy blloqe antagonistë, nga njëra anë, Antanta (Britani, Francë dhe Rusi) dhe, nga ana tjetër, Blloku Qendror, (Gjermani, Austro-Hungari).

Në mars 2014, Rusia ndërhyri e vetme në Ukrainë, pa pasur ndonjë aleat pas vetes. Bile, as Bjellorusia dhe Kazakistani, anëtarë të Bashkimit Doganor Euraziatik, nuk i mbështetën veprimet e Moskës në Krime.

Një dallim tjetër, gjithashtu thelbësor, ka të bëjë me raportin e forcave. Moska, vërtet, ka arritur paritetin strategjik me Uashingtonin, që në mesin e shekullit të 20-të, por në të gjithë elementët e tjerë të fuqisë ekziston një asimetri e dukshme midis këtyre dy vendeve. Mjafton të përmendim që ekonomia e SHBA-së është tetë herë më e madhe se e Ruisë, buxheti ushtarak amerikan është shtatë herë më i lartë se ai rus³⁰, pa folur për epërsitë e SHBA-së në teknologji, në telekomunikacion, në “fuqinë e butë”, etj.

Në këtë kontekst, vështirë të thuhet që Putini është i gatshëm për një ballafaqim me SHBA, me NATO-n dhe Perëndimin, në përgjithësi. Deklaratat e tij kërcënuese duhen parë më shumë si mjet presioni ndaj Perëndimit, për të zbutur sanksionet apo për ta lënë të qetë në “tajgën” e tij, sesa kërcënim real për përdorimin e armës bërthamore. Kërcënime të tilla pati bërë edhe paraardhësi i tij, Boris Jelcin, në vitin 1995, gjatë luftës në Bosnje-Hercegovinë, si dhe në vitin 1999, gjatë luftës në Kosovë, si shprehje e pakënaqësisë së tij ndaj ndërhyrjes së NATO-s kundër forcave serbe.³¹ Ato mbeten pjesë e retorikës së nxehtë, më shumë simbol i dobësisë, sesa i fuqisë ruse. Siç do të mbeten të tilla, me siguri, edhe kërcënimet e Putinit. Sepse, çdo udhëheqës shteti që ka pultin e komandimit të armës bërthamore e di që shtypja e tij çon në shkatërrimin e ndërsjellë, të sigurt. Është vetë arma bërthamore që shërben si siguresë për mospërdorimin e saj dhe jo arsyeja e shëndoshë e Putinit dhe as triumfi i drejtësisë ndërkombëtare. Ka shumë të ngjarë që, po të mos ishte arma bërthamore, lufta botërore do të kishte filluar me kohë.

Megjithatë, siç konstaton me të drejtë studiuesi bullgar, Ivan Krastev, përkujtimi i 100-vjetorit të fillimit të Luftës së Parë Botërore, e bëri të pashmangshme referimin ndaj analogjisë me të,³² gjë që nuk kaloi pa ndikim në vendimmarrjen dhe reagimin e Brukselit dhe të Uashingtonit. Sipas këtij koncepti, që njihet edhe si “sindromi i Luftës së Parë Botërore”, meqenëse konflikti para 100 vjetësh erdhi si pasojë e keqkuptimit dhe mungesës së besimit midis fuqive të mëdha, pra, dështimit të diplomacisë, atëherë, mësimi që duhet nxjerrë është ky: kujdes nga reagimi i tepruar, jepi shans diplomacisë³³; ndaj veprimeve të Moskës të veprojmë me kujdes, të mos e provokojmë atë, përndryshe ajo do të bëjë ndonjë të keqe edhe më të madhe. Ky koncept gjeti vend në reagimet e para të Perëndimit ndaj aneksimit të Krimesë, të cilat ishin të vakëta dhe të mangëta³⁴, duke u kufizuar me disa sanksione ndaj një numri nëpunësish të administratës së Putinit.

Koncepti tjetër, që filloi të shfaqet me thellimin e krizës, ishte i kundërt me atë të sindromit të Luftës së Parë Botërore: ndaj Rusisë duhet qëndruar fort,³⁵ ajo duhet frenuar në agresivitetin e saj dhe ky frenim duhet të jetë sistemor, në të kundërtën, lëshimet dhe pasiviteti e trimërojnë regjimin e Putinit dhe ai mund të ndërmarrë aventura të tjera, me pasoja edhe më të rënda. Pra, jo reagimi, por mosreagimi do të ishte i rrezikshëm. Këtë kishte dëshmuar përvoja e Luftës së Dytë Botërore, kur politika e pajtimit me Hitlerin, veç i kishte shtuar orekset e tij dhe historia e saj, tashmë, dihet. Këtë dëshmoi edhe

përvoja e Luftës së Ftohtë, kur politika amerikane e frenimit dhe sanksioneve ndaj BS dha frytet e veta. Këtë dëshmoi edhe rasti i Kosovës, kur qëndrimi i fortë i Perëndimit ndaj Millosheviqit u konkretizua me ndërhyrjen e NATO-s, në pranverën e vitit 1999, duke parandaluar spastrimin etnik të shqiptarëve nga dhuna e strukturuar ushtarake dhe policore serbe. Koncepti i qëndrimit të fortë gjeti konkretizimin e vet me sanksionet e nivelit të tretë të BE-së dhe vendimet e Samitit të NATO-s në Uells, të cilat, pritet që në të ardhmen e afërt, të japin efektet e duhura.

Përkujtimi i 100-vjetorit të fillimit të Luftës së Parë Botërore, si dhe zhvillimet e sotme ndërkombëtare, sidomos lufta e Rusisë kundër Ukrainës, pra, historia dhe e sotmja, duhet të shërbejnë si momente reflektimi për shqiptarët. Popujt dhe kombet seriozë nxjerrin mësimet të vyera nga përvoja historike dhe ajo aktuale. Ashtu si gjatë historisë, politika zyrtare e shtetit rus vazhdon të jetë në kundërshtim me interesat tona kombëtare shtetërore. Moska vazhdon të mbetet kundërshtari më i egër i pavarësisë së Kosovës. Si instrument të lojërave të saj gjeopolitike në rajonin e Ballkanit, ajo ka zgjedhur Beogradin dhe serbët, natyrisht, në funksion të interesave të veta dhe jo “vëllezërve sllavë”.

Nga ky këndvështrim, ngjarjet në Ukrainë, edhe një herë tjetër, rikonfirmojnë të vërtetën e shpallur, që në kohën e Rilindjes dhe të përsëritur si devizë kryesore në lëvizjet demokratike, në kapërcyell të viteve '80- '90-të të shekullit të 20-të, se për Shqipërinë dhe Kosovën, ashtu si për gjithë kombin shqiptar, nuk ka alternativë tjetër, veç forcimit të lidhjeve të gjithanshme me Perëndimin dhe, veçanërisht, me aleatin tonë strategjik-SHBA, si dhe vazhdimi i proceseve integruese në strukturat euro-atlantike.

Literatura

- Pavel Sheremet, “Peredel Ukrainy”, Ukrainskaya Pravda, 14.04.2014
 Robert Kagan, “Superpowers don't get to retire”, www.newrepublic.com, 26.05.2014
 Gal Luft, “Tsar Vladimir the first”, www.foreignpolicy.com, 05.08.2014
 Viktor Cernomyrdin, “Vyzov”, M., 2003, s. 193-194;
 “Za balkanskimi frontami Pervoy Mirovoy Voyni “, M., 2002, predisllovye, s.3
 Nikolay Rizhkov, Vyacheslav Tetyokin, “Yugoslavskaya Golgofa”, M., 2002, s. 22-35;
 E. Yu. Guskova, “Istoriya Yugoslavskogo krizisa” (1990-2000), M., 2001, s. 508;
 A. Bezchicky, “Voyna, kotoraya vseгда s toboy”, Ogonyok, nr. 30, iyul', 1995

- Henri Kissinger, "Diplomacia", Tiranë 1999, f. 194;
- Patrick J. Buchanan, "Who and what is Vladimir Putin?", *The American Conservative*, 18.03.2014;
- Margaret Macmillan, "Sherri i madh i Serbisë së vogël", *Koha Ditore*, 18.01.2014
- Henri Kissinger, op. cit
- Henri Kissinger, op.cit, f. 181;
- N. Rich, "Diplomacia e fuqive të mëdha 1814-1914", Tiranë, 2006, f. 260-261
- Yu. Pisaryev, "Tayny Pervoy Mirovoy Voyny. Rossiya i Serbiya v 1914-1915 gg.", M., 1990, s. 109-110
- D.C.B. Lieven, "Russia and the origins of the First World War", New York, St. Martin's Press, 1983, p. 46
- D.C.B. Lieven, Op.cit, p. 69
- George F. Kenan, "The fateful alliance: France, Russia and the coming of the First World War", New York, Pantheon, 1984, Appendix II, p. 264
- "Istoriya vneshney politiki Rossii", M., 1997
- Moris Paleologu, (1859-1944), diplomat i shquar francez, nga viti 1914 deri në vitin 1917 ka qenë ambasador i Republikës së Francës në Perandorinë Ruse
- Cari Nikollaj II (1868-1918), ka qenë perandori i fundit rus. Gjatë revolucionit të shkurtit të vitit 1917, abdikoi nga fronin. Me urdhër të autoriteteve sovjetike, në vitin 1918 u pushkatua në qytetin Ekaterinburg, me të gjithë anëtarët e familjes së tij.
- Moris Paleologu, "Tsarkaya Rossiya vo vremya mirovoy voyny", M., 1991
- Viktor Cernomyrdin, op cit
- Gal Luft, op.cit
- Vladimir Putin, "Obrascheniye Prezidenta Roossiskoy Federacii", www.kremlin.ru, 18.03.2014
- Charles W. Freeman, "Kogda bessil'na diplomatiya", www.globalaffairs.ru, 03.09.2014
- Dominik Geppert, Sonke Neitzel, Cora Stephan, Thomas Weber, "Pochemu vinovata ne tol'ko Germaniya", *Die Welt*, www.inosmi.ru, 12.01.2014
- Sergey Karaganov, "Evropa: Okonchit' holodnyuyu voynu", www.globalaffairs.ru, 08.04.2014;
- Sergey Karaganov, "Evropa i Rossiya: Ne dopuskat' novoy holodnoy voyny", www.globalaffairs.ru, 27.04.2014;
- Fyodor Lukyanov, "Mechta o holodnoy voynye", www.globalaffairs.ru, 28.04.2014;
- Georgiy Bovt, "Hotyeli russkiye voyny?", www.globalaffairs.ru, 02.03.2014
- Stephen F. Cohen, "The new cold war and the necessity of patriotic heresy", www.thenation.com, 12.08.2014
- Jacques Attali, "Geopolitique de l'humiliation", www.slate.fr, 16.09.2014;
- Gareth Evans, "Five reasons why the sky is not falling", www.project-syndicate.org, 27.05.2014;

-
- Han Siudun, “Pora gotovit`sya k tret`yey mirovoy”, Huancin Zhibao, www.inosmir.ru, 16.09.2014
- Robert Legvold, “Managing the new cold war”, www.foreignaffairs.com, 08.08.2014
- Fyodor Lukyanov, op cit
- Andrey Bystritskiy, “SMI v koren` ”, www.globalaffairs.ru, 27.01.2014
- Dominique Moisi, “Vladimir Poutine donne un nouvel elan a l`axe Paris-Berlin”, Les Echos, FR, 24.03.2014
- Graham Allison, “Could the Ukraine crisis spark world war?”, The national interest, 07.05.2014
- Robert Legvold, op cit
- John Mearsheimer, “Why the Ukraine crisis is the west`s fault?”, www.foreignaffairs.com, (nr. 5, 2014), dt.31.08.2014
- Ivan Krastev, “1914 protiv 1938: kak yubileyniyie daty delayut istoriyu”, www.globalaffairs.ru, 19.07.2014
- Ivan Krastev, idem.
- Robert Kagan, op cit
- David J. Kramer, “Action, not words needed for Ukraine”, The Washington Post, 22.04.2014; David Francis, “How NATO could confront the Putin doctrine”, www.foringpolicy.com, 26.08.2014.

LËNDA ARKIVORE PËR LUFTËN E PARË BOTËRORE NË ARKIVIN E KOSOVËS

KDU 902(496.51)“1914”

Duke e përshëndetur pjesëmarrësit e kësaj Konference dhe duke u falënderuar për organizimin e saj, duhet të them se ndjehem i nderuar që më është dhënë rasti që para këtij auditoriumi të nderuar, me pak rreshta të kumtesës sime të prezantoj disa të dhëna për lëndën arkivore në Institucionin e Arkivave të Kosovës, në përgjithësi dhe për lëndën arkivore, që i referohet temës së sotme të kësaj Konference, në veçanti.

Fillimisht rikujtoj se arkivat e një vendi përbëjnë memorien e një shoqërie, një kombi. Ato janë pjesë thelbësore dhe e pazëvendësueshme e pasurisë kulturore, historike, shkencore etj. Arkivat ruajnë përjetësinë e memories kolektive njerëzore të një treve a vendi, të një populli. Rrjedhimisht, pa dokumente nuk ka histori të mirëfilltë, nuk ka histori të besueshme. Ndërsa, një popull pa histori nuk ka as të ardhme, do të ishte virtual. Sepse, e kaluara historike e një populli a vendi, në mënyrë reale dhe të argumentuar mund të paraqitet, të shpjegohet e shtjellohet më së miri kur për atë periudhë historike ekzistojnë dokumente të shkruara, dokumente arkivore. Nga arkivat gjithmonë është thithur pjesë e madhe e njohurive për të kaluarën tone. Ndërkaq, është detyrë permanente e punonjësve shkencorë që të reflektojnë, të vetëdijesojnë më tej shoqërinë dhe veçmas struktura të caktuara të saj për rëndësinë e dokumenteve arkivore si thesar i paçmuar dhe i pazëvendësueshëm për ndriçimin shkencor të datave e ngjarjeve të së kaluarës sonë. Madje, në këtë kuptim unë mendoj se do të duhej të nguteshim ngadalë, siç do të thoshin latinët e urtë. Sepse, sikundër vlerat tjera monumentale të kulturës dhe trashëgimisë tonë edhe thesari arkivor duhet shfrytëzuar por edhe mbrojtur e ruajtur për brezat që vijnë.

Do të përmend kalimthi se sot Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës me Njësitë e saj në 6 qendra regjionale të vendit, ka vetëm rreth 1200 fonde arkivore apo rreth 7200 metra gjatësi të lëndës arkivore ose mbi tre milion njësi dokumentesh të ndryshme. Nga e tëra kjo sasi, kryesisht për mungesë të kapaciteteve të nevojshme njerëzore, është rregulluar, që do të thotë është e përpunuar afër një e

treta e kësaj lënde kurse dy të tretat e saj janë pjesërisht të rregulluara ose të paprekura ende nga dora e rregulluesit apo përpunuesit arkivor.

Nga sasia e rregulluar ne kemi gjetur se është një sasi e konsiderueshme dokumentesh që kanë të bëjnë me Luftën e Parë Botërore, me kontekstin e saj dhe rrethanat historike të kohës. Në vazhdim paraqes një pasqyrim të shkurtër të disa prej këtyre fondeve, përkatësisht dokumenteve, sepse për të prezantuar të gjitha, do të bëhej një regjistër më i gjatë.

Fondi: Ushtria e ish Jugosllavisë- mes viteve 1884-1930 ka afër 15000 dokumente të viteve të para Luftës së parë botërore, në të cilat synimet pushtuese serbo-malazeze e greke janë dominuese:

letërkëmbime të Esat Pashës me komandantin e ushtrisë serbe në kufirin serbo-shqiptar - dok. Nr.3;

rreth Marrëveshjes së paqes të vitit 1914 në mes të Mbretërisë serbe dhe Perandorisë otomane - dok. Nr. 4;

për stacionimin e 15000 ushtarëve grekë në Korçë dhe disa pika të tjera kufitare - dok. nr.13;

për lidhjet mes shqiptarëve të besimit muhamedan dhe disa komitëve bullgarë, për mbrojtjen e interesave të Shqipërisë dhe shkëputjen e të gjitha lidhjeve me Serbinë, dok. nr.20;

për furnizime me armë të Esat Pashës, disa herë, nga ushtria serbe, dok. nr.28;

për organizim të krerëve të bashkuar të fiseve Gashi, Krasniqi, Gruda, Mërturi kundër Malit të Zi - dok. Nr.33;

Togeri Mladen Stamatoviq, nga Komanda e ushtrisë nga Timoku ishte këthyer nga Mati ku ishte dërguar për të neutralizuar dhe margjinalizuar Ahmet Beun (Zogun) sepse ishte kundër ushtrisë së Esat Pashës - dokumenti nr.38;

Dokumenti nr.41 - Komanda e ushtrisë së Timokut: Esat Pasha urdhëron mobilizim sa më të madh të njerëzve për të mbrojtur kufijtë e rretheve. 2.

Dokumenti nr.49 - Rregullore mbi ushtrimin e pushtetit në territoret e okupuara.

Dokumenti nr.50 - Telegram dërguar Esat Pashës në Durrës, nga Koloneli serb Miçiq.

Dokumenti nr.66: Shkresë Ministrin të ushtrisë (serbe)- "Komandanti i Rrethit të Kosovës lajmëron se një mësues nga Vushtrria deklaroi se Hazir Laja nga Belaje e Rrethit të Pejës

dëshiron të vendoset në Serbi dhe të punojë për interesa tona. Ky ishte bashkëpunëtor i Malit të Zi dhe bashkëpunëtor i ngushtë i Bajram Currit”. /Unë dua të besoj se djallëzitetë, intrigat, shantazhet dhe përçarjet nga pushtuesit gjithmonë kanë qenë dhe fatkeqësisht kanë mbet mekanizëm veprues, ndonjëherë edhe i suksesshëm, në ambiciet permanente të tyre/.

Dokumenti nr.67- Informatë se Hasan Beu, Bajram Curri dhe Elez Jusufi gjenden në rrethinën e Prizrenit dhe po punojnë për të ngritur popullin kundër serbëve.

Dokumentet nr. 71 e 73- Letër e dërguar nga Esat Pasha për bashkëpunim me Komandantin serb dhe kërkesat tij ndaj Komandantit serb.

Dokumenti nr.85 - Krerëve dhe popullit të Tiranës dhe Matit - që nga nesër do të fillojë grumbullimi i armëve.

Dokumenti nr.93 - Situata që ka të bëjë me lëvizjen e trupave arnauete nën Komandën e Haxhi Qamilit, që numron 1500 veta. Vazhdimi i luftës. Humbjet në beteja.

Dokumenti nr.103 - Komanda supreme: Lajmërohet Ministri i ushtrisë se, Esat Pashës mund t'i japim 1 000 000 fishekë dhe një sasi të madhe bombash.

Dokumenti nr.106 - Raport ushtarak mbi Shqipërinë- Informatë për situatën ushtarake në Shqipëri.

Sa për informatë them se 110 dokumente të këtij Fondi, më 15 shtator janë prezantuar në Ekspozitën e përbashkët të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe Kolegjit universitar “Fama” – me rastin e 100-vjetorit të Luftës së parë botërore - vetëm disa që u selektuan nga numri prej rreth 15000 sosh.

Ka edhe disa fonde të tjera në Arkivat e Kosovës, që përmbajnë dokumente që lidhen me Luftën e parë botërore.

3.

Ministria e Punëve të Jashtme, e Serbisë – Korrespondenca sekrete, Nr. I inv. 464,465 dhe 466 vitet 1913-1915 një Kuti arkivore;

Ministria e Punëve të Jashtme e Malit të Zinr. Nr i inv.178.BI dhe Sig. VII/2 (1-4) vitet 1883-1915 dhe 1900-1915 (shkresa, telegrame, raporte, letra private për ngjarjet në Kosovë e Mal të Zi, sidomos për viset shqiptare Tuz, Vuthaj, Ulqin, për Lidhjen e Pejës,

telegrame nga Berlina Andrijeviç, Podgorica, lidhur me situatën në Turqinë Evropiane, kryengritjet shqiptare etj),

Arkivat në Austri - Arkivi shtetëror dhe ai Oborrit mbretëror, nr. Inv.167/3 bl, vitet 1869-1912 /Raporte konsullore dhe të tjera nga Prizreni, Mitrovica, Vjena, Durrësi, Manastiri, Shkupi, Vlora, Beogradi, Zara, Dubrovniku, Shkodra e Janina/.

Pastaj fonde e koleksione personale të Jovan Jovanović - Pizhonit f. Nr. 30;

Koleksioni i kronikave, dokumenti nr. 33;

Koleksioni - Memoare për Gjimnazin bullgar në Prishtinë, viti 1916;

Marrja nga bullgarët i dorëshkrimeve nga Manastiri i Çagllavicës;

Koleksioni Varia "L'indipendence Albanaise" Sofie, 1915 - 1916, dok. Nr.36

Në Arkivin e Kosovës, në një koleksion të veçantë ruhet një studim në 64 faqe, i bërë gjatë Luftës së Parë Botërore, me titull: "Hyrja e ushtrisë bullgare në Prizren" - 16 nëntor 1915, i cili ka të bëjë kryesisht me sjelljen e ushtrisë bullgare ndaj popullatës vendëse.

Ka edhe fonde të tjera të shumta nga arkivat e Turqisë, prej disa vendeve të ish Federatës Jugosllave etj.

Gjithë këto fonde dhe dokumente mund të përdoren e shfrytëzohen nga të interesuarit, individë, institucione ose qarqe hulumtuese, shkencore e studimore, pra janë të qasshme. Dhe, ne në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës vlerësojmë se dokumentet e mbyllura e që nuk mund të përdoren, nuk kanë vlerë.

Ju faleminderit!

PROTESTAT E SHQIPTARËVE, DËRGUAR KONFERENCËS SË VERSAJËS

KDU 94(4/9)“19”
327(4/9)“19”

Të dhënat, dokumentet dhe dëshmitë e përfshira në këtë kumtesë, pasqyrojnë një pjesë të protestave të popullit shqiptar e të grupimeve të ndryshme politike dhe patriotike për mbrojtjen e të drejtave të nëpërkëmbura nga fuqitë fituese të Luftës së Parë Botërore. Ato i janë drejtuar Konferencës së Paqes në Paris në të cilën populli shqiptar dhe përfaqësuesit e tij shpresonin t’i realizonin aspiratat e tij kombëtare.

Delegacioni shqiptar, që në fillim të Paqes së Versajës, u ndesh me vështirësi tejet të mëdha, duke u ndodhur përballë kërcënimeve të integritetit tokësor shqiptar, të cilat vinin sidomos nga politika zyrtare e Greqisë, së cilës në këtë Konferencë i printe kryetari Venizellos. Kërkesat e delegacionit grek në dëm të shqiptarëve i mbështeste edhe Lidhja Anglo-Helene, e formuar në vitin 1913, Shoqëria Amerikano-Helene, e formuar gjatë vitit 1917, si dhe Lidhja Panamerikane- Epirote, që vepronte në shumë vende të SHBA-së. Në anën tjetër, delegacionin shqiptar e ndihmuan përfaqësuesit e Shoqërisë Panshqiptare “Vatra” dhe Shoqëria Anglo-Shqiptare e formuar në Londër në vitin 1918.¹

Rreth fuqive të Antantës vërtiteshin shtetet më të vogla, të cilat synonin realizimin e premtimeve që u ishin bërë si shpërblim për aleancën gjatë luftës, kurse fuqive të mundura s’u kishte mbetur gjë tjetër veçse t’i prisnin vendimet e Versajës.²

Delegacioni shqiptar, përveç prezantimit zyrtar në këshillin e të Dhjetëve të Konferencës së Paqes, ia ka paraqitur kërkesat e drejta të shqiptarëve në një seri memorandumesh dhe protestash në mbrojtje të tërësisë territoriale shqiptare.

Kronologjia e memorandumëve të para në mbrojtje të çështjes shqiptare, të paraqitura nga shqiptarët, filloi me memorandumin e 28 tetorit 1918, sjellë nga Mihal Tortulli, i cili ua dorëzoi tri kopje të memorandumit së bashku me kërkesën për t’u pritur me një koleg të tij në Londër, për të bërë një ekspozitë të çështjes shqiptare, si delegat i shoqërisë “Vatra”.³

¹ Masar Kodra, Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane (1918-1945), Logos-A, Shkup, 1997, fq. 35.

² Lush Culaj, Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1918-1924, Prishtinë 1997, 48.

³ Romeo Gurakuqi, Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore,

Memorandumi tejet i argumentuar me fakte, është nënshkruar nga Fan S. Noli, Naun V. Ciri, Damiani C. Angjeli, Mark J. Kondili, Pando Sinitza, Vangel Chamche. Mirëpo, këto nuk kanë qenë memorandumet e vetme. Në Somerset Record Office gjenden edhe dy memorandumet e tjera. Memorandumi i parë i drejtohet Konferencës së Kombeve të Varura në Uashington, ndërsa tjetri i dërgohet Lloyd George, kryeministër i Mbretërisë së Bashkuar.

Më 27 nëntor 1918 klerikët më të lartë të Kishës Ortodokse Shqiptare në shtetin Massachuset në SHBA, i kanë dërguar një memorandum Arthur J. Balfour-it, sekretarit të Shtetit për Punët e Jashtme të Britanisë së Madhe.⁴

Delegacioni qeveritar shqiptar, duke ia paraqitur Konferencës kërkesat serbe për të dalë në det si të padrejta, pastaj si jorealiste, edhe pretendimet greke sipas të cilave të gjithë ortodoksët konsideroheshin grekë, hartën gjeografike të kufirit etnik shqiptar, përbërjen e popullsisë shqiptare dhe mjaft argumente të tjera bindëse theksohet: “Nuk po kërkojmë kurrëgjë që s’asht shqiptare, po kërkojmë me u ba të zotët e vendeve shqiptare, me vetësinë e tanësinë tokësore të Shqipërisë e respektimin e të drejtave sovrane të popullit shqiptar.”⁵

Edhe para fillimit të Konferencës së Paqes, më 18 dhjetor 1918, Hasan Prishtina i drejtohet presidentit amerikan, Vilson, në Paris, ku kërkon mbrojtjen e të drejtave të popullit shqiptar në Konferencën e Paqes.⁶

Me 5 janar 1919 kemi protestën e një grupi qytetarësh shkodran drejtuar konferencës së Paqes, ku përgënjeshtrohen shpifjet se gjoja krahina e Shkodrës dëshiron të bashkohet me sllavët dhe betohen se do të luftojnë për një Shqipëri të bashkuar e të lirë.⁷

Më 10 janar 1919 i dërgohet letër e Turhan Pashës, dërguar S. Soninos, me anën e së cilës kërkonte ndërhyrjen e tij për përfaqësimin e Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris, ku, ndër të tjera, theksohej: “Kërkesa jonë është më tepër se e ligjshme, sepse përderisa disa shtete të krijuara rishtas do të marrin pjesë në këtë konferencë. Shqipëria që është shpallur dhe njohur si e pavarur qysh prej gjashtë vjetësh ka më tepër të

Shkodër, 2007, fq.32.

⁴ Po aty.

⁵ Po aty, 12.

⁶ Hasan Prishtina, *Dokumente*, Tiranë 1983, dok. nr. 57, 99-100.

⁷ Rolanda Ziu, Protesta të popullit shqiptar drejtuar Konferencës së Paqes më 1919 në mbrojtje të të drejtave kombëtare, në revistën Arkivi shqiptar viti 1, nr. 1, 1999, Tiranë, 1999, fq. 75.

drejtë se ata të pranohet në këtë konferencë, në mënyrë që të mund të mbrojtë të drejtat e saj kundër synimeve të fqinjëve të vet të pangopur dhe të kërkojë përcaktimin e kufijve të saktë sipas parimit të kombësive, gjë që, mjerisht, nuk u bë në Konferencën e Londrës të viteve 1912-13.”⁸

Ndërkaq, Bajram Curri në një letër dërguar kryetarit të Konferencës së Paqes, Zh. Klemansosë, nga Vjena më 19 shkurt 1919, në emër të komitetit kombëtar shqiptar “Kosova”, proteston energjikisht kundër metodave mizore dhe barbare të autoriteteve ushtarake e civile serbe në Kosovë dhe kërkon që popullit shqiptar të Kosovës t’i mundësohet shprehja e lirë e aspiratave të tij kombëtare sipas parimeve demokratike.⁹

Këto protesta morën përmasa të gjera dhe u bënë nga të gjitha anët e vendit e veçanërisht ato u shtuan gjatë muajit mars të vitit 1919, kur me ndihmën e Qeverisë së Beogradit, Esat Toptani, u paraqit në Paris haptas si vegël e fqinjëve. Miqtë e Shqipërisë jashtë vendit bënë përpjekje të mëdha për ta ndihmuar Shqipërinë. Një grup prej mbështetësve të Shqipërisë u pajtuan që të caktohej si ndërmjetës një aristokrat me mjaft ndikim hungarez, për të lobuar tek amerikanët, por pa ndonjë sukses të veçantë.

Një aktivitet tejet të madh zhvilloi Federata Panshqiptare “Vatra”, e cila angazhoi një misionar amerikan (Telford Erickson) në mbrojtje të çështjes shqiptare, por edhe ky, me gjithë përpjekjet e mëdha, nuk pati një rezultat të rëndësishëm. Një mbështetje të veçantë e zhvilloi Shoqëria Anglo-Shqiptare, e veçanërisht kryetari i saj Aubrey Herbert, djali më i ri i një familje të madhe aristokrate britanike. Ai kishte kaluar një pjesë të kohës së tij para luftës duke udhëtuar nëpër Perandorinë Otomane. Ai fliste disa gjuhë në mënyrë të rrjedhshme, përfshirë gjuhën turke dhe shqipe, e në të njëjtën kohë ishte edhe agjent i papaguar i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar.

Shqiptarët, madje, i ofruan atij fronin e Shqipërisë, të cilin ai e refuzoi atë, por krijoi shoqërinë e lartpërmendur, ndërmjet së cilës punoi për pavarësinë e Shqipërisë, ndërsa Edith Durhami ka qenë sekretare e kësaj shoqërie.¹⁰

⁸ Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920, përmbledhje dokumentash I, Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Historisë, Drejtoria e përgjithshme e Arkivave të shtetit të RPSH, Tiranë 1975, fq. 81.

⁹ *Përmbledhje dokumentash 1918-1920*, vëllimi i parë, Tiranë, 1975, dok. nr. 68, 125.

¹⁰ Romeo Gurakuqi, vep. cit., fq. 49.

Më 7 dhe 11 mars 1919, delegacioni qeveritar shqiptar në Paris, ia dërgoi dy memorandume të tjera kryetarit të Konferencës, meqenëse ndodhën ngjarje të reja gjatë atyre muajve. Në ato memorandume delegacioni shqiptar protestoi ashpër kundër masakrimit të popullsisë shqiptare nga serbo-malazezët, duke kërkuar që, në bazë të programit të 14 pikave të presidentit Vilson dhe të parimit të së drejtës për vetëvendosje të kombeve, populli shqiptar në Jugosllavi të përcaktohet lirisht për fatin dhe të ardhmen e vet.¹¹ Konferencës së Paqes, me protesta iu drejtuan edhe populli i pakënaqur. Kështu, banorët e Kavajës, më 12 mars 1919, shprehin indinjatë të thellë ndaj tradhtisë së Esat Toptanit dhe kundër atyre shteteve që lakmonin copëtimin e trojeve shqiptare, njëkohësisht duke kërkuar përgjegjësinë nga Fuqitë e Mëdha, në qoftë se bëhet ndonjë ngatërresë ose gjakderdhje.¹²

Në memorandumun e 7 marsit 1919 theksohet se, në qoftë se argumentet që kemi shtruar para kësaj konference nuk janë bindëse për të drejtën tonë, atëherë i lutemi Konferencës që ta autorizojë Qeverinë e SHBA-së për t'i shkelur dhe administruar një ose dy vjet këto treva, me qëllim të organizimit të plebshitit.¹³

Përmes këtij plebishiti, theksohej më tutje në memorandum, e tërë popullata e këtyre trevave do të mund të përcaktohet lirisht dhe pa kurrfarë presioni mbi vullnetin e vërtetë të tyre. Në protestën kundër Traktatit të Fshehtë të Londrës të vitit 1915 dërguar më 17 mars, z. Klemanso, e të nënshkruar nga kryetari i Dërgatës shqiptare, Turhan Pasha, theksohej: Ndonëse qëllimet fisnike me të cilat konferenca ka nisur punimin e vet e parimet bujare që ajo kishte marrë për themel s' duhej "t'u jepeshin lakmive e dëshirave për pushtimin e askujt, po e shohim, megjithëkëtë, se shtetet fqinje të Shqipërisë, duke mos u kënaqur me tanësinë e tyre kombëtare po pretendojnë të për drejta të tjera mbi vendin tonë."¹⁴

Më 12 mars të vitit 1919 kemi protestën e qytetarëve të Peqinit dërguar Ministrisë së Brendshme për Konferencën e Paqes, kundër pretendimeve serbe dhe greke ndaj Kosovës, Manastirit e Janinës.¹⁵ Një ditë më vonë pason një protestë e fuqishme nga qytetarët e krahinës së

¹¹ Paskal Milo, *vep.cit.*, 100-101: Haris Silajdžić - *Stav Sjedinjenih Americkih drzava prema Albaniji 1912-1939*, tezë doktore, Prishtinë, 1980, 134.

¹² Dokumente dhe materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri dhe demokraci, 1917-1941, Tiranë 1959, dok. nr. 4. f. 3.

¹³ *Shqipëria para Konferencës së Paqes*, ble i parë, 41-42.

¹⁴ *Po aty*, 45.

¹⁵ Rolanda Ziu, *pun. i cit.*, fq.81.

Matit dërguar kryetarit të delegacionit në Paris, ku kërkohej largimi i forcave pushtuese serbe nga viset shqiptare dhe protestohej për mizoritë e tyre.¹⁶

Përmes një proteste edhe populli i Elbasanit, dërguar Turhan pashës në Paris, kundër pretendimeve greke dhe serbe si dhe kundër çdo marrëveshjeje tjetër ndërmjet shteteve të huaja për copëtimin e Shqipërisë, të datës 16 mars 1919, ndër të tjera, theksohej se “populli i Elbasanit mori vesh me zemërim të madh se Greqia, Serbia dhe Mali i Zi shtrojnë të drejta mbi Shkodrën, Dibrën, Lumen, Starovën, Korçën dhe Gjirokastrën, tue u mbështetë mbi lidhje të mëshefta që paskeshin ba me Esat Pashën. Populli i Elbasanit proteston me za të naltë kundër kësaj tradhtie, që dëftohet me gojë, të bame për dam të atdheut nga pasha i Tiranës. Pra i lutet Shkelqësisë Suej me i ba me ditë Konferencës së Paqes se Esati, i cili nuk ka përfaqësue as nuk përfaqëson ndonjë pushtet zyrtar të shtetit shqiptar, nuk mundet në kurrfarë mënyre me pas leje e të drejtë të lidh traktate në emën të Shqipërisë e tu lëshojë tokë shqiptare shteteve të hueja.”¹⁷ Në letra telegrame dhe memorandumë të ndryshme natyrisht që kishte edhe qëndrime dhe pikëpamje të ndryshme që jepeshin. Kështu, më 20 mars 1919, e kemi një telegram dërguar nga Gjirokastra nga Myfit Libohova etj. kryetarit të delegacionit qeveritar shqiptar në Paris, Turhan pashë Permetit, ku pranohej vendosja e Shqipërisë së Jugut në një sistem të veçantë administrativ nën mbrojtjen e Italisë.¹⁸

Po më 20 mars 1919 organizohet një protestë nga populli i Beratit kundër planeve antikombëtare të Esat Pashës dhe të tjerëve në dëm të tërësisë tokësore të shtetit shqiptar dhe pavarësisë së tij, ku, ndër të tjera, theksohej: “Shqipëria është e shqiptarëve dhe për fatin e saj kanë të drejtë të flasin ata bij të vërtetë që nuk e tradhtojnë, nuk e shesin, nuk e bëjnë vegël për interesat e tyre, kanë kompetencë për të folur ato fytyra që nuk shkelin idealin kombëtar, nuk kërkojnë copëtimin e Arbënisë nuk falin copërat e zemrat shqiptare, nuk japin premtime për robëri e për hije.”¹⁹

Më 28 mars 1919, Kolë Tromara, në cilësinë e Presidentit të Federatës Panshqiptare të Amerikës “Vatra” i drejtoi një telegram të gjatë, me ndërmjetësinë e Mehmet Konicës, kryeministrit britanik, Lloyd George. Telegrami u pasqyrore në mënyrë të qartë delegatëve të Fuqive të Mëdha rezolutën e aprovuar nga Këshilli i Kishës Ortodokse Shqiptare

¹⁶ Po aty, fq. 82.

¹⁷ Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920, vep. cit., fq. 139.

¹⁸ Po aty, fq. 142.

¹⁹ Po aty, fq. 143.

të Amerikës, duke apeluar për rivendosjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe bashkimin e të gjithë shqiptarëve të të gjitha besimeve fetare nën një qeveri kombëtare në kufijtë etnikë të Shqipërisë, përfshirë edhe krahinat e Çamërisë dhe Kosovës.²⁰

Më 29 mars 1919 nga Korça kemi thirrjen e qytetarëve të saj, dërguar z. Llojd Georges në Konferencën e Paqes, ku e njoftonte për rrezikun e pushtimit të Korçës nga Greqia pas largimit të trupave franceze.²¹ Me një letër proteste, presidentit Wilson, i drejtohen edhe gratë e Korçës më 30 mars 1919, ku kërkohej shpëtimi i Korçës nga pushtimi grek.²²

Letra dhe telegrame protestuese u dërguan edhe nga mërgata shqiptare. Letra e përfaqësuesve të kolonive shqiptare të Turqisë, të Rumanisë dhe të Amerikës, dërguar Turhan Pashë Përmetit, më 18 prill 1919, me anë të së cilës kërkonin të bëhej një mbledhje për të biseduar problemet kombëtare ndër të tjera theksonte: “Ne, të nënshkruarit, delegatët e kolonive shqiptare të Turqisë, të Rumanisë e të Amerikës, kemi nderin t’ju lutemi zotërisë suaj që të keni mirësinë e të na caktoni vendin dhe orën për të bërë një mbledhja nesër nën kryesinë e Shkëlqesisë Suaj bashkë me shokët e tjerë të qeverisë, ku do të bisedohej çështja kombëtare.”²³ Megjithatë, kundërthënie në mendime në mes delegatëve shqiptarë në Paris ekzistonin. Këtë e dëshmon edhe letra e P. Evangjelit, e datës 19 prill 1919, dërguar sekretarit të kolonisë shqiptare të Rumanisë, Aleksandër Stavre Drenovës-Asdrenit, ku e njoftonte për divergjencat midis delegatëve shqiptarë në Paris, dhe për veprimtarinë e tyre politike, ku, ndër të tjera, theksonte: “Të lutem të thërrasësh zotërinjtë këshilltarë dhe t’ua lexosh sa vijon që të mësojnë mbi gjendjen tonë dhe mbi çështjen tonë deri në këtë çast. Megjithëse ne, delegatët e kolonive nga vende të ndryshme, kemi insistuar dhe insistojmë vazhdimisht që të arrijnë bashkimin midis anëtarëve të qeverisë së përkohshme, deri tani kemi mundur ta arrijmë. Si njëri grup edhe tjetri punojnë të veçuar. Pikëpamja e të gjithëve është pothuajse e njëjtë, mandati për të mbrojtur efektivisht Shqipërinë në hapat e saj të parë.”²⁴

Edhe vendimi i kolonisë shqiptare të Turqisë nga Stambolli, i datës 28 prill 1919, për dërgimin e Sylejman Delvinës në Paris, për të ndihmuar në sheshimin e divergjencave që ekzistonin ndërmjet anëtarëve

²⁰ Romeo Gurakuqi, vep. cit, fq. 50.

²¹ Rolanda Ziu, vep. cit, fq. 83.

²² Po aty, fq. 84.

²³ Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920, vep.cit, fq. 173.

²⁴ Po aty.

të delegacionit shqiptar lidhur me çështjen kombëtare, flet për përpjekjet e pareshtura për krijimin e një uniteti mbarëshqiptar në rrethanat e pafavorshme për çështjen shqiptare.²⁵

Ndërkaq, më 21 prill 1919, nga Lozana kemi protestën e përfaqësuesve të komiteteve kombëtare shqiptare të SHBA-së, Kanadasë dhe Zvicrës, dërguar kryesisht së konferencës së Paqes, kundër pretendimeve të padrejta të Italisë për ankesimin e Vlorës.²⁶

Kurse, më 4 prill 1919, Dërgata shqiptare në Konferencën e Paqes e informon kryetarin e Konferencës, z. Klemanso se Esat Pashë Toptani nuk ka mandat për ta përfaqësuar Shqipërinë në Konferencën e Paqes e as gjetiu.²⁷

Duke i hedhur poshtë akuzat e kundërshtarëve se si shqiptarët po përpiqeshin ta ndërtonin një Turqi të vogël në Evropë, delegacioni qeveritar shqiptar ia paraqet Konferencës së Paqes, më 14 prill 1919, kushtet sipas të cilave do ta pranonte kujdesin e njëjës nga fuqitë e mëdha, për të dhënë prova se duam ta ngenë një shtet përparimtar e të bazuar në parimet e lirisë, barazisë, vëllazërisë dhe të drejtësisë.²⁸

Kur Dërgata e Qeverisë së përkohshme shqiptare u informua përmes shtypit se kryetari i SHBA-së kishte kërkuar nga Italia që ta mbante limanin e Vlorës për vete, më 8 maj 1919, i drejtohet këtij kryetari me protestë kundër qëndrimit të tij, duke shpresuar se ky apostull nuk do të largohej nga parimet e tij fisnike dhe bujare.²⁹

Delegacioni i Qeverisë së Durrësit u përpoq të realizonte marrëveshje edhe me jugosllavët. Mihajl Turtulli bisedoi me N. Pashiqin, kurse M. Konica me ministrin e Jashtëm të Beogradit Trumbiqin, por pa asnjë sukses, sepse, siç shprehej Trumbiqi: “Derisa Esad Pasha t’u rrijë lidhjeve që ka me Serbinë, delegatët jugosllavë nuk mund të merren vesh me shqiptarët e tjerë.”³⁰

Edhe Komiteti shqiptar i Lozanës i dërgon letër Konferencës së Paqes, në të cilën hidheshin poshtë qëllimet pushtuese që cenonin tërësinë tokësore të Shqipërisë³¹, ndërsa më 24 prill 1919, Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, në një letër dërguar parisë në Kosovë,

²⁵ Po aty, fq. 183.

²⁶ Po aty, fq. 176.

²⁷ Po aty, 47.

²⁸ Po aty, 49.

²⁹ Po aty, 49.

³⁰ Paskal Milo, *vep.cit.* 101.

³¹ *Përmbledhje dokumentesh 1918-1920*, vëll. i parë, dok. nr.101, fq. 160-161.

informon lidhur me pozitën e Shqipërisë në Konferencën e Paqes, duke mbështetur shpresat se presidenti Vilson dhe SHBA-ja do të angazhoheshin për mbrojtjen e çështjes shqiptare.³²

Më 6 maj 1919, Komiteti i drejtohet me një letër presidentit Vilson për mbrojtjen e Shqipërisë në Versajë, duke i dërguar statistika dhe raporte tronditëse mbi gjendjen në Kosovë.³³ Pastaj, po përmes të dhënave dhe statistikave, për mizoritë serbe mbi popullin shqiptar informohet edhe papa në Romë.³⁴

Letra e përfaqësuesve të Pogradecit, dërguar kryetarit të delegacionit qeveritar shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, me anën e së cilës denonconim veprimtarinë armiqësore të kryer atje nga shovinistët serbë dhe shprehnin vendosmërinë e tyre për të mbrojtur vendin, mban datën e 8 majit 1919.³⁵

Më 9 maj 1919, kemi një letër nga Lozana, të një grupi patriotësh, përfaqësues të shoqërive shqiptare jashtë shtetit, drejtuar anëtarëve të Dërgatës shqiptare në Paris, Gj. Fishta, L. Gurakuqi, M. Kruja, ku i falënderojnë për misionin e tyre në mbrojtje të Vlorës dhe të çështjes kombëtare.³⁶

Në protestat kundër mandatit italian në Shqipëri, dërguar më 1 qershor 1919 nga delegacioni i Qeverisë së përkohshme të Durrësit, theksohet se populli shqiptar nuk do të mund t'i pranojë vendimet që ishin në dëm të tërësisë tokësore dhe të mëvetësisë së tij.³⁷ Më 3 qershor 1919, ky delegacion, e informon kryetarin e Konferencës së Paqes lidhur me masakrat jugosllave në Shqipërinë Veriore, me ç'rast i dërgohet edhe lista e masakrimeve të Rugovës, e mbledhur nga Komiteti i Kosovës në Shkodër.³⁸

Më 24 qershor e kemi letrën e M. Turtullit, drejtuar kryeministrit të Francës, Zh. Klemanso, me anën e së cilës kërkonte të hidheshin poshtë pretendimet e shteteve fqinje në dëm të tërësisë tokësore dhe të pavarësisë politike të shtetit shqiptar.³⁹ Kurse letra e grupit të shqiptarëve të Lozanës, dërguar kryesisë së Këshillit të Ministrave në Romë, me anën e së cilës ftonte Qeverinë italiane të ndryshonte politikën e saj ndaj

³² Arkivi Qendror Shtetëror-Tiranë – AQSH fondi 846 dosja 12.

³³ AQSH fondi 826 dosja 28/3. dok. nr. 708. 102. 59.

³⁴ AQSH fondi 846 dosja 33/2 dok. nr. 708. 167, 70.

³⁵ Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar I 1918-1920 fq. 203.

³⁶ Rolanda Ziu, pun. cit., fq. 87-88.

³⁷ *Shqipëria përpara Konferencës së Paqes*, ble i parë, 59.

³⁸ *Po aty*, 61.

³⁹ Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920, vep. cit., fq. 229.

Shqipërisë dhe t'i mbronte të drejtat kombëtare shqiptare në Konferencën e Paqes, mbante datën e 25 qershorit 1919.⁴⁰

Protestat e popullit shqiptar nga të gjitha trevat ishin të pandërprera. “Si diplomat i urtë, duke e njohur mirë pozicionin e Shqipërisë, Turhan Pasha e kuptoi se për të pasur shanse fitimi, ishte më e udhës që para kancelarive evropiane të paraqitej një prelat katolik si Luigj Bumçi sesa një ish-ambasador i Turqisë së vjetër në Peterburg⁴¹, theksonte Atë Pal Dodaj në shënimet e tij. Lidhur me këtë çështje nga Parisi udhëheqësi i ri i delegacionit shqiptar, Luigj Bumçi, më 26 qershor 1919, e informon qeverinë e përkohshme.

Më 1 korrik 1919, përfaqësuesit e Qeverisë se përkohshme në Paris, i drejtohen me një letër kryetarit të delegacionit Italian, T. Titoni, në Konferencën e Paqes, ku kërkojnë nga shteti i tij që ta respektojë pavarësinë e shtetit shqiptar dhe t'ua heqë fqinjëve të tjerë pretendimet e tilla⁴², ndërsa një ditë më vonë, përmes një letre, Titonit iu drejtua edhe udhëheqësi i delegacionit qeveritar shqiptar, Luigj Bumçi.

Më 27 qershor 1919, Luigj Bumçi, Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, ia dërguan nga Parisi episkopit katolik në Shkodër një telegram në të cilin thuhej: “Jugosllavët po i shumëfishojnë përpjekjet e tyre pranë Konferencës për të aneksuar Shkodrën, bregun e djathtë të Drinit, Lezhën e Mirditën. Prandaj, është tepër e rëndësishme që me shpejtësi t'i sillët Konferencës nga ana e klerit katolik një protestë energjike kundër pretendimeve të tilla, duke deklaruar se elementi katolik shqiptar dëshiron të qëndrojë në kuadër të Shqipërisë së pavarur.”⁴³

Menjëherë, më 4 korrik, përfaqësuesit e krahinave të Shkodrës iu drejtuan Konferencës së Paqes, duke deklaruar se Shkodra dhe Vlora janë dhe do të mbeteshin pikëmbështetje të pandara të atdheut. Po më 4 korrik kemi letrën e popullit katolik të Dioqezës së Pultit, dërguar konferencës së Paqes, ku protestohet kundër pushtimit të Shkodrës, Lezhës e Mirditës nga jugosllavët dhe theksohej se interesi i kombit dhe i besimit e do që këto krahina të jenë pjesë e pandarë e Shqipërisë së pavarur.⁴⁴

Ndërkaq, Luigj Gurakuqi, në një letër dërguar Mihail Gramenos nga Parisi, më 7 gusht 1919, e njoftonte rreth qëndrimit të delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes dhe shfaqte mendimin e tij mbi të

⁴⁰ Po aty, fq. 230.

⁴¹ Aurel Plasari, *Vija e Teodosit rishfaqet* - Nga do t'ia mbajnë shqiptarët? Tiranë, 1992, 29.

⁴² *Përmbledhje dokumentash 1918-1920 I*, dok. Nr.168, 248.

⁴³ *Po aty*, dok. nr.172, 256.

⁴⁴ Rolanda Ziu, vep. cit., fq. 89.

ardhmen e Shqipërisë, duke theksuar: “E dini mirë se mua më është mbushur mendja se sot e mbrapa kemi detyrë t’ua themi të drejtën shqiptarëve e të mos i ushqejmë me shpresa të tepërme, as të mos i gënjejmë mbi gjendjen e vërtetë të punëve të Shqipërisë. E dini se shqiptarëve nuk u pëlqen e drejta dhe e vërteta, kur është e hidhur, e se e shikojnë për armik atë që guxon e ua thotë, por unë nuk trembem për këtë; ata që do të më shajnë sot, do të më japin të drejtë nesër.”⁴⁵ Siç shihet, këtu vërehet një pesimizëm i Gurakuqit lidhur me të ardhmen e Shqipërisë dhe kufijtë e saj.

Në këto rrethana të tendosura, me ç’rast kërkohej që Korça t’i kalonte Greqisë, më 10 gusht 1919, përfaqësuesit e këtij qyteti i dërgojnë protestë Konferencës së Paqes, në të cilën e shprehin dëshirën e zjarrtë të popullit për mosshkëputje nga Shqipëria.⁴⁶

Më 11 gusht 1919 e kemi protestën e popullit të Krujës, dërguar qeverisë së përkohshme të Durrësit për t’ia përcjellë Konferencës së Paqes, ku kërkohet bashkimi i Kosovës dhe i Çamërisë me Shqipërinë.⁴⁷

Gjithashtu, Dërgata shqiptare në Paris, nën udhëheqjen e Luigj Bumçit, ipeshkëv i Lezhës, më 14 gusht 1919, i drejtohet z. Klemansosë, duke e kundërshtuar marrëveshjen ndërmjet Italisë dhe Greqisë në dëm të shqiptarëve dhe duke theksuar se ky veprim është në kundërshtim me parimin e popujve të vegjël, nisur dhe me parimet e kryetarit Vilson e të përfaqësuesve të pushteteve të mëdha besëlidhëse.⁴⁸

Edhe Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, më 4 shtator 1919, i drejtohet delegacionit të SHBA-së në Konferencën e Paqes, ku paraqitet vendosmëria e korçarëve dhe e mbarë popullit shqiptar për të luftuar kundër pushtuesve grekë, duke ua përkujtuar edhe shteteve të tjera të Antantës se “numri i dëshmorëve që dha Korça për ta siguruar çlirimin e saj është më i madh sesa numri i të vrarëve të Greqisë, e cila hyri në luftë në pragun e fitores.”⁴⁹ Kryetari i Dërgatës shqiptare në Paris, Luigj Bumçi, më 10 shtator 1919, përmes një letre kërkon nga kryetari i

⁴⁵ *Përmbledhje dokumentash 1918-1920 I*. dok. nr. 201,300.

⁴⁶ *Po aty*, dok. nr. 203,302.

⁴⁷ Rolanda Ziu, pun. cit., fq. 94-95.

⁴⁸ *Shqipëria para Konferencës së Paqes*, ble i dytë - dokumente zyrtare të paraqitura nga ana e dërgatës shqiptare qysh prej 24 korrikut 1919 e deri më 11 shkurt 1920 e të botuara nga ana e Qeverisë shqiptare, Shtypshkronja Françeskane në Shkodër 1921, 15-16, përkthyer nga Luigj Gurakuqi.

⁴⁹ AQSH fondi 846, dosja 28/2 përkthimi nga frëngjishtja - Greqia hyri zyrtarisht në luftë në verë të vitit 1917, pasi mbreti Konstantin u detyrua të abdikojë nga fuqitë e Antantës, nga Anglia dhe Franca që e përkrahnin Venizelosin.

Konferencës së Paqes që të ndikojë te Qeveria Jugosllave që të mbroheshin të drejtat e shqiptarëve brenda këtij shteti.⁵⁰ Në mbledhjen e përbashkët të delegacioneve shqiptare në Konferencën e Paqes, më 7 tetor 1919, rreth përmbajtjes së notës që do t'i dërgohej konferencës për çështjen e pranimit ose të mospranimit të “asistencës” italiane, z. Gurakuqi, ndër të tjera, e shpreh mendimin se duhej protestuar patjetër, pavarësisht se mendonte që Konferenca vështirë se do t'i miratonte kërkesat e tyre.⁵¹ Me një letër Konferencës së Paqes, më 8 tetor 1919, iu drejtuan edhe përfaqësuesit e kolonisë shqiptare të Turqisë, që kryekëput kërkonin nga Konferenca mospranimin e “asistencës” italiane mbi shtetin shqiptar.⁵²

Përsëri, më 9 tetor 1919, kryetari i Dërgatës, Luigj Bumçi, i drejtohet kryetarit të Konferencës, duke theksuar se populli shqiptar nuk do të pranonte assesi që Vlora t'i jepej Italisë dhe jugu i Shqipërisë t'i jepej Greqisë.⁵³

Qeveria shqiptare, përmes Luigj Bumçit, më 9 tetor 1919 i dërgoi sekretariatit të përgjithshëm të Konferencës së Paqes një notë proteste, në të cilën protestohej kundër atributit të Italisë dhe mandatit mbi Shqipërinë.⁵⁴

Rol tejet të vështirë, delegacioni shqiptar në Paris, pati edhe për mbrojtjen e qytetit të Shkodrës nga pretendimet jugosllave. Si argument për mbrojtjen e këtij qyteti, delegacioni shqiptar, më 8 nëntor 1919, e paraqiste mendimin e ministrit anglez, Eduard Grei, në dhomë të bashkësive më 7 mars 1913: “Luftimet, që vijnë kundër Shkodrës e kanë humbur prej shumë kohësh arsyen e vet. Këtej e tutje nuk e kanë efektin e luftës ndërmjet Turqisë e të besëlidhurve dhe nuk mund të quhet një luftë çlirimtare. Veprimet ushtarake të Malit të Zi kundër Shkodrës sot e mbrapa do të njihen si pjesë e një lufte që ka për qëllim pushtimin e tokave të huaja. Asnjë arsye s'mund të na shtrëngojë pra që të gjitha ato simpati, që kishim për Malin e Zi e për pjesët e tjera që luftonin për liri e mëvetësinë e vet, të mos i kemi sot edhe për popullin shqiptar të krahinës së Shkodrës, të përbërë në shumicë të madhe prej katolikësh e muhamedanësh, të cilët luftojnë për atdheun e vet, për fenë e vet, për

⁵⁰ *Shqipëria përpara Konferencës së Paqes*, ble i dytë, 19-21.

⁵¹ *Përmbledhje dokumentesh 1918-1920* I dok. nr. 272-419-423.

⁵² *Po aty*, dok. nr. 273-423-424.

⁵³ *Shqipëria para Konferencës së Paqes*, ble i dytë, 23-24-përmbledhje dokumentesh dok. 1918-1920 I dok. nr. 274-425-426.

⁵⁴ Romeo Gurakuqi, vep. cit., fq. 67.

gjuhën e vet, për të qenët e vet.”⁵⁵ Protesta mbi mbrojtjen e qytetit të Shkodrës kishte edhe nga përfaqësuesit e Shkodrës me të gjitha rrethet si dhe nga mbarë populli shqiptar.

Më 4 nëntor 1919, kemi protestën e bajraktarëve të krahinës së Oroshit të Mirditës, dërguar delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes, ku kundërshtoheshin pretendimet e Serbisë për aneksimin e kësaj krahine.⁵⁶

Kundër marrëveshjes italo-greke, që parashikonte copëtimin e Shqipërisë, u deklarua edhe populli i Beratit përmes një proteste dërguar kryetarit të SHBA-së, më 1 dhjetor 1919.⁵⁷ Më 9 dhjetor 1919 përfaqësuesit e Anglisë, Francës dhe SHBA-së ia njohin Italisë sovranitetin e plotë mbi Vlorën dhe krahinën e saj. Diktuar nga rrethanat e krijuara në një mbledhje urgjente, Dërgata shqiptare i lutet imzot Bumçit të nisej për në Romë e të kërkonte ndihmën e Papë Benediktit XV. Kështu, me të arritur në Romë, më 12 dhjetor 1919, pas tri-katër ditësh, takohet me Papën, i cili i premtonte Luigj Bumçit se do të përpiqej ta mbronte çështjen e drejtë shqiptare përmes ndikimit të tij në Qeveritë e SHBA-së dhe të Anglisë.⁵⁸

Ndërkaq, Hasan Prishtina, në një telegram dërguar Sotir Kolesë, më 7 janar 1920, nga Vjena kërkon që ta informojë Konferencën e Paqes mbi masakrat e fundit të serbëve ndaj shqiptarëve.⁵⁹ Më 12 janar në vazhden e shumë protestave e kemi edhe një protestë të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, drejtuar kryesisht së Konferencës së Paqes, kundër planeve të saj për copëtimin e Shqipërisë, ku ndër të tjera theksohej: “Me hidhërim po ndëgjojmë se shtetet e mëdha, për të siguruar interesat politike të Italisë, dashkan të vendosin që si kompensim për Fiumen t’i jepet Jugosllavisë Shkodra dhe të zbatohen klauzolat e Traktatit të Londrës të vitit 1915 mbi Shqipërinë. Të kompensosh Fiumen me pjesë nga toka e Shqipërisë do të thotë të marrësh nëpër këmbë të drejtat e një kombi nga më të vjetrit në Ballkan. Prandaj protestojmë fuqishëm kundër kësaj padrejtësie”.

Vendimi për të cilin kemi dëgjuar dhe sipas të cilit Shkodra do t’i jepej Jugosllavisë, Epiri Greqisë dhe Vlora Italisë do të ishte një vendim

⁵⁵ *Shqipëria para Konferencës së Paqes*, ble i dytë, 25-29.

⁵⁶ Rolanda Ziu, pun. cit., fq. 100-101.

⁵⁷ *Dokumente e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar...1917-1941*. dok. nr. 9.

⁵⁸ Aurel Plasari - *Vija e Teodosit rishfaqet - nga do t’ia mbajnë shqiptarët?*, Tiranë 1992-31-32.

⁵⁹ Hasan Prishtina – *Dokumente* - dok. nr. 64, 107.

mizor e barbar që nuk do ta pranonte ndërgjegjja njerëzore në shekullin të 20-të. Dhe historia do ta shënonte dhe do ta regjistronte këtë akt të shëmtuar politik. Shqiptarët do të luftonin, derisa të mos mbetej asnjë i gjallë, për ta ndaluar vënien në jetë të çfarëdo vendimi të shteteve të mëdha që do të sillte si pasojë zhdukjen e një kombi të vogël, por fisnik e të vjetër, shqiptar. Me një vendim të tillë, Evropa nuk do të bënte tjetër veçse do të shkaktonte luftëra e turbullira të vazhdueshme në Ballkan. Prandaj, për të mos lënë shteg që të shqetësohet Evropa për shkak të ngjarjeve tragjike e të mjerueshme që mund të ndodhin me këtë rast, kërkojmë e presim nga shtetet e mëdha dhe nga Konferenca e Parisit që vendimi në fjalë të mos aprovohet dhe lidhur me Shqipërinë të merret një vendim, i cili të përputhet me drejtësinë.”⁶⁰

Po më 12 janar 1920, e kemi protestën e organizatës të Shqiptarëve në SHBA - “Partitë Politike”, dërguar kryetarit të Konferencës së Paqes, kundër projekteve të fuqive për copëtimin e vendit dhe zhdukjen e pavarësisë së tij, ku, ndër të tjera, theksohej: “Shqiptarëve u bëri përshtypje të thellë lajmi, sipas të cilit Fuqitë e Mëdha aleate dhe shoqe mendojnë t’ia japin Vlorën dhe rrethin e saj Italisë dhe mandatin mbi pjesën tjetër të Shqipërisë. Kjo gjë është në kundërshtim me parimet e shenjta të kombësisë dhe vetëvendosjes së popujve. Protestojmë energjikisht kundër kësaj padrejtësie dhe njoftojmë Shkëlqesinë tuaj se në qoftë se nuk hiqet dorë nga ky projekt, kombi shqiptar do të luftojë deri në fund për tërësinë tokësore dhe pavarësinë e plotë të atdheut tone të dashur.”⁶¹

Në vazhden e protestave të përgjithshme, ku nuk munguan as protestat edhe të arbëreshëve të Italisë⁶², kemi përsëri letrën e kryetarit të delegacionit shqiptar në Paris, Luigj Bumçit, drejtuar kryetarit të Lidhjes së Kombeve, më 16 janar 1920, me anën e së cilës kërkonte mbrojtjen nga lidhja kundër pazarllëqeve të padrejta të Konferencës së Paqes. Me atë rast delegacioni shqiptar proteston, në emër të drejtësisë, kundër vendimit që ia dorëzon popullin dhe territorin shqiptar, të konsideruar si mall tregu, lakmive të fqinjëve. Ajo kërkon mbrojtjen nga Lidhja e Kombeve si institucion paqej dhe drejtësie, edhe shpreson se ajo nuk do të lejojë që të bëhet një padrejtësi e tillë.⁶³

⁶⁰ Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920 përmbledhje dokumentash II, Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Historisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit të RPSH, Tiranë, 1976 fq. 27-28.

⁶¹ Po aty, fq. 32-33.

⁶² MPJ, Ministria e Punëve të Jashtme, fondi 34, dosja 32, fq. 5-11.

⁶³ Po aty fq. 37.

Edhe më 2 mars 1920, Imzot Luigj Bumçi i drejtoret me një letër presidentit amerikan, Wudro Wilson, duke i dërguar të dhëna të shumta mbi përbërjen e popullsisë shqiptare në krahinat që kërkoreshin nga Greqia dhe kërkonte ndihmën e Presidentit Wilson.⁶⁴

Rezume

Të dhënat, dokumentet dhe dëshmitë të përfshira pasqyrojnë një pjesë të protestave të popullit shqiptar e të grupimeve të ndryshme politike dhe patriotike për mbrojtjen e të drejtave të nëpërkëmbura nga fuqitë fituese të Luftës së Parë Botërore. Ato i janë drejtuar Konferencës së Paqes në Paris në të cilën populli shqiptar dhe përfaqësuesit e tij shpresonin t'i realizonin aspiratat e tij kombëtare.

Delegacioni shqiptar, që në fillim të Paqes së Versajës, u ndesh me vështirësi tejet të mëdha, duke u ndodhur përballë kërcënimeve të integritetit tokësor shqiptar.

Edhe para fillimit të Konferencës së Paqes, më 18 dhjetor 1918, Hasan Prishtina i drejtohet presidentit amerikan, Vilson, në Paris, ku kërkon mbrojtjen e të drejtave të popullit shqiptar në Konferencën e Paqes.

Ndërkaq, Bajram Curri në një letër dërguar kryetarit të Konferencës së Paqes, Zh. Klemansosë, nga Vjena më 19 shkurt 1919, në emër të komitetit kombëtar shqiptar "Kosova", proteston energjikisht kundër metodave mizore dhe barbare të autoriteteve ushtarake e civile serbe në Kosovë dhe kërkon që popullit shqiptar të Kosovës t'i mundësohet shprehja e lirë e aspiratave të tij kombëtare sipas parimeve demokratike.

Një aktivitet tejet të madh zhvilloi Federata Panshqiptare "Vatra", e cila angazhoi një misionar amerikan (Telford Erickson) në mbrojtje të çështjes shqiptare, por edhe ky, me gjithë përpjekjet e mëdha, nuk pati një rezultat të rëndësishëm. Një mbështetje të veçantë e zhvilloi Shoqëria Anglo-Shqiptare, e veçanërisht kryetari i saj Aubrey Herbert.

Më 7 dhe 11 mars 1919, delegacioni qeveritar shqiptar në Paris, ia dërgoi dy memorandume të tjera kryetarit të Konferencës, meqenëse ndodhën ngjarje të reja gjatë atyre muajve. Në memorandumin e 7 marsit 1919 theksohet se në qoftë se argumentet që kemi shtruar para kësaj konference nuk janë bindëse për të drejtën tonë, atëherë i lutemi Konferencës që ta autorizojë Qeverinë e SHBA-së për t'i shkëlur dhe administruar një ose dy vjet këto treva me qëllim të organizimit të plebishitit.

Përmes këtij plebishiti, theksohej më tutje në memorandum, e tërë popullata e këtyre trevave, do të mund të përcaktohet lirisht dhe pa kurrfarë presioni mbi vullnetin e vërtetë të tyre.

⁶⁴ MPJ, viti 1920 dosja nr. 34. fleta 65- 69.

RECENSIONE

Arsim BAJRAMI, *Historia e konstitucionalizmit shqiptar*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2014, f.572.

Studimi monografik është hulumtim serioz i autorit Bajrami, që ka për objekt trajtimi historinë e konstitucionalizmit shqiptar nga viti 1912 e deri në vitin 2012. Ky hulumtim është i pari i këtij lloji në teorinë juridike-kushtetuese në Kosovë e Shqipëri.

Historia e konstitucionalizmit shqiptar, siç vlerëson me të drejtë autori i dorëshkrimit, ndërlidhet me historinë e përgjithshme shqiptare dhe përpjekjet e popullit shqiptar për liri, barazi e pavarësi. Konstitucionalizmi, si proces, e ka rrjedhën që nga themelimi i shtetit shqiptar në vitin 1912. Ai është zhvilluar mbi një shekull, duke reflektuar kontekstin socio-politik të historisë shqiptare.

Autori i qaset trajtimit të materies sipas metodologjisë së hulumtimit të njohur për shkencat shoqërore në përgjithësi dhe ato juridike në veçanti. Studimin e tij shumëdimensional e shtrin në tri aspekte kryesore: *Aspekti historik, Aspekti kushtetues-juridik, dhe Aspekti socio-politik.*

Qasja historike e hulumtimit tregon evolucionin dhe zhvillimin e konstitucionalizmit shqiptar, duke specifikuar fazat e këtij procesi dhe duke analizuar aktet kushtetuese dhe ligjore të të gjitha periudhave historike të zhvillimit të tij.

Qasja kushtetuese-juridike përqendrohet në analizën e akteve kushtetuese të kësaj periudhe, duke analizuar përmbajtjen e tyre, format e qeverisjes, parimet e sistemit politik dhe specifikat e akteve kushtetuese të kësaj periudhe. Kjo qasje është dominuese në këtë hulumtim dhe paraqet një kontribut të rëndësishëm të autorit, i cili vë në spikamë si traditën kushtetuese shekullore të shqiptarëve, ashtu dhe përpjekjet e krijimit të identitetit kushtetues, në pajtim me aspiratat për krijimin e një shteti modern.

Aspekti socio-politik, si dimension i tretë i këtij studimi, shtrihet në rrethanat shoqërore dhe politike të zhvillimit të konstitucionalizmit shqiptar, të cilat janë të ndryshme në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Përderisa në Shqipëri konstitucionalizmi ka një shekull histori dhe lidhje me lindjen e shtetit shqiptar, në Kosovë populli shqiptar luftojë për të drejtat kombëtare dhe për pavarësi, proces ky që u kurorëzua me lindjen e Republikës së Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran më 17 shkurt të vitit 2008. Në Maqedoni procesi i afirmimit kushtetues të

drejtave shtetformuese ishte shumë kontradiktor dhe aktualisht mbetet një sfidë e përpjekjeve politike për barazi të plotë të shqiptarëve.

Arsim Bajrami, si njohës i mirë i fushës kushtetuese-juridike, studimin e tij monografik e ka mbarështuar në 572 faqe teksti. Ky studim monografik synon të paraqes pasqyrën e një procesi shekullor të zhvillimit të konstitucionalizmit ,si në Shqipëri, ashtu në Kosovë dhe në Maqedoni, i cili, në fakt, reflekton procesin historik të lindjes së qytetërimit shqiptar dhe të shtetit modern.

Ideja e autorit për këtë studim, edhe pse e mëhershme, doli në dritë në kohën kur para dy viteve tërë kombi shqiptar festoi dhe rikujtoi 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë dhe më shumë pietet u shënuan proceset historike nga viti 1912, kur u shpall Pavarësia e Shqipërisë, ndërkohë që sot Shqipëria ka hyrë në fazën përfundimtarë të transicionit të saj demokratik drejt integritit të plotë në strukturat euro-atlantike.

Duke u ndal te Kosova, Prof. Bajrami vlerëson se, në fillim të këtij shekulli, shqiptarët e Kosovës krijuan shtetin e tyre, Republikën e Kosovës, si një aspiratë historike e një lufte shekullore për liri dhe barazi mbi parimin e vetëvendosjes. Lindja e Republikës së Kosovës dhe krijimi i shtetit të dytë shqiptar në Ballkan është një fitore e madhe e shqiptarëve. Historia e konstitucionalizmit në Kosovë ndërlidhet me përpjekjen shekullore për vetëvendosje dhe barazi. Ajo shoqërohet me kërkesën për kushtetutshmëri, sepse shqiptarët e Kosovës nëpërmjet Kushtetutës shihnin rrugën e garantimit dhe avancimit të lirive dhe të drejtave të tyre kombëtare.

Përderisa konstitucionalizmi në Shqipëri ishte proces i krijimit dhe konsolidimit të shteti shqiptar, parimi i kushtetutshmërisë në Kosovë shihej si hallkë e rëndësishme për çlirimin e Kosovës nga shtypja e egër serbe, për lirinë dhe barazinë e tyre me kombet e tjera dhe krijimin e Republikës së Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur. Ky proces kishte përparësitë dhe u ballafaqua me sfida të ndryshme, deri më 17 shkurt të vitit 2008. Me të drejtë autori konstaton se ai proces ishte, në të vërtetë, përpjekje e pandalshme e një populli të shtypur në rrugën e tij drejt lirisë dhe pavarësisë kombëtare. Pas pavarësisë, Kosova filloi të ndërtojë konstitucionalizmin burimor dhe filloi transicionin demokratik të saj, në të cilin ideja e Kushtetutës, parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmëria paraqesin sfidat kryesore me të cilat ajo u ballafaqua në përpjekjet për të ndërtua një shtet modern evropian.

Sa i përket Republikës së Maqedonisë, lufta e shqiptarëve për konstitucionalizëm paraqet një proces kontravers, i ndjekur me diskriminimin sistematik të të drejtave kushtetuese të shqiptarëve. Kërkesat për barazi dhe trajtim si element shtetformues të shqiptarëve në Maqedoni, akoma po ndeshen me konceptin e shtetit hegjemonist maqedonas, i cili po vazhdon me diskriminimin kushtetues të shqiptarëve, edhe pas konfliktit të armatosur ndëretnik dhe Marrëveshjes së Ohrit e cila premtonte afirmimin kushtetues të shqiptarëve në këtë shtet.

Krahas evolucionit një shekullor historik, konstitucionalizmi shqiptar sot po ballafaqohet me shumë probleme, që reflektojnë realitetin socio-politik shqiptar, kulturën shtetformuese dhe kushtetuese dhe aftësinë e shoqërisë shqiptare për t'u përfshirë në proceset integruese evropiane dhe për t'u bërë pjesë e civilizimit bashkëkohor evropian. Vështruar nga ky kënd, konstitucionalizmi shqiptar aktualisht paraqet parakushtin themeltar të konsolidimit të dy shteteve shqiptare dhe realizmit të aspiratave shtetformuese të shqiptarëve në Maqedoni.

Koncepti i shtetit ligjor dhe shtetit kushtetues, forcimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë paraqesin *condition sine qua non* –kushte pa të cilat nuk mund të ndërtohet një shoqëri moderne. Përpjekjet për konsolidimin e konstitucionalizmit, në fakt, janë kusht themelor i ekzistencës demokratike të shqiptarëve në rajon. Një komb kushtetues i civilizuar, i qeverisur me kushtetutë, me rregulla demokratike të qeverisjes dhe me një edukatë kushtetuese, paraqet aspiratën aktuale të ndërtimit të identitetit modern të shqiptarëve në Evropë.

Përkushtimi konstitucional shpreh devotshmërinë e qytetarëve dhe kombit në mbrojtjen e vlerave fundamentale të shtetit, që nga sovraniteti i popullit, deri te respektimi i lirive dhe të drejtave të qytetarëve, pa asnjë diskriminim. Demokracia konstitucionale siguron stabilitetin e kombit shqiptar, e mbron atë nga anarkia dhe kontradiktat politike të luftës së egër për pushtet dhe trason rrugën e forcimit të shtetit dhe kombit në përgjithësi.

Së këndejmi, edukimi i brezave të ri për rëndësinë e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në shoqëri paraqet investimin më të mirë në të ardhmen e shtetit. Kjo nga se përmes këtij edukimi, sigurohet devotshmëria e qytetarëve ndaj shtetit dhe atdheut, lojaliteti i tyre patriotik dhe një sistem i mirëqenies shtetërore. Ky studim si një

retrospektivë historike e zhvillimi të konstitucionalizmit shqiptar është në funksion të këtij qëllimi.

Autori ka ndërtuar një kompozicion logjik të strukturës së punimit, ku krahas shqyrtimeve hyrëse, studimi përbëhet nga tri pjesë. Në *pjesën e parë* (f. 33-175) shtjellohet historia e konstitucionalizmit në Shqipëri duke filluar nga Shpallja e pavarësisë më 28 Nëntor 1912 e deri në analizën që i bëhet Kushtetutës aktuale të Shqipërisë të vitit 1988. Në këtë pjesë autori shtjellon të gjitha kushtetutat e Shqipërisë, organizimin shtetëror dhe kushtetues të shtetit dhe sfidat dhe tendencat bashkëkohore të konstitucionalizmit shqiptar. *Pjesa e dytë* e studimit (f. 175-439) i kushtohet zhvillimit të konstitucionalizmit në Republikën e Kosovës në një periudhë prej 5 dekadave, duke filluar nga aneksimi i dhunshëm i Kosovës nga Serbia në kuadrin e Federatës Jugosllave e deri më sot. Në këtë pjesë analizohen të gjitha proceset dhe aktet kushtetuese nga Konferenca e Bujanit, ku për herë të parë përcaktohej e drejta e vetëvendosjes së popullit shqiptar të Kosovës e deri te procesi i pavarësisë dhe shtetndërtimit të Republikës së Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur, i shpallur më 17 shkurt 2008. Dhe së fundi, *pjesa e tretë* (f. 439-494) i referohet zhvillimit të konstitucionalizmit në Republikën e Maqedonisë, ku akoma vazhdon mohimi i të drejtave kushtetuese të shqiptarëve përkundrejt pritjeve nga Marrëveshja e Ohrit e cila premtonte trajtimin e barabartë dhe shtetformues të shqiptarëve.

Një komponentë të pandashme të zhvillimit të konstitucionalizmit shqiptar paraqet edhe gjyqësia kushtetuese, si formë e institucionalizuar për mbrojtjen e Kushtetutës. Gjyqësia kushtetuese si pjesë e konstitucionalizmit reflekton përpjekjet për respektimin e parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe shtetit ligjor në përgjithësi. Njëkohësisht përmes veprimit të gjykatave kushtetuese bëhet institucionalizimi dhe konstitucionalizimi i politikës shqiptare dhe ngritja e kulturës kushtetuese dhe ligjore në përgjithësi.

Një vlerë të posaçme të këtij botimi të autorit paraqet *shtojca* me pjesë dokumentesh të rëndësishme për specialistë të fushës por edhe për opinionin e gjerë lexues. Kjo për faktin se aty mund të gjinden disa materiale dokumentare të një rëndësie të veçantë.

Metodologjia e përdorur nga autori gjatë hulumtimit të këtij studimi i plotëson të gjitha standardet e hulumtimeve shkencore shumëdimensionale. Ai ka përdorur metodat e studimeve juridike siç janë metodat dogmatike, krahasuese, logjike, historike etj, si dhe ka pasur qëndrim kritik ndaj burimeve bibliografike. Nga pasqyra e

literaturës së shfrytëzuar shihet se autori është shërbyer me një literaturë të gjerë dhe të pasur, e cila e ka ndihmuar për ta rrumbullakuar temën bosht të këtij studimi.

Monografia voluminoze e Arsim Bajramit, kushtuar *Historisë së konstitucionalizmit shqiptar 1912 – 2012*, është një punë më përkushtim që paraqet kontribut me vlera të veçanta shkencore për rrugën njëshekullore të konstitucionalizmit si formë dhe përmbajtje e vetëdijës kombëtare e shtetërore.

Jusuf Bajraktari

Anton KOLË BERISHAJ, *Shoqëria pa shtet - studim socioantropologjik*, ASHAK, Prishtinë, 2014, f. 275.

Leximi i pare i librit të autorit Berishaj, i titulluar “*Shoqëria pa shtet*” krijon përshtypjen e analizës së një kompozite elementesh, të cilat natyrshëm synojnë krijimin e një tërësie, mirëpo për shkak të specifikës së kontekstit të rrethanave, kohës dhe fuqisë me të cilën shfaqen dhe funksionojnë, e ruajnë edhe mëvetësinë e vet. Në shkencë është e njohur se qasja fleksibile e ndërtimit të tërësisë me elemente të skalitura veç e veç, nuk është punë e lehtë. Shkrirja e natyrshme e tyre, në rastin konkret e synon mozaikun e formësuar me mjeshtri të një krijese shoqërore, aparatit shtetëror, që në ambientin alpin të Veriut shqiptar, realisht mungonte. Një heterogjenitet dhe shpërndarje e e komponentëve qenësore të organizimit të jetës jashtë kornizës politikë të organizimit shoqëror, nuk është punë e lehtë pasi që nuk duron asnjë maskim artificial. Mirëpo, autori e eviton këtë rrezik, duke manifestuar, jo vetëm njohje të themeltë të specifikave dhe kontekstit jetësor të këtij ambienti përgjithësisht, por edhe të nuancave, që si elemente qenësore i japin koloritin e duhur organizimit shoqëror, strukturimit të institucioneve të traditës, të vlerave, të individit të shkrirë natyrshëm në grup dhe funksionimit të tyre jashtë kontekstit politik dhe shtetëror. Kjo materie e zotuar me admirim, e përcjellë në koherencë, kronologji dhe funksionim të natyrshëm brenda kontekstit specifik sociokulturor, e bën librin, jo vetëm të veçantë për nga metodologjia dhe qasja, por edhe për nga pesha e institucioneve që kanë bartur barrën e funksionimit shoqëror jashtë politikës dhe shtetit.

Koherenca e manifestuar në trajtimin e veçorive sociokulturore dhe shoqërore përgjithësisht, krijon efektin e një uniteti të dyfishtë, jo të zakonshëm në studimet e këtij lloji: unitetin e objektit të studimit me unitetin i mendimit të përvijuar dhe ruajtur me mjeshtri gjatë gjithë librit. Libri i autorit Berishaj shfaq synimin e krijimit të unitetit të objektit të studimit, meqë kapitujt e ndryshëm të librit përbëjnë secili për vete komponentë të veçanta, por në tërësi korrespondojnë natyrshëm ndërmjet veti duke krijuar një monument shkencor që autori e synon dhe paralajmëron që nga mbarështimi i kornizës metodologjike të hulumtimit. Këtu gjithçka ndodhe si në projektet e përsosura arkitektonike: përfshihet historia, antropologjia, psikologjia, etnologjia dhe sociologjia e një universi, në rastin konkret

atij alpin-malësor, i ndërlidhur me kohezionin e komunikimit dhe me diskursin e veçantë të etnopsikologjisë malësore.

Uniteti i mendimit, që buron nga dialogu kontinuel, të cilin autori e ruan me objektin e tij të studimit, rezulton me një filozofi origjinale historike, sociale dhe politike. Vepra, sidomos veçohet me një karakter sistematik që synohet, arrihet dhe ruhet nga dora e njohësit të ambientit dhe mjeshtrit të analizës sociologjike, që nuk lë asnjë paqartësi dhe asgjë të rastit, meqë përqendrohet në lidhjen e vazhdueshme të shkakut dhe pasojës. Kjo hetohet aq lehtë gjatë leximit të librit.

Kornizat e limituara të një recensionit e vështirësojnë analizën e merituar të këtij libri, andaj i mbetemi borxh kësaj filozofie, duke ia mohuar hapësirën e merituar që autori i jep në libër. 14 kapituj e librit ‘Shoqëria pa shtet’, e mbulojnë dhe përthejnë materien ambicioze të studimit, me të gjitha veçoritë e saj, sidomos për kohën e sotme. Autori nuk mbetet vetëm në terrenin e historisë, të së kaluarës, por me kompetencë e përcjell zhvillimin e proceseve, formësimin e dukurive dhe implikimet që ato manifestojnë edhe në kohën e sotme. Kjo, sidomos është e evidente në kapitullin e 4, për identitetin, kapitullin 5, për religjiozitetin, kapitullin 8, për gruan, kapitullin 9, për organizimin politik etj.

Metodologjia e qasjes në trajtimin e specifikave të institucioneve arkaike, evoluimin dhe adaptimin e tyre në kornizat ligjore të shtetit të organizuar pas krijimit të shtetit shqiptar, vështirësitë e integritit të popullatës së ambientit kanunor në jetën urbane, rezistenca dhe stigmatizimi i tyre, refuzimi i pushtetit komunist që të ofrojë modele të pranueshme të integritit për ata, për shkak të mungesës së lojalitetit ndaj regjimit etj, janë analiza të cilat paraqesin një risi në qarqet shkencore sociokulturore ndër shqiptarë.

Megjithatë, mendoj se specifikat e qasjes dhe analizave që autori i ofron në këtë libër, mund të përmbliidhen në tri kategori. E para, shfaqet nëpërmjet refleksionit mbi një shoqëri me premisa të qarta arkaike të organizimit shoqëror, si shoqëri ‘pa shtet’, i cili zgjerohet dhe sqarohet progresivisht me analiza sociologjike dhe kalim të lehtë nga qasja antropologjike në atë sociologjike. E dyta, lidhet me faktin se autori nuk e radikalizon diskontinuitetin ndërmjet shoqërisë alpine tradicionale dhe asaj moderne, duke nxjerrë edhe konsekuencat e kritikës së evolucionizmit. Dhe e treta, lidhet me ekonominë e mbijetesës, gjithmonë të karakterizuar nga mungesa, uria dhe me

mjete të prodhimit rudimentar, të dominuar nga preokupimi i mbrojtjes, sigurisë dhe sigurimit të minimumit ekonomik.

Ekonomia, sipas autorit, nuk gëzon statusin e dimensionit autonom në raport me jetën shoqërore (këtu hetohet një qasje veberiane), pasi që sipas tij, fjala është për një ‘ambient malor, me mungesë të tokës së bukës, me ekonomi të dominuar nga blegtoria etj., që e imponon angazhimin e tërë familjes për të siguruar ekzistencën’ (faqe 113). Sipas autorit, kjo autarki e cila e karakterizon shoqërinë pa shtet që i limiton transaksionet ekonomike me shoqëritë fqinje, nuk është ideal shoqëror, por shkak i izolimit. Pasojat e një izolimi të tillë manifestohen në funksionimin e saj si “tërësi etnopsikologjike, historike, ekonomike dhe kulturore” (faqe 16).

Një ndër përkufizimet e para është raporti i shoqërisë malësore me shtetin, ose më mirë të themi, me mungesën e shtetit. Mungesa e shtetit tek kjo shoqëri të cilën e definojnë vetë titulli, nuk konsiderohet si mungesë për shkak se shoqëria nuk mund të konsiderohet si shoqëri e cila i paraprin shoqërisë së organizuar në shtete ose se kjo shoqëri është jokomplete, nuk është mjaft e gjerë ose nuk është mjaft e pjekur. Refuzimi i shtetit këtu është sinonim me mbijetesën dhe refuzimin e dominimit. Liria thotë autori është gjithmonë transgresion. Banorët e shoqërisë pa shtet i rezistojnë asimilimit duke refuzuar integrimin me të tjerët duke preferuar gjithnjë jetën e izoluar. Mirëpo është pikërisht nga "ky refuzim dhe neveria ndaj integritetit që ka rezultuar me mbijetesë në këto hapësira ». (faqe 153). Malësia definohet si një “oazë” shoqërore (f. 14) e cila *de facto* ka qenë shoqëri pa shtet, shoqëri e cila ka injoruar shtetet, të cilat kanë pasur autoritetet *de jure* mbi këtë tërësi dhe gjithashtu ka qenë e injoruar nga ato.

Problemi i radhës që haset në këtë libër dhe që zë vend qendrorë, meqë përshkohet në të gjitha segmentet e strukturës shoqërore të shoqërisë pa shtet, është raportit ndërmjet individit, kolektivit dhe territorit. Për zbardhjen e këtij raporti, autori shfrytëzon një numër të konsiderueshëm të burimeve dhe analizave, që lidhen me kushtet dhe rrethanat specifike të jetës, me traditat, me vlerat, me strukturimin dhe me organizimin e jetës. Autori analizon llojet e organizimeve të shoqërive nëpërmjet mënyrës së zotërimit të hapësirës gjeografike: qoftë të familjes së ngushtë, të familjes së madhe, të vëllazërisë, të fisit etj., traditat dhe sjelljet të cilat i definojnë shoqëritë tradicionale në përgjithësi dhe shoqërinë e këtij ambienti në veçanti.

Mungesa e shtetit si organizëm, sipas autorit, në raport me komunitetet lokale, kërkon në mënyrë të vazhdueshme të favorizojë struktura inkuadruese të cilat reperkusohen mbi organizimin territorial. Në mungesë të shtetit, individit nuk mund të ekzistojë jashtë grupit, nuk mund të diferencohet nga familja, grupi, etj. "Individi është element i shoqërisë dhe shoqëria disponon me atë si me sendet, pronën. Andaj, vetëdija kolektive dominon mbi atë individuale dhe shoqëria disponon me individin (faqe 22)". Kjo e ngrit çështjen e identitetit, temë kjo që prekë interpretimet dhe qasjet transversale. Autori ofron një analizë të teorive të autorëve më të njohur bashkëkohor, siç janë: E. Gellner, E. Hobsbawm, etj. Në këtë kontekst, vend të posaçëm ka identiteti fisnor, që gjatë ka luajtur rol më të fuqishëm sesa ai fetar, pasi që siç pohon autori, "ndjenja e përkatësisë fisnore është më e fuqishme sesa ligjet kishtare, të cilat në këtë aspekt, janë shumë më fleksibile" (faqe 165).

Emigrimi i jashtëm i banorëve të shoqërisë pa shtet rezulton me shkapërderdhje të ambientit jetësor, të strukturave arkaike, të organizimit dhe funksionimit të saj. Emigrimi si sfidë e mbijetesës jashtë ambientit ku dominonte e drejta zakonore, vlerat dhe ekonomizimi ekstensiv, përjetohet si "përmbysje" e idilës alpine, por edhe si nxitës për lëvizje masive të kësaj popullate, jo vetëm jashtë vendit, por edhe në drejtim të qendrave të afërta urbane. Megjithatë, religjioni dhe identiteti fisnor dëshmojnë si dy elemente identitare të cilat i mbijetojnë edhe presionit mjaft agresiv të akulturimit në ambientin e ri. Jeta e gjatë në ambiente të getoizuara, banorëve të « shoqërisë pa shtet » u vështirëson lidhjen e fijeve për krijimin e identitetit nacional. Që nga ardhja e turqve, banorët e shoqërisë pa shtet kanë jetuar kryesisht vetëm, në vete dhe për vete - ose në fqinjësi me „joshqiptarë” të deklaruar. Vetëm koha më e re u ka ofruar një bazë solide për të formuar, kristalizuar, mobilizuar dhe forcuar vetëdijen nacionale” (f. 73).

Për ndryshim nga shumica e studimeve që si objekt studimi e kanë pasur këtë shoqëri, dhe të cilat zakonisht e kanë mënjanuar çështjen e religjionit (ndoshta nga arsyet ideologjike, ose edhe nga fakti se është çështje e ndjeshme në raportet ndërmjet komuniteteve fetare), në veprën e autorit Berishaj, studimi i rolit të religjionit zë një vend të rëndësishëm, si element identitar, por edhe si faktor që e mundëson kuptimin e strukturës determinuese, të formës që e marrin interaksionet dhe reprezentimet. Sa i përket rolit të religjionit, autorit i

interesojnë, para së gjithash, format simbolike dhe jo institucionet fetare, për shkak së ato mungojnë në kontinuitet.

Autori bën një analizë të thellë shkencore të ndërthurjes së identitetit fisnor dhe të atij fetar, meqë – siç e quan ai, “getoizimi i ambientit” që ka pasë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në forcimin konfesional tek popullata e izoluar, dhe ajo natyrshëm i nënshtrohet ndikimit të religjionit të institucionalizuar të proviniençës katolike, duke e shfrytëzuar edhe këtë si « faktor të ri koheziv të mbijetesës dhe bashkimit të këtij etniciteti” (f.103). Mirëpo, ai i jep religjionit një rol të fuqishëm politik sepse” në periudha të ndryshme kohore, meshtarët ishin të kërkuar dhe të nevojshëm, pasi që përveç shërbesave fetare dhe “ushqimit shpirtëror », religjioni kishte edhe një rol politik dhe “përkatësia katolike mbijeton si element identitar kolektiv” (f. 107)

Ambienti alpin shqiptar nuk ka qenë i injoruar vetëm nga pushtetet që janë ndërruar pas rënies së Perandorisë Osmane në Shqipëri, por një kohë të gjatë, është injoruar edhe nga studimet e mirëfillta sociologjike të cilat kanë mundur të jenë referenca solide mbi evoluimin e kësaj shoqërie, jo vetëm në aspektin politik por edhe ekonomik. Për këto arsye është i vetëdijshëm edhe autori i këtij libri, dhe pohon: “këtë trashëgimi publicistiko-shkencore, kryesisht e karakterizon mungesa e qasjeve kritike dhe e analizave të mirëfillta shkencore brenda kontekstit historik, sociokulturor, ekonomik dhe politik të kohës”. (f. 16).

Si përfundim, ky libër ka një autenticitet dhe rëndësi të veçantë, si për shkencën përgjithësisht, e për shoqërinë e gjerë shqiptare në veçanti. Vepra e autorit, Anton Kolë Berishaj, formave specifike të organizimit të jetës në një ambient po aq specifik (vlerë kjo që kësaj shoqërie të shkapërderdhur dhe para zhbërjes), padyshim ia siguron përjetësinë. Ky studim i realizuar me ambicie të madhe, i shkruar me një gjuhë të pastër, të rrjedhshme, me analiza origjinale e brilante, është udhëzues sidomos për sociologët dhe antropologët se si duhet t’i qasen këtij ambienti të veçantë shqiptar.

Ekrem Murtezai

Edi SHUKRIU, *Hyjnesha Dardane*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2014, f. 190.

Edi Shukriu, është studiuese e mirënjohur në Kosovë e më gjerë në fushën e arkeologjisë. Studimi ka për objekt trajtimi prezencën dhe funksionet e shumta të Hyjneshtës Dardane, një nga hyjnitë më të adhuruar të panteonit dardan. Ky botim, është më i kompletuari deri më sot, për këtë figurë të historisë tonë më të lashtë.

Edi Shukriu, studimin e saj prej 190 faqesh nga aspekti metodologjik, e ka trajtuar sipas këtij kompozicioni: *hyrja; shtatë pjesë të veçanta; çështje për hulumtim të mëtejshëm; përfundimi dhe literatura; lista e hartave; lista e fotografive dhe shënime për autorën*. Në hyrje autorja merret me motivin, synimin dhe peripecitë që ka kaluar gjatë punës hulumtuese për një temë e cila e ka preokupuar shumë vite, për tu marrë në mënyrë shkencore me këtë problematikë. Janari i vitit 1988 është ngjarje e rëndësishme jo vetëm për autorën dhe ekipin e saj hulumtues, por edhe për faktin se për herë të parë në trevat dardane u zbulua një monument që i përkushtohet *Hyjneshtës Dardane*.

Pjesa e parë titullohet “*Monumentet votive përkushtuar Hyjneshtës Dardane*.” (fq.19-69). Kjo pjesë zë hapësirën më të madhe të botimit. Brenda saj janë trajtuar edhe 15 nëntituj, në të cilët flitet përveç të dhënave të deritashme kushtuar studimeve më të thelluara mbi besimin dardan, qasjen e tyre ndaj jetës, vdekjes dhe të jetës së përtejme edhe për ekzemplarë të shtatores së *Hyjneshtës Dardane* në vendgjetje të ndryshme, me karakteristikat e tyre të veçanta.

Pjesën e dytë, autorja e titullon “*Simbolet në Monumentet e Hyjneshtës Dardane*” (fq.70-106). Në këtë pjesë bëhet fjalë për simbole të gjetura e ku autorë të ndryshëm i kanë shpjeguar si shprehje që flasin me një gjuhë figurative në periudha të ndryshme kohore. Mbi këto premisa dallohen edhe fazat e zhvillimit të besimit nga format më primitive të besimit në ato më të sofistikuar si shprehje e klimës shoqërore. *Hyjnesha Dardane* kishte funksione të shumta, duke filluar nga funksioni i pëlleshmërisë, i mbrojtjes së territorit, i mbrojtjes së rrugëve, i ruajtjes së tregtarëve e të udhëtarëve, i mbrojtjes së rajoneve me xehe, i mbrojtjes së burimeve e të ujërave termale e deri te simboli i “*qesës*” në shtatoren e Medianës, e cila shpjegohet si shenjë e pasurisë së Dardanisë me rezerva të arit. Në fq.73-106 paraqitet tabela e 19 simboleve në të cilën shënohet

vendi i gjetjes së tyre, ku në mënyre ilustruese, duke filluar nga edhi, cjapi, dielli e hëna e deri te qesja, kurora e qytetit, nyja profilaktike e Labirintit të Smirës, shprehet domethënia figurative sipas periudhave kohore.

Titulli “*Funksionet e Hyjneshës Dardane*” (fq.107-114) trajtohet në pjesën e tretë të studimit. Në pjesën e katërt dhe të pestë (fq. 150-130), bëhet fjalë për zhvillimin e besimit dardan dhe sforcimi i këtij besimi të *Hyjnesha Dardane gjatë periudhës romake*. Ndërsa në pjesën e gjashtë e të shtatë (fq.131-136 dhe 137-165) autorja trajton Qiellvrotjesin Dardan, ku bëhet fjalë për Kozmologjinë, si shkencë mbi origjinën dhe strukturën e universit dhe Kozmogoninë si varg idesh mbi origjinën e universit. Duke trajtuar këto forma, sipas përvojës së shumë autorëve, vihet deri te ideja qendrore së “nuk ka krijim pa sakrificë dhe as jetë pa vdekje” (fq.168-169), autorja në bazë të këtyre njohurive identifikon çështjet kryesore me të cilat duhet vazhduar hulumtimin e mëtejshëm. Botimi monografik mbi *Hyjneshën Dardane* i Edi Shukriut mbyllet me një përfundim ku autorja sintetizon çdo gjë të vlefshme për këtë temë mjaft interesante.

Në fund jepet bibliografia e pasur, të cilën autorja e ka shfrytëzuar gjatë punës së saj, lista e hartave dhe biografia e shkurtër e saj. Një kontribut tjetër i rëndësishëm është edhe pajisja e studimit me 4 harta që paraqesin shtrirjen e dardanëve; 96 fotografi dhe ilustrime të tjera, të cilat padyshim ia shtojnë vlerën shkencore dorëshkrimit.

Në bazë të analizave që autorja ka bërë gjatë hartimit të studimit e vlerësojmë të qëlluar faktin që në fund të tekstit ka arritur në përfundim se *Hyjnesha Dardane* është hyjneshë autoktone, që përcjell të gjitha fazat e besimit dardan, nga periudhat parahistorike e deri ne shek. IV.

Në fund konsiderojmë se studimi monografik “*Hyjnesha Dardane*” e autores Edi Shukriu, paraqet një kontribut me rëndësi për studimet historike te ne në përgjithësi dhe për ato arkeologjike në veçanti. S’ka dyshim se ky kontribut me vlera të posaçm e begaton korpusin e veprimtarisë botuese të Akademisë së Shkencave e të Arteve të Kosovës për vitin 2014.

Jusuf Bajraktari

Hivzi ISLAMI – Arsim EJUPI, Popullsia dhe vendbanimet shqiptare të Luginës së Preshevës - Gjendja dhe rrjedhat bashkëkohore, Botim i ASHAK-ut, Prishtinë, 2015.

Vepra “POPULLSIA DHE VENDBANIMET SHQIPTARE TË LUGINËS SË PRESHEVËS” – Gjendja dhe rrjedhat bashkëkohore, e konceptuar nga Akademik Hivzi Islami dhe Prof. Dr. Arsim Ejupi, është me karakter të studimit monografik të kompleksit etnogeografik, historik dhe demografik, ku shqiptarët kanë një shtrirje territorialisht kompakte në komunën e Preshevës, të Bujanocit dhe të Medvegjës, megjithëse territori i Medvegjës lidhet me rajonin e Gollapit të Kosovës. Objekt studimi i autorëve të kësaj vepre është struktura e popullsisë dhe vendbanimet, tipologjia dhe proceset transformuese të tyre të studiuara nga këndvështrimi i së sotmes dhe i së ardhmes. Vlerësuar nga ky këndvështrim, vepra në fjalë, ka dimension teorik dhe empirik.

Vepra “Popullsia dhe vendbanimet shqiptare të Luginës së Preshevës” - Gjendja dhe rrjedhat bashkëkohore - është e shtrirë në 627 faqe të kompjuterizuara. Përmbajtjes së veprës i paraprinë “Parathënia” dhe pas saj, kjo veper ka një strukturë të përbërë prej tetë pjesëve: 1. Rrethanat e përgjithshme gjeohapësinore dhe historike, 2. Zhvillimi demografik dhe ligjësitë e ndryshimeve të popullsisë në hapësirë dhe kohë, 3. Kompleksi popullativ i Luginës së Preshevës në kontekst të zhvillimit demografik të Kosovës dhe shqiptarëve, 4. Karakteristikat gjeohapësinore dhe proceset transformuese të vendbanimeve shqiptare në Luginën e Preshevës, 5. “Monografitë” e vendbanimeve më të mëdha shqiptare të Luginës së Preshevës, 6. Trashëgimia kulturore në vendbanimet shqiptare të Luginës së Preshevës, 7. Pozita dhe përparësitë e Luginës së Preshevës në bashkëpunim ndërkuftar dhe 8. Shtojca statistikore. Secila nga pjesët e përmendura është e ndarë dhe e sistemuar në kaptina dhe tema të veçanta. Përpos këtyre pjesëve, vepra ka edhe pjesët e tjera përbërëse të saj: Sumary, Lietratura dhe burimet si edhe indeksin e emrave. Vështruar nga kjo pikëpamje, vepra është gjithëpërfshirëse, complete dhe unike dhe konsiderojmë se është e para e këtij lloji.

Sipas theksimit përmbajtjesor të autorëve dhe gjykuar sipas literaturës së gjerë të shfrytëzuar (488 njësi bibliografike në gjuhën shqipe, anglishte frëngjishte, serbishte etj.). Lugina e Preshevës është studiuar shumë pak, madje vetëm pjesërisht, kryesisht nga autorët

serbë, në kuadrin e regjioneve gjeohapësinore më të gjera. Duke zbatuar metodologjinë klasike të shkollës antropogjeografike të akademikut, Jovan Cvijiq.

Autorët kanë zbatuar metodat bashkëkohore të hulumtimit të mbledhjes, përpunimit, klasifikimit, analizës së të dhënave relevante për studimin kompleks të tyre. Në këtë kuadër dallohet qasja komparative dhe gjenetike e studimit të zhvillimeve demografike, ekonomike, historike etj., ku përmendet krahasimi i zhvillimeve demografike të shqiptarëve të Luginës së Preshevës me zhvillimet demografike të shqiptarëve të Kosovës. U dallua edhe shfrytëzimi i procedurës së anketës dhe i rezultateve të saj në gjurmimet sociodemografike të Luginës së Preshevës. Falë zbatimit të këtyre metodave dhe procedurave hulumtuese dhe analizës së kryqëzimit të rezultateve të tyre, autorët kanë arritur të rezultate, të cilat hedhin dritë njohëse të gjerë dhe më të thellë për zhvillimet e përgjithshme Luginës së Preshevës. Nga ky këndvështrim dallohen proceset prapambetëse ekonomike, sociale e kulturo - arsimore të shqiptarëve, proceset emigruese të popullsisë shqiptare nga kjo Luginë, sidomos nga komuna e Medvegjës etj.

Pas përshkrimit të hollësishëm të pozitës gjeografike të Luginës së Preshevës, të karakteristikave gjeohapësinore dhe historike të kësaj Lugine, të perspektivës historike e aktuale dhe të rrjedhave aktuale gjeopolitike, pasojnë pjesët e posaçme të ligjësive të zhvillimit demografik dhe të ndryshimeve të popullsisë shqiptare, ku janë bërë sulme të rënda në arsyeshmërinë e zhvillimit të natyrshëm të popullsisë dhe të planifikimit të familjes, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat dhe liritë elementare njerëzore nga ana e disa demografëve të ish-Jugosllavisë. Autorët, me argumentime bindëse, kanë thyer qëndrimet dhe pikëpamjet ekspansioniste të egoizmit dhe hedonizmit në riprodhimin e popullsisë, që kishin marrë karakter të një fushate kundër natalitetit të popullsisë shqiptare. Me kundërgargumentet ndaj kësaj fushate, në këtë vepër, dallohen qartësisht motivet hegjemoniste dhe gjenocidale për pastrimin etnik.

Ndër rezultatet e rëndësishme hulumtuese të argumentimit të hipotezës për popullsinë dhe vendbanimet shqiptare të Luginës së Preshevës janë identifikimi i proceseve transformuese të vendbanimeve shqiptare, që kapin një hapësirë të shtrirjes grafike prej faqes 259 – 322. Në këtë pjesë janë vë në dukje struktura e vendbanimeve shqiptare, tipologjia e tyre, ndryshimet funksionale të vendbanimeve, objektet e infrastrukturës shoqërore dhe publike të

vendbanimeve, karakteristikat ekonomike të tyre dhe përfundon në trajtimin e remitancave nga bota e jashtme, duke theksuar rolin e tyre në ruajtjen e mirëqenies ekonomike dhe shoqërore. Që në parathënie thuhet se Shqiptarët e Luginës së Preshevës “sot kryesisht jetojnë nga remitancat që i sjellin emigrantët e punës nga ky territor në vendet e Evropës dhe jashtë saj; rreth 60% të mjeteve të fituara u dërgojnë familjarëve në vendlindje për plotësimin e nevojave elementare jetësore . . .”. Nga rezultatet hulumtuese, autorët e kësaj vepre, kanë nxjerrë përfundimin sipas të cilit “Lugina ishte dhe mbeti rajoni më i pazhvilluar në Serbi dhe në Ballkan: pjesët e banuara me shqiptarë sot janë më se 7 herë më të pazhvilluara se mesatarja e Serbisë”.

Në këtë vepër monografike janë zbërthyer të përpunuara hollësisht njëzetekatër vendbanime të Luginës së Preshevës, që kanë më shumë se 1000 banorë. Këto janë: Presheva, Bujanoci, Medvegja, Tërnoci, Rahovica, Miratoci, Bilaçi, Rainca, Corotica, Nosalca, Zhunica, Konçuli, Tërnavë, Letovica, Lluçani, Bushtrani, Tupalla, Norça, Bukuroca, Geraj, Samolica, Dobrosini, Muhoci dhe Sjarina.

Rezultatet e gjurmimeve kulturore të vendbanimeve të përmendura kanë zënë vend të posaçëm në këtë vepër. Në këtë pjesë, përpos koncepteve themelore mbi trashëgimin kulturore, është përpunuar gjendja dhe perspektiva e tyre dhe janë dhënë rezultatet e monumenteve kryesore të trashëgimisë kulturore në Luginën e Preshevës. Në këtë pjesë janë përpunuar këto monumente kulturore: Kalaja e Preshevës, Kacipupi – Oppidum Dardan, Kalaja e Bushtranit, Kërshevisa, Guri i Shpumë, Xhamia e Ibrahim Pashës “Atik Xhamia” dhe Tyrbja Bektashiane.

Në këtë vepër autorët kanë arritur të përcaktojnë, jo vetëm pozitën e Luginës së Preshevës për bashkëpunim ndërkuftar, por edhe përparësitë e Luginës në bashkëpunimin ndërkuftar.

Shtojca statistikore ka më tepër karakter argumentues dhe, si e këtillë, mund të konsiderohet pjesë integrale e përmbajtjes së veprës “Popullsia dhe Vendbanimet Shqiptare të Luginës së Preshevës” – Gjendja dhe rrjedhat bashkëkohore -.

Vepra në fjalë ka vlera teorike dhe praktike. Vlerat teorike kryesore të kësaj vepre janë: saktësia e të dhënave dhe e fakteve demografike, ekonomike, gjeografike, historike, kulturore, etj. e bëjnë këtë vepër shkencore të pazëvendësueshme. Në këtë pikëpamje përmbajtja e kësaj vepre shërben edhe si burim I të dhënave, fakteve e komenteve dhe të ndërlidhjeve të tyre për studime të mëvonshme jo vetëm për Luginën e Preshevës, por edhe për regjionin e gjerë.

Studiuesit këtu mund të gjejnë lëndë të mjaftueshme për planifikimin hapësinor, rajonal dhe shoqëror. Vlerë e posaçme e kësaj vepre është shfrytëzimi i saj në përpilimin e strategjive dhe politikave zhvillimore të Luginës së Preshevës dhe më gjerë. Natyrisht, gjendja e identifikuar me metoda e procedura shkencore pritet ta sensibilizojë çështjen e shqiptarëve të Luginës së Preshevës si ndër shqiptarët e shteteve ballkanike, ashtu edhe ndër faktorët ndërkombëtar. Në këtë pikëpamje, autorët kanë sjellje argumente ekonomike, sociale, politike, etj. për subjektivitetin politiko – territorial të Luginës së Preshevës.

Pajazit Nushi

Ekrem MURTEZAI, Hyrje konceptuale në filozofi, ASHAK, Prishtinë, 2015, f. 390.

Që nga viti 1957, kur e botoi shkrimin e parë nga lëmi i filozofisë (Filozofia dhe marksizmi, Rilindja, 7.XI.1957), autori i dorëshkrimit “Hyrje konceptuale në filozofi”, akademik Ekrem Murtezai, paralajmëroi se qasja kritike ndaj realitetit shoqëror në Kosovë do të instalohet nëpërmjet një metodologjie të mirëfilltë filozofike e shkencore, duke përfillur kriteret e të shkruarit të bazuar, të argumentuar dhe të verifikuar. Akademik Murtezai, është i pari nga Kosova që studioi dhe e kreu me sukses filozofinë e kulluar në Universitetin e Beogradit dhe këtë përvojë dhe shkathtësi të trajtimit të problemeve specifike filozofike, e barti dhe në mënyrën më të mirë e përcolli tek gjeneratat e reja nëpërmjet punës shumëvjeçare si profesor në Katedrën e Filozofisë dhe sociologjisë, për të cilën ishte ndër meritoret që ajo u themelua në vitin shkollor 1973/74, por edhe në katedra tjera të UP-së.

Opusi krijues i akademik Murtezait, është imponant: mbi 15 libra autorialë dhe mbi 30 artikuj të botuar në revista shkencore me renome filozofike në vend dhe në rajon. Punëtor shoqëror-politik, aktiv në takime të niveleve të ndryshme shkencore – në Kosovë dhe jashtë saj. Drejtor i shkollave të mesme në Gjakovë, drejtor i Qendrës Krahinore për mësimin Marksist, laureat për punën e mirëfilltë arsimore dhe shkencore, anëtar i ASHAK.

Me dorëshkrimin e librit të tij më të ri, të titulluar: “Hyrje konceptuale në filozofisë”, autori e përvijon mendimin filozofik që nga etimologjia e tij, duke e shtrirë natyrshëm nëpër periudha, të cilat jo gjithherë janë të lehta të përthekohen. Mirëpo, dorëshkrimi ofron një pajtim shumë të lehtë dhe të natyrshëm të nuancave që lehtësisht barten nëpër kohëra, pa ndonjë kërcim të dhunshëm apo zbrazëti ndërmjet probleme që ai i shtjellon. Dorëshkrimi i librit problematikën e konceptualizimit të filozofisë e shtrin në 16 kapituj, 385 faqe të fontit 12, Times new roman, që përfundon me një literaturë jashtëzakonisht të pasur të burimeve. Kriteret e shkrimit të mirëfilltë akademik respektohen me pedanteri, pasi që autori ishte edhe ligjëruesi metodologjisë së kërkimeve shkencore.

Strukturimi i veprës ndjek një kronologji të natyrshme të zhvillimit të mendimit filozofik, duke analizuar kushtet në të cilat është bërë i mundshëm ky mendim, mendimin parafilozofik, fillimin e

filozofisë, filozofinë si problem i vetvetes dhe për vete etj, - duke përshtetur etapizimin e mendimit filozofik – prej filozofisë së lashtë greke e gjerë te ajo bashkëkohore.

Në kapitullin në vazhdim, autori nuk heziton të merret edhe me “Divergjencat dhe dallimet e filozofëve lidhur me përkufizimin e filozofisë”, terren ky i rrëshqitshëm për shumë autorë. Mirëpo, falë njohurive dhe shkathtësisë së mendimit filozofik të këtij autori, dorëshkrimi na ofron një kthjelltësim të pozicioneve divergjente të autorëve, pa lënë asnjë konfuzion në përsiatje. Po ashtu, me kapitullin e radhës: “Filozofia dhe religjioni”, autori e dëshmon edhe një herë se është njohës i shkëlqyeshëm i këtyre dy fushave. Në vazhdim edhe kapitulli “Filozofia dhe arsyeja e shëndoshë”, del të jetë përpjekje e qëllimtare e autorit për analiza të mirëfillta shkencore, në mënyrë që të mos mbesin dilema rreth pikave ku filozofia dhe religjioni puqen dhe ndahen.

Në kapitujt e radhës, autori i qaset interpretimit të shkencës, duke u ndalur në definimin e saj, zanafillën e zhvillimit, pozitivizmin, neopozitivizmin dhe postpozitivizmin, scientizmin dhe antiscientizmin, për të vazhduar me kompletimin e analizës rreth disiplinave të veçanta të filozofisë, zanafillës dhe përkufizimit të tyre.

Vend të rëndësishëm në dorëshkrimin e librit të autorit zën metafizika. Që nga etimologjia e saj, zhvillimi dhe lulëzimi që ajo e përjeton – e deri në rrumbullakimin e kontributit të veçantë që lidhur me këtë japin autorët si Aristoteli, Dekarti, Hobsi, Spinoza dhe Lajbnici, autori në këtë dorëshkrim me vendosmëri e ndjek intencën e përmbledhjes së zhvillimit të metafizikës nëpër etapa të ndryshme kohore, duke mos lënë pas dore kontributin e asnjërit prej tyre.

Ontologjia, çështja e qenies, domosdoshmëria dhe rastësia, determinizmi, fatalizmi, indeterminizmi, probabilizmi, teleologjia, çështja e qëllimsisë etj., në dorëshkrimin e autorit zënë vend në një kapitull të veçantë. Edhe në këtë kapitull, autori shfaq njohuri të lartë mbi problematikën esenciale të koncepteve që asnjëherë nuk kanë humbur në aktualitetin e vet. Strukturimi i veprës është diçka që patjetër duhet veçuar si vlerë e posaçme e dorëshkrimit të librit. Pas çështjeve që ontologjia i imponon si substanciale për mendimin filozofik, autori natyrshëm i pason kapitujt me logjikën dhe gnoseologjinë.

Duke bërë një analizë të mirëfilltë të logjikës dhe gnoseologjisë, autori hyn në terrenin e mendimtarisë filozofike, që shpie kah filozofia

klasike gjermane, Kanti dhe Hegeli, historia e filozofisë, filozofia e historisë, estetika, të bukurit dhe sublimja, aksiologjia dhe antropologjia...

Autori i dorëshkrimit, akademik Ekrem Murtezai, librin: “Hyrje konceptuale në filozofi” e përfundon me pikëpamjet e ndryshme mbi antropologjinë.

Pas leximit të këtij dorëshkrimi, duhet nënvizuar më së paku dy çështje:

1. Dorëshkrimi ofron qasje të mirëfillta shkencore, kronologji dhe sistemim të jashtëzakonshëm të çështjeve të ndërlidhura në kohë dhe hapësirë, të larmishme por të rrumbullakuara nga dora e një njohësit të dëshmuar.
2. Botimi i këtij libri, padyshim do të përmbushë mangësinë evidente të literaturës së mirëfilltë shkencore për të gjithë ata që synojnë të njohin kronologjinë, zhvillimin, rrethanat shoqërore dhe historike të të menduarit filozofik.

Të bindur se përmbajtja e ofruar në këtë dorëshkrim do të jetë një kontribut i veçantë për filozofinë përgjithësisht, e në veçanti për katedrën dhe studentët e filozofisë, jo vetëm në Prishtinë, me kënaqësi të veçantë i propozojmë Seksionit të Shkencave Shoqërore, të ASHAK-ut që të procedojë botimin e këtij dorëshkrimi: “Hyrje konceptuale në filozofi”, të akademik Ekrem Murtezai.

Pajazit Nushi, Anton Berishaj

Pajazit NUSHI, Leksikoni i Psikologjisë në dy vëllime, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2014, f.1130.

Kohë më parë doli nga shtypi **Leksikoni i Psikologjisë** në dy vëllime i autorit të mirënjohur, Pajazit Nushi. Ky botim, padyshim është leksikoni më komplet në këtë lëmi, në gjuhën shqipe. Vëllimi i parë ka 550 faqe, ndërsa vëllimi i dytë 580 faqe.

Në këtë studim, hapësirën më të madhe e kanë zënë termat e psikologjisë të sistemuar sipas rendit të shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe, nga shkronja A deri në Zh. Vëllim i parë nga A deri në M dhe vëllimi i dytë nga N deri në Zh.

Shpjegimin e termave kuçe të psikologjisë, autori e ka bërë duke iu referuar literaturës burimore. Një numër i konsiderueshëm termash janë shpjeguar, duke shfrytëzuar ilustrime, tabela, grafikone, diagrame etj.

Pjesa hyrëse e këtij leksikoni është e përbërë nga parathënia, shpjegimi i shkurtesave të përdorura dhe falënderimet drejtuar specialistëve të konsultuar nga fusha e gjuhës shqipe, e terminologjisë së psikologjisë e psikiatrisë, e artit figurativ dhe e njohësve të gjuhës angleze për disa përkthime, të bëra nga anglishtja në gjuhën shqipe.

Pjesa kryesore e leksikonit ka të bëjë me identifikimin e termave të psikologjisë dhe shpjegimin e tyre. Në këtë pjesë janë përpunuar termat nga të gjitha degët më të zhvilluar të psikologjisë, veçmas të psikologjisë konjuktive, psikologjisë sociale dhe psikologjisë klinike, degë të psikologjisë që pësojnë zhvillim të hovshëm në dekadat e fundit të shekullit të kaluar dhe në vitet e para të shekullit njëzetësh. Termat nga psikometria, përkatësisht statistika psikologjike janë përpunuar hollësisht në kuadër të metodave gjurmuese psikologjike. Meqë njohuritë nga statistika psikologjike, janë të domosdoshme për hulumtimet shkencore, shpjegimit të koncepteve të saj i është kushtuar kujdes i posaçëm. Në analizën e termave të veçanta, dallohet po ashtu numri i madh i termave nga psikologjia fiziologjike, e cila në kohë të fundit ka avancuar shumë. Pjesa e sistemit nervor, shqisor dhe atij endokrinologjik, janë shpjeguar duke shfrytëzuar ilustrime formash të ndryshme.

Në këtë pjesë të leksikonit dalluam dy karakteristika kryesore. Së pari, për termat më të rëndësishëm, pas shpjegimit të tyre, janë dhënë burimet e literaturës prej nga janë nxjerrë këta terma. Kështu, termat agresivitet, emocion, psikanalizë etj. në fund të shpjegimit kanë

edhe burimet kryesore prej nga janë nxjerrë. Kjo do t'u mundësojë studiuesve të njihen edhe me literaturën më relevante për hulumtimin e çështjeve të ndryshme psikologjike. Titujt e këtyre veprave të autorëve përkatës janë dhënë në gjuhën burimore të tyre dhe janë përkthyer në gjuhën shqipe. Së dyti, në këtë pjesë të leksikonit është bërë sistemimi i autoriteteve shkencore, studiuesve të dalluar të psikologjisë dhe kontributi i tyre në zhvillimin e psikologjisë dhe mendimit psikologjik, përgjithësisht. Në të gjendet biografia shumë e shkurtër, me përshkrim dhe vlerësim të aktivitetit hulumtues dhe rezultateve të Vilhelm Vuntit (Wilhelm Wundt), Maks Verthajmerit (Max Wertheimer), Filip Vernonit (Philip Vernon), Viliam Sheldonit (William Sheldon), Herman Rorshahut (Hermann Rorschach), Zhan Pijazhes (Jean Piaget) etj. Brenda këtij konteksti, autori ka sistemuar edhe studiuesit e parë shqiptarë të psikologjisë, me veprat psikologjike të tyre, si Hasan Tahsini, arbëreshi nga Italia, Gabriele Bukola, Aleksandër Xhuvani etj., si edhe ata të kohës më të re që zhvilluan psikologjinë ndër shqiptarët. Autori ka synuar identifikimin e zhvillimit të psikologjisë ndër shqiptarët, duke u përqendruar posaçërisht në hapat e parë studimorë të psikologjisë.

Përpunimi burimor i termave nga literatura e gjerë dhe përpunimi biografik i klasikëve të psikologjisë, i studiuesve të parë shqiptarë të psikologjisë dhe i veprave të tyre konsiderojmë se janë një qasje e re dhe kreative në literaturën psikologjike në gjuhën shqipe.

Në shpjegimin e termave brenda këtij leksikoni të psikologjisë është e pranishme qasja zhvillimore studimit të këtyre termave. Në këtë kontekst, hetohen shumë huazime nga greqishtja e latinishtja, që janë rrënjësor në terminologjinë e psikologjisë, sidomos të psikologjisë fiziologjike. Zëvendësimi i tyre me terma në gjuhën shqipe, pothuajse tash është i pamundur. Aktualisht, nga përkthimi i veprave të psikologjisë, dallohet depërtimi i termave të anglishtes në këtë terminologji, me synim për t'u bërë ndërkombëtarizma.

Numri më i madh i termave dhe përpunimi i tyre, siç thekson edhe vetë autori, janë nxjerrë nga literatura e gjerë e psikologjisë. Në hartimin e leksikonit të psikologjisë, autori ka shfrytëzuar edhe librat e vet: Psikologjia e Përgjithshme (Kaptina të zgjedhura), botuar më 1995; Psikologjia e Përgjithshme 1, botuar më 2002; Psikologjia e Përgjithshme II (Njeriu dhe personaliteti i tij në psikologji), botuar më 1999; Kujtesa dhe Trajtimi i saj në Literaturën Shqipe Nomotike, botuar më 2008' Fjalor Shpjegues i Psikanalizës, botuar më 2010 etj.

Leksikoni i Psikologjisë me veprat e shpërmendura të autorit përbëjnë një tërësi terminologjike, në kuadër të këtij lëmi specifike. Ato, si të tilla, janë ndihmesë e madhe për studimet interdisiplinare.

Në përpunimin e strukturës domethënëse të termave dallohen tri lloje shtrirjesh grafike të shpjegimit të koncepteve të këtyre termave: termat me shtrirje të ngushtë, të mesme dhe me shtrirje grafike të gjatë. Këtë ndarje, autori e ka bërë në bazë të rëndësisë dhe vlerave domethënëse të termave për psikologjinë dhe mendimin psikologjik e zhvillimin e tij. Historia e Psikologjisë, Historia e Psikologjisë ndër Shqiptarët, Personaliteti, Shkollat psikologjike dhe disa terma të tjerë me rëndësi të veçantë, janë shtjelluar hollësisht. Në këtë leksikon paraqitet për herë të parë “skica” e zhvillimit të mendimit psikologjik shqiptar dhe institucionalizimi i psikologjisë në Shqipëri dhe në Kosovë.

Ky fakt flet edhe për vlerat e veçanta, që ka botimi për opinionin e gjerë lexues përgjithësisht dhe atë të rretheve të specializuara posaçërisht.

Nga vështrimi analitik i përmbajtjes së kësaj pjese të leksikonit mund të përgjithësohet sistemimi, si veçori terminologjike e psikologjisë: termat e psikologjisë janë njësi speciale që i përkasin një sistemi të veçantë terminologjik, i cili i përgjigjet, po ashtu, një sistemi të caktuar konceptesh psikologjike.

Pjesa e fundit e Leksikonit të Psikologjisë përmban indeksin e termave, indeksin antropologjik, pasqyrën përmbledhëse të shkollave psikologjike, regjistrin e fobive dhe regjistrin e iluzioneve, duke e përmbyllur në mënyrë të natyrshme studimin në aspektin metodologjik.

Në fund mund të konstatojmë me kënaqësi se Leksikoni i Psikologjisë, i autorit Pajazit Nushi, është një studim serioz analitik dhe gjithëpërfshirës në fushën e terminologjisë psikologjike. Problemet e terminologjisë psikologjike kanë qenë prej dekadash në fokusin kontinual studimor të autorit. S’ka dyshim se kultura e gjerë e autorit për një studim shkencor të nivelit të tillë, si dhe prirja e veçantë e tij për trajtimin e problemeve, njohja e thellë e fushës studimore, përvoja e begatë dhe përkushtimi profesional, janë tipare që ia shtojnë vlerat këtij botimi, i cili ka munguar në literaturën shkencore në gjuhën shqipe.

Ekrem Murtezai

FJALIME PËRMORTORE

FJALA E HIVZI ISLAMIT PËR AKADEMIK ENGJËLL BERISHËN

E nderuara familje Berisha,
I nderuari ministër i Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të
Teknologjisë, prof. Arsim Bajrami,
Të nderuar kolegë dhe miq,
Zonja dhe zotërinj,

Duke qenë në përgatitje të shënimit të 7-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës erdhi lajmi i pikëllueshëm se u nda nga jeta akademik Engjëll Berisha. Prandaj, jemi tubuar sot këtu, në mjediset e Akademisë, për t'i bërë nderimet e fundit anëtarit të rregullt të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe ish-Sekretarit të Përgjithshëm të saj, muzikologut, historianit të muzikës, njohësit të mirë të zhvillimeve të muzikës moderne shqiptare dhe avancimit të saj, akademik Engjëll Berishës. Profesor Berisha ishte personalitet me një rrugë të bujshme jetësore, që la gjurmë të pashlyeshme në fushën arsimore-edukative, nga shkolla e mesme deri te Universiteti, në trashëgiminë tonë kulturore dhe në jetën publike. Akademik Berisha u shqua dhe në organizimin dhe drejtimin e institucioneve kulturore - pedagogjike dhe në afirmimin e vlerave kulturore-civilizuese dhe kombëtare të shqiptarëve.

Ju ftoj që me një minutë heshtje ta nderojmë bashkëshortin, prindin, gjyshin, mikun dhe kolegun tonë të dashur akademik Engjëll Berishën.

Lavdi!

Me këtë rast Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së akademik Engjëll Berishës, si dhe të gjithë miqve dhe shokëve të tij të shumtë anembanë Kosovës dhe trojeve shqiptare. Familjes Berisha dhe Akademisë u kanë arritur shumë telegrame ngushëllimi, nga miqtë dhe shokët e Republikës së Kosovës. Në pamundësi që t'i lexojmë të gjitha, po e lexojmë vetëm telegramin e Presidentes së Republikë së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga.

Për jetën dhe veprën e akademik Engjëll Berishës do të flasë Sekretari i Seksionit të Arteve, anëtar i korrespondent, akademik Luan Mulliqi.

FJALA E HIVZI ISLAMIT PËR AKADEMIK RUZHDI PLLANËN

E nderuara familje Pllana,
I nderuar Kryeministër i Republikës,
Të nderuar kolegë dhe miq,
Zonja dhe zotërinj,

Sapo e përcollëm për në banesën e fundit akad. Engjëll Berishën, na erdhi lajmi tjetër i hidhur se nga jeta u nda anëtari korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Prof. dr. Ruzhdi Pllana. Jemi sot këtu për t'i bërë nderimet e fundit Profesorit Pllana, specialistit të spikatur në fushën e gjeoshkencave, veçanërisht në disiplinat e gjeografisë fizike - hidrologjisë, klimatologjisë, speleologjisë, geomorfologjisë, mjedisit jetësor dhe metodologjisë e teknikave kërkimore të resurseve natyrore të Kosovës. Si hulumtues i zellshëm dhe si pendë e re në këto fusha arriti të ngrihej dhe afirmohej edhe jashtë kufijve të Kosovës, duke u bërë pjesë e qarqeve të njohura shkencore-hulumtuese në rajon dhe më gjerë. Nuk ka dyshim se pa prof. Pllanën gjeoshkencat tona dhe veçanërisht studimet mbi ujërat dhe klimën e Kosovës, gjeotrahëgiminë e saj dhe rreziqet natyrore do të ishin shumë të varfra, madje edhe të panisura. Për këto probleme na la shumë dorëshkrime, gati të finalizuar, por dhe të papërfunduara. Nga dashuria e madhe për natyrën e Kosovës, e bëri edhe një vilë modeste në Brezovicë, prej nga i vrojtonte dhe i studionte fenomenet dhe ritmet e caktuara të natyrës. Ishte një adhures i madh i alpinizmit dhe pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në të.

Prof. Ruzhdi Pllana ishte personalitet që kontribuoi shumë dhe në sferën arsimore - edukative, nga shkolla e mesme deri te Universiteti i Prishtinës, duke drejtuar shumë kandidatë në diploma, në studimet e magjistraturës dhe të masterit dhe në doktorate të shkencave, dhe duke hartuar edhe tekste për ta. U shqua edhe në jetën publike, në udhëheqjen me sukses të institucioneve shkencore - pedagogjike dhe në mbrojtjen e kauzës sonë.

Mirësia, toleranca dhe njerëzia ishin veçori të dalluara të prof. Pllanës, sikundër dhe raportet e tij me kolegët, bashkëpunëtorët, studentët dhe njerëzit e tjerë me të cilët kishte kontakte. Duke respektuar çdo mendim të tjetrit, ishte shumë i përshtatshëm për bashkëpunim dhe i gatshëm në çdo moment që të ofronte ndihmë për

secilin atje ku ishte e mundur, veçanërisht ndihmë për kolegët dhe bashkëpunëtorët.

Ju ftoj që me një minutë heshtje ta nderojmë prindin, gjyshin, vëllain, mikun dhe kolegun tonë të dashur anët. korresp. Prof. Ruzhdi Pllanën.

Lavdi!

Me këtë rast Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së Prof. Ruzhdi Pllanës, si dhe të gjithë kolegëve, miqve dhe shokëve të tij të shumtë, nga gjithë Kosova dhe bota shqiptare. Akademisë dhe familjes i kanë arritur edhe disa telegrame ngushëllimi. Në pamundësi që t'i lexojmë të gjitha telegramet, po e lexojmë vetëm telegramin e Presidentes së Republikës znj. Jahjaga dhe telegramin e Ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, prof. Arsim Bajramit.

Për jetën dhe veprën e Prof. Ruzhdi Pllanës do të flasë sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës, akademik Fejzullah Krasniqi.

FJALA E PAJAZIT NUSHIT PËR AKADEMIK BESIM BOKSHIN

Sot, në këtë ditë pikëllimi, ndahem i fundit nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës nga ish-Kryetari i Akademisë, poeti dhe gjuhëtari Akademik Bokshi. Vdiq në moshën tetëdhjetekatërvjeçare në Gjakovë, ku kaloi pjesën më të mirë të jetës dhe veprimtarisë arsimore, kulturore dhe shkencore dhe, pavarësisht se vendbanimi i tij që prej kohësh ishte Prishtina, deshi të varrosej në Gjakovën e dashur, ku kreu shkollimin fillor dhe gjimnazin e ulët dhe, si nxënës i shkëlqyeshëm, vazhdoi mësimet në Gjimnazin e Prishtinës, kurse studimet universitare i kreu në Universitetin e Beogradit dhe në Universitetin e Prishtinës. Me punën e tij arsimore, kulturore dhe shkencore, për më shumë se një gjysmë shekulli në Gjimnazin “Hajdar Dushi”, në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Gjakovës, në Fakultetin Filologjik dhe në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, i ka lënë trashëgimi Kosovës dhe jo vetëm Kosovës, vepra të shquara dhe të paharruara. Ndërprerja e jetës së tij e fisme dhe e veprimtarisë arsimore, kulturore dhe shkencore e tij, me gjithë trashëgimin e vet, konsideroj se është humbje e madhe, dhembje e pikëllim i madh për të gjithë. Në këtë ditë dhembjeje e pikëllimi të madh, familja Bokshi, qytetarët e Gjakovës, të Kosovës dhe me gjerë, anëtarët e Shoqatës Intelktuale të Gjakovës, kryetar i Kuvendit të së cilës ishte i ndjeri, bashkëpunëtorët, anëtarët e Akademisë dhe personeli i saj, ndahen nga mendjemprehti, i ndershmi dhe burri i këtij vendi. Ngelëm të gjithë pa Besimin e madh, familja pa kryefamiljarin, na pa mikun, shokun, e kolegun e ngritur dhe të dijshtëm, tek i cili kemi parë gjithmonë mendje të shquar dhe sjellje me qëndrime burrërore, nga i cili kemi gëzuar sjelljen e kujdesshme dhe nga i cili kemi dëgjuar përherë mendimin e urtë të tij. Prandaj, vdekja e tij është dhembje jona e madhe për njeriun me vlera gjithëkombëtare. Dhembja dhe pikëllimi për Akademik Besim Bokshin është njëkohësisht pikëllim për kulturën e gjuhës shqipe dhe për albanologjinë, ku ka lënë një zbrazëti, që sigurisht, nuk do të plotësohet shpejt me studiues të tipit mendjemprehtë, të ndershëm dhe bujar.

Akademik Besim Bokshi i këndoi “Jubileve të tij” duke kujtuar e ironizuar datëlindjen dhe vitet e fëmijërisë së hershme me sundimin e egër të Pashiqit dhe të Mbretit Zog, fëmijërinë e vonshme me pushtimin fashist, rininë e hershme me ripushtim sllav, rininë e vonshme me sundimin egërsinor të Rankoviçit dhe moshën e pleqërisë së hershme me gjakësorin Millosheviq. Këto, i ndjeri i quajti “Jubile të jetës sime”. Unë këtë e përmendi për të kujtuar kushtet në të cilat ka jetuar, punuar

dhe krijuar Akademik Besim Bokshi. Deputeti i Dhomës Arsimore të Kuvendit Federativ në vitet e fundit të dekadës së gjashtë të shekullit të kaluar ka ditur dhe ka guxuar ta ngrejë zërin për barazinë e plotkuptimshme të gjuhës shqipe me gjuhët e tjera të popujve në ish-Jugosllavi. Kjo do të thotë se në poezi i ka kënduar lirisë, duke mallkuar pabarazinë dhe shtypjen politike, kurse aty ku duhet, pra në politikë dhe në organet politike, këtë e ka thënë haptas dhe me guxim, jo vetëm në organet e pushtetit lokal të Gjakovës dhe të Kosovës, por edhe në organin më të lartë ligjdhënës të ish Federatës Jugosllave.

Besimit të ndjerë i dukej se angazhimi i tij në veprimtarinë universitare e akademike ishte i pamjaftueshëm për atë që kërkon liria e popullit të vet, prandaj angazhohej edhe në veprimtaritë politike, madje mu aty ku mund t'i ndihmonte popullit të vet e zhvillimit të tij. Në këtë vazhdë, Akademik Besim Bokshin e shohim të zgjedhur deputet në Kuvendin e Kosovës në kohën e Ibrahim Rugovës. Jo vetëm kaq; Akademik Besim Bokshi, në vitet 1993 - 1996 ka qenë Kryetar i Partisë Socialdemokrate, ku dallojmë dhuntinë e prirjen e tij për t'u angazhuar në zgjidhjen e raporteve sociale e njerëzore, në formën demokratike. Pikërisht këtu dallohet njerëzia e tij, e nivelit më të lartë. Këtë e dëshmojnë edhe shkrimet e tij në vitet 80 - ta të shekullit të kaluar. Kështu dallojmë shkrimin për barazi gjuhësore në revistën "Gjuha shqipe" të vitit 1987, ku i ndjeri Besim ka artikuluar mendimet e qëndrimet e veta në punimin e titulluar "Politika gjuhësore në disa vise të Jugosllavisë". Qëndrimet e të ndjerit për barazi e liri të gjithëve nuk ngurren të t'i thoshte haptas në artikullin "Agensë shqetësuese anticivilizuese e makiaveliste". Prandaj në pistat paralele të veprimtarisë së tij, të rinisë së hershme dhe asaj të vonshme dhe të gjithë jetës, do të mbahen në mend përherë, sepse këto e kanë bërë dijetar dhe politikan - patriot. Këtë dyzim të gërshetuar, vazhdimisht me njerëzi, që i kishte hije vetëm të ndjerit Besim, e dallojmë në të gjitha format e angazhimit të tij, madje edhe në çështjet e raporteve ndërmjet nesh - kolegëve dhe ndërmjet tij dhe të gjithë të tjerëve. Këtë e ka çmuar lart edhe vendlindja e tij, duke e shpallur 'qytetar nderi' të Gjakovës.

Por, lirinë, drejtësinë e mençurinë, që kaq shumë i ka dashur dhe me lakmi u ka mbetur besnik gjithmonë nuk arriti t'i përjetojë sa dhe si duhet. Në alenë e të mëdhenjve të Gjakovës e Kosovës, do ta gjejë qetësinë e përherëshme.

Lavdi e përjetshme i qoftë Akademik Besim Bokshit!

FJALA E ZEQRJJA BALLATËS PËR AKADEMIK ENGJËLL BERISHËN

Profesori, **Engjëll Berisha**, i lindur në gusht 1934 në Prizren, i përkiste brezit të parë të maturantëve të Shkollës së Mesme të muzikës, të parës në Kosovë. Me kolegët e brezit të tij muzikorë i qe përveshur studimeve në mesin e viteve të 50-ta në Akademinë e muzikës në Beograd. Këtij brezi i takoi të kthehet pas diplomimit Kosovë. Prof. Engjëlli zuri punë në Shkollën e mesme të muzikës këtu, në Prizrenin e lindjes, ashtu si të tjerët në qendra, gjimnaze e normale gjithandej Kosovës, si dhe në shkolla fillore dhe në ato pak shkolla të ulëta të muzikës, ku mungonin kuadro muzikore në gjuhën shqipe. Në Shkollën e mesme të muzikës zuri ta ligjërojë lëndën “Historia e muzikës” përgjatë një decenieje, për mungesë kuadrosh edhe lëndët “Harmoni”, “Lexim partiturash” e “Piano”. Në atë periudhë fillon veprimtaria e tij prej pedagogu të zellshëm ndaj nxënësve për të vazhduar më se një gjysmë shekulli. E ka drejtuar dhe Korin e shkollës ku ligjëronte, si dhe atë të ShKA “Agimi” në Prizren. Në ato vite ka korrë suksese në koncerte e festivale në Kosovë dhe jashtë saj.

Misionin prej pedagogu muzikor prof. Engjëlli e vazhdoi në Shkollën e Lartë Pedagogjike, më 1968, si profesor i Historisë së muzikës, deri më 1975. Në atë periudhë filloi interesimi i tij edhe për rrjedhat muzikore të krijimtarinë, kulturës dhe historisë së muzikës, edhe të kësaj kombëtare. Filloi të shkruajë e botojë vështrime, recensione në shtypin ditor e periodik në Kosovë e jashtë saj; t'i rendisë punimet muzikore (Vatroslav Lisinski – themelues i operës kroate, Ç'vend zë muzika kombëtare shqiptare në 'Enciklopedinë muzikore të Jugosllavisë, Krijimtaria korale në Kosovë, Përvojë e çmueshme në traditën e muzikës popullore, Muzika në Shqipëri). Me më shumë rëndësi për atëherë ishte dispensa “Historia e muzikës” për studentët e ShLP, më pas edhe atyre të Fakultetit të Arteve, për pedagog muzikor. Dispensa ishte një ndihmesë e mirëpritur, si literaturë e mangët muzikore që ishte. Kjo dhe shkrimet e tjera bënë me dije se profesori ynë, krahas punës prej pedagogu, preokupohej edhe me çështjet studimore të historisë së muzikës së përgjithshme dhe kësaj kombëtare.

Pas përfitimit të një përvoje pedagogjike, me qëllim të thellimit të njohurive profesionale, pati filluar të studiojë në Degën e muzikologjisë në Lubjanë, por duhej të vazhdonte edhe si pedagog pa

ndërprerje pune. Ndërkohë, me disa kolegë ka kontribuar në themelimin e Degës së Artit Muzikor në Akademinë e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Kështu, ka vazhduar të ligjërojë lëndën “Historia e muzikës”, t’i kryejë studimet pasuniversitare në Akademinë e muzikës në Sarajevë me temë: “Zhvillimi i stileve” në veprat e kompozitorëve shqiptarë të Kosovës (te prof. Dr. Zija Kuçukaliq), të botuar nga ETMM e Kosovës. Ky studim përfshinte, hyrjen, parathënien, pozitën gjeografike të Kosovës, rrethanat historike, shoqërore-ekonomike e kulturore, me karakteristika të folklorit muzikor shqiptar, muzikës artistike e shembuj muzikorë, bashkë me shënimet biografike për kompozitorët tanë. Nëpërmjet analizash, përdorimit të folklorit muzikor kombëtar, mjeteve kompozicionale, janë ndriçuar ecuritë krijuese të tyre, përcaktuar rrjedhat zhvillimore stilistike. Ishte një problematikë mjaft e ndërlikuar për vetë profesorin, Engjëll Berisha, por edhe për gjithë krijimtarinë tonë muzikore.

Magjistrin Engjëll Berisha, u thellua edhe më tej në ndriçimin e krijimtarisë muzikore, jo vetëm kosovare, por edhe përgjithësisht kombëtare. Prandaj vazhdoi të botojë punime, vështrime, recensione, studime nga më të ndryshme analitike (Gjurmët e muzikës artistike në Kosovë, Luftërat çlirimtare në veprat vokalo-instrumentale të autorëve kosovarë, Disa karakteristika të brezit të dytë të kompozitorëve tanë; Fillimet e muzikës kamerale në Kosovë. Temat e muzikës shqiptare në disa vepra të autorëve joshqiptarë, Veprat korale të Lorenc Antonit, Kristo Kono jetoi për muzikë, Krijimtaria muzikore e Fan Nolit, Ndikimi i stileve në veprat e kompozitorëve Shqiptarë të Kosovës, Gjergj Kastrioti Skenderbeu në krijimtarinë muzikore, Data të rendësishme të kulturës tone muzikore; “Musica sacra” - thesar i kulturës shqiptare, Palok Kurti - figurë komplekse në fushën e muzikës, Botime me vlerë të krijimtarisë tone muzikore...).

Fjala e prof. Engjëllit është dëgjuar edhe në ligjërata, kumtesa, seminare, tryeza, tribuna, sesione shkencore, në përvjetorë figurash muzikore në Prishtinë, Tiranë, Novi Sad, Sarajevë e gjetiu. I ka transmetuar njohuritë e tij mbi historinë e muzikës, mbi krijimtarinë dhe kulturën muzikore shqiptare, me qëllim të afirmimit të saj përmes punimeve të ndryshme (Krijimtaria muzikore në Kosovë, mbi opusin krijues të Rexho Muliqit, Revolucioni në veprat vokalo - instrumentale të kompozitorëve tanë; Veprimtaria muzikore-skenike, Lëvizjet artistike dhe romantizmin, Rrethanat që ndikojnë në

zhvillimin e stileve, Zhvillimi i muzikës së kultivuar shqiptare, Pozita e kulturës muzikore në Kosovë...).

Dua të përmend, gjithashtu, Serinë e zërave për fushën e Artit muzikor në Leksikonin muzikor të Jugosllavisë mbi kompozitorët, dirigjentët, interpretët, pedagogët, institucionet muzikore, festivalet, ansamblet... Më pas, ka botuar disa doracakë e libra nga lënda e Historisë së përgjithshme muzikore dhe kombëtare për shkolla të mesme Në to ka pasqyruar zhvillimi e kulturës dhe të krijimtarisë muzikore që nga civilizimet më të hershme e deri në kohët e sotme.

Duke ligjëruar pa ndërprerje për më shumë se një një gjysmë shekulli në lëndën “Historia e muzikës” në arsimin muzikor të mesëm, atë të lartë dhe e superior në Fakultetin e Arteve, si ligjërues dhe profesor ordinar, magj. Engjëll Berisha iu përkushtua me mish e shpirt punës prej pedagogu muzikor. U ka ligjëruar, madje, jo vetëm studentëve, por dhe fëmijëve të ish-studentëve të tij. Kjo ka sjell rezultate të pamohueshme në paraqitjen dhe rëndësinë e lëndës për muziktarët e rinj dhe për historiografinë muzikore ndër ne.

Edhe gjatë periudhës së fundit, profesor Engjëlli, ka vazhduar vendosmërisht me shkrime analitike muzikore në shtypin ditor e revial, për çështje të ndryshme dhe sidomos për kompozitorë gjeneratash të ndryshme, si “Martin Gjoka - fillestar i artit të kultivuar muzikor”; “Mark Kaçinari, figurë e shquar e kulturës muzikore”; “Rauf Dhomi - kompozitor që integron përmes muzikës”; “Çesk Zadeja - kompozitor që e ngriti muzikën shqiptare”; “Tish Daija, ndër të parët e muzikës sonë”; “Nismëtar i muzikës artistike në Kosovë”; “Mbi veprën e kardinalit të parë shqiptar” etj.

Gjatë kësaj periudhe kohore, ka shkruar dhe komente për programet e festivaleve, fletushkat e koncerteve. Ka vazhduar të jetë i angazhuar si pedagog, duke kontribuar me pasion dhe çuar më tej materien historike-muzikore. Atë e ka përmbledhur në një publikim gjithëpërfshirës, me titull: “Studime dhe vështrime për muzikën, që nga viti 1969 e këtej - çështje rrjedhash krijuese muzikore, mbi kompozitorë, instrumentistë e këngëtarë, mbi arsimin muzikor e historinë artistike në Kosovë e Shqipëri”.

Pedagogut tonë të shquar, historianit dhe profesorit emeritus, Engjëll Berisha, në saje të përvojës permanente, shkrimeve, botimeve mbi krijimtarinë dhe kulturën muzikore, këtij intelektualit tonë me ndërgjegje të lartë, pjesëmarrësi me ligjërata-kumtesa në tribuna, tryeza, seminare e sesione shkencore, qysh gjatë veprimtarisë së hershme, i janë besuar detyra e angazhime me peshë profesionale -

shoqërore, të dala nga qarqe të shëndosha intelektuale. Pos të tjerash ishte vrojtues i Grupit të Edukatës muzikore në ShLP, në Prishtinë, kryetar i Kuvendit të Bashkësisë Krahinore të Kulturës, kryetar i Pleqësisë, prodekan e dekan i Fakultetit të Arteve, anëtar i Redaksisë së revistës muzikore jugosllave dhe i Leksikonit muzikor të Jugosllavisë... Këto i ka kryer me zell, ndërgjegje e përkushtim; me takt profesional-pedagogjik, i matur dhe me modestinë prej intelektualit të mirëfilltë. Përpos shpërblimesh e mirënjohjesh të tjera, që nga viti 2000, qe zgjedhur anëtar korrespondent, më pas anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, së fundi edhe laureat i Shpërblimit jetësor “Niketë Dardani”.

Qoftë i përjetshëm kontributi i tij prej pedagogu e historiani muzikor!

FJALA E FEJZULLAH KRASNIQIT PËR ANËTARIN KORRESPONDENT RUZHDI PLLANA

I nderuar kryetar i ASHAK-ut, z. Hivzi Islami,
Të nderuar anëtarë të Akademisë,
E nderuara familje e profesorit Ruzhdi Pllana,
Te nderuar kolege dhe miq të profesorit Ruzhdi,

Jemi tubuar sot në këtë mbledhje komemorative për të shprehur së bashku nderimin dhe dhembjen e thellë që e ndiejmë për vdekjen e profesorit, shkencëtarit dhe intelektualin shumë të çmuar, të bashkëpunëtorit dhe shokut tonë të nderuar anëtarit korrespondent të ASHAK-ut, profesor Ruzhdi Pllana.

Lajmi pikëllues për vdekjen e prof. Ruzhdiut, na ka tronditur thellë të gjithë neve anëtareve të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, të gjithë stafin akademik dhe punëtorët e Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore të UP-së, të gjithë studentet e qytetaret që e kanë njohur këtë njeri me veti shumë të larta njerëzore.

Këtë ndarje nga profesori Ruzhdi, të gjithë ne e ndiejmë rëndë. Nga sot, jemi të detyruar që të kënaqemi vetëm me kujtimet e mira për profesorin Ruzhdi, këtë njeri të mrekullueshëm, shok të shtrenjtë e të paharrueshëm dhe të krenohemi me punën, kontributin dhe angazhimet e tij, në rrafshin shkencor dhe profesional.

Ruzhdi Pllana u lind me 15.05.1940, në fshatin Dobërllukë, komuna e Vushtrrisë. Shkollën fillore e kreu në Smrekonicë dhe Vushtrri, kurse shkollën normale në Prishtinë, më 1960. Studimet në Seksionin e Gjeografisë i mbaroi në Universitetin e Novi Sadit, në vitin 1966 me notën mesatare 9.20. Si student i dalluar, ai ishte bursist i Universitetit të Novi Sadit dhe dy herë nga ky universitet e mori shpërblimin e nëntorit. Studimet pasuniversitare i përfundoi në Universitetin e Zagrebit, më 1973, kurse disertacionin e doktoratës në Prishtinë më 1977.

Në vitin 1971 zgjidhet asistent në Departamentin e Gjeografisë të Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore, më 1974 ligjërues, më 1978 docent, më 1983 prof. inordinar dhe me 1994 prof. ordinar. Në departamentin e Gjeografisë, në FSHMN-së ka ligjëruar lëndët: "*Klimatologjia me Meteorologji*", *Hidrologjia dhe Gjeografia nacionale*".

Me propozimin e Këshillit mësimor-shkencor të FSHMN dhe Seksionit të SHN, kuvendi i ASHAK-ut më 05 dhjetor 2012, profesor Ruzhdi Pllanën e zgjodhi anëtar të vet korrespondent.

Ne janar/shkurt të vitit 1975 qëndroi në “Hydroprojekt” në Bërno, Çekosllovakia. Gjatë vitit akademik, 1978/1979, ka qëndruar për specializim posdoktorate në Universitetin Shtetëror të Moskës-MGU “Lomonosov”. Disa kohë, ai qëndroj për punë hulumtuese edhe në disa institute kërkimore-shkencore dhe universitete, si në Petersburg, Tbilisi dhe Tashkent. Për vizita studimore ishte në disa qendra kërkimore për çështje të mjedisit si në: Britaninë e Madhe, Holandë, Poloni dhe Çekosllovakia . Ka mbajtur ligjëratat rasti në qendra të ndryshme universitare dhe studimore. Ka ushtruar detyrën e kryetarit të Shoqatës së gjeografëve të Kosovës.

Në periudhën 1975-1977 ishte prodekan i FSHMN, ndërsa për dy mandate ishte edhe shef i Departamentit të Gjeografisë, drejtues i studimeve të magjistraturës, ndihmës i ministrit për Arsim, Shkencë dhe Kulturë - Sektori universiteti dhe shkenca, (1985-1989) etj.

Si mentor ka udhëhequr disa kandidatë për magjistraturë, master dhe doktoratë. Ka marrë disa mirënjohje dhe falënderime nga organet, institucionet dhe organizatat e ndryshme.

Aktiviteti shkencor dhe profesional i profesorit Ruzhdi Pllana është shumë i pasur. Ai ka botuar mbi 40 punime shkencore dhe profesionale, në lëmin e gjeografisë fizike, në revistat vendore dhe ndërkombëtare.

Ishte udhëheqës, konsulent nacional apo anëtar i ekipit punues i mbi 10 projekteve shkencore dhe profesionale. Në këtë fushë, ai ka dhënë një kontribut shumë të çmuar.

Në Vështrimin monografik Kosova (Prishtinë, 2011) të ASHAK-ut, ai është hartues i artikujve: “Ujërat; Klima dhe Vlerat e trashëgimisë natyrore”.

Ai gjithashtu dallohet edhe si hartues i disa teksteve të gjeografisë fizike për nivele të ndryshme të arsimit në Kosovë.

Në kuadër të Seksionit të SHN të ASHAK-ut , ai përgatiti dhe e menaxhoi me shumë sukses tryezën shkencore: “Ujitja në Kosovë - menaxhimi i ujërave për bujqësi të qëndrueshme”, mbajtur më 16 tetor 2014.

Për botim në ASHAK, ai e ka përgatitur studimin monografik: “Klima e Kosovës”, në të cilin analizohen në mënyre komplekse roli i faktorëve globalë, regjionalë dhe lokalë në kushtet klimatike të

Kosovës si dhe analiza e elementeve klimatikë në vend. Kjo vepër është në proces të botimit.

Profesori Ruzhdi, me punën e vet produktive, me veprat që na ka lënë pas, e ka siguruar se do të mbetet gjithmonë i paharrueshëm në opinionin shkencor e arsimor të Kosovës.

I përjetshëm qoftë kujtimi për prof. Ruzhdi Pllanën!
Faleminderit!

FJALA E LUAN MULLIQIT PËR AKADEMIKUN ENGJËLL BERISHA

I nderuari z.Kryetar i Akademisë,

E nderuara familje Berisha, miq e kolegë të pikëlluar,

Dje, pushoi së rrahuri zemra e dijetarit e studiuesit e të urtit, e të qetit, e pedagogut, e historianit të muzikës, i cili bëri aq shumë hulumtime në historinë e pashkruar të thesarit tonë muzikor. Me punën e tij të palodhshme për shumë decenie, la pas vetës një numër të madh studimesh dhe publikimesh në këtë fushë.

Prof. Engjëll Berisha u lind në Prizren, më 24 gusht të vitit 1934. Në vitet 1954-1955 mbaroi Shkollën e Lartë në Degën e Teorisë dhe të Pedagogjisë Muzikore, në Akademinë e Muzikës të Beogradit. Pas diplomimit, në vitin 1958 kthehet në Prizren, ku deri në vitin 1968 ishte pedagog në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren, i lëndëve teorike dhe praktike. Në vitin 1968 zgjidhet profesor i lëndës “Histori e muzikës” - Dega e muzikës në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Aty punoi deri në vitin 1975. Po atë vit u hap Akademia e Arteve, sot Fakulteti i Arteve, Dega e muzikës, dhe u zgjodh ligjërues i lëndës “Histori e muzikës botërore dhe kombëtare”. Më vonë morri titullin profesor ordinar i Universitetit të Prishtinës.

Gjatë viteve 1962-1968, prof.Engjulli ishte drejtor i Shkollës së Mesme të Muzikës në Prizren dhe për një kohë edhe drejtor i Gjinnazit të Prizrenit, gjatë viteve 1969-1970; ka qenë gjithashtu dekan në Fakultetin të Arteve. Njëherësh, gjatë disa viteve ishte edhe dirigjent i Korit të SHKA “Agimi”. Në vitin 2000 është zgjedhur anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa në vitet 2008-2011 ishte edhe Sekretar i Përgjithshëm i saj.

Akademik Engjëll Berisha, ka botuar edhe shumë vështrime dhe recensione nga fusha e historisë botërore dhe kombëtare të muzikës, si dhe shumë botime të tjera. Për nevojat imediate të nxënësve dhe të studentëve, ka botuar këta libra:

- Kultura muzikore, për klasën I dhe II të gjinnazit, EMM, Prishtinë, 1989
- Kultura muzikore botërore dhe shqiptare, për shkolla të mesme, Libri Shkollor, Prishtinë, 1998.
- Arti muzikor, për shkolla të mesme kl. 10,11,12, botues Libri Shkollor, Prishtinë, 2004, 2005, 2006.

- Historia e muzikës I (dispensë), për studentë të muzikës, SHLP, Prishtinë, 1975.
- Zhvillimi i stileve në veprat e kompozitorëve shqiptarë të Kosovës, Libri Shkollor, Prishtinë, 1997;
- 50 vjet të shoqërisë kulturo-artistike “Agimi” të Prizrenit (1944-1994) bashkë (me Kolë B. Shiroka, Prizren, 1997).
- Studime dhe vështrime për muzikën, ASHAK, botime të veçanta LII, Prishtinë, 2004.
- Punime për Fjalorin e ri Enciklopedik shqiptar , botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë. 2008.
- Album me vepra për piano, zgjodhi dhe përgatiti për shtyp Botoi ASHAK, Prishtinë. Një varg vështrimesh të publikuar në Fjala, Shkëndija, Rilindja, Bota sot, Koha ditore etj.
- Ishte anëtar i Redaksisë të “Leksikonit muzikor të Jugosllavisë”

Për kontributin dhe veprimtarin e tij profesionale ka marrë shumë lëvdata dhe shpërblime, ndër të cilat duhet cekur, Shpërblimin për vepër jetësore “Niket Dardani” të cilin ia dha Ministria e Kulturës, në vitin 2014.

Akademik Engjëlli, me afërsinë e tij njerëzore, rrezatonte optimizëm, ndërsa për guximin dhe vendosmërinë prej hulumtuesi gëzonte respekt të veçantë të studentët dhe kolegët. Ne, bashkëpunëtorët dhe miqtë e tij ndjehemi krenarë, që e kemi pasur si në shkollë e në universitet, ashtu edhe në këtë Akademi, në këtë institucion të lartë, ku për herë të fundit po ndahemi nga ai. Për familjen dhe rrethin e tij të ngushtë, shuarja e të dashurit është e rëndë, ndërsa për kulturën tonë shqiptare, humbja e Engjëllit është e pakompensuar.

Na mbetet vetëm të gjejmë ngushëllim në veprën që na ka lënë dhe vizionin e tij prej pishtari, që do të vijojë e të na ndriçojë në të ardhmen.

KRONIKA 2014

ASHAK NDAN PËR HERË TË PARË SHPËRBLIMIN MBËSHTETËS 2014

Më 10 shkurt 2014, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u mbajt ceremonia solemne e ndarjes së *Shpërblimit mbështetës 2014*.

Fjalën e hapjes me këtë rast e mbajti Kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami, i cili ndër të tjera tha:

“Jemi mbledhur sot në mjediset e Akademisë për një rast të veçantë për të cilin nuk jemi tubuar asnjëherë në historinë tashmë katërdekadëshe të kësaj themelate. Jemi këtu për ta shpallur një çmim që e ka themeluar Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të cilin e ka emërtuar “Shpërblimi mbështetës 2014” dhe u jepet kandidatëve të moshës së re që kanë arritur rezultate të larta, të veçanta në fushën e shkencës dhe të artit. Ky çmim do të jetë tradicional dhe do të jepet në fillim të çdo viti. Fondi për këtë shpërblim krijohet nga donacionet.

Tashmë një kohë të gjatë, Kryesia e Akademisë, përgatitet për dhënien e këtij çmimi, që ishte nismë e kryetarit të mëparshëm, akademik Besim Bokshit, i cili besonte se përmes një forme tjetër financiare do ta jepte çmimin. Por kjo nuk u realizua, për disa arsye. E falënderoj shumë për idenë dhe përpjekjet e tij!

Në mbledhjen e saj të 31 dhjetorit 2013, Kryesia e themeloi këtë çmim dhe më 22 janar 2014 e shpalli konkursin publik për këtë qëllim. Në konkurs u paraqitën katër kandidatë nga fusha të ndryshme të shkencave dhe të arteve. Kryesia, në mbledhjen e vet të mbajtur më 31 janar 2014, ka caktuar Komisionin vlerësues në përbërje kryetari i Akademisë Hivzi Islami, akademiku Tahir Emra dhe anëtari korrespondent, Qamil Haxhibeqiri.

Komisioni, pasi e shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur dhe në përputhje me kushtet e kërkuara me konkurs, përzgjedhi për laureat të çmimit “Shpërblimi mbështetës 2014” dr. Qëndrim Gashin, profesor i asociuar në Departamentin e Matematikës të Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore të UP-së. Si një shfaqje e re në jetën tonë arsimore e shkencore, dr. Qëndrim Gashi, në moshën 18-vjeçare u diplomua në Departamentin e Matematikës të FSHMN-së, që ishte një përjashtim në Kosovë dhe më gjerë, dhe në moshën 23 vjeçare u doktorua në Universitetin e Çikagos të SHBA-ve. Në punën e tij arriti rezultate shumë të larta, të veçanta në fushën e

shkencës, konkretisht të shkencës së matematikës. Për realizimet e tij në këtë fushë u bë i njohur në botën e shkencës në të katër anët e globit.

Vlera materiale e “Shpërblimit mbështetës 2014” është 3.000 euro. Ky është donacioni i parë që vjen nga kompania “Ing Office, Sh. P. K.”, Gjilan, me përfaqësuesin inxhinier, Mejdi Rexhepin në krye, i cili është këtu dhe në emër të Akademisë e falënderoj shumë. Shpërblimi i dhënë mbi bazë të këtij donacioni, mendojmë se është një simbolikë e fuqishme, sepse përmes tij, kjo themelatë si më e larta e shkencës dhe e artit në Kosovë, ia njeh punën dhe meritat një të riu, pa i mbushur të 30-at, për atë që ka arritur deri më sot në fushën e shkencës, dhe e motivon për punë të mëtutjeshme produktive në shkencë, në këtë rast në shkencën e matematikës. Por ky shpërblim është një privilegj edhe për Akademinë që iu dha mundësia, në saje të donacionit në fjalë, ta laurojë një të ri me këto kualitete.

Raportin vlerësues për punën dhe rezultatet e arritura të dr. Qëndrim Gashit në shkencën e matematikës, do ta paraqesë anëtari korrespondent, dr. Qamil Haxhibeqiri, anëtar i komisionit dhe profesor e bashkëpunëtor i laureatit Gashi”.

Në fjalën e tij, anëtari korrespondent, Qamil Haxhibeqiri, pasi paraqiti biobilografinë për kandidatin, Prof. dr. Qëndrim Gashi, ndër të tjera tha:

“Edhe pse i ri në moshë (së shpejti do t’i mbushë 30 vjet), dr. Qëndrim Gashi, pa dyshim, është një punëtor i mirëfilltë shkencor. Me aktivitetin i tij shkencor e profesional ai e afërmoi shkencën tonë në mënyrën më të denjë në suaza ndërkombëtare. Jemi thellë të bindur që ai e meriton “Shpërblimin mbështetës 2014” që ASHAK-u e ndan për shkencëtarin më të ri dhe më të suksesshëm. Prandaj, me kënaqësi e propozojmë që ky shpërblim t’i ndahet dr. Qëndrim Gashit, profesor i asocuar, si mirënjohje për kontributin shkencor dhe si një shtytje për punën e tij të mëtejme shkencore dhe profesionale.”

Laureati prof. dr. Qëndrim Gashi, në fjalën e tij, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, falënderoi Akademinë për *Shpërblimin mbështetës*. Ai tha se ndjehet jashtëzakonisht i nderuar dhe i privilegjuar që merr këtë shpërblim, nga Institucioni më i lartë i Shkencës dhe i Artit në vend dhe u zotua se do ta mbajë me nder gjatë gjithë jetës dhe veprimtarisë së tij.

MBAHET LIGJËRATA INAUGURUESE E ANËTAR KORRESPONDENT SALIH GASHI

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, më 13 shkurt 2014, organizoi ligjërata të inauguruese të anëtarit korrespondent, Salih Gashi, më temë: ‘‘Proceset membranore dhe zbatimi i tyre’’.

Fjalën e hapjes më këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës, akademik Fejzullah Krasniqi.

AKADEMIK HIVZI ISLAMI DHE ANËTAR KORRESPONDENT EDI SHUKRIU INAUGUROHEN ANËTARË TË AKADEMISË EVROPIANE TË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE

Më 8 mars 2014, në Asamblenë e përgjithshme të Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve (ASAE), me seli në Salzburg të Austrisë, u bë inaugurimi solemn i dy anëtarëve të kësaj Akademie, prof. dr. Hivzi Islami - demograf, anëtar i rregullt i ASHAK-ut dhe kryetar aktual i saj, dhe prof. dr. Edi Shukriut - arkeologe, anëtare korrespondente. Akademikët Islami dhe Shukriu në nëntor të vitit 2013 ishin zgjedhur anëtarë të Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve.

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT ME AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË MAQEDONISË

Në Prishtinë, më 11 mars 2014, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Maqedonisë, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit në fushat e shkencave dhe arteve.

Marrëveshja u nënshkrua në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nga Kryetari i ASHAK-ut, Akademik Hivzi Islami dhe Kryetari i Akademisë së Maqedonisë, Akademik Vlado Kambovski.

Para ceremonisë së nënshkrimit u zhvillua takimi në mes të udhëheqjes së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe delegacionit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë.

Kryetari i MANU-së, Akademik Vlado Kambovski, shoqërohej nga nënkryetari, Akademik Lupço Kocarev, Sekretari, Akademik Gjorgji Stardellov, dhe akademikët Alajdin Abazi e Luan Starova, dhe nga Ambasadori i Maqedonisë në Kosovë, H.E. Stojan Karajanov.

Format e bashkëpunimit ndërakademik, mes të tjerash, do të jenë përmes modaliteteve: takime bilaterale shkencore, simpoziume, konferenca dhe seminare pune, si dhe aktivitete në fushën e arteve që mbulohen nga palët; shkëmbim të shkencëtarëve; shkëmbim të informacioneve dhe publikimeve; mbajtje të ligjëratave; dhe aktivitete të tjera, nëse është e nevojshme, sipas marrëveshjes ndërmjet të dy palëve.

ANËTAR KORRESPONDENT ARSIM BAJRAMI, NË KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE, NË UNIVERSITETIN SHQIPTAR TË TETOVËS

Më 11-13 mars, anëtari korrespondent, Arsim Bajrami, ka përfaqësuar ASHAK-un në Konferencën shkencore ndërkombëtare, me titull: "Demokracia dhe sfidat e transicionit demokratik", mbajtur në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Profesor Bajrami ka paraqitur kumtesën me titull: "Sfidat e transicionit në Kosovë".

MBAHET NË PRISHTINË MBLEDHJA E KËSHILLIT NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN SHQIPE

Në mjediset e Qendrës leksikografike-enciklopedike të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 14 mars 2014, u mbajt mbledhja e radhës e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe. Mbledhja u mbajt nën drejtimin e akad. Rexhep Ismajlit dhe akad. Jani Thomait (bashkëkryetarë), me pjesëmarrjen e akademikëve: Besim Bokshi, Ethem Likaj, Kolec Topalli, Gjovalin Shkurtajt, profesorë doktorët: Shezai Rrokajt, Mehmet Çeliku, Seit Mansaku, Enver Hysa, Tomor Osmani, Imri Badallaj, Shefkije Islamaj, Bardh Rugova, Rrahman Paçarrizi, Abdullah Zymberi dhe ligjëruesi, Isa Bajçinca.

Diskutimet u zhvilluan në tri seanca, sipas materialeve të parapërgatitura nga grupet e punës për çështje të drejtshkrimit dhe të morfologjisë nga Tirana, si dhe nga anëtari i Këshillit e i kryesisë së tij akademik Kolec Topalli, të diskutuara me shënime të veçanta edhe nga grupet përkatëse nga Prishtina.

MBAHET LIGJËRATA INAUGURUESE E ANËTAR KORRESPONDENT ARSIM MORINA

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, më 28 mars 2014, organizoi ligjëratën inauguruese të anëtarit korrespondent, prof. dr. Arsim Morina, më temë: “Shkenca e Neurokirurgjisë sot”.

Fjalën e hapjes me këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit, akademik Fejzullah Krasniqi.

ANËTAR KORRESPONDENT LUAN MULLIQI, NË RUMANI

Më 2-6 prill, anëtari korrespondent në ASHAK, Luan Mulliqi, me ftesën e galerisë Triada Timisuara, ka marrë pjesë në ekspozitën personale, në të cilën ka paraqitur 20 punime të derdhura në bronz. Ekspozita ka zgjuar interesim, si te kritika, ashtu edhe te mjetet e informimit dhe të publikut prezent. Profesor Mulliqi, po ashtu, ka marrë pjesë edhe në tryezën: “Mundësitë e bashkëpunimit kulturor rajonal”.

AKADEMIK EQREM BASHA, NË TUBIMIN E ALLEA-s.

I deleguar nga ASHAK, akademik Eqrem Basha, ka marrë pjesë në tubimin e ALLEA-s (All European Academies), në Bruksel, më 8-10 prill 2014. Ai është takuar me përfaqësues të Akademisë Mbretërore Flamane, me të cilët Akademia jonë ka marrëveshje bashkëpunimi. Akademik Basha, po ashtu, ka marrë pjesë edhe në ceremoninë në të cilën ndahej Çmimi i lartë i ALLEA-s, ku pos përfaqësuesve të shumë Akademive Europiane, prezent ishte edhe Kryetari i Komisionit European, Jose Emanuel Baroso.

LIGJËRATË INAUGURUESE E EDI SHUKRIUT

Në mjediset e Akademisë, më 17 prill 2014, u mbajt Ligjëрата inauguruese e anëtares korrespondente, Edi Shukriu, më temë: “Tej imazhit arkeologjik – Kozmologjia dardane”.

Fjalën e hapjes, me këtë rast, e mbajti Sekretari i Seksionit të Shkencave Shoqërore akademik, Mark Krasniqi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit tha se ligjëрата inauguruese po mbahet me rastin e zgjedhjes së prof. Shukriut, anëtare korrespondente e ASHAK-ut.

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI, NË ASAMBLE TË PËRGJITHSHME TË ALLEA-s

Më 23-26 prill 2014, akademik Rexhep Ismajli, ka qëndruar në Oslo. Në mjediset e Akademisë Norvegjeze të Shkencave dhe të Arteve në Oslo, ai ka marrë pjesë në Asamblenë e XV-të e përgjithshme të ALLEA-s. Në kuadër të punimeve të Asamblesë, akademik Ismajli, ka marrë pjesë në Simpoziumin me temën: ‘Enabling Early Carrier Researchers – Need for Training of a New Generation’.

ASHAK NË FESTIVALIN E LIBRIT DHE ARTIT

Më 23-27 prill, në Tiranë, ASHAK-u mori pjesë me botimet e veta në *Festivalin e Parë të Librit dhe Artit, Tirana 2014*. Manifestimi u mbajt në Muzeun Historik Kombëtar dhe u organizua nga Shoqëria e Librit Shqip.

AKADEMIK ZEQRIRJA BALLATA, NË SIMPOZIUMIN NDËRKOMBËTAR MBI ARTET NË SOFJE

Me ftesë të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë, në kuadër të Protokollit të bashkëpunimit ASHAK-BAS, akademik Zeqirja Ballata ka marrë pjesë në Simpoziumin 5-ditor ndërkombëtar mbi artet, të organizuar nga Instituti i Studimeve të Arteve të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë.

Akademik Ballata është paraqitur me kumtesën: ‘Mbi disa veçori të kompozitorëve shqiptarë të Kosovës, të shekullit XX-të.’

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI, NË PLENUMIN SOLEMN TË AKADEMISË AUSTRIAKE TË SHKENCAVE

Më 15-19 maj, akademik Rexhep Ismajli, ka qëndruar në Vjenë ku ka marrë pjesë në Plenumin Solemn të Akademisë Austriake të Shkencave. Ai ka marrë pjesë edhe në organizimet e tjera, në kuadër të plenumit, si dhe ka realizuar takime të rëndësishme.

TRAJNIMI PËR FJALORIN ENCIKLOPEDIK

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, përkatësisht Redaksia Qendrore e FEK-ut ka organizuar takim pune për Fjalorin Enciklopedik të Kosovës në Durrës, nga 9-12 qershor 2014.

Në takim kanë marrë pjesë: Redaksia Qendrore e Fjalorit dhe redaktorët e fushave përkatëse të FEK-ut, me përjashtim të ndonjë zëvendësimi të tyre nga një anëtar i redaksisë përkatëse. Takimi është realizuar sipas programit të paraparë.

ÇMIMI STIMULUES I FONDIT

Më 16 qershor 2014, u organizua ceremonia solemne e ndarjes së *Çmimit stimules* për veprën më të mirë nga lëmi i shkencave të Natyrës për tre vjetët e fundit (2011-2013). Laureati i këtij çmimi u zgjodh prof. dr. Lulzim Zeneli. Fjalën e hapjes me këtë rast e mbajti akademik Fejzullah Krasniqi, ndërsa për veprimtarinë shkencore të prof. Zenelit foli akademik Nexhat Daci, i cili e vlerësoi lartë punën e tij. Në fund, prof. Zeneli falënderoi ASHAK, për çmimin e dhënë.

TRYEZË SHKENCORE

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Shkencave Shoqërore, organizoi Tryezën shkencore “Arkeologjia në trojet shqiptare: “Sfidat dhe mundësitë”.

Tryeza u mbajt të enjten, më 19 qershor 2014, me fillim në orën 9:30, në mjediset e Akademisë. Fjalën e hapjes e mbajti sekretari i Seksionit akademik Mark Krasniqi.

AKADEMIK PAJAZIT NUSHI, NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE KUSHTUAR AKADEMIKUT JASHAR REXHEPAGIQI

Me ftesë të Akademisë Pedagogjike të Tiranës, akademik Pajazit Nushi, më 22-23 maj, ka marrë pjesë në Konferencën ndërkombëtare me titull: “Akademik Jashar Rexhepagiqi dhe mendimi social-pedagogjik i tij”. Akademik Nushi është paraqitur me kumtesën e tij: “Psikologjia dhe pedagogjia në mendimin social-pedagogjik të akademik Jashar Rexhepagiqi”.

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI DHE ANËTAR KORRESPONDENT EDI SHUKRIU, NË BUDAPEST

Më 25-27 maj, akademik Rexhep Ismajli dhe Anëtar Korrespondent Edi Shukriu, kanë marrë pjesë në Konferencën shkencore, me titull: “Albanians and Hungarians Historical Similarities and Differences in Centuries- The Contribution of Their

Diasporas in Their Mutual Recognition”të organizuar nga Universiteti i Budapestit.

ANËTAR KORRESPONDENT SALIH GASHI QËNDRON NË KOPENHAGEN

Më 21-26 qershor anëtar korrespondent Salih Gashi ka qëndruar në Kopenhagen, ku ka marrë pjesë në tubimin:”Euroscience Open Forum (ESOF). Ai ka realizuar edhe takime të rëndësishme në kuadër të zhvillimit të shkencës dhe orientimet për të ardhmen.

ASHAK MERR PJESE NË SHKOLLËN VERORE DHE KONFERENCËN LET’S FACE CHAOS THROUGH NONLINEAR DYNAMICS

Më 22 qershor, deri më 6 korrik 2014, në Maribor u mbajt shkolla verore dhe konferenca: “Lets’s Face Chaos Through Nonlinear Dynamics”.

Në emër të ASHAK-ut, në këtë ngjarje, mori pjesë prof. dr. Qëndrim Gashi.

KONCERT VEPRASH VOKALO-PIANISTIKE

Seksioni i Arteve i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 3 korrik 2014, në mjediset e Akademisë organizoi Koncert veprash vokalo-pianistike, me vepra të përzgjedhura kompozitorësh të njohur: Wolfgang Amadeus Mozart, Franz Lehar, Kozma Lara, Esat Rizvanolli, Fahri Beqiri, Zeqirja Ballata, Rauf Dhomi.

Artistët: Besa Llugini - soprano, Armando Likaj – bariton, Lejla Haxhiu Pula - piano, Etrita Ibrahimimi - piano, Çun Lajqi - aktor, realizuan me shumë sukses programin e paraparë.

TUBIM SHKENCOR-GJUHA E SIMETRIVE

Më 11 korrik 2014, në sallën e Akademisë, Seksioni i Shkencave të Natyrës, përkatësisht Këshilli organizativ: dr. Qamil Haxhibeqiri (ASHAK), dr. Masoud Kamgarpour (Universiteti i Kuinslandit) dhe dr. Qëndrim Gashi (Universiteti i Prishtinës), organizoi Tubimin shkencor me titull: “Gjuha e simetrive - një këndvështrim nga teoria e përfaqësimit dhe gjeometria”

Referues në këtë tubim ishin: dr. Ethan Cotterill - Universiteti Federal Fluminense, Brazil, dr. Harald Grobner - Universiteti i Vjenës, Austri, dr. Masoud Kamgarpour - Universiteti i Kuinslendit, Australi, Robert Kremser - Universiteti i Mynihut, Gjermani, dr. Marie-Amelie Lawn - Universiteti i Teksasit, Austin, SHBA, dr. Justin Noel - Universiteti i Regensburgut – Gjermani dhe dr. Travis Schedler - Universiteti i Teksasit, Austin, SHBA.

MBAHET NË TIRANË MBLEDHJA E KËSHILLIT NDËRAKADEMIK PËR GJUHË SHQIPE (KNGJSH)

Më 20 qershor 2014, në Tiranë, në mjediset e Bibliotekës së Akademisë së Shkencave, u mbajt mbledhja e radhës e Këshillit Ndëraakademik për Gjuhën Shqipe, nën drejtimin e akademikëve: Jani Thomai e Rexhep Ismajli (bashkëkryetarë) dhe me pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit: akademikët Kolec Topalli e Gjovalin Shkurtaj dhe profesorët Mehmet Çeliku, Seit Mansaku, Shezai Rrokaj, Shefkije Islamaj, Enver Hysa, Isa Bajçinca, Imri Badallaj, Abdullah Zymberi, Bardh Rugova e Rrahman Paçarizi.

Në rendin e ditës për diskutim pati dy çështje:

1. Çështje të sintaksës në shqipen standarde.
2. Shqipja standarde dhe shkolla.

Për të dy çështjet u paraqitën parashtrësata e hartuara nga grupet përkatëse të punës, në Tiranë e në Prishtinë, në të cilat shtroheshin vëzhgimet për gjendjen dhe propozimet për përmirësime të mëtejshme në përdorimin e zbatimin e shqipes standarde.

Këshilli arriti këto përfundime e propozime:

1. Meqë cikli nëntëvjeçar nuk po arrin dot t'ua mësojë mirë nxënësve të gjitha nënsistemet e shqipes standarde, si në të shkruar ashtu edhe në të folur, propozohet që gjuha shqipe në planin mësimor të shkollës së mesme të jetë lëndë e veçantë, e ndarë nga letërsia, dhe të jepet provim pjekurie në përfundim të shkollimit parauniversitar.

2. U miratua propozimi që në të gjitha shkollat e mesme, të të gjitha profileve, lënda e gjuhës të mësohet gjatë tri viteve, me një program të ri dhe me tekste të reja.

3. U mbështet propozimi që në vitet e para të ciklit nëntëvjeçar (cikli fillor) në mësimin e gjuhës shqipe t'i jepet përparësi anës praktike, zotërimit të standardit, bashkë me leximin; në vitet në vazhdim të ciklit nëntëvjeçar (klasa VI-IX) dhe në ciklin e shkollës së

mesme, gjuha të mësohet në aspektin teorik, por, krahas kësaj, t'u jepet rëndësi e veçantë leximit të letërsisë artistike dhe punëve me shkrim, hartimeve e diktimeve.

4. U arrit përfundimi që planet e programet në fakultetet e mësuesisë, përfshirë ato të gjuhëve të huaja, e në fakultetet që përgatisin edukatorë për institucionet parashkollore, si dhe në fakultetet e gazetarisë, ka nevojë të rishikohen, duke u dhënë shtrirje më të gjerë lëndëve kryesore të gjuhës së sotme, si leksikologjia, morfologjia, sintaksa. Mendohet që përvetësimi i drejtshkrimit duhet të përfundojë në shkollimin parauniversitar. U propozua që lënda “Kulturë gjuhe” të përfshihet në programet e universiteteve, në radhë të parë në fakultetet e mësuesisë, të gazetarisë, të gjuhëve të huaja, të arteve, të drejtësisë, të mjekësisë etj., me synimin e zotërimit sa më të mirë të normës leksikore, gramatikore, stilistike e terminologjike, në funksion të komunikimit sa më të plotë.

5. U pa e arsyeshme të kërkohet për t'u zbatuar nga institucionet përkatëse:

- rritja e orëve mësimore për lëndën e gjuhës në ciklet nëntëvjeçare;
- reduktimi i normës mësimore për mësuesit e gjuhës;
- mësimi i gjuhës shqipe në ciklet parauniversitare, nëpërmjet teksteve e mësuesve, sipas koncepteve teorike e terminologjike bashkëkohore;
- trajnimi i mësuesve të gjuhës në kurse periodike katërvjeçare;
- hartimi i teksteve për fëmijët e emigrantëve, sipas një politike në ndihmë të emigracionit;

6. Përgatitja e gjuhës shqipe në universitete duhet të jetë përparësi e arsimit universitar, ndërsa mësimdhënës i lëndës së gjuhës dhe të letërsisë shqipe në nivelet e ulëta e të mesme nuk mund të jetë askush që nuk ka, së paku, 180 kredite (ECTS) të lëndëve profesionale sipas planprogrameve të shkollave përkatëse. Ndonëse nismat për përmirësimin e cilësisë në arsim kanë propozuar shtimin e komponentit didaktik, kujtojmë se kompetenca gjuhësore është parakushti themelor për mësimdhënie cilësore.

7. Albanologjia, me shqipen në veçanti, duhet të jetë përparësi e investimeve shkencore të qeverive përkatëse. Përqindje të konsiderueshme të investimeve për shkencë e kërkime shkencore

duhet të jepen për projekte që lidhen me albanologjinë. Duhet të ngrihet departament i veçantë për gjuhën shqipe (përdorimet, terminologjitë, përshtatjet me standardet evropiane, ku po synojmë të integrohemi) në kuadër të ekzekutivit (mbase brenda ministrive të Arsimit a të Kulturës).

8. Në shkolla t'i kushtohet vëmendje diversitetit kulturor e begatisë dialektore të shqipes, në mënyrë që të mos krijohet hapësirë për stigmatizim të cilitdo varieteti të shqipes.

MBLEDHJA PËRKUJTIMORE PËR AKADEMIK BESIM BOKSHIN

Më 16 gusht 2014, vdiq akademik Besim Bokshi. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës mbajti mbledhjen komemorative, më 17 gusht.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami, i cili ndër të tjera tha:

“E nderuara familje Bokshi,
Të nderuar kolegë dhe miq,
Zonja dhe zotërinj,

Jemi mbledhur sot këtu, në mjediset e Akademisë, për t'i bërë nderimet e fundit anëtarit të rregullt të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe ish-kryetarit të saj, dijetarit dhe personalitetit që pati një rrugë të bujshme jetësore, intelektuale, shkencore-hulumtuese dhe publike, akademik Besim Bokshit.

Ju ftoj që me një minutë heshtje ta nderojmë bashkëshortin, prindin, gjyshin, mikun dhe kolegun tonë të dashur profesor Besim Bokshin. Akademik Bokshi bën pjesë në lagjen e personaliteteve më të shquara në fushën e shkencës, të arsimit dhe të kulturës shqiptare në Kosovë dhe jashtë saj këto 6 dhjetëvjetëshat e fundit, ku la gjurmë të pashlyeshme në jetën letrare-kulturore, kombëtare dhe intelektuale, në dijet albanologjike dhe veçanërisht në gjuhësinë shqiptare, duke u gjendur në majat e saj. Punën e tij e filloi në Gjakovën arsimdashëse dhe patriotike, ku në vitet e 50-ta e të 60-ta të shek. të kaluar ushtroi funksione të ndryshme në arsim dhe kulturë, për të arritur deri te bashkëpunëtori shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, të cilit në fillimet e tij i dha mbështetje të fuqishme profesionale, pastaj u zgjodh profesor i Universitetit të Prishtinës dhe anëtar i rregullt i Akademisë dhe nënkryetar dhe kryetar i saj. U shqua dhe në afirmimin

e vlerave kombëtare e kulturore-civilizuese të shqiptarëve dhe në organizimin e institucioneve shkencore, pedagogjike e kulturore të Kosovës. E deshi shumë Gjakovën, por edhe ajo e deshi dhe e respektoi shumë, duke ia akorduar çmimin qytetar i nderit të qytetit. Deri në minutën e fundit të jetës nuk pushoi të kontribuojë në fushën e shkencës së gjuhësisë dhe albanistikës në përgjithësi, duke zgjeruar opusin e tij shkencor me botime të reja. Për këtë dëshmon edhe dorëshkrimi që la të finalizuar, i cili këto ditë shkon në shtyp, gjithnjë në fushën e gjuhësisë shqiptare, por nuk pati jetë që ta priste daljen në dritë të tij. Vepra e tij shkencore në sferën e gjuhësisë do të mbetet pa dyshim burim reference për brezat e sotme dhe të nesërme. Pa akademik Bokshin nuk ka dyshim që gjuhësia dhe kultura shqiptare do të ishin më të varfra. Trashëgimia e ndritshme që la pas e bëjnë të pavdekshëm shkencëtarin dhe krijuesin, profesor Besim Bokshin.

Me këtë rast Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së akademikut Besim Bokshi, si dhe të gjithë miqve dhe shokëve të tij të shumtë anë e mbanë Kosovës dhe trojeve shqiptare”.

Për jetën dhe vdekjen e akademik Bokshit fjalë rasti mbajti akademik Rexhep Ismajli, nga e cila veçuam:

“I nderuar z. Kryetar i Akademisë,

Zonja Muhamedije, Astrit, Shkëndije, Ilir, familja Bokshi, miq e kolegë të pikëlluar.

Dje pushoi së rrahuri zemra e dijetarit dhe poetit, e të urtit, studiuesit, vrojtuesit e këshilltarit të durimshëm, albanologut që gjithë jetën e tij kërkoi dhe gjeti shpjegime për mistere të fshehura në historinë e pashkruar të thesarit tonë më të madh të gjuhës, poetit që me dritën e mendjes përjetësonte e luçidonte qeniesimin tonë të përkohshëm, të vështirë e të mundimshëm, vinte çdo ditë nga një gur në themelin e krenarisë sonë.

Me studimet që shënojnë majat e albanistikës, me krijimet e veçanta letrare poetike, me veprimtarinë intelektuale publike, me jetën e tij frymëgjatë arsimuese për brezat e shekullit që shoi robërinë, me punën e tij të themeltë shoqërore e politike, me angazhimet në Lëvizjen për pavarësi të vendit, Akademik Besim Bokshi shquhet në horizontet e dijeve, të kulturës dhe të botës shqiptare. I lindur në Gjakovë më 1930, i diplomuar në albanologji më 1958, i doktoruar në shkencat filologjike me specializim në fushë të historisë së gjuhës shqipe në Prishtinë më 1978, profesor dhe drejtor i gjimnazit në

Gjakovë, profesor dhe Drejtor i SHLP në Gjakovë, profesor dhe Shef i Degës së Gjuhës Shqipe në FF/ F të UP-së, anëtar i ASHAK-ut nga 1989, nënkryetar i ASHAK-ut 2002- 2008 dhe kryetar nga viti 2008-2011, pjesëmarrës aktiv dhe bashkëhartues i Konkluzave të Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, pjesëmarrës i Kongresit të Drejtshkrimnit, drejtues i Komisionit për Gjuhë i ASHAK-ut, anëtar i Këshillit Ndërkademiq për Shqipen Standarde, akademik Besim Bokshi ishte i pranishëm në mënyrë të vazhdueshme, të qetë, por me veprim të themeltë, në jetën tonë plot të papritura, dhe ngado që sillej linte gjurmë të pashlyeshme kulturore, shkencore, arsimore e emancipuese shoqërore në botën shqiptare qysh nga vitet '50 të sh. XX. Prania e tij në gjithë këtë gamë përpjekjesh të botës shqiptare në një histori tashmë të pikatur për rropatjet e turbulencat, do të mbetet e shënuar me ndihmesat thelbësore, me rezultatet që çojnë peshë, me orientimet ndriçimtare, me synimet për çlirimin nga vargojt e të gjitha llojeve. I dijshtëm dhe i urtë, shembull korrekte ndaj tjetrit, vrojtues i thellë e me veprime të matura por të vendosura, deri në fund të përgjegjshme, Besim Bokshi ishte bërë një lloj shenje orientuese për ata që e rrethonin, për ata që ndjenin rrezet e dritës së mendjes së tij, për ata që mësuan prej tij, për ata që shijuan bukurinë dhe thellësinë e fjalës së tij, për ata që vlerësuan moralin dhe mësimin shembullor moral prej veprës dhe veprimtarisë së tij, për të gjithë ata që nga Gjakova e në tërë Kosovën, në hapësirat e dijeve e të jetës kërkonin horizonte të lirisë, të dinjitetit, të krijimit e të lumturisë njerëzore.

Në veprimtarinë e tij shoqërore, Besim Bokshi, ishte gjithnjë i lidhur me fushën e arsimit, ku shkëlqeu me aurën e tij prej të dijshtëmit, të thellit, të urtit kërkues të së drejtës e të barazisë, dhe pikërisht në bazë të një autoriteti të tillë vazhdimisht ishte kërkuar nga ai të angazhohej në funksione të ndryshme shoqërore, të jepte ndihmesën e tij për zgjerimin e horizonteve të lirisë, nga deputeti i Kosovës në fund të viteve '60 e deri te Kryetari i Partisë Socialdemokrate të Kosovës në vitet e rënda '90.

Në letrat shqipe, emri i Besim Bokshit, shfaqet në vitet '50 me poezitë me ngjeshje të madhe semantike e emocionale në temën e poezisë refleksive e shoqërore, me vulën e protestës, me metaforikën e thellë e me simbolikën kombëtare, poezi që zhytet në thellësitë dhe degëzimet e simboleve, të kuptimeve. Në poezinë e Bokshit, edhe tematizimet sociale marrin vulën e refleksionit, shprehen me një figuracion të kursyer, por të thellë. Jo rrallë, në të gjejmë reflekse të thelluara me shprehje finoke të qëndrimeve, të distancave ndaj

padrejtësisë, ndaj pabarazisë, ndaj shkeljeve të dinjiteti njerëzor, ndaj cenimit të lirisë, në pritje të së cilës edhe kur të plakem, siç thoshte ai në poezinë e bukur ‘Në pritje’, ‘e s’do të mundem me qeshë si flladi i pranverës’, “Me vdekë, porse, nga gëzimi do të mundem”.

Shkëlqimin madhor të mendjes krijuese, akademik Besim Bokshi, e shënoi në studimet për gjuhën shqipe, ku vlen ndër autoritetet më të mëdha. Me hulumtimet frymëgjata e të thelluara në fushën e linguistikës, në fushën e strukturës gramatikore të shqipes, me vrojtimitet e rëndësishme për strukturat gramatikore të gjuhëve të Ballkanit, me akribinë shembullore shkencore, akademik Besim Bokshi, ka sjellë kontribute me vlerë të jashtëzakonshme. Ndihtmesat e tij për studimet e zhvillimeve gramatikore të shqipes zënë vend të veçantë për origjinalitetin e mënyrës së hulumtimit, për rezultatet e shumta, për thellimin krejt të veçantë, për vështirimin sistemor e struktural në këto studime, për orientimin e përgjithshëm të tyre drejt horizonteve të reja, për krijimin e një koncepti koherent dhe konsistent për rrugët e zhvillimeve morfologjike, në ndërlidhje me zhvillimet e tërësishme strukturore të shqipes. Duke i integruar studimet për strukturën gramatikore të shqipes në rrjedhat studimore të kohës, duke i shpënë ato ndjeshëm përpara dhe modernizuar në metodë, akademik Besim Bokshi e ka rritur kredibilitetin e studimeve albanistike shqiptare në komunitetin e studiuesve të gjuhës dhe ka krijuar një model për të ndjekur nga të rinjtë.

Po lejojmë të shquaj me këtë rast disa prej veprave të tij madhore. Në gjuhësinë shqiptare, ai u shfaq më 1971, me studimin befasishtë të thellë për tipat e temave nominale në gjuhën shqipe.

Më 1978, Bokshi, përfundoi monografinë “Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes”, vepër në të cilën dalin në shesh cilësitë kryesore të linguistit Bokshi: orientimi rezolut diakronik, por prandaj me vështirim të thelluar në funksionimin sinkronik të sistemit gjuhësor. Në studimet e gramatikës historike të shqipes, me atë vepër, futeshin nëpër derë të madhe metodat gjuhësore mbisunduese të shekullit 20, ato që gjuhën e shihnin si sistem. Kjo monografi e Besim Bokshit mbetet një nga veprat me rëndësi themelore për studimet në fushën e gramatikës historike të shqipes në tërësi. “Prapavendosja e nyjave në gjuhët ballkanike” është një libër tjetër me vlerë i Besim Bokshit për albanologjinë dhe për ballkanologjinë, vepër në të cilën hipoteza për ngjizjen e procesit të prapavendosjes së nyjës në gjuhët e Ballkanit ka nisur pikërisht në

shqipen vjen e bëhet një teori e rëndësishme, refuzimi i së cilës tashmë nuk është gjë e lehtë.

Ai na ka dhënë një monografi të rëndësishme që na shpie drejt shpjegimeve edhe të sistemit foljor, po me këto rrugë e procedime: monografinë “Pjesorja e shqipes”. Depërtime të ngjashme të Bokshit ndeshim dhe në monografinë me shumë interes “Për vetorët e shqipes”, ndërsa kërshëri të madhe zgjon libri i tij i fundit “Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes”, që paraqet një vepër sintetizuese për idetë dhe për periodizimet e propozuara deri tash mbi bazë të të dhënave vetëm gjuhësore. Me këtë libër, Bokshi ka bërë dhe një hap tjetër me rëndësi, duke vënë kështu një rend që mund të nxisë ide të reja më tej. Akademik Besim Bokshi, nuk reshti së studiuar deri në frymën e fundit të jetës së tij. Para pak javësh shkoi në shtyp vepra e tij më e re “Varia”, ku përfshihen diskutime për çështje të veçanta shkencore, por edhe për personalitete të dijes e të jetës shoqërore. Për fat të keq, ai nuk arriti ta shihte dritën e këtij botimi. Pak ditë më herët, ai më fliste për një projekt të tij të ri studimi, për të cilin po punonte edhe në atë gjendje të rënduar e me probleme shëndetësore. Horizontin e studimeve të tij gjuhësore akademik Besim Bokshi e kishte lidhur me nevojën për shpjegimet e zhvillimeve që kanë ndodhur në një gjuhë me lashtësi të madhe, por me dokumentim të vonë. Të kuptuarit e funksionimit të sotëm të kësaj gjuhe i jepte atij dritën e çelësit shpjegues për rrugët e atij zhvillimi. Dhe, atë funksionim, ai e kishte hetuar me tërë frymën dhe thellësinë e mendjes, gjë që shpesh, në mbisundimin e nevojës për shpjegimet diakronike, mbetej implicite, e nënkuptuar, e kërkueshme nga lexuesi, frymëzuese për atë që hyn në dialog me të. Dhe kjo u siguron veprës dhe ideve të tij jetëgjatësinë.

Në poezi, si në aforizma, në gjuhësi apo në jetë, Besim Bokshit i përshtatet thënia: për thelbësoren fol në mënyrë thelbësore. Me thellësinë, me refleksivitetin prej të urti, me vendosmërinë dhe guximin prej hulumtuesi të përkushtuar, me lirinë dhe dritën e mendjes, me afërsinë njerëzore, me butësinë dhe dashamirësinë e tij, me përmbajtjen e respektin ndaj tjetrit, që rrezaton qetësi e siguri tek rrethi, akademik Bokshi, ka bërë që mjedisi ku ka vepruar të ndjehet krenar që e ka pasur në shkollë, në Universitet, në Akademi, në institucione apo jashtë tyre, në rrethin e gjerë dhe në horizontet e jetës. Për familjen dhe rrethin e të afërmeve shuarja e të dashurit është e rëndë, ndërsa për kulturën, dijen dhe botën shqiptare e pakom-

pensueshme. Ngushëllimin duhet ta gjejmë në veprën që na ka lënë, në dritën e mendjes që do të vijojë të na ndriçoj”.

Pas mbledhjes komemorative u bënë homazhe të shumta pranë trupit të të ndjerit dhe më pas, kortezhi funeral u nis për në varrezat e Gjakovës.

Pranë varrit të akademik Bokshit, në praninë e shumë strukturave udhëheqëse, qytetarëve të Gjakovës dhe më gjerë folën: akademik Pajazit Nushi, në emër të ASHAK-ut, përfaqësues nga ASHSH-ja dhe Kryetari i Asamblesë komunale të Gjakovës.

AKADEMIK ENGJËLL BERISHA NDEROHET ME ÇMIMIN KOMBËTAR PËR VEPËR JETËSORE

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Memli Krasniqi, më 17.09.2014, në një ceremoni solemne, ia ka ndarë Çmimin Kombëtar për Vepër Jetësore “Niketë Dardani” për fushën e muzikës, kompozitorit dhe pedagogut të njohur shqiptar, akademik Engjëll Berisha.

KONFERENCË SHKENCORE: Lufta e Parë Botërore dhe Çështja Shqiptare 1914-1918.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Shkencave Shoqërore, organizoi Konferencën shkencore “Lufta e Parë Botërore dhe çështja shqiptare 1914-1918”.

Konferenca u mbajt, të premtën, më 19 shtator 2013, me fillim në orën 10:00, në mjediset e Akademisë.

Konferencën e shpalli të hapur. me një fjalë rasti. akademik Pajazit Nushi.

Anëtarë të Këshillit Organizues ishin Jusuf Bajraktari, Beqir Meta, Fehmi Rexhepi, Marenglen Verli, Frashër Demaj, Lush Culaj.

Me kumtesat e tyre në konferencë u paraqitën:

1. Beqir META, Ndikimi i Luftës së Parë Botërore në procesin e konsolidimit të kombit shqiptar.
2. Jusuf BAJRAKTARI, Kosova dhe viset tjera shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore.
3. Marenglen VERLI, Shqipëria në optikën e diplomacisë vjeneze në prag të Luftës së Parë Botërore.

4. Anton PANÇEV, Statistikat bullgare mbi popullsinë e Kosovës në Luftën e Parë Botërore.
5. Skender ASANI, Viset lindore shqiptare nën okupimin serb 1912-1915.
6. Fehmi REXHEPI, Zona okupuese bullgare gjatë Luftës së Parë Botërore në Kosovë.
7. Frashër DEMAJ, Diplomacia e Fuqive të Mëdha gjatë Luftës së Parë Botërore.
8. Isa BICAJ, Mali i Zi dhe shqiptarët gjatë Luftës së Parë Botërore.
9. Islam LAUKA, Lufta e Parë Botërore dhe konflikti aktual Rusi-Ukrainë.
10. Teki KURTI, Shtypi shqiptar për Luftën e Parë Botërore.
11. Ramë MANAJ, Lënda arkivore për Luftën e Parë Botërore në Arkivin e Kosovës.
12. Lush CULAJ, Protestat e shqiptarëve dërguar Konferencës së Versajës. Fjalën përmbyllëse e mbajti anëtari korrespondent Jusuf Bajraktari.

TRYEZË SHKENCORE ‘‘UJITJA NË KOSOVË - Menaxhimi i ujërave për bujqësi të qëndrueshme’’.

Seksioni i Shkencave të Natyrës i ASHAK-ut organizoi, më 16 tetor 2014, tryezën shkencore ‘‘Ujitja në Kosovë - Menaxhim i ujërave për bujqësi të qëndrueshme’’.

Anëtarë të Këshillit Organizues ishin: Ruzhdi Pllana - anëtar korrespondent i ASHAK-ut, Feriz Krasniqi - akademik dhe prof. dr. Bashkim Kabashi.

Fjala hyrëse u mbajt nga akademik Fejzullah Krasniqi, ndërsa fjala përshëndetëse nga Ruzhdi Pllana, anëtar korrespondent i ASHAK-ut. Tryeza u zhvillua në dy sesione gjatë të cilave u paraqitën kumtesat e pjesëmarrësve si dhe u zhvilluan diskutime pas secilit sesion. Kumtesat u lexuan nga këta pjesëmarrës: Bashkim Kabashi, Ruzhdi Pllana, Mazllum Baraliu, Besnik Gjongecaj, Latif Susuri, Sylejman Daka, Shukri Fetahu, Sali Aliu, Justina Boriqi, Besim Sahiti, Lavdim Lepaja, Demë Abazi dhe Sami Kryeziu. Disa nga kumtesat ishin kumtesa të përbashkëta. Në fund pjesëmarrësit u pajtuan që të dalin me konkluzione të përbashkëta rreth tryezës shkencore.

ANËTAR KORRESPONDENT ARSIM BAJRAMI, NË MAQEDONI

Më 5-6 nëntor, me ftesë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë, anëtar korrespondent Arsim Bajrami, ka marrë pjesë në konferencën shkencore kushtuar projektit të bashkëpunimit rajonal, në të cilën kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të akademive të tjera, si: Shqipëria, Bullgaria, Turqia, Moldavia.

NË TIRANË MBAHET KONFERENCA SHKENCORE, KUSHTUAR 200-VJETORIT TË LINDJES SË DE RADËS

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, më 11 nëntor 2014, organizoi Konferencën shkencore kushtuar 200-vjetorit të lindjes së Jeronim De Radës. Nga Akademia jonë, në këtë konferencë morën pjesë akademikët: Ali Aliu dhe Sabri Hamiti.

Ali Aliu u paraqit me kumtesën: Vizioni testamentar i De Radës “Tek parimet e estetikës”, ndërsa Sabri Hamiti paraqiti kumtesën: “Milosao”.

ASHAK MERR PJESË NË PANAIRIN E LIBRIT “TIRANA 2014”

Më 12-16, nëntor në Tiranë, në Panairin e 17-të të librit, “Tirana 2014” në mesin e rreth 100 shtëpive botuese, institucioneve shkencore dhe arsimore nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia, përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Francës, Italisë dhe të Suedisë, me botimet e veta është paraqitur edhe ASHAK. Stenda ka qenë e vendosur në hollin kryesor të Pallatit të Kongreseve, kurse ASHAK ka pasur prezantim të dinjitetshëm dhe të suksesshëm.

ANËTAR KORRESPONDENT, EDI SHUKRIU, MERR PJESË NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE “INTEGRIMI KULTUROR DHE STABILITETI NË BALLKAN”

Më 25-27 nëntor, Anëtar Korrespondent Edi Shukriu, ka qëndruar në Shkup. Ajo ka marrë pjesë në Konferencën ndërkombëtare me titull: “Integrimi kulturor dhe stabiliteti në Ballkan”, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Maqedonisë dhe Akademia e Shkencave të Bullgarisë. Konferenca u organizua si pjesë e projektit bilateral shkencor, që kishte në fokus hulumtimet e vitit 2014 lidhur me identitetet ballkanike dhe stereotipat

rreth identitetit ballkanik në kontekstin e rrjedhave bashkëkohore të integritit kulturor të identiteteve kulturore të veçanta.

TRYEZË SHKENCORE: “Në 200-vjetorin e lindjes së Jeronim De Radës”

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK-ut, më 21 nëntor 2014, organizoi tryezën shkencore: ‘Në 200-vjetorin e lindjes së Jeronim De Radës’. Fjala hyrëse u mbajt nga akademik Mehmet Kraja, ndërsa tryeza u moderua nga akademik Ali Aliu. Tryeza u mbajt sipas programit të paraparë prej dy seancash, gjatë të cilave u lexuan kumtesat e të ftuarve. Në tryezë morën pjesë të gjithë të ftuarit. Në kuadër të seancës së parë u paraqitën me kumtesa pjesëmarrësit, si në vijim: Ali Aliu, Françesko Altimari, Floresha Dado, Sabri Hamiti, Pajazit Nushi, Dhurata Shehri, Luan Starova dhe Alfred Uçi.

Pushimi i shkurtër për kafe u shfrytëzua për promovimin e veprës së Françesko Altimarit ‘Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian’, e cila u mirëprit nga pjesëmarrësit, si një kontribut i çmuar në këtë lëmi. Pjesëmarrësit që u paraqitën me kumtesa në seancën e dytë ishin: Mateo Mandala, Ymer Çiraku, Zejnullah Rrahmani, Ardian Marashi, Fatmir Sulejmani, Mark Marku, Kujtim Shala dhe Mehmet Kraja.

Kjo tryezë u vlerësua të jetë edhe një hap më tutje në trajtimin e veprës së Jeronim De Radës nga aspekte të ndryshme socio-linguistike, estetike etj.

AKADEMIKËT IDRIZ AJETI, MARK KRASNIQI E ALI ALIU NDEROHEN ME “NDERI I KOMBIT “

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani dekoroi me çmimin “Nderi i Kombit” akademikët: Idriz Ajeti, Mark Krasniqi dhe Ali Aliun. Ceremonia solemne u mbajt më 28 nëntor, në Tiranë.

Në nderim të akademikëve në fjalë, kryetari Islami shtroi drekë solemne në mjediset e Akademisë.

REAGIM I ASHAK-ut

Deklaratë e ASHAK-ut përkitazi me ngjarjet e fundit në UP

Udhëheqja e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës po i ndjek me vëmendje zhvillimet në Universitetin e Prishtinës dhe rreth tij. Tensionimet e fundit kanë marrë përmasa shqetësuese.

E tërë kjo situatë tendosjeje në UP ndërlidhet me praktikat e gjata të ndërhyrjeve të ndryshme, të drejtpërdrejta a të tërthorta, nga jashtë në punën e këtij institucioni të pavarur. Pasojat e një gjendjeje të atillë, bashkë me ritmet e paharmonizuara të zhvillimeve e sollën UP-në në një gjendje të vështirë, me rreziqe për proceset e ligjshmërisë në funksionimin e tij.

Zgjedhja e Rektorit të ri – profesor dr. Ramadan Zejnullahut dhe veprimet e tij në drejtim të respektimit të ligjshmërisë dhe të stabilizimit të gjendjes të përcjellë me çrregullime për vite të tëra, janë një shpresë për zhvillime të reja në drejtim pozitiv në këtë institucion të rëndësishëm arsimor-shkencor të Kosovës dhe të rajonit. Duke e njohur dhe punën e tij të mëhershme si profesor i UP-së, si shkencëtar dhe si Dekan shumë i suksesshëm i Fakultetit të Shkencave, duke i vlerësuar nismat që ka ndërmarrë dhe maturinë e vendosmërinë që e karakterizojnë punën e tij, shprehim publikisht mbështetjen për angazhimet e tilla brenda UP-së dhe kërkojmë nga institucionet që të gjejnë rrugë për zhbllokimin e nismave të tij, gjithsesi pozitive.

Jemi të ndjeshëm dhe për kërkesat dhe nevojat e shtresave të ndryshme të popullsisë, sidomos të pasardhësve të pjesëmarrësve të UÇK-së në luftën e viteve 1998-99, por besojmë se shoqëria dhe institucionet munden dhe duhet të gjejnë rrugë për mbështetjen e tyre duke krijuar rrethana për respektimin e ligjshmërisë dhe të pavarësisë institucionale të Universitetit të Prishtinës, ashtu si të të gjitha institucioneve të tilla në vend. Ligjshmëria dhe puna e përgjegjshme institucionale në UP janë thelbësore dhe vetëm respektimi i plotë i tyre mund të krijojë rrethana edhe për mbrojtjen e interesave të shtresave të ndryshme dhe të tërë Kosovës.

Në historinë e këtij vendi, UP-ja ka luajtur rol shumë të rëndësishëm. Prekja e themeleve të tij, që është të qenit institucion i pavarur i arsimit dhe shkencës, vatër e dijes dhe e emancipimit të përgjithshëm të Kosovës dhe të rajonit, mund të lë pasoja që nuk merren me mend në zhvillimet e mëtejme. Prandaj, bëjmë apel tek institucionet e shtetit që të ndërmarrin çdo gjë për të krijuar rrethana sa më të përshtatshme infrastrukturore, po edhe në fushën e burimeve njerëzore e profesionale - shkencore, në mënyrë që UP-ja të jetë në gjendje t'i zgjidhë vetë dhe në mënyrë të pavarur kërkesat e rritura, gjithë duke e ngritur cilësinë. Ndërhyrjet nga jashtë, tensionimet si këto të fundit dhe kërcënimet ndaj Rektorit, që po bën përpjekje serioze për stabilizimin e gjendjes, vetëm sa e thellojnë krizën në këtë institucion vital edhe për funksionimet e tjera në vend. Kërkojmë nga

të gjithë të jemi të matur dhe të përgjegjshëm në vlerësime, ndërhyrje e nxitje dhe të shquajmë atë që është thelbësore për interesat e UP-së dhe të vendit.

EKSPOZITË & MBRËMJE MUZIKORE E POETIKE

Seksioni i Arteve i ASHAK-ut organizoi, më 5 dhjetor 2014, një "Ekspozitë & Mbrëmje Muzikore-Poetike" në kuadër të shënimit të 80-vjetorit të lindjes së muzikologut Engjëll Berisha dhe piktorit Xhevdet Xhafa.

Mbrëmja muzikore-poetike u hap nga akademik Zeqirja Ballata. Akademik Rexhep Ferri mbajti fjalën e rastit për piktorin Xhevdet Xhafa ndërsa akademik Zeqirja Ballata mbajti fjalën e rastit për muzikologun Engjëll Berisha.

Aktori i njohur, Çun Lajqi, recitoi vargje poetike, ndërsa pjesa muzikore përfshiu interpretimet e sopranos Sanije Matoshi, përcjellë në piano nga Lirika Pula - Kasapolli. Mbrëmja muzikore-poetike u mbyll nga akademik Zeqirja Ballata.

AKADEMIK NEXHAT DACI – anëtar i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve të Evropës (ASAE)

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Evropës (ASAE), me seli në Salzburg të Austrisë, ka konfirmuar këto ditë zgjedhjen në radhët e saj të akademik Nexhat Dacit. Në adresë të Akademisë dhe të prof. Dacit, ekspert i njohur në fushën e shkencave kimike, anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ka ardhur letra zyrtare me të cilën njoftohen se është zgjedhur anëtar i rregullt i kësaj Akademie, në mbledhjen e Komitetit të Nominimit, të mbajtur në nëntor të këtij viti. Inaugurimi solemn i Akademik Nexhat Dacit do të bëhet në Asamblenë e Përgjithshme, që do të mbahet më 8 mars 2015, në Salzburg. Me këtë dëshmohen edhe një herë meritat që u bëhen shkencëtarëve nga Kosova në suaza ndërkombëtare.

ANËTAR KORRESPONDENT SALIH GASHI MERR PJESË NË MBLEDHJEN PLENARE TË GRUPI PUNUES TË ALLEA-s

Më 16-19 dhjetor, anëtar korrespondent Salih Gashi, ka marrë pjesë në mbledhjen plenare të grupit punues të ALLEA-s, që është mbajtur në Akademinë e Shkencave të Francës, në Paris. Në takim janë shqyrtuar një varg çështjes në lidhje me aktivitetin e grupi punues

për vitin 2014, përfshirë edhe projektin AEMASE, marrë nga Komisioni Evropian.

ASHAK NDEROHET ME MIRËNJOHJE NGA BIBLIOTEKA NDËRKOMUNALE E PRIZRENIT

Më 22 dhjetor 2014, në Prizren, në një ceremoni solemne ASHAK nderohet me *Mirënjohje për bashkëpunim në pasurimin e fondit librar*. Nga ASHAK në ceremoni morën pjesë anëtarja korrespondente Edi Shukriu dhe znj. Lendita Juniku Pula, sekretare e ASHAK.

Mirënjohjen në emër të ASHAK-ut e mori znj. Pula, e cila me këtë rast përshëndeti të pranishmit me një fjalë rasti.

MBAHET MBLEDHJA E KUVENDIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJEN E KRYESISË SË AKADEMISË

Më 24 dhjetor, në sallën e Akademisë, u mbajt mbledhja e Kuvendit zgjedhor të Akademisë, për zgjedhjen e Kryesisë së re të saj.

Kuvendi zgjodhi Kryesinë e re me këtë përbërje:

Akademik Hivzi Islami - kryetar, akademik Pajazit Nushi - nënkryetar, akademik Isuf Krasniqi - Sekretar i Përgjithshëm, akademik Eqrem Basha - Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari - Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore, akademik Fejzullah Krasniqi – Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe anëtar korrespondent Luan Mulliqi - Sekretar i Seksionit të Arteve.

Lendita Pula

STUDIME SHOQËRORE

2

2015

Botues

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Ganimet Klaiqi

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia:

23.06 tabakë shtypi

Tirazhi:

200 copë

Formati:

16x24 cm

U shtyp në shtypshkronjën:

Focus Print

Shkup